

ENVER HOXHA

VEPRA

46

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SE PUNËS TË
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH**

ENVER HOXHA

VELLIMI

46

PRILL 1971 – SHTATOR 1971

SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»
TIRANË, 1985

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 46-TË

Në këtë vëllim përfshihen materiale të periudhës prill-shtator 1971, një pjesë e të cilave botohen për herë të parë.

Materialet e këtij vëllimi, ashtu si e gjithë vepra e shokut Enver Hoxha, përbajnë ide, orientime dhe mësime të çmuara me vlera për kohën kur janë shkruar, por edhe për të sotmen e të ardhmen. Ato karakterizohen nga parimësia e lartë marksiste-leniniste e nga partishmëria proletare dhe janë një zbatim krijues i marksizëm-leninizmit, në përshtatje me situatat e reja dhe me kushtet reale të vendit tonë. Duke përgjithësuar përvojën e Partisë dhe të masave tona punonjëse në revolucion e në ndërtimin socialist në Shqipëri, edhe në këtë periudhë shoku Enver Hoxha krijoj Veprat e tilla që i shërbyen jo vetëm momentit por që ndriçojnë edhe sot rrugën ku po ecin Partia e popullit dhe njëkohësisht hapin horizonte për të ardhmen. Çdo faqe e këtij vëllimi afirmon edhe një herë se Ai ka qenë projektuesi i të gjitha shndërrimeve revolucionare që janë realizuar në vendin tonë.

Materialet e këtij vëllimi i përkasin një periudhe gjashtëmjore gjatë së cilës masat punonjëse, të udhëhequra nga Partia, krahas punës vetëmohuese që bënин për të realizuar detyrat e ditës e për të shkuar me një

bilanc sa më të pasur suksesesh në Kongresin e 6-të të PPSH, po diskutonin projektdirektivat e pesëvjeçarit të ri.

Prandaj autor i kushton te një vëmendje të posaçme punës që duhej bërë për hartimin e një plani sa më real e mobilizues. Duke folur për këtë problem në mbleðhjen e përbashkët të Byrosë Politike e të Këshillit të Ministrave, në Plenumin e 12-të të KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha kritikon dy tendencat e gabuara që viheshin re në këtë drejtim, si hartimin e planeve lehtësisht të realizueshme, ashtu edhe «planet në stratosferë», pa baza, pra të parealizueshme. «Ne, — tërheq vëmendjen autorit, — nuk mund të gënjejmë veten me asnjë nga këto plane». Por, theksohet në vëllim, harti mi i planit, sado i studiuar që të bëhet, është vetëm hapi i parë; vendimtare është puna për vënien e tij në jetë. Duke trajtuar këtë problem shoku Enver Hoxha porosit në mënyrë të veçantë që të forcohet puna e Partisë me masat punonjëse për të arritur realizimin ritmik e në të gjithë zërat të planit dhe vë në dukje rolin e madh që duhet të luajë veçanërisht klasa punëtore në realizimin e planit të ri pesëvjeçar.

Me interes janë në këtë vëllim takimet që shoku Enver Hoxha ka bërë në këtë periudhë me shokë të Qeverisë për diskutimin e materialeve të përgatitura prej tyre për shifrat e projektplanit pesëvjeçar. Në to shihen qartë mendimi ekonomik shkencor i shokut Enver Hoxha, trajtimi i gjerë dhe i thellë që u bën ai problemeve nga më të ndryshmet të politikës ekonomike të Partisë, si për hapjen e tokave të reja, për zhvillimin e blektorisë e për bazën ushqimore të

saj, për investimet e ndërtimet etj. Në to shohim, gjithashtu, kritikat e drejtëpërdrejta e të hapëta që u ka bërë ai pikëpamjeve e prirjeve të gabuara të Mehmet Shehut, Abdyl Këllezit e Pirro Dodbibës për probleme të ndryshme të ekonomisë.

Orientime shumë të rëndësishme jep shoku Enver Hoxha për revolucionarizimin e punës së Partisë dhe të levave të saj, veçanërisht në drejtimin e ekonomisë dhe në zgjidhjen e suksesshme të problemeve të saj. Duke marrë parasysh sejeta në vendin tonë ecën përpëra, ekonomia sa vjen e rritet me ritme përherë e më të shpejta, zhvillohen forcat prodhuuese e përsosen në rrugë revolucionare marrëdhëniet socialiste në prodhim, autori vë në dukje se ekonomia nuk mund të drejtohet më me të njëjtat metoda e me të njëjtin stil dhe me po ato njohuri që mund të ishin të mjaftueshme disa kohë më parë. Për këtë arsyesh, theksohet në vëllim, është e domosdoshme të intensifikohet puna studiuuese, analizuuese e përgjithësuese e organizative të Partisë dhe e levave të saj, thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik e kulturor si dhe i revolucionit tekniko-shkencor në vendin tonë. Në tërë këtë proces, tonin duhet ta japë klasa punëtore. Lidhur me këtë, shoku Enver Hoxha e përqendron vëmendjen në dy momente kyç: Së pari, ta bëjmë klasën punëtore sa më shumë të ndërgjegjshme për rolin e saj udhëheqës, drejtues, edukues e kontrollues dhe, së dyti, ta ngremë atë në atë nivel që të mund të kontrollojë të tjerët, por edhe të bëjë më parë kontrollin e vetvetes.

Në mjaft materiale të kësaj periudhe shoku Enver Hoxha ndalet veçanërisht në sektorin e bujqë-

sisë, ku, kahas sukseseve, siç del edhe në vëllim, vi-heshin re edhe dobësi, veçanërisht në drejtim të shfrytëzimit jo si duhet të tërë atyre mundësive të mëdha për të rritur rendimentet e për të shtuar prodhimet bujqësore e blegtoreale nëpërmjet mekanizimit e modernizimit të saj, nëpërmjet forcimit të organizimit dhe të disiplinës proletare në punë. Interes të veçantë paraqesin mendimet e orientimet e shokut Enver Hoxha për krijimin e kooperativave bujqësore të tipit të lartë, me pjesëmarrjen e shtetit në to. Ai ndalet hollësishët në rrugët e kalimit gradual të pronës personale në atë të grupit e më pas në atë të gjithë popullit dhe argumenton shkencërisht domosdosh-mërinë e organizimit të ri, qëllimi kryesor i të cilit ishte shtimi i prodhimit. Kahas këtyre, autori kritikon edhe njëanshmërinë që vihej re në disa rrethe e ekonomi bujqësore që kënaqeshin me realizimin e prodhimit të drithërave në total, pa u ndalur për çdo bimë në veçanti, sidomos për grurin, perimet e foragjeret.

Në këtë vëllim përfshihen edhe materiale që kanë të bëjnë me rritjen e rolit të organizatave-bazë në institucionet qendrore e në dikastere, me forcimin e përbërjes së Partisë, të shtrirjes dhe të gjallërimit të jetës së brendshme të saj; për luftën që duhet zhvilluar kundër formalizmit e konservatorizmit në punën me rinnë; për metodën e stilin në punë, cilësinë e prodhimit e zbatimin drejt të normave kolektive; për ngritjen e nivelit të shkrimeve në shtyp, për punën edukuese dhe luftën parandaluese kundër kriminalitetit etj. Mjaft interes paraqet Fjala në Plenumin e 12-të të KQ të PPSH më 1 korrik 1971, ku trajtohen gjerësisht pro-

bleme të forcimit të atdheut nga i gjithë populli ushtar. Të bëhet zakon, jetë e dytë, — porosit shoku Enver Hoxha, — profesioni për të qenë ushtar i përsosur i republikës. «Ushtria është e fortë kur është populli i fortë», — do të theksojë Ai në një bisedë tjetër.

Në artikullin që hap vëllimin, në disa biseda me të huaj e në materiale të tjera, trajtohen probleme të situatës ndërkombëtare, ku demaskohet politika agresive e dy superfuqive, kritikohen rrymat e ndryshme të revizionizmit modern, si dhe pasqyrohen qëndrimet parimore e marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë të Partisë e të shtetit tonë socialist.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

KONGRESI I RESTAURIMIT TË KAPITALIZMIT DHE I SOCIALIMPERIALIZMIT

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

17 prill 1971

Më 9 prill përfunduan në Moskë punimet e Kongresit të 24-t të partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik, që u hap më 30 mars. Ashtu siç edhe pritej, ai riafirmoi vijën hrushoviane të udhëheqjes së sotme sovjetike. Raporti i mbajtur nga Brezhnjevi dhe diskutimet e inskenuara ishin një përsëritje e mërzitshme e tezave të njohura revizioniste, autolëvdata bajate dhe premtimë demagogjike.

Karakteristikë e përgjithshme e këtij kongresi ishte këmbëngulja për të ecur deri në fund në rrugën e tradhtisë së marksizëm-leninizmit, të revolucionit e të socializmit. Brezhnjevi deklaroi zyrtarisht se krerët e Kremlinit nuk kanë ndër mend të heqin dorë nga Kongresi i 20-të dhe nga programi i partisë i aprovuar në Kongresin e 22-të, kur në fuqi ishte Nikita Hrushovi dhe ku u kodifikua revizionizmi modern hrushovian.

Në qoftë se mund të bëhet fjalë për ndonjë gjë të re që solli kongresi i tanishëm, është pikërisht thellimi

i mëtejshëm i hruščovizmit në të gjitha fushat, politike, ekonomike, ideologjike, të brendshme e të jashtme.

Kujdesi dhe preokupacioni kryesor i organizatorëve të kësaj mbledhjeje të madhe revizioniste ishin forcimi dhe perfeksionimi i mjeteve e i metodave për restaurimin e kapitalizmit, për konsolidimin e diktaturës borgjeze revizioniste. Me anë të këtij kongresi udhëheqja revizioniste sovjetike kërkoi të merrte një aprovim formal gjoja në emër të partisë e të popullit për të ndjekur si gjer më tanë politikën e saj social-imperialiste kundër revolucionit e lëvizjes çlirimtare të popujve, për ruajtjen e perandorisë revizioniste sovjetike, për shtrirjen e ekspansionit politik e ekonomik dhe për zgjerimin e bashkëpunimit me imperializmin amerikan.

Antimarksizmi dhe antikomunizmi — baza ideologjike e revizionizmit hruščovian

Fjalimet që u mbajtën në kongres për dhjetë ditë me radhë, mbushin vëllime të tëra dhe shifrat e përmendura as që mund të llogariten. Por kushdo që i ndoqi me vëmendje punimet e kongresit, nuk mund të mos vinte re boshllékun e madh teorik, varfëri-në e mendimeve dhe mediokritetin burokratik. Në raportet e Brezhnjevit e të Kosiginit pati vend për të zënë në gojë të gjitha cikërrimat e ekonomisë, që nga hekurat për hekurosje e deri tek tirazhet e broshurave, që nga puna e pensionistëve në ndihmë të komunales

e deri te makinat qepëse. Por kërët sovjetikë mbajtën një heshtje të plotë dhe u bënë bisht problemeve të mprehta që preokupojnë popullin dhe shoqërinë sovjetike. Në Bashkimin e sotëm Sovjetik ekziston një konflikt i njojur midis aparatit burokratik të partisë e të shtetit, nga njëra anë, dhe masave të gjera të popullit, nga ana tjetër; ekzistojnë kontradikta të thella midis centralizmit burokratik në fuqi dhe kërkesave të masave për liri e demokraci. Por për këto nuk u tha asnjë fjalë.

Sot vështirë se mund të gjesh një vend tjetër në botë ku burokracia të ketë përqendruar në duart e saj fuqi të tillë të mëdha e të pakontrolluara si në Bashkimin Sovjetik. Ajo mban në duart e saj jo vetëm pushtetin politik, por edhe atë ekonomik e monopolin ideologjik. Klasa punëtore dhe masat punonjëse tanimë janë zhveshur nga ato të drejta që fituan në Revolucionin e Tetorit për të ushtruar kontrollin e vet mbi aparatet dhe për të marrë pjesë drejtpërdrejt në qeverisjen e vendit. Edhe pse kanë mbetur akoma mjaft organizma të tillë si sovjetët, bashkimet profesionale, komsomoli, mbledhjet e prodhimit etj., ato ruajnë vetëm emrin dhe formën e vjetër, por kanë humbur përmbajtjen dhe janë kthyer në organe propagandistike të vendimeve e të direktivave të aparatit burokratik dhe në instrumente për zbatimin e tyre.

Demokracia për të cilën u mburr Brezhnjevi në kongres nuk është demokracia për masat, por për kastën burokratike. Është fakt se jo vetëm masat, por edhe organet e ashtuquajtura të zgjedhura nuk marrin pjesë në formulimin e politikës dhe të qëndrimeve,

qoftë për çështjet e brendshme, qoftë për ato të jashtme. Ajo përcaktohet nga rrethi i ngushtë i klikës në fuqi dhe masat vihen kurdoherë përparrë fakteve të kryera. Mos vallë u pyetën masat sovjetike kur u denigrua Stalini e u mohua lufta dhe puna revolucionare e brezave të tërë të bolshevikëve e të popullit sovjetik, kur u rrëzua Hrushovi dhe vendin e tij e zunë Brezhnjevi e Kosigini, kur u sulmuan Kina e Shqipëria, kur u pushtua Çekoslovakia etj., etj.? Nuk është shprehje anekdotike thënia tanimë e zakonshme e njerëzve sovjetikë se «*naçalstvo znajet*» (e di udhëheqja) për çdo gjë që ndodh në vendin e tyre. Ajo shpreh një realitet të hidhur, sundimin absolut të burokracisë, hendekun e thellë që ekziston midis saj dhe popullit.

Prej vitesh në Bashkimin Sovjetik ka lindur një kontradiktë tjetër e mprehtë, e cila as ka gjetur dhe as do të gjejë zgjidhje përderisa në fuqi qëndrojnë revisionistët. Kjo është kontradikta midis punës së madhe të njerëzve sovjetikë në fushën e prodhimit të të mirave materiale e shpirtërore dhe shkallës së ulët të efikasitetit të saj. Makina e rëndë burokratike është bërë një pengesë e pakapërcyeshme në rrugën e zhvillimit të forcave prodhuese, në shfrytëzimin racional të pasurive të vendit, të krahut të punës e të mjeteve materiale e financiare, të futjes së teknikës e të teknologjisë së përparuar etj. Ajo mbyt iniciativën dhe veprimtarinë krijuese të masave.

Vetë Brezhnjevi në raportin e tij u detyrua të pranonte se ekonomia sovjetike vuan sot nga fenomene të tillë si zvarritja e ndërtimeve kapitale, mosshfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese, ngadalësia në futjen e

teknikës së re në prodhim, rritja jo në nivelin e mundshëm e rendimentit të punës, prodhimi i shumë artikujve me cilësi të dobët, mungesa e organizimit në prodhim etj., etj.

Për të dalë nga këto kontradikta e vështirësi revolucionistët hruščovianë, në përputhje me konceptet e tyre politike e ideologjike, ndërmorën futjen e metodave kapitaliste të organizimit e të drejtimit të prodhimit dhe të shpërndarjes. Këto u sankzionuan në mënyrën më të plotë e më të gjithanshme në të ashtuquajturën reformë ekonomike. Qëllimi i saj ishte ta sillte ekonominë sovjetike në përshtatje me superstrukturën borgjeze revolucioniste.

Por rruga kapitaliste e prodhimit që zgjodhën revolucionistët nuk mund ta nxirre në dritë ekonominë sovjetike. Filluan të shfaqen gjithnjë e më me forcë ato plagë e sëmundje që janë tipike të shoqërisë borgjeze, si konkurenca, fluktuacioni i madh i fuqisë punëtore, lindja e shpërpjesëtimeve midis degëve të ndryshme të prodhimit, zgjerimi i marrëdhënieve të tregut edhe në fushën e mjeteve kryesore të prodhimit etj. Mbi bazën e reformave kapitaliste ka lindur tani kontradikta e madhe sociale, midis klasës punëtore e masave punonjëse, nga njëra anë, që krijojnë të gjitha të mirat materiale, dhe klasës së re borgjeze, që përvetëson djersën e punën e popullit punonjës, nga ana tjetër. Stimuli material e fitimi, që qëndrojnë në themel të reformës, po e thellojnë e po e acarojnë gjithnjë e më shumë këtë kontradiktë.

Propaganda revolucioniste, bile edhe ajo borgjeze, e quajnë Kongresin e 24-t si kongresin e «konsumit».

Kjo ka lidhje me premtimet e shumta të Brezhanjevit e të Kosiginit për të shtuar në këtë pesëvjeçar prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë dhe për ngritjen e rrogave të disa kategorive të punonjësve. Natyrisht, revisionistët përpiken t'i reklamojnë këto masa të «kujdesit» të tyre për të ngritur nivelin e jetesës së popullit, se gjoja ato burojnë nga vetë qëllimi i prodhimit në Bashkimin Sovjetik. Në të vërtetë, qëllimi i prodhimit të sotëm në Bashkimin Sovjetik është nxjerra e fitimeve në dobi të kastës burokratike në fuqi. Në realitet masat e premtuara janë një koncesion që klasa sunduese borgjeze, në momente të caktuara të ashpërsimit të luftës klasore, është e detyruar t'i bëjë për të ruajtur sundimin e saj. Të tilla lëshime për të qetësuar e për të mashtruar punonjësit, për t'i larguar ata nga lufta revolucionare, ka bërë dhe bën herë pas here edhe borgjezia e vendeve kapitaliste.

Nuk është e rastit që «preokupacioni» për rritjen e nivelit të jetesës së masave u shfaq pikërisht tanë. Ai erdhi menjëherë pas ngjarjeve të kohëve të fundit në Poloni, kur shpërtheu revolta e furishme e klasës punëtore polake kundër regjimit revisionist. Ngjarjet e Polonisë treguan se punonjësit polakë nuk mund të pajtoheshin më gjatë me gjendjen e mjerueshme ku ishin katandisur, nuk mund të duronin shtypjen politike dhe shfrytëzimin ekonomik. Si shkak për shpërthimin e revoltës shërbyen niveli i ulët i pagave, ngritja e çmimeve, mungesa e artikujve të konsumit dhe cilësia e tyre e dobët, mungesa e banesave etj. Por ajo mori karakterin e një lufte të theksuar politike dhe u drejtua kundër tërë sistemit revisionist.

Udhëheqësit e Moskës, për t'u dalë përpara dhe për të evituar shpërthime të tilla si ato të Polonisë, nxituan ta zgjidhin pak qesen. Por ata gabohen rëndë në qoftë se mendojnë se me thërrime të vogla do të mund t'i mashtrojnë për një kohë të gjatë punonjësit dhe të kapërcejnë kontradiktat e thella që kanë me ta. Pakënaqësitet e mëdha të punonjësve sovjetikë, ashtu si edhe të të gjitha vendeve të tjera revizioniste, nuk burojnë vetëm nga shkaqe ekonomike. Ato kanë lindur dhe janë zgjeruar, para së gjithash, për shkaqe politike e ideologjike. Përderisa të ekzistojë tradhtia revizioniste, që është burimi i të gjitha të këqijave, shpërthimet revolucionare të klasës punëtore janë të pash-mangshme, pavarësisht se cili motiv do të shërbejë si detonator i tyre.

Me revizionistët sovjetikë ndodh e njëjta gjë si edhe me borgjezinë e vendeve të vjetra kapitaliste, e cila, krahas disa lëshimeve që bën në fushën e kërkuesave socialekonomike të punonjësve, shtrëngon vidhat për të mbajtur në dorë frenat e sundimit të saj. Brezhnjevi, në raportin e tij, kërkoi disiplinë dhe «zbatim pa kusht» të urdhreve e të direktivave të aparatave shtetërore e të partisë. Ai kërcënoi gjithë ata që nuk pajtohen me veprimet e me pikëpamjet e udhëheqjes sovjetike dhe i paralajmëroi me rreptësi ata që do të «njollosin flamurin» e klikës sunduese.

Këtë shtrëngim të vidhave Brezhnjevi mundohet ta paraqesë si një luftë që ai bën për të mbrojtur «vijën e përgjithshme të partisë» nga sulmet që vijnë nga e majta dhe nga e djathta. Pavarësisht nga poza parimore që kërkon të mbajë Sekretari i Përgjithshëm

i partisë revizioniste sovjetike, në këtë mënyrë ai është i detyruar të pohojë ekzistencën e kundërshtimeve që ka në popullin sovjetik ndaj vijës revizioniste. Është pikërisht frika e zgjerimit të pakënaqësisë dhe e kundërshtimit të shtresave të ndryshme të populsisë ndaj politikës zyrtare që e detyron udhëheqjen e Kremlinit të manovrojë midis demagogjisë dhe kërcënimit të përdorimit të forcës.

Për të ruajtur sundimin e saj, klika renegate sovjetike nuk e ka harruar kurrë edhe përpunimin ideologjik të masave, mbajtjen e tyre nën goditjen e vazhdueshme të propagandës revizioniste. Kjo u duk qartë edhe në kongresin e fundit, ku Brezhnjevi, Kosigini e të tjerët u munduan që revizionizmin ta shesin si marksizëm, bile edhe krijues, që qëndrimet e metodat e tyre revizioniste t'i paraqesin si leniniste. Ata kërkojnë të mbytin çdo mendim kritik e krijues, t'u imponojnë masave konceptet e nënshtrimit dhe të bindjes pa kusht ndaj politikës dhe veprimtarisë së udhëheqjes. Këtu s'ka asgjë marksiste, asgjë leniniste. Me autoritetin dhe emrin e Leninit e të leninizmit ata spekulojnë për të mbuluar boshllëkun e ideologjisë së tyre revizioniste, për të fshehur tradhtinë e tyre të plotë ndaj marksizëm-leninizmit.

Brezhnjevi, në raportin e tij, u mburr për «kontributin» që udhëheqësit sovjetikë paskan dhënë në zhvillimin dhe në pasurimin e teorisë marksiste-leniniste, në fushën e ekonomisë, të rolit dhe të ndërtimit të partisë, të historisë dhe të teorisë së shtetit, të zhvillimit të kapitalizmit të sotëm e të socializmit, të lëvizjes revolucionare e nacionalçlirimitare. Në qoftë se

mund të flasim për një «kontribut» të vërtetë të revizionistëve sovjetikë, ai është kontributi për revisionimin e përgjithshëm të marksizëm-leninizmit, për shtrembërimin flagrant të teorisë e të praktikës së socializmit. Këtu ata mbajnë flamurin dhe mund t'u njihen të gjitha meritat.

Si mund të quhet zhvillim i mëtejshëm i teorisë së ndërtimit të socializmit «përpunimi i metodave të reja të planifikimit dhe të drejtimit të ekonomisë», të cilat i vunë kazmën ekonomisë socialiste në Bashkimin Sovjetik dhe i hapën rrugën rivendosjes së kapitalizmit? Për çfarë kontributi mund të bëhet fjalë në «doktrinën mbi rolin udhëheqës të partisë komuniste» kur hrushovianët, nën maskën e «partisë së të gjithë popullit», e likuiduan partinë bolshevike të Leninit e të Stalinit dhe e shndërruan atë në një vegël të sundimit të tyre mbi klasën punëtore dhe popullin sovjetik? Si mund të quhen «pasurim i historisë e i teorisë së shtetit» shpifjet dhe sulmet e egra kundër diktaturës së proletariatit, që u bënë nën maskën e luftës kundër kultit të individit, dhe likuidimi i saj i plotë nën pretekstin e shndërrimit në «shtet të të gjithë popullit»?

Udhëheqësit revizionistë të Bashkimit Sovjetik ngrenë në qiell edhe «përpunimin e parimeve të reja të marrëdhënieve midis vendeve socialiste». Mos vallë janë marksizëm-leninizëm «teoria e sovranitetit të kufizuar» të Brezhnjevit, pushtimi i Çekoslovakisë, ndërhyrja brutale në vendet e tjera, shfrytëzimi ekonomik që u bëhet shteteve të Evropës Lindore, provokacionet e sulmet kundër Kinës e Shqipërisë? Apo

mos vallë kanë ndihmuar zhvillimin e teorisë së revolucionit, siç pretendojnë ata, predikimet e tyre oportuniste mbi rrugën paqësore e parlamentare për në socializëm, mbi integrimin e kapitalizmit në socializëm me anën e reformave, mbi kalimin e vendeve të ndryshme në socializëm pa revolucionin socialist, pa udhëheqjen e partisë proletare e pa diktaturën e proletariatit?

Raporti i Brezhnjevit dhe të gjitha punimet e kongresit treguan se baza ideologjike e gjithë veprimtarisë së revizionistëve hrushovianë nuk është marksizëm-leninizmi, por antimarksizmi ideologjia borgjeze, një variant i së cilës është tërë revizionizmi modern. Vija që sankzionoi Kongresi i 24-t në esencë është vija e vjetër hrushoviane. Kongresi nuk bëri gjë tjetër veçse shprehu edhe një herë vendosmërinë e udhëheqjes së sotme sovjetike për të vazhduar me këmbëngulje në rrugën e saj të tradhtisë e të kundërrevolucionit.

Kurs shovinist dhe neokolonialist i shtetit të madh

Një vend të rëndësishëm në dokumentet dhe në punimet e Kongresit të 24-t zunë marrëdhëniet midis Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera revizioniste. Siç edhe pritej, Brezhnjevi e të tjerët paraqitën një tablo mjaft idiliqe, si të marrëdhënieve të dyanshme, ashtu edhe të gjendjes në këto vende. Pa u skuqur aspak nga turpi, ai foli për «forcimin e miqësisë e të

unitetit midis Bashkimit Sovjetik e vendeve socialiste» sikur të mos kishte ndodhur fare çështja çekosllovake, foli për «sukseset e përparimet e vendeve vëllezër» sikur të mos kishin ndodhur fare ngjarjet në Poloni, foli për «marrëdhëniet e barabarta e pavarësinë» e tyre sikur të mos ekzistonte fare pushtimi i përhershëm ushtarak i Gjermanisë Demokratike, Hungarisë, Polonisë, Bullgarisë e Mongolisë. Ai nuk i kurseu deklaratat bombastike për «ndihmën vëllazërore» që u dhënka Bashkimi Sovjetik këtyre vendeve sikur bota të mos e dinte fare se si ai i shfrytëzon ato ekonomikisht se si i ka shndërruar në shtojca të ekonomisë sovjetike.

Por me demagogji dhe lustra nuk mund të mbulohet gjendja tragjike që mbretëron në kampin revisionist. Çekoslovakia ka qenë dhe mbetet një akt-akuzë e parrëzueshme për klikën që sundon sot në Kremlin. Brezhnjevi, në raportin e tij, u mundua ta kalojë shkarazi problemi çekoslovak, duke kujtuar se kështu mund t'ia hedhë opinionit publik. Për të justifikuar pushtimin e Çekoslovakisë, ai s'gjeti gjë tjetër më të mirë se një deklaratë të Husakut që e quante agresionin «një akt internacionalist». Një dëshmitar me të vërtetë kyç! Sjellja si «argument» e deklaratave të një njeriu aq të diskredituar siç është Husaku dhe që janë shkruar në zyrat e ambasadës sovjetike në Pragë, tregon se në ç'pozitë të ulët e kanë vënë veten udhëheqësit sovjetikë.

Agresioni në Çekoslovakia mbetet agresion dhe asnë teori,asnë dokument ose argument nuk mund ta justifikojë. Ai zbuloi dhe vërtetoi karakterin e

vërtetë të politikës së sotme imperialiste të Bashkimit Sovjetik, kalimin e tij në socialimperializëm. Ngjarjet e gushtit 1968 demaskuan gjithë falsitetin e predikimeve demagogjike të krerëve sovjetikë. Ato treguan se Bashkimi Sovjetik është sundimtari absolut në këto vende, ai që bën ligjin, që përcakton politikën e brendshme e të jashtme të tyre. Pushtimi i Çekoslovakisë dhe ngritja në normë zyrtare e doktrinës mbi «sovranitetin e kufizuar» dëshmojnë se vendet e tjera revizioniste tanimë e kanë humbur lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tyre kombëtar.

Çekoslovakia mbetet gjithnjë një plagë e hapët për revizionistët e Moskës dhe ajo nuk mund të shërohet as me fjalët e Brezhnjevit, as me deklaratat e kuqislingëve çekoslovakë. Vazhdimi i qëndrimit të trupave sovjetike në Çekoslovakia s'ka si të mos e thellojë gjithnjë e më shumë krizën çekoslovake, që është kritë e gjithë revizionizmit hruščovian. Pushtimi i Çekoslovakisë zgjeron e thellon luftën e popullit çekoslovak për liri e pavarësi ndaj pushtuesve të huaj dhe shton revoltimin e opinionit publik botëror ndaj politikës imperialiste të udhëheqësve sovjetikë.

Një tjetër problem që Brezhnjevi u mundua t'i bëjë bisht në raportin e tij ishte problemi polak. Ai u përpoq ta trajtojë atë sikur i takon vetëm Polonisë, sikur s'ka të bëjë aspak me vendet e tjera revizioniste, dhe u kufizua t'i urojë Gierekut «suksese të mëdha në kapërcimin e vështirësive». Brezhnjevi nuk mund ta hapte përpëra kongresit dosjen e ngjarjeve të fundit në Poloni. Një gjë e tillë do të zbulonte

se gjendja dhe shkaqet që i ngritën në revoltë punëtorët polakë janë të njëllojta për të gjitha vendet revizioniste, duke përfshirë edhe vetë Bashkimin Sovjetik. Ato do të tregonin karakterin dhe kuptimin e vërtetë politik të dhjetorit polak, si dhe faktin e ri të madh se klasa punëtore në vendet revizioniste fillojë zgjohet dhe të ngrihet kundër pushtetit sundues revizionist.

Udhëheqësit sovjetikë, ashtu si në rastin e Çekoslovakisë, edhe ngjarjet polake kërkojnë t'i rrethojnë me një mur heshtjeje, t'i vënë një kapak dhe t'i konsiderojnë si të shkuara e të harruara. Por kazani përbrenda zien, herët ose vonë ai do të shpërthejë përsëri. Lufta revolucionare e klasës punëtore dhe e masave punonjëse nuk mund të shuhet pse e injorojnë Brezhnjevi dhe miqtë e tij. Ajo ka ligjet e saj të zhvillimit, është e pashmangshme pérderisa interesat e klasës punëtore dhe të klikave revizioniste në fuqi janë të kundërtë dhe të papajtueshme.

Perspektiva që u paraqiti Kongresi i 24-t vendeve revizioniste është shumë e errët. Në fakt ai tregoi se synimi i udhëheqësve sovjetikë është t'u rrëmbejë edhe atë pak çka u ka mbetur nga pavarësia e sovranitetit i tyre kombëtar dhe t'i shndërrojë në guberna ushtarake të tipit carist. Brezhnjevi, në mënyrë aspak të kamufluar, kërkoi koordinimin e politikës së tyre të jashtme me atë të Bashkimit Sovjetik, integrimin ekonomik dhe forcimin e instrumenteve politike e ushtarake të Traktatit të Varshavës. Në të vërtetë, «koordinimi i politikës së jashtme» do të thotë të mos ketë fare politikë të jashtme për vendet e tjera, ose që ajo

të jetë një jehonë propagandistike e departamentit të Gromikos. Dhe praktika tregon se këto vende në fushën e marrëdhënieve ndërkombe të kanë humbur tanimë individualitetin e pavarësinë e tyre dhe janë të detyruara të aprovojnë pa kushte çdo manovër të diplomacisë sovjetike edhe atëherë kur këto bien në kundërshtim me interesat e tyre kombëtarë, siç është rasti me Traktatin Moskë-Bon etj.

Për sa i përket integrimit ekonomik, nuk është vështirë të kuptohet se cilat janë qëllimet dhe pasojat e tij. Që tani ekonomia e vendeve revisioniste është shndërruar në një shtojcë të ekonomisë sovjetike. Drejtimet, ritmet dhe përpjesëtimet e saj përcaktohen jo në Berlin, Pragë apo Varshavë, por në Gosplanin e Moskës. Ajo varet për çdo gjë nga Bashkimi Sovjetik, për lëndë të parë e teknologji. Tregtia e tyre e jashtme mbahet krejtësisht në duart e Moskës. I ashtuquajturi Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke në të vërtetë është një këshill i skllavërimit ekonomik, një instrument i politikës neokolonialiste të Bashkimit Sovjetik.

Një funksion të tillë, por në fushën ushtarake e politike, luan edhe Traktati i Varshavës. Nëpërmjet mekanizmave të tij, që Brezhnjevi kërkon t'i forcojë, udhëheqja sovjetike ushtron presion politik e ushtarak mbi aleatët e saj, i mban ata nën një kontroll të vazhdueshëm dhe i detyron t'u binden urdhreve të saj. Traktati i Varshavës nuk është më një forcë për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së vendeve pjesë-marrëse nga kërcënimet e huaja imperialiste, por një mjet për të ruajtur pushtimin e huaj revisionist. Për

më tepër tani Traktati i Varshavës paraqitet si një bllok ushtarak në shërbim të politikës ekspansioniste sovjetike, i cili përbën një rrezik serioz edhe për vendet e tjera.

Politika e nënshtimit ndaj udhëheqjes sovjetike, e cila doli mjaft e qartë edhe në Kongresin e 24-t, synon jo vetëm vendet satelite, por edhe të gjitha partitë revizioniste që mbajnë lidhje me Moskën. Në raport, në fjalën e mbylljes dhe në atë të darkës për delegacionet e huaja pjesëmarrëse në kongres, Brezhnjevi kërkoi nga të gjitha partitë bindje dhe solidaritet të pakufizuar ndaj politikës aktuale të Bashkimit Sovjetik. Ai, me mjaft arrogancë, e quajti si «antikomuniste» e «antisovjetike» çdo vërejtje apo kritikë që mund t'i bëhet «veprimtarisë së pagabuar» të udhëheqjes sovjetike. Ai kërkoi prej tyre të lënë mënjanë çdo gjë dhe si qëllim kryesor e të vetëm të veprimtarisë së tyre të konsiderojnë mbështetjen pa kushte dhe në çdo rrethanë të politikës shtetërore sovjetike.

Shumë elozhe u bëri Brezhnjevi mbledhjeve ndërkombëtare revizioniste dhe kërkoi që ato të «futen thellë në praktikën e lëvizjes komuniste botërore». Dihet mirë se ç'janë këto mbledhje dhe kujt i shërbejnë ato. Udhëheqja sovjetike i ka përdorur dhe do t'i përdorë për t'u imponuar të tjerëve konceptet dhe diktatin e saj, për t'i mbajtur partitë e tjera të lidhura pas qerres së politikës së saj.

Por dëshirat janë një gjë dhe realiteti është një gjë tjetër. Fakt është se gjithnjë e më tepër partitë e ndryshme revizioniste jo me shumë entuziazëm dhe me shumë qejf e shfaqin «solidaritetin» e tyre ndaj Mos-

kës. Në kampin revizionist sot nuk ka dhe as që mund të ketë unitet. Secila parti i bie gjithnjë e më shumë kambanës së saj nacionaliste. Presioni i diktatit sovjetik, nga ana tjetër, i shton tendencat centrifugale, mosmarrëveshjet e konfuzionin. Këtë situatë, të papël-qyeshme për Moskën, në njëfarë mase u detyrua ta pranojë edhe Brezhnjevi kur foli për «vështirësitë e unititetit», për «tendencat e vetizolimit nacional», për «gjallërimin e oportunizmit të djaththë» etj.

E shqetësuar nga kjo situatë, klika sovjetike bëri çmos që të mblidhte në kongres sa më shumë delegacione të huaja. Ajo ndiqte dy qëllime: propagandistike e politike. Nga njëra anë, synonte që praninë e delegacioneve të huaja në Moskë ta paraqiste në sytë e opinionit publik të brendshëm e të jashtëm si një shprehje të solidaritetit me vijën e Kremlinit dhe, nga ana tjetër, t'i bënte mysafirët komplisë të kësaj politike. Por bota nuk gjykon për udhëheqësit sovjetikë dhe për politikën e tyre nga fakti se kush shkon e vjen në Moskë, as nga fjalët e përzemërtë që u adresojnë atyre. Me gjeste të tillë këta nuk i shpëtojnë nga demaskimi krejt sovjetikë dhe as e nderojnë veten.

Zjarrfikës të revolucionit dhe të lëvizjes çlirimtare të popujve

Ashtu siç pritej, në Kongresin e tyre të 24-t revolucionistët sovjetikë nuk i kursyen deklaratat e kritikat kundër imperializmit. Po t'u besosh fjalëve të tyre, duket sikur udhëheqja sovjetike kundërshton me të

gjitha mënyrat politikën e agresionit e të luftës të imperializmit, me atë amerikan në krye. «Antiimperializmi» i revisionistëve sovjetikë ka qenë dhe mbetet një parullë boshe e demagogjike, e destinuar të mashtrojë popujt dhe të minojë luftën e tyre. Bashkimi Sovjetik ka pushuar prej kohësh së qeni një fuqi revolucionare e antiimperialiste. Ai jo vetëm që vetë nuk bën asnjë luftë të vërtetë kundër imperializmit, por edhe saboton çdo lëvizje revolucionare e nacionalçlirimtare.

Brezhnjevi mund të mburret sa të dojë, mund të betohet e të përgjërohet pér solidaritetin dhe ndihmën që gjoja Bashkimi Sovjetik u jep popujve që luftojnë pér liri e pavarësi, kundër kolonializmit, shtypjes e shfrytëzimit. Por praktika ka treguar se revisionizmi sovjetik është përpjekur dhe ka bërë çmos që të shuajë çdo zjarr revolucionar e çdo luftë antiimperialiste kudo që ka ndodhur.

Qëndrimet dhe veprimet proimperialiste e kundërrevolucionare të udhëheqjes sovjetike kushtëzohen nga vetë viaja dhe natyra e revisionizmit. Çdo lëvizje revolucionare e çlirimtare e vërtetë, në çdo vend që të shpërthejë, do të vijë patjetër në kundërshtim të hapët me revisionistët sovjetikë. Çdo revolucion, me dashje a pa dashje, e detyron Bashkimin Sovjetik të mbajë qëndrim. Po ta përkrahë, atëherë ai do të vinte në kundërshtim me fuqitë e tjera imperialiste e reaksionare, gjë që nuk e dëshiron në asnjë mënyrë. Po të rrijë mënnjanë, atëherë si t'i justifikojë përrpara opinionit publik të brendshëm e të jashtëm pretendimet e tij si «qendra e madhe e komunizmit botëror», si «partia e vërtetë komuniste», «përkrahësja e revolucionit» etj.?

Prandaj e vëtmja rrugë objektivisht e kushtëzuar është ta sabotojë revolucionin që pa lindur, ose ta shuajë kur ai shpërthen. Tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit e revolucionit i ka mbërthyer ata për gryke dhe nuk i lë të manovrojnë. Ajo i detyron të jenë medoemos-zjarrfikës të revolucionit.

Udhëheqësit sovjetikë prej vitesh sabotojnë luftën heroike të popullit vietnamez dhe përpilen me çdomjet t'i shpëtojnë nga disfata e pashmangshme imperialistët amerikanë. Ata ushtrojnë presione të shumëlllojta ndaj Vietnamit, për ta detyruar atë të gjunjëzohet dhe të pranojë diktatin amerikan. Ata flasin shumë për «solidaritet» dhe «ndihmë» popujve të Indokinës. Por, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës vazhdojnë agresionin në Kambozhia, ata edhe sot e kësaj dite mbajnë lidhje diplomatike me klikën reaksionare të Lon Nolit. Kur imperialistët amerikanë hynë në Laos, revisionistët sovjetikë u mjaftuan vetëm me një deklaratë «simpatie». Zgjerimi i agresionit imperialist në Indokinë e në vende të tjera nuk i ka penguar aspak revisionistët sovjetikë të mbajnë e të forcojnë miqësinë e bashkëpunimin me vrasësit e popujve, imperialistët amerikanë. Ku janë këtu antiimperializmi, përkrahja për luftën e drejtë të popujve të Indokinës, për të cilat Brezhnev foli aq gjatë dhe me aq shumë reklamë në Kongresin e 24-t?

Duket, në ndonjë rast, siç është ai i lëvizjes anti-imperialiste arabe, sikur Bashkimi Sovjetik e ndihmon atë dhe sikur nuk kursethet t'i japë njëfarë përkrahjeje materiale e politike. Por qëllimi i tij është të shtrijë influencën e vet ekspansioniste. Në raste të tjera ai

mban ndaj lëvizjeve çlirimtare asnjanësi të plotë, ose i saboton ato me të gjitha mjetet.

Le të shikojmë qëndrimin e Bashkimit Sovjetik ndaj lëvizjes së partizanëve palestinezë, e cila qëndron në pararojë të luftës së popujve arabë. Revisionistët e Moskës, ndërsa hiqen si mbrojtësit e popujve arabë, sikur përkrahin të drejtën e tyre për liri e pavarësi, sikur janë përkrahës të përpjekjeve të tyre antiimperialiste, ata e luftojnë dhe kërkojnë ta shuajnë lëvizjen e partizanëve palestinezë. Qëndrimi krejt indiferent që ata mbajnë ndaj sulmeve antipalestinezë të reaksionit jordanëz, është një provë më se e qartë. Udhëheqësit sovjetikë e kundërshtojnë lëvizjen e partizanëve palestinezë, pasi ajo shkon ndesh me politikën e tyre hegemoniste në Lindjen e Mesme, godet komplotet e tyre të përbashkëta me imperializmin amerikan për sundimin e dy superfuqive në këtë zonë, demaskon demagogjinë dhe falsitetin e politikës së tyre gjoja antiimperialiste.

Revisionistët sovjetikë, për të depërtuar në Lindjen e Mesme dhe për të zënë pozita ekonomike, politike e ushtarake, duke u maskuar me petkun e «anti-imperializmit» përpiken të shfrytëzojnë vështirësitë e përkohshme të popujve arabë. Ata duan, ashtu si imperializmi amerikan, të ngulin rrënjjë në këtë zonë për të krijuar baza që t'u shërbejnë si plasdarm për qëllimet e tyre ekspansioniste e imperialiste në kontinentet e Afrikës e të Azisë. Krerët revisionistë të Bashkimit Sovjetik, së bashku me imperializmin amerikan, përpiken t'i përcajnjë popujt arabë dhe t'u diktojnë një paqe në dëm të interesave të tyre dhe në dobi të dy

superfuqive. Të gjitha qëndrimet e veprimet e revisionistëve sovjetikë në Lindjen e Mesme janë një provë tjetër e falsitetit të «antiimperializmit» të tyre, një dëshmi e qartë e bashkëpunimit me imperializmin amerikan për ndarjen e zonave të influencës dhe sundimin e botës.

Jo rastësisht Brezhnjevi, në raportin e tij, nuk e përmendi fare luftën heroike të popujve të Amerikës Latine kundër imperializmit amerikan dhe diktaturave fashiste. Nuk është se ai nuk e njeh gjendjen, por sepse udhëheqësit sovjetikë e konsiderojnë Amerikën Latine një zonë influence të SHBA-së, ku ata nuk duan të përzihen, sepse nuk duan të prishen me regjimet reaksionare, me të cilat kërkojnë të zgjerojnë e të forcojnë lidhjet e bashkëpunimin e tyre. Lufta revolucionare e popujve latino-amerikanë, të cilët në shumë vende kanë rrëmbyer armët, bie në kundërshtim me predikimet e revisionistëve sovjetikë, që shprehën kundër dhunës revolucionare, për rrugën paqësore etj.

Në këtë vijë të qëndrimit të revisionistëve sovjetikë është edhe mospërfillja e plotë e lëvizjeve çlirimtare të popujve të Azisë e të Afrikës sikur këto të mos ekzistonin fare. Mos vallë mund të quhen ndihmë për zhvillimin e lëvizjes revolucionare iluzionet që i theksoi edhe një herë tjetër Brezhnjevi në kongres se gjoja shumë nga këto vende, nëpërmjet së ashtuquajturës «rrugë jokapitaliste të zhvillimit», kanë marrë kursin e socializmit dhe të ndërtimit të shoqërisë sociale?

Të gjitha predikimet e veprimet e revisionistëve

sovjetikë në lidhje me revolucionin e lëvizjen çlirimtare janë predikime e veprime oportuniste e kundërrevolucionare, që kanë për qëllim të shuajnë flakët e luftës kundër imperializmit për çlirimin kombëtar e shoqëror. Kështu ka qenë deri më sot, kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Çdo iluzion për «antiimperializmin» e udhëheqësve sovjetikë, çdo besim naiv në deklaratat e tyre demagogjike u sjell një dëm të madh lëvizjes revolucionare botërore, luftës së vërtetë kundër imperializmit.

Politikë e superfuqisë për ekspansion dhe hegjemoni botërore

Në raportet e Brezhnjevit, Kosiginit dhe në diskutimin e Gromikos e të tjerëve një vend të madh zunë trajtimi i marrëdhënieve sovjeto-amerikane, problemet e luftës e të paqes dhe përgjithësisht politika e jashtme e Bashkimit Sovjetik. Esenca e tërë vijës sovjetike në marrëdhëni ndërkombëtare është politika e superfuqisë që lufton për ekspansion dhe hegjemoni botërore.

Kritika ndaj politikës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës pati mjaft në Kongresin e 24-t. Por të gjitha këto ishin sâ për sy e faqe dhe të imponuara nga rrethanat. Thelbi i vërtetë i qëndrimit të revisionistëve sovjetikë, vija zyrtare e tyre në marrëdhëni me SHBANË, nuk janë demaskimi dhe lufta kundër tyre, por dëshira për të zgjeruar e për të forcuar gjithnjë e më shumë dhe në të tëra fushat bashkëpunimin me impe-

rializmin amerikan. «Përmirësimi i marrëdhënieve sovjeto-amerikane, — deklaroi Brezhnjevi, — do t'u përgjigjej interesave të popujve sovjetikë e amerikanë, interesave të forcimit të paqes».

Popujt e botës nuk mund të mos çuditen dhe të pyesin se si qenka e mundur që bashkëpunimi me një vend, i cili, siç thotë edhe vetë Brezhnjevi, «përpinqet të ruajë rolin e garantit dhe të mbrojtësit të sistemit ndërkombëtar të shfrytëzimit e të shtypjes», që «përpinqet të sundojë kudo, të ndërhyjë në punët e popujve të tjerë, të shkelë pa ceremoni të drejtat e ligjshme dhe sovranitetin» etj., të konsiderohet «në interes të popujve e të paqes».

Midis fjalëve dhe veprave të revisionistëve sovjetikë ka pasur gjithnjë një mospërputhje të thellë. Me «interesa të popujve» ata kanë parasysh interesat e borgjezisë imperialiste, që sundon në SHBA e në Bashkimin Sovjetik. Kurse «forcimi i paqes», sipas tyre, do të thotë paqe midis dy superfuqive dhe luftë kundër të tjerëve.

Gjatë viteve të fundit, me gjithë shtimin e agresivitetit të imperializmit të SHBA-së, marrëdhëni dhe bashkëpunimi sovjeto-amerikan kanë ardhur duke u shtuar e duke u thelluar gjithnjë e më shumë. Aleanca kundërrevolucionare sovjeto-amerikane përbën një nga faktet më të rëndësishme të skenës së sotme ndërkombëtare.

Kjo aleancë ka gjetur shprehjen e saj në përpjekjet që bëjnë të dyja superfuqitë për ta ruajtur sundimin e tyre në zonat përkatëse të influencës. Ato i kanë lënë dorë të lirë njëra-tjetrës që të veprojnë si

të duan në ato vende që i takojnë influencës së tyre. Kështu, për shembull, në kohën e agresionit sovjetik në Çekosllovaki imperialistët amerikanë mbajtën një qëndrim mjaft luajal kundër pushtuesve, ashtu si mbajtën revizionistët sovjetikë ndaj agresionit amerikan në Kamboxhia e në Laos.

Në kuadrin e kësaj aleance po zhvillohet sot një pazarllék i mbyllur për të ndarë sfera të reja influence, që më parë u përkilnin fuqive të tjera imperialiste. Tipik në këtë drejtim është qëndrimi që mbajnë këto dy fuqi të mëdha ndaj Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut.

Tani të dyja superfuqitë bëjnë përpjekje të mëdha për të koordinuar politikën e tyre dhe për të dalë me një qëndrim të përbashkët për të gjitha çështjet e rëndësishme ndërkombëtare dhe për t'ua imponuar këto vendeve të tjera. Kjo duket qartë sidomos në OKB, e cila manovrohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Bashkimi Sovjetik dhe është shndërruar në një instrument të politikës së tyre hegjemoniste. Synimi i tyre është të bëhen arbitra për punët e brendshme e të jashtme të vendeve të tjera dhe t'u diktojnë të gjithëve vullnetin e vet.

Për të ruajtur dhe për të forcuar aleancën, si revisionistët sovjetikë ashtu edhe imperialistët amerikanë një kujdes të madh tani u kushtojnë shmangies së fërkimeve midis tyre, likuidimit të mosmarrëveshjeve dhe ruajtjes së ekuilibrit të fuqisë. Preokupacion i përherëshëm i tyre është ruajtja e monopolit bërthamor dhe të epërsisë tekniko-shkencore, me qëllim që të mbajnë distancën nga vendet e tjera dhe të ushtrojnë një

presion dhe kërcënëm të vazhdueshëm mbi to. Tanimë është bërë e qartë se bisedimet e SALT-it, ato të Gjenevës për çarmatimin, marrëveshjet për hapësirën kozmike etj. u shërbejnë pikërisht këtyre qëllimeve.

«Plani i paqes» i Brezhnjevit, të cilin ai e trumbetoi me bujë në Kongresin e 24-t, është një plan demagogjik, i cili ka qëllim ta paraqesë në një dritë të bukur politikën imperialiste e agresive sovjetike dhe për të mashtruar popujt. Ky plan synon të arrijë një numër objektivash të caktuar të politikës së jashtme sovjetike duke shkelur mbi interesat jetikë të popujve. Në të vërtetë, Brezhnjevi nxori nga sirtaret propozimet e vjetra të Hrushovit, të cilat popujt i kanë hedhur poshtë. Plani i tij i paqes nuk është plan i kundërshtimit të imperializmit, që është burimi i luftërave dhe i prishjes së paqes. Ky është një program që në esencë ka për qëllim t'u shërbejë interesave imperialistë të dy superfuqive dhe t'u sigurojë atyre privilegje dhe epërsi në çështjet ndërkombëtare.

Demagogjia dhe falsiteti duken në të gjitha pikat e «planit Brezhnev». Ai kërkon që «të ndalohen të gjitha aktet e agresionit dhe të arbitraritetit ndërkombëtar, të likuidohen të gjitha vatrat e luftës» etj. Nuk merret vesh kujt i drejtohet Brezhnjevi: urtësisë së Niksonit apo «arsyes» së Pentagonit? Imperializmi amerikan nuk është larguar e as që do të largohet me vullnet të mirë e nga motive morale as nga Indokina, as nga Lindja e Mesme e as nga vende të tjera ku ka shtrirë kthetrat e tij. Ai nuk heq dorë nga politika e dhunës dhe e agresionit, që është produkt i vetë sistemit kapitalisto-imperialist. Me të tilla predikime udhë-

heqësit sovjetikë përpinqen të krijojnë iluzione dhe t'i largojnë popujt nga rezistenca dhe lufta çlirimtare, që janë e vëtmja rruge efektive për të kundërshtuar agresionin dhe për të mbrojtur lirinë e pavarësinë.

Nga ana tjetër, për çfarë kundërshtimi të dhunës e të arbitraritetit mund të flasë Brezhnjevi kur social-imperializmi sovjetik është vetë agresor dhe kërcënimin e arbitraritetin ndaj vendeve të ndryshme e kan gritur në ligj? Ndërsa janë kundër dhunës revolucionare, udhëheqësit sovjetikë zbatojnë gjërisht dhunën kundërrevolucionare. Rreziku i agresionit dhe i luftës sot nuk vjen vetëm nga imperializmi amerikan, por edhe nga socialimperializmi sovjetik, të cilët agresionin, kërcënimin e përdorimin e forcës i kanë mjetin kryesor për realizimin e politikës së tyre të hegjemonisë e të sundimit botëror.

Si një nga masat për mbrojtjen e paqes në botë Brezhnjevi paraqiti edhe propozimin e mirënjohnur të «sigurimit kolektiv në Evropë». Ky i ashtuquajtur sigurim evropian nuk ka asgjë të përbashkët me sigurimin e vërtetë të Evropës dhe me mbrojtjen e paqes. Popujt e Evropës rrezikohen në radhë të parë nga dy fuqitë e mëdha dhe kundër tyre duhet të sigurohen. Kurse plani sovjetik i sigurimit evropian kërkon që «garantë» të Evropës të bëhen armiqtë kryesorë të saj, imperializmi amerikan dhe ai revisionist sovjetik. Kjo është njëloj si të vësh çobanë ujqit. Në të vërtetë plani i Brezhnjevit për Evropën kërkon të sigurojë e të përjetësojë zonat e influencës dhe sundimin sovjeto-amerikan në Evropë, të ruajë statukuonë reaktionare në këtë kontinent dhe ta drejtojë tehun e luftës

e të agresionit në Azi. Për sa i përket likuidimit të NATO-s e të Traktatit të Varshavës, për të cilin bën fjalë Brezhnjevi, ai nuk mund të realizohet përderisa ekziston politika agresive, ekspansioniste e hegjemoniste e të dyja superfuqive, të cilat blloqet ushtarake i përdorin si vegla kryesore për zbatimin e kësaj politike.

Në «planin e paqes» të Brezhnjevit shumë fjalë thuhen edhe për çarmatimin, për ndalimin e armëve atomike, për ndalimin e garës së armatimeve, likuidimin e bazave të huaja, pakësimin e forcave të armatosura, shkurtimin e buxheteve ushtarake etj.

Të tilla predikime «të embla» popujt kanë kohë që i dëgjojnë dhe me ato janë ngopur deri në grykë. Brezhnjevi, me planin e tij, spekulon me kërkeshat e drejta të popujve për çarmatimin e plotë e të përgjithshëm dhe kërkon ta mbajë botën me shpresat të kota se diçka mund të bëhet dhe të fshehë kuptimin e vërtetë të zhurmës që të dyja superfuqitë bëjnë rreth çarmatimit. E gjithë politika dhe të gjitha veprimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të revizionistëve sovjetikë tregojnë se ata jo vetëm nuk punojnë për çarmatimin, por armatosen gjithnjë e më shumë, se synimi i tyre është të ruajnë për vete armët dhë t'i ndalojnë të tjerët për t'u armatosur e për t'u mbrojtur.

Mos vallë mund të quhen «hana pozitivë e premtues» traktati famëkeq i ndalimit të provave në tokë, në sipërfaqe e në atmosferë të armëve bërthamore, ai i ndalimit të përhapjes së tyre, traktati për ndalimin e vendosjes së armëve shkatërruese në fundin e oqeaneve, apo në hapësirën kozmike? Këto traktate dhe të

tjera të këtij lloji që po projektohen, janë marrëveshje të përfunduara midis dy fuqive të mëdha, që koordinojnë e ekuilibrojnë planet e tyre të armatimeve. Me anë të tyre ato duan të ruajnë monopolin bërthamor e teknologjik për vete, në mënyrë që të zbatojnë pastaj pa u ndalur shantazhin e kërcënimin bërthamor ndaj të tjerëve. Mos vallë popujt janë më të qetë tani që të dyja superfuqitë nuk i bëjnë më provat në sipërfaqe, por i shpërthejnë ato nën tokë, se nuk i vendosin në anijet kozmike, por i mbajnë në aeroplani që vijnë rrrotull botës, se nuk i kanë në fund të detit, por në mes e në sipërfaqe të tij?

Garën e armatimeve nuk e ka nxitur askush tjetër përveç dy superfuqive, ashtu si edhe bazat ushtarake në vendet e huaja nuk i ka askush tjetër përveç vetë atyre. Janë ato që sot kanë ushtritë më të mëdha dhe që buxhetet e tyre të luftës kanë arritur shifra astronomike.

Fjalët në publik kundër imperializmit, për paqen e çarmatimin u nevojiten revizionistëve sovjetikë për të mos u demaskuar përpala popujve. Ato nuk i prekin dhe nuk i shqetësojnë aspak imperialistët amerikanë, sepse në bazë të politikës sovjetike qëndron bashkëpunimi dhe diplomacia e fshehtë me SHBA-në, me të cilat ata përfundojnë lloj-lloj marrëveshjesh prapa shpinës së popujve e në kurriz të tyre.

Popujt nuk mund të presin asgjë të mirë nga sozialimperializmi sovjetik. Politika e jashtme sovjetike është shprehje e aspiratave hegemoniste e ekspansioniste të borgjezisë së re të Bashkimit Sovjetik. Krerët e Kremlinit mundohen ta paraqesin kursin e tyre sikur

ai i kundërvihet politikës agresive të imperializmit amerikan. Në të vërtetë, e gjithë kjo është një blof i maskuar keq, pasi politika e të dyja superfuqive ka të njëjtat tipare dhe është e së njëjtës natyrë klasore. Prandaj mbrojtja e paqes dhe e sigurimit ndërkombe-tar, çlirimi nga shtypja nacionale e sociale mund të arrihen vetëm me anë të një lufte të vendosur e konsekiente në dy fronte, kundër imperializmit amerikan dhe kundër socialimperializmit sovjetik. Aleancës kundërrevolucionare sovjeto-amerikane i duhet kundërvënë fronti i bashkuar revolucionar antiimperialist i popujve të të gjithë botës.

Armiqësi e tërbuar kundër forcave marksiste-leniniste

Kongresi i 24-t filloi e mbaroi si një kongres revisionist e antikomunist. Ai riafirmoi edhe një herë tjetër kursin kundërrevolucionar të udhëheqjes së sotme hrushoviane të drejtuar kundër lëvizjes së vërtetë komuniste, kundër gjithë forcave marksiste-leniniste.

Është fakt se tani forcat marksiste-leniniste, gjithnjë në rritje, dhe lufta e tyre i shqetësojnë mjaft Brezhnjevin e kompani. Partitë e reja marksiste-leniniste ai u mundua t'i paraqesë si krijime të udhëheqjes së Partisë Komuniste Kineze dhe t'i identifikojë me grupet trockiste. Se si i quan Brezhnjevi këto, kjo s'ka aspak rëndësi. Nga ai, si armik i marksizëm-leninizmit, nuk mund të priten veçse sharje. Partitë e reja marksiste-leniniste nuk janë krijesa artificiale. Ato kanë

lindur nga gjiri i klasës punëtore si një nevojë historike për udhëheqjen e luftës së saj revolucionare në kohën kur partitë e vjetra komuniste në shumë vende tradhtuan dhe kaluan në revizionizëm. Ato ishin një produkt logjik dhe i pashmangshëm i luftës midis marksizëm-leninizmit e revizionizmit në shkallë kombëtare e ndërkombejtare. Si të tilla, partitë e reja marksiste-leniniste rriten e forcohen vazhdimisht, e ardhmja u takon vetëm atyre.

Brezhnjevi, në raportin e tij, nuk la pa përmendur edhe Shqipërinë. Ai i ofroi vendit tonë «rivendosjen e marrëdhënieve normale». Natyrisht, ne nuk mund ta ndalojmë atë të flasë për marrëdhëniet me vendin tonë. Por në qoftë se revisionistët sovjetikë mendojnë se me të tillë taktika do të na vënë në pritje të «zhvillimeve të reja pozitive» nga ana e tyre, do të na bëjnë të ndërpresim polemikën dhe luftën kundër revizionizmit, ne u themi se kanë gabuar adresë. Vigjilanca jonë revolucionare kundër manovrave të tyre të djalëzuara ka qenë dhe do të jetë kurdoherë në lartësinë e duhur.

Ne kemi deklaruar dhe deklarojmë se dëshirojmë të kemi marrëdhënie të mira dhe korrekte edhe me shtete që kanë regjime të kundërtë nga yni, por me kusht që ato të respektojnë lirinë e pavarësinë e atdheut tonë, sovranitetin, integritetin tokësor dhe gjithë fitoret e revolucionit tonë popullor. Kurse të gjitha ato shtete imperialiste dhe revisioniste që kanë mbajtur dhe mbajnë qëndrime armiqësore ndaj Shqipërisë socialistë, kanë marrë dhe do të marrin kurdoherë përgjigjen e merituar nga ne. Ato i kanë borxhe të më-

dha politike dhe ekonomike Shqipërisë, që nuk lahen me fjalë boshe dhe demagogji. Revolucioni i pashmangshëm në këto vende do t'i vërë në vend krimet që u janë bërë dhe po u bëhen nga ana e tyre jo vetëm Republikës Popullore të Shqipërisë, por gjithë popujve të botës.

Jo një herë, por shumë herë Partia e Punës e Shqipërisë u është drejtuar popullit dhe komunistëve të Bashkimit Sovjetik duke u tërhequr vëmendjen rreth shkaqeve të vërteta të prishjes së marrëdhënieve sovjeto-shqiptare. Por krerët revizionistë sovjetikë kanë vazhduar rrugën e tyre të tradhtisë e të qëndrimeve armiqësore ndaj Partisë, vendit tonë dhe marksizëm-leninizmit.

Normalizimi i marrëdhënieve midis Bashkimit Sovjetik e Shqipërisë socialiste nuk është një çështje që mund të zgjidhet me një deklaratë false të një udhëheqjeje revizioniste sovjetike, që mban një qëndrim armiqësor dhe kërcënon vendin tonë. As që mund të bëhet fjalë për një ndërmarrje të tillë në rast se nuk ndërhyjnë energjikisht popujt vëllezër sovjetikë dhe bolshevikët e vërtetë për të vendosur drejtësinë e madhe marksiste-leniniste mbi këto çështje, sepse me udhëheqjen e sotme sovjetike na ndajnë mosmarrëveshje të thella e parimore politike e ideologjike.

Kongresi i 24-t ishte një kongres i organizuar nga klika revizioniste sovjetike për qëllimet e saj revizioniste. Ai kishte për qëllim ta mobilizonte popullin sovjetik për zbatimin e vijës së saj, për konsolidimin e

pozitave të borgjezisë së re sunduese revizioniste. Për të mashtruar popullin sovjetik dhe opinionin botëror, Brezhnjevi e shokët e tij u munduan të paraqiten si marksistë të kulluar, sikur mbajnë një qëndrim të ekuilibruar dhe luftojnë si të majtët, ashtu edhe të djathtët, si centralizmin burokratik e teknokratik, ashtu edhe anarkizmin liberal, si «kultin e individit», ashtu edhe «subjektivizmin e arbitraritetin», si nacionizmin reaksionar, ashtu edhe antipatriotët etj.

Këto janë manovrime të njohura taktike, që synojnë të qetësojnë masat punonjëse, të largojnë vëmentjen e tyre nga problemet e mëdha e të pazgjidhura që preokupojnë popullin sovjetik. Krerëve revizionistë u duhet tani një periudhë qetësie për të zbatuar pa telashe politikën e tyre të restaurimit të kapitalizmit brenda dhe të socialimperializmit jashtë.

Populli sovjetik, i cili ka tradita të lavdishme revolucionare, nuk duhet të gënjejhet nga demagogjia revizioniste dhe nga taktikat mashtruese të sundimtarëve të tij. Kongresi i 24-t i shton vargonj të rinj zgjedhës revizioniste, ai rrit edhe më shumë dozat e helmit, me të cilin revizionistët shkatërrojnë ndërgjegjen e njerëzve dhe trullozin mendjet e tyre.

Nga fatkeqësia e rëndë në të cilën ka rënë populli sovjetik, ai nuk mund të dalë as duke pritur, as me apolitizëm, indiferentizëm ose pasivitet. Rruga e vetme e shpëtimit është që klasa punëtore, i gjithë populli sovjetik të zbresë në fushën e betejës dhe, me aksionin e vet revolucionar, të përbysin revizionizmin, të ri-

vendosin diktaturën e proletariatit dhe ta kthejnë përsëri Bashkimin Sovjetik në rrugën e lavdishme të Totorit të Madh.

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit», nr. 91 (7068), 17 prill
1971*

*Botohet sipas librit
Enver Hoxha. «Kundër revisionizmit modern (Përmble-
dhje veprash) 1971-1975»,
Tiranë, 1980, f. 17*

**FITORJA PËRFUNDIMTARE NUK VARET
NGA VULLNETI I REVIZIONISTËVE, POR NGA
LUFTA E MARKSISTË-LENINISTËVE, NGA LUFTA
E POPUJVE TË BOTËS**

*Nga biseda me ambasadorin e RD të Vietnamit,
Nguyen Van Hong*

17 prill 1971

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se na erdhët, shoku ambasador! Si jeni me shëndet?

NGUYEN VAN HONG: Falemnderit, mirë jam. Me rastin e largimi të tim nga Shqipëria, e ndiej veten shumë të gjuar që m'u dha rasti të takohem sot me Ju për t'Ju dhënë lamtumirën. Në të njëjtën kohë shpreh kënaqësinë time të jashtëzakonshme që gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, si ambasador i Republikës Demokratike të Vietnamit, marrëdhëniet midis partive dhe popujve tanë janë zhvilluar shumë. Ju personalisht jeni kujdesur dhe keni bërë një punë të madhe për ndërtimin e marrëdhënieve të miqësisë midis dy partive tona. Partia, Qeveria dhe populli juaj kanë dhënë një ndihmë të madhe për luftën e popullit tonë. Me rastin e takimit me zgjedhësit, në muajin

shtator të vitit të kaluar, Ju keni folur shumë në përkrahje të Vietnamit. Fjalët Tuaja u dëgjuan dhe u përvetësuan nga populli dhe komunistët vietnamezë. Me këtë rast, në emër të partisë dhe të popullit tonë, më lejoni t'Ju falënderoj sinqerisht për ndjenjat Tuaja të zjarrta në mbështetje të luftës së popullit vietnamez.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falemnderit shumë për vlerësimin që i bëni ndihmës sonë. Ne e dimë se nga ana materiale ajo është e vogël, por ju jepet me gjithë zemër nga populli shqiptar, sepse lufta heroike e popullit të Vietnamit të Veriut, e popullit heroik të Vietnamit të Jugut dhe e gjithë popujve të tjerë të Gadishullit të Indokinës është çlirimtare. Partia ne na ka mësuar t'i shikojmë heroizmat, sakrificat dhe gjakun që derdh populli vietnamez jo vetëm si përpjekje për çlirimin dhe bashkimin e atdheut të vet, por edhe si kontribut për mbrojtjen e lirisë së popujve pra edhe të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Imperialistët amerikanë dhe bashkëpunëtorët e tyre, siç na mëson eksperiencia shumëvjeçare, pa hequr dorë nga mendimi për të atakuuar edhe popuj e shtete të mëdha, që nuk u shkojnë pas qerres, përpiken të godasin më parë popujt dhe shtetet e vogla, duke shkuar me shpresë se këtyre do t'u imponojnë më lehtë ligjin kapitalist të skllavërimit. Në këto llogari që bëjnë, ata ndeshin në kundërshtimin e popujve. Një shembull i madh i kësaj rezistence aktive është lufta heroike e popullit vietnamez në Veri dhe në Jug, e cila vërtetoi se shtetin agresor, imperialist apo revizionist, sado i fuqishëm dhe i armatosur me armët më

moderne që të jetë, e pret disfata e pashmangshme si në fushën e betejës me popujt, ashtu dhe në fushën diplomatike. Populli heroik i Vietnamit vërtetoi se në këtë drejtim qëndron lart në mënyrë absolute mbi imperialistët amerikanë dhe kukullat e administratës së Sajgonit.

Duke e vështruar çështjen në këtë platformë ndërkombëtare, lufta juaj heroike ka qenë për ne shqiptarët një mbrojtje aktive dhe na ka shërbyer njëkohësisht si një eksperiencë për mundësinë e rezistencës së një populli të vogël kundër fuqisë së madhe agresive imperialiste, kundër mjeteve moderne taktike dhe strategjike të armikut. Ajo na ka inkurajuar ne edhe në rezistencën kundër revizionistëve sovjetikë dhe gjithë armiqve të tjerë. Ka edhe popuj të tjerë në botë, të mëdhenj e të vegjël, që kanë përfituar shumë nga eksperienca e luftës suaj. Kjo është një eksperiencë shumë e vlefshme, si për popujt që e kanë fituar lirinë dhe luftojnë për ta mbrojtur atë, ashtu dhe për ata që tani janë duke luftuar ose të tjerë që do të luftojnë për ta fituar në të ardhmen. Për të gjitha këto arsyet është e kuptueshme sa të thella e të mëdha janë miqësia dhe dashuria e popullit shqiptar për popullin e Vietnamit të Veriut dhe të Jugut.

Luftën e Vietnamit ne e kemi vënë dhe e vëmë vazhdimisht në dukje, në radhë të parë, për të kalitur te populli ynë ndjenjën e thellë të përgjegjësisë për të qenë kurdoherë të gatshëm e të përgatitur kundër armiqve të shumtë imperialistë e revizionistë, me imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë në krye,

të cilët, pavarësisht nga rrethanat e koniunkturat aktuale, prësin rastin të bëjnë kundër nesh po atë që bënë kundër jush imperialistët francezë dikur apo atë që po bëjnë imperialistët amerikanë sot.

Në këto rrethana të zhvillimit të situatës detyra jonë është të ndjekim një politikë të drejtë revolucionare, politikën e forcimit të Republikës Popullore të Shqipërisë në të gjitha drejtimet, duke filluar nga problemet ekonomike e deri tek ato të mbrojtjes. Kjo arrihet, në radhë të parë, kur populli çdo gjë ta ketë kuptuar drejt politikisht e ideologjisht. Ne luftojmë që populli ynë të jetë në gjendje ta vlerësojë drejt çdo situatë të jashtme politike, pa humbur për asnje moment vigjilencën dhe përgatitjen. Ai është i bindur se miqtë e vendit tonë, si Republika Demokratike e Vietnamit, populli i të gjithë Vietnamit, popujt e Indokinës dhe gjithë popujt e tjerë në botë, do të na përkrahin në rast rreziku në luftën kundër imperialisteve amerikanë, kundër revizionistëve sovjetikë dhe kundër gjithë reaksionit botëror. Me gjithë besimin e madh në përkrahjen e miqve të singertë e të fuqishëm, Partia jonë i mëson njerëzit tanë që të kenë parasysh se rrethimin e Shqipërisë nga armiqtë duhet ta përballojmë me vendosmëri dhe me forcat tona, sepse kështu edhe mundësia e ndihmës së miqve për ne në të gjithë botën do të jetë akoma më e madhe. Nga këto qëndrime që mbajmë, del qartë se Partia jonë nuk i ka ndërruar dhe nuk i ndërron politikën dhe strategjinë e saj, pavarësisht se imperialistët amerikanë, revizionistët e Moskës dhe revizionistët e tjerë lehin sikur nc gjoja qenkemi kthyer në një vend të mbyllur, se qenkemi të

prapambetur, të egër e të tjera shpifje armiqësore që nuk kanë asnjë bazë.

Partia jonë është kurdoherë vigilente dhe taktikën e saj e ndërton në bazë e në interes të strategjisë së vet marksiste-leniniste e jo të strategjisë së imperializmit apo të revizionizmit. Taktika jonë u shërben interesave të Republikës Popullore të Shqipërisë, vendeve mike dhe aleate të saj dhe interesave të proletariatit e të popujve të botës, prandaj edhe në marrëdhëni me vendet që kanë sisteme të ndryshme shoqërore nga yni, pra dhe me vendet kapitaliste të Perëndimit, ajo vepron pikërisht duke u udhëhequr nga këta interesa të lartë.

Kur interesat strategjikë të Republikës Popullore të Shqipërisë e kërkojnë të hidhet një hap më përpalla në taktikën ndaj Jugosllavisë titiste, pa hequr dorë nga asnjë prej pikëpamjeve të Partisë sonë ndaj revisionistëve titistë, pikëpamje këto që i vërtetoi koha si të drejta që nga a-ja e deri te zh-ja, ne veprojmë ashtu sikundër vepruam. Klika titiste e ka shndërruar Jugosllavinë në një vend kapitalist dhe Partinë Komuniste të Jugosllavisë e ka likuiduar prej kohësh; ajo e shiti Jugosllavinë tek të huajt, ngjalli në vend tendencat shqeriniste borgjeze për konflikte nacionale etj. Por, kur ndaj këtij vendi u shfaq rreziku i një sulmi të armatosur nga socialimperializmi sovjetik, që ishte një kërcënim edhe për vendin tonë, ne deklaruam se do të qëndronim përkrah popujve të Jugosllavisë. Revisionistëve sovjetikë ky akt i solidaritetit tonë me popujt jugosllavë në mbrojtje të pavarësisë së tyre nuk u pëlqeu.

Në Greqi ka ardhur në fuqi përsëri një regjim fashist por edhe qeveritë e mëparshme greke kërkonin çdo mëngjes Shqipërinë e Jugut. Për këtë qëllim ato organizonin afér kufirit tonë kongrese të ashtuquajtura të vorioepirotëve, futnin spiunë e diversantë në Shqipëri dhe bënин provokacione kufitare të vazhudeshme. Sunduesit e tanishëm të Greqisë, duke u gjendur në vështirësi të mëdha, si brenda vendit edhe në arenën ndërkombëtare, i kanë pushuar provokacionet ndaj nesh, nuk bëjnë më kongrese, megjithëse, si të parët, edhe këta e lakmojnë Shqipërinë e Jugut. Por fakt është se në shtyp, në radio etj. ata nuk flasin më për rivendikime tokësore ndaj vendit tonë, sepse e panë që nuk është aq lehtë të prekësh kufijtë e Shqipërisë. Që të mund të realizojnë ëndrrat e tyre grabitqare, atyre u duhet të përgatiten mirë për të luftuar kundër nesh.

Qeveritarët grekë tash na kanë propozuar të bëjmë tregti, të shkëmbejmë mallra. Ne u jemi përgjigjur se nuk kemi kundërshtim, bile, që kur u çlirua Shqipëria, u kemi propozuar për zhvillimin e tregtisë midis të dy vendeve, por kanë qenë ata, pala greke, që kanë nxjerrë pengesa duke pretenduar se janë në gjendje lufte me Shqipërinë.

Para disa muajsh na propozuan të lidhim edhe marrëdhënie diplomatike dhe ne u përgjigjëm pozitivisht. Edhe në këtë drejtim, që kur u çlirua Shqipëria, ne u kemi propozuar të kishim marrëdhënie diplomatike, por ata, për «arsyet» që thamë, refuzonin. Tani jemi në marrëveshje për këtë çështje, por bisedimet nuk kanë përfunduar akoma. Qeveria greke na ka

deklaruar se heq dorë nga pretendimi për gjendjen e luftës me ne, që gjoja ka ekzistuar deri tash, dhe nuk flet më për Shqipërinë e Jugut.

Në këto kushte a do të ketë ndryshime në politikën e jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë ndaj Greqisë? Në esencë jo! Politika jonë ka qenë dhe mbetet gjithnjë po ajo, tash janë qeveritarët grekë ata që po e ndërrojnë politikën e tyre ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë. Republika Popullore e Shqipërisë, në asnjë rrethanë nuk ka bërë lëshime në qëllimet e interesat e saj strategjikë. Këto ngjarje janë pasoja direkte të takikës revolucionare dhe të politikës së drejtë marksiste-leniniste që ndjek Partia e Punës e Shqipërisë.

Ne e dimë ç'janë revisionistët jugosllavë, ata sovjetikë, imperialistët amerikanë dhe të tjerë për vendintonë. Jemi të bindur se politika që ndjekim ka shumë rëndësi jo vetëm për ne, por edhe për miqtë tanë, prandaj asnjë lëshim nuk u bëjmë armiqve imperialistë dhe revisionistë, përkundrazi, u çjerrim maskat, me qëllim që popujt të njojin fytyrën e tyre të vërtetë.

Si të mos i demaskosh këta armiq të popujve, veprimet e të cilëve janë diametralisht të kundërtat me deklaratat që bëjnë? Imperialistët dhe revisionistët sovjetikë përpiken me të gjitha mënyrat të fshehin qëllimet e tyre me parulla të rreme e gjithfarë veprimesh mashtruese për të térhequr vëmendjen e opinionit publik, për të përligjur veprimet e tyre agresive, për të fituar kreditin e humbur dhe autoritetin e rënë përtokë. Të heshtësh përpara këtyre qëndrimeve është një dëm kolosal që i bëhet luftës së popujve. Presidenti

amerikan, nga njëra anë, shpall se do t'i heqë trupat nga Vietnami i Jugut dhe merr vendim se nuk do ta bombardojë më Vietnamin e Veriut, nga ana tjetër vepron në kundërshtim me sa ka deklaruar, duke filluar bombardimet kundër Vietnamit të Veriut dhe duke zgjeruar luftën në Laos. Kuptohet sa me vend është qëndrimi juaj dhe sa e drejtë bindja e popujve për të mos u besuar kurrë deklaratave «paqësore» të imperialistëve. Megjithatë Niksoni edhe në Laos «i mori këmbët në sup», i detyruar nga forcat e Frontit të Bashkuar të Vietnamit, të Laosit dhe të Kamboxhias. Ju edhe një herë u dhatë grusht të fortë këmbësorisë, helikopterëve dhe të gjitha mjeteve të tjera të ushtrisë amerikane dhe, para kësaj lufte të rreptë, forcat e armatosura «të fuqishme» amerikane u kthyen mbrapsht me turp, duke u futur përsëri në strofkat e Vietnamit të Jugut.

Dredhitë, gënjeshtrat dhe demagogjia e imperialisteve amerikanë dhe e revizionisteve sovjetikë janë të mëdha, por ato nuk u kalojnë pa kuptuar marksistë-leninistëve dhe popujve që luftojnë për lirinë e vet. Brezhnjevi foli shumë në Kongresin e 24-t të partisë revizioniste sovjetike dhe ne i lexuam të gjitha ato që parashtroi në emër të grupit revizionist në raportin e mbajtur në një situatë të brendshme jashtëzakonisht të vështirë politike, ekonomike dhe ushtarake. Në planin e politikës së jashtme aleanca e Traktatit të Varshavës është diskredituar keq. Këto vështirësi bien në sy edhe në raportin e Brezhnjevit, ku nuk ngrihet asnjë problem, sepse marrëdhëniet midis revizionisteve janë shumë të acaruarë dhe, po të shpoheshin, mund t'i

nxirrnin telashe të mëtejshme që do ta rëndonin akoma më tej gjendjen e kongresit revisionist, të udhëheqjes sovjetike dhe të vetë Brezhnevë.

Marrëdhëniet e Polonisë me Bashkimin Sovjetik janë të mira, deklaroi me pompozitet Brezhnevi, por kjo nuk është aspak e vërtetë. Në mes Çekoslovakisë e Bashkimit Sovjetik marrëdhëniet janë të mira, deklaroi prapë ai, por as kjo nuk është e vërtetë. Marrëdhëniet në mes Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Demokratike Gjermane janë të mira, përsëriti ai edhe një herë, por as kjo nuk është e vërtetë, sikurse nuk janë të mira edhe me Rumaninë, sepse ne e dimë mirë si janë këto marrëdhënie. Edhe në vendet e tjera të botës pozitat e Bashkimit Sovjetik janë jashtëzakonisht të lëkundshme, por, natyrisht, këto marrëdhënie Brezhnevë nuk mund t'i trajtonte e t'i shpjegonte siç janë në të vërtetë, prandaj në përshkrimin e situatave zgjodhi formula të vakëta.

Partia jonë është e bindur se revisionistët, e në radhë të parë ata sovjetikë, janë armiq që i kanë sjellë dëme të mëdha lëvizjes marksiste-leniniste, revolucionit, dhe për këtë duhen demaskuar e luftuar me ash-përsinë më të madhe. Ne kemi besim të plotë se, sado dhe sidon që të përpilen ta frenojnë lëvizjen revolucionare armiqtë tanë, shkallët e revolucionit patjetër do të ngjiten, kurse ata do të pësojnë humbje katastrofale. Fitorja përfundimtare varet jo nga vullneti i revisionistëve, por nga lufta e marksistë-leninistëve, nga lufta e popujve të botës, të cilët nuk flenë.

Ne kemi, gjithashtu, bindjen se populli juaj heroik do ta fitojë luftën dhe ajo që ju ndan prej fitores është

vetëm çështje kohe, e cila nuk do të vonojë të vijë. Imperializmi amerikan do të mundet në Vietnam, sepse gjatë gjithë kësaj kohe ai është dobësuar shumë ushtarakisht, politikisht dhe ekonomikisht. Tani ai përpinqet të gjejë një mënyrë për t'iu shmangur disfatës së turpshme, por s'ka si t'i shpëtojë dhe do të thyhet¹.

Të jeni të sigurt se te populli shqiptar dhe te Partia e Punës e Shqipërisë ju keni miq nga më besnikët, që ju duan me gjithë shpirt dhe do t'ju ndihmojnë deri në fund me të gjitha forcat, me aq sa kanë dhe me çfarëdo që të kenë.

Ju uroj rrugë të mbarë dhe shëndet! Popullit vietnamez i uroj suksese të mëdha dhe fitore të shpejtë në luftën e tij.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash)
1971-1975», Tiranë, 1980, f.42*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Kundër revi-
zionizmit modern (Përmble-
dhje veprash) 1971-1975»,
Tiranë, 1980, f. 42*

1. Me luftën e tij heroike kundër agresorëve amerikanë e kukullave të tyre, populli vietnamez çlroi Jugun më 30 prill 1975 dhe arriti kështu ribashkimin e vendit.

TE NGREMË NË NJË NIVEL MË TË LARTE PËRMBAJTJEN DHE ORGANIZIMIN E PUNËS SHKENCORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

20 prill 1971

Në diskutimin tim ka mundësi t'i përsëris disa çështje, po për to dëshiroj të shpreh edhe unë mendimin. Jam dakord me raportin që na është paraqitur; ai është rezultat i një analize të gjatë në të cilën kanë marrë pjesë shumë kuadro. Gjithashtu jam dakord me shumë nga vërejtjet dhe mendimet e shokëve që, në vija të përgjithshme, i konsideroj të drejta dhe të arsyeshme.

Gjatë gjithë zhvillimit të punës për të ngritur në një nivel më të lartë përmbajtjen dhe organizimin e punës shkencore, ne duhet të bëjmë përpjekje për të krijuar ato mundësi që nuk i kemi akoma, por që, me

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit: «Të vëmë mbi baza më të shëndosha shkencore zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, duke ngritur në një nivel më të lartë përmbajtjen dhe organizimin e punës shkencore».

kalimin e kohës, sa vjen e bëhen më të nevojshme. Mendimi im është se për sa i përket punës shkencore ne kemi hedhur hapa të mirë përpara. Ky problem nuk është parë si një çështje në vetvete, por i lidhur ngushtë me praktikën revolucionare.

Me zhvillimin e shkencës te ne merren shumë njerëz e jo vetëm kuadrot. Studimet shkencore, realizimet në këtë fushë unë nuk i kuptojoj vetëm si një fryt apo cilësi të kuadrove që kanë mbaruar shkollën, por i konsideroj si rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë në mes punonjësve dhe kuadrove, pra, të punëtorëve, të fshatarëve dhe të inteligjencies. Gjithë ekonomia dhe kultura jonë dolën nga një prapambetje shumë e theksuar, që trashëguam nga e kaluara dhe u ngritën në shkallën që kemi arritur sot, pikërisht në sajë të këtij bashkëpunimi. Hapat e mëdhenj përpara që janë bërë në fabrikat, në ndërmarrjet, në kooperativat bujqësore, në shkollat etj. nuk u detyrohen vetëm kuadrove, inxhinierëve, agronomëve, mësuesve ose profesorëve, por u detyrohen bashkërisht si këtyre, ashtu edhe punonjësve që i ndërtuan dhe i vunë ato në veprim. Punëtorja e kombinatit të tekstileve «Stalin» që mori në dorë një makineri për të punuar, në fillim ishte analfabete, por, duke punuar e duke mësuar, ajo mbaroi me kohë edhe një kurs teknik ose një shkollë, kuptoi ç'ishte teknika në sektorin e punës ku shërbente, e përvetësoi atë dhe e vuri në zbatim. Kështu ndodh kudo te ne, në çdo institucion e ndërmarrje, pse Partia jonë shkencën dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj nuk e konsideron si monopol të disa «papëve», por si pronë të të gjitha masave të gjera punonjëse.

Puna shkencore te ne lidhet kurdoherë me prodhimin dhe duhet t'i shërbejë prodhimit. Edhe në vendet e tjera, deri në njëfarë shkalle shkenca lidhet me prodhimin. Përparimi i shkencës në shumë vende të botës sot ka marrë një zhvillim të gjerë dhe kuadrot shkencorë janë me shumicë, sepse kanë traditë në këtë drejtim. Duke e parë përparimin e vendeve të tjera në një prizëm të ngushtë, në vështrimin e parë, duket sikur ato e zhvillojnë shkencën për shkencë, por, në fakt, edhe kur ata ndërtojnë stacione ndërplanetare në kozmos, patjetër kanë disa objektiva të caktuar shkencorë, ekonomikë, shëndetësorë, ushtarakë etj. Ndryshimi midis nesh dhe vendeve kapitaliste është i madh për sa u përket qëllimeve dhe motiveve që ndiqen për zhvillimin e shkencës, pasi atje në këtë çështje nuk udhëhiqen nga interesi i ndërtimit të socializmit, domethënë nga interesat e lartë të masave të gjera të popullit, por nga interesat e klasave shfrytëzuese kapitaliste, prandaj atje nuk lejojnë që shkencën ta zhvillojnë e ta përvetësojnë masat e gjera të popullit. Zhvillimin e shkencës dhe të teknikës borgjezia e lë kryesish në duart e përfaqësuesve të saj të zgjedhur dhe jo të masave, siç ndodh në vendin tonë.

Sikurse kemi vepruar ngaherë dhe ashtu siç u diskutua sot këtu, zhvillimin e shkencës duhet ta lidhim ngushtë me nevojat e prodhimit dhe me detyrat e planit. Në Kongresin e 6-të të Partisë ne do të paraqitim për aprovim direktivat e planit të pestë pesëvjeçar. Natyrisht, ide të përgjithshme për planin ne kemi qysh tani, por atë do ta studiojmë përsëri dhe, para se të paraqitet në Kongres, ai do të kalojë nëpër shumë

debate, diskutime e studime. Detyrat e këtij plani, sidomos problemi i investimeve dhe të tjera, janë shumë të ngjeshura e të vështira në shumë drejtime. Tani ka një mobilizim total në të gjitha drejtimet, por do të jetë e zorshme t'i realizojmë kuotat e para që kemi caktuar, në rast se shkencën dhe teknikën, që i kemi futur në një rrugë të drejtë, nuk i zhvillojmë dhe nuk i shfrytëzojmë në mënyrë sa më racionale, në rast se disa të dhëna mjaft të vështira të projekteve tona në fushën e investimeve nuk do t'i ulim dhe rendimentet, mekanizimet etj. nuk do t'i përmirësojmë.

Unë mendoj që aktualisht, me ndonjë përjashtim të vogël, puna shkencore ka marrë rrugë të drejtë, ajo nuk ka ndjekur zhvillimin e shkencës për shkencë, po është lidhur me praktikën e punës revolucionare të Partisë, pikërisht për arsyen se kuadrot kanë fituar besim në vlerën e dijenive të tyre dhe kanë vullnet e bëjnë përpjekje t'i zhvillojnë më tej dijenitë dhe aftësitë, duke mësuar, punuar, eksperimentuar dhe duke përgjithësuar me këmbëngulje për t'i vënë ato në zbatim në dobi të atdheut. Në këto përpjekje ne shohim diçka pozitive dhe inkurajuese dhe kjo përbën një sukses të madh për Partinë. Këto përpjekje të kuadrove dhe të punonjësve tanë janë një fenomen masiv që vihet re kudo ku punohet. Rruga e masivizimit të shkencës te ne çeli shumë horizonte pune, ndërtimi e studimi dhe krijoj mundësi të mëdha teknike, që nuk ekzistonin në vitet e para të ndërtimit të socializmit. Tani në çdo vit dhe pesëvjeçar janë shtuar jashtëzakonisht shumë mundësitë teknike të eksperimentimit dhe të aplikimit të shkencave në vendin tonë dhe në

të ardhmen këto mundësi do të shtohen akoma më tepër. Tani, pra, janë krijuar shumë mundësi tekniqe dhe materiale për një zhvillim akomë më të gjerë dhe të kombinuar të shkencave tonë. Këta janë faktorë shumë pozitivë, që në situatat e krijuara na shtrojnë përpëra detyra të reja.

Dua të theksoj se në këtë drejtim ne nuk duhet të qëndrojmë në vend. E theksoj këtë se te disa kuadro, punëtorë dhe fshatarë, vihet re një ndjenjë e palejueshme vetëkënaqësie, duke u mjaftuar me aq sa kanë mësuar, ndjenjë kjo që është shumë e rrezikshme pse frenon përpjekjet për të zhvilluar akoma më tepër intelektin, eksperiencën dhe zbatimin e dijenive të fituara në kushtet që na rekomandon Partia. Që mësohet tani te ne, kjo është evidente, por, po të thellohem i përfitohet nga eksperiencia e madhe e punës, nga shkollat e ulëta, të mesme apo të larta, rezulton se jo të gjithë interesohen në atë shkallë që e kërkojnë situatat. Ka shokë, siç janë intelektualët e sidomos kuadrot me arsim të lartë dhe kuadrot me përgjegjësi, që bëjnë përpjekje të mësojnë, por, po të shkojmë poshtë, do të shohim se përpjekjet për të mësuar në bazë të një pune metodike nuk ekzistojnë në masën që lypset, sepse nuk shfrytëzohen të gjitha mundësitë reale që kemi. Ne duhet të shkundemi nga një situatë e tillë dhe të bëjmë çmos që t'i kapërcejmë caqet aktuale të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës sonë, duke ngritur në një nivel më të lartë organizimin e punës shkencore. Këto kërkesa që na imponon zhvillimi ynë i tanishëm, nuk mund të plotësohen, në rast se përpjekjet e secilit nuk shkojnë paralelisht me një

përvetësim dhe thellim të mëtejshëm të shkencës dhe të teknikës në të gjithë sektorët.

Ekonomia jonë zgjerohet, krahas zhvillimit të saj ndryshojnë struktura dhe organizimi i saj, por këto ndryshime kërkojnë patjetër zgjidhje të reja, kërkojnë gjetje dhe zbatim metodash të reja e më të përparuara në shkencë, në prodhim, në automatizim e në shfrytëzim, me shpenzime më të pakta e me rendimente më të larta. Të gjitha këto detyra bien si një imperativ i domosdoshëm jo vetëm për udhëheqjen kryesore të Partisë e të shtetit, por edhe deri për udhëheqjen e bazës, për drejtuesit e ndërmarrjeve, për gjithë njerëzit tanë, të cilët të mos i zërë gjumi për këto çështje. Kurrë punonjësit tanë të mos mendojnë «të shkojmë si të shkojmë, se mund të kalojmë edhe me një organizim të tillë siç e kemi pasur me të cilin kemi bërë përparime, kemi arritur këto ose ato rezultate» etj. Ne akoma nuk e kemi zgjidhur problemin e sigurimit të bukës në vend. Vihet pyetja: «Kanë punuar vallë njerëzit e bujqësisë për zgjidhjen e këtij problemi jetik?». Të gjithë jemi të mendimit se duart ata nuk i kanë lidhur, kanë derdhur djersë, ata kanë punuar dhe fakt është që kemi përparime. Ka në vendin tonë ekonomi bujqësore të zhvilluara etj., etj., por plani ynë në bujqësi nuk është realizuar në të gjithë treguesit. Kjo gjendje ka ardhur për shumë arsyen dhe ne duhet të shikojmë mirë sidomos shkaqet subjektive. Unë insistoj që në këto situata, kur kërkohet një mobilizim konkret nga të gjithë punonjësit, Partia duhet t'ua bëjë atyre mjaft të qartë përgjegjësinë për realizimin e kësaj detyre, të interesohen më shumë për këtë problem, nga zgjidhja e

të cilit varet shumë kryerja me sukses e shumë detyrave të tjera në të ardhmen. Në qoftë se nuk zgjidhen mirë e me sukses këto detyra, atëherë, natyrisht, mund të na krijohen situata ekonomiko-shoqërore të vështira, mund të na krijohen kontradikta që do të na vënë në vështirësi jo vetëm nga ana ekonomike. Edhe sikur t'i zgjidhim me sukses dhe plotësisht problemet që na shtrohen në bujqësi, do të na lindin marrëdhënie ekonomiko-shoqërore të reja, të cilat duhen studiuar me kohë, ashtu siç studiojmë, për shembull, si të ndërtojmë më mirë një hidrocentral ose një fabrikë.

Në fushën e industrisë dhe të minierave, bie fjala, problemet nuk duhen parë vetëm nga ana e Ministrisë së Industrisë e të Minierave, po edhe nga institutet e saj vartëse.

Unë jam dakord për sa u tha këtu që duhen studiuar shumë probleme që kanë lidhje me parandalimin e ndikimit të ideologjisë borgjeze e revisioniste, por përvèç ndikimeve të huaja, ne na pengojnë edhe mbeturinat e së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve. Në situatën e dhënë, përpjekjet për të bërë një jetë më të mirë krijojnë te disa njerëz edhe zakone e shprehi jorevolucionare, siç janë, për shembull, qetësia, rehatia, vetëkënaqësia, mendimi se mirë jemi me kaq sa kemi arritur dhe s'ka përsë të bëjmë përpjekje të mëtejshme etj. Prandaj theksova se, në situatat e reja, krijohen marrëdhënie ekonomiko-shoqërore të reja, që duhen kupuar, studiuar dhe, mbi këtë bazë, duhen marrë masa të përshtatshme për të zbuluar anomalitë e përtë zgjidhur drejt kontradiktat që krijon zhvillimi ynë

i pandërprerë. Në përpilimin e planit ne duhet të shikojmë më shumë kujdes përpjesëtimet e zhvillimit të harmonishëm në mes degëve të ekonomisë, se ndryshe, në vend që të shkojmë përpara, mund të thyejmë kurrizin.

Njerëzit që punojnë në bazë, mund të mos i konsiderojnë si shkencore të gjitha punët që përmenda, por në të vërtetë këto janë punë shkencore. Shumë shokë nga baza japin mendime mjaft të vlefshme për probleme të ekonomisë dhe të kulturës, pa e ditur vetë se ato kanë vlerë shkencore dhe ndihmojnë shumë në zhvillimin e shkencës sonë. Prandaj Partia këshillon që përfshirja e masave në veprimtarinë shkencore, tërheqja e mendimeve të tyre e pasuron shkencën, goftë kjo teknike, ekonomike, ideopolitike etj., etj.

Ndryshimet në zhvillimin e ekonomisë dhe të shkencës ngrenë edhe më lart ndërgjegjen socialiste të punonjësve, natyrisht, diçka me vonesë, pse zhvillimi i ndërgjegjes, sikurse dihet, kurdoherë mbetet pas ndryshimeve dhe zhvillimit material. Kjo do të thotë se vënia mbi baza më të shëndosha shkencore e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës, duhet të shërbëjë një-kohësht për të revolucionarizuar ndërgjegjen e njerezve dhe jo për t'i borgjezuar ata e për t'i lënë që t'i mbulojë pluhuri i vetëkënaqësisë mikroborgjeze, i福德lëkut, i burekratizmit, i rutinës dhe i dembelizmit anadollak.

Të gjithë jemi të mendimit që, brenda mundësive dhe nevojave dhe krahas me sukseset e zhvillimit tonë, duhet thelluar më tej revolucioni ynë ideologjik, kulturor dhe tekniko-shkencor; ky proces duhet të shkojë

vazhdimeshit në ngritje që të jemi në gjendje t'u përgjigjemi kërkesave për zhvillimin e prodhimit, të kulturës, të artit etj. Për këtë qëllim ne duhet të shfrytëzojmë të gjitha mjetejt materiale dhe njerëzore, kuadrot e kualifikuar dhe ata gjysmë të kualifikuar.

Unë jam, gjithashtu, dakord me gjithë shokët për të mos u nxituar në këtë drejtim, siç ndodh nganjëherë, që, duke u nisur nga një dëshirë e zjarrtë dhe e pastudiuar me kujdes, krijojmë diçka sa për të krijuar. Byrotë teknike, organizative dhe projektuese vërtet janë të nevojshme, por ato mund të ngrihen, kur gjykohet se nevojiten e të mos krijojmë organizma të tillë vend e pa vend, atje ku është e ku s'është nevoja. Në këto byro detyrat duhet të janë të përcaktuara si duhet për secilin dhe të mos mbahen në to njerëz që nuk e meritojnë bukën aty, kur fare mirë mund të shkojnë për të punuar gjatkë, ku mund ta japid më të madh frytin e diturisë së tyre. E theksoj këtë se mund të ngjasë që nën parullën e ngritjes së shumë byrove, të grumbullohen në to kuadro më tepër nga sa duhen, për të cilët kanë nevojë sektorë të tjerë. As të mos ngjasë që punët që duhet t'i bëjë ndërmarrja, mjeshtri ose punëtori, t'i ngarkohen byrosë. Pastaj përse u dashka të krijohet një byro kur punën e saj mund ta bëjnë fare bukur një ose dy mjeshtra me tre a katër punëtorë? Në këtë anë ne duhet të bëjmë një ekonomi të madhe kuadrosh, t'i vlerësojmë këta si duhet, pse konstatohet në shumë raste që vlerësimi i tyre, sidomos i kuadrove me arsim të lartë dhe të mesëm, në të vërtetë nuk është kudo ai që duhet të jetë.

Punët tona janë të mëdha dhe gjithnjë zgjerohen, prandaj kuadrot me arsim të lartë e të mesëm nuk duhen përdorur pa kriter; në shpérndarjen e tyre të mos shkohet «me shpirtin e repartit», sa mezi i jepen një, dy ose pesë inxhinierë një ndërmarrjeje që ka shumë nevojë, në një kohë që në ndërmarrjen, fabrikën ose kombinatin ku ata punojnë ka me dhjetëra mjeshtër të kualifikuar që mund ta zëvendësojnë inxhinierin e vënnë në krye të repartit. Me një qëndrim të tillë bëhet një gabim i rëndë ndaj ekonomisë dhe zhvillimit të shkencës. Pikërisht këtu duhet të kenë kujdes Partia, Qeveria dhe ministritë, të cilat të marrin masa serioze në këtë çështje.

Ne duhet ta perfektionojmë atë që kemi arritur dhe ta zhvillojmë më shumë nëpërmjet metodës shkencore dialektike, me qëllim që të njohim mirë bazat shkencore për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës. dhe prej këtej të nxjerrim qartë detyrat që duhet të shtrojmë. Në raportin që na është paraqitur janë përcaktuar një sërë orientimesh e detyrash, për të cilat më duket se duhet të përcaktojmë qartë dhe të harmonizojmë sa më mirë objektivat imediatë dhe ata të perspektivës, të përcaktojmë sa më drejt metodat më të drejta të punës shkencore. Për arritjen e këtyre objektivave ne duhet të përcaktojmë mjetet kryesore dhe vendimtare që duhen, të bëjmë mobilizimin e madh të forcave në ekonomi, të cilën do ta zhvillojmë në mënyrë të organizuar, saqë cilido që do të vëré gurin e vet në ngritjen e kësaj vepre të madhe, ta ndiejë përgjegjësinë dhe të kuptojë se ajo që jep ai, ka rëndësinë e vet, prandaj detyra e tij është të kualifikohet.

çdo ditë dhe të japë kontributin më të lartë tekniko-shkencor, duke ndjekur format e ndryshme të kualifikimit, si: shkollat, kurset, konferencat etj., etj., që përmenden edhe në materialin e paraqitur.

Unë jam dakord me orientimet që jepen këtu për bujqësinë. Në këtë degë me rëndësi të ekonomisë ne kemi marrë një rrugë të mirë, veçse duhet të mobili-zohemi që të arrijmë synimet që caktojmë. Në tematikën për bujqësinë duhen bërë studime shkencore të mëtejshme dhe të thella, për sot dhe për perspektivën, për organizimin e përsosur të punës në kooperativat bujqësore dhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, për organizimin financiar të tyre, për marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore që krijojnë në to me zhvillimin e tyre ekonomik, teknik, kulturor, në gjirin e ndërtimit të socializmit, në marrëdhëniet me shtetin, në raportin midis kooperativave fushore e malore etj.

Jam, gjithashtu, dakord se edhe në industri kemi përparime, por duhet të njohim që në këtë fushë nuk jemi të azhurnuar me shkencën e përparuar dhe në përgjithësi na mungon kualifikimi i punonjësve. Nga raporti del se në prodhim përdoret akoma në shkallë të gjerë metoda artizanale dhe shkencëtarët tanë lidhen akoma dobët me prodhimin. Në këtë drejtim duhet të bëjmë kujdes për mekanizimin e proceseve të punës, që është një detyrë e madhe. Për këto arsyе duhet t'i aktivizojmë njerëzit më mirë dhe të përdorim të gjitha mundësitë e mjetet që kemi, sidomos librat etj., etj. Të interesohemi, në radhë të parë, që njerëzit të azhurnohen me të dhënat e shkencës botërore, të cilat t'i aplikojnë në kushtet tona. Ne nuk jemi kundër shken-

cës botërore, as kundër shkencës kapitaliste, por kundër metodave dhe ideologjisë kapitaliste që e shfrytëzon shkencën për shpërthimin dhe përhapjen e luftërave dhe për shfrytëzimin e masave të popullit.

Prandaj, si konkluzion, them se ne sot kemi forca shkencore teknike dhe materiale të konsiderueshme që, po t'i gjallërojmë akoma, po t'i organizojmë më mirë dhe t'i ndihmojmë më shumë, me siguri do të bëjmë hapa të mëdhenj përparrë. Për këto arsyë t'i përvishe mi punës në mënyrë masive dhe të mos harrojmë asnjëherë që lidhja dhe vartësia reciproke e shkencës dhe e teknikës me prodhimin, është kurdoherë e pandarë nga politika dhe ideologjia e Partisë sonë. Të tëra këto janë të pleksura njëra me tjetrën dhe bashkëpuni-mi i ngushtë e i pashkëputur, si dhe harmonizimi dhe kondicionimi i tyre me njëri-tjetrin është i domos-doshëm.

Duhet të shmangim sa më shumë rrezikun e studimeve të cekëta, moskoordinimin e mirë të punëve shkencore dhe marrëdhëniet e ndihmës reciproke jo në nivelin e duhur midis qendrave të ndryshme të një sektori ose të sektorëve të ndryshëm. Të mënjanojmë, gjithashtu, edhe moskomunikimin e organizuar të studimeve dhe të përfundimeve të eksperimenteve, që sjellin me vete humbje kohe dhe materiale, si edhe një punë paralele që nuk shfrytëzohet me shpejtësi në të gjithë sektorët. Këto të meta t'i kemi parasysh patjetër, sepse na krijojnë rreziqe të mëdha e shumë dobësi, këto lindin mendjemadhësinë, konservatorizmin, monopolizimin e shkencës në një ndërmarrje ose në disa kuadro shkencorë që kanë rezultate të mira, por që di-

sa prej tyre mund të kenë tendencën t'i mbajnë ato përvete.

Për sa u përket lidhjeve midis shkollave të larta me prodhimin, me byrotë teknike, me këshillat shkencore në uzina, në fabrika, në ndërmarrje e kooperativa nuk ka nevojë të flas, sepse shokët e prekën shumë mirë këtë çështje. Forcat shkencore dhe mjetet finanziare të mos harxhohen pa kritere të shëndosha, pa rentabilitet për ekonominë dhe kulturën socialiste, të mos lejohen paralelizma në temat, studimet dhe në eksperimentimet, sidomos për ato që janë të kushtueshme.

Me të gjitha orientimet e përgjithshme lidhur me tematikat për gjeologjinë, historinë, shkencat, letërsinë, gjuhësinë, jam dakord, ato ne mund t'i aprovojmë si orientime të përgjithshme, por, natyrisht, mbi to të punojnë në mënyrë të veçantë organet dhe njerëzit e specializuar, me qëllim që t'i zhvillojnë, t'i shkallëzojnë në afate etj., duke caktuar njerëzit, forcat, mjetet dhe fondet e nevojshme.

Të organizohet mirë edhe puna e kontrollit përzbatimin e orientimeve. Format organizative të punës që rekomandohen, më duket se janë të pranueshme, vetëm nuk duhet të jenë të ngurta, burokratike e thjesht administrative.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
"Raporte e fjalime 1970-
-1971", Tiranë, 1972, f. 268*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, "Raporte e fja-
lime 1970-1971", Tiranë, 1972,
f. 268*

SHKOLLËN TA NDËRTOJME NË PËRPUTHJE ME ZHVILLIMIN E EKONOMISE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

20 prill 1971

Natyrisht, kur të vendosim për planin e ardhshëm pesëvjeçar nuk do të qëndrojmë në vend edhe për çështjen e shkollës. Por kjo kërkon studime. Nxënësit, që mbarojnë shkollën e mesme profesionale dhe sidomos ata që mbarojnë shkollën e mesme të arsimit të përgjithshëm, medoemos duhet të plotësojnë kërkesat e universitetit dhe të shkollave të tjera të larta. Ata nxënës që mbarojnë shkollën e mesme profesionale mund të venë, por edhe mund të mos venë në universitet, sepse mund të mos duan, apo se nuk plotësojnë kërkesat e domosdoshme. Pra, jo të gjithë ata që mbarojnë shkollat e mesme ndjekin edhe shkollën e lartë. Këtë duhet ta kemi parasysh kur të caktojmë numrin e shkollave të mesme që do të hapen, si dhe

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe studimi: «Mbi perspektivat e shtrirjes së arsimit të mesëm».

raportin se sa do të jenë profesionale dhe sa të përgjithshme. Këtë numër do ta caktojmë duke llogaritur nevojat e ngutshme për specialistë të mesëm dhe nevojat e gjithë ekonomisë sonë për kuadro me arsim të lartë. Në qoftë se duhet të përgatitim, fjala vjen, 50 000 veta në shkollat e ulëta profesionale, do të thotë që hëpërhë neve nuk na intereson aq shumë çështja nëse këta do ta ndjekin apo jo shkollën e mesme, sesa kërkesa që të ecë përpara prodhimi.

Në pesëvjeçarin tjetër, përvèç shkollave të mesme që kemi do të shtojmë, ta zëmë, edhe 30 të tjera. Mirëpo ata që kanë mbaruar deri tash shkollat e ulëta profesionale, atëherë do të jenë specialistë me minimum nga 10 vjet eksperiencë në punë. Kjo është një eksperiencë e madhe. Meqenëse janë pa shkollë të mesme, atyre më vonë mund t'u bëhet edhe një kurs plotësues. Por të kupto hemi drejt: këtu në asnjë mënyrë nuk bëhet fjalë për zëvendësimin e shkollës së mesme me shkollën e ulët profesionale.

Për sa i takon përgatitjes së kuadrove me arsim të lartë, prej atyre që dalin nga shkollat e mesme profesionale, këtë duhet ta plotësojmë për aq sa kemi nevojë dhe diçka më tepër, se natyrisht, gjatë kohës, numri i kuadrove me arsim të mesëm dhe me arsim të lartë do të ndryshojë, do të ketë edhe humbje e firo. Ne do të shkojmë drejt përgjithësimit të arsimit të mesëm, por çështja është që ta ndërtojmë shkollën në përputhje me kërkosat që shtron përmirësimi i ekonomisë dhe me rritjen e nivelit të mekanizmit të shumë proceseve të prodhimit në degë të ndryshme. Me zhvillimin e vrullshëm të ekonomisë dhe me rritjen e shkallës së

mekanizimeve neve na krijohen shumë mundësi në këtë drejtim.

Edhe në pesëvjeçarin e ardhshëm ne do të ecim përpara drejt shtimit të shkollave të mesme, me dhe pa shkëputje nga puna, si dhe drejt shtimit të shkollave të ulëta profesionale. Sa për shpenzimet që nevojiten për shkollat që do të ngrihen në fshat, unë jam dakord me atë që u tha këtu. Atje ku kooperativat kanë të ardhura të mira dhe janë në gjendje për të investuar, ndërtesat e shkollave mund t'i ngrenë edhe vetë ato. Por kjo çështje duhet parë ashtu siç veprohet për qytetin, që edhe në fshat, në të ardhmen, shteti të përballojë gjysmën ose bile edhe të tëra shpenzimet për ngritjen e shkollave, duke gjykuar në çdo rast sipas gjendjes dhe mundësive ekonomike të secilës.

Të bëjmë çështë e mundur që edhe në shkollat e fshatit të plotësohet medoemos kontingjenti i planifikuar se po të mos veprojmë kështu, atëherë do të mbarojnë universitetin vetëm nxënësit e qytetit.

Në lidhje me kuadrin që do të caktohet për të dhënë mësim në shkollat e mesme me dhe pa shkëputje nga puna, mua më duket se duhen pasur para-sysh mirë nevojat. Atje duhet të venë pak më tepër, sepse shkollat pa shkëputje nga puna do të ndiqen nga shumë punonjës. Shkolla ne nuk do të hapim dhe nuk do të ndërtojmë më tepër nga sa janë të domos-doshme, por duhet të mendojmë që kuadrin ta përgatitim me kohë dhe ta plotësojmë, se një mësues nuk mund të përballojë dhënien e të gjitha orëve të mësimit edhe me nxënësit që ndjekin shkollën me shkëputje nga puna, edhe me ata që ndjekin shkollën pa shkë-

putje nga puna, prandaj ngarkesën e këtyre kuadrove ta shikojmë pak më ndryshe.

Rëndësi e madhe t'u vihet edhe cilësisë së punës për përgatitjen e nxënësve, sidomos të shkollës 8-vjeçare, se ajo nuk është aq e mirë. Shkolla 8-vjeçare është baza ku merren njohuritë fillestare, prandaj, mua më duket se duhet ta shikojmë nevojën për kualifikimin dhe perfeksionimin e mësuesve të këtyre shkollave. Nxënësit që mbarojnë 8-vjeçaren të dalin të aftë që, kur të futen në shkollat e mesme profesionale apo të përgjithshme, tõ kenë një përgatitje të mirë.

Shqyrtimi i këtij problemi në Byronë Politike ishte shumë i nevojshëm dhe pak a shumë diskutimet u zhvilluan drejt, prandaj, gjatë hartimit të planit pesëvjeçar, duke pasur parasysh që ne do të ecim edhe më përpara në fushën e arsimit, këto diskutime duhet të merren parasysh kur ta rishikojë këtë problem Komisioni i Planit të Shtetit në kuadrin e përgjithshëm të planit.

Botohet për herë të parë si-pas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TOKAT E REJA QË HAPEN, TË FUTEN MENJËHERË NË PRODHIM

*Nga një bisedë me sekretarë të KQ të PPSH
dhe me disa shokë të Qeverisë¹*

23 prill 1971

Ne rekomanduam studimin e disa problemeve kyç të planit gjatë kohës që këto vijnë nga baza në dikastere, pastaj, pasi të shihen edhe nga Komisioni i Planit të Shtetit, do t'i paraqiten Byrosë Politike. Por, duke punuar për këtë qëllim, është konstatuar se ekzistojnë disa vështirësi, që kanë nxjerrë në pah nevojën e një shqyrtimi e diskutimi paraprak, përpala se çështja t'i referohet Byrosë Politike.

Ne u sinjalizuam shokëve që të shqyrtojnë herë pas here të tilla probleme të rëndësishme. Kështu u bë edhe për çështjen e fondit të tokës së punuar dhe të strukturës së mbjelljeve. Në këtë drejtim Komisioni i Planit ka tani si pikëpamjen e Ministrisë së Bujqësisë, ashtu edhe të bazës. Natyrisht, ne ishim të

1. Kjo bisedë u zhvillua rrëth problemit të fondit të tokës së punueshme dhe strukturave të mbjelljeve.

shqetësuar për situatën e krijuar, për arsyen se shifrat kanë një ndryshim të ndjeshëm në krahasim me kuotat e para orientuese. Kuotat ishin parë lidhur me zhvillimin e përgjithshëm të pesëvjeçarit, po megjithatë ndonjë ndryshim mund të bëhej dhe mund të bëhet edhe gjatë procesit të punës. Sidoqoftë sot këtu ne vetëm mendime do të shkëmbejmë dhe nuk do të vendosim.

Mendimet që do të shkëmbejmë, mund të bien ndesh me pikëpamjet që ka Ministria e Bujqësisë, por qëllimi është të arrijmë në një konkluzion sa më të drejtë. Pastaj mund të bëjmë edhe një konsultim për të parë nëse ezaurohen të gjitha mundësitë që kemi tani e në perspektivë, por në këto përfundime do të arrijmë kur të kemi një ide më të plotë si qëndron konkretisht situata në sektorët e tjerë. Për këtë arsyen, të dhënat, që jep baza, si dhe ato të Ministrisë së Bujqësisë, të na argumentohen mirë.

Kur kemi bërë studimin e vitit 1968, kemi arritur në përfundimin që planin e parashikuar për hapjen e tokave ta realizojmë në 10 vjet, kurse tani kërkohet ta plotësojmë atë në 5 vjet. Ky shkurtim i kohës a është bërë në bazë të llogarisë së krahëve të punës, të mjeteve të mekanizuara dhe të gjithë gjendjes reale? Për këto ti, Pirro [Dodbiba], nuk flet fare.

Dëgjojmë të thuhet të mos hapim më toka të reja. Probleme këtu ka por çështja nuk duhet shtruar kështu. Tokat e reja që hapim mund të jenë në lartësi dhe pjerrësi të ndryshme, por puna nuk mbaron vetëm me çeljen. Përkundrazi, puna me to vazhdon për t'i futur në prodhim. Të mos largohemi shumë, le të marrim

pesëvjeçarin e katërt. Gjatë kësaj kohe kemi pasur mundësi që tokat e reja t'i futim në prodhim. A mund të na thuhet se sa për qind e tokave të reja janë futur mesatarisht në prodhim gjatë këtyre pesë vjetëve dhe cili është rendimenti i marrë në to? Këtu mund të gjykojmë të gjitha arsyet që shokët i zvogëlojnë ose i ekzagjerojnë. Ky është një tregues shumë më i bazuar për ne që të dimë nëse i kemi mbjellë, sa na kanë dhënë dhe sa janë braktisur¹.

Tokat e reja të hapura në zonat kodrinore e malore mund të mos jepin rendimente të larta si ato të fushës. Por kjo nuk do të thotë të arrijmë në konkluzionin që të mos hapen toka të reja në këto zona. Ne duhet të ndjekim ecurinë dhe rritjen e prodhimit të tyre, në mënyrë që Byroja Politike të nxjerrë konkluzione për vazhdimin e ritmit të rritjes së tokave të reja, për nevojën e marrjes së masave të veçanta për bimët që do të mbillen në to, për plehërimin etj., sepse janë me qindra mijëra hektarë. Mua më duket se një gjë e tillë nuk është bërë si duhet.

Krahas kësaj kërkohet që tokat të punohen e të

1. Lidhur me këto kërkesa, ish-ministri i Bujqësisë, Pirro Dodbiba, në këtë takim, u përgjigj se nuk mund të jepet të dhëna të sakta, kurse armiku i karmufluar Mehmet Shehu hodhi idenë se tokat e reja «jepin rendiment të ulët», se «që ta sistemosh tokën si duhet, kërkohet një punë jashtëzakonisht e madhe». Kështu ai zmadhonte me qëllim «vështirësitë» e kësaj pune, duke synuar indirekt të thoshte që të mos hapen toka të reja, gjë që ishte në kundërshtim me orientimet e Partisë dhe me direktivat e Kongresit të 5-të të saj.

sistemohen, t'u bëhen shërbimet e nevojshme, se nganjëherë ndodh që këtyre nuk u bëjmë as gardhet, as muret. Siç u tha këtu, shumë bukur është sistemuar toka në Vrith¹, prandaj do të ishtë mirë të na thoni më parë për sa kohë u bë gjithë kjo punë në Vrith, që është një tregues konkret, pastaj të shohim sa qëndrojnë parashikimet për këto që do të bëjmë.

Gjithashtu të shikohet mirë çështja e rendimentit. Ne po bëjmë reklamë për misrin hibrid dhe mendojmë që të arrijmë rendimentin mesatar 52-55 kuintalë për hektar, por në të vërtetë deri tani po marrim një rendiment mesatar prej 27 kuintalë për hektar. Atëherë pse e llogaritim kaq rendimentin kur nuk e marrim? E kam fjalën që nesër të mos dalim përsëri dhe të themi se llogaritë e fillimit për rendimentin e misrit ishin të gabuara.

Ne duhet të marrim parasysh disa gjëra. Në bujqësi punojnë njerëz të moshave të ndryshme. Jo të gjithë këta njerëz e kanë atë forcë krahë që kanë njëzetvjeçarët. Në llogaritjen e krahëve të punës përfshatarësinë mund të mbështetemi në shumë faktorë, pra edhe në bazë të regjistrimit të popullsisë dhe prej këtej pastaj do të nxjerrim se sa dynymë tokë i bie mesatarisht të punojë një njeri. Është bërë apo nuk është bërë kjo llogari? Në këtë llogari do të bazohemi ne, sipas mendimit tim, për të nxjerrë treguesit e punës së njerëzve. Në realizimin e kësaj çështjeje luajnë rol shumë faktorë si mekanika etj., prandaj në qoftë se na del llogaria, ta zëmë, 20 dynymë për njeri,

1. Fshat në rrethin e Shkodrës.

ne duhet të bëjmë edhe ndonjë zbritje, për arsyet se do të ketë edhe lëvizje të njerëzve.

Të gjitha variantet që u përmendën këtu mendoj që shokët e Komisionit të Planit dhe Ministria e Bujqësisë t'i shoshitin me kujdes. Unë jam me variantin e paraqitur. Mbetet që të organizojmë punën më mirë në bujqësi, sepse në qoftë se nuk e organizojmë mirë punën, ka rrezik që edhe ky variant të dalë jashtë caqeve të mundësive tona. Në qoftë se caktojmë një plan shumë të madh, atëherë rreziku është i tillë që pastaj ai të mos realizohet dhe kështu do të krijohen vështirësi.

Me variantin e paraqitur, që edhe ky është i reduktuar për sa u përket tokave të reja, në bilancin e bukës mbetemi zbuluar, gjë që do të na detyrojë të importojmë. Kjo tregon se edhe në këtë pesëvjeçar, me gjithë vendimet e masat që kemi marrë dhe përtë cilat kemi bërë shumë përpjekje, përsëri ne kemi një plan të sforcuar. Unë nuk kuptoj një gjë, që ne përsëri proporcionin ndërmjet grurit dhe misrit po shkojmë duke e keqësuar, sepse rritet sipërfaqja e mbjellë me misër dhe ulet ajo e grurit. Në parashikimet përvitit 1973 ruhet proporcioni, domethënë, gruri është më lart, kurse më pas hipën misri. Na thuhet se misrin e eksportojmë. Mirë, por edhe grurë duhet të prodhojmë më shumë. Ne jo vetëm duhet të tregojmë dëshirën, por edhe të krijojmë mundësitë përvianatin që na jep prodhim më shumë, por përkëtë gjë duhet ta forcojmë shumë punën ideopolitike dhe organizative përmobilizimin e përgjithshëm të punonjësve të bujqësisë. Në të vërtetë asnjë nga rrethet nuk i është

përgjigjur qoftë edhe afërsisht plotësimit të kuotave të tokave të reja; ato kanë dhënë 39 mijë hektarë më pak për toka ara. Ne duhet ta marrim parasysh këtë. Të dhënat e tyre, sipas mendimit tim, janë për më pak, jo se nuk kanë tokë, por sepse nuk është studiuar mirë problemi dhe se nuk është punuar sa duhet. Mendoj se këto nuk janë të dhëna në të cilat mund të mbështetemi krejtësisht dhe do të bënim gabim sikur t'i pranonim kuotat që propozojnë rrethet. Është fakt se mobilizimi dhe organizimi i punës nëpër fshatra dhe kooperativa, si dhe shfrytëzimi i mekanizmit dhe i qeve të punës, sikurse e kemi konstatuar, nuk janë në rregull.

Hapjen e tokave të reja dhe sistemimin e tokave të hapura ta kemi kurdoherë në qendër të vëmendjes. Këto probleme t'i shtrojmë në kompleksin e plotë të tyre, si detyra me rëndësi për kooperativën, që qysh kur hap tokën të mendojë se nga ajo do të marrë prodhim, prandaj duhet të punohet, të mbillet, të plehë-rohet dhe t'i bëhen të gjitha shërbimet. Po t'i themi fshatarësishë të hapë toka të reja dhe pastaj të lihen pa u mbjellë për vite me radhë, pa iu bërë sistemim etj., problemi i tokave të reja nuk do të realizohet kurrë. Por, mos harrojmë se tokat e reja futen në planet tona të prodhimit bujqësor, ndaj, prej tyre, duhet të sigurojmë të ardhurat e parashikuara.

Për t'i realizuar këto detyra forca kemi, vetëm se duhet organizim, i cili na galon shumë në bujqësi, në një kohë kur nevojat tona janë të mëdha. Dimë që krahët e punës në kooperativë nuk shfrytëzohen si duhet, shumë njerëz largohen nga puna me arsyen e

pa arsy, me leje dhe pa leje. Gjithashtu të bëhet kujdes që në aksionet e mëdha si në hekurudhë etj., të mos dërgohen vetëm kooperativistë, por më shumë studentë, të rinj punëtorë, se ndryshe do të dëmtohet puna në kooperativë, pasi rinia atje është forca më aktive e fshatit. Nuk duhen tërhequr pa kriter nga fshati krahët e punës. Po ashtu të shihet problemi i pjesëmarrjes në punë në kooperativa, se ka të tjerë që rrinë në shtëpi apo zbresin në qytet dhe nuk punojnë për një arsy ose për një tjetër.

Gjithashtu kam mendimin që në këtë pesëvjeçar të bëjmë përpjekje akoma më të mëdha për shtimin e plehut, jo me anë të fabrikave, pse pleh kimik kemi dhënë me qindra mijëra tonë, por duke grumbulluar e përdorur më shumë plehun organik, sepse këtu ne kemi akoma rezerva. Kjo punë mund të bëhet e kombinuar: në ato kooperativa që kanë pleh organik të ulim sasinë e furnizimit me plehun kimik, kurse atyre që nuk kanë t'u japim diçka më shumë. Pra, të bëjmë mirë bilancin e plehut.

Unë mendoj që gjatë këtij pesëvjeçari pleh organik dhe sipërfaqe të ujishme do të kemi më shumë. Prandaj dhe lufta të jetë për ta shtuar rendimentin e drithit jo 7,5 kuintalë, por mesatarisht 10 kuintalë për hektar.

Nuk e di nëse do të realizohet kjo shtesë prej 10 kuintalë për hektar, por ne kemi nevojë, për këtë, duam sasinë e misrit dhe të grurit që po diskutojmë. Unë pranoj që të bëjmë ndonjë zbritje në pambukun dhe në bimët e tjera, por nuk jam shumë i bindur se kjo do të na japë gjë. Mua më duket se në fondet e përgjithshme të rrethit nuk duhet të llogariten ata

mijëra hektarë që kanë në shfrytëzim oborret kooperativiste. Megjithatë ne duhet të dimë se me çfarë do t'i mbjellin kooperativistët këta hektarë tokë, me drithëra, foragjere apo me perime.

Për sa u përket tokave të reja ne duhet të parashikojmë në plan një kuotë të caktuar si tokë për arë, kurse çështjen e pemëtarisë ta shikojmë. Jam dakord që të krijojmë bloqe të mëdha me dru frutorë. Këto t'i realizojmë nëpërmjet aksioneve me goditje të përqendruar si dhe me ndihmën e shtetit.

Jam i mendimit që të caktohet një rendiment i arsyeshëm për tokat e reja, por pa u inkluduar të gjitha rendimentet e rretheve, sepse pastaj do të hiqet vëmendja dhe kujdesi i madh nga organizimi dhe shfrytëzimi maksimal i tokave të reja. Lidhur me këtë duhet pasur parasysh se plani i prodhimit të drithërave ndërtohet duke u bazuar në një rendiment të caktuar veç për tokat e reja dhe veç për të vjetrat. Për ta arritur atë duhet punë e studiuar, organizim, disiplinë. E theksoj këtë, sepse në kooperativa, edhe kur ka krahë pune të mjaftueshme, ka mungesë organizimi e discipline. Puna jonë duhet të synojë që njerëzit të mobilizohen më shumë, për të arritur rendimentet e planifikuara në drithërat e bukës, si dhe në bimët e tjera, si: oriz, duhan, pambuk, lulëdielli etj.

Pra, shokë, t'i rishikojmë këto çështje. Kjo është e domosdoshme. Dhe të mos u caktojmë rretheve detyra të lehta, sepse detyrat e lehta nuk i mobilizojnë njerëzit. Përkundrazi, ata mobilizohen më mirë me detyra të mëdha, po, sigurisht, të mundshme dhe reale. Kur këto detyra zbërthehen e kuptohen politikisht

dhe ekonomikisht, kur rëndësia e tyre shihet jo vetëm për rrëthin, por edhe në shkallë kombëtare, kjo do të bëjë që të mobilizohen rrëthet jo vetëm që t'i hapin tokat e reja sipas planit, por edhe t'i punojnë ato si duhet e të marrin prej tyre prodhim.

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimave të mbajtura
në këtë takim, që gjenden
në AQP*

AVIATORI ME AVIONIN JANË NJË E TË PANDARE

*Fjala me rastin e 20-vjetorit të krijimit të armës
së avacionit*

24 prill 1971

Të dashur shokë të avacionit, të mbrojtjes kundërajrore dhe të reparteve të tjera të ushtrisë,

Më lejoni që, me rastin e 20-vjetorit të armës luftarake të avacionit, t'ju sjell sot urimet më të mira, të ne, shokëve që ndodhemi këtu me ju, si dhe përgëzimet më të nxehta të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë për kryerjen me sukses të detyrave të mëdha që ju ka caktuar Partia.

Ne jemi shumë të gjëzuar veçanërisht sot që morëm pjesë në manifestimin e një stërvitjeje, mund të them, të cilësisë së lartë nga ana juaj. Gjithë pilotët, inxhinierët, teknikët e mekanikët, të frysmezuar nga mësimet e Partisë, janë të sigurt në veprime, nga që kanë arritur në një stad të lartë përgatitjeje; ata janë mobilizuar totalisht për t'i përdorur me efikasitet të madh armët e vlefshme që u kanë vënë në dorë pëpulli dhe Partia. I përvetësoni gjithnjë e më mirë këto armë që të janë në gatishmëri në çdo mo-

ment që ta lypë nevoja e mbrojtjes së atdheut dhe e interesave të lartë të popullit!

Siq dihet, armën e aviacionit ne e krijuam nga e para. Natyrisht, si kudo, edhe në këtë sektor mërita e madhe i përket Partisë sonë heroike që mori vendimin për ta krijuar atë. Por, një meritë e madhe ju përket edhe juve, pionierëve të aviacionit tonë, pilotëve, mekanikëve, gjithë teknikëve, që, duke kuptuar rëndësinë politike dhe ushtarake të kësaj arme, e mëkëmbët atë, mësuat me zell të madh dhe e përvetësuat në kompleks teknikën e saj. Ju kuptuat se teknika e aviacionit, jo vetëm në përdorimin dhe në shfrytëzimin e saj me mjeshtëri, por edhe në mirëmbajtje është një teknikë e lartë, që kërkon nga ana juaj një kujdes e mobilizim të jashtëzakonshëm, qoftë në shkollë e në mësim, ashtu edhe në praktikë e në fluturim. Gjatë zbatimit ajo kërkon gjithashtu një regjim të përditshëm personal të rreptë.

Shokët që janë pionierë të kësaj arme kanë mëritë të shquara, për të cilat i respekton Partia dhe populli, i respektojnë edhe brezat e rinj të oficerëve dhe të specialistëve të aviacionit që janë futur më vonë për të shërbyer në këtë armë. Në aviacion, për natyrën e punës së rëndë që bëhet në periudha të caktuara, është e nevojshme të vijnë pareshtur kontingjente të reja kuadrosh e specialistësh. Shumica, sigurisht, është e përbërë nga ata pilotë trima që, në kohën kur Partia e krijoi këtë armë, ishin akoma në bankat e filllores. Ndoshta, mund të ketë qëlluar atëherë që, kur kemi vizituar ndonjë shkollë të tillë, ndonjërit nga ju, t'i kemi fërkuar leshrat dhe ta kemi pyetur: «Ç'dëshi-

ron të bëhesh ti?» — «Aviator», mund të na ketë thënë ai. Ja, pra, kalamanët e atëhershëm, tash janë bërë burra. Disave që kanë pasur zell të madh e të papërmbajtur për armën e aviacionit u është realizuar kjo dëshirë dhe sot janë bërë aviatorë të shquar. Shpresat e tyre të mëdha, si në çdo lëmë tjetër, i realizoi Partia, që i ka vënë një kujdes të veçantë armës së aviacionit.

Shokë të dashur,

Ne duhet të jemi plotësisht të gatshëm e të përgatitur mirë për mbrojtje nga çdo rrezik. Partia jonë dhe populli shqiptar janë kundër çdo lufte grabitqare, janë kundër të gjithë atyre që e kanë luftën në gjak. Por derisa ekzistojnë në botë imperializmi dhe revizionizmi, të cilët po armatosen vazhdimisht për të shtypur popujt, për të shuar revolucionet dhe luftërat nacionalçlirimtare, për të likuiduar socializmin, ne, tok me të gjitha forcat revolucionare të botës, përgatitemi ushtarakisht dhe u bëjmë ballë me heroizëm e me sukses të madh armiqve. Neve nuk na lejohet për asnjë moment të gjendemi të çarmatosur, të pastërvitur, nuk na lejohet të na ndryshket vigjilanca revolucionare. Në këtë çështje, shokë, luajnë rol edhe sasia e armëve të armikut, edhe madhësia e territorit të tyre, edhe sasia e natyra moderne e armëve që ata zotërojnë. Të gjitha këto ne nuk i nënveftësojmë, por as edhe i mbivlerësojmë. Këta faktorë ne i kemi kurdoherë parasysh, pse kështu do të dimë të luftojmë si duhet kundër armiqve. Për asnjë

minutë nuk na lejohet të trembemi nga forcat e armikut apo të një grupimi armiqsh, që eventualisht mund të sulmojnë Republikën tonë Popullore, sado i madh që të jetë ai.

Partia jonë nuk e ka zakon të mburret, pse mburjet, sidomos ato pa baza, kanë pasoja të rënda. Por për disa probleme kapitale, ajo shfaq mendime dhe, kur i shfaq, i ka bërë më parë mirë llogaritë. Çdo gjë Partia jonë e bën të studiuar, të bazuar. Cilatdo qofshin forcat e një armiku ose të një grupei armiqsh, që mund të na sulmojnë, ato do të janë të detyruara të veprojnë në territorin e Republikës Popullore të Shqipërisë. Mirëpo ky territor mund të nxërë një sasi të caktuar forcash armike, pse forca kolosale të panumërtë në këtë territor të vogël s'ka si futen. Edhe sikur të supozojmë se armiku do të na sulmojë në disa drejtime, me forca të mëdha, forcat njërezoresh dhe armët që disponon populli shqiptar janë të mjaftueshme që jo vetëm t'i përballojnë plotësisht ato të armikut, që janë më të mëdha në numër, por edhe të tejkalojnë potencialin e tyre, për arsyen se sasia dhe cilësia e forcave tona, sido që në numër do të janë më të vogla, në kohë rreziku e mobilizimi do të shumëfishohen. Këtë e bazojmë në llogaritë tona, duke pasur parasysh armatimet, dispozicionin e tyre, konfiguracionin e terrenit dhe, në radhë të parë, moralin e lartë, vendosmërinë dhe vullnetin e pathyeshmët të njerëzve tanë për mbrojtjen e atdheut.

Faktori vendimtar, shokë, në luftë, siç na mëson Partia, është njeriu, është ai që do të përdorë armët. Ushtarët e ushtrive imperialiste, pavarësisht se mund

të janë të pajisur me armë moderne, nuk janë dhe nuk mund të janë të frysmezuar me atë moral të lartë, me atë patriotizëm të zjarrtë dhe vullnet të çeliktë, siç janë të frysmezuar njerëzit e popullit tonë. Ushtria jonë, oficerët tanë, i madh e i vogël te ne, janë të vendosur gjer në fund për të mbrojtur atdheun, për t'i dhënë grushtin e vdekjes çdo agresori që do të orvatej të prekte kufijtë e vendit tonë. Kjo përbën një forcë kolosale, një plus të madh që shumëfishon rezistencën dhe shpirtin sulmues të popullit dhe të gjithë Ushtrisë sonë Popullore kundër çdo sulmi ose grupimi armiqësor. Këtu bazohet ajo llogari e pagubueshme e Partisë sonë.

Direktivat e Partisë në lidhje me ushtrinë janë të atilla që, duke filluar nga i vogli e tek i madhi, nga i riu e deri te plaku, gratë dhe burrat, të tërë të janë ushtarë të republikës, jo vetëm me dëshirë të plotë, por edhe të stërviten e të edukohen si të tillë, që të janë me të vërtetë të aftë për mbrojtjen e interesave të lartë të popullit, të socializmit e të revolucionit. Kjo, natyrisht, kërkon, në radhë të parë, një përgatitje të gjithanshme e të madhe, një kuptim të thellë politik të këtij problemi kapital që i vihet përpara gjithë popullit nga ana e Partisë. Zbërthimin e zbatimin si duhet të kësaj direktive Partia, në radhë të parë, jua ka ngarkuar juve, kuadrove të ushtrisë sonë të lavdishme. Ushtria jonë është krijuar e mbrujtur me gjak dhe ka dhënë prova në përpjekjet e ashpra të Luftës Nacionallirimtare dhe gjatë periu-dhës së ndërtimit socialist.

Puna e zhvilluar gjer më sot nga ana e kuadrove

e ka bërë ushtrinë të arrijë në stadin e një ngritjeje të madhe politike, ideologjike, teknike dhe ushtarake. Ushtria është bërthama e fuqishme e organizimit të të gjithë popullit për ta bërë çdo qytetar njëkohësisht edhe një ushtar të mirë. Ushtari ynë duhet të mësohet që jo vetëm të dijë të përdorë më së miri pushkën, mitralozin, topin e çdo mjet tjetër, por me diturinë e tij të madhe në çdo armë e degë që caktohet, ato që di t'ua mësojë edhe masave të gjera të popullit, të cilat në të ardhmen do të organizohen edhe më mirë në forcat tona të armatosura. Kështu ato do të jenë në gjendje të dinë sa lart të qëllojnë e qysh të qëllojnë me këto mjete, të njohin si duhet artin e luftimit, domethënë të sulmit, të mbrojtjes, të törheqjes kur duhet, artin për të vrarë sa më shumë armiq dhe për të pasur vetë sa më pak humbje, artin për të mos e lënë të huajin të shkelë në tokën tonë. Kështu, të gjithë në vendin tonë, popull dhe ushtri, do të dinë të gjitha të fshehtat e taktilës e të strategjisë ushtarake. Kjo do të bëjë të mundshme që truri i njerëzve tanë, i punëtorëve dhe i fshatarëve, të punojë e të krijojë qysh tash në kohën e paqes relative që më vonë, në kohë të rrezikshme, të gjitha ato ç'kanë mësuar tash t'u bëhen shprehi e zakone. Ne në këtë rrugë po ecim dhe kemi suksese, por duhet pranuar se kemi akoma përpara një punë të madhe për të bërë.

Ngritja politike e njerëzve tanë është një forcë kolosale që qëndron në radhë të parë, mbi çdo forcë tjetër, edhe mbi teknikën dhe armatimin e armikut. Faktori i dytë me rëndësi që bën të pathyeshme ush-

trinë tonë është puna për përgatitjen e njerëzve tanë si ushtarë të vërtetë të republikës me një aftësi të tillë që të jenë superiorë mbi përgatitjen e ushtarëve, oficerëve dhe aviatorëve të armikut. Ne kemi parasysh se edhe aviatorët e armikut kanë zotësi, kapacitete, shumë prej tyre janë trima. Këto nuk duhet t'i nënveftësojmë, por ne jemi superiorë, pse dimë përsë luftojmë. Armiku ka frikë se mos e vrasësh në luftë, kurse ne nuk kemi frikë, se frysëzohemi nga idealet e larta të Partisë, të mbrojtjes së atdheut dhe fitoreve të popullit.

Armët që kemi tash nuk janë të vjetra si në kohën e luftës, megjithëse me ato armë të vjetra e të pakta të asaj kohe u dhamë dërmën italianëve, gjermanëve e ballistëve, të pajisur me mjete shumë më moderne nga tonat dhe me municione pa hesap. Ne, edhe ato armë të pakta që kishim, ua morëm armiqve dhe fituam mbi ta. Tash armët që disponojmë barazohen, bille nganjëherë ua kapërcejnë atyre të armiqve. Në të ardhmen ato do të jenë edhe më të mira.

Është fakt që nuk duhet ta mohojmë, se në fuqishën e aviacionit, në rast lufte, armiqtë do ta zotërojnë qiellin tonë. Po ne ama ata nuk do t'i lejojmë t'i përdorin si të duan avionët e tyre dhe të futen sipas qejfit në vendin tonë, si në një han pa porta. «Vrima e miut do të bëhet 500 grosh» për ta, si thotë populli. Me këtë duam të themi se armiqtë imperialistë, revisionistë e të tjerë do të lënë kokën në Shqipëri, po të guxojnë të na sulmojnë. Sidoqoftë, në ajër ata do të kenë épërsi. Në këto kushte, numrit të madh të avionëve, që mund të përdorin armiqtë

për të sunduar në qiel, ne duhet t'i kundërvëmë tërë forcat tonë.

Partia na këshillon që armën e aviacionit ta zhvillojtmë e ta forcojmë vazhdimisht. Rëndësi ka që avionët që kemi dhe që do t'i shtojmë edhe më shumë në të ardhmen, të mbahen sa të jetë e mundur në eficiencë. Ne ju përshëndetim me gjithë shpirt për stërvitjet e nivelistët të lartë që zhvilluat sot në ajër, duke treguar një zotësi e shkathëtësi të madhe. Unë dhe shumë shokë të tjerë kemi parë parada ajrore edhe në Bashkimin Sovjetik, ku aviacioni ka pasë marrë një zhvillim të madh. Në raste të tilla, në stërvitje, s'ka dyshim që atje marrin pjesë asët. Po edhe ju, sidonë jeni bij të një populli të vogël e të një vendi të vogël, ju them me bindje, dhe për këtë të mos ju rritet mendja, se edhe ju jeni asë. Te pilotët e Bashkimit Sovjetik unë nuk kam parë ndonjë gjë më tepër në krahasim me ju, pavarësisht se nuk i kuptoj mirë si ju këto çështje. Dua të them se me eficiencë duhet të kuptojmë atë që një avion yni në kohë lufte të kryejë detyra sa për tre avionë armiq. Atëherë forca e aviacionit tonë, në kohë rreziku, do të rritet tri herë më shumë. Kjo varet nga ju, pilotët, inxhinierët dhe teknikët e aviacionit, që duhet të bashkëveproninë një unitet të ngushtë e të pandarë me njëri-tjetrin. Aviacioni është një nga armët speciale të ushtrisë, ku aviatori me avionin janë një e të pandarë. Edhe kuadrot e ushtarët e armëve të tjera duhet të jenë të pandarë me mjetet luftarake. Kështu duhet të jenë topçiu me topin, mitralieri me mitralozin etj. Por me pilotin është më ndryshe pasi ai gjer në fund nuk

ndahet nga avioni i tij, i cili po u godit e u shkataerrua, mbaroi edhe vetë ai që e drejton. Për këtë arsyе avioni duhet të jetë në një gatishmëri teknike të përsosur, asnjë vidhë sado e vogël të mos jetë mangët. Prandaj është e domosdoshme të ketë një kontroll të rreptë në këtë drejtim.

Kryesorja është që nga ana e komandës dhe e vetë pilotëve të tregohet kujdes i veçantë për kalitjen fizike. Për këtë qëllim rëndësi të madhe ka zbatimi i një regjimi të rreptë për ju. Ky mund të jetë një regjim i shtrënguar, por ndihmon në kohë rreziku për ta ngritur më lart punën tuaj të madhe heroike në mbrojtje të atdheut kundër avionëve gjuajtës e bombarduesve armiq, me të cilët do të duhet të ndeshem. Ju e dini më mirë se unë, po mendoj se regjimi juaj në punë dhe në jetë duhet të zbatohet me rreptësi, që, kur të hipni në avionët që kemi ose në të tjerë më të shpejtë se këta të tashmit, që mund të kemi e do të kemi në të ardhmen, trupin ta keni të çeliktë dhe nervat të ftohtë, të qetë. Komanda, familjet, gratë tuaja e kanë për detyrë t'ju organizojnë një regjim shkencor të atillë që ta mbani trupin kurdoherë të freskët. Prandaj, të gjithëve, u vihet një detyrë e madhe partie që të tregojnë kujdes të veçantë për ju. Të tërë njerëz jemi, kemi edhe halle, pse jemi në luftë të përditshme me armiqtë, me vështirësi gjithfarësh. Kur punojmë, përgjithësisht, planet na realizohen, po nganjëherë edhe nuk na realizohen, prandaj ndodh të kemi emocione, mërzira, ashtu siç kemi edhe gjëzime, kur punët na shkojnë mirë. Të gjitha këto ushtrojnë ndikimin e tyre për mirë ose për keq te njeriu. Por,

te ne të tjerët, kjo nuk prish ndonjë punë, se i kemi këmbët në tokë, kurse ndryshe është puna me ju. Prandaj Partia, të gjithë ne, duam që ju të mos keni as shqetësimin më të vogël, që mendjen ta keni kurdoherë të kthjellët, pse, sikur për një sekondë të humbisni toruan, kjo mund të bëjë që të përplaseni pas shkëmbit, kurse jetën tuaj Partia e konsideron shumë të vlefshme.

Partia kërkon, gjithashtu, nga ju, pilotët, që avionin ta mbani kurdoherë në eficiencë dhe në gatishmëri të plotë. Kjo lyp, së pari, të zbatoni normat e ruajtjes së avionit. E dyta, të mësoni teknikën luftarake, në mënyrë sa më të përsosur. E treta, të keni kujdesin më të madh për regjimin tuaj. Kjo është një detyrë partie që ju vihet për ta zbatuar me përpikëri, prandaj të flini në orën e caktuar, të bëni gjimnastikë në orën e caktuar, të mbani me përpikëri atë regjim ushqimor që ju rekomandohet, të mos pini duhan, as alkool. Po t'i zbatoni të gjitha këto, atëherë do të jemi të sigurt për atë që thashë, që një avion yni të përballojë tre avionë armiq.

Çështja nuk qëndron vetëm këtu. Gjatë veprimeve luftarake ju do t'ju shoqërojnë dhe do t'ju vijnë në ndihmë armë të tjera që do t'jua lehtësojnë punën. Me këtë rast sot kanë ardhur për t'ju parë shokët tuaj të armëve më të afërta, ata të artilerisë kundërrajrore. Edhe kësaj arme ne i kemi vënë një rëndësi të madhe e të veçantë. Në të ardhmen do t'i vëmë akoma më shumë rëndësi, në mënyrë që në çdo situatë, me të gjitha forcat dhe me një kuptim të madh politiko-ideologjik, të jemi kurdoherë në

gjendje të thyejmë çdo armik që do të orvatet të sulmojë vendin tonë.

Ne kemi besim të patundur se ju, shokë të dashur të aviacionit, do të ecni përpara, siç ecën përpara gjithë ushtria jonë, siç ecën përpara gjithë ekonomia jonë socialiste, industria, bujqësia, kultura dhe arsimi etj. Të gjitha këto ecin përpara frontalisht, pse vija e Partisë është e drejtë.

Sivjet jemi përpara jubileut të 30-vjetorit të Themelimit të Partisë. Ishim të rinj atëherë, kur u themelua Partia, ndërsa tash themi: kur shkuan kaq shpejt gjithë këto vite? Gjatë kësaj periudhe Partia jonë është bërë e fuqishme me tetëdhjetë e ca mijë anëtarë e kandidatë, luftëtarë trima e të vendosur, që udhëheqin popullin me sukses në ndërtimin e socialistizmit dhe qëndrojnë në ballë të luftës e të sakrificave. Partia jonë e Punës është Partia e trimave, siç i këndon populli. Ajo ka mundur të çelikosë unitetin e popullit rrëth vetes, ka bërë të mundur që gjatë këtyre 30 vjetëve të mposhtë çdo armik, të vendosë diktaturën e proletariatit, të ndërtojë socialistimin dhe të krijojë një situatë të atillë, saqë sot habiten njerëzit që e kanë njojur Shqipërinë përpara. Habitën miqtë, habiten edhe armiqtë, bile habitemi edhe ne vetë, pse na duket sikur gjithë këto realizime janë si një ëndërr. Këto i bënë njerëzit tanë me vullnet të madh, me kurajë, njerëz dikur të paditur, çobanët, punëtorët, farkëtarët, nxënësit e rinj të shkollave, që u rritën në kohën e Partisë. Këta njerëz të thjeshtë të popullit u bënë inxhinierë, agronomë, tornitorë, aviatorë, teknikë e të tjera, të aftë për të përdo-

rur çdo mjet modern deri të elektronikës, kibernetikës etj. Sa vite që shkojnë, aq më shumë gjëra do të krijohen nga populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë. Me sukseset që arrin populli ynë fiton respektin e të tjerëve. Në botën kapitaliste apo revizioniste s'e respekton kush tjetrin, sidomos një popull të vogël. Mirëpo në rast se sot nuk tregon vitalitet, energji, forcë, zotësi dhe vendosmëri, siç bën populli ynë i vogël, imperialistët, revizionistët dhe reaksionarët të marrin nëpër këmbë. Ne, më mirë se kushdo, e dimë se nëpër këmbë u përpoqën njëri pas tjetrit të na merrnin armiqjtë për shumë vjet me radhë, po nuk na mposhtën dot. Prandaj sa më mirë t'i kuptojmë, t'i thellojmë, t'i zbërthejmë e t'i zbatojmë direktivat e Partisë, aq më të mëdha do të jenë fitoret e popullit në çdo lëmë, aq më të fortë do të bëhem i dhe aq më shumë frikë do të kenë armiqjtë për të na sulmuar.

Partia na mëson t'i mbajmë sytë kurdoherë hapur, pavarësisht nga koniunkturat që mund të krijohen. Qëkurse lindi, Republika Popullore e Shqipërisë ka dashur të ketë marrëdhënie sa më të mira me shtetet e tjera, sidomos me fqinjët, po këto s'i kanë dashur të tjerët.

Ne vendosëm marrëdhënie tregtare edhe me Greqinë, me të cilën me siguri mund të lidhim edhe marrëdhënie diplomatike.

Vendi ynë ka marrëdhënie diplomatike e tregtare me Jugosllavinë. Ne, nga ana jonë, pavarësisht se e kemi të qartë kush janë Titoja dhe titizmi, siç e keni parë edhe nëpërmjet shtypit, jemi për zhvillimin e këtyre marrëdhënieve në rrugën shtetërore, kurse në

fushën ideologjike qëndrimi i Partisë sonë ndaj revisionistëve jugosllavë nuk ka ndryshuar asnjë grimë. Ajo e di se ata janë antimarksistë, agjentë të amerikanëve. Titoja me gjithë njerëzit e tij e kanë halë në sy Shqipërinë. Këtë ne e kemi të qartë. Po të rrezikohej Jugosllavia prej ndonjë sulmi nga ana e revisionistëve sovjetikë ose nga Bullgaria, kjo natyrisht do të përbënte rrezik edhe për Shqipërinë, pse synimi i revisionistëve sovjetikë në këtë ndërmarrje do të qe dalja në Adriatik, për të siguruar baza detare për flotën e tyre në Mesdhe. Po të sulmohej Jugosllavia, siç e deklaruam edhe në shtyp¹, populli shqiptar do të ishte dhe do të jetë në krah të popujve jugosllavë.

Kjo ishte një politikë largpamëse e Partisë dhe e Qeverisë sonë. Në çdo kohë gjithçka mund të ngjasë, po vështirë të ndodhë si në kohët e para. Ta çosh sot në luftë aq lehtë popullin jugosllav kundër popullit shqiptar është vështirë, pse ai do të gjykojë që, në momente të rrezikshme për të, populli shqiptar ka dekluaruar se do të qëndrojë krah për krah me popujt e Jugosllavisë. Për të ardhmen kjo do të jetë një gozhdë e imprehtë për titistët.

Tani Titoja është në pozita jashtëzakonisht të vështira politike, ideologjike dhe ekonomike. Jugosllavia është në dekompozim si shtet, si ekonomi, pa lëre pastaj nga pikëpamja ideologjike dhe politike, për

1. Është fjala për artikullin e shokut Enver Hoxha: «Prezisionet ushtarake — bazë e diktatit dhe e shantazhit politik të udhëheqësve revisionistë sovjetikë» botuar në gazeten «Zeri popullit», nr. 86 (6438), datë 11 prill 1969. (Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 40, f. 401-415).

arsye se atje është vendosur tashmë kapitalizmi që u ka sjellë popujve jugosllavë të gjitha të këqijat. Ç'mund të sillnin vendosja e kapitalizmit në Jugosllavi dhe shtrirja e kthetrave të trusteve të mëdha amerikane në ekonominë e këtij vendi, përveç të këqijave për popullin? Këto kanë krijuar atje kaosin. Tradhtia e titizmit, siç e ka demaskuar gjatë gjithë kohës Partia jonë, tashmë është vërtetuar plotësisht. Sot në Jugosllavi ka rivalitet klanesh, serbomëdhenjtë komplotojnë kundër kroatëve e kundër shqiptarëve të Kosovës, kroatët kundër sllovenëve, malazeztë kundër maqedonasve e kështu me radhë, të gjithë kundër njëri-tjetrit.

Titoja vetë është në kundërshtim me krerët serbë, prandaj përpinqet t'i ketë nga ana e vet shqiptarët e Kosovës, sepse e njeh kokën e shqiptarit. Shqiptarët e Kosovës janë kundër serbomëdhenjve, pse vazhdimisht u ka kulluar gjaku rrëke nga mizoritë e tyre. Në këto rrethana, Titoja që i di këto, u detyrua t'u jepte disa liri kosovarëve, nga të cilat këta kanë filluar të përfitojnë dhe të reagojnë drejt. Për ne është e qartë se Titoja nuk i do shqiptarët, po tash përpinqet të bëjë politikë me shqiptarët e Kosovës, prandaj kuptohet se këto lëshime i bën nga halli. Serbomëdhenjtë tash kundërshtojnë e përpinqen të mos u jepen të drejtë kosovarëve. Megjithatë ne zhvillojmë tregtinë me Jugosllavinë dhe ca më shumë me Kosovën. Ju gjithashtu e dini se atje venë profesorët tanë për të mbajtur leksione; arsimtarë kosovarë vijnë te ne për eksperiencë. Kjo ka rëndësi të madhe se mban të gjallë te populli kosovar dashurinë për gjuhën dhe për

zhvillimin e kulturës shqiptare. Atje po punohet në këtë drejtim nga elementët patriotë. Rezistencë e intligjencies shqiptare në Jugosllavi tash ka marrë një formë shumë të zhvilluar, ajo e mbron me guxim gjuhën e kulturën shqiptare. Intelektualët patriotë kosovarë shkruajnë në shtyp, i presin jashtëzakonisht mirë, si vëllezër, ata që dërgojmë ne për të dhënë mësimë, bile shumë prej tyre, kur takohen me njerëzit tanë, qajnë nga gjëzimi. Kur shfaqen filmat shqiptarë, sallat e kinemave të Kosovës mbushen sa s'ka ku të vejë.

Pra, siç e thashë dhe më parë, ne duhet të jemi fort vigjilentë, vigjilentë dhe kurdoherë vigjilentë, zemra të mos na zbutet për asnjë çast kundër armiqve të jashtëm dhe, në rrugën e Partisë, të jemi gjithashtu vigjilentë edhe brenda.

Te ne situata është e shëndoshë. Kudo ekziston një gjendje revolucionare. Njerëzit tanë u janë përveshur punës dhe studimit. Krahas tyre të mos harrujmë mbeturinat mikroborgjeze në ndërgjegjen e punonjësve, presionin e madh të borgjezisë dhe të revizionizmit modern nëpërmjet një mijë e një mijeteve që depërtojnë dhe synojnë të ushqejnë njerëzit tanë. Aty-këtu ka elementë që preken nga ideologjia borgjezo-revizioniste, bile edhe nga radhët tona, shokë, nga rinia jonë. Ka punëtorë dhe kooperativistë që vjedhin pasurinë e shtetit, që mbajnë qëndrime jashtë moralit komunist, jashtë rrugës së ndershme të popullit etj.

Ku e qysh molepsen këta njerëz me vese të tilla? Nga televizioni, ose nga ndonjë film që vetë

ne e sjellim, sido që bëjmë kujdes të madh në këtë drejtim, ose nga radiot e huaja që dëgjojnë etj. Këto probleme nuk janë kaq të mprehta për ne, por rreziqet ekzistojnë. Prandaj Partia duhet të shkundet, të jetë vigjilente kundër çdo shfaqjeje të huaj në ndërgjegjen e njerëzve tanë, sado e vogël qoftë ajo. Sikur edhe tre-katër njerëz të tillë të ekzistojnë në lagje, sikur te katër-pesë kalamanë, nga 14-18-vjeçarë të duken shfaqje të tilla, duhet të shqetësohet gjithë opinioni ynë dhe të përpinqet t'i edukojë këta njerëz që të ecin në rrugë të drejtë. Vigjilanca duhet të mprehet, gjithashtu, edhe për mbrojtjen e pasurisë së shtetit, edhe kundër atyre që e dëmtojnë këtë pasuri. Kemi ne interes të dënojmë e të futim në burg disa njerëz? Jo, nuk kemi. Te ne nuk ekzistojnë premisat për lindjen e veseve të këqija, megjithatë këto kri-johen, jo se nuk ka punë, si në vendet e tjera ku ekzistojnë papunësia, uria dhe shtypja e shumë të këqija të tjera. Atje, nga një anë janë të pasurit, që mbushin rrugët e qyteteve të mëdha me makina të panumërtë, nga ana tjetër, ata që s'kanë bukë të hanë, kalamanët dhe pleqtë e të cilëve vuajnë nga sëmundjet, ose ngaqë s'kanë ku të rrinë. Atëherë ç'ndodh? Lind kështu banditezmi nga të katër anët. Te ne nuk ekzistojnë baza për fenomene të tillë, pse kudo është kujdesi i Partisë, kujdesi i prindërve, kudo ka shkolla për rrininë dhe punë për të gjithë.

Megjithatë, ka raste, e ndër këta edhe komunistë, që kujdesi i familjes apo i prindërve venitet dhe njëc mëngjes të mirë sheh që djali i ndonjërit të ketë marrë rrugë të keqe. Atëherë kujtohet ai të interesohet

për fëmijën e vet, që është larguar nga shtëpia, dhe vete kërkon ndihmën e shoqërisë. Kjo dhe organet përkatëse do të përpiqen ta ndihmojnë, por vetë prindi ku ishte më parë, dhe pse nuk tregoi asnje interesim për djalin e vet? Me siguri që djali nuk është larguar përnjëherësh nga shtëpia. Jo, ai është mësuar për disa kohë të shkojë me vonesë në shtëpi, çka do të thotë se familja s'ka çarë kokën fare, nuk e ka kontrolluar atë. Pikërisht, duke qenë jashtë këtij kontrolli, ai ka marrë rrugën e keqe.

Prandaj, pa i mposhtur ndjenjat e lirisë dhe të iniciativës së të rinxve, pa u bërë sektarë, brutalë, konservatorë etj., na vihet detyrë të rritim kujdesin për rinnë. Partia na mëson të mos i lëmë fëmijët në një liberalizëm të shthurur, por të kujdesemi vazhdimisht t'i edukojmë, t'i frenojmë në shfaqjet jo të mira të tyre, të flasim me ta si të sillen e si të veprojnë në jetë, derisa të marrin tiparet e njerëzve të pjekur, pastaj, e kanë vetë veten në dorë. Këto nuk janë çështje shqetësuese, ta kuptojmë, por shfaqje të tillë, që ju i dini, ekzistojnë aty-këtu, prandaj kërkohet nga të gjithë një preokupacion më i madh për luftimin e tyre.

Duke përfunduar, dëshiroj të shpreh kënaqësinë e madhe që pata mundësinë të piqem me ju. Me këtë rast u çà akulli, bile sot ia hipa helikopterit, me të cilin kurdoherë kam pasur dëshirë të lëviz. Tash mosha na shkoi ca, prandaj në rrethet e largëta si në Tropojë apo në Gjirokastër, nuk shkojmë dot më me automobil, se duhet një ditë rrugë e pastaj, një apo dy ditë çlodhje, kështu që harxhohet shumë kohë,

kurse me helikopterët tuaj udhëton shumë mirë, shpejt dhe rehat.

Ju uroj, shokë, të korrni suksese akoma më të mëdha në detyrën e madhe patriotike, marksiste-leniniste, që ju ka caktuar Partia. Të jeni të sigurt se Komiteti Qendror ndjek me admirim e kujdes të vëçantë mësimin dhe përgatitjen tuaj dhe është i sigurt se ju do ta kryeni me nder këtë detyrë. Ju uroj festën e 20-vjetorit të armës së aviacionit dhe ju stoj të pimë këtë dolli për lavdinë e Partisë sonë heroike të Punës që na udhëheq e sigurt në rrugën e socializmit dhe të komunizmit, ta pimë për shëndetin tuaj, shokë të dashur të aviacionit, për shëndetin e ushtrisë sonë të lavdishme.

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë me
ndonjë shkurtim sipas origji-
nalit që gjendet në AQP*

TE LUFTOJMË KONSERVATORIZMIN DHE FORMALIZMIN NË PUNËN ME RININË

Nga biseda¹ me sekretarin e parë të KQ të BRPSH

28 prill 1971

Shoku Enver Hoxha priti në takim sekretarin e parë të Komitetit Qendror të BRPSH dhe bisedoi me të për disa probleme të punës me rininë. Në fillim ai e informoi mbi punën që zhvillohet për të zbatuar porositë dhe këshillat që dha shoku Enver Hoxha në fjalimet e mbajtura para një grupei aktivistësh të organizatave të rinisë më 12 maj 1970 «Mbi gjallërimin e mëtejshëm të jetës së organizatave të rinisë në shkolla»² dhe në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH më 24 mars 1971 «Mbi disa aspekte të punës

1. Në këtë takim shoku Enver Hoxha dha porosi të qarta për të luftuar konservatorizmin dhe formalizmin në punën me rininë. Por Agim Meroja, në atë kohë sekretar i parë i KQ të BRPSH, i shtrembëroi dhe i interpretroi keq ato duke dëmtuar kështu punën e Partisë me këtë organizatë. Për gabimet e tij të rënda u përjashtua nga Plenumi i KQ të PPSH dhe nga Partia.

2. Enver Hoxha, Vepra, vëll. 43, f. 164-188.

së organizatave të BRPSH për përsosjen e figurës morale të rinisë¹. Pastaj ai ngriti disa probleme që kanë dalë e dalin para organizatave të BRPSH dhe organeve të tyre drejtuese.

Problemet më thelbësore për të cilat u vu në dijeni shoku Enver ishin: formalizmi në organizimin e mbledhjeve të rinisë; zbatimi i ngurtë i disa rregullave organizative dhe i një fryme zyrtare që vihet re disa herë në jetën e organizatave të rinisë; frika për të përdorur një larmi të tërë formash, që rinia i gjen vetë të përshtatshme për edukimin e saj, gjë që e ka burimin në mungesën e besimit të duhur ndaj rinisë dhe në konzervatorizmin e disa kuadrove të saj drejtues, disa komunistëve, mësuesve e prindërve; insistimi që në disa aktivitete shoqërore të marrin pjesë të gjithë të rinjtë pa mbajtur kurdoherë parasysh parimin e vullnetarizmit; mungesa disa herë e predispozionit për ta kuptuar si duhet rininë, për të hyrë thellë në botën e saj shpirtërore etj.

Pasi dëgjoi dhe pyeti disa herë rreth këtyre problemeve të punës me rininë, shoku Enver tha:

Shumë mirë bëre që erdhe. Këto probleme që shtroni ju janë të rëndësishme dhe duhen zgjidhur drejt nga Partia dhe organizata e rinisë së bashku. Ne duhet të përpinqemi t'i kapërcejmë një sërë vështirësish që paraqiten sot dhe që do të paraqiten akoma nesër në punën tonë me rininë.

Nuk është zhdukur akoma kudo konzervatorizmi

1. Enver Hoxha, Vepra, vëll. 45, f. 353.

për sa i përket edukimit të rinisë. Konsiderata e njerezve në rrugën e Partisë nuk është forcuar akoma si duhet ndaj të rinxve dhe të rejave. Në disa drejtime, sidomos në kërkesat morale, ka shfaqje të theksuara të konservatorizmit. Kjo duket qartë në dyshimin e tepruar të disave te të rinxjtë e të rejat, ndërsa gjendja realisht është e shëndoshë. Këta njerëz konservatorë nuk e kuptojnë që pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre të sëmura për rininë i sjellin asaj një dëm të madh. Vajtja e mësuesit në mbrëmje me ombrellë në dorë, për të ruajtur e për të vështruar nxënësit me bishatin e syrit, është një metodë e huaj për edukimin e të rinxve dhe e të rejave tona dhe tregon se vija e Partisë nuk është kuptuar nga ana e tyre. Nga rastet që përmende ti duhen nxjerrë mësime dhe të bëhet kthesë, sidomos në mendjen e shokëve që drejtojnë organizatat e rinisë, në radhë të parë.

Ka të tjerë konservatorë që, nën maskën e ruajtjes së të rinxve ose të rejave nga veset e këqija, përgjithësojnë ndonjë gabim që ka bërë ndonjëri dhe akuzojnë kështu padrejtësisht tërë rininë tonë. Kjo është krejtësisht e gabuar dhe gjithashtu e dëmshme. Rinia jonë është e pastër. Vija e Partisë synon që të pastrohen nga rrënjet të gjitha veset e këqija, format e ndryshme të degjenerimit kapitalist e revisionist, mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze që shfaqen aty-këtu si kudo edhe në punën dhe në jetën e të rinxve. Njerëzit konservatorë, duke iu qepur prapa rinisë, kujtojnë se «i ruajnë» të rinxjtë dhe të rejat mos bëjnë ndonjë gjest të papëlqyer kur këta organizojnë mbrëmje défrimi etj., por gabojnë, sepse gjatë mbrëm-

jeve ose në çdo aktivitet tjetër, ata nuk kanë si bëjnë gjëra jo të hijshme. Ata nuk mund ta marrin dot me mend se organizimi i formave shoqërore të dëfrimit shhang edhe ndonjë gabim që i riu ose e reja mund ta bëjë jashtë mbrëmjes, kur nuk janë në shoqëri të gjerë. Të rinjtë dhe të rejat i duan shokët e shoqet dhe kanë respekt të madh për ta, ata janë të një moshe dhe në mbrëmje ku ka një shoqëri prej dhjetëra vetësh, bëjnë shaka të pastra, ashtu siç janë të pastra vetë ndjenjat e tyre. Pastërtia morale e të rinjve dhe e të rejave nuk përjashton lindjen e simpative reciproke midis tyre. Puna është që simpatinë, miqësinë dhe dashurinë të rinjtë e të rejat t'i kuptojnë në rru-gë të drejtë morale. Nuk mund të ndalohen të rinjtë dhe të rejat të shoqërohen, të njihen e të miqësohen me njëri-tjetrin. Disa edhe do të dashurohen, por nga këto ndjenja të pastra asgjë e keqe nuk mund të ngjasë.

Edhe në rast se vërtetohet ndonjë gabim, atë nuk mund ta përgjithësojni dhe të përlyejmë gjithë rinnë. Nuk është e drejtë të alarmohemi në mënyrë të tepruar për disa shfaqje negative që nuk janë tipike, por janë të rastit në jetën e rinisë sonë. Puna që bën Partia veçanërisht në terrenin ideologjik, kundër gjithfarë mbeturinash të këqija të trashëguara nga e kaluara, është një luftë e madhe. Ky është ai revolucion që bën dhe vazhdon të bëjë Partia për edukimin e njerëzve gjatë të cilit ka fitore, por ka edhe ndonjë të ri e të re që shket, ashtu siç ngjet të shkasin ndonjëherë edhe disa të moshuar. Kur ngjet një aksident, nuk është e drejtë të thuhet se rinia jonë u korrup-

tua. Atë të ri apo të re që ka shkelur normat e moralit proletar ne do ta kritikojmë, që ky rast të bëhet mësim edhe për të tjerët, por të mos lejojmë që gabi mi i njërit të përdoret si armë nga ana e konservatorëve kundër rinisë në tërësi. Të metat t'i luftojmë me anë të edukimit të shëndoshë të njerëzve, por ky edukim nuk mund të kryhet me sukses në qoftë se kërkesat e njerëzve për ngritjen ideologjike të tyre nuk i kuptojmë në lidhje të ngushtë me periudhën që jetojmë. Prandaj përgjithësimet që bëhen dhe konkluzionet që arrihen duhet të lidhen patjetër me aktualitetin dhe rezultatet të mos krahasohen vetëm me kohët e shkuara, me moralin e kaluar që konserverët e quajnë gati si moral komunist. Kështu nuk dilet në rrugë të drejtë. Derisa shtrohet me të madhe që gruaja të dalë në punë, në jetë e në shoqëri, derisa i thuhet vajzës ta zgjedhë vetë burrin dhe të luftojë kundër atyre që duan ta luftojnë, duhet njuhur që në këtë proces ndryshimesh të gjera dhe pozitive që vërehen kudo, do të ngjasin aty-këtu edhe gabime, do të bëhen shkurorëzime, do të ndodhë edhe ndonjë fatkeqësi. Mund t'i thuhet vajzës të rrrijë me shokët dhe të mos ndiejë asnje simpati, ose dashuri për ndonjérin, të ndrydhë ndjenjat, duke i thënë indirekt se burrin do t'ia gjejë babai ose nëna? Çdo prind duhet ta këshillojë të bijën apo të birin që ta zgjedhë shokun ose shoqen e jetës me dashuri, po edhe me logjikë, që të jetë njeri i mirë, i ndershëm, patriot, të dojë popullin dhe Partinë etj. Në këtë rrugë duhet të ecim ne. Megjithatë, nuk do të thotë se në jetë s'mund të bëhen gabime, vetëm ne duhet

të përpinqemi që gabime të vërtetohen sa më pak dhe ato që ndodhin të riparohen në rrugën e drejtë të Partisë e jo sipas mendjes së mykur të disa kon-servatorëve.

Partia e ka theksuar kurdoherë se organizata e rinisë është masive. Po të thellohem i në kuptimin e kë-tij koncepti, do të dalim në përfundimin e drejtë që forumet janë të nevojshme. Sekretarët dhe anëtarët e këtyre forumeve janë të domosdoshëm, mbledhjet gjithashtu janë të nevojshme e të domosdoshme. Por forumet dhe njerëzit që i përbëjnë ato nuk duhet të kërkojnë nga rinia që t'u përshtatet disa formave organizative të ngurta, ose të detyrohen i riu dhe e reja që të marrin pjesë detyrimisht në të gjitha akti-vitetet, në çdo aksion, veprimitari dhe në çfarëdolloj mbledhjeje që organizohet. Në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet t'u japim mbledhjeve të rinisë forma burokratike dhe mungesën e tyre ta interpre-tojmë si një dobësim të organizatës së rinisë. Përkundrazi, burokratizmi e bën atë pa jetë, pa shpirt dhe amorfe. Varet pikërisht nga metoda e zhdërvje-llët e punës që rinia të jetë një organizatë masash e fortë, e çeliktë, e shkathët, revolucionare.

Të gjitha shfaqjet e huaja që ekzistojnë realisht, do ta dobësojnë organizatën e rinisë, në qoftë se nuk ngulim këmbë për luftimin dhe mënjanimin e tyre. Ky problem duhet kapur mirë dhe në kohë. Nuk duhet të vazhdohet me pikëpamjen e gabuar që mbledhja e organizatës së rinisë dhe e byrosë së saj qenka çdo gjë, ose të kërkohet aty një disiplinë formale, derisa të bëhet apeli dhe të tjera çështje të natyrës që për-

mende ti. Të gjitha këto çojnë në pikëpamjen e gabuar që po s'u bë kështu ose ashtu, nuk e kemi nën kontroll rininë nga rreziku i shthurjes. Ata që kanë shumë besim në format e gabuara organizative dhe sidomos në rregullat e ngurtë që vendosin, gjoja për të mbajtur në këmbë funksionimin e mirë të organizatës së rinisë, rrojnë me idenë e shtrembër se organizata ekziston vetëm nga këto forma e rregulla dhe jo nga pjesëmarrja e gjallë në të e të rejave dhe e të rinjve tanë të mrekullueshëm.

Organizata e rinisë dhe ajo e Partisë nuk duhet ta lënë pas dore punën edukative me rininë, ndryshe do të krijohen mundësi për të dalë mbi ujë disa elementë llafazanë që do të marrin në dorë drejtimin e aktiviteteve të rinisë e do të ndikojnë mbi rininë me pikëpamjet e qëndrimet e tyre të shtrembra. Po u lejua kjo gjendje, atëherë do të krijohet me të vërtetë një situatë e vështirë. Me sekretarët e organizatave-bazë dhe me drejtuesit e forumeve të rinisë duhet punuar që të kenë parasysh se në çdo mbledhje që bëjnë ata, të shtrohen, të diskutohen e të zgjidhen problemet kyç dhe më interesante që preokupojnë rininë në jetën e saj të përditshme. Shokët e forumeve duhet të jenë në gjendje për t'i zgjidhur mirë problemet e rinisë, në teori dhe në praktikë.

Të kihet, gjithashtu, parasysh se kur bëhet një mbledhje e organizatës së rinisë për një problem të caktuar, të mos kujtohet se çdo gjë u zgjidh me mbledhjen. Kuadrot, drejtuesit, sekretarët, pas mbledhjes, duhet të futen në masën e rinisë e të bisedojnë me të në mënyrë të çiltër si shoqe e shokë të tyre, si

punëtorë, kooperativistë, si studentë apo nxënës dhe jo vetëm si anëtarë të forumit, ose si sekretarë organizatash. Kështu i jepet mundësia drejtuesit të rinisë të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet edhe si sekretar, si anëtar i byrosë ose i komitetit, por edhe si shok. Duke qëndruar me përzemërsi afër shoqeve dhe shokëve të organizatës, ata njihen lirisht me zhvillimin e mendimit të të rinxve, pikërisht atje ku ata jetojnë, ku punojnë, studiojnë, ushqehen, dëfrejnë etj. Të frymëzuar nga vendimet e mbledhjes dhe nga aktivitete të tilla, të gjithë të rinxve u punon mendja dhe në-përmjet formave të ngrohta e interesante të marrëdhënieve shoqërore, ata ndihmohen për një diskutim të hapët dhe shumë të dobishëm për zgjidhjen e problemeve. Në qoftë se këto forma pune organizohen mirë e me kujdes, do të forcohet patjetër më shumë organizata e rinisë, e cila do të bëhet edhe më e dashur përmasën që bën pjesë në të. Edhe të rinxjtë do t'i vlerësojnë e do t'i duan më tepër forumet, sepse këta do të shikojnë që shoqet dhe shokët të cilët i kanë zgjedhur vetë përpiken me të vërtetë e lodhen shumë për ta. Mbledhjet që bëhen në formën e diskutimeve të hapëta dhe jo të imponuara e formale, janë tërheqëse dhe frytdhënëse.

Si mund t'i kuptojnë dhe t'i zgjidhin kërkuesat e problemet e rinisë drejtuesit e saj, në qoftë se nuk venë në gjirin e masës, në qoftë se nuk diskutojnë, ta zëmë, për çështjet e letërsisë tok me ata të rinx e të reja që interesohen për problemet letrare, qoftë në biseda të veçanta, apo në mbledhje ku grumbullohen vullnetarisht 30-40 veta. Gjatë debateve që bëhen në

këto raste, dalin në shesh edhe pikëpamjet e të rinjve për këtë ose atë çështje. Për këto probleme shërbejnë më mirë takime të tillë sesa mbledhjet që caktohen qysh më parë në bazë të një programi vjetor, sipas të cilit duhet të ngarkohet ky ose ai i ri për të bërë referatin. Kur vjen koha për të zhvilluar një mbledhje të tillë shpeshherë detyrohen të rinjtë të shkojnë pa përjashtim t'i dëgjojnë këto referate. Unë mendoj se nuk duhet vepruar në këtë mënyrë. Në një konvikt të universitetit, për shembull, ku flenë, punojnë, mësojnë, ushqehen dhe jetojnë studentët, kur një shok i përgatitur i rinisë ngarkohet të flasë për një roman, mund të ngjallet një diskutim shumë interesant. Me këtë rast mund të dalin mendime të shumta, të lindura qysh më parë ose edhe aty për aty gjatë diskutimit. Pasi të rriven mendimet, mund të vendoset që të bëhet edhe mbledhja e organizatës së rinisë, ku t'i bëhet ftesë autorit për t'iu përgjegjur pyetjeve të të rinjve për çështjet që u ngriten rrith romanit. Unë jam i bindur se në mbledhje të tillë do të vijnë plot të rinj e të reja. Diskutime të këtij lloji, pa i organizuar njeri, bëhen çdo ditë e çdo natë në shkolla nga nxënësit dhe studentët.

Ne duhet të mos kemi frikë aspak nga praktikimi i formave të tillë, vetëm të kemi kujdes që të ngjallim tek të rinjtë, sa të jetë e mundur më shumë diskutime të shëndosha. Me këtë nuk dua të them se midis shuni diskutimeve që zhvillohen nuk do të ketë edhe mendime të papjekura, as ne nuk mund të pretendojmë që tërë masa e rinisë të piqet para kohe dhe për çdo gjë të mendojë siç mendojmë ne. Por çështja është që të

mos ketë ngurtësi në trajtimin e problemeve si dhe njëfarë dyshimi e frike për ca gjëra, siç vërehet në disa raste, por të kihet më shumë besim te rinia e të mbahet më tepër përgjegjësi për të.

Shokët që punojnë me rininë, duhet t'i drejtojnë të rinjtë dhe të rejat në rrugën e Partisë me forma të përshtatshme, joburokratike, të pranuara prej saj pa imponim. Duhet të bëhen kurdoherë përpjekje për gjetjen e formave të atilla pune që të ngjallin interes, dëshirë dhe zell tek të rinjtë. Kjo është një punë që kërkon art, gjë që nuk mund ta bëjnë kurrë njerëzit me tendenca sektare dhe burokrate. Ne duhet të luftojmë që rinia t'i kundërshtojë format e punës jo të përshtatshme për të dhe qëndrimet jo të drejta ndaj saj. Në raste të tillë të rinjtë e të rejat mund të shfaqin edhe nervozizëm, bile ndonjëherë edhe papjekuri, por kjo duhet të kuptohet se rrjedh nga mosha e tyre e re dhe jo siç interpretohet nga konservatorët, se «rinia është e padisiplinuar», «s'ka respekt për të moshuarit» etj.

Të moshuarit dhe sidomos anëtarët e Partisë duhet t'i kuptojnë drejt kërkesat e rinisë, të mos i vënë asaj «barrikada». Ne nuk do të lejojmë në asnje mënyrë qëndrime ekstremiste me rininë. Do t'i lëmë ne të rinjtë t'i mbajnë flokët të gjatë në mënyrë të shëmtuar? Jo, po ama as do të lejojmë që t'i qethin me forcë, siç është vepruar në ndonjë shkollë. Asnjeli s'ka të drejtë të sillet keq me të rinjtë, ndaj tyre nuk duhet përdorur forca, por bindja e vazhdueshme për atë që duhet të bëjnë. Vajzat e djemtë duhet t'i lëmë të mbli-dhen në shtëpitë e njëri-tjetrit, të mos i pengojmë të

shkojnë te shoqet dhe shokët e tyre të shkollës nën pretekstin se «mos na ngjasin gjëra të papëlqyera». Ne nuk duhet të heqim dorë nga ajo për të cilën kemi luftuar, luftojmë e do të luftojmë akoma: nga lufta për emancipimin e plotë të gruas. Lufta e Partisë synon që në vendin tonë të lulëzojë morali proletar, por kjo dëshirë dhe ky synim i Partisë nuk kanë arritur dhe nuk mund të arrijnë në atë shkallë sa të mos ngjasinasnjëherë gjëra të papëlqyera. Për t'ia arritur kësaj duhen disa dekada, ndoshta edhe shekuj.

Ka rëndësi të madhe mënjanimi dhe largimi nga format burokratike të mbledhjeve, gjetja e formave të tillë të punës që ta frymëzojnë rininë të punojë, të shfaqë lirisht mendimet e saj dhe të diskutojë për të gjitha problemet, jo vetëm në organizatën-bazë, por edhe jashtë saj. Kur të realizohen këto kërkesa ne do të kemi arritur një fitore të madhe, sepse kështu rininë, anëtarët e ardhshëm të Partisë dhe popullin do t'i përgatitim që të kuptojnë ç'është mendimi i lirë komunist, ç'janë kritika, autokritika, disiplina proletare, mbledhjet, rregullat etj. Kështu ne e mësojmë rininë t'i zbatojë drejt në jetë direktivat e Partisë. Të edukuar në këtë frymë, të rinjtë dhe të rejat, kur të shkojnë në mbledhjet e organizatës, të aktivit të bashkimeve profesionale, ose të skuadrës së kooperativës, me vrullin e tyre, do t'i gjallërojnë e do t'i bëjnë më shumë luftarakë këta organizma. Kurrë te të rinjtë e të rejat të mos futet mendimi që po nuk vajtën në mbledhje do të konsiderohen të padisiplinuar, kundër vijës së Partisë, do të konsiderohen si njerëz që nuk kanë respekt për udhëheqjen, por të punohet që ata të binden vetë

e të çmojnë se pjesëmarrja në mbledhjet është e nevojshme për ta. Mbledhjet kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë edhe në të ardhmen, se pa to nuk mund të shkojë mirë puna, por mbledhje të tepruara dhe jo të përgatitura mirë nuk duhen bërë.

Unë u kam rekomanduar shokëve që Radio Tirana të transmetojë herë pas here muzikë vallëzimi, si dhe pjesë të kompozitorëve të huaj të dëgjuar e përparimtarë që i pëlqen rinia. Ne nuk mund të kufizohemi duke transmetuar për rininë vetëm nga këngët, meloditë dhe vallet tona popullore, ndryshe ajo do të përpinqet të gjejë vetë edhe do të dëgjojë muzikën e huaj. Nesër televizioni ynë do të përhapet në masë, por emisione do të japid njëkohësisht edhe televizonet e huaja afér territorit të vendit tonë, prandaj radiotelevizioni shqiptar duhet të përgatitë programe të studiuara mirë që të pëlqehen nga punonjësit dhe nga rinia jonë. Të rinxjtë dhe masat e popullit dëshirojnë në masë të gjerë të shohin filma muzikorë, shkencorë, historikë etj. Ata do të kërkojnë edhe filma që tregojnë për jetën dhe zhvillimin e popujve të Afrikës, të Azisë, të Amerikës Latine etj. Filma të tillë nuk i prodhon kinostudioja jonë, por i prodhojnë dhe i përhapin mëjetet e tyre institucionet borgjeze. Në filma të këtillë, krahas pallateve të mëdha e luksoze të klasave shfrytëzuese, shikohet edhe mizerja e masave popullore. Por të rinxjve t'u bëhet e qartë se këto pallate dhe pasuri janë ndërtuar me duart dhe me djersën e popullit të thjeshtë, megjithëse ai nuk i gjëzon ato vetë. Edhe në këto raste mund të nxirret diçka pozitive, por në to ka edhe shumë helme kundër të cilave ne duhet ta or-

ganizojmë mirë propagandën tonë, me qëllim që të rintjtë tanë të bëhen të aftë dhe ta kuptojnë konkretisht dëmin e helmit borgjez që përhapin me mjetet e tyre të propagandës kapitalistët e revisionistët, ndryshe, kur t'u qëllojë rasti të ndeshen vetëm për vetëm, nuk do të dinë të mbrohen prej tij dhe atëherë ne nuk do t'ia dalim në krye detyrës për një edukim të shëndoshë të rinisë sonë dhe mund të na vërtetohen ngjarje të papëlqyera.

Të ndrydhësh të rintjtë dhc të përpinqesh t'u imponosh atyre mendime e veprime, siç mendojnë konservatorët, është diçka që nuk përputhet me vijën e Partisë. Ne duhet të punojmë për t'i përgatitur njerëzit tanë që të mendojnë drejt, kurdoherë në rrugën marksiste-leniniste, me qëllim që, kur të vijnë vetë në kontakt me mjetet që përhapin ideologjinë dhe mënyrën e jetesës borgjeze e revisioniste, të jenë në gjendje të dallojnë shapin nga sheperi, ç'është e mirë e ç'është e keqe. Njerëzit që janë me të vërtetë të formuar politikisht dhe ideologjikisht nuk lëkunden para çfarëdo gjëje që shikojnë, dëgjojnë ose lexojnë. Prandaj unë nuk e kuptoj përsë jepen disa urdhra pa kuptim që për të térhequr për lexim një roman, ta zëmë të Dostojevskit, nga biblioteka e universitetit, duhet të jepet leje e posaçme. Dhe veprokan kështu gjoja për të frenuar depërtimin e ideologjisë së huaj! Atëherë, përsë vihen librat në indeks e mbyllen në hekura? Që të mos i këndojnë pedagogët dhe studentët? Ky është një sektařizëm dhe burokratizëm trashanik! Në nuk i shumëfishojmë vetë të tillë libra, por nga 10-15 kopje për nevoja studimi i mbajmë në bibliotekat tona. Edhe

shkrimtarë të tjerë të kësaj natyre mund të lexohen, me qëllim që nga studimi i tyre të shikohen ç'janë këta dhe të nxirren konkluzione se çfarë interesash përfaqësojnë. Në qoftë se dikush nuk është i zoti të nxjerrë përfundime të drejta nga një libër, le të pyesë dikë tjetër, sepse të tërë mësojmë nga njëri-tjetri, që të dimë kështu si të armatosemi kundër teorive që predikojnë këta ose ata autorë. Ç'kuptim ka të jetë tjetri filozof dhe të mos i jepet mundësia të lexojë filozofët e rrymave të ndryshme për t'iu kundërvënë si duhet pikëpamjeve të tyre reaksionare? Mund të studiosh, për shembull, për filozofinë e Markuzesë, por ama duhet kuptuar që ky është anarkist dhe kjo do të dalë qartë nëpërmjet studimit të mendimeve të tij dhe jo pse themi ne. Prandaj njerëzit e interesuar duhet të lexojnë librat përkatës, të konsultohen me shokët më të aftë e më të ngritur, të diskutojnë e të rrahin pikëpamje. Ne, pra, nuk duhet të censurojmë librat e autorëve të huaj etj., etj., por të forcojmë punën ideo-politike me njerëzit tanë, pse kështu do të mund t'i edukojmë dhe t'i mbrojmë ata nga ndikimet borgjezo-revizioniste.

Kështu mund të themi edhe për filmat e huaj që duhen parë nga të rinjtë. Ne nuk mund të shkëputemi nga bota e jashtme, do të shfaqim edhe filma të huaj, sigurisht sa të jetë e mundur më pak të dëmshëm, që janë më pak të molepsur me ide reaksionare, por nuk duhet të pretendojmë që ata të janë krejt të kulluar dhe sipas ideologjisë sonë. Kjo do të ishte e pamundur, pse çdo film i huaj, natyrisht, në masa të ndryshme do të pasqyrojë tendencat ideopolitike të kohës dhe të

vendit ku prodhohet, prandaj dhe duhet parë me sy kritik e në frymën e Partisë.

As shkenca e madhe botërore nuk është e kulluar, edhe në të ka gjithfarë orientimesh politike dhe ideologjike. Për t'i kualifikuar në këtë drejtim njerëzit tanë do t'i dërgojmë edhe jashtë shtetit, bile në të ardhmen kjo punë do të zgjerohet akoma më shumë. Në qoftë se do t'i mbajmë të mbyllur, nuk do t'i vëmë në kontakt me botën e jashtme, ata do të gabojnë më tepër. Por, në dërgimin e njerëzve tanë për kualifikim jashtë shtetit është e domosdoshme të zbatohen kriterë të drejta partie. Të nisësh ndonjërin për të studiuar disa dokumente historike vetëm se ai ka teserën e Partisë në xhep, ndërsa nuk di asnjë gjuhë të huaj, apo nuk merret fare me historinë, është shumë gabim, pse jo vetëm që do të bëjë atje figurë të keqe, por nuk do t'i arrihet as qëllimit për të cilin e dërgon. Me njerëz që nuk kanë shumë haber nga zhvillimi i shkencës botërore, nuk mund të zhvillohet shkenca jonë. Ne duhet të dimë se borgjezi shovinist, që çdo gjë të tij e konsideron mbi të tjerët, kur të shohë njerëzit tanë se nuk e dinë gjuhën e vendit ku kanë shkuar, do të thotë: këta nuk paskan haber, prandaj të kthehen më mirë nga kanë ardhur.

Të punojmë, pra, që njerëzit, sidomos të rinjtë, t'i përgatitim me kujdes, sepse situatat janë të tillë që nuk mund të mbyllemi në guaskën tonë. Në ndërtimin e punës për edukimin e rinisë ne duhet të përdorim të gjitha format, duke përjashtuar ato që janë burokratike. Të bëhen përpjekje për të gjetur forma pune e aktiviteti që t'u hapin të rinjve horizonte të reja, t'i paji-

sin ata me ide dhe mendime që kanë përmbajtje të shëndoshë. Përmbajtja e punës me rininë ka rëndësi të madhe, pavarësisht nga vendi ku praktikohen format që përdoren në shkollë, në qendër pune, në kooperativa bujqësore etj. Për ne ka vlerë që në takime, biseda, mbledhje etj., etj., të diskutohen ato probleme me rëndësi që u interesojnë të rinjve.

Duhet të marrë fund sidomos angazhimi i rinisë në disa aktivitete të imponuara. Kjo u duhet bërë mirë e qartë të gjithëve, se një e metë e tillë e ka burimin jo në bazë, po këtu lart, prandaj asaj duhet t'i jepet fund. Le të marrim për shembull çështjen e zhvillimit masiv të lëvizjes artistike. Përse duhet të marrë pjesë medoemos e gjithë rinia në këtë lëvizje dhe të futen të tërë të rinjtë, ta zëmë, të një ndërmarrjeje në kor? Kjo nuk është aspak e drejtë dhe e rregullt. Në kor duhet të marrin pjesë ata të rinj e të reja që kanë dëshirë, që ndiejnë kënaqësi kur këndojnë e kanë zë të bukur. Por edhe një që vete në kor, ku qëndron një ose dy vjet, më vonë mund të mos ketë dëshirë të marrë pjesë, sepse dëshiron të futet, ta zëmë, në skuadrën e futbollit ose do që të ndjekë ndonjë aktivitet tjeter. Për këtë atij nuk duhet t'i sillet asnje pëngesë dhe këtu s'ka asgjë të keqe. Format masive të punës lypset t'i kuptojmë drejt, masivitet do të thotë pjesëmarrje e shumë njerëzve në një aktivitet, por ama të dëshiruar prej tyre dhe jo të imponuar nga di-kush. Në këtë mënyrë disa futen në kor, disa në balet, të tjerë në teatër, disa në sport e kështu me radhë. Ne nuk duhet t'u presim rrugën formave të lira të pje-

sëmarrjes në aktivitetet e ndryshme që organizohen, të zhdukim çdo imponim në këtë punë.

Për arsyet që thashë, çështjet që ngritët më duken të drejta dhe duhet t'i shikojmë. Predispozicioni i rinisë sonë për të zbatuar detyrat që asaj i ka ngarkuar Partia, është i madh, por prapë në punën me të duhet të kemi kujdes. Janë me të vërtetë gjëra fare të vogla ato që kërkojnë të rinxjtë dhe nxënësit, si bie fjala ndonjë top futbolli, shtëpi për pionierët etj. Këto sigurisht nuk janë probleme preokupante, por mosplotësimi i tyre tregon se disa shokë të Partisë nuk i kuptojnë mirë kërkesat e rinisë dhe nga kjo anë ne ndeshemi në vështirësi.

Mua më duket se nuk ka rëndësi për mbarëvajtjen e organizatës së rinisë fakti që në shumë shkolla ka vetëm tre-katër komunistë, sepse këta po e kuptuan mirë dhe drejt rininë mund të frenojnë fare mirë disa gjeste të pahijshme dhe trajtime të pakujdeshme që bëhen ndaj vajzave dhe djemve. Por e keqja është se ata komunistë që bëjnë jetën e Partisë në organizatat-bazë të Partisë në shkolla nuk e kuptojnë në gjerësi dhe në thellësi vijën e Partisë, paraqiten në rregull vetëm në sipërfaqe, nga ana formale e problemit, por nuk hyjnë thellë në brendinë e ndjenjave dhe të pikëpamjeve të të rinxve, u vënë pak rëndësi këtyre gjërave, ose disa as që çajnë kokën fare çfarë mendon i riu apo e reja.

Ka gjëra siç është rrënjosja e ndjenjës së disiplinës, për të cilat duhet punuar që t'i bëhen edukatë rinisë nëpërmjet një pune bindëse të vazhdueshme, por

ka edhe gjëra të vogla që nuk duhen bërë problem, siç është rasti kur ndonjëri shtyn tjetrin, bën zhurmë etj. Të tërë kemi qenë të rinj, e kemi kaluar atë moshë, prandaj në raste të tillë s'ka përse të kërcënohen të rinjtë, duke u thënë «Ta tregoj unë qejfin në mbledhjen e organizatës». Është lehtë të merret një masë disiplinore kundër ndonjë të riu, por nuk është ky ilaci që kërkohet, çështja është që të derdhet djersë për ta bindur atë që të kuptoje në mënyrë të ndërgjegjshme gabimin që ka kryer dhe të bëjë autokritikë. Kjo është një punë e lodhshme, por më e dobishme sesa të përdorësh në çdo rast dhe për çdo gjë forma të ngurta dhe masa disiplinore. Kur një i ri, ose kushdo qoftë tjetër bën një gabim, të mendojmë shumë se edhe ai ndien një shqetësim të madh në botën e tij të brendshme, të mos shikojmë vetëm anën që ai vërtet bëri faj, duke i rënë shokut me grusht dhe për këtë duhet ta dënojmë patjetër, pavarësisht edhe nga pendimi i thellë dhe i singertë që mund të ketë ndier. Në këtë drejtim lypset një punë e vazhdueshme edukative me kuadrot dhe sidomos me të rinjtë.

Unë mendoj se më shumë gabime në trajtimin e të rinjve kanë kuadrot, sesa vetë disa të rinj që gabojnë. Me këtë nuk dua të them se në radhët e rinisë nuk ka nga ata që me qëndrimin e sjelljet e tyre e teprojnë, por nuk mund të jenë dhe nuk janë të tillë të tërç. Në qoftë se veprojmë me takt dhe përdorim forma të përshtatshme pune ndaj tyre, do të jemi në gjendje ta mësojmë rininë se si ta shikojë objektivisht drejtësinë, zgjidhjen e problemeve, përkrahjen dhe da-

shurinë që ushqejnë për të Partia, udhëheqja e saj dhe organizatat e masave. Në këtë rrugë të rinjtë me siguri do të bëjnë më pak gabime.

Duhet parë në praktikë çështja që rinia të mos rëndohet me shumë mbledhje dhe të ngarkohet me shumë detyra. Kjo varet nga udhëheqja e rinisë. Kur lind nevoja të flitet për një problem, për shembull, për cilësinë e prodhimit në fabrikë dhe kur çështja shtrohet në mbledhjen e bashkimeve profesionale ku merr pjesë edhe rinia punëtore, atëherë s'ka përse të shtrohet e njëjtë gjë edhe në mbledhjen e organizatës së rinisë. Kur shtrohet, ta zëmë, problemi për çështjen e forcimit të disiplinës proletare në punë, ose problemi i edukimit komunist, këto, për natyrën e tyre, mund të diskutohen edhe në organizatën e bashkimeve profesionale, edhe në atë të rinisë, por, meqenëse shumica e punëtorëve janë të rindërtuar, çështjet që përmenda mund t'i shqyrtojë rinia, në mbledhjen e së cilës mund të ftohen edhe disa nga anëtarët e organizatës së bashkimeve profesionale për ta diskutuar bashkërisht problemin.

Kur është për t'u diskutuar një problem që u përket kryesisht grave, përse të shtrohet ky problem edhe në organizatën e rinisë? Unë them që, në një rast të tillë, të rejt mund të shkojnë në mbledhjen e organizatës së gruas, ku të dëgjojnë e të diskutojnë, pastaj të zbatojnë detyrat që u përkasin si të reja.

Mbledhjet është mirë të bëhen sipas nevojave që dalin dhe sipas sektorit të punës. Mbledhja me gjithë anëtarët e organizatës së rinisë mund të bëhet kur është fjala për direktivat e përgjithshme, ose për zbatimin e detyrave. Në qoftë se lind nevoja të bëhet një

mbledhje për një problem që ka lidhje me brigadën e arave dhe me atë të foragjereve, atëherë të mblidhen vetëm të rintjtë e këtyre dy brigadave, të diskutojnë për problemin që ka dalë dhe të nxjerrin detyrat e përbashkëta. Të rintjtë e brigadave të tjera nuk ka përsë të marrin pjesë në një mbledhje që bëhet për një çështje që nuk ka lidhje me punën e tyre.

Ne nuk po shkëputemi dot akoma nga formalizmi, duke kujtuar që po nuk u bë mbledhje me të gjithë të rintjtë e organizatës, ajo nuk konsiderohet si punë. Prandaj të heqim dorë nga mbledhjet pa bereqet e me shumë llafe pasi ato janë formale dhe asgjë nuk të japid, përkundrazi pjesëmarrësit që mërziten prej tyre hezitojnë të diskutojnë dhe presin që të mbarojë mbledhja sa më parë.

Unë jam dakord me çështjet që shtrove dhe do të gjej ndonjë rast për të folur pak më gjërë për këto probleme. Jeta shtron shumë çështje për të cilat udhëheqja mund të nxjerrë mjaft konkluzione, të lëshojë direktiva të shëndosha për punën me rininë.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Raporte e fjalime 1970-
-1971», Tiranë, 1972, f. 281*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime
1970-1971», Tiranë, 1972,
f. 281*

TAKTIKAT T'I SHËRBEJNË STRATEGJISË REVOLUCIONARE

Nga biseda me delegacionin e punëtorëve kinezë

30 prill 1971

Pasi shoku Enver Hoxha u uroi mirëseardhjen, kryetari i delegacionit kinez përshëndeti në emër të shokëve. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Ju falënderojmë për fjalët miqësore dhe të ngrohta që shprehni për Partinë dhe për popullin tonë, të cilat na inkurajojnë shumë.

Ne dëshirojmë që vizitat e shokëve dhe të shoqeve kinezë në vendin tonë të jenë të shpeshta e të vazhdueshme. Të tilla vizita shërbejnë jo vetëm për forcimin e miqësisë, por edhe për shkëmbimin e eksperiençës, të cilën e konsiderojmë një ndihmë të çmuershme për popujt tanë.

Dy vendet tona janë larg gjeografikisht, por ne vazhdimisht ndjekim përpjekjet që bëni ju në punën tuaj, sakrificat e klasës punëtore e të popullit kinez që kanë sjellë suksese në industri, në bujqësi, në arsim e kulturë në të gjithë vendin tuaj.

Dihet fare mirë se ç'ndryshim të madh ka po-

litika e një vendi socialist nga ajo e një vendi kapitalist. Një vend socialist, sado i fuqishëm qoftë, nuk mund të jetë superfuqi, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo Bashkimi Sovjetik revizionist, sepse nuk udhëhiqet nga parimet shtypëse e kolonialiste të këtyre dy superfuqive, të cilat në pamje duken sikur janë fuqi të tmerrshme, por në fakt shkojnë drejt shkatërrimit të tyre.

Partia jonë e ka thënë kurdoherë dhe e përsërit se veprimet e qëndrimet e drejta marksiste-leniniste ndihmojnë që të realizohen ëndrrat dhe aspiratat e njerëzimit përparimtar.

C'po ngjet tani në botë? Kapitalizmi dhe revizionizmi, sipas pikëpamjes sonë, janë në krizë të thellë, për arsy se popujt e botës janë hedhur në revolucion. Në ballë të këtij revolucioni të madh botëror qëndron proletariati me partitë marksiste-leniniste në krye. Aktualisht në botën josocialiste, në radhët e imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, në radhët e revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, dhe në të gjitha shtetet ku sundon borgjezia kapitaliste, ekzistojnë dhe po zhvillohen njëra pas tjetrës kriza politike, ekonomike, ushtarake, ideologjike etj.

Politika reaksionare e shteteve kapitaliste e revizioniste është bërë e qartë prej kohësh për popujt. Aleanca sovjeto-amerikane është zhvilluar me ritme të shpejta, lufta në Vietnam ka ardhur vazhdimishit duke u ashpërsuar. Të qarta janë bërë për këdo, gjithashtu, dredhitë dhe intrigat e pareshtura që kurdisin në kurriz të popujve imperialistët amerikanë e revisionistët sovjetikë.

Populli ynë ka një fjalë të urtë sipas së cilës «armiku kur nuk ta kafshon dot dorën, ta puth». Edhe imperialistët, revizionistët, kapitalistët, kudo në botë, si e panë që nuk u dolën planet për ta mposhtur Kinën me forcë dhe nëpërmjet agjenturës së Liu Shao Çisë, u detyruan të rishikojnë qëndrimet politike ndaj saj, jo nga malli, jo se duan, por se janë të detyruar. Aleatët e imperializmit amerikan, të inkuadruar në NATO, SEATO etj., etj., kanë filluar t'i buzëqeshin Republikës Popullore të Kinës, kërkojnë të kenë të tërë lidhje diplomatike dhe të bëjnë edhe tregti me të, se i griu kapitali amerikan dhe duan të marrin një çikë frymë. Këtë dje ata nuk e bënin, ndërsa sot luten.

Nga gjithë këto ngjarje ne nxjerrim konkluzionin se imperializmi amerikan sot nuk mund t'i mbajë fort si më parë rrëth vetes dhe t'i hedhë kundër vendit tuaj aleatët e tij. Këta aleatë duan të dobësojnë hallkat e zinxhirit imperialist amerikan që u ka lidhur duar e këmbë. Kjo e dobëson politikisht imperializmin amerikan, dobëson bashkë me të edhe grupimin e forcate që ka organizuar ai kundër Kinës për arsyet që thashë më lart.

Dalja aktive e Kinës në arenën ndërkombëtare dhe zhvillimi nga ana e saj i një politike të jashtme jo të mbyllur, kanë rëndësi të madhe për çështjen e revolucionit dhe të popujve. Kuptohet që dobësimi e shpartallimi i armiqve imperialisto-revizionistë, natyrisht, nuk mund të arrihet në një vit. Për këtë qëllim përdoren taktika të ndryshme, që është e domosdoshme të jenë në përputhje me parimet marksiste-leniniste.

Një grup pingpongistësh amerikanë bëri ca kohë më parë një vizitë në Kinë. Agjencitë e lajmeve të shteteve kapitaliste kanë filluar të flasin andej e këtej përditë për këtë ngjarje. Kjo tregon për efektin që ka bërë në kampin imperialist ky gjest politik që lidhet me marrëdhëniet e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat tanë po ndryshojnë qëndrim në përputhje me situatat që janë krijuar në vendin tuaj¹. Këto veprime të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj Kinës bëjnë që marrëdhëniet e tyre me sovjetikët të mos jenë më si përpara.

Ne shohim, gjithashtu, se edhe revizionistëve sovjetikë u ka hyrë paniku. Këta janë në panik dhe u ka hyrë frika për dy arsyen: së pari, kanë frikën e demaskimit si pseudoleninistë dhe pseudomarksistë që janë, kanë frikë nga lufta parimore e partive marksiste-leniniste që i demaskon çdo ditë, kanë frikë nga përhapja e ideve të marksizëm-leninizmit. Së dyti, sepse politika parimore që ndjekim ne, dobëson sundimin e tyre në botë, aleancën amerikano-sovjetike, duke acaruar çdo ditë e më shumë kontradiktat në mes imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë. Mirëpo kur dy zihen, dhe thellimi i kontradiktave do të bëjë që këta armiq të betuar të po-

1. Në Ditarin Politik për Çështje Ndërkombëtare shoku Enver Hoxha shkruan: «Ne mendojmë se ardhja e pingpongistëve nuk është një gjë e rastit. Ardhja e pingpongistëve nuk ka pasur për qëllim «lidhjet me popullin amerikan», por, përkundrazi, ka qenë një pretekst për të rivendosur lidhjet e shkëputura dhe për të vënë në jetë ujditë e arritura». (Shih: Enver Hoxha, «Shënimë për Kinën», vell. 1, f. 543.)

pujve të zihen çdo ditë e më shumë, i treti fiton, — thotë një fjalë e urtë, — dhe ai që do të fitojë, do të jemi ne, do të jetë marksizëm-leninizmi. Ne do të përpinqemi që kontradiktat ndërmjet imperialistëve dhe revisionistëve sovjetikë të shtohen sa më tepër. Marksistë-leninistët duhet t'i drejtojnë ngjarjet politike në botë në favorin e tyre dhe për këtë mbështeten gjithmonë në forcën e pamposhtur të doktrinës sonë.

Në këto kushte revisionistët sovjetikë i kanë ngri-
tur dhe do t'i ngrenë gjithnjë e më shumë boritë e propagandës së tyre kundër vendeve tona. Ka edhe revisionistë të tjerë, të tipit Tito apo Çaushesku, që mendojnë ndryshe. Ata deklarojnë se politika e Kinës është e mirë, por këtë nuk e gjykojnë nga pozitat tona marksiste, por nga pozitat e tyre revisioniste. Titoja dhe Çaushesku deklarojnë që Kina është në luftë me revisionistët sovjetikë, se kundër këtyre, kundër hru-
shovianëve të Moskës, qenkan edhe ata të dy, prandaj, siç thonë ata, u puqkan me kinezët. Ndërsa hiqen si-
kur janë marksistë, ata, nga ana tjetër, puthen edhe me imperialistët amerikanë, anglezë, francezë, gjermanë etj. Ata bëjnë deklarata se politika e Kinës është shumë e drejtë dhe e aprovojnë plotësisht, por në fakt ata aprovojnë, në të njëjtën kohë, edhe politikën agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Izraelit etj.

Revisionistët si Titoja, Çaushesku e të tjerë i shikojnë këto çështje nga pozitat e tyre, por ne i kup-
tojmë, i njohim mirë ç'janë, prandaj edhe ndaj tyre duhet të ndjekim një taktikë të qartë e të mbajmë një qëndrim të vendosur.

Armiqtë e socializmit janë në çdo drejtim në panik politik, ideologjik dhe ushtarak. Lufta në Vietnam dhe në të gjithë Indokinën shkon vazhdimesht përpëra, në favor të popujve të këtyre vendeve. Kjo është një provë e madhe që tregon se forca dhe ndikimi i marksizëm-leninizmit, i revolucionit, përhapja e ideve tona marksiste-leniniste shkon dhe do të shkojë gjithmonë përpëra. Besimi ynë është i patundur në fitoren e pashmangshme të marksizëm-leninizmit dhe të politikës sonë parimore në botë. Në rrugën e kësaj politike ne duhet të ecim të bashkuar, për të luftuar me radhë të shtrënguara në të dy krahët, si kundër imperializmit, ashtu edhe kundër revisionizmit, duke qenë njëkohësisht shumë vigjilentë ndaj armiqve të brendshëm.

Politika jonë duhet të jetë kurdoherë parimore, e shkathët, revolucionare, sepse kështu do të jemi kurdoherë të sigurt se armiqtë do t'i mundim. Objektivi ynë është që t'i dobësojmë gradualisht ata gjersa t'i shkatërrojmë. Për të arritur këtë objektiv duhet të jemi të fortë, të mobilizuar, të përgatitur, në mënyrë që në qoftë se armiqtë do të bëjnë marrëzi, atëherë t'i shkatërrojmë.

Populli ynë, duke pasur të qarta këto orientime, këtë vijë, punon me të gjitha fuqitë për forcimin e republikës ekonomikisht, politikisht, ideologjikisht, për zhvillimin e arsimit e të kulturës, për kalitjen e Partisë në rrugë revolucionare, për kalitjen e unitetit të radhëve të saj dhe të unitetit të masave të popullit me Partinë, si dhe për forcimin e ushtrisë sonë.

Partia jonë zhvillon një politikë të jashtme kon-

sekuente, tërësisht në shërbim të strategjisë së saj. Natyrisht, taktikat, duke marrë parasysh kushtet, vëçoritë e këtij apo atij vendi, si dhe kohën kur ato përdoren, mund të jenë të ndryshme, por ato përherë duhet të jenë parimore dhe t'i shërbejnë së njëjtës strategji revolucionare. Në këtë drejtim ne zhvillojmë taktikat tona marksiste-leniniste që e ndihmojnë zhvilimin e revolucionit dhe demaskojnë njëkohësisht armiqtë imperialistë dhe revisionistë.

Qëndrimi i Partisë dhe i shtetit tonë është i patundur, konsekuent e parimor. Ky qëndrim bëri që qeveria greke të kërkojë vetë të lidhë marrëdhënie diplomatike me ne. Kjo është një fitore diplomatike për ne dhe një faktor që i shërben forcimit të miqësisë së popullit shqiptar e popullit grek.

Tani ne po punojmë me vrull për hartimin e planit të ri pesëvjeçar, gjë që shpresojmë ta përfundojmë, brenda disa muajve, dhe ta paraqesim për aprovim në Kongresin e 6-të të Partisë. Planin e vitit të parë të pesëvjeçarit të pestë e kemi filluar shumë mirë. Klasa jonë punëtore është në ballë dhe po i realizon detyrat me sukses. Kooperativistët gjithashtu janë hedhur në luftë për realizimin e detyrave. Gruri këtë vit përgjithësisht paraqitet mirë. Në rast se nuk ndodh ndonjë pengesë natyrore, ne mendojmë të mbarojmë mbjelljet e pranverës në kohën optimale, brenda javës së parë të muajit maj, pasi për këtë janë marrë të gjitha masat.

Ju duhet të qëndroni ca kohë në vendin tonë, që të shikoni Shqipërinë. Ne dëshirojmë të shkoni nga të katër anët, të shikoni vendin tonë, të merrni kontakt

me të gjithë, me punëtorë, me fshatarë, ta ndieni veten si në shtëpinë tuaj.

Pas kësaj, kryetari i delegacionit të punëtorëve kinezë i shprehu shokut Enver Hoxha falënderimet e përzemërta për pritjen dhe bisedën e ngrohtë që u zhvillua në këtë takim.

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimave të mbajtura në
këtë takim, që gjenden në
AQP*

VULLNETIN E NJË POPULLI TË BASHKUAR DHE TË VENDOSUR NUK E MPOSHT DOT AS ARMA MË MODERNE

*Nga biseda me delegacionet e huaja që morën
pjesë në festimet e 1 Majit*

6 maj 1971

Të dashur shokë dhe shoqe, të dashur miq,

Ju përshëndes nga zemra dhe ju falënderoj përmirësinë që patët duke ardhur në atdheun tonë socialist përmë të festuar dhe përmë të gjuar së toku me neditën e madhe të përbashkët të proletariatit botëror, festën ndërkombëtare të punonjësve, 1 Majin. Populli shqiptar dhe çdo popull tjetër në botë nuk mund të rrojë pa dashurinë e pa solidaritetin e popujve të tjerë, pa eksperiencën, pa ndjenjat dhe pa përkrahjen e tyre internacionaliste proletare. Këto ndjenja përbëjnë përtak një forcë kolosale që nuk mund të mposhtet nga askush. Ne jemi të bindur se do të vijë koha që popujt, në unitet të çeliktë midis tyre, t'i këputin të gjithë njëri pas tjetrit zinxhirët e robërisë kapitaliste. Populli shqiptar i do singerisht dhe lë kokën

për miqtë, siç themi ne shqiptarët, kurse armiqtë i urren për vdekje dhe i lufton, prandaj, gjatë gjithë historisë së tij, ai jo vetëm që nuk është përulur, por kurdoherë ka luftuar me armiqtë dhe ka fituar.

Kur ne, shokë e vëllezër, themi se forca e popullit tonë është e pathyeshme, kjo nuk është një parullë pa baza, por këtë e themi se i tillë është realiteti sot në vendin tonë. Popujt e botës janë solidarë dhe e ndihmojnë popullin shqiptar në rrugën e tij të drejtë dhe është e qartë se vullnetin jo vetëm të të gjithë popujve, por edhe të një populli të vetëm, kur ai është i bashkuar dhe i vendosur, nuk e mposht dot as arma më moderne. Pse e them këtë? Sepse kur ne filluam luttën kundër pushtuesve italo-gjermanë, nuk kemi pasur as topa, as mitraloza, bile as pushkë. Në fillim kishim vetëm disa kobure të vjetra, megjithatë rrëmbyem ato armë të pakta që kishim dhe dolëm malit, u futëm në luftë me besim në fitore, se na vlonë gjaku përliri. Duhej çliruar atdheu, sepse të robëruar dhe më turp nuk mund të jetonim, prandaj si çliruam zonat fshatare, sulmuam edhe qytetet dhe e shporrëm armikun nga i gjithë vendi.

Nuk mund të fitohet mbi armiqtë e egër e të fuqishëm, imperialistët, socialimperialistët dhe gjithë reaksionarët, pa luftuar, sepse ata nuk e lëshojnë dhe asnjëherë nuk do ta lëshojnë vullnetarisht pushtetin. Të tëra teoritë e armiqve për këtë çështje janë vetëm për t'u hedhur njerëzve hi syve. Populli shqiptar i ka mposhtur armiqtë, sepse në radhë të parë ka luftuar vetë, por edhe sepse ka pasur përkrahjen dhe ndihmën vëllazërore të popujve të tjerë. Këtë ndihmë po-

pulli ynë e ka ndier në shekuj, ashtu siç ka ndier edhe robërinë e rëndë të pushtuesve. Por edhe populli shqiptar ka qenë solidar ndaj gjithë popujve të tjerë dhe jo vetëm ndaj atyre që e kanë ndihmuar. Ai e ka dalluar popullin nga klasat sunduese, prandaj edhe kur i ka mposhtur dhe i ka mundur armiqjtë e vet, ka ditur të bëjë diferencimin e njerëzve të popullit që kanë gabuar dhe janë çuar prej tyre si mish për top, nga kriminelët fashistë dhe agjentët e imperialistëve që e kanë sulmuar me tërbim. Kështu ka ngjarë edhe në luftërat e mëparshme, edhe në ato të tashmet.

Populli ynë i vogël e ndien dhe e vlerëson jashtë-zakonisht luftën për liri e pavarësi që bëjnë popujt vëllezër, si ata që janë çliruar dhe luftojnë për t'i ruajtur e për t'i konsoliduar fitoret e arritura, ashtu edhe ata që vazhdojnë të luftojnë akoma për çlirimin e tyre, sepse e çmon shumë lirinë e vet, që e ka fituar me gjak e sakrifica të panumërtë. Partia dhe pushteti ynë kanë ndjekur dhe do të ndjekin kurdoherë një politikë të drejtë, që konsiston në konsolidimin e fitoreve brenda vendit, në vazhdimin e luftës kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, kundër rezisionizmit, me atë sovjetik në krye, dhe kundër gjithë kapitalistëve e reaksionarëve të tjerë, me qëllim që këta të dobësohen dita-ditës, dhe në përkrahjen pa rezerva të luftës revolucionare dhe çlirimitare të popujve. Ne jemi pro me të gjithë popujt e botës, si me ata që kanë rrokur drejtpërsëdrejti armët, ashtu edhe me ata që luftojnë me gjithfarë mënyrash për të shpartalluar robërinë kapitaliste. Partia na mëson të mos i ndahemi kësaj vije, sepse atëherë vendi ynë

socialist do të gjendej i izoluar dhe, siç thotë populli ynë, «po u ndave nga kopeja, të hëngri ujku», kurse të bashkuar popujt janë të pathyeshëm, sepse, kur radhët e tyre janë të ngjeshura, forca është kolosale.

Ju e keni të qartë se çfarë fqinjësh kemi rreth e rrotull kufijve të vendit tonë. Sidoqoftë, me ta ne ndjekim politikën leniniste të bashkekzistencës dhe jo të bashkekzistencës paqësore që predikonte Hrushovi me pasuesit e tij, që tradhtuan socializmin dhe shitën interesat e popujve të tyre e të popujve të tjerë te borgjezia imperialiste. Këtë ne nuk e bëjmë, por marrëdhënie diplomatike e tregtarë mbajmë me shtetet që na rrethojnë, kurse gojën nuk e mbyllim. Ne mbrojmë me vendosmëri, si kurdoherë, interesat e atdheut e të popullit, parimet e marksizëm-leninizmit dhe demaskojmë pa druajtje revizionizmin, vetadiministrimin kapitalist-titist e fashizmin. Kështu veprojmë ne, e tillë është politika e Partisë sonë.

Ndaj revisionistëve, ndaj imperialistëve dhe kërkosave të paligjshme të kujtdo, kurrë nuk duhet bërë lëshim, parimet duhen mbrojtur me vendosmëri. Duke qëndruar në pozita të drejta parimore, askush nuk ka çfarë të të bëjë. Kanë kaluar tashmë kohët e para, kur shtetet e mëdha, si dikur Turqia otomane, Italia etj., bënин ligjin, duke pushtuar vende e popuj të vegjël, midis tyre edhe Shqipërinë, e cila sot mban lart flamurin e marksizëm-leninizmit dhe nuk lejon ta prekë kush.

Ndryshe ngjet me vendet që kanë tradhtuar marksizmin, dhe shembull për këtë është Jugosllavia. Ky vend tani është në një kaos të madh, atje ka krizë të

thellë ekonomike, krizë nacionale, krizë të pushtetit. Korrupsioni e degjenerimi politik e moral janë përhapur në të gjitha republikat. Titoja po përpinqet shumë për të dalë nga kjo gjendje dhe flet ditë e natë për këtë, por s'ka se si, pse është ai vetë që e shkaktoi këtë kaos, është ai vetë që lëshoi «djajtë nga shishja». Kështu ndodh sot në Jugosllavi, por kjo është një çështje e brendshme që u përket ta zgjidhin vetë popujt jugosllavë.

Detyra jonë si marksistë-leninistë është të mbrojmë ideologjinë tonë, parimet e saj, dhe në fakt këtë e kemi bërë dhe po e bëjmë me vendosmëri. Ne i kemi mbrojtur këto parime si kundër revizionistëve titistë, ashtu edhe më vonë kundër revizionistëve sovjetikë, bile në një kohë kur këta ishin në kulmin e fuqisë dhe të prestigjit ndërkombetar, ndërsa ne ishim në rrezik të madh. Megjithatë, Partia jonë, duke qenë e bindur se ata kishin tradhtuar, vendosi t'u binte në kokë sido që të ngjiste. Mund të na ndodhë të mos kemi as bukë, por me parimet nuk bëjmë tregti. Kështu na mëson marksizëm-leninizmi, ndaj në vitin 1960 ne u thamë udhëheqësve revizionistë sovjetikë se, po të jetë nevoja, edhe bar do të hamë, por parimet s'i shkelim. Prandaj i luftuam e deri në fund do të vazhdojmë t'i luftojmë revizionistët. Dhe për këtë i kishim bërë mirë llogaritë. Ne qëndruam, sepse u mbështetëm te populli, i cili kur ka një udhëheqje të vendosur me një vijë të drejtë, bën gjithçka. Partia jonë qëndroi e papërkulur dhe ja si po lulëzon sot Shqipëria, kurse revizionistët nga dita në ditë po shkatteredohen. Nga jashtë duken të fuqishëm revizionistët

sovjetikë, por përbrenda janë të krimbur. Atje revolucioni do të ecë përpara, do të shpërthejë një ditë, dhe revisionistët do të pësojnë disfata njëra pas tjetrës, derisa populli t'i zhdukë përfundimisht.

Revolucioni në botë ecën përpara, luftërat nacionaçlirimitare ecin, gjithashtu, përpara. Imperialistët amerikanë dhe të tjerë, revisionistët sovjetikë dhe ata të vendeve ish-socialiste e të partive që e kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin, janë në krizë të thellë. Popujt dhe ata që i frymëzojnë në rrugën e vërtetë të çlirimt, komunistët dhe patriotët revolucionarë, nuk mund t'i trembin as demagogjia, as armët atomike, as fuqia e madhe ekonomike që mund të kenë disa shtete agresive imperialiste. Pse? Sepse ata peshojnë forcën e tyre dhe të armikut.

Le të marrim shembullin e popullit të Vietnamit, që ka mbi 20 vjet që po lufton. Më përpara ai luftoi kundër imperialistëve francezë, pastaj kundër imperialistëve amerikanë dhe kukullave të Sajgonit. Të gjithë këta armiq kanë qenë dhe janë të armatosur deri në dhëmbë, udhëheqësit e tyre ushtarakë janë hequr e hiqen si strategë të mëdhenj e me eksperiencë të madhe luftarake dhe e vërteta është se kanë edhe një ekonomi të fuqishme. Por lufta e popullit të bashkuar vietnamez, e udhëhequr nga idealet e lirisë së popullit dhe të atdheut, ua ka prishur planet. Si rezultat i saj imperialistët francezë u dërrmuant, u shpartalluan; Vietnami i Veriut u çlirua dhe u shpall republikë demokratike e udhëhequr nga Partia e Punonjësve të Vietnamit, që për një kohë të gjatë u kryesua nga plaku i nderuar Ho Shi Min. Më vonë në

Vietnam filloi luftën edhe imperializmi amerikan, por edhe ky pësoi dhe po pëson disfata të njëpasnjëshme. Populli vietnamez e ka futur atë në një krizë të tmerrshme politike, ekonomike dhe ushtarake. Për 7 ditë me radhë në Uashington dhe në disa qytete të tjera amerikane janë arrestuar rreth 9 000 veta pse protestojnë kundër kësaj lufte barbare. Llogaritet se për çdo orë 20 veta kalojnë në gjyqet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo situatë e rëndë është krijuar atje sepse masat e punonjësve amerikanë janë ngritur dhe luftojnë kundër politikës agresive të monopoleve imperialiste.

Ne konstatojmë se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka në përgjithësi një ngritje të opinionit publik. Natyrisht, populli amerikan është akoma larg asaj që të kuptojë se ç'është liria e vërtetë e tij, por konkretisht ai e ndien peshën e rëndë të politikës agresive dhe antipopullore të monopoleve që ia kanë vështirësuar jetën dhe, veç kësaj, sheh që në luftën në Vietnam t'i vritten edhe djemtë e tij. Deri tanë amerikanët nuk janë vrarë në luftëra, ndërsa në Vietnam ndodh ndryshe, atje ata po grihen. Njëri pas tjetrit kanë dështuar sulmet e agresorëve amerikanë në këtë luftë, saqë janë detyruar të mbyllen në disa baza, por edhe këto janë të pasigurta për ta. Ata u orvatën ta lehtësonin ca gjendjen e trupave të tyre në Vietnam, duke e shtrirë luftën edhe në Laos, por atje pësuan, gjithashtu, disfata të mëdha. Pastaj ushtritë agresore ndërruan takтикën, intensifikuan luftën ajrore. Megjithatë, vietnamezët gjetën mënyrën dhe janë duke ua grirë avionët. Këto tregojnë se forca e popujve është e pamposhtur.

Tani imperialistët amerikanë i ka mbërthyer një krizë e rëndë ekonomike. Vlera e dollarit ka rënë si kurrë ndonjëherë. Në Angli, në Holandë, Zvicër, Francë, Luksemburg etj. nuk blen më njeri dollarë, se tërë Evropa është mbushur me këtë monedhë që nuk e ka më vlerën e dikurshme. Ky inflacion monetar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është shkaktuar edhe nga politika luftënxitëse që ndjekin ato kudo dhe kryesisht nga lufta e humbjet që kanë në Vietnam.

Ne kemi besim se vietnamezët do të luftojnë deri në fund dhe do të fitojnë kundër imperialistëve amerikanë, ashtu sikurse fituan edhe kundër atyre francezë, jo vetëm se janë trima, jo vetëm se ndjenjat e lirisë janë të fuqishme në ndërgjegjen e tyre, por edhe se ata kanë ndihmën e përkrahjen e vendeve socialistë e të popujve të botës.

Edhe popujt arabë, me të cilët ne na lidh një miqësi e lashtë, janë sot në luftë me imperialistët. Izraeli, ku është sot në fuqi sionizmi, kjo rrymë e egër imperialiste, ka pushtuar territorin e Palestinës. Duke mbajtur Palestinën të pushtuar, ai tregon hapur se është bërë një vegël e verbër, është kthyer në një kobure në duart e imperializmit amerikan dhe të imperialistëve të tjera, që e fabrikuan shtetin e Izraelit apostafat kundër popujve arabë dhe e ndihmuat atë që me agresion të arrijë deri në buzë të kanalit të Suezit.

Në këtë vepër të ndyrë Izraeli është ndihmuar direkt dhe hapur, në radhë të parë, nga imperialistët amerikanë, por indirekt dhe fshehtazi ai ndihmohet edhe nga revisionistët sovjetikë, prandaj krekoset si

kaposh. Megjithatë, në mos sot, nesër, do të vijë koha që ai do ta pësojë dhe imperialistët amerikanë e socialimperialistët sovjetikë do të damkosen kështu me turp. Popujt arabë, duke përfshirë edhe atë palestinez, e shikojnë me besim të ardhmen, pavarësisht nga vuajtjet e vështirësitë e përkohshme. Ata kanë sot edhe shembullin e popullit heroik luftarak algjerian, që u ngrit i téri në këmbë, rröku armët, formoi ushtrinë e tij popullore dhe mundi Francën imperialiste, të quajtur «demokratike», duke krijuar shtetin e vet të ri. S'ka asnje dyshim se kështu ka për ta pësuar edhe Izraeli dhe të gjithë ata që e ndihmojnë.

Ka shumë valë, nën det dhe mbi det, që përpiken ta shuajnë luftën e popullit heroik palestinez. Tani, për ta mbajtur atë në skllavëri dhe për të nënshtuar popujt arabë, dy fuqitë e mëdha imperialiste përpiken të bien në ujdi. Por lufta e popullit palestinez nuk shuhet, se ky popull lufton për lirinë e vet, për çlirimin e atdheut të skllavëruar dhe për të drejtat e të gjithë popujve arabë. Prandaj popujt arabë, e në radhë të parë populli palestinez, e mbajnë lart flamurin e luftës për liri. Ne i nderojmë dhe kemi respekt të madh për ata që luftojnë dhe jemi të bindur se populli palestinez, që është sot në pararojë të popujve arabë, do të fitojë, sepse çështja e tij është e drejtë.

Në luftën e tyre palestinezët nuk janë të vetëm. Populli sirian e ka treguar me vepra se qëndron afër tyre. Këtë e dinë edhe Niksoni, Brezhnjevi dhe Izraeli, prandaj hidhërohen. Këtë e dimë edhe ne, miqtë dhe vëllezërit e palestinezëve, dhe gjëzohemi. Populli egjiptian, ai algjerian, ai i Marokut dhe të gjithë po-

pujt e tjerë në vendet arabe e në botë janë solidarë me luftën e popullit palestinez. Ky është një tregues që vërteton se politika e imperializmit, e socialimperializmit dhe e gjithë reaksionarëve është në një periudhë krize që po thellohet dita-ditës.

Popujt me siguri do të çlirohen. Vietnami do të fitojë, gjithashtu edhe palestinezët do ta çlirojnë atdheun e tyre të pushtuar dhe imperialistët, me ata amerikanë në krye, revisionistët, me klikën sovjetike në krye, do të pësojnë disfatë.

Ne e dimë se për lirinë dhe për pavarësinë e popujve ekzistojnë rreziqe në botë, prandaj na vihet të gjithëve për detyrë që ta ndjekim këmba-këmbës situatën politike. Partia jonë na ka mësuar të mbrojmë pa frikë dhe me guxim gjithë popujt që luftojnë për liri. Për këtë arsy e urrejnë armiqëtë politikën e Partisë sonë, kurse të gjithë popujt e botës e aprovojnë atë, se e gjejnë të drejtë. Armiqëtë përpiken të na dëmtojnë, por më parë se të bëjnë ndonjë hap kundër Shqipërisë, t'i bëjnë mirë llogaritë. Ndaj cilitdo agresor ne nuk do të rrimë duarlidhur, sepse kemi qenë gjithnjë të ndërgjegjshëm për rrezikshmërinë e rrëthimit armiqësor dhe kemi marrë kurdoherë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtje. Megjithatë e dimë se armiqëtë presin momentin që të na gjejnë të dobët për të na goditur, prandaj e kemi bërë sot kala Shqipërinë dhe ditë e natë qëndrojmë vigjilentë.

Ne jemi përpjekur me të gjitha forcat të ndërtojmë socializmin në vendin tonë, të krijojmë një ekonomi të shëndoshë, me industri dhe me bujqësi të përparuar. Shikojeni vetë me sytë tuaj Shqipërinë, të

dashur shokë dhe miq! Ndaj jush nuk mbajmë asnje të fshehtë, prandaj shkoni kudo, shkoni deri në fshatrat më të largëta, hyni brenda në familje, i pyetni njerëzit tanë si kanë qenë, si kanë jetuar përpara, si janë dhe si jetojnë sot. Po si u arritën gjithë këto përparrime? Sigurisht me përpjekje, me luftë, me gjak dhe me djersë.

Pas Çlirimtit të vendit na u desh ta vazhdonim luftën me armiqjtë e jashtëm dhe të brendshëm, të cilët s'heqin dorë nga përpjekjet për të na penguar, prandaj ishim dhe jemi të detyruar ta ndërtojmë socializmin duke mbajtur në njëren dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën. Po të keni një ide si ka qenë Shqipëria para Çlirimtit, do të mund të gjykonи drejt për sukseset tona gjatë kësaj periudhe 27-vjeçare. Asgjë nuk kemi trashëguar nga e kaluara, shokë dhe miq, gjithçka e kemi ndërtuar krejt të re, sepse çdo gjë e filluam nga zeroja. Megjithatë, kurrë nuk u dëshpëruam. Po përsë fituam? Sepse i thamë popullit të punojë dhe rrënjosëm tek ai besimin se me forcat e tij dhe me vijën e drejtë të Partisë mund ta ndërtojë vetë socializmin. Kush tradhton popullin, deklaroi Partia jonë, do të vihet në plumb, ndërsa kush punon për popullin, ai do të respektohet dhe do të ngrihet lart e më lart. Partia i mësoi njerëzit tanë që, sa më lart të ngjiten, aq më të thjeshtë të jenë, që uniteti Parti-popull në vendin tonë të mos ketë asnje të çarë, ku të mund të futin thinkën e tyre të helmatisur armiqjtë.

Partia jonë është përpjekur vazhdimisht të ndjekë një politikë të urtë dhe të diferencuar edhe ndaj atyre që kishin gabuar në të kaluarën dhe shumë prej tyre

ajo arriti t'i sjellë në rrugë të drejtë. Natyrisht, atyre nuk u besoi, por u tha të futen në punë dhe vetëm atje do të shikohej nëse do t'i qëndronin besnikë popullit. Pas kësaj prove ne do ta shikonim çështjen te kush mund të kishim besim e te kush jo. Nga këta shumë u bënë të nderuar, kurse të tjërët vazhduan në rrugën e tradhtisë dhe u goditën. Kështu e ka revolucioni, por populli jeton dhe ai është mbi të gjithë, interesat e tij janë të shenjtë dhe jo ata të 4-5 vetave.

Po a kemi arritur ne të krijojmë çdo gjë që duhet në vendin tonë? Sigurisht që jo. Ne kemi akoma dobësi e të meta, kemi akoma për të ndërtuar, na duhet të zhvillojmë akoma më tej industrinë, bujqësinë, arsimin, që të kemi të detyrueshëm jo vetëm arsimin 8-vjeçar, siç e kemi deri sot, por të bëjmë të detyrueshëm edhe arsimin 12-vjeçar. Çështja është që të arrijmë t'i rritim me shumicë kuadrot tanë, të zhvillojmë kulturën, të krijojmë sidomos një njeri të tipit të ri, me ndërgjegje të lartë, të zgjuar, të thjeshtë, punëtor, që të dojë atdheun, popullin dhe të jetë i gatshëm që të sakrifikohet në çdo kohë për ta. Një njeri të tillë përpinqemi të edukojmë, si Partia, shteti dhe gjithë shoqëria.

Kjo është një luftë që do të vazhdojë për një kohë të gjatë, shokë, shumë të gjatë, sepse ka vazhdimesht pengesa të shumta në këtë rrugë. Vërtet punon dhe e përgatit gjer në njëfarë shkalle njeriun, e bën me një ndërgjegje mië të lartë, por ka raste pastaj që për një gjë të vogël, i nxitur nga një mbeturinë e vjetër, ai të largohet nga rruga e Partisë. Prandaj duhet filluar përsëri nga «zdrugimi» i tij me durim e me këmbë-

ngulje. Sidomos ndjenja e interesit personal, e trashë-guar nga e kaluara, ekziston akoma e fortë në ndërgjegjen e disa prej njerëzve tanë. Ja pse në këtë çështje na mbetet shumë e shumë për të bërë akoma. Megjithatë jemi të bindur se kjo luftë, në të cilën jemi futur, është e lavdishme. Suksese kemi arritur, por duhet akoma të çajmë për të kapërcyer vështirësitet e shumta, të cilat nuk na trembin.

Partia jonë na mëson që, krahas realizimit të detyrave brenda vendit, të ndjekim me kujdes zhvillimin e situatës në botë që të mund të ndihmojmë edhe miqtë e shokët tanë kudo që janë, sepse këtë e konsiderojmë si një detyrë të domosdoshme. Por edhe Shqipëria socialiste dhe mbarë populli ynë ndihmohen, gjithashtu, reciprokisht nga miqtë e shokët e shumtë që kemi kudo në botë.

Revisionistët sovjetikë dhe imperialistët na quajnë ne bishti i Kinës. Le të na quajnë si të duan, ne jemi marksistë, prandaj e duam Kinën njëlloj si gjithë vendet e tjera.

Tani anëtarët e NATO-s njëri pas tjetrit vendosën ta njobin Kinën dhe njëkohësisht përpilen të afrohen me të edhe anëtarët e Traktatit të Varshavës. Po pse e bëjnë këtë armiqtë? Mos vallë për sytë e bukur të Mao Ce Dunit duan tani të lidhen me Republikën Popullore të Kinës? Jo, ata e bëjnë këtë sepse e shikojnë se Kina është një vend me një potencial të madh njerëzor e material. Italia e njobu Kinën, nesër do ta njobë me siguri Turqia e kështu me radhë gjithë të tjerët, pasnesër Kina do të futet edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Krerët revizionistë i kanë zënë ethet nga fuqizimi i vazhdueshmëri i lëvizjes revolucionare e çlirimtare të popujve. Në radhët e tyre nuk ka asnjëfarë uniteti, ata grinden me njëri-tjetrin, ndërsa ekonomikisht të tërë janë në krizë. Mungesa e unititetit në mes tyre duket edhe në faktin se në Poloni, në Gjermani, në Çekosllavaki, në Hungari apo në Bullgari vazhdojnë të qëndrojnë prej kohësh forca të konsiderueshme ushtarake sovjetike. Për këto arsyen perspektivat për ne, për popujt, për revolucionin janë të shkëlqyera, vetëm se të gjithë së bashku duhet të forcojmë luftën dhe solidaritetin me njëri-tjetrin.

Ju falënderoj për ardhjen tuaj në Shqipëri. Pjesë-marrja juaj në festimet e 1 Majit u ka dhënë Partisë, klasës punëtore, mbarë popullit tonë, një inkurajim, një forcë të madhe në luftën për vazhdimin e ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjen e atdheut. Ju lutem t'u transmetoni popullit, klasës punëtore, gjithë punonjësve, luftëtarëve të paepur për çështjen e madhe të lirisë, të çlirimit dhe të socializmit në vendet tuaja, përshëndetjet revolucionare të popullit, të Partisë sonë të Punës dhe të pushtetit popullor në Shqipëri. Të jeni të sigurt se te klasa punëtore, te mbarë populli shqiptar, te Shqipëria socialiste punonjësit e vendeve tuaja kanë miq e shokë besnikë.

Ju uroj nga zemra suksese të mëdha në luftën që po bëni për konsolidimin e fitoreve të arritura dhe për fitore demokratike të mëtejshme e të thella në interes të popujve në vendet tuaja. Ju uroj, në radhë të parë, juve shokë të vendeve e popujve që jeni ngritur në këmbë dhe luftoni me armë në dorë për çlirimin e at-

dheut dhe për vendosjen e një pushteti të vërtetë popullor. Ky urim del nga zemra e gjithë popullit shqiptar, i cili do të jetë kurdoherë me ju dhe, me sa të jetë e mundur, do t'ju ndihmojë. Ne kemi parasysh se ndihma jonë është e vogël, por si ne ka edhe të tjerë popuj që janë me ju, prandaj, ashtu siç thotë populli, që «pika-pika bëhet pérroi», nga bashkimi i përrrenjve lumi dhe nga këta detet dhe oqeanet, kështu bëhemë edhe ne, të tërë popujt që luftojmë për të njëjtin qëllim, prandaj s'ka forcë që ta mposhtë vullnetin tonë të përbashkët. Në këto kushte edhe ndihma e vogël e Shqipërisë ka të mirat e saj dhe ne këtë ndihmë nuk do ta kursejmë kurrë t'jua japim.

Ju ftoj të pimë një gotë për mirëseardhjen tuaj, shokë dhe miq, ju uroj shëndet e suksese në punën dhe në luftën tuaj!

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Kundër revizionizmit modern (Përmble-
dhje veprash) 1971-1975», Tiranë, 1980, f. 50*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Kundër revi-
zionizmit modern (Përmble-
dhje veprash) 1971-1975»,
Tiranë, 1980, f. 50*

TË ORGANIZOHET MË MIRË PUNA EDUKATIVE DHE LUFTA PARANDALUESE KUNDËR KRIMINALITETIT

*Fjala në mbledhjen e zgjeruar të byrosë
së Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit*

7 maj 1971

Ju, shokë, vepruat mirë që analizuat, në byronë e Komitetit të Partisë të Rrethit, zbatimin e politikës së goditjes nga organet e drejtësisë dhe të punëve të brendshme. Ky është një problem i rëndësishëm politik dhe ideologjik në radhë të parë dhe lidhet direkt me luftën që zhvillohet te ne për parandalimin, për zbulimin dhe goditjen në kohë të veprimtarisë armiqësore e keqbërëse. Kjo veprimtari, siç dihet, është një nga shprehjet tipike të luftës së klasave, një nga aspektet më të mprehta të shkeljes së ligjshmërisë, një pengesë e konsiderueshme për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë. Ky problem në të njëjtën kohë ka për qëllim edukimin e të gjithë atyre individëve që shkelin me ndërgjegje ligjet e shtetit.

Unë nuk do të flas vetëm për politikën penale, pasi për këtë kam folur edhe herë të tjera, por dëshi-

roj të theksoj edhe disa anë të tjera të problemit, siç janë shkaqet dhe mënyrat e shfaqjes së kriminalitetit në kohë dhe në vende të ndryshme, cilat mund të jenë subjekte të krimeve dhe si duhet organizuar më mirë lufta ideopolitike e Partisë kundër kësaj së keqje që mund të dëmtojë shoqërinë tonë.

Kriminaliteti, si fenomen shoqëror, është pjellë e shoqërisë me klasa antagoniste dhe në kushtet e sotme ushqehet çdo ditë e më shumë nga ideologjia borgjeze e revizioniste. Në vendet kapitaliste, kriminaliteti është bërë prej kohësh një plagë e rëndë, një problem shqetësues në shkallë kombëtare. Vrasjet, grabitjet, tradhtia, spiunazhi, marrëdhëniet seksuale me dhunë e të shthurura, vjedhjet me anë thyerjesh e vrasjesh etj., etj. janë pamje nga më të zakonshmet e jetës së vendeve kapitaliste. Atje po përhapet në përpjesëtime gjithnjë e më të mëdha degjenerimi politik e moral.

Përpjesëtime alarmuese ka marrë kriminaliteti edhe në vendet ku sunojnë revizionistët, sidomos në Bashkimin Sovjetik, ku, si rezultat i degjenerimit të shfrenuar ideologjik, politik dhe moral të shoqërisë, përveç vrasjeve, vjedhjeve, përdhuniuve e krimeve të tjera të shëmtuara, një përhapje të gjerë kanë marrë krimet në detyrë të kryera nga personat zyrtarë, ryshfeti që praktikohet në shumë sfera të shërbimit shtetëror e shoqëror, si dhe alkoolizmi që është bërë sëmundje shoqërore që shthur e nxit gjithnjë e më tepër edhe rininë për akte huliganizmi.

Për të mbuluar shkaqet e vërteta të kriminalitetit, ideologët borgjezë që kanë vënë penën dhe ndërgjegjen

e tyre shkencore në rrugën e mashtrimit, po bëjnë në shumë vende një punë që nuk do të gjejë kurrë mirënjohje. Duke u përpjekur të fshehin shkaqet e vërteta socialo-ekonomike dhe ideologjike të kriminalitetit në vendet e tyre, ata përhapin pikëpamjen sikur gjoja rritja e numrit të keqbërësve qenka shkaktuar nga shtimi natyral i popullatës, megjithëse kjo nuk është aspak një arsyё dhe megjithëse dihet që në këto vende kriminaliteti po rritet më tepër se numri i popullsisë.

Përfaqësuesit e shkencës së kriminologjisë borgjeze, duke mos u dhënë një përgjigje të drejtë çështjeve rrënjosore dhe sidomos shkaqeve të vërteta të kriminalitetit në shoqërinë e tyre, duan të shfajësojnë sistemin kapitalist, atë burim që krijon dhe zhvillon në kulm kriminalitetin. Ata e shpjegojnë këtë fenomen me ndikimin e faktorëve shoqërorë, që formojnë kriminelin, pavarësish nga struktura ekonomike e shoqërisë; një pjesë tjetër kriminalitetin e shpjegojnë me vetë natyrën e njeriut, i cili gjoja paska disa prirje kriminale që në lindjen e tij. Pavarësish nga varietetet e shumta e të stërholluara të drejtimeve që vihen re në shkencën borgjeze të së drejtës penale, për sa u përket shpjegimit dhe interpretimit të shkaqeve të kriminalitetit, pavarësish nga emrat e shkollave «sociologjike», «psikologjike» etj., etj., në thelb, të gjitha teoritë e tyre dalin në një shteg: të mbrojnë dhe të justifikojnë rendin shfrytëzues, shkaktar dhe burim i kriminalitetit. Prandaj kriminaliteti në shoqërinë me klasa antagonistë nuk mund të zhduket, për sa kohë që atje do të ekzistojë ai që e lind, rendi shfrytëzues. E njëjtë gjë mund të thuhet, gjithashtu, për krimina-

litetin në vendet revizioniste për sa kohë që atje do të jenë në fuqi klikat tradhtare.

Në vendin tonë socialist nuk ka bazë ekonomike dhe politike për lindjen e kriminalitetit si fenomen shoqëror. Krijimi i pronës socialiste mbi mjetet dhe veglat e prodhimit dhe sistemi socialist i ekonomisë bënë të mundur që punonjësit tanë të jenë zotë të kësaj pasurie dhe ta përdorin atë për të mirën e tyre. Partia, që përfaqëson dhe mbron interesat jetikë të masave punonjëse, punon pareshtur për të ngritur në një nivel gjithnjë e më të lartë ndërgjegjen e njerëzve, për të zhvilluar e për të forcuar pasurinë sociale, me të cilën lidhen ngushtë mirëqenia e punonjësve dhe rritja e aftësive mbrojtëse të atdheut. Puna e vazhdueshme dhjetëravjeçare politike dhe ideologjike e Partisë për të rrënjosur në ndërgjegjen e njerëzve tanë idealet e mëdha të socializmit e të komunizmit dhe normat e moralit të lartë proletar ka dhënë rezultate të mrekullueshme. Tashmë në vendin tonë janë edukuar në masë luftëtarët besnikë e të vendosur të këtyre idealeve që janë gati të jepin gjithçka që kanë më të shtrenjtë për mbrojtjen e tyre. Pikërisht kjo ndërgjegje e lartë politike dhe kjo pastërti morale, me të cilat janë mbrujtur njerëzit tanë, i kanë bërë të pathyeshëm Partinë dhe popullin shqiptar.

Por, megjithëse kriminaliteti nuk ka baza ekonomiko-politike, edhe te ne ka njerëz të veçantë që kryejnë krime. Ky është një realitet që Partia e njeh dhe e shpjegon shkencërisht.

Shekuj me radhë në vendin tonë kanë sunduar marrëdhëniet feudale dhe patriarkale. Pushtuesit e

huaj dhe tradhtarët e vendit kanë nxitur kriminalitetin për të përçarë e për të sunduar më lehtë masat punonjëse. Bashkë me klerin reaksionar, që ka luajtur kurdoherë kartat e të huajve në kurriz të popullit, ata kanë vepruar për të rrënjosur koncepte, zakone, tradita e shprehi të botës së vjetër, «njollat» e të cilave akoma edhe sot shfaqen në jetën dhe në punën e përditshme të disa njerëzve, në qëndrimin e tyre ndaj punës, pronës, shoqërisë, familjes etj., etj. Që të krijohen koncepte të reja revolucionare e të rrënjosjen normat e moralit tonë socialist tek të gjithë njerëzit duhet akoma kohë dhe shumë punë, sepse këtu kemi të bëjmë me transformimin e ndërgjegjes. Në këtë luftë të gjatë e me përpjekje të shumanshme të Partisë për edukimin e punonjësve, plekset bota e re me të vjetër, zhvillohet një ndeshje e fortë midis së resë dhe së vjetrës, ku me luftë të ashpër e vjetra i lëshon terren së resë që kapërcen vështirësitë dhe çan vazhdimisht përpara. Ky është shkaku i brendshëm i kriminalitetit.

Shkaku i jashtëm i tij është diversioni ideologjik imperialisto-revisionist, i cili përbën një rrezik të vërtetë, prandaj nuk duhet marrë aspak si diçka që mund të përballohet lehtë e vetvetiu. Në këtë drejtim Partia duhet të jetë si gjithnjë shumë e vëmendshme dhe të mos ushqejë asnjë iluzion. Arriqtë e vendit tonë, imperialistët dhe revisionistët, përdorin të gjitha format e mjetet e propagandës së tyre si: radion, televizionin, filmin, shtypin, përfaqësuesit diplomatikë e tregtarë, turistët, marinaret, shoferët, grupet kulturoro-sportive, komunikimet postare etj. për të ndikuar mbi njerëzit tanë moralisht dhe politikisht, për t'i hedhur ata në

rrugën e kriminalitetit dhe gradualisht, po të mundin, për t'i shndërruar kontradiktat në gjirin e popullit në kontradikta antagoniste. Ata luftojnë të përhapin çdo ditë ide për shkatërrimin e familjes, të përhapin zbrazëtirën shpirtërore dhe morale të vendeve të tyre, të ndikojnë sidomos në rininë tonë nëpërmjet normave të tyre etike dhe estetike. Armiqtë propagandojnë me të madhe fitimet përrallore të shtresës së parazitëve, siç janë: gangsterët, tregtarët e narkotikëve, mbajtësit e lokaleve të vjedhësve e të prostitucionit e të tjerë, të cilët nuk merren me punë prodhuesc dhe nuk kanë asnjë lidhje me sferat e prodhimit material e shpirtëror. Partia asnjëherë nuk ka menduar dhe nuk mendon se presioni i ideologjisë së huaj mund të frenohet nëpërmjet censurës, as duke u izoluar nga bota e jashtme. Përkundrazi, politika e Partisë sonë kurdoherë ka qenë dhe është për forcimin dhe për zgjerimin e marrëdhënieve të drejta me të gjitha vendet, por mbi bazën e parimeve të njohura botërisht. Për të përballuar me sukses presionin që bëhet në drejtim të vendit tonë për depërtimin e ideologjisë reaksionare, Partia punon dhe do të punojë për të ngritur gjithnjë e më lart në formë dhe sidomos në përbajtje nivelin e punës ideopolitike në të gjitha drejtimet. Për këtë qëllim është e domosdoshme të studiohen, të zbërthehen dhe të përpunohen akoma më mirë se deri sot problemet e edukimit komunist të punonjësve. Formimi i ndërgjegjes socialiste të masave të mos kufizohet vetëm në propagandimin e disa normave dhe parimeve të përgjithshme të moralit komunist, por këto të lidhen çdo ditë në mënyrë organike me jetën, me kohën dhe me

vendin ku zbatohen, pse kështu do të shndërrohen në bindje të brendshme të njerëzve dhe do të mishërohen në qëndrimet dhe në veprimet e tyre praktike. Është e vërtetë se kushtet e reja socialo-ekonomike te ne krijojnë njëfarë ndërgjegjeje socialiste, por kjo është e pamjaftueshme për edukimin e gjithanshëm të njerëzve, prandaj në këtë drejtim rëndësi vendimtare merr faktori subjektiv, puna edukative e organizuar mirë nga Partia, shteti dhe organizatat e masave. Kjo duhet bërë me kujdes e me vëmendje të pandërprerë, natyrisht pa nënvleftësuar aspak edhe rolin shumë të rëndësishëm të punës edukative individuale dhe të diferençuar.

Si pasojë direkte e ndryshimeve të thella ekonomiko-shoqërore dhe e punës së madhe politike që ka bërë e po bën Partia për edukimin komunist të punonjësve, kriminaliteti te ne ka shkuar vazhdimisht drejt uljes. Kjo duket në tendencën e përgjithshme të pakësimit të krimeve dhe në ndryshimin e ndjeshëm sasior dhe cilësor të disa krimeve të përhapura e me rrezikshmëri më të theksuar. Këta tregues, pa pasur nevojë për koment, flasin për suksesin e punës së Partisë sonë në luftën kundër kriminalitetit.

Cdo krim që kryhet në vendin tonë prek direkt marrëdhëniet shoqërore socialiste të vendosura për mbrojtjen e bazës ekonomike dhe politike të Republikës Popullore të Shqipërisë, prek interesat e qytetarëve si subjekt të marrëdhënieve shoqërore socialiste, veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore dhe të ekonomisë popullore, rendin shoqëror, disiplinën në punë.

Le të shohim tani konkretisht disa shfaqje të kriminalitetit te ne. Gjatë vitit 1970 krimet kundër shtetit, që kanë rrezikshmëri të theksuar shoqërore, në krahasim me vitet e mëparshme, janë pakësuar dhe gati 73 për qind e tyre janë kryer në formën e agjizacionit e të propagandës. Shkaku kryesor këtu është se armiqëtë e jashtëm e të brendshëm, duke pasur si pikësynim përmbysjen e pushtetit populor, janë përpjekur të shtrembojnë kuptimin dhe karakterin e vërtetë të masave revolucionarizuese që ka marrë Partia. Çdo aksion që është ndërmarrë në këtë drejtim në vendin tonë ka ndeshur në reaksionin e armiqve.

Veprimitari armiqësore është zhvilluar te ne edhe nëpërmjet spiunazhit, përgatitjes për akte terrori, diversioni etj. Në veprimtarinë e tyre agjenturoro-subversive, zbulimet kapitalisto-revisioniste gjatë këtyre viteve kanë synuar të grumbullojnë të dhëna mbi gjendjen e vendit dhe mbi politikën e Partisë e të shtetit tonë, duke përdorur për këtë qëllim rrugët legale që përmenda më parë. Gjatë viteve të fundit është vërtetuar se disa nga këto veprimitari armiqësore shumë të rrezikshme janë kryer të koordinuara midis zbulimeve kapitaliste e revisioniste.

Një tjetër aspekt shqetësues i kriminalitetit në vendin tonë ka qenë dhe është dëmtimi dhe përvetësimi i pasurisë socialiste. Është karakteristik fakti se në këtë lloj kriminaliteti gjemjë raste të pleksjes së vepritarisë armiqësore me atë keqbërëse, si dhe tendencën e mbulimit të vjedhjeve nëpërmjet «pakujdesive», duke shkaktuar çrregullime në ruajtjen dhe në administrimin e pasurisë socialiste.

Vjedhjet janë kryer edhe nga njerëz që, duke qenë dembelë e parazitë, duke dashur të jetojnë pa derdhur djersë, janë futur në rrugën e kriminalitetit për të zhvatur nga shoqëria sa më shumë dhe për t'i dhënë asaj shumë më pak ose aspak.

Në luftën kundër krimit të vrasjes Partia ka një meritë të madhe. Në krahasim me të kaluarën si dhe aktualisht me vendet kapitaliste e revizioniste, sukset e arritura në vendin tonë janë të mira. Vrasja e kryer për gjakmarrje, fenomen i shpeshtë ky para Çlirimt, po shkon drejt uljes së ndjeshme. Në qytete kanë ndodhur shumë më pak vrasje se në fshatra, ku gjatë vitit 1970 u kryen 82 për qind e tyre, për arsy se aty janë më të theksuara mbeturinat dhe konceptet feudale e patriarchale, kurse niveli i punës politike e ideologjike është relativisht më i dobët se në qytet.

Në numrin e përgjithshëm të krimeve të dënuara prej gjykatave, gjatë vitit 1970, diçka më tepër se 2 për qind e zënë krimet seksuale. Kjo shifër, megjithëse nuk është e madhe, është për t'u shqetësuar. Shkaku kryesor i këtyre shfaqjeve të neveritshmë është ndikimi i ideologjisë së disa vendeve ku këto kime kanë marrë një përhapje të gjerë, sepse atje po ndodh «përfshirja e sferës së marrëdhënieve intime në numrin e mallrave të konsumit të gjerë», dhe kuptohet se në këtë gjendje marrëdhëniet seksuale me dhunë për kriminelët janë bërë një praktikë e zakonshme.

Në statistikat e kriminalitetit, megjithëse në përqindje të vogël, për fat të keq duken aty-këtu disa shënja të pjesëmarrjes së të rinjve në krimet e marrëdhënieve seksuale me dhunë dhe në disa kime të tjera.

Kjo shfaqje duhet ta shqetësojë Partinë jo për «të vënë duart në kokë», po për të studiuar shkaqet dhe për të marrë masat parandaluese, një ndër të cilat është edukimi me një moral të lartë proletar dhe kujdesi më i madh që duhet të tregojë familja për edukimin e fëmijëve, përvç një pune më të kualifikuar që duhet të bëjë organizata e rinisë. Ne kemi një rini të mrekullueshme, revolucionare, të zgjuar, shumë të ndershme, punëtore dhe të lidhur ngushtë me Partinë. Rininë tonë të re e të pastër duhet ta kuptojmë në zhvillimin e saj të vrullshëm. Që të plotësohen qëllimet dhe objektivat që i caktojmë rinisë, është e domosdoshme të njohim dëshirat dhe aspiratat që ka ajo dhe t'i plotësojmë nevojat e saj të arsyeshme. Askush të mos mendojë se rinia jonë kërkon gjëra ekstravagante, përkundrazi, ajo është e thjeshtë në kërkesa, kurrë nuk ka pasur dhe nuk ka pretendime të tepruara. Provat e jetës e të luftës së rinisë e vërtetojnë më së miri këtë që po them. Prandaj, kur vë në dukje pjesëmarrjen në kriime të disa të rinxve, gjë që e shprehur në shifra konkrete është e vogël, këtë e bëj pse Partia do që asnjë i ri ose e re të mos figurojë në këto statistika. Por shfaqje të tillë, pavarësisht nga dëshira dhe puna e madhe që zhvillon Partia, nuk mund të zhduken akoma nga jeta jonë edhe për një kohë të gjatë.

Dëshiroj të theksoj se këto njolla nuk janë karakteristikë e rinisë sonë. Me këtë dua t'u tërheq vëmendjen disa njerëzve me pikëpamje të theksuara konservatore që hiqen si moralistë dhe për çdo gabim që ndodh të bëhet nga ndonjë i ri ose e re, janë gati jo vetëm t'i dënojnë pa mëshirë, por edhe ta përgji-

thësojnë këtë faj ose gabim të dënueshëm dhe të përlyejnë kështu gjithë rininë. Të tillë njerëz hiqen sikur mbrojnë vijën e Partisë, por në fakt ata nuk e kuptojnë hiç këtë vijë dhe as luftën që zhvillohet përzbatimin e drejtë të saj. Këta nuk kuptojnë zhvillimin e vrullshëm të situatave, transformimin e gjerë pozitiv të pikëpamjeve politiko-ideologjike, zhvillimin pozitiv të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore dhe marrëdhëniet e reja të njerëzve në prodhim dhe në shoqëri. Ata nuk gjykojnë, gjithashtu, se ne kemi bërë një revolucion të madh që po vazhdon, nuk kuptojnë zhvillimin e luftës së klasave që e mendojnë si një formulë të thatë dhe nuk shohin se në këtë luftë ka fitues, por ka edhe nga ata që shkasin. Lufta që bën Partia synon që numri i këtyre që gabojnë të zgogëlohet, por për t'ia arritur kësaj nuk mund të ecet prapa, duke mbyllur gruan ose vajzën në kafaz, duke u ndrydhur të rinxje e të rejave, me shumë mënyra dhe mjete anadollake, vullnetin, ndjenjat dhe duke mos pasur besim të madh në ta gjoja me pretekstin se janë të rinj.

Pikëpamje dhe metoda të tilla janë të huaja për Partinë. Disa mendojnë se me këto veprime shhangen krimet, korruzioni e të këqija të tjera. Ata që mendojnë kështu gabohen. Statistikat vërtctojnë se në regjimet e kaluara, para Çlirimt, kur ishin në fuqi dhe vepronin në jetë këto norma e parime, pikëpamje ose ligje, lulëzonin krimet, vjedhjet, vrasjet etj. Vetëm kur Partia dhe populli erdhën në fuqi, këto shfaqje negative filluan të pakësohen dhe vazhdojnë të pakësohen dita-ditës për arsyet që thashë më lart.

Unë, shokë, preka shkurtimisht vetëm disa nga krimet me rrezikshmëri të theksuar shoqërore dhe vetëm një pjesë të shfaqjeve të tyre, me qëllim që të tërheq vëmendjen se sukseset e arritura në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi nuk duhet të na pengjnë të shohim rrezikun e madh të disa kimeve të veçanta, të cilat, po të mos luftohen sistematikisht dhe pa ndërprerje, mund të dëmtojnë rëndë interesat e popullit dhe të Partisë dhe të komprometojnë ndërtimin socialist të vendit.

Në situatat që jetojmë veprimtaria armiqësore synon disa objektiva të caktuar, siç janë: përpjekjet për të dobësuar unitetin e çeliktë të popullit rrëth Partisë, disiplinën proletare në punë, dashurinë për punën dhe respektin për njerëzit e punës etj. Si mjet më të përshtatshëm për arritjen e objektivave të tyre dhe për çoroditjen e mendjes së njerëzve tanë armiqëtë kanë zgjedhur propagandimin e mënyrës borgjeze e revizioniste të jetesës, modën e huaj në veshje, sjelljen e shthurur, përhapjen e letërsisë dhe të arteve dekadente si: muzikën, pikturen etj. Partia duhet t'i analizojë hollësisht objektivat e armikut dhe mjetet që përdor ai, me qëllim që t'i njoħë mirë dhe mbi këtë bazë të ndërtojë luftën e saj efikase kundër tyre.

Në këtë luftë Partia duhet të aktivizojë më shumë se deri tani organet e pushtetit, organizatat e masave, si dhe shkrimtarët e artistët e vendit tonë.

Subjekte të kimeve nuk janë vetëm armiqëtë, por edhe njerëzit tanë, të cilët duke qenë nën ndikimin e mbeturinave, traditave, zakoneve e shprehive të botës së vjetër, si dhe nën presionin e përditshëm të ideolo-

gjisë borgjeze e revisioniste, u kundërvihen raporteve shoqërore të mbrojtura nga e drejta penale. Për të kuptuar përsë ndodh që edhe njerëzit tanë të moshave, të krahinave e të shtresave të ndryshme kryejnë krimet, duhet të kemi parasysh mësimin e Partisë se lufta e klasave, si fenomen objektiv dhe i pashmangshëm, zhvillohet jo vetëm midis nesh dhe armiqve, të brendshëm apo të jashtëm, por edhe në gjirin e popullit, pra midis njerëzve tanë, se lufta e klasave shprehet në një formë të ashpër pikërisht në fushën e kriminalitetit, duke përfshirë këtu jo vetëm krimet kundër shtetit, po edhe krimet e tjera.

Për të pasur më shumë rezultate në luftën kundër kriminalitetit rëndësi të madhe ka lufta parandaluese. Krimi është kategori historike, ai u duk vetëm me lindjen e pronës private, me ndarjen e shoqërisë në klasa dhe me lindjen e shtetit, prandaj kriminaliteti nuk do të zhduket në një ditë, as në dhjetë vjet, por do të shuhet historikisht. Për këtë arsy, kur flasim për parandalimin e krimeve, kemi parasysh pakësimin e kriminalitetit sa të jetë e mundur më shumë dhe jo zhdukjen e përnjëherëshme të të gjitha krimeve.

Për parandalimin e krimeve, kërkohet, në radhë të parë, kuptimi i thellë dhe zbërthimi i plotë i direktivave të Partisë që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit politik, ideologjik dhe kulturor të njerëzve. Krahas zhvillimit të industrisë, të bujqësisë etj., për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste është e domosdoshme kalitja e gjithanshme shpirtërore e njeriut të ri, forcimi i një ndërgjegjeje të lartë socialiste tek të gjithë punonjësit, e cila nuk formohet spontanisht,

por futet e zhvillohet nga Partia, që, si në çdo sferë tjetër të jetës, udhëheq edhe në luftën parandaluese kundër kriminalitetit. Prandaj është gabim të mendohet se lufta kundër kriminalitetit duhet të zhvillohet vetëm nga organet e punëve të brendshme, të prokurorisë dhe të gjykatës, kurse organet e Partisë, ato të pushtetit ose të ekonomisë, si dhe organizatat shqërore duhet të merren me probleme të tjera.

Në punën e madhe që bën Partia dhe në rezultat pozitive që janë arritur për uljen e kriminalitetit e të shfaqjeve të huaja, një faktor me rëndësi ka qenë dhe është përbushja me sukses e detyrave nga organet e drejtësisë dhe nga ato të punëve të brendshme. Këto organe të udhëhequra nga Partia, në lidhje të ngushtë me masat punonjëse, kanë gërshtuar me pjkuri zbatimin e ligjeve me punën edukuese. Gjyqtarët, prokurorët dhe punonjësit e organeve të punëve të brendshme duke çmuar se, në radhë të parë, janë punëtorë politikë, kanë treguar kujdes për edukimin e masave me frymën e respektimit të ndërgjegjshëm të ligjeve. Ata kanë pasur parasysh se kur punojnë për parandalimin e krimeve, që është detyra e tyre kryesore, kur zhvillojnë hetime, kur gjykojnë dhe caktojnë dënimet kundër elementeve fajtorë, funksioni i tyre nuk shkëputet nga funksioni politik, sepse ata, si bij të klasës së tyre, e çmojnë shkallën e rrezikshmërisë së veprës, të fajit dhe të fajtorit, në radhë të parë në aspektin politik, ideologjik dhe shqëror, duke analizuar nëpërmjet metodës dialektike se në ç'mënyrë dhe në ç'masë akti kriminal ka prekur interesat e Partisë dhe të popullit, sa i ka shërbyer ai ar-

mikut të klasës dhe çfarë lloji e mase dënim i që parashikon Kodi Penal duhet zbatuar në çdo rast konkret kundër elementit fajtor.

Organet e hetimit, qofshin këto të prokurorisë ose të punëve të brendshme¹, jo vetëm duhet të jenë të vëmendshme për të zhvilluar hetime të gjithanshme dhe objektive, për të nxjerrë në shesh të gjitha rrëthanat e gështjes, si ato që e rëndojnë, ashtu edhe ato që e lehtësojnë përgjegjësinë e të pandehurit, por në të njëjtën kohë të nxjerrin shkaqet që çuan në shkeljen e ligjit, të evidencojnë qartë rrëthanat dhe përgjegjësitë e njerëzve apo të organeve që me dashje ose pa dashje favorizuan krimin etj. Ky lloj hetimi do të lejojë një politikë penale më të bazuar dhe njëkohësisht krijon mundësi më të mëdha për të intensifikuar punën edukuese me njerëzit, zhvillon vigjilençen revolucionare, siguron tërheqjen në shkallë më të gjerë të masave punonjëse në ruajtjen e rendit e të qetësise.

Gjykatat e të gjitha shkallëve, duke dhënë vendimin në emër të popullit që i ka zgjedhur, shprehin gjykimin dhe qëndrimin politik e moral të shoqërisë sonë për veprën dhe fajtorin, këtej del sa e rëndësishme dhe me përgjegjësi partie është detyra e tyre.

Të gjithë duhet të jenë të ndërgjegjshëm se puna e hetimit dhe e gjykimit është e vështirë dhe e lodh-

1. Me vendim të Kuvendit Popullor të RPSSH, duke filluar nga 1 shtatori 1983, hetuesia u veçua nga administrata dhe drejtimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme. dhe kaloi në vartësi të drejtpërdrejtë të Kuvendit Popullor, njëlloj si 'Gjykata e Lartë e Prokuroria e Përgjithshme.

shme. Partia e ka çmuar kurdoherë punën e organeve të diktaturës së proletariatit, dhe i ka mësuar kuadrot që punojnë në këta sektorë të jenë të shkathët, të shpejtë në veprime, të durueshëm dhe mbi të gjitha të pjekur ideologjikisht dhe politikisht për t'i zgjidhur çështjet me partishmëri.

Punonjësit e këtyre organeve duhet të mbajnë mirë e gjithnjë parasysh se lufta kundër kriminalitetit dhe shfaqjeve të huaja është lufta për mbrojtjen e pushtetit. Dënim i është një armë në duart e Partisë dhe të popullit për të mbrojtur fitoret tona socialiste nga elementët armiq e keqbërës dhe për të mbështetur fuqimisht punën edukative të Partisë me masat. Edhe vetë dënim i te ne ka, në radhë të parë, qëllim edukativ ndaj elementit fajtor dhe pjesëtarëve të lëkundshëm të shoqërisë. Si fenomen politik dënim i është i ndryshueshëm, prandaj standardizimi i tij, që vihet re nganjëherë, është i dëmshëm dhe pa kuptim. Gjykatat dhe prokuroritë e rretheve e kanë për detyrë të jenë shumë të vëmendshme në këtë drejtim dhe të orientohen për çdo dënim nga rrethanat konkrete të kryerjes së krimít, nga koha kur kryhet, nga vendi ku ndodh dhe nga personaliteti i autorit të veprës shoqërisht të rrezikshme. Mbi këto të dhëna të vërtetuarë mirë ato duhet të çmojnë drejt, objektivisht dhe me partishmëri llojin dhe masën e dënimit. Këtë gjë duhet ta kenë parasysh edhe Gjykata e Lartë me Prokurorinë e Përgjithshme për çështjet që gjykojnë në shkallë të dytë. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë duhet të jetë i vëmendshëm që të mbikëqyrë respektimin me rreptësi të ligjit dhe zbatimin e orientimeve të për-

gjithshme të politikës penale nga gjykatat e instancës më të ulët.

Për të tri organet ka, gjithashtu, rëndësi krijimi i një raporti sa më të drejtë midis zgjidhjes së detyrave në dinamikë dhe punës studiuese të thelluar. Për vetë funksionet që kryejnë, këto organe i shohin më nga afër shfaqjet e luftës klasore në fushën e kriminalitetit. Rrjedhimisht aq sa e rëndësishme është dhënia drejt rrugë e sipas rastit problemeve të ditës, po aq rëndësi ka edhe studimi i ngjarjeve e i fenomeneve të lidhura njëra me tjetrën. Studimi çon në konkluzione më të thella mbi shkaqet e rrethanat e krimtit dhe jep mundësi për të përcaktuar detyra e masa sa më efektive.

Studimi dhe ngritja e problemit, e shoqëruar me mendime e propozime për Partinë, për organet e push-tetit, për organizatat e masave, për kolektivat punonjës etj., është një detyrë e vazhdueshme. Pas kësaj pune këto organe dhe punonjësit e tyre, me durim dhe me këmbëngulje, të luftojnë që problemeve të ngritura t'u jepet rrugë. Këtu duhet të mos lejohet indiferentizëm e mërzitje, që ndonjëherë shprehen me mendimin se «Ne e ngritëm një herë problemin, po nuk u morën masa, tani nuk kemi çfarë të bëjmë» etj., etj. Është e tepërt të theksohet se jo vetëm ato organe apo njerëz të cilëve u shtrohen probleme për zgjidhje, duhet të ndalen në to, t'u japid medoemos rrugë e të vënë në dijeni të interesuarin, por nga ana tjetër as që mund të konsiderohet e plotësuar detyra ndaj Partisë dhe popullit vetëm me ngritjen e problemit apo me dhënien e mendimit; ajo që kërkohet është zgjidhja deri në fund e tij.

Në vënien në jetë të vijës së masave me gjithë përparimet e bëra, duhet të kihet kujdes që të zbatohet drejt dhe pa teprime politika e Partisë. Të hetohen dhe të gjykohen para masave ato çështje për të cilat çmohet se është i nevojshëm mendimi i masës dhe vendimi që do të jepet për to do të luajë një rol me të vërtetë edukativ. Nuk ka asnë kuptim që për hetimin dhe për gjykimin e çështjeve të bëhen shumë mbledhje me popullin, edhe kur dihet se çështja nuk paraqit ndonjë interes të veçantë shoqëror ose politik. Në rast të kundërt disa hetime ose gjykime nuk do t'ia arrijnë qëllimit për të cilin zhvillohen para masave dhe njerëzit, edhe në qoftë se mblidhen, do të mërziten e nuk do të shprehin mendim.

Për parandalimin e krimeve nuk mjafton vetëm puna për popullarizimin e një ligji në mbledhje, ose mbajtja e një leksioni për ndërgjegjen socialiste në një seminar. Lufta për parandalimin e krimeve duhet kuptuar më gjerë dhe, pa hequr dorë nga format e punës që janë përdorur deri tanë, është e nevojshme të praktikohet shumë më tepër dhe më mirë puna individuale me njerëzit.

Kur lind një kontradiktë midis dy ose më shumë njerëzve, sado e vogël që mund të duket kjo në fillim, nuk duhet nënveftësuar, por të punohet për zgjidhjen e drejtë të saj. Praktika e punës së organeve shtetërore dhe të Partisë ka provuar se në jetë ndodh shpesh që edhe konflikte të thjeshta civile, kur nuk janë zgjidhur me kohë, kanë shërbyer si shkaqe për krime, nganjëherë me rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Zvarritjet burokratike në shqyrtimin e kërkësave dhe

të ankesave të qytetarëve e frenojnë shumë luftën për parandalimin e krimeve. Kuadrot dhe tërë qytetarët duhet të jenë më të shkathët e të zhdërvjellët në zgjidhjen e kontradiktave në gjirin e popullit dhe jo të përpiqen t'i mbulojnë këto me disa fjalë të thata, me disa «këshilla» në këmbë, pa u shtruar për ta zgjidhur drejt problemin, pa përcaktuar origjinën dhe shkaqet e mosmarrëveshjes e pa kritikuar shkaktarin e konfliktit.

Për parandalimin e krimeve, nëpërmjet metodës së edukimit, rëndësi shumë të madhe, sidomos për të ardhmen e atdheut, ka edukata familjare. Këtë edukatë siç thuhet shpesh, njeriu e merr që në moshën e njomë bashkë me qumështin e nënës. Familja është celula bazë e shoqërisë ku fillon procesi i edukimit të vazhdueshëm të njeriut tonë të ri. I riu pjesën më të madhe të kohës e kalon me prindërit dhe me pjesëtarët e tjërë të familjes, të cilët ndikojnë përditë dhe vazhdimi i mbi të. Këto ndikime lënë gjurmë të forta në ndërgjegjen e të riut, në edukatën, në karakterin, në formimin e tij shpirtëror dhe moral. Në edukimin komunist të të rinjve një rol të veçantë luan shembulli i prindërve dhe i pjesëtarëve të tjerë më të rritur të familjes, prandaj këta nuk duhet ta nënvleftësojnë këtë çështje.

Duhet njohur se jo në çdo familje punohet kurdoherë në atë nivel që kërkojnë Partia dhe interesat e atdheut. Ka ndonjë prind, bile dhë komunist, që nuk i kushton vëmendjen e duhur kësaj çështjeje kaq të madhe për të ardhmen, që kujton se me dërgimin e fëmijës në shkollë, me blerjen e disa librave dhe flëtoreve, e ka plotësuar dëtyrën ndaj fëmijëve! Njerëz

të tillë, po aq mendjelehtë sa edhe ata që janë konzervatorë, për të cilët fola më parë, tregohen shumë të pakujdeshëm dhe mbajnë qëndrime pa përgjegjësi ndaj sjelljeve dhe veprimeve të fëmijëve, duke u bërë vetë shkaktarë për shthurjen e tyre. Është e drejtë që prindi të mos shqetësohet fare kur fëmija shkëputet për disa ditë nga shkolla? Po kur fëmija, pa njoftuar me kohë familjen, kthehet pa arsyen në orët e vona të natës, ndërsa askush nuk e pyet ku ishte, me kë u shoqërua, çfarë bëri deri në atë kohë etj., nuk tregon kjo për një indiferentizëm të palejueshëm nga ana e prindërve? Bile ka edhe më keq. Vetëm kur fëmija largohet, e nuk duket për dy-tri net me radhë në shtëpi, atëherë këta prindër pa pikë turpi drejtohen në polici për t'ia gjetur fëmijën që vetë e kanë edukuar të shthurur. Një qëndrim i tillë është me të vërtetë i padenjë dhe tregon se këta prindër nuk e ndiejnë përgjegjësinë që kanë për plotësimin e detyrimeve prindërore! Prindër si këta, që përfat të mirë te ne numërohen me gisht, harrojnë se në familjen tonë rriten pjesëtarët e ardhshëm të shoqërisë socialiste, se e kanë për detyrë jo vetëm prindërore, por edhe shoqërore për t'i rritur ata si qytetarë të denjë dhe të ndërgjegjshëm, patriotë, luftëtarë për çështjen e Partisë, të gatshëm për punë në dobi të shoqërisë, të edukuar moralisht dhe të kulturuar. Në kokën e njerëzve të tillë duhet të bëhet një kthesë rrënjosore që të kuptojnë thellë se përgjegjësia e prindit për edukimin e fëmijës nuk është një çështje thjesht individuale, prandaj në këto raste shteti dhe shoqëria në asnje mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të qëndrojnë indiferentë.

Kundër ndikimit të propagandës reaksionare që përhapet nëpërmjet letërsisë dhe artit borgjez e revisionist dhe që ushqen kriminalitetin, një rol edhe më të madh se deri tani duhet të luajnë të gjithë shkrimtarët dhe artistët tanë, që kanë një mision fisnik për edukimin e njeriut të ri me idealet e socializmit dhe me normat e moralit komunist. Shkrimtarët dhe artistët të mos e nënveftësojnë për asnjë çast ndikimin që ushtrojnë në njerëzit tanë literatura dhe artet e huaja borgjeze e revizioniste që, me ideologjinë e tyre reaksionare, përpiken të depërtojnë e të helmojnë ndërgjegjen e atyre që akoma nuk janë kalitur si duhet ideologjikisht dhe politikisht. Për ta kryer mirë këtë mision, në krijimtarinë e tyre punonjësit e letërsisë dhe të arteve të mbajnë kurdoherë të ndezur zjarrin e luftës si kundër konservatorizmit ashtu edhe kundër liberalizmit, të zbatojnë me këmbëngulje dhe drejt vijën e Partisë për pasqyrimin sa më thellë nga ana ideoartistike të botës reale në zhvillimin e saj revolucionar, të heronje të kohës sonë dhe të ruhen për të mos rënë në krijimtari të dobët, në mungesën e frysës klasore e të partishmërisë komuniste, në humanizmin abstrakt, në objektivizmin borgjez, në mënyrat false të paraqitjes etj.

Lufta parandaluese kundër krimeve, siç thashë, është e gjerë dhe e shumanshme. Unë ngrita këtu vetëm disa aspekte të saj, sepse për këtë problem kam folur edhe në Sekretariatin e Komitetit Qendror¹. Për parandalimin e krimeve nuk mund të jepen receta,

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 45, f. 467.

por, duke ditur se në këtë drejtim ndikon mbi të gjitha puna e shëndoshë edukative që duhet të bëjë Partia, organizatat e masave dhe organet shtetërore, secili rrëth, pa humbur kohë, të organizojë punën parandaluese sipas kushteve konkrete që i paraqiten, të studiojë shfaqjet më të theksuara të kriminalitetit në qytet dhe në fshat, bile edhe për krahina e zona të veçanta. Çdo rrëth duhet të shikojë faktorët objektivë dhe subjektivë të kriminalitetit, që janë të ndryshueshmë sipas kohës, vendit dhe ambientit. Kjo gjë, të bëhet për kriminalitetin në tërësi dhe për llojet e vëçanta të disa krimeve më të përhapura brenda rrëthit. Të analizojë mirë shkaqet, motivet, rrezikshmërinë e krimeve, pa i shkëputur këta tregues nga personat që i kryejnë, nga koha dhe vendet ku ndodhin, nga stadi i zhvillimit të luftës së klasave në momentin e dhënë, nga zakonet e traditat që veprojnë, si dhe nga niveli i punës politike dhe ideologjike që është bërë. Në këtë drejtim duhet të shfrytëzohet nga Partia eksperienca dhe të dhënat që kanë organet e drejtësisë dhe të punëve të brendshme, si dhe studimet e tyre për të cilat fola pak më parë. Mbi këtë bazë të përgatitet Partia se ku duhet ta vëré theksin e punës edukative, në ç'krahina ta përqendrojë më shumë vëmendjen, sa forca kërkohen dhe si duhet koordinuar më mirë puna për parandalimin e krimeve.

Partia na mëson se në luftën kundër kriminalitetit është i domosdoshëm mobilizimi i të gjithëve. Në qoftë se kemi pasur suksese në luftën parandaluese kundër kriminalitetit që nga Çlirimi i Shqipërisë e deri sot, mund të themi me bindje se kjo meritë i takon popu-

llit të udhëhequr nga Partia. Në qoftë se ka pasur krimë që mund të ndaloheshin para se të kryheshin dhe nuk janë ndaluar, kjo, gjithashtu, është shkaktuar nga dobësitë e punës sonë në mobilizimin e masave, pse në punën për parandalimin e krimeve dhe për edukimin ideopolitik të masave duhet të pranojmë që ka akoma shabllonizëm e formalizëm. Prandaj të përpinqemi me të gjitha fuqitë që t'i zhdukim në maksimum dobësitë e punës për mobilizimin e popullit në luftë kundër krimeve dhe të ngremë kurdoherë më lart vigjilencën revolucionare të masave.

Nga disa shfaqje të kriminalitetit që përmenda, kur fola për krimet kundër shtetit, kundër pasurisë socialiste etj., doli qartë si dhe sa shumë punon armiku i jashtëm dhe ai i brendshëm për të futur pyka e për t'i shkaktuar të çara unitetit të popullit me Partinë, për të përbysur pushtetin popullor, për të shthurur moralisht e politikisht rininë etj. Partia na ka porositur të mos i zëmi besë armikut, edhe kur situata ndërkontaktore qetësohet përkohësisht, sepse pikërisht në këto momente ai përpunon metoda e forma pune të stërholluara për të na dëmtuar më lehtë. Rrethimin imperialisto-revizonist, këtë rrethim të fëlliçur që përhap çdo ditë sëmundje të rrezikshme, mund ta përballojmë dhe ta mposhtim me sukses me rritjen e ndërgjegjes politike dhe të vigjilencës revolucionare të masave punonjëse. Në këtë drejtim Partia dhe populli ynë kanë eksperiencën e tyre me një bilanc të pasur suksesesh.

Unë shokë e ngre tani me të madhe problemin e luftës kundër krimeve dhe kalitjen e mëtejshme të

ndërgjegjes revolucionare të masave, jo sepse në momentin aktual ky fenomen është përhapur më tepër se disa vjet më parë, përkundrazi, siç thashë, tani kemi më pak krime, por në këtë kohë, kur komunistët dhe mbarë populli ynë janë në pragun e 30-vjetorit të themelimit të Partisë dhe të Kongresit të 6-të të saj dhe me të gjitha forcat i janë përveshur punës për realizimin më me vrull të detyrave në lëmin e ekonomisë e të kulturës, duhet punuar që kriminaliteti të mos shqetësojë e të mos pengojë punën krijuese, entuziazmin e mobilizimin e njerëzve ose të kolektivave të caktuar. Duhet punuar gjithnjë e më me këmbëngulje për formimin e njeriut të ri. Prandaj ky problem, aktualisht dhe në të ardhmen, meriton një vëmendje të veçantë dhe duhet të konsiderohet si një nga shfaqjet më të ashpra të luftës klasore në planin kombëtar dhe ndërkombëtar. Duke u nisur nga kjo konsideratë realiste, gjithë Partia, organizatat e masave, organet shtetërore dhe ekonomike, duke pasur si mbështetje të fortë popullin, le ta organizojnë më mirë luftën parandaluese kundër kriminalitetit, me qëllim që këtij fenomeni negativ t'i ngushtohet gjithnjë e më shumë sfera e veprimit në jetën e shoqërisë sonë. Natyrisht, në krye të kësaj pune duhet të qëndrojë si kurdoherë Partia, e cila të bëjë përpjekje që ta njohë mirë gjendjen e kriminalitetit brenda rrethit dhe të udhëheqë me urtësi masat punonjëse të qytetit e të fshatit në luftën kundër kriminalitetit, t'i organizojë dhe t'i mobilizojë ato sa më mirë.

Kontradiktat lindin në gjirin e popullit, por edhe krimet ndodhin në gjirin e popullit, i cili është

ai që pëson nga veprimtaria kriminale. Populli është shumë i interesuar në këtë luftë, prandaj në asnjë mënyrë nuk është dhe nuk mund të jetë indiferent. Jeta ka provuar se populli ka parandaluar krimet e rrezikshme, ai u ka ndalur dorën shpeshherë keqbërësve, të cilët, nga presioni i opinionit shoqëror, kanë dështuar dhe nuk kanë mundur të gjejnë vrimë ku të futen. Kam bindjen e plotë se si në çdo drejtim edhe në luftrën kundër kriminalitetit, në të ardhmen ne do të korrим suksese të reja.

Tash dëshiroj t'ju flas pak edhe për disa probleme të gjendjes aktuale ndërkombëtare.

Jo vetëm ne, anëtarët e Partisë, po gjithë populli ynë duhet të jemi kurdoherë syhapur dhe në korent të ngjarjeve më të rëndësishme politike, për arsyen se Republika Popullore e Shqipërisë nuk rrон e izoluar në këtë botë e as i ka lidhur ndonjëherë duart, por, me qëndrimet dhe veprimtarinë e saj, me aq sa i është mundur, ndikon edhe ajo në arenën ndërkombëtare. Kjo veprimtari, e udhëhequr nga Partia, ka bërë që politika e Republikës sonë Popullore të ndiqet me kujdes nga të gjitha shtetet, miq dhe armiq.

Politika e Partisë dhe e shtetit tonë është marksiste-leniniste, aktive, në favor të revolucionit botëror dhe në unitet të plotë pikëpamjesh, në teori dhe në veprim, me partitë marksiste-leniniste, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre revolucionare në vende e kontinentale të ndryshme, dhe me të gjithë popujt që luftojnë me armë në dorë kundër të huajve që u kanë shkelur vendin ose klikave reaksionare që sundojnë mbi ta.

Forcat revolucionare në shkallë botërore janë të mëdha e vazhdimisht në ngjitje. E themi me bindje se ajo u shkakton shumë kokëçarje e disfata të pandreqshme, në të gjitha lëmet, imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe aleatëve të tyre të bindur, si edhe borgjezisë reaksionare të vendeve të ndryshme.

Aktualisht imperializmi amerikan është duke kaluar një krizë të rëndë në të gjitha drejtimet. Edhe socialimperializmi sovjetik, sidomos, është duke kaluar një krizë të rëndë, të brendshme dhe të jashtme, krizë politike, ushtarake e ekonomike. Të dyja palët janë duke kaluar një krizë në mes tyre, grupimeve të tyre, si edhe në aleancat që kanë krijuar. Kurse nga ana jo-në, nga ana e revolucionit, forcat janë vazhdimisht në ngjitje e në unitet që vjen duke u kalitur çdo ditë, çdo muaj e çdo vit.

E dimë prej kohësh se tradhtarët revisionistë sovjetikë kanë vendosur kapitalizmin në Bashkimin Sovjetik; se ata janë duke e konsoliduar atë në favor të shtresës së re burokratike borgjeze dhe në dëm të popullit punonjës, të klasës punëtore. Tradhtinë e tyre ata përpiken ta mbulojnë me fletë fiku, me maska, me idetë e Leninit. Ata përpiken të lënë përshtypjen, pratë gënjejnë, sikur ekziston unitet i plotë në radhët e tyre. Por, unitet në mes revisionistëve nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë, bile as brenda në vetë Bashkimin Sovjetik, sepse, si në çdo vend kapitalist, atje ka grindje midis klikave, grupeve të ndryshme në pushtet. Interesat midis këtyre grupeve bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, gjë që ka krijuar, përveç të tjerave, edhe kontradikta të theksuara nationale.

Republikat e ndryshme që përbëjnë Bashkimin Sovjetik, në sipërfaqe, duket sikur janë në unitet të plotë midis tyre, por në realitet ato janë të përqara, për arsyen se në udhëheqje nuk ekziston një parti e vërtetë marksiste-leniniste, që të ketë në themel të gjithë veprimtarisë së saj ideologjinë proletare, e cila ta çimentojë unitetin. Në këto kushte, ndërmjet republikeve sovjetike që formoi Lenini dhe që kaliti më tej Stalini nuk mund të ekzistojë ai unitet i çeliktë i dikurshëm marksist-leninist; prandaj edhe disfatat ekonomike në to vijnë njëra pas tjetrës.

Për ta mbajtur në këmbë shtetin e tyre revolucionist, udhëheqësit hruščovianë janë të detyruar të mbajnë në këmbë një ushtri të madhe, të armatosur deri në dhëmbë. Ajo u duhet atyre jo vetëm për ta pasur si bazë mbështetjeje dhe sulmi për mbrojtjen e privilegjeve që kanë krijuar për vete në vendin e tyre, por edhe për të mbajtur nën zgjedhë taborin e revolucioniste të tjerë, shtetet e Traktatit të Varshavës, të cilat, edhe këto, nuk janë dhe nuk mund të janë në unitet ndërmjet tyre. I ashtuquajturi unitet që reklamojnë ata, mbahet me zor, me imponim, mbasi dihet që gati të gjitha vendet revolucioniste janë të okupuara nga ushtria sovjetike. Në radhët e tyre kanë lindur kontradikta të mëdha, pse janë krijuar organizma ekonomikë dhe janë nënshkruar traktate që u kanë lidhur duart klikave revolucioniste në fuqi të këtyre vendeve. Megjithatë, jo vetëm popujt, po as këto klika vetë nuk mund ta durojnë për një kohë të gjatë zgjedhën e revolucioniste të Moskës, e cila sot në këto vende mbahet me forcën e armëve.

E njëjta gjendje kaotike politike, ideologjike dhe ekonomike që ekziston në Bashkimin Sovjetik, pasqyrohet ca më keq në vendet e tjera revizioniste që bëjnë pjesë në Traktatin e Varshavës. Kudo, megjithëse në forma e rrugë të ndryshme, po përsëriten ngjarje si ato të Çekoslovakisë. Në Bullgari, udhëheqësit e këtij vendi i qëndrojnë besnikë Bashkimit Sovjetik revizionist; ndër gjithë të tjerët ata janë lakinjtë më të mëdhenj të revizionistëve të Moskës. Në sipërfaqe duket sikur çdo gjë në Bullgari shkon në rregull, mirëpo populli atje është në kundërshtim me udhëheqjen, të cilën e urren pa masë.

Rumania, siç e dini, ndjek edhe ajo një kurs revizionist, por përpinqet ta kundërshtojë shtypjen sovjetike. Në sajë të rezistencës që bën, ajo ka arritur të fitojë disa privilegje në kuadrin e aleancës së Traktatit të Varshavës dhe në disa veprime duket sikur është diçka më e lirë nga vendet e tjera të kësaj aleance. Udhëheqësit rumunë synojnë të lidhen çdo ditë e mëngushtë me imperializmin amerikan dhe me Gjermaninë e Bonit, të marrin kredi prej tyre dhe nga shtetet e tjera imperialiste, por, për të ruajtur pamjen sikur janë komunistë, herë pas here shkëmbejnë edhe me nendonjë telegram.

Nga ana e vet revizionistët sovjetikë, në kursin e «politikës së tyre të madhe», përpinqen ta forcojnë gjithnjë e më shumë aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që është në qendër të gjithë politikës dhe veprimtarisë së tyre në arenën ndërkombëtare. Kjo aleancë ka për qëllim ndarjen e botës dhe të sferave të influencës. Megjithatç, siç na mëson marksizëm-

-leninizmi, ndërmjet këtyre dy fuqive të mëdha imperialiste, klikës revizioniste sovjetike dhe përfaqësuesve të monopoleve amerikane, pavarësisht nga përparimi i madh që është arritur në aleancat midis tyre dhe nga marrëveshjet e nënshkruara për shumë probleme me njëri-tjetrin, është e pamundur të mos ketë kontradikta, bile ne i shohim këto gjatë vetë zhvillimit të ngjarjeve. Këto kontradikta janë të shumta dhe aspak të rastit. Këto dy fuqi imperialiste dita-ditës po gërryhen nga disfatat e mëdha politike që janë duke pësuar në arenën ndërkombëtare për shkak të luftës që u bëjnë popujt revolucionarë të botës.

Cdo ditë e më shumë po demaskohen blofi dhe demagogjia e së ashtuquajturës luftë antiimperialiste dhe qëndrimi gjoja antiamerikan i revizionistëve sovjetikë. Popujt po shohin gjithnjë e më qartë që kjo është vetëm një gjenjeshtër, sepse revizionistët sovjetikë, në fakt, janë në aleancë me Shtetet e Bashkuara për ndarjen e sferave të influencës.

Revizionistët sovjetikë flasin për «ndihmën» që u japidnë popujve arabë, por ndihma që ata gjoja japidnuk është veçse mjet për t'u hedhur atyre kanxhat, për të vënë këmbët e tyre të hekurta me anije, tanke e aeroplanë në vendet arabe, për të shtënë në dorë baza detare e tokësore në Republikën Arabe të Bashkuar, në Libi, në Algjeri e gjekë, me qëllim që të sigurojnë në këto vende dhe në vende të tjera të Afrikës pozita strategjike, si baza mbështetëse përfotën e tyre të Detit të Zi që qarkullon në Mesdhe.

Revizionistët sovjetikë flasin gjithashtu shumë për «ndihmën e madhe» që i japidnë Vietnamit etj., por

propagandës së tyre pak janë ata që i besojnë, pse shumica e njerëzve në botë janë të bindur që kjo ndihmë nuk është e singertë. Bashkimi Sovjetik revolucionare të popujve të Indokinës dhe, në radhë të parë, të popullit vietnamez; t'i futë vietnamezët, qoftë të Veriut, qoftë të Jugut, në bisedime me amerikanët, që t'u bëjnë Shteteve të Bashkuara lëshime dhe të arrihet kështu në një kompromis në favor të amerikanëve e të sajgonezëve. Kjo është e qartë dhe dihet nga të tërë, edhe nga vetë vietnamezët.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë më si përpara, «mbreti i mbretërve», në aleancën e NATO-s. Ndërmjet partnerëve të kësaj organizate ka kontradikta të mëdha. Me gjithë frikën nga një sulm eventual i revisionistëve sovjetikë, ata duan të çlironen nga lidhjet e vartësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aleanca e NATO-s ekziston dhe do të ekzistojë si kundërpeshë ndaj vendeve të Traktatit të Varshavës, por njëkohësisht edhe si një armë në duart e imperialistëve amerikanë për të nënshtruar pjesëtarët e tjerë të këtij pakti, prandaj brenda kësaj aleance shtetesh kapitaliste nuk mund të ekzistojë unitet; pjesëtarët që e përbëjnë atë kanë kontradikta me njëri-tjetrin. Kjo do të thotë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të sundojnë mbi të tjerët, siç mendojnë dhe dëshirojnë ata.

Disfata të mëdha po pësojnë imperialistët amerikanë në Vietnam. Vietnamese u kanë shkaktuar atyre një turp të pashlyeshëm; me luftën e tyre shumëvjeçare ata kanë goditur rëndë prestigjin politik dhe ush-

tarak amerikan. Taktikat dhe strategjia amerikane në Vietnam kanë dështuar, ato janë thyer njëra pas tjetrës. Për vite të tëra imperialistët amerikanë kanë bombarduar Republikën Demokratike të Vietnamit, po kjo nuk u dorëzua. Për vite me radhë kanë luftuar ata në Vietnamin e Jugut, po asgjë s'kanë fituar; as kanë mundur dhe as do ta mposhtin dot vullnetin e popullit vietnamez. Përkundrazi, ushtritë amerikane dhe ato të reaksionarëve sajgonezë tash janë struktur në disa baza. Niksoni, për të ruajtur interesat e klanit, me qëllim që të qëndrojë në fuqi grupimi i tij, përpinqet tash të gjejë ndonjë mënyrë për t'i shpëtuar disfatës e për të dalë nga kjo darë nëpërmjet zbatimit të teorisë së «vietnamizimit» të luftës, domethënë të vëniec së vietnamezëve kundër vietnamezëve. Sajgonezët dhe padronët e tyre amerikanë provuan ta lehtësonin gjendjen duke sulmuar Laosin, po kavaleria e hekurt e tankeve, avionët dhe helikopterët amerikanë u bënë shkrumb e hi. Taktika dhe strategjia e re amerikane pësoi kështu një tjetër humbje të madhe. Popujt e Indokinës, që luftojnë për jetën e tyre të lirë, kanë fituar një eksperiencë të madhe në luftë; ata kanë gjetur mjete të përshtatshme të luftës popullore kundër avionëve, helikopterëve dhe desantëve të lëshuar nga ajri; kanë përballuar me sukses djegien e fushave dhe të pyjeve me napalm. Kjo është një disfatë shumë e rëndë për amerikanët. Lufta tash e ka bërë shumë të pasigurt qëndrimin e tyre në Vietnam. Por, me gjithë disfatat që kanë pësuar, këta natyrisht nuk tërhiqen, prandaj përpinqen si e si të gjejnë një *modus vivendi* për të dalë nga qorrssokaku ku janë futur

dhe në këtë drejtim ata i ndihmon shumë Bashkimi Sovjetik.

Për popujt rëndësi ka fakti që disfata e madhe ushtarake e imperialistëve amerikanë në Indokinë ka diskredituar rëndë fuqinë e tyre, autoritetin e shtetit të madh imperialist me një potencial kolosal ushtarak, me mjetet më moderne të luftës dhe me industriën më të madhe në botë. Me gjithë këto forca të vëna në dispozicion, me gjithë luftën barbare, imperialistët amerikanë s'e mposhtën dot për shumë vjet me radhë popullin e Vietnamit të Jugut, përkundrazi, është ky që ua ka futur atyre të dyja këmbët në një këpucë dhe u kërkon me këmbëngulje të dalin jashtë vendit të tyre.

Disfatat e njëpasnjëshme ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Vietnam kanë shkaktuar për to disfata të pandreqshme politike edhe në arenën botërore, mosbesim deri te miqtë e tyre më të ngushjtë. Jo vetëm kaq, por këto disfata kanë shkaktuar shqetësimë dhe turbullira të mëdha brenda vetë Shteteve të Bashkuara, në opinionin publik amerikan. Pavarësisht se mendja e njerëzve të thjeshtë në Shtetet e Bashkuara përpunohet pareshtur me ideologjinë më reaksionare, me anë mjetesh nga më të fuqishmet të propagandës për të skllavëruar ndërgjegjen e tyre, atyre u ka vajtur tash thika në kockë, pse janë të shumtë djemtë amerikanë që vriten në luftën e pадрејтë që ato bëjnë në Vietnam. Kjo i dhemb fort popullit amerikan, që deri tash ishte mësuar vetëm të punojë e të fitojë, kurse në luftë të vriteshin të tjerët, jo bijtë e tij. Tash kohët kanë ndryshuar, ame-

rikanët sot po vihen drejtpërdrejt përballë luftërave të armatosura; atyre nuk po ua nxjerr më tjetërkush, si përpara, gështenjat nga zjarri.

Para dy dekadalash shumë djem amerikanë u vranë në Kore; tash edhe më shumë po vritten në Vietnam. Perspektiva është se edhe gjetkë mund të vritten të tjerë, pse e tillë është politika agresive e imperializmit amerikan. Politikën e luftës dhe të agresionit imperialist gjithnjë e më shumë po e kundërshtojnë njerëzit e thjeshtë në Amerikë, prandaj është duke u ngritur çdo ditë e më shumë në këmbë opinioni amerikan kundër luftës në Vietnam. Ka rëndësi të madhe çështja që tash masat popullore amerikane e kundërshtojnë politikën e Niksonit në një masë të paparë, saqë qeveria e tij është detyruar të arrestojë me mijëra veta përnjëherësh. Kështu, ngaqë të arrestuarit janë shumë, gjyqet detyrohen të gjykojnë në grupe, nga dhjetëra njerëz përnjëherë.

Kriza e imperializmit nuk kufizohet vetëm në disfatat politike që sot ai po pëson kudo. Bota kapitaliste është duke kaluar edhe një krizë të thellë ekonomike. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bashkë me rolin e turpshëm të xhandarit ndërkombëtar, për interesat e tyre janë bërë njëkohësisht investorët më të mëdhenj të kapitaleve jashtë vendit të tyrc. Mirëpo kjo ka shkaktuar turbullira të rënda për vetë ata dhe për miqtë e tyre.

Para disa ditësh, siç jeni në dijeni, një tjetër krizë e madhe shpërtheu në botën kapitaliste. Është vënë në shenjë dollari amerikan. Qeveria e Gjermanisë së Bonit vendosi të mos pranojë më që bankat e saj të

shkëmbejnë dollarë me marka. Shembullin e saj e ndoqën edhe disa qeveri të shteteve të tjera, si ajo e Holandës, e Zvicrës, e Austrisë etj. Pse e mbajtën këto vende një qëndrim të tillë? Sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë nxjerrë në qarkullim me dhjetëra miliardë dollarë në kartmonedhë, duke mbushur me to bankat e Evropës. Gjithë kjo masë kolosale parash nuk është sigruar me ar; bankat amerikane nuk kanë në depozita aq ar sa kartmonedhë kanë hedhur në qarkullim, në mënyrë që cilitdo shtet që disponon dollarë, kur të dojë t'i shkëmbejë ato, bankat t'ia kthejnë menjëherë kundërvleftën përkatëse të barabartë në shufra ose monedha ari. Në këto kushte miliardat e dollarëve që kanë shpërndarë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vendet e tjera kapitaliste, nëpërmjet investimeve dhe shpenzimeve të tjera, sidomos në vendet kapitaliste të Evropës, kanë shkaktuar një shqetësim të madh, pse kjo gjendje rrezikon me inflacion monedhat e tyre. Masat që morën këto vende kanë për qëllim të shpëtojnë monedhat e tyre që aktualisht i kanë më të forta se dollari. Dollari kartmonedhë sot ka një vlerë më të ulët, prandaj ato u kanë kërkuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ta zhvleftësojnë dollarin. Kjo do të ishte një tjetër disfatë e madhe e turpshme e me shumë pasoja të rënda për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prandaj këta njoftuan se nuk do ta zhvleftësojnë. Atëherë të tjerët vunë veton. Ç'do të bëhet në të ardhmen, do të shohim, po, me sa dimë, sot më 7 maj, bëhet mbledhja e qeverisë gjermane; nesër do të mblidhen ministrat e Financave të vendeve të Tregut të Përbashkët për të marrë një

vendim së toku për të dalë nga gjendja e vështirë që është krijuar.

Të gjitha këto ngjarje rrokullisen dhe do të rrokullisen edhe më shumë në të ardhmen në kampin imperialisto-revzionist, për arsyet që parashtrova. Popujt në këto situata po ziejnë, ata lëvrijnë. Në Vietnam, siç thamë, imperialistët amerikanë po pësojnë disfata, por lufta atje s'ka mbaruar, prandaj disfata të tjera i presin në të ardhmen. Në Lindjen e Mesme ata dhe revisionistët sovjetikë përpiken të konsolidojnë pozitat respektive mbi popujt e këtij pellgu. Përveç kontradiktave që ekzistojnë në këtë zonë në mes Izraelit dhe popujve arabë dhe në mes vetë popujve arabë, kontradikta të mëdha ekzistojnë edhe në mes këtyre - dhe dy fuqive të mëdha imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Natyrisht, në këto situata mjaft të ndërlikuara, në radhët e popujve arabë ekzistojnë qëndrime kontradiktore. Disa janë për kompromis; palestinezët janë të vendosur të luftojnë; edhe algjerianët duan të luftojnë, por janë larg kësaj zone shumë të ndjeshme, ku po veprojnë imperialisto-revzionistët. Sidomos populli palestinez është i vendosur për luftë dhe do të luftojë, pse e di që, duke hequr dorë nga lufta, kauza e tij do të humbasë, imperialistët dhe revisionistët do ta marrin nëpër këmbë; do të zhduket, si thotë populli, si vaji në lakra, do të kthehet në gjendjen e mjeruar ku ishte përpara. Populli palestinez është sot në pararojë të vendeve arabe; mirëpo brendapërbrenda radhëve të tij ka tendenca të ndryshme, nuk ekziston një unitet monolit, si ai që kishte krijuar Fronti

ynë gjatë Luftës Nacionallirimtare, pse në krye ishte Partia Komuniste e Shqipërisë që fryshtonte, edukonte dhe bindte masat për rrugën që duhej ndjekur për çlirimin e atdheut, për realizimin e Reformës Agrare etj. Për këto arsyen, në luftë, me përjashtim të tradhtarëve dhe pasanikëve, u bashkua i gjithë populli më Partinë. Në botën arabe gjendja është krejt ndryshe. Atje nuk ka parti marksiste-leniniste. Popujt e vendeve arabe udhëhiqen nga clementë heterogenë, demokratë borgjezë, antisionistë etj., po dhe reaksionarë që janë me kontradikta të mëdha me njëri-tjetrin. Brenda radhëve të tyre kanë futur duart agjenturat e huaja imperialiste, amerikane, angleze, sioniste, sovjetike etj., që manipulojnë gjendjen në këto vende në drejtimet që i interesojnë se cilës palë.

Roxhersi¹, që, siç e keni dëgjuar, vizitoi ditët e fundit vendet arabe, sot ndodhet në Tel-Aviv. Botërisht flitet sikur s'ka arritur asnjë përfundim me krerët arabë, po diçka duhet të ketë arritur dhe kjo diçka do të jetë patjetër në disfavor të popujve arabë. Sa do të jenë lëshimet që i kanë bërë atij udhëheqësit e vendeve arabe, nuk dihet, po kjo, natyrisht, nuk do t'u pëlqejë sovjetikëve, pse në mos një përputhje e plotë pikëpamjesh, qoftë edhe një kompromis i vendeve arabe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është në dëm të sovjetikëve. Është e kuptueshme për të gjithë që imperialistët amerikanë përpilen t'u futin fitilat revizionistëve sovjetikë, t'u ngrenë këmbët që të qërohen nga Lindja e Mesme, se nuk i durojnë

1. Në atë kohë, sekretar i Departamentit të shtetit të SIIBA,

dot. Dhe shenjën e parë sovjetikët e morën me largimin nga pushteti të njërit prej elementëve më të besuar të tyre, Ali Sabriut¹. Se ç'do të bëhet më vonë, do të shohim, po fakt është që lufta nga ana e fuqive imperialiste atje vazhdon, si në gjithë botën, e do të vazhdojë e ashpër.

Në këto situata ne duhet t'i kemi sytë kurdoherë hapur, të jemi vigjilentë, të zbatojmë politikën e drejtë të Partisë, të ruhemti nga propaganda që përhapin revizionistët, titistët e borgjezia, e cila ka për qëllim t'i vërë popujt në gjumë. Tash në botë kudo shtypi e radiot imperialisto-revisioniste propagandojnë «pa-qen». Ata herë pas here i bëjnë lajka dhe mburrin edhe Shqipërinë për ta gënjeratë që të futet në rrugën e tyre pa krye. Partia jonë i shikon me sy të mprehtë dhe i ndjek me vëmendje këto manovra; ajo e di se lajkat e imperialistëve dhe të revizionistëve janë thika pas shpine, prandaj na mëson të ndjekim kurdoherë, si deri tash, edhe në të ardhmen rrugën e drejtë dhe të mos lëshojmë kurrë në parimet, pse këto janë vendimtare. Çdo çap që hedhim në politikën e jashtme ta mendojmë mirë, ashtu siç thotë populli: «të matim 7 herë, të presim një herë»; të pyesim veten nëse ajo që bëjmë, a është në interes të vendit tonë, jo vetëm për sot, por edhe për të ardhmen. Dhe, vetëm në rast se del që është në interes të atdheut, atëherë të veprojmë.

Në lidhje me Greqinë ne kemi mbajtur qëndrim të drejtë dhe kemi deklaruar se dëshirojmë të kemi

1. Ish-nënresident i Egjiptit.

marrëdhënie diplomatike me të dhe fqinjësi të mirë me popullin vëlla grek; u kemi dhënë në çdo rast përgjigjen e prerë dhe të merituar reaksionarëve grekë, vazhdimisht u kemi bërë të qartë se çështja e «Vorio-Epirit» është absurde; për ne shqiptarët nuk ekziston një problem i tillë, kurse ajo që ata e quajnë Vorio-Epir është tokë shqiptare, prandaj kush e prek, gjen vdekjen. Qëndrimin tonë të prerë e dinë dhe e kanë të qartë të tërë. Mirëpo qeveritë në Athinë, që ngrinin çështjen e «Vorio-Epirit», venin e vinin. Papa Kotokoja, i përkrahur nga këto qeveri bënte kongrese për të nxitur shovinizmin grek për aneksimin e Epirit të Veriut, ndërsa ne qëndronim të patundur. «Jemi në gjendje lufte me Shqipërinë», ishte ngahera parulla e tyre. Shovinistët e «megalidhesë» nuk e mbanin pa qëllim «digjin e gjendjes së luftës», por ne s'na frikësonin dot duke i rënë këtij buzuku. Ishte me të vërtetë absurde deklarata e reaksionarëve grekë për qenien e gjendjes së luftës, që nga koha kur vetë Shqipëria ishte okupuar nga fashistët italianë. Si mund të pranohej kjo nga opinioni i shëndoshë, kur Italia fashiste që pati okupuar Shqipërinë, u orvat të pushtonte më pas Greqinë, e cila sot ka marrëdhënie normale me atë që e sulmoi, ndërsa me ne që ishim viktimi e fashizmit italian, pretendon të jetë në gjendje lufte? Po, pavarësisht nga qëndrimi i shovinistëve grekë, Shqipëria ecte gjithnjë përpara, ajo ndërtonte dhe vazhdon të ndërtojë me sukses socializmin. Ata u bindën se Shqipëria nuk prekej lehtë, pse që ta sulmosh atë, duhen bërë llogaritë mirë. Këto i kanë bërë me siguri edhe sundimtarët e sotëm grekë, prandaj ata

nuk vazhduan në rrugën e paraardhësve. Këtë qëndrim të tyre ne e kemi ndjekur me objektivitet dhe i jemi përgjigjur me korrektësi, pa bërë si zakonisht asnjë lëshim në parimet.

Parvjet një avion grek, i detyruar nga një doktor, kundërshtar i regjimit të sotëm grek, u ul në tokën tonë. Doktorit i dhamë paratë e udhëtimit për të shkuar në Oslo, ku kishte dëshirë të vendosej, dhe përnjëherësh lajmëruam qeveritarët grekë se u vinim në dispozicion ekuipazhin, pasagjerët dhe avionin përtu kthyer në Greqi. Udhëheqësve të tashëm grekë u erdhi mirë ky qëndrim. Ne, pra, u sollëm korrektë, gjithë udhëtarët dhe ekupiazhin i morëm, i çuam në hotel të mirë, i mbajtëm me shpenzimet tona, gjatë ditëve të qëndrimit në Vlorë, gjë që u bëri përshtypje të madhe këtyre njerëzve, të cilëve propaganda e Kotokos dhe e gjithë reaksionarëve të tjerë grekë ua paraqiste shqiptarët si njerëz me thikë në dhëmbë. Prandaj qytetarët grekë çuditeshin për qëndrimet tona njerëzore dhe mirëdashëse me ta.

Dua të hap këtu edhe një parantezë tjetër, lidhur me një ngjarje që ka ndodhur në Sarandë me disa zyrtarë grekë për çështjen e një varke. Disa ushtarakë grekë, të autorizuar nga Korfuzi, u lejuan përtë tërhequr në Sarandë një varkë greke që kishte hyrë në ujërat tona. Si pasojë e propagandës shpifëse anti-shqiptare, ata qëndronin si të ngrirë përpara njerëzve tanë që kishin dalë t'i pritnin, prandaj, sa mbaruan punë, kërkuan të iknин shpejt. Por, tanët, me mirësjellje u thanë të mos nxitoheshin; u propozuan, po të dëshironin, të hanin bashkërisht drekë, pastaj të

iknin. «*Efkaristo poli*»¹, u përgjigjën ata të kënaqur dhe u ulën me tanët të hanin drekën që u ishte shtruar. Grekët mbetën të habitur, kur mësuan se birra që ishin duke pirë gjatë ngrënies, konservat dhe cigaret që shijonin si dhe gjërat e tjera ishin të prodhimit shqiptar, prandaj kërkuan të mos i hanin ato që u qenë vënë përpara, por t'i merrnin me vete për t'ua treguar njerëzve të tyre në Greqi, ku kishin dëgjuar shumë gjëra të këqija për Shqipërinë. «Këto që kemi përpara, do t'i hamë së bashku», u thanë tanët, «po të dëshironi, ne ju japim të tjera me vete për njerëzit tuaj».

Pas drekës kërkuuan pastaj të dilnin shëtitje nëpër qytetin e Sarandës për t'u takuar me njerëz që flasin greqisht. Tanët u thanë se në atë rreth ka shumë banorë që flasin greqisht; ka edhe minoritarë dhe, mbasi dëshironin, nuk kishte asnjë arsyе përsë të mos takoheshin. Dhe, në fakt, u takuan; folën me ata që u dolën rastësisht përpara, biseduan si janë dhe si jetojnë. Kur i pyetën nëse i ndalon njeri të flasin greqisht, morën përgjigje të qartë prej tyre, se jo vetëm që askush në Shqipëri nuk i ndalon, po treguan se kötu ka shkolla të veçanta në gjuhën greke, ku mësojnë kalamanët minoritarë. Kështu, pasi morën me vete një numër pakosh me cigare, kuti konservash dhe shishe me birrë, deklaruan se do t'ua tregonin njerëzve të tyre, mbasi përpara për Shqipërinë ishte bërë në Greqi një propagandë krejt ndryshe nga ato që panë me sytë e tyre.

Pas këtyre ngjarjeve qeveritarët grekë na propo-

1. Greqisht — faleminderit shumë.

zuan të bëjmë tregti me njëri-tjetrin. Dakord, u thamë ne, nuk kemi kundërshtim, këtë e kemi dashur ngahera, po kjo nuk varej vetëm nga dëshira jonë. Kështu përfundua me ta një marrëveshje tregtare.

Më vonë, përfaqësuesi grek në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, na propozoi të lidhim edhe marrëdhënie diplomatike e të shkëmbëjmë ambasadorë.

Kështu grekët hoqën të gjitha pengesat që vetë i kishin vënë dhe më në fund doli komunikata për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike që keni lexuar në gazetë. Kjo komunikatë ka një rëndësi të madhe dhe është një fitore e politikës së drejtë të Partisë sonë. Ne duam të kemi marrëdhënie e do të bëjmë tregti me ta, si me çdo vend tjeter, po ideologjikisht dhe politikisht, kurdoherë që të jetë rasti, do ta themi fjalën tonë, ashtu siç kemi menduar dhe vepruar kurdoherë, pse vija jonë është po ajo, nuk ka ndryshuar. Dhe vijen tonë ne nuk e ndryshojmë as kur është fjala për Bashkimin Sovjetik revizionist, as për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as për Jugosllavinë, Italinë etj. Në marrëdhëni me të gjithë, në radhë të parë, synojmë të ruajmë të pastër vijën, parimet tona mark-siste-leniniste, duke përfshirë edhe ata të bashkekzistencës paqësore leniniste. Parimin e bashkekzistencës paqësore me vendet e tjera ne e kuptojmë drejt. Ne duam të kemi marrëdhënie diplomatike, tregtare etj., me të gjithë, po në asnjë rast nuk mund t'i vëmë fre luftës ideologjike dhe politike. Kush dëshiron të ketë marrëdhënie me ne, të ketë parasysh se të tilla janë e do të jenë qëndrimet tona, kush s'do, aq punë na prish; ne shkojmë përpara. Por, në qoftë se dikush i

pranon këto kushte, atëherë jemi dakord të zhvillojmë me të marrëdhëniet normale në rrugën shtetërore, kështu siç bëmë edhe me grekët.

Vija jonë nuk ka ndryshuar as ndaj revizionistëve të Beogradit. Ne si kurdoherë vazhdojmë t'i konsiderojmë Titon dhe shokët e tij ashtu siç janë, tradhtarë të marksizëm-leninizmit. E kemi thënë dhe do të vazhdojmë ta themi pa druajtje q'është titizmi, çfarë ka bërë dhe si duhet kuptuar ai. Këto 2-3 vjetët e fundit, sidomos pas pushtimit të Çekosllovakisë, Jugosllavia u kërcënua seriozisht nga Bashkimi Sovjetik dhe Titoja mobilizoi atëherë popullin për ta kundërshtuar agresionin. Ne e kishim të qartë se po të pushohej Jugosllavia, rrezikohej edhe vendi ynë, të cilin revizionistët sovjetikë e kanë halë në sy. Por edhe vetëm Shqipërinë po të sulmonin, revizionistëve sovjetikë do t'u duhej të kalonin nëpër Jugosllavi, prandaj morëm në atë kohë të tëra masat përmbrojtjen e atdheut nga çdo armik, qofshin revizionistët e Bashkimit Sovjetik, qofshin imperialistët amerikanë, apo kushdo tjetër, veç e veç ose të tërë së bashku. Në atë kohë Partia jonë doli me deklaratën, sipas së cilës, në rast se do të sulmohej Jugosllavia nga revizionistët sovjetikë, populli shqiptar do të qëndronte përkrah popujve të këtij vendi. Kjo deklaratë e kishte burimin në politikën shumë të drejtë të Partisë sonë dhe luajti një rol të madh pozitiv. Popujt e Jugosllavisë nuk kanë për ta harruar kurrë këtë qëndrim të drejtë, solidar, internacionalist të mbajtur nga Shqipëria në favor të tyre, pavarësisht nga të këqijat e panumërtë që na kishte bërë titizmi. Ky është një qëndrim parimor,

marksist-leninist në mbrojtje të popujve jugosllavë. Çdo njeri me mend atje nuk ka si të mos arsyetojë që populli shqiptar në kohë rreziku ishte i pari dhe i vetmi që deklaroi dhe mori masa se do të luftonte krahas dhe në ndihmë të tyre.

Edhe Titos i erdhi mirë qëndrimi që mbajtëm ne. Prandaj Partia jonë, për të penguar çfarëdo spekulimi ideologjik dhe politik që mund të bëhej ndaj vendit tonë, batoi pas kësaj deklarate një artikull për të sqaruar edhe një herë pozitat tona ideopolitike ndaj regjimit titist. Për shumë muaj me radhë ata na kanë propozuar të shkëmbejmë ambasadorë, po ne u jemi përgjigjur se do ta studiojmë një herë çështjen, pastaj do t'i njoftojmë. Për të na bindur në propozimin që na bënин, titistët na thoshin se të njëjtën gjë e kanë bërë edhe me Kinën. Ne ua kemi bërë të qartë se nuk jemi bishti i Kinës, siç kujtojnë armiqtë. Secili vepron sipas kushteve konkrete, siç e lypin interesat e brendshëm të secilit vend. Edhe për këtë u sqaruan mirë revizionistët e Beogradit. Më në fund, pas sa e sa përsëritjesh e kërkesash, u thamë se, meqenëse keni kërkuar prej kohësh, jemi dakord edhe ne të shkëmbejmë ambasadorë.

Situata që u krijua është shumë e favorshme për ne, kjo na jep mundësinë të forcojmë lidhjet me shqiptarët e Kosovës, që marrëdhëniet tona me ta të zhvillohen në interesin e tyre në një shkallë gjithnjë e më të gjerë. Gjendja imediate e brendshme e vështirë e detyron Titon të jetë aktualisht ca më zemërgjerë ndaj shqiptarëve të Jugosllavisë. Duke përfituar nga kjo, këta na kanë kërkuar t'u dërgojmë ndihma në

fushën kulturore dhe arsimore. Ne kemi qenë kurdoherë të gatshëm për këtë, sepse kemi detyra të shumta ndaj shqiptarëve të Jugosllavisë.

Kështu, profesorë e pedagogë të Universitetit të Tiranës dhe të shkollave tona të tjera të larta kanë filluar të venë në Kosovë në grupe, sipas një plani, për të dhënë leksione në Universitetin e Prishtinës. Mirëpo kjo ka krijuar një situatë jashtëzakonisht entuziaste në radhët e shqiptarëve, që e ka frikësuar shumë Beogradin. Për këtë arsyе në kryeqytetin e Jugosllavisë janë thirrur nga Titoja dhe Kardeli udhëheqësit e partisë titiste dhe të pushtetit të krahinës autonome të Kosovës, të cilëve u kanë thënë për sa kishin dëgjuar pér Universitetin e Prishtinës, sikur ky qenka zaptuar nga Tirana. Ata u dhanë përgjigje se një gjë e tillë nuk ishte e vërtetë, u raportuan se profesorët e pedagogët e dërguar nga Tirana jo vetëm që janë njerëz shumë të kualifikuar, por edhe me sjellje jashtëzakonisht korrekte në çdo drejtim; u thanë se informatat ua kishin servirur ata që nuk ia duan të mirën Kosovës dhe shqiptarëve. Titoja u detyrua të deklaronte sikur kishte mbetur i qartë pér sa i reportuan gjatë këtij takimi.

Po Titoja s'ka qenë kurrë konsekuent pér këto çështje. Konsekuent ka qenë ai vetëm pér vijën e tij tradhtare që e ka çuar Jugosllavinë prej kohësh në një krizë të madhe të brendshme. Kjo krizë po thellohet dita-ditës dhe po vë në dukje kalbëzimin e regjimit titist, falimentimin e tij ideologjik, politik dhe ekonomik. Tradhtia e Titos dhe e grupit të tij antimarksist do t'i sillte, ashtu siç i solli, Jugosllavisë katastro-

fën. Titoja, në buzë të greminës, përpinqet duke u përpëlitor si dashi te kasapi ta evitojë katastrofën, por është e pamundur të bëjë gjë, për arsyen se Jugosllavia ka hyrë plotësisht dhe definitivisht në rrugën kapitaliste, në rrugën e një kapitalizmi anarkik. Atje po përleshën forcat e brendshme reaksionare, në luftë për supremaci e pushtet, dhe forcat kapitaliste të jashtme, që kanë investuar në Jugosllavi kapitale të shumta dhe kanë shtënë në dorë pozita të forta ekonomike e politike.

Të gjitha këto forca reaksionare po ndeshen në arenën jugosllave. Titoja vazhdon të luajë kartën e vetadministrimit dhe përpinqet nën këtë maskë të hiqet si «mbrojtës marksist i rrugës socialiste jugosllave, socialist specifik». Kjo kartë false tani është demaskuar përfundimisht ngajeta, nga faktet. Ajo ishte një «fletë fiku» për të vendosur kapitalizmin, për të maskuar procesin e këtij transformimi.

Ngjau ajo që duhet të ngjiste dhe që ne e kishim parashikuar dhe e kishim thënë më parë. Ky maskim, në dukje dhe në brendi, ishte aq i dobët, saqë nuk mund të mbante në kornizat e tij prej karte dhe fjalësh të Tito-Kardelit marshimin galopant të degjenerimit moralo-politik që sillte me vete sistemi kapitalist.

Ky dualizëm, i maskimit dhe i veprimit, bëri që edhe kapitalizmi që po restaurohej në Jugosllavi, të merrte një zhvillim anarkik që krijon turbullira të mëdha në investime e në ndërtime, inflacion monetar e kriza në prodhim, krijon anarki në tregje, ku çmimet ngrihen pareshtur; të krijonte rivalitetë ndërmjet republikave të ndryshme; të nxiste frymën shoviniste nacionaliste dhe grindjet ndërmjet republikave më të

forta dhe atyre më të dobëta, të republikave të fuqishme ekonomikisht, që përfitonin pjesën e luanit nga investimet dhe kapitalet e huaja, dhe republikave të varfра, që rronin me thërrimet e sofrës.

Çdo autoritet që mund t'u vinte fre këtyre lakkimeve, që mund të vinte sadopak rregull në vend, nuk ekzistonte. E ashtuquajtura Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, jo vetëm që ishte krejt e degjeneruar, por asaj i ishin hequr të gjitha fuqitë edhe si parti revisioniste. I vetmi «autoritet», si me thënë, që kishte mbetur në Jugosllavi, ishte tradhtari Tito, i mbështetur nga grupime nacionale shoviniste të brendshme dhe nga kapitalistët e tjerë të huaj, kryesisht nga kapitali amerikan. Në këtë gjendje Titoja bën përpjekje ta risabilizojë gjendjen në Jugosllavi.

Në radhë të parë, i shtrënguar nga situata brenda dhe nga kapitalet e huaja që e financojnë dhe që kanë në dorë pozitat kyç të ekonomisë së vendit, dhe vetë personin e Titos, ai po sakrifikon ca nga demagogjia për të përsosur dhe konsoliduar brenda sistemin kapitalist. Prandaj, këshilltarë të shumtë të koncerneve të huaja kanë shkuar në Jugosllavi dhe po riorganizojnë ndërmarrjet ekonomike në format më të përshtatshme kapitaliste. Kapitalistët kolonizatorë s'mund të lejojnë më sfumatura, ata nuk duan të rrezikojnë kapitalet e investuara as pozitat kyç dominuese.

Le që vetadministrimi u ka vërtetuar punëtorëve në jetë shfrytëzimin e egër që u solli. Ky farë vetadministrimi, nuk u dha atyre as më të voglën mundësi të administronin. Në vend u krijuar dhe u pasurua një shtresë e madhe dhe e fuqishme grabitësish, që u ho-

dhi punëtorëve zinxhirët e skllavërisë, i përplasi në rrugë e i la pa punë. Jugosllavia titiste u bë kështu vendi që eksporton më shumë krahë pune në Evropë. Ajo është një shtet që rron me emigracion dhe me turizëm. Të dyja këto rrugë katastrofike për ekonominë e vendit, për moralin e për politikën ekzaltohen vazhdimisht nga i falimentuari Tito.

Për Tito tradhtarin çështja tash qëndron se si ta forcojë disi këtë situatë. Ai nuk mund të bëjë asnjë hap prapa nga rruga e tradhtisë së tij; ai nuk mund ta mohojë në bllok vetadiministrimin, se këtë tezë e përdorin kundërshtarët e tij, antimarksistët, revisionistët e tjerë, shovinistët serbomëdhenj me Rankoviçin e të tjerë. Këta janë për «centralizmin kapitalist», dome thënë dominimin serb mbi të gjithë e mbi çdo gjë. Titoja atëherë, në këto kondita, e mbron vetadiministrimin, duke i bërë disa kritika të rastit, por qëllimi i tij është dhe mbetet shpartallimi i kundërshtarëve.

Titoja mbështetet në ato republika, përkëdhel ata popuj të Jugosllavisë dhe ato klika revisioniste që janë kundër fuqisë dominuese të Republikës së Serbisë. Kjo është taktika e tij. Këtë gjë ai përpinqet ta realizojë nëpërmjet reformës së kushtetutës, e cila gjoja do të shpërndajë fuqitë aktuale të presidentit të republikës te presidiumi që do të formohet nga të zgjedhurit e republikave dhe të krahinave autonome, në mes të të cilave edhe të Kosovës. Me këtë reformë Titoja përpinqet të tregojë se «u njeh» efektivisht të gjitha republikave e krahinave autonome të drejtat dhe, pas vdekjes së tij, do të ruhet e do të forcohet kështu uniteti i Federatës.

Kjo është ëndërr me sy hapur, orvatje për t'u hedhur njerëzve hi syve. Kjo është një manovër për të dalë nga kriza e rëndë dhe për të mposhtur grupimet kundërshtare që kërcënojnë Titon dhe grupin e tij. Titoja i kërcënoi hapur këta në një fjalim që mbajti nga mesi i muajit prill në Kosovë.

Në këtë fjalim Titoja, duke kujtar periudhën Tito-Rankoviç, kur Partia Komuniste e Jugosllavisë ishte kthyer në një UDB të dytë, nën drejtimin direkt të ministrit të brendshëm Rankoviç dhe kur ishin shkelur e bastarduar të gjitha normat e një partie marksiste-leniniste, tha se «në Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë ka fraksione të rrezikshme. Unë jam mësuar në luftë kundër këtyre fraksioneve dhe s'kam frikë të luftoj. Unë do të flas hapur kundër tyre» etj., etj.

Këto janë kërcënime të kota që nuk i frikësojnë kundërshtarët e Titos, pse Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë s'ka aktualisht asnë autoritet dhe nuk luanasnë rol të rëndësishëm. Të jesh apo të mos jesh në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë nuk ka rëndësi për kërkënd. Ata që janë brenda në këtë parti s'kanë gjë në dorë, në qoftë se i përjashton, kjo asnë punë nuk u prish këtyre. Çështja është kush ka në dorë dhe nën drejtim efektiv politikisht dhe ideologjisht ushtrinë, UDB-në, pushtetin civil dhe atë ekonomik, kush është më i zoti dhe më në gjendje të përpunojë opinionin.

Punët kanë degjeneruar në atë shkallë në Jugosllavi sa përpunimi i opinionit në përgjithësi bëhet nga shumë grupime rivale. Këta, pavarësisht se janë ose nuk janë formalisht në radhët e Lidhjes së Komunis-

tëve të Jugosllavisë, brenda dhe jashtë kësaj, kanë lidhjet e tyre, siç kanë brenda dhe jashtë pushtetit qendror federativ, brenda dhe jashtë republikave, prandaj është e zorshme për Titon dhe grupin e tij të marrë aktualisht masa administrative ndaj kundërshtarëve, siç bënte në kohën e vet Tito-Rankoviçi.

Dhe në fakt, pas fjalimit në Kosovë, ku Titoja kercënoi kundërshtarët, ai bëri mbledhjen e udhëheqjes së gjerë në Brioni, mbledhje që vazhdoi tri ditë dhe mbaroi më 30 prill. Por, premtimet dhe kercënimet e Titos nuk u vërtetuan. Doli një komunikatë e gjatë dhe e zezë, ku vihet në dukje gjendja e krizës së madhe dhe të përgjithshme të Jugosllavisë. Kush janë fraksionistët, ç'masa u morën kundër tyre, asgjë nga të gjitha këto nuk shohim të ketë dhe natyrisht nuk mund të ketë. Titoja dhe grupi i tij, sido që duhet të jetë më i fuqishëm nga grupet e tjera rivale, i tremben marrjes së masave, pse këto do ta shtojnë më tepër kaosin. Titoja dëshiron dhe shpreson të arnojë situatat dhe të ruajë prestigjin e tij personal derisa të vdesë.

Këtu nuk luhet aspak kujdesi i tij gjoja për të shpëtuar Jugosllavinë nga humnera ku e çoi ai. Këtu luhet një lodër e hapët dhe e fshehtë për pushtet. Një pjesë, sa rron Titoja, përpinqet të përfitojë nga koha për të forcuar pozitat e veta; të tjerët gjithashtu përpinqen edhe ata të të forcojnë pozitat, të evitojnë grushtet kundër tyre dhe të presin vdekjen e Titos për të vepruar më energjikisht për dominim dhe supremaci.

Shqiptarët e Kosovës përpinqen të konsolidojnë pozitat e fituara dhe luftojnë për të fituar të drejtat e tjera që u mohchen. Në këto koniunktura duket si-

kur «Titoja i mbron» disi shqiptarët për interesat e tij kundër klanit aktual serb, kundërshtar të tij, por kuptohet se ai, si antimarksist, bën politikën e balancimit, as shumë kundër serbëve, as shumë afër me shqiptarët.

Reaksioni sérb në fuqi, për të mos folur për atë që vepron nga jashtë, është i egër, i hapët, kundër shqiptarëve. Serbët përpiken që kushtetuta të mos ua japë të gjitha të drejtat shqiptarëve (krahinës së Kosovës), që kjo krahinë, kështu, në letër, të quhet «autonome», por të vazhdojë si më parë dhe, më keq pas vdekjes së Titos, të lëngojë nën terrorin serbomadh.

Serbomëdhenjtë përpiken dhe do të përpiken t'i përçajnë, se e shikojnë që shqiptarët janë një forcë e madhe. Në regjistrimet e muajit prill të këtij viti rezulton se vetëm në Kosovë jetojnë rreth 920 000 shqiptarë, domethënë afro 74 për qind e popullsisë së Kosovës. Në Maqedoni, Mal të Zi dhe në komunat me popullsi shqiptare në Serbinë Jugore, mund të jenë rreth 400 000. Kështu që gjithë shqiptarët që jetojnë nën robërinë titiste jugosllave mund të arrijnë afersisht 1 500 000 veta, tri herë më shumë se malazetzë, më shumë se slovenët e se maqedonasit.

Ngjarjet në Jugosllavi po zhvillohen në mënyrë shumë interesante, me të papritura e rreziqe të mundshme, prandaj po i ndjekim ato me vigjilencë të madhe.

Duke përfunduar me çështjet ndërkombëtare, desha t'ju thoshja diçka edhe mbi ngjarjet e zhvilluara në Gjermani. Siç e dini, para pak ditësh Valter Ulbrihti u shkarkua nga detyra e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane. Këtu nuk është çështja e një personi, po kjo

është një ngjarje që ka të bëjë me Gjermaninë, e cila, për pozitën dhe potencialin e saj, ka luajtur dhe do të luajë, edhe në të ardhmen, një rol të rëndësishëm në Evropë, prandaj shkarkimi i Valter Ulbrihit nga detyra, neve, natyrisht, nuk mund të mos na tërhiqte vëmendjen. Për këtë subjekt flitej me kohë, po në ditët e para të majit Berlini lajmëroi se Valter Ulbrihti «dha dorëheqjen nga funksioni si Sekretar i Parë i Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, duke mbetur kryetar i partisë, anëtar i Byrosë Politike dhe kryetar i Këshillit të Shtetit». Arsyja që u dha ishte mosha e tij e kaluar 77-vjeçare. Vendin e tij si Sekretar i Parë e zuri Honekeri.

Mundet të jetë edhe arsyja e moshës. Flitej me kohë që ai ishte edhe «i sëmurë nga kanceri», por kjo mund të jetë edhe fjalë që hapej për të përgatitur këtë terren.

Që revizionisti i vendosur Ulbriht, me një të kaluar të gjatë militanti, ishte një personalitet revolucionar, që më vonë si shumë shokë të tij në Bashkimin Sovjetik, në Gjermani e gjekë, tradhtoi marksizëm-leninizmin, kjo është e vërtetë.

Pas vdekjes së Stalinit dhe të Vilhelm Pikut, Ulbrihti u imponua në Gjermaninë Lindore dhe në Partinë Socialiste të Bashkuar Gjermane me të kaluarën e tij dhe me personalitetin e tij. Në Kongresin e 20-të ai ishte dakord me Hrushovin kundër Stalinit e kundër marksizëm-leninizmit. Ai besonte në forcën e Bashkimit Sovjetik dhe për «interesin e Republikës Demokratike Gjermane», sipas tij, duhet që të qëndronte i lidhur ngushtë me sovjetikët. Por unë mendoj, me sa

e njoh Ulbrihtin, karakterin e tij, pikëpamjet e tij (mbasi me të kam biseduar shumë herë, kemi shkëmb-
byer bashkërisht mendime për shumë probleme), se ai
nuk ishte një qole i Hrushovit, ose i Brezhnev-Kosi-
ginit, sikurse u treguan shumë lakenj të tjerë. Ulbrihti
kishte personalitetin e tij.

Revizionistët sovjetikë e dinin se Republika Demokratike Gjermane s'mund të ekte dot pa Bashkimin Sovjetik, po edhe Ulbrihi e dinte, gjithashtu, se Bashkimi Sovjetik kishte shumë nevojë për Republikën Demokratike Gjermane, pa të cilën nuk mund të ekte asgjë mirë në Evropën e pasluftës së Dytë Botërore. Prandaj Ulbrihti, me dashje ose pa dashje, duhet të pyetej nga revizionistët sovjetikë, të dëgjohej, të bihej dakord me të dhe shumë herë sovjetikët t'i cedonin në shumë gjëra kokëfortësisë gjermane të Ulbrihit. Shumë herë Ulbrihti në sy tim i ka akuzuar Hrushovin dhe Mikojanin si burokratë dhe ka kërkuar me insistim që Gjermanisë Lindore t'i jepeshin kredi pa kufi dhe favore kolosale, që ajo i merrte.

Sigurisht, unë jam i bindur që Hrushovi, e më vonë Brezhnev me Kosiginin, dëshironin dhe fshehtazi punonin për t'i ngritur këmbët Ulbrihit, që të kishin të bënin me një gjerman të tipit Zhivkov, por ishte e zorshme.

Përveç të tjerave, çështja vendimtare për Ulbrihtin ishte nënshkrimi i Traktatit të paqes me të dy Gjermanitë dhe, fundi, vetëm me Republikën Demokratike Gjermane. Hrushovi e tradhtoi këtë vijë. Natyrisht Ulbrihti s'ishte dakord dhe duhet ta ketë pëlqyer rënien e Hrushovit dhe ardhjen në vend të tij të Brezh-

njev-Kosiginit, të cilët, me veten e vet, ai i ka çmuar me siguri si më pak të zotë dhe më të manovrueshëm prej tij për interesat e RDGJ.

Mirëpo me këta kontradiktat u shtuan. Revisionistët sovjetikë po futeshin më thellë në aleancë me amerikanët. Si ata, edhe polakët, erdhën në ujdi me Bonin, nënshkruan edhe traktate, të cilat kanë mbetur pezull dhe nuk ratifikohen nga Boni, pse ky i fundit kërkon koncesione, natyrisht në kurriz të Republikës Demokratike Gjermane. E gjithë kjo situatë nuk ishte e favorshme për Republikën Demokratike Gjermane dhe për «liderin» e saj Valter Ulbrihtin. Ai ishte i zemëruar, i pakënaqur dhe me siguri ka vënë veton në shumë veprime sovjeto-polake me Bonin.

Unë mendoj se Ulbrihti nuk ka hequr dorë nga pikëpamjet e tij mbi të drejtat e Republikës Demokratike Gjermane. Mundet që presionet e mëdha dhe të shumëllojshme të sovjetikëve dhe të shokëve të tij më oportunistë ta kenë detyruar atë të tërhiqet, duke rënë në disa kompromise për t'u zhbllokuar situata aktuale. Ky variant ka rëndësi dhe do të duket shpejt në qëndrimet politike të sovjetikëve, të Bonit dhe të Republikës Demokratike Gjermane. Do të shohim sa u pagua dhe si u pagua «koka dhe mjekra e cjasit». Ideologjikisht Valter Ulbrihti ishte një revisionist i bindur dhe jo pse i fliste në vesh Hrushovi; ai ishte një revisionist prusian që nuk i kishte thonjtë të gjatë, se ndryshe ata ua hidhët në grykë Hrushovit dhe gjithë të tjerëve. Ulbrihti ishte i pari në luftë kundër Stalinit, kundër nesh, kundër Kinës. Ai luajti një rol të rëndësishëm në okupimin e Çekoslllovakisë më 1968,

por vendin e tij e mbajti dhe e mban nën robërinë e rëndë të ushtrisë pushtuese sovjetike. E gjithë kjo mund të jetë rezultat i një perspektive kombinacionesh të ardhshme.

Revisionistët sovjetikë, duke u frikësuar nga një zhvillimi «i kontakteve Kinë-SHBA», duke parë rrezikun e likuidimit të influencës së tyre në Lindjen e Mesme, kërkojnë të konsolidojnë alcancën ruso-gjermane, duke arritur deri edhe në bashkimin e të dy Gjermanive si kundërpeshë për amerikanët dhe për dobësimin e pozitave të këtyre të fundit në Evropë dhe në NATO.

Do të ndjekim zhvillimin e ngjarjeve dhe do të shohim ku e ka bishtin «çështja e Ulbrihit», pse mund të ngjasë edhe ndryshe, që të vazhdohet rezistenca kundër përpjekjeve sovjetike që të marrin koncesione nga gjermanët e Lindjes për të përmirësuar marrëdhëniet me Bonin. Në këtë rast ne do të asistojmë në qëndrime më të ashpra e më të prera nga ana e Honekerit kundër Bonit, që do të thotë kundër tendencave të lëshimeve. Atëherë është me vend të thuhet se Ulbrihti u tërroq për arsyet e moshës dhe jo për arsyet presioni dhe la Honekerin më të ri që të luftojë. Honekeri është një revisionist pa personalitet. Ai u gri së foluri duke lavdëruar Kongresin e 24-t të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Të shohim pra ç'do të bëjë Honekeri, ç'qëndrime do të mbajë. Në qoftë se mban qëndrim intransigjent, atëherë do të kemi të tjera gjëra me rusët në Evropë; po të bëhet qole i sovjetikëve, prapë do të zhvillohen situata të reja në këtë kontinent.

Detyra jonë është të punojmë e të luftojmë për forcimin e pozitave të atdheut tonë. Për këtë qëllim, të mobilizojmë forcat për realizimin e planeve, të punojmë për ngritjen e ndërgjegjes politike dhe ideologjike të masave, për të arritur me suksese sa më të mëdha në Kongresin e 6-të të Partisë me detyra e plane të realizuara. Kurse në drejtim të politikës së jashtme të forcojmë përherë e më tepër vigjilencën kundër të gjitha manovrave të armiqve tanë dhe të përpinqemi çdo ditë për rritjen e aftësisë mbrojtëse të atdheut.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtim, në librin
Enver Hoxha, "Raporte e
fjalime 1970-1971", Tiranë.*

1972, f. 300

Botohet i plotë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NË ÇERDIE E NË KOPSHTE FËMIJËT RRITEN TË SHËNDETSHËM E TË LUMTUR

*Nga bisedat e zhvilluara gjatë vizitave në Lagjen e Re¹
të qytetit të Elbasanit*

8 maj 1971

Gjatë qëndrimit në Elbasan, shoku Enver Hoxha vizitoi Lagjen e Re, të ndërtuar me punë vullnetare brenda një kohe të shkurtër. Në fillim ai u ndal për të parë kinemanë, klubin dhe bibliotekën e lagjes së spondërtuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë e bukur qenka, është sallë e madhe dhe e ajrosur.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU²: Kjo, shoku Enver, është ndërtuar brenda një kohe shumë të shkurtër; u deshën vetëm dy muaj për ngritjen e saj.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë bukur! Këto janë më të mira nga të vjetrat. Vlora, për shembull, ka mbetur akoma me atë kinema që ka pasur përpëra.

Edhe klubi qenka i bukur.

1. Më vonë kësaj lagjeje iu dha emri «Vullnetari».

2. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Kjo është biblioteka e lagjes. Shoqja që punon këtu është arsimtare.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Arsimtari është i përshtatshëm për një punë të tillë. Ju uroj suksese në punë, shoqe!

Biblioteka është e mirë, e ajrosur, me drithë. Besoj se ngrohje keni që të vijnë këtu për të lexuar literaturë shkencore, shoqërore, artistike e politike.

Shumë mirë! Ju uroj suksese të mëtejshme në punë, shëndet dhe mirupafshim!

Duke iu drejtuar banorëve të Lagjes së Re që kishin dalë për ta pritur, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ju jeni të gjithë banorë të Lagjes së Re. Shikoni çfarë bën Partia, shikoni ç'bëhet kur puna organizohet si duhet! Brenda një kohe të shkurtër këtu u ngrit një lagje e tërë dhe 620 familje hynë në shtëpitë e reja; u sistemuan kështu gati 3 000 veta. Paçi jetë të lumtur e të gjuar!¹

Në lagjen tuaj tanë i keni të gjitha: kinema, klub, bibliotekë, shkollë, çerdhe, kopsht etj. Shtëpitë i keni me drithë e me ujë brenda. Çdo gjë që i duhet njeriut e keni. Të rrojë Partia!

Pastaj shoku Enver shkoi për vizitë në kopshtin e fëmijëve nr.12.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se ju gjej! Si jeni shoqë arsimtare? Fëmijët i keni nga familje të reja, shkollat të reja, kopshtet të reja. Këtu gjithçka është e re. Si shkon, si janë fëmijët?

1. Banorët e lagjes i uruan shokut Enver: «Marrsh nga kilitët tonas».

SHOQJA ATLIJE BAJOTI¹: Mirë janë të gjithë. Vazhdimisht po na vijnë fëmijë dhe ne jemi të gatshme t'i presim dhe të kujdesemi për ta.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa djem dhe vajza keni në kopshë?

SHOQJA ATLIJE BAJOTI: Kemi më shumë djem, kurse vajza më pak.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse ndodh kjo? Mos vallë nga kujdesi i veçantë që tregohet për djemitë?

SHOQJA ATLIJE BAJOTI: Ne, duke u bazuar në lindjet, mendojmë se kështu ka takuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Në bazë të lindjeve natyrale të ne më shumë ka djem sesa vajza.

Si bëhet pagesa?

SHOQJA ATLIJE BAJOTI: Pagesa bëhet në bazë të të ardhurave të prindërve. Pavarësisht nga pagesa, kujdesi është njëlloj për të gjithë.

Shoku Enver takohet me fëmijët, i përgëzon, i puth dhe që andej shkon në kuzhinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë u keni bërë sot për drékë fëmijëve?

SHOQJA NIQI JANKU²: Kemi mish pule, supë me lëngun e pulës dhe byrek me vezë e djathë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga je ti?

SHOQJA NIQI JANKU: Jam nga Përmeti.

SHOKU ENVER HOXHA: Përmetaret janë shumë të paqme, të zhvilluara dhe nikoqire, ashtu si edhe elbasanaset. Në përgjithësi përmetaret, lunxhiotet e

1. Drejtore e kopshët.

2. Kuzhinieria e kopshët.

të tjera, janë pastërtore të mëdha. Edhe ju këtu ju uroj për punën tuaj të pastër, sepse pastërtia ka rëndësi të madhe, në radhë të parë për shëndetin e fëmijëve.

Që këtej shoku Enver shkon në grupin e dytë të fëmijëve të kopshtit, të cilët po vizatonin një shtëpi.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa të bukur e keni bërrë shtëpinë! Ju po ndërtoni kështu kopshtin e ri, pallatet e reja. O, sa të bukura! Dale ta shikoj një çikë xhaxhi Enveri si e ke vizatuar shtëpinë ti. Si të quajnë ty? (*Rudina¹, përgjigjet vajza.*) U, dale Rudina, ta vizatojmë bashkë, ja këtu është çatia, kjo tjetra është dera, pastaj penxherja. Tash të bëjmë edhe një pemë këtu jashitë, të bëjmë manin, dhe një kumbull. Këtu lart të bëjmë oxhakun, tymin që del nga oxhaku dhe më tej rrugën e re.

Si të quajnë ty?

FËMIJA: Tomor².

SHOKU ENVER HOXHA: O, ti qenke Tomori! Më kanë folur për ty, por tani që të pashë, u kënaqa shumë.

Ju shoqë edukatore shumë mirë e keni bërë ambientin, të pastër e të bukur. Ju uroj që kështu t'i keni ngahera. Tani mirupafshim fëmijë!

FËMIJËT: Mirupafshim! O, iku xhaxhi Enveri!

SHOKU ENVER HOXHA: Do të vijë prapë xhaxhi Enveri dhe atëherë t'i keni nbaruar pallatet, të keni ngrënë drekën, se tetat ju kanë bërë gjellë të

1. Rudina Myslimi.

2. Tomor Sharra.

mirë, supë, mish puqe dhe byrek. Këtu ju bëjnë nga të gjitha gjërat, ashtu siç ju bëjnë edhe në shtëpi, bille këtu është më mirë.

Pastaj shoku Enver vizitoi grupin e madh të kopshtit. Fëmijët, të veshur pastër e bukur, e pritën me duartrokositje ardhjen e tij. Shoku Enver puthi e përqasoi disa nga fëmijët, pastaj u ul për të parë programin e përgatitur prej tyre. Njëri nga fëmijët reciton vjershë për xhaxhin Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë e the vjershën! Të lumtë! Kush tjetër do të na thotë një vjershë?

Fëmijët recituan njëri pas tjetrit. Pastaj radha i erdhi zezakut të vogël nga Kongoja. Pasi recitoi vjershën, shoku Enver e përqasoi atë, e puthi, e mbajti në prehër dhe i tha:

SHOKU ENVER HOXHA: Mos e harro këtë, vogëlush! Këtu të gjithë njerëzit janë të mirë, prandaj ti je si në shtëpinë tënde. Të gjithë ju kongolezët jeni si në shtëpinë tuaj.

Di të flasësh frëngjisht?

FËMIJA: Jo, nuk di frëngjisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Shqipen veç e slet shumë mirë, e slet më mirë nga të gjithë. Kur të rritesh, do të shkosh në shkollë, do të kesh mundësi të vazhdosh dhe universitetin. Çfarë dëshiron të bëhesh?

FËMIJA: Do të bëhem ushtar.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, ushtar, të bëhesh edhe oficer, çfarë të duash ti të bëhesh.

Shoku Enver Hoxha, i përcjellë nga duartrokositjet dhe brohoritjet e fëmijëve të kopshtit, vajti në çer-

dhen e re, ku, duke përqafuar e përkëdhelur fëmijët, ndërmjet të tjerash tha:

O sa të bukura i keni këto përparëse, të pastra dhe të qëndisura me lule e qershi, sa të bukura! Kjo pastërti që po shoh këtu është një gjë e mirë. Pastërtia ka rëndësi të madhe, sidomos për kalamanët.

Kur hapëm çerdhet, në fillim, ata që s'e kuptonin rëndësinë e madhe të tyre thoshin se ne «u rrëmbiyem nënave fëmijët». Kështu na akuzonin ne, komunistët, edhe gjatë kohës së luftës. Por, shikoni tani sa të lumtur, të shëndetshëm, të pastër e të gëzuar rriten fëmijët në çerdhe!

Në sa kohë vijnë mëmat e tyre këtu, për t'u dhënë të vegjelje të pijnë?

SHOQJA MEREME DYRMISHI¹: Vijnë çdo tri orë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku punojnë më shumë ato?

SHOQJA MEREME DYRMISHI: Në kombinat.

SHOKU ENVER HOXHA: Me se vijnë këtu, në këmbë?

SHOQJA MEREME DYRMISHI: Po.

SHOKU ENVER HOXHA: Si mund të arrijnë? Ato kështu humbasin edhe shumë kohë, meqë është larg.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Disa nga nënët bëjnë një gabim: vijnë e u japin fëmijëve pür të pirë pas 6 orëve. Bile, ato janë të kënaqura t'i lënë fëmijët këtu dhe në atë triorësh t'ua zëvendësojnë gjirin me ushqim.

1. Kujdestare e çerdhes.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, kjo është gabim. Ju duhet ta organizoni punën në mënyrë të tillë që të vihet në dispozicion, në orar të caktuar, një makinë, për të marrë nënrat nga kombinati dhe pér t'i sjellë këtu. Makina të presë në oborr 15-25 minuta, aq kohë sa u duhet nënave pér t'u dhënë fëmijëve të pijnë dhe pas kësaj, menjëherë, pa humbur kohë, të nisen në punë. Në asnjë mënyrë nuk duhen lënë fëmijët pa pirë. Kjo punë duhet të përfundojë sa më parë. Më mirë të mbeten ca prodhimi, sesa të mbeten kalamanët pa pirë. Vetëm se nënrat duhet të bëhen të ndërgjegjshme edhe pér punën, të vijnë, t'u japin fëmijëve të pijnë dhe të kthehen shpejt ku i pret autobusi.

Ngrohjen me se e bëni këtu?

SHOQJA MEREME DYRMISHI: Me stufa.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa komuniste jeni këtu?

SHOQJA MEREME DYRMISHI: Tri.

SHOKU ENVER HOXHA: Më pëlqeu shumë kjo ndërtesë. Ju uroj nga zemra pér irregullin dhe pastërtinë. Vazhdoni kështu se shëndeti i kalamanëve është më e rëndësishmja. Fëmijët mbi të gjitha. Është e lumtur nëna që dërgon foshnjën në çerdhe, se këtu ushqehet mirë, mbahet pastër dhe rritet i shëndetshëm.

*Botohen pér herë të parë, sipas
shënimive të mbajtura në këto takime, që gjenden në AQP*

ASHTU SI NJERIU QË NUK MUND TË RROJË PA BUKË, EDHE EKONOMIA NUK MUND TË RROJË PA HEKUR

*Fjala në mitingun spontan me banorët e Lagjes së Re
në Elbasan*

8 maj 1971

Në një shesh të Lagjes së Re ishin grumbulluar disa qindra banorë, të cilëve shoku Enver iu drejtua me këtë fjalim të shkurtër:

Jam shumë i lumtur dhe i gjëzuar që n'u dha rasti të vij këtu, për të parë Lagjen tuaj të Re.

Shokët e Komitetit të Partisë dhe të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Elbasanit, dhe në mënyrë të veçantë shoku Jashar [Menzelxhiu], si dhe shokë të tjerë që kanë kaluar në qytetin tuaj, më kanë folur për punën e madhe, të palodhur e këmbëngulëse që keni bërë në këtë lagje ju, banorët e Elbasanit, sidomos gratë. Por, që të bindet më mirë dhe plotësisht njjeriu për të gjitha sa dëgjon, duhet t'i shikojë edhe vetë me sy. Kështu, me ardhjen këtu, edhe për vete u binda për sa kisha dëgjuar, pse pashë me sy diçka të bukur që meriton me të vërtetë për

t'u lavdëruar dhe ju them plot gojën: Ju lumshin duart!

Gëzimi i Partisë dhe personalisht imi është shumë i madh, kur shohim që ju rroni të lumtur e të gëzuar në apartamentet e reja, komode e plot dritë që keni ndërtuar vetë me kontribut vullnetar. Partia dhe populli ynë, duke përgjithësuar përvojën e punës së madhe që është bërë për ndërtimin e kësaj lagjeje, po luftojnë tash që brenda një kohe sa më të shkurtër, familjet e vendit tonë që akoma nuk janë sistemuar, të strehohen në banesa të reja. Dhe ne do ta realizojmë me siguri këtë detyrë, se kemi udhëheqjen e drejtë të Partisë, vullnetin e madh dhe forcën e popullit, të grave, burrave dhe rinisë sonë heroike.

Në këtë lagje të re, më pëlqyen në mënyrë të vecantë çerdhja dhe kopshti, pse janë ndërtuar me një arkitekturë të përshtatshme dhe me të gjitha ambientet që duhen për plotësimin e nevojave të fëmijëve. U gëzova shumë sidomos kur pashë kalamanë aq të shëndetshëm, të qeshur, të lumtur dhe të rrëthuar nga një kujdes e pastërti shembullore. Edhe gatimi në ku-zhinën që vizitova, m'u duk i mirë, i pasur, me assortimente të shumëlojshme ushqimesh që në shtëpitë tona është vështirë t'i gjesh. Partia përpinqet që kalamanët të ushqehen mirë, të janë të pastër e të shëndetshëm, të lumtur e të gëzuar dhe të edukuar me mësimet e saj, që, kur të rriten, të bëhen ushtarë të denjë e besnikë të atdheut tonë socialist.

Cerdhe e kopshte janë hapur kudo në vendin tonë, megjithatë si numër ato janë akoma të pamjaftueshme. Për t'i plotësuar të gjitha nevojat për të tilla in-

stitucione, në të ardhmen, do të ndërtojmë të tjera, akoma më shumë, pse shteti ynë, çdo vit që kalon, bëhet më i pasur e më i fuqishëm. Kështu që edhe kujdesi për kalamanët, për gjithë brezin e ri të vendit tonë, do të jetë gjithnjë e më i madh.

Partia na mëson të tregojmë kujdes të veçantë sidomos për gratë dhe vajzat. Ato duhet t'i nderojmë e t'i respektojmë të gjithë, në punë dhe në jetë, në shoqëri dhe sidomos brenda në ambientin familjar. Të jemi me to të dashur e të sjellshëm, të kemi besimtë madh ndaj tyre. Ne burrat duhet të jemi të qartë se nuk qëndrojmë më lart se gratë, nuk kemi as dituri e as zotësi më shumë se ato. Natyrisht flas në përgjithësi, pse ka edhe gra me aftësi të kusizuara ashtu sikundër ka edhe burra të tillë. Kjo do të thotë se, në përgjithësi, të dyja palët jemi njëloj, prandaj Partia jetën e ka ndërtuar në mënyrë të atillë që pozitat në shoqëri, të burrave dhe të grave, të jenë të barabarta, me qëllim që të gjithë së bashku t'i përvishemi punës për ndërtimin e socializmit, të marrim pjesë aktivisht në çdo vepër, në çdo aksion, në shkolla, në fabrika, në ara, që jeta shpirtërore dhc materiale e mbarë popullit të zbukurohet, të bëhet qëdo vit e më e këndshme, më e lumtur dhe më e begatshme.

Veçanërisht ju, banorët e Elbasanit, ashtu si gjithë populli shqiptar, gjatë këtij pesëvjeçari do tëjeni dëshmitarë të një transformimi të dukshëm të qytetit tuaj, i cili do të bëhet qendra më e madhe e industrisë së rëndë e të gjithë Shqipërisë. Këtu do të ndërtohet kombinati i parë në rrëthin tuaj që do të jetë njëkohësisht edhe më i madhi i vendit tonë, ai i metalur-

gjisë së hekurit, që është ushqimi kryesor për industrinë e çdo vendi. Ashtu si njeriu që nuk mund të rrojë pa bukë, edhe ekonomia nuk mund të rrojë pa hekur. Të gjitha fabrikat, makineritë, automobilat, traktorët, ndërtesat e çdo objekt tjeter që ju shikoni në të katër anët e atdheut, janë ndërtuar edhe me hekur e çelik që tash jemi të detyruar t'i blejmë, t'i sjellim nga jashtë. Por, në sajë të udhëheqjes së ndritur dhe largpamëse të Partisë, në sajë të zgjuarsisë, këmbënguljes dhe shpirtit revolucionar të të gjitha masave tona punonjëse ne kemi çelur hap pas hapi miniera të reja, i kemi zhvilluar ato dhe tash ekonominë e kemi mëkëmbur në një nivel të tillë, saqë jemi në gjendje të ndërtojmë kombinatin e madh të Elbasanit, kolosin e industrisë sonë të rëndë. Ai do t'i japë gjithë vendit në sasi të mëdha prodhime hekuri, gize e çeliqe të llojeve nga më të ndryshmet dhe të një cilësie të lartë. Ky kombinat do të plotësojë nevojat tona të shumta dhe të ngutshme për industrinë mekanike, për vegla ndërrimi të të gjitha makinerive që kemi; ai do të na japë mundësi të krijojmë me kohë edhe industrinë tonë të ndërtimit të makinave dhe, në këtë mënyrë, të zgjidhim problemin e ngritjes në vend të një sërë fabrikash, të cilat deri më sot i kemi importuar. Me gjithë kapacitetin e tij të madh, prodhimet e kombinatit që do të ngrihet në qytetin tuaj nuk do të mund të plotësojnë të gjitha nevojat që do të ketë Shqipëria për çeliqe në një të ardhme të mëvonshme. Prandaj, në pesëvjeçarët e tjerë, ne do të ngremë të tjera kombinate si ky, i cili do të bëhet atëherë «kombinati mëmë», do të jetë tamam si nëna, së cilës na-

tyra i ka falur meritën e madhe të vazhdimësisë së jetës mbi tokë. Kombinati metalurgjik i Elbasanit do të ketë, në perspektivë, bija dhe bij të vet, në të katër anët e Shqipërisë, që do të plotësojnë, me prodhimet e tyre, nevojat e shumta gjithnjë në rritje të industrije së vendit tonë, duke furnizuar rregullisht e pandërprerje uzinat mekanike, që po shtohen gjithashtu nga viti në vit në gjithë Shqipërinë.

Natyrisht, për t'u realizuar kjo vepër kaq e rëndësishme, kërkohet një punë e madhe dhe e lavdishme, kërkohen përpjekje e sakrifica, vullnet e vendosmëri, si dhe një organizim sa më i përsosur, cilësi këto që juve nuk ju mungojnë dhe i keni vënë në çdo moment në shërbim të socializmit. Për ndërtimin e kësaj vepre madhështore në Elbasan do të vijnë me mijëra punëtorë nga të katër anët e atdheut. Për ta dhe përlëvizjen e gjithë materialeve e makinerive të shumta, do të duhen ndërtesa banimi, transport i madh hekurudhor e automobilistik, vende për çlodhjen dhe argëtimin e punëtorëve në kohën e lirë e shumë objekte të tjera plotësuese. Prandaj janë planifikuar të ndërtohen rrugë të reja, linja autobusi, kinema, teatro etj. Elbasani do të bëhet kështu, së shpejti, një qytet i madh industrial, qendra më e rëndësishme metalurgjike e vendit.

Por, veç këtij kombinati për zhvillimin e ekonomisë, do të ndërtohen edhe vepra të tjera të rëndësishme kudo në vendin tonë. Të gjitha këto do të bëhen pa lënë mënjanë bujqësinë. Në pesëvjeçarin që porsa filluam, do ta vazhdojmë punën për modernizimin e bujqësisë sonë socialiste me një ritëm akoma

më të madh. Këtë do ta intensifikojmë në mënyrë që të mos mbetet prapa e të jetë në gjendje të furnizojet popullin çdo vit e më mirë me drithëra, perime, fruta, prodhime blegtorale etj. Megjithatë, ne nuk do ta pengojmë industrinë të ecë më përpara; ritmet e zhvillimit të saj do t'ua kalojnë atyre të zhvillimit të bujqësisë dhe kjo është e drejtë. Për këtë ndiejmë gëzim e kënaqësi të madhe të gjithë ne, pse kështu do të rritet me shpejtësi begatia dhe fuqia mbrojtëse e atdheut.

Prandaj të törë t'i përvishemi punës me të gjitha energjitet e të jemi gati për luftën e madhe që do të bëjmë për ndërtimin e këtij kombinati, ashtu siç duhet t'i përvishemi punës me të gjitha forcat dhe me hovin revolucionar që karakterizon Partinë dhe popullin tonë për të marrë prodhime me rendimente të larta dhe të një cilësie të mirë në bujqësi.

Partia jonë, e udhëhequr kurdoherë nga mësimet e marksizëm-leninizmit, në politikën e saj të drejtë ka pasur kurdoherë parasysh forcimin e lidhjeve ndërmjet qytetit dhe fshatit, klasës punëtore dhe fshatarësisë. Gjithë veprinatarinë e jetës sonë e drejton Partia. Ajo është kudo dhe lufton që fryma revolucionare e klasës punëtore të përshkojë edhe jetën e kooperativave bujqësore, të fshatit tonë të ri. Prandaj ne, punonjësit e qytetit, të mobilizohemi në të gjitha drejtimet për të realizuar me sukses detyrat që na ka caktuar Partia, të bëjmë përpjekje për të tejkaluar të gjitha planet (dhe këtë e them sepse në Elbasan ka disa ndërmarrje që janë deficitare në këtë drejtim), sepse kështu do të jemi në gjendje të ndihmojmë

zhvillimin me ritme më të shpejta të fshatit tonë të ri.

Qëllimi i vizitës sime ishte për të parë sukseset që ka arritur populli i Elbasanit nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, por njëkohësisht edhe për të diskutuar me shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit tuaj rreth të metave që ekzistojnë e për të gjetur rrugët e mundësitë për likuidimin e tyre. Për këto çështje unë bisedova me shokët drejtues të rrethit, prandaj nuk kam ndër mend t'i përsëris këtu. Gjatë këtyre bisedimeve mësova se te ju ka shumë gjëra të mira, për të cilat ju lavdërova, por, nga ana tjetër, kritikova për disa të meta që vihen re akoma.

Përpara, kur ndonjëri punonte i shtyrë nga frika, pleqtë fetarë thoshin: «frika ka dalë nga xheneti». Tash që na udhëheq Partia dhe na edukon me ideologjinë e saj, frikën e kemi shporrur. Për edukimin e njerëzve përdorim kritikën se e dimë që është një gjë e mirë. Është një armë në duart e popullit, që e korrigjon dhe e shëron njeriun që gabon, ashtu siç vepron ilaçi mbi të sëmuran; prandaj atë duhet ta praktikojmë pa hezitim kudo ku ka gabime. Të gjithë atyre që nuk kryejnë detyrën, «t'u heqim veshin» dhe ata ta pranojnë kritikën me zemër të hapët. Prandaj tanë me të drejtë mund të themi se «kritika ka dalë nga Partia».

Por, të kemi kujdes që kritika të jetë kurdoherë e drejtë, parimore, e argumentuar, me baza të shëndosha, të mos jetë e shpifur dhe e nisur nga qëllimi të këqija, për të diskredituar një person, për të ulur, nga smira. Nderin e zotësinë e tij etj. Atë që nuk e bën kritikën mbi këtë bazë, populli ta vërë me shpatulla pas murit. Ai që ka bërë një saj, duhet ta pranojë kri-

tikën, të analizojë të metat në personin e tij, të gjejë shkakun dhe të bëjë autokritikë se kjo është rruga e shërimit më të mirë për të. Ndërsa ai që me kritikën e tij mbron interesat e socializmit e të popullit, mbron me gjakftohtësi dhe me fakte të drejtën e tij ose të shokut, të nderohet e të respektohet nga të gjithë. Kështu duhet të veprojnë të tërë, po sidomos komunistët. Kjo e bën unitetin e popullit me Partinë e tij të çeliktë.

Me një unitet të tillë të pathyeshëm Parti-popull, edhe armiqtë më të fortë, të çfarëdo kallëpi që të jenë, kapitalistë apo revisionistë, s'kanë ç'të na bëjnë. Pikërisht se kemi punuar kurdoherë kështu, se kemi folur gju më gju me popullin, se i kemi hapur zemrën dhe i kemi thënë atij të mirat dhe të këqijat, dobësitë dhe sukseset e punës sonë, për këtë është forcuar dhe është bërë si shkëmb graniti Republika Popullore e Shqipërisë. Kjo e ka bërë këtë që të respektohet në mbarë botën nga miqtë, që na duan, dhe nga armiqtë, që nuk na duan. Këta tashmë e kanë të qartë se me Shqipërinë «nuk duhen zënë qetë» se është një shtet që thotë kurdoherë të drejtën dhe nuk ngurron të demaskojë pa hezitim çdo akt në dëm të lirisë e pavarësisë së popujve, të çlirimt të tyre kombëtar e shoqëror, në dëm të revolucionit. Shqipëria sot është zëri i së vërtetës në botë, i pëlqen a s'i pëlqen ndonjërit, i madh a i vogël qoftë ai, asaj aq i bën. Ajo nuk do t'ia dijë fare nga askush, po çan përparrë në rrugën e saj të drejtë marksiste-leniniste.

Forca e madhe e mbrojtjes të së vërtetës, që ekziston te populli ynë, besimi e dashuria që ka krijuar

Partia te njerëzit tanë dhe kudo për drejtësinë që mbron, kanë bërë jehonë të madhe ndërkombëtare. Ky besim e kjo dashuri rriten çdo ditë e më shumë edhe në botën e jashtme. Së fundi, edhe ata që nuk na duan, kanë filluar të kuptojnë se ky popull i vogël, që udhëhiqet e frymëzohet nga një Parti kaq e drejtë dhe e papërkulur, që flet me guxim e s'i trembet syri nga revizionistët sovjetikë, nga imperialistët amerikanë e kushdo tjetër qoftë, në asnjë mënyrë nuk është frikaman. Përkundrazi, ai është i fortë e trim dhe po i del zot vendit të vet, prandaj duhet respektuar e duhet dëgjuar zëri i tij, pavarësisht se nuk janë dakord me rrugën që ndjek ai.

Të gjithë mësuat nga shtypi lajmin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis vendit tonë dhe Greqisë. Republika Popullore e Shqipërisë ka qenë dakord për t'i lidhur këto marrëdhënie që kurse lindi si shtet i lirë dhe sovran, por ishin të tjerë ata që vunë pengesa në këtë drejtim me pretendimet e tyre absurde. Nuk ishte asnjë arsy që ne të ishim «në gjendje lufte» me grekët; argumentet që nxirreshin ishin pa baza, se ne nuk kemi luftuar kurrë kundër Greqisë. Përkundrazi, ishte Italia fashiste ajo që, pasi ishte okupuar edhe Shqipërinë, të cilën u përpoq ta bënte urë kalimi, u hodh këtej për të okupuar edhe Greqinë. Shqiptarët e sabotuan agresionin fashist italian kundër Greqisë¹. I tillë është realiteti në këtë çështje.

1. Duke bërë fjalë për sabotimin që i bëri populli shqiptar këtij agresioni kundër Greqisë, në librin «Kur lindi

Më së fundi, mbasi i sqaruam që të mos kenë asnje iluzion për politikën tonë të drejtë dhe konsekutive, ne iu përgjigjëm atyre pozitivisht, se jemi dakord të lidhim marrëdhënie diplomatike në rang ambasade e të zhvillojmë edhe marrëdhënie tregtare. Dhe kështu u bë. Ja, çfarë arriti qëndrimi i drejtë, parimor e konsekuent i popullit shqiptar dhe i Partisë së Punës të Shqipërisë! Dhe tash, nëpër botë, flitet nga të katër anët për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Greqisë e Shqipërisë. Ka edhe që s'na duan, flasin keq për Shqipërinë, prandaj ta shtojmë sa më shumë vigjilencën, të forcojmë unitetin popull-Parti-pushtet, të mbrojmë Republikën tonë Popullore, të mbrojmë socializmin dhe çdo gjë të shenjtë të popullit, i cili, me duart e veta dhe me të gjitha forcat përpinqet të ndërtojë një ekonomi të fuqishme, një industri moderne dhe bujqësi të përparuar, që jetat e tij të bëhet gjithnjë më e mirë dhe më e lumtur. Krahas këtyre, të ndjekim njëkohësisht shkollat, të zhvilllohem nga pikëpamja arsimore-kulturore, me qëllim që, kudo ku punojmë, të nxjerrim nga duart prodhime me vlerë për popullin dhe për tregun e jashtëm, pse duke rritur vazhdimisht eksportin, ne do t'i sjellim të ardhura gjithnjë e më të mëdha ekonomisë sonë.

Partia» shoku Enver Hoxha ndër të tjera shkruan: «...populli shqiptar jo vetëm e priti me indinjatë e urrejtje të pakufishme agresionin e ri të fashistëve kundër popullit grek, por dhe ata pak ushtarë shqiptarë që u çuan nën forcën e bajonetave në front, nuk zbrazënasnje pushkë kundër vellezërve grekë, përkundrazi, ose ua kthyen pushkët agresorëve fashistë, ose dezertuan në masë».

Në këtë mënyrë, Republika Popullore e Shqipërisë do të forcohet dhe do të përballojë me sukses çdo pengesë e vështirësi që do të na krijojnë armiqëtë.

Rroftë Partia!

Mbetshi me shëndet, shoqe dhe shokë të dashur të Elbasanit!

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimeve të mbajtura në
këtë takim, që gjenden në AQP*

KUR KALON MOSHA, KEMI EDHE MË SHUME MALL PËR VENDLINDJEN

*Nga bisedat në familjen e shokut Jashar Menzelxhiu
si dhe në atë të shokut Jorgji Xhufka*

8 maj 1971

Pasi përshëndetet me pjesëtarët e familjes, shoku Enver Hoxha zhvilloi me ta një bisedë të përzemërt:

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni me shëndet? Fëmijët si janë? Ti vetë si ke qenë tani¹? Ke vajtur tani shpejt andej nga Peshkopia? Nga Nexhmija ke shumë të fala.

Nga je ti²?

ILIRIANA: Jam nga Dibra.

SHOKU ENVER HOXHA: Po të isha unë në vendin tënd, do të thosha që jam nga Elbasani...

Po ju³ si jeni? Si shkoni në fakultet? Jeni të kë-naqur nga pedagogët?

1. I drejtohet Margaritës, gruas së Jashar Menzelxhiut.

2. Pyet vajzën, Ilirianën.

3. I drejtohet djalit, Agronit.

AGRONI: Mirë jemi, tekste kemi, të gjitha të mirat i kemi.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë gjuhe të huaj di?

AGRONI: Di rusisht dhe tani po mësoj frëngjisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Rusishten po se po që duhet ta mësosh mirë, por edhe frëngjishten e anglishten duhet t'i mësosh. Gjuhët e huaja na duhen, sidomos kur dërgojmë njerëzit tanë jashtë, në konferanca ndërkontaktare. Atje, po nuk zotërove një nga gjuhët më të përhapura në botë, nuk di çfarë të bësh. Gjuha e huaj nuk mund të mësohet brenda tre muajsh. Kur vete jashtë për specializim 3 ose 6 muaj nuk duhet të mendosh se do ta mësosh atje gjuhën e vendit. Përkundrazi, atje ke vajtur për të marrë njohuri të posaçme e të thelluara në një degë të shkencës a të teknikës ose për të fituar shprehi të veçanta në një mjeshtëri, prandaj gjuha duhet të jetë mësuar qysh më parë. Unë kam tërë jetën që e njoh frëngjishten dhe, kur vjen puna që flet ndonjë profesor, duhet të vë shumë kujdes. Në gjuhë të huaj ka materiale të shumta, ka literaturë që flasin për shpikje të mëdha, prandaj njerëzit tanë, që t'ia dalin në shkencë, duhet të dinë dhe gjuhë të huaja. Po mësove frëngjishten do të mësosh lehtë edhe italishten.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Disa herë fëmijët tanë nuk i kanë vënë shumë rëndësi gjuhës së huaj. Edhe vetë shkollat e mesme kanë akoma shumë mangësi në këtë drejtim.

SHOKU ENVER HOXHA: Kohët e fundit, mësimit të gjuhës së huaj po i kushtohet më shumë vëmendje dhe të rinjtë po mësojnë më mirë, se e shikoj-

në që pa të nuk mund t'i shfrytëzojnë dot librat. Mua më thonë se te ne vijnë shumë libra të huaj. Prandaj ne duhet, medoemos, të marrim masa për vendet ku duhen mbajtur librat dhe ku duhet bërë manipulimi i tyre. Vendosja e tyre duhet rregulluar në mënyrë sistematike që, kur të kërkosh atë libër që do, të të vijë brenda pak minutash, dhe jo pas disa orësh.

Duke biseduar për daljen e njerëzve në pension, shoku Enver Hoxha tha:

Ka njerëz, për shembull, mjekë, që edhe pasi dalin në pension, mund të mbahen në punë. Flas për mjekë të aftë, që kanë eksperiencë, si Dr. Hoxha, Ndroqi e të tjerë. Për kuadro të këtij kalibri ne kemi shumë nevojë, prandaj këtyre mund t'u pakësohen orët e punës e të aktivizohen; prej tyre do të përfitojnë edhe mjekët e tjerë.

Pastaj shoku Enver Hoxha, pasi vlerësoi disa tradita të mira të Elbasanit e të Dibrës për gatimin e gjellëve tha:

Për gatimin e gjellëve çdo rreth ka traditat e tij. Elbasani njihet sidomos për tavën e kosit dhe ballakumet, kurse Dibra për hallvën dhe birjanin; birjanin e gatuan mirë edhe Gjirokastra.

Muhabeti na pëlqen, por mua më duhet të iki, se dua të bëj edhe disa vizita të tjera.

Mirupafshim e qofshi mirë!

Në vazhdim shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në familjen e shokut Jorgji Xhufka, në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit. Pasi u përshëndet me të pranishmit, shoku Enver Hoxha zhvilloi me ta një bisedë të ngrohtë:

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se ju gjetëm. Si jeni me shëndet? Po ju nga jeni¹?

SHOQJA MARTA XHUFKA: Nga Gjirokastra, nga Selcka.

SHOKU ENVER HOXHA: O, qenkemi nga një anë. Vendlindja është e dashur, por kur kalon mosha kemi edhe më shumë mall për të. Në fshatin tuaj, në Selckë, njerëzit kanë qenë të varfër, shumë të varfër. Stegopuli ka qenë pak më mirë se Selcka, ku vetëm gurë e strall ka. Keni qenë andej tanë?

SHOQJA MARTA XHUFKA: Që në vitin 1942 kam ikur andej, por nuk kam shkuar më.

Pastaj biseda vazhdoi për bujqësinë. Shoku Enver foli për rëndësinë që i duhet dhënë kultivimit të duhanit, pse Elbasani ka kushte të përshtatshme, sidomos Dumreja. Duke folur për këtë bimë sugjeroi për të rritur rendimentin dhe cilësinë e duhanit, i cili ka mjaft leverdi ekonomike, theksoi punën e madhe që bëjnë sidomos gratë në bujqësi.

Në përfundim shoku Enver Hoxha tha:

Faleminderit për pritjen. Bëra disa vizita në Elbasan, që do të jenë të paharruara për mua.

Qofshi mirë e mirupafshim!

Pasi doli në fotografi me pjesëtarët e familjes shoku Enver Hoxha ndahet ngrohtësisht me ta.

Botohen për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këto takime, që gjenden në AQP

1. I drejtobet Martës, gruas së shokut Jorgji Xhufka.

NJERËZIT QË ECIN NË RRUGËN E PARTISË JANË TË PAHARRUAR NGA POPULLI

*Nga biseda në familjen e komunistit veteran
Todi Naska*

8 maj 1971

Në shtëpi shoku Enver Hoxha u takua me motrën e Todit dhe me fëmijët e tij. Pasi u përshëndet me të gjithë, në fillim ai ngushëlloi pjesëtarët e familjes:

SHOKU ENVER HOXHA: Ju shëndoshë! T'ju rrojnë fëmijët! Të rrojë Partia! Të ndiqni rrugën e Partisë, të babait, të vëllait tuaj që kanë luftuar trimërisht dhe dhanë jetën për Partinë. Më erdhi shumë keq kur dëgjova për Tordin që vdiq, pse vërtet ishte i kaluar në moshë, por mund të rronte akoma edhe ca.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Vuajti një muaj. Ishte komunist me partishmëri të madhe.

SHOKU ENVER HOXHA: Todi ishte një shok i vjetër i Partisë. Njerëz të tillë që e kryejnë detyrën në rrugën e Partisë janë të paharruar nga populli. Pasardhësit do t'i kujtojnë kurdoherë me respekt jo vetëm njerëzit që derdhën gjakun në luftën për çlirim, po edhe ata që dolën gjallë prej saj dhe iu futën

luftës tjetër për ndërtimin e vendit, po aq e zorshme dhe e madhe sa edhe ajo për çlirim. Një nga këta ishte dhe shoku Todi. Por ai u nda prej nesh shumë i kënaqur e i gjuar, se la plot vajza dhe djem të lumtur e të gjuar, njerëz të pushtetit e të Partisë.

SHOQJA KRISTINA LAÇKA¹: Faleminderit, të rrojë Partia! Të rroni Ju!

Pastaj shoku Enver i pyeti të gjithë me radhë se ku punonin dhe me se merreshin. Përgjigjet e tyre ishin nga më të ndryshmet: «në arsim», «në bujqësi», «në ushtri», «jam elektriciste», «jam mësues», «punoj në filial, këtu në Elbasan», «jam inxhinier» etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Profesioni i mësuesit është një nga punët më të rëndësishme e më të respektueshme që mund të bëhet, pse ka të bëjë me fillimin e zgjimit të njeriut, me hedhjen e bazave të edukatës te fëmijët në shkolla.

Sot pamë me shokët e rrethit shtëpitë e reja në Lagjen e Re. U lumtë elbasanasve, sidomos grave, se ato kanë punuar më shumë!

Qoftë i paharruar kujtimi i Todit dhe «kyç e liga në familjen tuaj», siç themi ne nga Gjirokastra. Të rroni ju të gjithë!

PJESËTARËT E FAMILJES: Faleminderit, të rrojë Partia dhe Ju shoku Enver!

SHOKU ENVER HOXHA: Po ju², ku jeni, në Elbasan?

SHOKU SIMON NASKA: Jam në Tiranë.

1. Motra e veteranit Todi Naska.

2. I drejtohet djalit oficer.

SHOKU ENVER HOXHA: E kemi të fortë ushtrinë, se dhe ushtria është e fortë kur është populli i fortë. Djemtë që kemi në ushtri janë djem të zotë e të mësuar. Për çdo të keqe që mund të vijë nga armiqjtë imperialistë, socialimperialistë e të tjerë ne jemi të përgatitur e të armatosur mirë. Kurdoherë duhet të jemi në gatishmëri të plotë. Neve nuk na lejohet të flemë. Armiku nuk duhet të na zërë asnjëherë në gjumë, ndaj të qëndrojnë zgjuar dhe të përgatitemi çdo ditë për mbrojtje.

Kam ardhur edhe një herë tjetër këtu. Ja, mu atje rrinin edhe plaku e plaka. Ishin njerëz të mirë s'aumë. Sa vjeç ishte Todi?

SHOQJA KRISTINA LAÇKA: 79. Për të u tregua kujdes i veçantë nga të gjithë, por e mposhti sëmundja.

SHOKU ENVER HOXHA: Në luftë bashkë keni qenë me Kozmanë¹? Po kur u vra bashkë ishit?

SHOKU SIMON NASKA: Ishim në një krahinë. Operacionin e dimrit e kaluam bashkë. Pastaj ai u vra në fshatin Brar të Tiranës. Atë ditë u vranë 10 veta.

SHOKU ENVER HOXHA: Zotrote sa fëmijë ke?

SHOQJA KRISTINA LAÇKA: Kam tre djem dhe tri vajza.

SHOKU ENVER HOXHA: Të të rrojnë!

SHOQJA KRISTINA LAÇKA: Ashtu bënim ne, përpara, nga shumë fëmijë.

1. Kozma Naska — dëshmor i Luftës Nacionalçlirimitare, Hero i Popullit.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë bënët, megjithëse atëherë ishin kohë të vështira për nënët.

SHOQJA KRISTINA LAÇKA: Edhe për burrat, edhe për gratë ishin kohë të vështira. Burrat punonin jashtë, gratë në shtëpi.

SHOKU ENVER HOXHA: Për të gjithë popullin ishte vështirë, por sidomos për gratë.

SHOQJA KRISTINA LAÇKA: Tani, po të vdesë nëna ose babai, fëmijët nuk mbeten rrugëve, sepse për ta mendon Partia. Ata kanë pension, kurse përpara ishte krejt ndryshe.

SHOKU ENVER HOXHA: Tani punojmë që të rrojimë të gjithë sa më mirë, që të përmirësohet jeta e tërë njerëzve tanë, që ata të kenë shkolla, shtëpi e të ardhura sa më të mëdha.

Meqë e do zakoni që të pi kafe, atëherë do ta pi, por pa sheqer. Për të mirë e në gjëzime!

Tani do të më falni se erdhi koha që të ndahemi. Por para se të largohem le të bëjmë një fotografë të gjithë, siç jemi.

Botohet për herë të parë, sipas shënimave të mbajtura në kë-të takim, që gjenden në AQP

EDHE KËSHTU SÎÇ JE, PA SY, E NDIHMON PARTINË

Nga biseda në familjen e nënë Hatixhe Ekmekçiut¹

8 maj 1971

Megjithëse plakë dhe e rënë fort nga shëndeti, nënë Hatixheja e priti te porta shokun Enver Hoxha, e rrrethuar nga të afërmit e saj. Ndonëse nuk shihte nga sytë, ajo e ndjeu kur po afrohej udhëheqësi i dashur i Partisë e i popullit tonë e, gjithë emocion, iu hodh atij në qafë dhe e përqafroi. Shoku Enver, duke e zënë për krahun, hyri në shtëpi së bashku me të.

SHOKU ENVER HOXHA: Si je me shëndet, nënë Hatixhe? Si i ke pasur gjithë këta fëmijë? Nga Nexhmija ke shumë të fala.

NËNË HATIXHEJA: Me shëndet mirë kam qenë, vetëm se humba dritën e syve. Por nuk më vjen keq për këtë, po më shumë që lashë punën.

SHOKU ENVER HOXHA: Je parë te doktori dhe ç'të ka thënë?

1. Agitatore dhe propagandiste e ideve të Partisë, bashkëshortja e patriotit Fetah Ekmekçi.

SHOKU PETRIT EKMEKÇIU¹: Është parë, e kanga pleqëria, ka sklerozën.

NËNË HATIXHEJA: Të na rrosh Ti shoku Enver, të na rrojë Partia!

SHOKU ENVER HOXHA: Më dallon mua po të mos flas?

NËNË HATIXHEJA: Jo, po të mos flasësh nuk të dalloj dot.

SHOKU ENVER HOXHA: Nënë Hatixhenë e kemi pasur aktiviste të dalluar. Ajo ka qenë punëtore e palodhur. Edhe në këtë moshë që është ajo thotë se nuk i vjen keq që u verbua, por se la punën.

Për të mirë e në gjëzime!

NËNË HATIXHEJA: Mirë se na erdhët, të të rrojnë Nexhmija, çunat, goca. M'u bë shumë qejfi që erdhe.

SHOKU ENVER HOXHA: Si nuk do të vija?! Llaf është ky? Sa erdha, pyeta për ty.

NËNË HATIXHEJA: Tu bëftë dita një mijë!

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit. Të rrojë Partia! Vuan nëna nga ndonjë gjë tjetër veç syve?

SHOKU PETRIT EKMEKÇIU: Jo, nuk vuan nga asgjë tjetër. Doktori thotë me e shëtitë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk kemi çfarë tu bëjmë syve përderisa u bënë të gjitha përpjekjet. Puna është të jesh mirë me shëndet, të rrosh sa më shumë. Prandaj shëtitjen që të ka këshilluar doktori, ta bësh, pavarësisht nga sytë, duhet të lëvizësh nga pak, duke të mbajtur dikush për krahu.

1. Një nga të afërmit e familjes së nënë Hatixhesë.

NËNË HATIXHEJA: Po, po, të gjithë më mbajnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzimi im është që të pashë ty, nënë Hatixhe. Sa herë të tjera do të takohemi bashkë përsëri! Nga nëntori do të bëhet kongresi i Partisë dhe ti do të vish në Tiranë, do të takohesh edhe me Nexhmijen në shtëpi. Bile, vetë Nexhmija do të vijë këtu të të takojë. Prandaj mos u bëj merak! Këto gjëra ndodhin në jetë, prandaj të bësh zemrën të gjerë. Po veshët si i ke?

NËNË HATIXHEJA: Veshët i kam mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Të kam sjellë një radio dore që ta hapësh sa herë të duash, dhe librin e «Historisë së Partisë të Punës të Shqipërisë»¹. Kështu do ta ndjesh më pak edhe mungesën e syve.

SHOKU PETRIT EKMEKÇIU: Ky libër do të jetë një kujtim i madh pér ne, pér gjithë jetën.

SHOKU ENVER HOXHA: Të punoni mirë, ta doni nënë Hatixhenë me gjithë zemër se ju ka rritur, ju ka edukuar. Të na rrush sa më shumë nënë Hatixhe, se edhe kështu sic je, pa sy, e ndihmon Partinë.

NËNË HATIXHEJA: Edhe kështu sic jam nuk rri, bëj ndonjë gjë, dal andej-këtej.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë bën. Këto shoqet mirë janë?

1. Shoku Enver i shpjegon nënë Hatixhesë si ta hapë dhe ta mbyllë vetë radion. E prekur shumë nga këto dhurata nënë Hatixheja i uron përsëri shokut Enver t'i bëhet dita një mijë që i do të gjithë fort. Në librin e «Historisë së Partisë të Punës të Shqipërisë» shoku Enver kishte lënë këtë mbiishkrim: «Nënë Hatixhesë, luftëtare e vendosur në rrugën e Partisë. Kujtim nga Enveri. 8.5.1971».

NËNË HATIXHEJA: Kjo është kunata ime. Sot që na erdhe Ti, u gjallëruam të gjithë, u përtëritëm edhe një herë.

SHOKU ENVER HOXHA: Përnjëherësh të erdhi humbja e të parit apo avash-avash?

NËNË HATIXHEJA: Avash-avash më erdhi. Po s'ka gjë, të na rrosh Ti! Një ditë, një mijë t'u bëftë!

SHOKU ENVER HOXHA: Këtu në Elbasan do të bëjmë akoma gjëra të tjera të mira. Do të marrim edhe ty që t'i shikosh, se ti do të rrosh edhe shumë e shumë vjet të tjera. Kur t'i inaugurojmë do të të marrim nga krahu e do të themi: «Këtu është një fabrikë, këtu është një tjetër!». Do të dëgjosh zhurma të mëdha dhe do t'i parafytyrosh të gjitha me mendje, kombinatin metalurgjik që do të jetë më i madhi i të gjithëve në Shqipëri. Do të t'i shpjegojmë një e nga një dhe ti do të marrësh me mend çdo gjë. Së shpejti do të hapim hekurudhë të re këtej nga Elbasani dhe tash po e çojmë në Librazhd. Do të të marrim dhe ty kur të niset treni për atje. Kur të futemi në tunel do të të themi se këtu, tash është errësirë. Megjithëse është errësirë, do të punojnë edhe atje, ashtu siç punove ti gjithë jetën tënde për Partinë.

NËNË HATIXHEJA: Ti i ke bërë këto, Ti me shokë, mendja jote, puna jote.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti do të na rrosh dhe shumë vjet të tjerë.

NËNË HATIXHEJA: Unë boll kam rrojtur, tani nuk dua ma.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk do ti që të rrosh, po duam ne e dhe njerëzit e tu të shtëpisë.

NËNË HATIXHEJA: Ty të të bëhet dita një mijë!

SHOKU ENVER HOXHA: Të rrojë Partia, të rroni ju!

Shoku Enver u largua i përcjellë me dashuri e ngrohtësi nga nënë Hatixheja dhe të afërmit e saj.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në kë-të takim, që gjenden në AQP

VULLNETI I ÇELIKTË E BËN NJERIUN TË DOBISHËM

*Nga biseda në familjen e Heroit të Punës Socialiste
Nuredin Hoxha*

8 maj 1971

Për të pritur shokun Enver Hoxha kishte dalë para pallatit vetë Nuredini me të shoqen dhe vajzën. Pasi takohet e përqasohet me ta, kapur krah për krah me Nuredinin, shoku Enver Hoxha ngjit shkallët e pallatit dhe hyn në shtëpinë e tij.

SHOKU ENVER HOXHA: Jam shumë i gëzuar që erdha për një vizitë në shtëpinë tuaj. Kam dashur t'ju shikoja ju, prandaj thashë: dale të vete njëherë edhe në shtëpinë e Nuredinit.

SHOKU NUREDIN HOXHA: Faleminderit shumë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jeni mirë këtu?

SHOKU NUREDIN HOXHA: Mirë, faleminderit, siç e shikoni.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti, shoqe, ku punon?

SHOQJA ALEM SHA HOXHA¹: Në çerdhen e Laggjes së Re.

1. Bashkëshortja e shokut Nuredin Hoxha.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë bukur, është çerdhe shumë e mirë. T'i mbajmë të pastra ashtu siç i pashë sot. Edhe ushqimin fëmijët e kanë aty shumë të mirë. U fola pak shokëve që ishin mbledhur në Lagjen e Re që të punojnë e të kujdesen të gjithë për kalamanët.

Ju kush jeni?

SHOQJA ILMIJE TOPI: Unë jam motra e Nuredinit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, dukeni, ngjisni ca me njëri-tjetrin.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Shoku Enver, për nc edhe gruaja e Nuredinit ka treguar një akt heroik, sepse ajo, megjithëqë Nuredini ishte pa këmbë, e dashuroi dhe vendosi të martohej me të në atë gjendje. Dhe u martuan.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa fëmijë keni?

E SHOQJA E NUREDINIT: Deri tani vetëm këtë vajzë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, se do të bëni edhe të tjerë.

Gëzuar, të rrojë Partia, të rroni ju! Jetë të lumbtur! Për shëndetin tuaj!

Vullneti i madh e ka bërë Nuredinin që, megjithëse pa këmbë, të ecë njëlloj si një njeri që i ka këmbët. Ai jo vetëm punon, po është nga ata që punojnë më mirë, është njeri i çeliktë, komunist i vendosur. Vullneti i tij i çeliktë e bën atë njeri të dobishëm.

SHOKU NUREDIN HOXHA: Faleminderit shumë, por Partia më bëri të tillë, ajo më dha e më jep

kurajë. E çfarë do të isha unë pa Partinë? Asgjë! Prandaj Partisë ia detyroj unë të gjitha.

SHOKU ENVER HOXHA: Do të ishte një fatkeqësi e madhe për popullin, në rast se nuk do të ishte Partia. Po të mos luftohej në vendin tonë nën udhëheqjen e Partisë këtu do të sundonte çizmja e huaj, njerëzit do të ishin të mjeruar. Por armiqtë askush nuk do t'i linte rehat; populli do t'u bënte gjëmën, ashtu siç ua ka bërë gjithmonë pushtuesve.

Thonë se sivjet agrumet do të kenë prodhim të mirë, edhe portokallet, edhe limonat. Puna është që, kur agrumet janë në lule, të mos bjerë shi.

Isha pak edhe te nënë Hatixheja. Ka qenë një agitatore e mirë, ju e njihni vetë.

Këtu pranë është shkolla, keni rininë afër.

SHOKU NUREDIN HOXHA: Nxënësit e shkollës po e ndërtojnë vetë konviktin, ndaj dhe ka shumë gjallëri.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Aty jashtë është edhe vetë drejtori i shkollës së mesme pedagogjike «Luigj Gurakuqi», Vasil Kamami. Ta thérresim të vijë?

SHOKU ENVER HOXHA: Posi, të vijë!

Si shkon Nuredini në punë, apo vjen autobusi deri këtu?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Nuredinit i kemi dhënë një motoçikletë.

Ndërkohë vjen drejtori i shkollës pedagogjike, Heroi i Punës Socialiste, Vasil Kamami, me të cilin shoku Enver përqafohet ngrohtësisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Bëre shumë mirë që erdhe këtu për t'u takuar. Pamë konviktin që ndërtohet dhe Jashari më tha që po e bëni vetë. Është një iniciativë e mirë që po e ndërtoni me forcat tuaja.

SHOKU VASIL KAMAMI: Nuk është vetëm puna jonë, se na kanë ndihmuar edhe shokët e tjerë, sidomos ata të transportit.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht që do t'ju ndihmonin, sepse nxënësit e kanë kohën të planëzuar dhe nuk ia dilnin dot vetëm.

Para se të largohej shoku Enver i dhuroi Nuredinit një libër të «Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë» me këtë mbishkrim: «Shokut heroik, Nuredin Hoxhës, me kujtimet e mia më të mira, me rastin e vizitës që i bëra në familjen e tij. Enver. Elbasan 8 maj 1971».

Botohet për herë të parë sipas shënimave të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

TE RRITIM MEKANIZIMIN E PROCESEVE TE PUNES NE NDERTIM, NE BUJQESI DHE KUDO

Nga biseda me disa shokë të Qeverisë¹

17 maj 1971

Sot do të diskutojmë së bashku relationet e paraqitura nga Komisioni i Planit të Shtetit për investimet dhe ndërtimet në pesëvjeçarin e pestë, për rendimentin e punës dhe bilancin e krahëve të punës. Këto probleme janë të lidhura me njëri-tjetrin, prandaj këtu do të shkëmbejmë disa mendime dhe sugjerime për të bërë edhe ndonjë shtesë po të jetë e mundur.

Më duket se ky material i paraqet të gjitha investimet të shprehura në lekë. Këtu janë cilësuar sidomos investimet kryesore si për metalurgjinë, për hidrocentralin e Fierzës, për rafinerinë e Ballshit, për bujqësinë dhe për banesat, kurse investimet e tjera janë shprehur në shuma të përgjithshme, pa emërtim. Investimet të specifikuara me emërtim do t'i

1. Ky takim u zhvillua rrëth disa problemeve të planit të pestë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës në vendin tonë (1971-1975).

shikojmë më gjërë kur të marrim në shqyrtim projektplanin. Tash, në këtë periudhë, këto materiale janë të mjaftueshme, sepse japid shumat më të mëdha të investimeve që kërkohen për planin, pra si të thuash paraqesin pjesën më të madhe të kostos të tij. Në qoftë se shokët kanë për të svaruar ndonjë gjë, ose kanë për të bërë ndonjë pyetje, mund të flasin.

Unë së pari, dua të di sa është vlera e makinerive në veçanti dhe sa është ajo e montimeve? Me shpenzime montimi kam parasysh të hollat që nevojiten për bashkimin e pjesëve përbërëse të makinerisë për ta ngritur në këmbë atë dhe për ta vënë në gjenjë funksionimi.

Për disa gjëra mund të ndalemi më hollësisht edhe në mbledhjen tjetër, sepse mund të ketë vështirësi për t'i svaruar qysh tanë.

Natyrisht, ju jeni përpjekur që të ulen shpenzimet, më duket 5 për qind. Në projektplan, për ndërtimet, sigurisht, ju jeni nisur për thjeshtime të mëtejshme, gjë që do ta vëmë si detyrë edhe në të ardhmen, por unë dua të pyes nëse ulja e shpenzimeve është pasur parasysh vetëm në projektim, apo edhe në ndërtim? A shikohet detyra e uljes së kostos në montim, apo kjo punë llogaritet me ato të dhënët arkaike të kohës kur kishim një numër të kufizuar montatorësh, disa prej të cilëve të pastërvitit mirë dhe kur niveli i organizimit s'ka qenë në shkallën e sotme? Mund të jetë vënë ujët në zjarr edhe për uljen e kostos së montimeve, por çështja është që në këtë drejtim të bëhet një luftë e madhe dhe të arrihet në një minimum të shtrënguar.

Një ditë, kërkova një informacion për shpenzimet që kemi bërë për të blerë nga jashtë makineritë për veprat që po vihen në shfrytëzim me vonesa të mëdha. Për këto vepra kaq të mëdha ne do të mobili zojmë shumë njerëz e fonde, po përse të harxhohet një kohë kaq e gjatë edhe për veprat e vogla, që mund të bëhen me një shpejtësi shumë të madhe, përt'i futur në shfrytëzim sa më parë? Mua më duket se nuk është e drejtë që veprat e vogla të zvarriten kështu. Po kur të vijmë te veprat e mëdha si do të bëjmë? Do të jetë me pasoja të rënda pastaj, në qoftë se ne nuk i llogaritim gjërat shtrënguar sipas detyrave që kemi caktuar.

Disa faktorë që u numëruan këtu dhe që ndikojnë në rritjen e rendimentit, ne duhet medoemos t'i parashikojmë mirë dhe detyrat e vëna t'i zbatojmë. Por, unë mendoj se njëfarë fluktuationi i krahut të punës në sektorin e ndërtimit megjithatë do të ekzistojë, prandaj përqindjet që vihen të mos i marrim në mënyrë absolute; ato nuk duhet të janë kategorike, sepse lëvizje do të ketë, pasi shumë punëtorë, për arsyet e ndryshme, do të venë e do të vijnë. Veçanërisht duhet të bëjmë kujdes për të mënjanuar ato të meta që burojnë nga shkaqe subjektive, siç janë dobësitë në organizimin e punës etj. Ndodh që punëtori vete në fshat ku ka familjen dhe kthehet në punë me dy ditë vonesë, se i sëmuret një pjesëtar i familjes, ose shkon për arsyet e tjera dhe nuk kthehet në kohën e caktuar etj. Çështja është që ta organizojmë punën në mënyrë të atillë që, sa të jetë e mundur, të ulim fluktuationin e fuqisë punëtore.

Ne duhet të synojmë më tepër, bile sa të jetë e mundur më shumë, për rritjen e mekanizimeve. Dhe të mekanizojmë jo vetëm proceset që kërkojnë mekanizime të mëdha, por t'i kushtojmë kujdes dhe të kemi në rendin e ditës edhe mekanizimin e thjeshtë, me qëllim që të kapërcejmë vështirësitë që do të na dalin për krahët e punës. Ne do t'u themi, për shembull, rretheve të Kukësit, të Tropojës etj. që të na nxjerrin kaq ose aq punëtorë, por të tëra këto llogari nuk do të na dalin kurdoherë siç duam ne. Kur t'i themi, bie fjala, rrethit të Korçës që krahët e tepërt të punës do t'i nisni për në hidrocentralin e Fierzës, kjo nuk është një fjalë që mund të zbatohet fare lehtë, se shokët e Korçës ndoshta nuk do të jenë në gjendje ta nisin përnjëherë tërë numrin e punëtorëve që do t'u kërkojmë ne, por me ca vonesë dhe pak si me zor, ngaqë do të shohin edhe nevojat e rrethit të tyre. Duke u nisur nga të gjitha këto penge-sa del detyra e domosdoshme e rritjes së mekanizimit.

Po të marrim parasysh edhe anën subjektive e psikologjike të njerëzve, si dhe nevojat e bujqësisë, nxjerrim në pah edhe kërkesën për një disiplinë të fortë në punë nga klasa punëtore etj. Mbi të gjitha, siç thashë, lypset mekanizim, prandaj nuk duhet të mbështetemi vetëm në numrin e punëtorëve. Duhet të bëjmë sa të jetë e mundur më shumë që puna e njeriut të zëvendësohet me punën e mekanizuar. Kjo, nga ana tjetër, kërkon edhe drejtim e organizim të mirë të punës.

Kur flasim për organizimin e punës në ndërtimin e veprave të pesëvjeçarit duhet të mendojmë edhe për mekanizimin. Ato punë e procese «të vogla», që

duken sikur nuk kanë rëndësi, janë voluminoze dhe harxhojnë fuqinë punëtore. Ne do t'i kryejmë me siguri më shpejt dhe më lirë ndërtimet e mëdha, në qoftë se u japim rëndësi edhe gjërave «të vogla», si transportimit të zhavorit me karrot e dorës e jo me tezgë, ose proceseve të tjera të punës që lypin një mekanizim të thjeshtë dhe që, me këtë rrugë, mund të kursejmë punën e 5-10 punëtorëve. Pra, kërkon që të prodhojmë shumë pajisje në seri për punën në ndërtim.

Por kjo gjë duhet parë edhe për bujqësinë, pasi edhe këtu ka shumë punime ku mund të zëvendësohet krahu i punës me mekanizma të vegjël. Për të zgjidhur këto probleme nuk është ndonjë punë e madhe. Po t'i quajmë edhe këto probleme të mëdha e të pa-zgjidhshme, atëherë punët nuk do të ecin kurrë me atë ritëm të shpejtë që kërkon Partia.

Vërejtjet që po bëj unë lidhur me investimet, kanë karakter të përgjithshëm, se në detaje dhe në shifra nuk do të futem. Mendimi im është që ky projektplan për sa u përket investimeve dhe në vëçanti për ndërtime e montime, për shpime, kërkime etj. është shumë i madh për pesëvjeçarin e pestë. Sigurisht, nuk do të bëhen shkurtime të veprave të mëdha e që janë kyç, por as në ndërmarrje të tjera industriale që i kemi në plan dhe që shërbejnë për zhvillimin e prodhimit e të forcave prodhuase. Në këto, si kudo, mund të bëjmë thjeshtime, po jo eliminime. Shkurtime, ekonomizime, duhet të bëhen në të gjitha drejtimet, në të gjitha fazat, në kosto etj. Por në radhë të parë shikojmë se ku mund të shkurtojmë në veprat që janë më pak të rëndësishme. Veç-

se shkurtimet në investime të mos i bëjmë në mes të punës, por t'i parashikojmë më drejt që në fillim, sepse në këtë drejtim eksperiencia na ka mësuar mjaft gjëra. Që të parashikojmë më drejt duhet të ndajmë mirë dëshirat nga mundësitë tona reale. Në qoftë se nuk vëmë një kufi të saktë midis dëshirave dhe mundësive, atëherë do të gabojmë. Perspektiva i janë hapur shumë vendit tonë, por ne duhet të shikojmë sa janë mundësitë për plotësimin e dëshirave dhe të kërkuesave tona. Dëshirat, për të cilat nuk janë mundësítë të realizohen tashti, do të plotësohen më vonë, pasi të krijohen mundësitë. Prandaj të kemi parasysh që fondet të mos harxhohen me dorë të lëshuar. Për shembull, në qoftë se do të bëjmë në veprat e reja banesa për punëtorët, ato t'i bëjmë të thjeshta dhe me kosto të ulët.

Ne duhet të jemi më të ndërgjegjshëm për kapacitetet e ekonomisë sonë, dhe mendoj se duhet t'i llogaritim mirë ato që të mos na ngjasin gjëra të papritura, të rrezikshme për vendin tonë, qoftë nga ana ekonomike, qoftë edhe nga ana politike.

Ne e bëjmë planin duke u mbështetur në forcën ekonomike të vendit dhe në punën e madhe të mësave të popullit, të punonjësve dhe të kuadrove, të cilët jepin mendimet e tyre shumë të vlefshme. Por ka mjaft kuadro dhe punonjës në bazë dhe në qendër, bille edhe këtu te ne lart, ku nganjëherë aprovojen detyra dhe kërkesa të tepruara¹, pa u vënë fre dëshirave edhe kur këto nuk përpushten me mundësitë. Në

1. Kështu vepronin armiqjtë e kamufluar Mehmet Shehu, Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi, që me këto praktika anti-

këtë të metë mund të ndikojë edhe mënyra e propagandimit jo të mirë që bëhet për këto probleme, gjë që ka sjellë si pasojë mungesën e një edukimi të plotë të masave punonjëse që, për çdo gjë që kërkojnë dhe për çdo gjë që realizojnë, duhet të bëjnë llogari, jo duke i parë çështjet në kuadrin e ngushtë të sektorit, por shumë më gjerë, duke ndjekur zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Por ka nga ata që nuk gjykojnë si duhet dhe që nuk mendojnë që qysh kur fillohet nga puna për plotësimin e planit, duhet të realizohen shpejt të gjitha ato që vendosen, të rritet rendimenti dhe të merret sa më parë prodhimi. Kështu ka ndodhur me tokat e Hoxharës që janë bonifikuar, por që nuk po shfrytëzohen si duhet nga ana e ndërmarrjeve bujqësore. Për këtë problem me rëndësi, drejtuesit atje nuk po e vënë ujët në zjarr. Po a lejohet një qëndrim i tillë? Nuk lejohet. Ne flasim këtu për këto çështje dhe i ritheksojmë disa herë, por përsëri gjenja vazhdon po ajo për neglizhencë të disa njerëzve të pandërgjegjshëm. Duke marrë parasysh një situatë të tillë, mua më duket që në këtë pesëvjeçar ne duhet të tregojmë kujdes të madh në shumë drejtime.

Më mirë duhet të kontrollojmë që të mos investojmë në ato vepra që duken si linja të reja, por që kushtojnë miliona lekë. Për këto unë mendoj se duhet të jemi jashtëzakonisht rigorozë dhe të lejojmë vetëm ato që kushtojnë lirë, përfundojnë shpejt, kanë efekti-

socialiste përpinqeshin t'i krijonin vështirësi të shumta ekonomisë sonë dhe të sabotonin politikën ekonomike të Partisë.

vitet dhe që futen përnjëherë në prodhim. Lidhur me këto e kemi thënë kaq herë, por nuk po e zbatojmë në praktikë problemin e përqendrimit në ndërtimë dhe mospërhapjen e tyre. Në qoftë se Ministri së Ndërtimit do t'i jepnim të ndërtojë vetëm një fabrikë, sigurisht ajo do ta kishte përfunduar atë dhe fabrika do të ishte në funksionim. Por ne, duke u nisur nga nevojat, i kemi ngarkuar asaj ministrie ndërtimin e disa dhjetëra fabrikave, të cilat i fillojë vetëm pasi u ndërhy nga lart. Gjatë pesëvjeçarit do të vëmë në plan me qindra fabrika të tilla që janë nesatare dhe të nevojshme për ne, se rritin prodhimin. Gjithashu, ne kemi për të ngritur gjithë këto fabrika kaq të mëdha, të cilat, me gjithë investimet që do të na nevojitet të përballojmë, duhet t'i përfundojmë në afat. Por, sipas eksperiencës që kemi, në qoftë se do të përhapemi në ndërtimet, me gjithë masat rigorozë që duhet të marrim për sigurimin nga jashtë të materialeve që lidhen me pajisjet, ne do të kemi një mijë e një pengesa në këto drejtime dhe do të gjejmë vështirësi. Unë këto i shikoj. Pra, me gjithë këto masa që janë marrë dhe do të merren akoma, ne do të kemi edhe vështirësi në realizimin e detyrate të planit, në rast se do të lejojmë të përhapemi njëkohësisht në një mijë e një objekte. Çimenton, për shembull, ne do ta përdorim në objektet kryesore, që nuk duhet të mbeten kurrë pa të. Kjo do të arrihet në qoftë se ne nuk bëjmë më me betonarme një fabrikë vaji, sikurse është bërë ajo e Ndroqit. Në këtë drejtim duhet të hapim sytë për shkurtimin e investimeve në objektet e vogla, por edhe në objektet e

mëdha të ulim shpenzimet në çdo fazë: në projektim, montim dhe ndërtim. Mendoj se ajo ulje investimesh që është caktuar është e paktë; unë jam i bindur për detyrën e domosdoshme të uljes së mëtejshme të tyre.

Ne kemi detyra shumë të mëdha në tri drejtime kryesore: drejtimi i parë janë projektet, i dyti ndërtimet dhe i treti montimet. Për sa u përket ndërtimeve nuk duhet të kënaqemi vetëm me mekanizimet që kemi bërë, por të marrim aktualisht edhe masa të tjera. Unë mendoj që Qeveria duhet ta ketë rezervën e nevojshme, e cila të jetë në sasinë e domosdoshme. Këtë ajo duhet ta ketë jo vetëm për të papriturat që u thanë këtu, por edhe për shumë nevoja të tjera. Nuk e kam fjalën këtu vetëm për makineritë, por edhe për disa gjëra të tjera që lehtësojnë prodhimin dhe ekonomizojnë krahët e punës. Prodhimin e pajisjeve për mekanizim, që është një çështje e madhe dhe urgjente për ne, e kemi lënë në dorën e një ndërmarrjeje. Duhet të planifikojni dhe t'u futemi mirë këtyre gjërvave, që t'i prodrojmë në scri, siç kemi bërë për mjaft vegla pune të bujqësisë; të organizojmë prodhime në seri të disa pajisjeve për mekanizimin e punës në ndërtime, në industri dhe në bujqësi që kërkojnë edhe materiale e lëndë të parë si dru ose hekur, që ne i disponojmë. Këtë anë të problemit mendoj të mos e nënvlerësojmë, sepse unë parashikoj se me gjithë masat që do të marrim dhe me gjithë propagandën që do të bëjmë, do të hasim pengesa të mëdha për krahun e punës. Në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të tërë vendit tonë, të detyrave politike, ekonomike, shoqërore në industri e bujqësi,

kemi dhe detyra në fushën e mbrojtjes, si ndërtimi i ushtarake, përgatitjen ushtarake të studentëve etj. Komisioni i Planit të Shtetit duhet t'i llogaritë të gjitha këto që të krijojnë fondet e nevojshme.

Kam përshtypjen se fondet nën limit janë një lumbi e madhe, e cila është e pakontrollueshme. Këtu nxjerr krye pikërisht megalomania dhe mburrja e disa njerëzve në bazë që kanë dëshirë të kenë në qytetin e tyre, bie fjala, hotel me shumë kate, fabrikë të madhe, të kenë këtë dhe atë, pavarësisht nga mundësítë dhe nevojat tona në shkallë kombëtare. Për këtë arsyre duhet treguar kujdes qysh në fillim, që t'i japid fondet minimale, jo me hamendje, por të llogaritura e të argumentuara mirë dhe për ato gjëra që janë më të nevojshme, që rritin dhe zhvillojnë ekonominë me një rendiment të madh dhe të shpejtë, me qëllim që jo vetëm të mund t'i realizojmë këto objekte në kohë, por edhe t'i futim sa më parë në prodhim apo në shfrytëzim.

Mua më duket se këto rezerva dhe këto mundësi për shkurttime nuk janë marrë seriozisht, ashtu siç nuk është menduar si duhet për mekanizmin e vogël të industrisë apo për mekanizmin e vogël të bujqësisë.

Te ne niveli i jetesës së popullit vjen vazhdëmisht në ngritje. Kjo shtron detyrën që të shtohen prodhimet, gjë që do të arrihet duke prodhuar sipas planit shumë të ngjeshur që kemi bërë. Por ngritja e nivelit të jetesës kërkon që të shohim me kujdes edhe importin. Llogaritë janë bërë një çikë të shtrënguara, por ne duhet të parashikojmë eventualitetin e

situatave dhe të kohëve të vështira, siç mund të jenë, ndoshta, ndonjë rrezik nga jashtë, ose ndonjë kërkesë e re urgjente që mund të dalë etj. Si do të bëjmë po të mos kemi fare rezerva? Të gjitha këto që paraqiten këtu kanë edhe pluse, edhe minuse, prandaj të tëra problemet duhet t'i shikojmë në kompleks. Të kujdesemi sidomos që t'i vëmë në shfrytëzim më shpejt të tëra ato objekte që duhet të viheshin me kohë dhe nuk i kemi vënë; të marrim rendimente sa më të mëdha prej tyre dhe të bëjmë që të na kush-tojnë sa më lirë.

Për sa i përket bujqësisë, unë jam dakord me vërejtjet që u bënë këtu, por kam mendimin të marrim masa që të gjitha ato ndërtime që kemi bërë për kullime, vaditje etj., të na japin të ardhurat e paracaktuara. Jam i mendimit që të mos heqim asgjë nga ato që janë parashikuar për bujqësinë, por kam diçka për ujitjen e zonave malore e kodrinore, si për shembull, për masivin e Vlorës me aftësi ujitjeje të përgjithshme prej 20 000 hektarë, nga të cilët në këtë pesëvjeçar përfitojmë vetëm 4 200 hektarë të vaditur dhe harxhojmë 39 milionë lekë. A ka mundësi që të shpenzojmë më pak dhe të futim në shfrytëzim sa më shpejt 1 000 ose 2 000 hektarë, jo deri në fund të pesëvjeçarit, por më përpara dhe për këtë qëllim të bëjmë në fillim një ose dy rezervuarë për vaditje, pastaj të vazhdojmë me të tjerët? Po kështu edhe në Gjirokastër e në ndonjë rreth tjetër.

Sipas llogarive, përveç mekanizimeve dhe krahëve të punës disa rrethe kanë nevojë edhe për fonde në të holla, për makineri, ndërtime e ujitje, si për

shembull, Tepelena, Kolonja, Pogradeci, Kukësi. Po a mund t'i plotësojmë ne tërë këto nevoja? Për këto çështje kam porositur Qeverinë që t'i shikojë me kujdes, mbasi ne nuk kemi aq mekanizma sa t'i futemi nga të katër anët tërë malësisë dhe të marrim përsipër që tani përmirësimin e tyre. Kur vajta para një viti në Has të Kukësit shokët atje më kërkuan mekanizime dhe ne dërguam përveç mekanizmave të tjerë edhe 20 a 25 traktorë të fuqishëm, por që atje nuk po shfrytëzohen si duhet.

Sa për ujiten përparësi t'i japim ujites së atyre tokave ku mund të vaditim më shpejt e me më pak shpenzime dhe ku mund të marrim rendimente të larëta. Kurse pesëvjeçarin tjetër e shohim përsëri këtë problem.

Ne duhet të mendojmë se, megjithëqë fshatari filloj të bëjë kanalet e dyta, përsëri rendimentet nuk janë të mira. Duhet menduar që fshatit i kërkohet të nxjerrë dhe fuqi punëtore, por t'i qepet edhe bujqësisë ku akoma nuk kemi vënë disiplinën që duhet.

Kur llogaritim sidomos krahët e punës në fshat, duhet të marrim mirë parasysh mekanizmin, se ndryshe ajo punë s'ka leverdi.

Në këtë prizëm, më duket mua, duhet t'i shikojmë këto probleme. Si përfundim, mendoj se të tërë jemi dakord që t'i bëjmë shkurtimet që thashë pak më parë.

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimeve të mbajtura në
këtë takim, që gjenden në AQP*

PROBLEMET E ZHVILLIMIT TË BLEGTORISE ZGJIDHEN ME FRYMË DHE PUNE REVOLUCIONARE

Nga biseda me disa shokë të Qeverisë¹

18 maj 1971

Të metat në sigurimin e bazës ushqimore nuk duhen kaluar lehtë. Po nuk folëm për to s'kemi gjë nö vijë për blegtorianë². Mendimi im është që po nuk ndreqëm të metat në punë, blegtorianë nuk e vëmë dot në rrugë. Po thamë që «përveç të metave që kemi, të cilat njihen» etj., dhe pastaj t'ua kalojmë fajin të tjerëve, përsëri nuk dalim dot në breg.

As ju Mehmet nuk ju lejohet që t'i përdorni rezervat e shtetit sipas qejfit tuaj³. Rregullat e shtetit

1. Në këtë takim u diskutuan relacionet e paraqitura nga Komisioni i Planit të Shtetit, për zhvillimin e blegtorisë në pesëvjeçarin e pestë dhe bazën ushqimore të saj.

2. Në diskutimin e tij Pirro Dodbiba që në fillim tha: «Unë nuk do të flas për të metat e shumta që kemi ne përbazën ushqimore».

3. Me këto fjalë shoku Enver Hoxha i drejtohet Mehmet Shehut, i cili në këtë takim, për t'u dukur se «e hante mëraku» për zhvillimin e mbarë të blegtorisë, i thotë Pirro Dod-

nuk duhet të shkelen nga asnjeri, pra as nga ju, sepse rezervat shtetërore destinohen për një kohë të keqë. Kështu si keni vepruar ju, janë hequr mjaft nga rezervat e shtetit dhe më e keqja është se nuk është kthyer më ajo që është marrë. Po të na vijë një kohë e rrezikshme, do të mbetemi ngushtë, prandaj, për t'i dalë para gjendjes, duhet të merret përgjegjësi dhe të realizohen planet në drithëra, në foragjere dhe në të gjitha sipërfaqet që caktohen. Të gjeni strukturat më të mira të këtyre bimëve, me qëllim që të plotësohen nevojat e blegtorisë. Në qoftë se ju të Ministri-së së Bujqësisë doni që, çdo vit, t'ju japim nga rezervat e shtetit dhe, pasi të hahen këto, të sjellim nga jashtë, e keni shumë gabim. Pse, pa rëndësi ju duket juve, Pirro, që soja, veç ushqimit për blegtorinë, 20 për qind të prodhimit të saj na jep vaj? Ajo ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për shtetin tonë. Ne duhet të nxjerrim vaj edhe nga foragjeret e tjera, bile edhe nga farërat e pemës, po të ketë mundësi.

Për yndyrën, sipas mendimit tim, duhet të marrim edhe masa të tjera, po për këtë do të flasim një çikë edhe më vonë. Atëherë, meqenëse ju kaluat në detaje, unë e shtroj çështjen kështu: Nga lopët e racës që kemi importuar, të marrim 4 000, 4 500 de-

bibës: «Çfarë keni kërkuar, ne jua kemi dhënë», «Edhe kur nuk është realizuar plani, ne kemi hequr për ju nga rezervat». Duke mos i dredhuar dot kritikës së drejtëpërdrejtë që i bëri shoku Enver Hoxha për prekjen e rezervave të shtetit, sabotatori dhe armiku i kamufluar Mehmet Shehu detyrohet të pohojë në këtë takim duke thënë: «Ne kemi shkelur rregullat».

ri në 5 000 litra qumësht siç e keni planifikuar ju, por në bazë të këtij planifikimi do t'ju kërkojmë llogari. Për sa u përket lopëve të tjera të racës «Xhersej» të marrim medoemos 2 500 deri në 3 000 litra qumësht. Sasia e yndyrës 4 për qind, 5 për qind a 6 për qind do të llogaritet veç e veç. E them këtë gjë sepse bëhen hile, pasi ushqinjet i jepen më shumë lopës së racës, kurse të tjerat nuk ushqehen si duhet dhe pastaj mesatarja del 900 litra qumësht. Po t'i bëjmë veç e veç llogaritë, atëherë të shohim sa do të dalë prodhimi i qumështit.

Përse nuk merret rendimenti i planifikuar për qumështin nga lopët, kur këto ushqehen në bazë të normave të parashikuara? A je i bindur ti Pirro që janë bërë për këtë të gjitha përpjekjet e duhura? Si thua që të skartojmë përnjëherësh më tepër bagëti nga sasia që kemi skartuar, pse shkon ti në rrugën më të lehtë? Është e qartë se sa më pak bagëti të kemi, aq më tepër ushqim do të ketë për to. Po neve nuk na intereson të kemi pak bagëti. Akoma ta reduktojmë numrin e krerëve? Po të gjykojmë kështu si gjykonit ju, do të heqim dorë edhe nga struktura e vendosur e mbjelljeve, edhe nga përpjekjet e shumta që duhen bërë për bazën ushqimore. Por ne nuk duhet të heqim dorë nga këto, prandaj duhen bërë përpjekje, duhen arritur rezultatet goftë edhe me mundime.

Ti thua se kjo nuk është e lehtë. Pikërisht pse nuk është e lehtë po bëjmë të gjitha këto përpjekje që të bindim fshatarin, kuadrot, ndërmarrjet bujqësore, kooperativat, ju edhe vetveten se këto realizime që duam, arrihen vetëm me luftë të madhe, sepse

ndryshe nuk bëhet asgjë. Ne jemi të bindur që ky parashikim është i ngjeshur, po si do të dalim nga këto situata pa një luftë të tillë? A ke dijeni ti për tërë planin tonë në vija të përgjithshme dhe pér mënyrën si do të përballohen të gjitha investimet tona?

Ne nuk themi që të vendosim gjëra fantastike, pa një bazë realizimi, por duam të bëhen përpjekje të mëdha. Mund të ketë dhe rreziqe. Ne duhet të përpinqemi të evitojmë ato që mund të evitohen me maksimumin e mundësive tona. Këtu kërkon organizim dhc punë shkencore. Këto kanë shumë rëndësi, por në qoftë se nuk punohet edhe me një frymë revolucionare krijuese pér realizimin e planeve, metodat shkencore, pér të cilat u bë fjalë këtu, nuk mjaf-tojnë dhe këto që themi do të janë muhabete të kota që nuk na japid gjë.

Unë, siç do ta them edhe në Byro kur të vijë rasti, mendoj se nuk kemi bërë sa duhet. Kjo nuk vjen pér arsyen se gjatë dhjetë vjetëve të fundit nuk kemi ditur ose nuk kemi pasur mundësi të mëdha, por se te ne, pér punën në bujqësi, kanë zënë vend disa formula shabllone, nga të cilat po ndahemi me zor. Këtë e tregojnë rezultatet.

Ne mund të themi se ka mundësi të krijojmë rezerva, por projektplani i paraqitur nuk e lejon kri-jimin e këtyre rezervave, ai kërkon të sjellim materiale nga jashtë. Ç'duhet bërë? Vihet detyra të krijojmë rezervat e nevojshme dhe të mos sjellim çdo gjë nga jashtë. Nuk është hera e parë që i ngremë këto gjëra. I kemi diskutuar këto edhe në Byronë Politike, në Kryesinë e Këshillit të Ministrave, në

Sekretariatin e Komitetit Qendror të Partisë, edhe në rrethe e në kooperativa bujqësore, duke i shtruar në detaje aq të holla, sa ndoshta nuk ishte nevoja, po kemi qenë të detyruar të vepronim kështu për të gjetur rrugët për eliminimin e vështirësive që haseshin. Kjo mënyrë e shikimit të problemeve edhe është edhe s'është e mirë; ka anë pozitive, por ka edhe shumë anë negative, për arsy se krijon te përgjegjësit, të cilët kanë për detyrë të thellojnë problemin, një fushë të gjerë për diskutime pa mbarim dhe për shfajësimë të mëdha.

E them këtë se nganjëherë shtrohen çështjet në plan akademik, por në jetë vërehet se qëllimet praktike nuk janë të realizueshme. Nuk është aspak me vend që detyrat e caktuara nga forumet kryesore të humbasin në një det të madh arsyetimesh të stërholluara, në vend që ato të përcaktohen qartë, ashtu siç është vija e Partisë sonë. Këto që them unë nuk ekskludojnë diskutimin e drejtë dhe parimor të problemeve.

Le të marrim, për shembull, bazën ushqimore të blektorisë. Në këtë drejtim është fakt se ju të Ministrisë së Bujqësisë keni mabetur te kashta e misrit, e grurit dhe te jonxha. Po veç këtyre a ka të tjera gjëra për bazën ushqimore? Sigurisht ka, këtu u përmendën një mijë e një gjëra që nuk janë të panjohura. Të tërë shokët folën për shumëlojshmërinë e ushqimeve, shoku Haki përmendi disa barishte që mund të shërbejnë edhe për bazën ushqimore të bagëtisë. A mbillet gjë nga këto për kafshët? Asnjë s'mbillet. Këtu duket se mungon fryma krijuar revolucionare.

Themi shpeshherë se na duhen më shumë hektarë si sipërfaqe, na duhen më shumë krahë pune, na duhet mekanizimi, na duhet kjo, na duhet ajo, pa të cilat nuk plotësohen dot këto detyra, prandaj i jemi qepur kashtës së misrit, të grurit dhe jonxhës. Është e vërtetë se në bazën e ushqimit të bagëtisë është edhe kashta e drithit, por kjo nuk mund të jetë një arsyё që të harrojmë ushqimet e tjera.

Ju thoni tani se lopët duhet të hanë kashtë të grirë. Po kur ju ra në mendje për këtë gjë, që i ngjan vezës së Kolombit? Kur e ditkeni këtë, atëherë përse nuk keni menduar me kohë që të ishin bërë ata mijëra mullinj, që, sipas jush, duhen për këtë punë e ta kishit filluar grirjen e kashtës shumë vjet më parë? Po të ishte punuar kaq vjet me radhë, tani do t'i kishim të gjithë mullinjtë e nevojshëm. Por, duhet thënë se ju keni nënvlerësuar edhe kashtën e zakonshme e prandaj i keni krijuar popullit mungesa në qumësht e në mish. Kështu nënvleftësohen edhe gjëra të tjera e pastaj vini këtu e thoni që do t'i zbatojmë pas pesë vjetëve! Ç'janë këto gjëra kështu?!

Ju thatë se këto çështje i ditkeni, kurse për teknologjinë e fermentimit të kashtës thoni se është një gjë e re. Si zor më duket mua që kjo të jetë një gjë e re. Në botë ekziston prej kohësh teoria e fermentimit. Të tjerët e vrashin mendjen dhe e bëjnë fermentimin e kashtës, kurse njerëzit tanë nuk i ha aq shumë meraku për këtë problem. Dhe tani na kërkoni të shkoni jashtë, ta shikoni si bëhet e pastaj të presim dhe ca vjet të tjerë derisa ta filloni ta zbatoni. Duhet të dalim nga këto situata, shokë, duhet të luf-

tojmë. Mua më duhen këtu sa më pak teorira, dhe gjërat që njihen t'i zbatojmë sa më parë në praktikë, sepse punët në bujqësi nuk po ju ecin aspak mirë. E them këtë se ti, si ministër, për gjëra që janë të njoitura e bile shumë të përparuara, na nxjerr plot teori-
ra, në një kohë kur neve na duhet punë dhe jo llafc.

Ju thoni që misrit i bëni vetëm një prashitje, pasi katër nuk i bëni dot. Pse nuk e bëni prashitjen me kultivatorë? Përse nuk janë prodhuar këta, se kemi kaq vjet që po flasim për ta? Ku do t'i gjejmë gjithë këta njerëz që duhen për prashitje? Si është e mundur që në ndërmarrjet bujqësore jeni keq për një prashitje, kurse kooperativistëve u kërkojmë t'i bëjnë dy e më tepër prashitje misrit? Përse nuk përdoren mekanizmat që kanë ndërmarrjet bujqësore? Pse nuk e keni mekanizuar prashitjen? Pa këtë mekanizim nuk mund të merret rendimenti që kërkohet në misër. Mendimi juaj që në misër hibrid të merret në ndërmarrjet bujqësore 40 kuintalë për hektar nuk është i drejtë. Byroja Politike nuk do ta pranojë këtë. Duhet luftuar për më shumë se 40 kuintalë, bile për 70 kuintalë për hektar, sepse ndërmarrjet bujqësore kanë dhe ujë. Ka kooperativa bujqësore që marrin më shumë.

A do të vazhdojmë akoma të zbatojmë në mënyrë kaq shabllone dhe pa e zbërthyer si duhet direktivën e madhe të Partisë për zgjidhjen e problemeve të bujqësisë? Mua më duket se Ministria e Bujqësisë ka një përgjegjësi të madhe përpara Partisë për mbarëvajtjen e bujqësisë. Unë e ngre si problem fryshtë jo sa duhet revolucionare që ekziston te drejtuesit e sek-

torit të bujqësisë, sepse zbatimi i vendimeve të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Qeverisë në përgjithësi, nuk është i plotë dhe i përpiktë. Prandaj nga kjo anë duhet të mobilizojmë tërë Partinë. Ministria e Bujqësisë, si organi shtetëror që merret kryesisht me këtë punë, të mos i zbatojë këto vendime në mënyrë shabllone, por gjatë vënies së tyre në jetë të organizojë e të udhëheqë mirë një gamë të madhe iniciativash krijuese që të na realizohen të tëra planet e bujqësisë. Ne mbajmë këtë qëndrim sepse shikojmë që besimi te kuadrot drejtues të ministrisë nuk ekziston dhe situata në bujqësi nuk është revolucionarizuar sikundër kërkon Partia.

Edhe problemi i mekanizimeve është çështje kryesore. Traktoret, kombajnat, makinat korrëse etj., që i kemi sjellë nga jashtë me një mijë mundime, duhet të jenë të gjitha në gatishmëri për punë. Të tjerat që mund t'i bëjmë këtu dhe që janë kaq të domosdoshme, gjithashtu duhet të jenë në gjendje të mirë funksionimi. Por zhvillimi i bujqësisë nuk merr fund me këto makina. Ne vazhdimisht po e ngremë çështjen që jemi prapa edhe në drejtime të tjera, pse na mungon një agroteknikë e përparuar, e ngritur dhe e mekanizuar. Po nuk zbërthyem mirë direktivat e Partisë, po nuk derdhëm shumë djersë, bujqësia nuk mund të zhvillohet ashtu siç kërkohet. Pse nuk merrn masat e duhura për këto gjëra? Vërtet duhen disa materiale, që nga viti në vit do t'i planifikojmë dhe të arrijmë kështu që, në një kohë të caktuar, të kemi një sasi të mirë, por aktualisht nuk keni siguruar as belat, as shatat nëpër fshatra, ose edhe

ato që keni, janë të konsumuara, pa folur dhe për të tjerat.

Ne e dimë shkakun përsë nuk marrim aq misër sa duhet, por në vend që të merren masa të drejta, kërkohen 2 000 krahë pune më tepër, materiale që sigoohen me devizë etj., në një kohë kur dihet se devizën duhet ta përdorim me kursim. E kemi theksuar vazhdimisht se në tokat që rezervojmë për foragjere duhet të marrim maksimumin e lëndëve ushqimore për blegtorianë. Kush duhet ta zbërthejë këtë porosi të Partisë? Sigurisht Ministria e Bujqësisë. A të ka penguar njeri ty, Pirro Dodbiba që të kërkosh farë panxhari, lulëlakre, patateje të kuqe, patateje të bardhë e të tjera si këto dhe t'i mbjellësh? S'të ka penguar njeri. Si do të dalim nga këto situata që na paraqiten? Mua më duket se nuk është e drejtë një gjë e tillë që t'i lëmë njerëzit që diskutojnë nga ana teorike çdo vendim të udhëheqjes, por në vend të llafeve të bëjnë punë dhe punë intensive. Dua të them me këto që numërova se vendimi i udhëheqjes duhet të zbërthehet, të merren të gjitha masat për zbatimin e tij e pastaj rezultatet do të duken.

Fondet e Ministrisë së Bujqësisë natyrisht nuk janë aq të mëdha sa të notohet në to, por, sipas mendimit tim, janë të mjaftueshme për zhvillimin në tërësi të bujqësisë dhe posaçërisht për zhvillimin e prodhimit që është kryesorja. Fondet që keni për bujqësinë, ju shokët e ministrisë duhet t'i shfrytëzoni sa të jetë e mundur më mirë me synimin që të ndikoni në shtimin e prodhimit dhe në uljen e kostos. Për këtë punë duhen shfrytëzuar me efektivitet edhe ato

drejtime të prodhimit në bujqësi, të cilave shpeshherë nuk u vihet rëndësi dhe që për zhvillimin e tyre pritet të sigurohen fonde të veçanta. Ky nuk është një veprim i rekomandueshëm.

Nga ana juaj të merren masa dhe të bëhen sa më shumë shkurttime e kursime në fondet e akorduarra, të bëhen shtëpi më të thjeshta për punonjësit, por të jenë komode nga brenda, të ngrohta etj. Të ekonomizojmë që të ngrihet prodhimi, se ndryshe nuk realizohen detyrat që na vihen.

Ndërmarrjet bujqësore, kuptohet, duhet të kenë rezultate shumë më të mira në prodhim se kooperativat bujqësore, ato nuk duhet të subvencionohen më nga shteti. Në qoftë se ekzistojnë qoftë edhe dy, tri apo katër ndërmarrje bujqësore që subvencionohen nga shteti dhe dalin me humbje kjo është një e keqe që nuk duhet ta pranojmë, shokë. Ndërmarrjet bujqësore duhet t'ua kalojnë kooperativave dhe të bëhen me të vërtetë shembull në të gjitha drejtimet për arsyen se ato janë në kondita më të mira nga kooperativat. Në qoftë se kryhet kjo detyrë nga personat e ngarkuar, mirë, ndryshe t'i thuhet Komitetit Qendror që të caktojë njerëz të tjerë më të aftë. Tani kërkohet që jo vetëm në ndërmarrjet bujqësore, por edhe në kooperativat bujqësore të forcohet organizimi, sepse këto të fundit çalojnë, në radhë të parë, nga mungesa e organizimit dhe e disiplinës në punë, gjë kjo që sjell mungesën e rezultateve të dëshiruara dhe të planifikuara, sidomos për blegtorinë ku kemi minuse shumë të mëdha.

Ju si ministri keni përgjegjësi bashkë me komi-

tetet ekzekutive të këshillave popullore të rrretheve, të cilat gjithashtu kanë përgjegjësitë e tyre të mëdha. Ministria e Bujqësisë ka përgjegjësinë e saj për të gjitha degët e bujqësisë në tërë republikën; ajo përgjigjet edhe për lopët e ndërmarrjeve bujqësore, për lopët e kooperativave, po edhe për ato të oborreve kooperativiste, prandaj kur duam të ngremë prodhue-shmërinë e tokës, pjellshmërinë e lopëve, të dhenve dhe të dhive, pra prodhimet e gjithë sektorit të bujqësisë, sigurisht ministria është shumë e interesuar, sepse vëtëm me ndërmarrjet bujqësore nuk rrojmë dot.

Për sa i përket mishit të lopës, të viçit etj., mua më duket se akoma nuk i është vënë rëndësia e duhur. Gjer tani kur bëhen skartimet mbahet parasysh vetëm qumështi dhe jo aq mishi. Por majmëria është një faktor që ndikon edhe për qumështin, sepse dihet që një lopë e dobët nuk jep as qumësht. Çështja e majmërisë del sidomos për meshkujt për mish. Me këtë proporcion që vëmë ne këtu nuk llogaritet si duhet majmëria e mishit të gjedhit nga ana e ndërmarrjeve dhe e kooperativave bujqësore. A kemi ne nevojë për mish apo s'kemi? Kemi nevojë për mish dhe kjo mund të përballohej nga gjithë sasia e madhe e lopëve, në qoftë se i ushqejmë ato për majmëri. E kam thënë edhe një herë tjetër që në ushqimin për majmëri dhe për qumësht nuk ka asnë dallim. Por në ndërmarrjet bujqësore dhe në kooperativat, e sidomos në këto të fundit, për sa i përket majmërisë çështja ndiqet shkel e shko. Pra, problemi i majmërisë duhet ta shikojmë seriozisht. Prandaj të luftojmë

fort për një organizim më të mirë, për të shfrytëzuar shumë mundësi që kemi, pa i lënë pasuritë të na shkojnë kot. Të vëmë në zbatim metodat e reja të punës që janë neglizhuar.

Këto që thamë këtu ishin disa gjykime paraprake, por shifrat e paraqitura mund t'i pranojmë.

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimeve të mbajtura në
këtë takim, që gjenden në AQP*

PËR POPULLIN DO TË VIJNË DITË EDHE MË TË LUMTURA

*Nga biseda me komunistin nga Mallakastra
Sulo Mustafai¹*

21 maj 1971

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se më erdhe Xha Sulo! Si të kam me shëndet? Si e kemi Partinë andej nga ana juaj?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Mirë, të gjithë mirë jemi.

SHOKU ENVER HOXHA: U gëzova shumë mbrëmë kur më more në telefon dhe thashë me vete: Sa mirë ia dëgjova zënë xha Sulos! Pastaj mendova: Përse të mos e thërrres, ta shoh e të bisedoj një herë me të? Me shëndet qenke mirë!

Si janë njerëzia nga ju? Me bujqësinë si dukeni?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Sivjet jemi shumë mirë. Kemi mbjellë njëqind hektarë me misër dhe gjer tani bima duket e mbarë. Shpresojmë të kemi prodhime të bollshme.

1. Nga Hekali i Mallakastrës.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Partia gjëzohet kur e kemi mirë bujqësinë.

Si jeni me ullinjtë? Sivjet duket se do të merrni prodhim më të mirë se vitin e kaluar?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Sivjet i kemi mirë ullinjtë. Vitin që kaloi nuk patëm prodhim fare. 76 vjeç u bëra dhe nuk mbaj mend ndonjëherë në historinë e ullinjve të kemi pasur një prodhim aq të varfër si ai i vjetmi.

SHOKU ENVER HOXHA: Ulliri është një bimë që në fazën e zhvillimit të tij ka nevojë për shi. Po sikur të bjerë shi tanë në maj, dëmtohet ai?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Tani nuk ka qeder, edhe sikur të bien shira, sepse lulja ka lidhur kokërr.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë sivjet do të kemi prodhim të bollshëm të ullinjve. Por, po të na bjerë një shi do të bëjë shumë mirë për bujqësinë si për të mbjellat, ashtu edhe për pemët. Frutat u bënë nga ju? Po bajamet si janë? Keni plan për to?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Kemi pak, por nga pemët kryesore te ne është ulliri.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju japid prodhim ullinjtë që janë mbjellë këtu e 10-12 vjet përpara?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Disa prej tyre japid, disa të tjera jo. Kjo varet nga lloji i tokës ku janë mbjellë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa kilogram ullinj jep një rrënë?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Në fillim nga një rrënë arrijmë të marrim 10-20 kilogram.

SHOKU ENVER HOXHA: Po me transportin e brendshëm, xha Sulo, si jeni?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Kooperativa jonë ka tri makina, të cilat na mjaftojnë për të përballuar nevojat e transportit.

SHOKU ENVER HOXHA: Djemtë që i përdorin këto makina i mirëmbajnë ato? Po transportin me qe si e keni?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Mirë e kemi. Me të përballojmë një pjesë të mirë të nevojave të kooperativës.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Për këtë pyes, sepse duke përdorur transportin me qe, grave do t'u krijohen ca kushte lehtësuese për të mos u marrë me punët e rënda të ngarkim-shkarkimit. Kijeni mirë parasysh këtë, ndryshe do t'ju kritikojmë. Domethënë në Mallakastër nuk paska më tërkuzë për gratë.

Po tregtia është organizuar mirë? Janë ngritur dyqanet e bukës në kooperativë?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Po, dyqanet që shesin bukën i kemi të kompletuara. Kemi 6 njësi të tilla, të tëra të vendosura afër shtëpive të kooperativistëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Është e mjaftueshme sasia e bukës që merrni apo ka kërkesa në këtë drejtim?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Është plotësisht e mjaftueshme dhe nuk ka njeri që të qahet.

SHOKU ENVER HOXHA: Po transportin e bukës nga furra deri në dyqanin e shitjes, me se e bëni?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Me karro, ose me kafshë.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, nuk keni pasur ndonjë pengesë. Për mbrujtjen e brumit për bukë rëndësi të madhe kanë mjetet që përdoren. Ju i keni siguruar këto mjete apo jo?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Po, edhe te ne gatimi i bukës bëhet me disa mjete të mekanizuara, jo me dorë si më parë.

SHOKU ENVER HOXHA: Pra, edhe në kooperativën tuaj buka gatuhet në mënyrë të mekanizuar. Kjo ka rëndësi sepse jo vetëm që punohet më lehtë, por edhe cilësia e saj del më e mirë. Kështu zhduken pastaj edhe ankesat e popullit. Kur ka raste ankesash, xha Sulo, ato duhen vlerësuar drejt, duhen dëgjuar e gjykuar kurdoherë me gjakftohtësi, me drejtësi dhe të merren masat për të evituar të metat.

Domethënë çështja e bukës është e zgjidhur te ju. Po rezervën për bukë e keni siguruar për gjithë vitin?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Buka nuk na ka munguar asnjëherë, shoku Enver, bile me rezervën që kemi siguruar, kemi bërë të mundur që të na zërë buka e re të vjetrën.

SHOKU ENVER HOXHA: Pagesa e bukës bëhet me lekë në dorë, apo ua ndalni paratë anëtarëve në fund të vitit, kur bëhet ndarja e të ardhurave?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Bukën e blejmë të tërë me lekë në dorë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është një gjë shumë e mirë, sepse shërben si nxitje që fshatari të punojë më tepër e të fitojë më shumë. Kur isha në një fshat të Tiranës, pyeta një grua kooperativiste: «Saqekë merr në ditë?». — «Nuk e di», — më tha.

Por njerëzit duke mos ditur sa marrin e sa harxhojnë për mallrat që blejnë, nuk nxiten për të punuar më shumë e, si rrjedhim, edhe të fitojmë më tepër e të rrojnë më mirë. Ndryshtë kur vete në furre, për shembull, kërkon dy kilogramë bukë dhe, aty për aty, jep lekët. Në këtë mënyrë kooperativisti do të interesohet të dijë se sa do të marrë në ditë nga puna e tij e do t'i bëjë mirë llogaritë e shpenzimeve për bukë dhe për nevojat e tjera. Kështu secili e rregullon vetë më mirë ekonominë.

Sivjet që nuk pati prodhim ulliri, si e zgjidhët problemin e vajit?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Ç'është e vërteta sivjet e patëm një çikë të vështirë furnizimin me vaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk ju sollën vaj në dyqanet e shitjes?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Shumë pak na kanë sjellë.

SHOKU ENVER HOXHA: Është e vërtetë që sivjet është ndier mungesa e furnizimit me vaj ulliri dhe ka pasur vështirësi.

Po për artikujt e tjerë ushqimore si: oriz, makarona, sheqer keni pasur furnizim të rregullt?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Nga të gjitha kemi pasur: oriz, makarona, sheqer etj., asgjë nuk na ka munguar, përvç vajit.

SHOKU ENVER HOXHA: Sivjet do të kemi nga të gjitha, nuk do të na mungojë asgjë, pse do të rregullohem i edhe me vaj ulliri, edhe me vaj lulëdielli. Do të ketë vaj për të gjithë. Çështja është të punojmë në mënyrë të tillë që të marrim prodhime të larta dhe

të realizojmë planin në sheqer, oriz, vaj, makarona dhe mish.

SHOKU SULO MUSTAFAI: Edhe për mish nuk kemi mbetur keq, kemi marrë diçka.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht që keni marrë, por, tash për tash, fshatarët tanë marrin pak mish. Fshati akoma nuk e ka rregulluar si duhet furnizimin me artikuj ushqimorë e sidomos me mish, ashtu si në qytet, xha Sulo. Për shembull, qytetarit kur i duhet mishi, vete te kasapi dhe e blen, kurse fshatarit një mundësi e tillë akoma nuk i është krijuar. Ai kur ka nevojë për mish, ther nga bagëtitë e oborrit që i ka të tijat, sjala vjen, dy pulë, ndonjë gjel ose ndonjë berr etj. dhe, kur i mbarohet kjo sasi mishi, pret derisa të vijë koha që të therë ndonjë tjetër. Megjithatë, në të ardhmen, të gjitha këto gjëra dhe mungesa që vihen re tash, do të rregullohen, sepse do të prodrojmë më shumë.

Letra e Komitetit Qendror të Partisë mbi nevojën e një kthuese rrënjosore në bujqësi, që u dërgua në gjithë Partinë, do të bëjë që të kemi një organizim më të mirë në punë, të forcohet më tej disiplina në bujqësi. Është e kuptueshme se po të mungojnë rregulli, disiplina dhe organizimi i punës në kooperativat bujqësore, nuk mund të arrijmë rezultate të mira. Është e vërtetë që puna e bujqësisë është e rëndë, por pikërisht për këtë arsyen atje duhet më shumë rregulli e disiplina. Prandaj gjithë vëmendjen tonë ta kthejmë në këtë drejtim, në mënyrë që të arrijmë ato rezultate të mëdha që presim në bujqësi, ashtu siç kemi arritur në të gjitha fushat e tjera të ekonomisë së vendit tonë.

Në kooperativat bujqësore sot nuk luftohet më për të marrë 35 kuintalë misër për hektar, por 80-90 dhe deri 100 kuintalë për hektar. Vetëm me një prodhim të tillë të lartë ne mund të sigurojmë bukë gruri për të gjithë popullin, sepse prodhimi i misrit me rendiment të lartë është tamam sikur të kesh në dorë monedhë floriri. Kështu, do të kemi mundësi të eksportojmë misër.

Pas pesë vjetësh, prodhimi, në të gjitha degët e ekonomisë sonë, do të jetë më i madh, sepse deri atëherë do të kenë përfunduar së ndërtuari të gjitha veprat që parashikohen të ngrihen këtë pesëvjeçar. Gjatë këtyre vjetëve, për ndërtimin e veprave madhështore, do të punojnë me mijëra punëtorë si në Metalurgjinë e Elbasanit, në Rafinerinë e Naftës në Ballsh, në Hydrocentralin e Fierzës etj., të cilat, në këtë periudhë, nuk do të na jepin akoma prodhim. Përkundrazi, nga kantieret e ndërtimit që do të kemi atje, do të na kërkohen ushqime për punëtorët që do të punojnë në këto vepra të mëdha. Ndryshe do të jetë gjendja më vonë, në pesëvjeçarin e ardhshëm. Këto vepra do të fillojnë të jepin prodhimet e tyre dhe, si rrjedhim, do të rritet mirëqenia e popullit dhe atëherë ç'do të na shohin sytë, xha Sulo!

Do të fitojmë shumë edhe nga nafta jonë, të cilën deri më sot e kemi shitur jashtë me çmime të ulëta, se nuk kishim me se ta përpunonim vetë. Tash, me ngrijtjen e rafinerisë në Ballsh, do të jemi në gjendje «t'i nxjerrim edhe vaj» naftës, bile edhe stofra bëhen nga nënproduktet e saj. E çfarë nuk bëhet nga ajo, asgjë nuk do të lihet të shkojë kot. Edhe erën (gazin)

që do të dalë prej saj, që është si avulli, do të vijë dita, kur të krijohen mundësítë, që ta kthejmë në lëng, i cili merr zjarr. Këtë lëng ne do ta mbyllim në kutira prej hekuri, bombola u thonë atyre, që populli t'i blejë dhe t'i futë në soba që do të ndërtohen apostafat për ngrohjen e gjellëve dhe të shtëpive, pa bërë tym fare. Kur të mbarohet bombola, atëherë njeriu blen një tjetër. Do të merren masa të tilla që furnizimi me to të bëhet i rregullt jo vetëm për ju që e keni afër Ballshin, po edhe për rrëthe të tjera. Këtë shërbim do ta bëjë ndërmarrja komunale, ashtu siç bën sot furnizimin me dru. Përdorimi i gazit të naftës për ngrohje ka leverdi ekonomike, sepse do të kursejmë lëndën e drurit. Nga ana tjetër, në shtëpitë tona do të ketë pastërti të madhe.

Që të realizohen këto vepra të mëdha duhet punë këmbëngulëse nga punëtorët tanë, nga inxhinierët dhe nga gjithë populli.

(Duke pirë kafenë e nxit mysafirin të pijë.)

Mirë se na erdhe xha Sulo! Dite të bardha e të lumtura!

SHOKU SULO MUSTAFAI: Mirë se ju gjeta, të rroni sa malet! Të rroni Ju dhe Partia që po bëni çdo gjë për lumturinë e popullit!

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit, të rrojë Partia! Drejt e the se mbi të gjitha ka rëndësi Partia, prandaj organizatat-bazë të Partisë duhet të luftojnë me frymë revolucionare, që Partinë ta kemi kurdoherë të fortë e të shëndoshë. Anëtarin e Partisë duhet ta karakterizojnë thjeshtësia, vullneti i hekurt, vënia

e interesit të popullit mbi çdo gjë tjetër. Edhe në qoftë se ndodh, për shembull, që ndërmjet dy shokëve anëtarë partie të ketë një mosmarrëveshje të vogël, kjo duhet të shikohet në kuadrin e interesit të përgjithshëm, duke pasur parasysh interesat e lartë të popullit e të atdheut. Prandaj duhet që në organizatën e Partisë t'i themi të gjitha hapur ato që kemi me njëri-tjetrin se kjo ndihmon mbarëvajtjen e punës; të mos i lëmë gjërat për prapa krahëve, pse thashethemet, tarafet, grindjet, mëritë etj. pengojnë punën e Partisë, dobësojnë rolin e organizatave-bazë, i bëjnë ato që të harrojnë rolin kryesor të tyre. Një gjë e tillë është shumë e keqe për Partinë dhe unitetin e saj.

Puset e naftës që keni nga ato anë, a kanë dhënë mirë?

SHOKU SULO MUSTAFAI: Po, mirë kanë dhënë, prodhimi i tyre po shtohet dita-ditës.

SHOKU ENVER HOXHA: Shtimi i nxjerrjes së naftës ka rëndësi të madhe ekonomike. Ngritja e rafinerisë në Ballsh do të sjellë të ardhura të mëdha për gjithë ekonominë dhe do të ndihmojë për përmirësimin e jetës së popullit. Ju të vjetrit e keni për detyrë t'ju jepni eksperiencën e punës suaj të rinjve, brigadierëve e brigadiereve. Kë'ta, nga ana e tyre, duhet të dëgjojnë me vëmendje fjalët tuaja, në mënyrë që të jenë të ndershëm e të drejtë, të mbajnë mirë shënim ditët e punës dhe realizimin e normave të koooperativistëve, se ato janë djersa e tyre, djersa e popullit. Po të organizohen mirë këto punë, të gjitha të tjerat do të shkojnë mirë.

SHOKU SULO MUSTAFAI: Të na rrojë Partia dhe Ju shoku Enver, se të gjitha të mirat i kemi. Këto ditë të lumtura që po gëzojmë sot nuk i kishim parë kurrë në regjimet antipopullore. Ato vetëm sa i kishim ëndërruar. Ajo ëndërr sot u bë realitet, sepse kemi në krye Partinë dhe Ju që na udhëhiqni.

SHOKU ENVER HOXHA: Për popullin e Mallakastrës, ashtu si për gjithë popullin e vendit tonë, do të vijnë ditë edhe më të lumtura e të begatshme. Këtë pesëvjeçar shteti do të harxhojë shumë që tokat e mjaft zonave malore dhe pa ujë, si ato të Mallakastrës, të Pogradecit, të Tropojës etj. të mos vuajnë më kurrë nga thatësira shekulllore, por të lagen, të lulëzojnë e të gjelbërojnë vazhdimisht, që t'i japid popullit prodhime të bollshme. Sigurisht këto nuk bëhen dot përnjëherë, sepse kërkojnë kohë dhe shpenzime të mëdha. Këtë pesëvjeçar, ashtu siç të thashë edhe më parë, jemi ca shtrënguar se kemi një plan të ngjeshur. Por, në pesëvjeçarin e ardhshëm, situata do të ndryshojë në të gjitha drejtimet, për të mirën e popullit, për përmirësimin e jetës së tij.

SHOKU SULO MUSTAFAI: Të rroni Ju shoku Enver e marrsh nga ditët tona, se ka fat Shqipëria që ju ka Ju në krye të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Është Partia ajo që i rregullon të gjitha ato për të cilat ka nevojë populli.

SHOKU SULO MUSTAFAI: Tani të më falni se do të shkoj, shoku Enver. Qofshi mirë, marrsh nga ditët tona e t'u bëftë dita një mijë. Mirupafshim e të na vish andej nga ne, se të presim.

SHOKU ENVER HOXHA: Faleninderit shumë. Do të më jepet rasti të vij andej dhe do të të takoj, xha Sulo. Mirupafshim! Shëndet e gjithë të mirat!

*Botohet për herë të parë, si-
pas shënimeve të mbajtura në
këtë takim që gjenden në AQP*

**PËR TË RRITUR MË TEJ ROLIN
E ORGANIZATAVE-BAZË TË PARTISË NË
DIKASTERE DHE NË INSTITUCIONET
QENDRORE ADMINISTRATIVE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 maj 1971

Sido që në diskutimet e shokëve dolën mjaft gjëra interesante, me të cilat jam plotësisht dakord, dua të them edhe unë disa mendime që kanë lidhje me rritjen e mëtejshme të rolit të organizatave-bazë të Partisë e të komunistëve në përgjithësi dhe të organizatave-bazë në dikastere e në institucionet qendrore administrative, në mënyrë të veçantë. Këto çështje ne kurdoherë i kemi shtruar dhe kemi rezultate, megjithatë shohim se ekzistojnë akoma mjaft të meta e dobësi. Natyrisht, nuk duhet të bëhem pesimistë për këto të meta e dobësi që konstatojmë akoma në pu-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për eksperiencën e grumulluar dhe masat që duhen marrë për të rritur më tej rolin e organizatave-bazë të Partisë në dikasteret dhe në institucionet qendrore administrative.

nën tonë dhe të lidhim duart. Për kundrazi, e kemi për detyrë të luftojmë për të zhdukur sidomos të gjitha ato të meta që na përsëriten në drejtim të kuptimit të vërtetë dhe parimor të ndërtimit të punës së Partisë, të lidhjeve që kanë problemet me njëri-tjetrin, të zbatimit drejt në jetë të vendimeve. Gjithashtu duhet të bëjmë akoma më shumë për zhdukjen e pikëpamjeve e të shfaqjeve të gabuara që lindin herë pas here, siç janë burokratizmi, intelektualizmi, rutina, të cilat ekzistojnë dhe kundër tyre çdo ditë luftojmë e do të vazhdojmë të luftojmë akoma edhe për mjaft kohë, pse ato nuk zhduken përnjëherësh.

Eshtë e domosdoshme ta kuptojmë mirë, në parim dhe në praktikë, përgjegjësinë që kanë forumet, shokët e veçantë që i përbëjnë ato, si dhe komunistët e punonjësit e tjerë kudo që punojnë, pse këtu, më duket mua, i kanë rrënjet shumë nga të metat dhe dobësitë në punën e organizatave-bazë në dikastere. Të gjithë e dimë, dhe me këtë nuk them ndonjë gjë të re, se Partia udhëheq nëpërmjet levave të saj, të cilave u ka caktuar funksione, detyra e përgjegjësi. Por Partia ka për detyrë të punojë që levat t'i bëjë të ndërgjegjshme, me qëllim që funksionet, detyrat e përgjegjësitë e ngarkuara ato t'i zbatojnë në mënyrë revolucionare dhe me iniciativë. Megjithëse s'është hera e parë që e theksojmë këtë çështje, përsëri gjejmë mjaft pengesa në këtë drejtim, ndeshemi me paqartësi e kuptime jo të drejta, prandaj mendoj t'ju përsëritim vazhdimesht, sepse jeta dhe lufta e përditshme për ndërtimin e socializmit zhvillohet dhe nxjerr kurdoherë nevoja e probleme të reja.

Sukseset ose mossukseset në zbatimin e detyrave të ngarkuara lidhen ngushtë me nivelin e ndërgjegjes ideologjike dhe politike të njerëzve tanë, me ngritjen e shkallës së kulturës dhe zhvillimin e tyre të shumanshëm. Ato lidhen me temperamentin dhe me iniciativën, veti këto që ndryshojnë nga njëri tek tjetri, pse një është më i hedhur dhe energjik, një tjetër më i përmrbajtur dhe i ngadalshëm, dikush është më i kujdeshshëm, dikush më indiferent e sa e sa gjëra të kësaj natyre që ndeshen në jetën e përditshme. Natyra e njerëzve është me një larmi të madhe vetish, temperamentesh e karakteresh nga më të ndryshmet. Prandaj edhe puna e Partisë me ta duhet të jetë e diferencuar.

Në praktikë vëmë re se ka shumë gjëra që nuk na ecin si duam, si mendojmë e vendosim. Ja, për shembull, shpërndarja e kompetencave që bëmë nuk është kuptuar mirë nga të gjithë, prandaj në zbatimin e tyre, qoftë nga ana e organeve të Partisë, qoftë nga ato të pushtetit, shpeshherë vihen re përplasje, çka do të thotë se në këtë fushë mbetet akoma shumë pér t'u bërë. Shokët që punojnë në organet e Partisë, me të drejtë i kritikojnë punonjësit e organeve të pushtetit, kur këta s'i kryejnë mirë detyrat dhe deri këtu ata janë në rregull. Por e keqja është se në vend që t'i nxitin e t'i udhëzojnë se si ta marrin punën në dorë, u ndërhyjnë dhe i dublojnë, kurse ata të pushtetit qahen se shokët e aparatave të Partisë, pa arsy, merren me punë që u takojnë atyre, duke u marrë kështu kompetencat që u janë ngarkuar. Në këto kritika dhe ankesa të të dyja palëve, sipas mendimit tim, ka edhe të vërteta, po ka edhe teprime.

E para e punës, çështjen duhet ta shikojmë në prizmin që punëtorët e Partisë, duke përfshirë si shokët e zgjedhur ashtu edhe ata që janë të emëruar për të punuar në aparatet e Partisë, janë ngarkuar posaçërisht me detyrën për të zhvilluar punë partie. Krahas tyre është pastaj moria e gjithë anëtarëve të Partisë që nuk punojnë në aparatet e Partisë, duke filluar që nga anëtarët e Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike deri tek ata të organizatave-bazë, që merren gjithashtu me punët e Partisë në aparatet shtetërore, ekonomike etj., etj.

Në këtë vështrim, komunistët mund t'i ndajmë në dy kategori. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë ata që merren me punë partie dhe punojnë në aparatet e Partisë, duke përfshirë këtu edhe komunistët që punojnë në organizatat e masave, të cilëve Partia u ka ngarkuar detyra të veçanta. Në kategorinë tjetër hyjnë komunistët të cilëve u janë ngarkuar, gjithashtu, detyra partie, por në sektorët e pushtetit, të ekonomisë, të ushtrisë etj.

Të gjithë duhet ta kuptojnë mirë dhe ta kenë të qartë se ata që udhëheqin gjithë jetën e vendit nuk janë vetëm komunistët e kategorisë së parë, domethënë komunistët që punojnë në aparatet e Partisë, pavarësisht se disa janë zgjedhur edhe në udhëheqje. Mbarë jetën e vendit — kjo të jetë e qartë mirë për cilindo — e udhëheq gjithë Partia. Neve, punonjësve të aparatave të saj, Partia na ka ngarkuar me një detyrë speciale, kurse pjesën tjetër të komunistëve, që punon jashtë aparatave të Partisë, në organet e pushtetit, të ekonomisë, të institucioneve socialkul-

turore etj., i ka ngarkuar me detyra të tjera speciale.

Asnjë nga komunistët që punojnë në aparatet e Partisë s'mund të mendojë se nuk duhet të merret me ekonomi, një koncept i tillë do të ishte antimarksist, i gabuar. Njëkohësisht edhe gjithë komunistët e tjerë që nuk punojnë në aparatet e Partisë, por janë caktuar me detyra shtetërore, ekonomike apo arsimore etj., nuk mund të mendojnë se ata duhet të merren vetëm me problemet teknike të sektorëve të tyre, pse edhe kjo do të ishte antimarksiste. Puna e Partisë është e lidhur me të gjitha problemet ideologjike, politike, organizative, ekonomike, kulturore, arsimore, ushtarake etj., etj., pra lidhet me të gjithë sektorët e aktivitetit të jetës së vendit, që përbëjnë të gjithë së bashku një të tërë, duke qenë njëkohësisht të ndarë veç e veç për lehtësi pune, për t'u realizuar më mirë me sukses detyrat në cilindo prej tyre. Të tërë këta sektorë dhe masat e popullit që punojnë në ta, Partia i udhëheq me levat e saj, nëpërmjet gjithë anëtarëve të Partisë, kudo që zhvillojnë veprimtarinë e tyre, të cilët i edukon çdo ditë me vijën e saj të drejtë. E ritheksoj këtë që ta kemi mirë të qartë se çështjet e Partisë i drejtojnë të gjithë komunistët, kudo që punojnë, si ata të aparatave të Partisë, ashtu edhe ata jashtë këtyre aparatave. Partia drejton në bllok, në mënyrë të organizuar dhe të centralizuar.

Interesimi për të gjitha problemet bëhet në bazë të rregullave e të parimeve të njoitura, natyrisht, me shkallëzime, nëpërmjet drejtimit të centralizuar. Komunistët që zgjidhen në Plenumin e Komitetit Qendror, në Byronë Politike, si dhe ata që zgjidhen në

Qeveri dhe në organet e tjera më të ulëta të Partisë e të pushtetit, janë absolutisht të detyruar të studiojnë më shumë nga të gjithë, çdo problem. Ata, fjalë vjen, duhet ta studiojnë fije e për pe ekonominë, për arsyec se do të përgjithësojnë, do të marrin vendime për të dhe do të kujdesen për zbatimin e tyre. Nëve, që merremi me detyra të veçanta në aparate partie, nuk na lejohet në asnje mënyrë që të mos i njohim problemet ekonomike të bujqësisë e të industrisë, problemet e arsimit, të kulturës dhe të ushtrisë, me arsyetimin se ato i njohin anëtarët e Qeverisë dhe shokët që punojnë në aparatet përkatëse shtetërore. Jo, në asnje mënyrë nuk duhet të mendojmë kështu. Të gjitha problemet, natyrisht jo në detaje, duhet t'i dimë edhe ne këtu në krye që kemi funksione centralizuese dhe detyra për përgjithësimin e eksperiençës. Por edhe shokëve që punojnë në aparatet e pushtetit dhe të ekonomisë, gjithashtu, nuk u lejohet të mos i njohin e të mos merren me problemet ideologjike, politike, organizative etj., duke u nisur nga koncepti jo i drejtë se me këto merren komunistët që punojnë në organet udhëheqëse ose në aparatet e Partisë.

Pas marrjes së vendimit nga organi i zgjedhur i Partisë ose i pushtetit, detyra e organeve dhe e organizatave të Partisë është që të përgatitin Partinë, dhe nëpërmjet levave të saj masat e popullit, që ky vendim të zbatohet nga të gjithë. Kjo kërkon të punojmë për t'i ngritur masat e komunistëve dhe të popullit në një nivel të lartë politik dhe ideologjik, për t'i bërë ata të ndërgjegjshëm për domosdoshmérinë e

zbatimit të këtij vendimi. Kjo është një detyrë e vëçantë, speciale e komunistëve që punojnë në organet e Partisë dhe në organizatat e masave që ata duhet të mos e harrojnë asnjëherë. Të mos ndodhë si në disa raste që komunistët që punojnë në aparatet e Partisë futen në çështje që u takojnë t'i zgjidhin të tjerrët, interesohen deri për sigurimin e automobilave për transportimin e mallrave, për gatishmërinë e traktorëve që u duhen ndërmarrjeve shtetërore ose koooperativave bujqësore në kohën e mbjelljeve, kujdesen deri përfurnizimin me materiale të kantiereve që merren me ndërtimin e shtëpive në lagje, përgjithësisht përfundimisht që u ngarkohen. Pëkërsht këtu bëhen gabime dhe këtu duhen sqaruar mirë kufijtë e kompetencave që të mos bëhen gabime e konfondime.

Në një shkallë më të ulët se organet qendrore të Partisë dhe të pushtetit, vijnë komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Planin në rreth e përgatit vetë çdo sektor, megjithatë komiteti i Partisë, si udhëheqja e Partisë në rreth, në përgjithësi duhet të njohtë medoemos situatat ekonomike, gjendjen e arsimt, të kulturës etj., në shkallë rrethi, sepse, kur vjen koha, rrethi do t'ia paraqiti planin përfundimisht Komitetit Qendror dhe Qeverisë përfundimisht Komitetit Qendror dhe Sekretarët e komitetit të Partisë nuk mund të justifikohen duke thënë se me problemet ekonomike merren

përgjegjësit e ndërmarrjeve shtetërore, kryesitë e koooperativave bujqësore etj., apo shokët e komitetit ekzekutiv. Problemet ekonomike duhet t'i njojin mirë edhe sekretarët e komitetit të Partisë, edhe anëtarët e tjerë të udhëheqjes së Partisë në rreth, pavarësisht nga vendi ku punojnë. Detyra e një sekretari partie nuk mund të reduktohet vetëm në thirrjen për t'u mësuar njerëzve Historinë e Partisë, veprat e mark-sizëm-leninizmit, apo për t'u bërë një leksion etj., pa e lidhur këtë me jetën, me detyrat konkrete. Jo, ai, bashkë me pjesëtarët e tjerë të forumit të Partisë në rreth, ka një rol drejtues, të cilin Partia nuk ua ka varur kurrë në qafë atyre që ajo cakton të punojnë nëpër aparatet e Partisë apo në aparatet shtetërore.

Përgjegjës për realizimin e planeve janë njëlloj si komunistët që punojnë në aparatet e Partisë, ashtu edhe ata që punojnë në aparatet e pushtetit, por kompetencat e veçanta të secilës palë, që synojnë në arritjen e një qëllimi, nuk duhet të konfondohen, sepse ndryshe biem në dublime, në gabime. Komunisti, kudo që është ngarkuar nga Partia të punojë, organizon masat, u bën atyre të qarta si duhet detyrat, në radhë të parë nga ana politike dhe ideologjike, për t'i bërë të ndërgjegjshme mbi rëndësinë e tyre, pastaj, së bashku me ato dhe kurdoherë duke dhënë i pari shembullin, i mobilizon dhe lufton për realizimin e tyre. Por, gjatë zbatimit të vendimit dalin të papritura, dalin pengesa e vështirësi për të cilat ai para të gjithëve e ka për detyrë të reflektojë thellë si të kapërcehen. Në situatat e reja që krijohen ka gjëra që s'shkojnë; kur ato varen direkt nga ai, atëherë ai

ndërhyr për t'i vënë në vend menjëherë, por edhe në rastet e tjera, kur çështjet varen nga administrata e qendrës së punës, ose nga organet më të larta, komunisti nuk duhet të qëndrojë indiferent, sidomos kur sheh se të tjerët që duhet ta ndreqin një situatë nuk veprojnë, tregohen të ngathët etj. Në raste të tillë, pavarësisht se ai nuk ka përgjegjësi direkte për çështjen në fjalë, e bën atë problem dhe kërkon që të zgjidhet çështja deri në fund. Në këtë mënyrë ai kryen një detyrë të rëndësishme partie. Detyrat, pra, nuk janë të ndara me mur, përkundrazi, ashtu si edhe sektorët, ato janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, vetëm, siç thashë, nuk duhet të konfondohen. Shtrohen nganjëherë pyetje të tillë: «Përse ta marrë organizata-bazë e dikasterit në shqyrtim këtë çështje?», «Mos hyjmë në kompetencat e ministrit apo të kolegjiumit?». Nuk ka problem që ka të bëjë me dikasterin që të mos e interesojë organizatën-bazë. Në rast se shikohet që në një drejtim s'po zbatohet vendimi i Partisë, ajo ndërhyr menjëherë, sqaron çështjen, vë para përgjegjësisë fajtorët, përcakton masat për plotësimin e detyrave.

Organizata-bazë ka të drejtë, gjithashtu, t'i kërkojë llogari ministrit, në qoftë se ai, fjalë vjen, jep një urdhër në kundërshtim me një vendim të Byrosë Politike të Komitetit Qendror apo të Qeverisë, ose lëshon një udhëzim të paligjshëm etj.

Kur merren vendime për probleme të caktuara qoftë nga Komiteti Qendror, qoftë nga komiteti i Partisë i rrëthit përkatës, organizatat-bazë të Partisë dhe organizatat e masave duhet të marrin të gjitha masat

që u takojnë, që vendimet e marra të zbatohen në të gjitha instancat e Partisë e të pushtetit. Të gjithë i dinë këto çështje dhe në praktikë, në përgjithësi, kështu veprohet.

Në qoftë se vendoset, për shembull, të ndërtohet një rrugë, natyrisht për këtë objekt do të duhet një numër punëtorësh specialistë, një sasi materiali, gurësh, cimentoje etj. Për realizimin e kësaj detyre ka punë që duhet të kryhen nga organet shtetërore, por ka edhe punë që i takojnë Partisë t'i kryejë. Këto në tërësi janë në unitet dhe si Partia, si pushteti në rreth synojnë që të gjithë në një objektiv, të ndërtohet rruga. Për realizimin e kësaj detyre në rrugë shtetërore, komiteti ekzekutiv nxjerr se, përvèç anëve materiale, për të cilat duhet të marrë masa që t'i sigurojë vetë dhe t'i dërgojë në kohë në objekt që të mos pengohet puna, atje duhen dërguar, siç thashë, edhe një numër punëtorësh. Kjo është një detyrë që duhet ta marrë përsipër Partia, e cila duhet të bëjë propagandë për t'i nxjerrë këta punëtorë. Ajo udhëzon dhe vë në lëvizje për këtë qëllim organizatat-bazë, të cilat pastaj bëjnë mbledhje që nga radhët e komunisteve dhe nga masat të dalin aq njerëz sa nevojiten përtë punuar në ndërtimin e rrugës. Për të mësuar punëtorët, Partia ngarkon organet përkatëse të pushtetit që të dërgojnë atje edhe një ose dy inxhinierë. Në qoftë se këta nuk shkojnë, faji bie natyrisht mbi shokët e pushtetit, të cilët organizata-bazë e Partisë i kritikon me këtë rast rreptë, sidomos atë komunist, cilido qoftë ai, që mban drejtpërsëdrejti përgjegjësi përmosrealizimin e kësaj detyre dhe kërkon të merren

masa të menjëherëshme për zbatimin e detyrës. Problemet e tjera që kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugës, si sigurimi i materialeve të ndërtimit, i fondeve që nevojiten, duhen zgjidhur të tëra në rrugë shtetërore. Kështu të dyja palët, sipas kompetencave të veçanta që kanë, por që janë të lidhura midis tyre, kanë të drejtë të kritikojnë dhe t'i kërkojnë llogari njëra-tjetrës, në mënyrë që të kryhen plotësisht dhe deri në fund të gjitha detyrat e ngarkuara nga Partia. Kështu punëtorët e Partisë kërkojnë nga komunistët dhe kuadrot e pushtetit realizimin një për një të detyrave që u takojnë këtyre. Edhe komunistët që punojnë në pushtet kanë të drejtë dhe detyrë të kërkojnë nga shokët e aparateve të Partisë që edhe këta t'i kryejnë mirë funksionet që u ka ngarkuar Partia.

Në rast se lind nevoja që në një kohë të caktuar, për shembull, për të ndërtuar një urë duhet punuar jo 8 orë, por 12-13 orë në ditë, atëherë sekretari i komitetit të Partisë shkon vetë në vend për të bindur e për të mobilizuar punëtorët, bile po të jetë nevoja ai s'lëviz fare andej, po punon edhe vetë së bashku me ta ditë e natë e me të gjitha forcat për t'i frymëzuar me shembullin e vet, në mënyrë që këto 4-5 orë pune, që bëjnë më shumë se koha e zakonshme, punëtorëve t'u duken si minuta.

Kur punëtori i Partisë konstaton se diku në një ndërmarrje çalon disiplina në punë, ai shkon në vend dhe bën propagandë për disiplinën; po të jetë nevoja mblidhet edhe organizata-bazë, pastaj ai flet me kolektivin për dobësitë që konstatohen, nga shfaqja e të cilave komprometohet realizimi i planit, kërkon for-

cimin e disiplinës dhe shpjegon politikisht e ideologjikisht rëndësinë e saj.

Në goftë se konstaton se në kantierin ku ndërtohet ura nuk vijnë në rregull një pjesë e materialeve të nevojshme të parashikuara sipas planit, për faj, ta zëmë, të Ministrisë së Ndërtimit, gjë që pengon punimet, ai nuk lidh aspak duart, por provokon përnjëherë një mbledhje të byrosë së komitetit të Partisë në rreth, ku propozon të thërritet edhe ministri i Ndërtimit që është anëtar partie dhe mban përgjegjësi për këtë mungesë dhe kërkon nga ai arsyet për këtë çështje serioze siç është zvarritja në furnizimin e materialit, e cila pengon ndërtimin në kohë të urës.

Por mund të ndodhë edhe e kundërtë e kësaj që thashë. Ministri i Tregtisë, duke qenë anëtar partie, bille anëtar i Komitetit Qendror, kur sheh, ta zëmë, që nuk shkon mirë furnizimi i popullit në një rreth, për arsyet se ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore shkelin disiplinën kontraktuale, nuk respektojnë afatet, ose i dorëzojnë prodhimet të kalbura, bisedon me sekretarin e parë të komitetit të Partisë, të cilin e informon shkurtimisht për gjendjen. I propozon të mblidhet për këto çështje me rëndësi byroja dhe i shpreh dëshirën të marrë pjesë edhe vetë për t'i shtruar këto çështje të rëndësishme partie që nuk po ecin mirë për mungesa subjektive nga ana e punonjësve të organeve shtetërore të sektorit të tregtisë të atij rrethi. Kështu, në datën që bien dakord, si anëtar i Komitetit Qendror që është, ministri shkon në rreth, merr pjesë në mbledhjen e byrosë ose të komitetit të Partisë, shtron konkretisht problemet, në ra-

dhë të parë nga ana ideologjike dhe politike dhe propozon në rrugë partie edhe masat për t'u dhënë fund një herë e mirë këtyre dobësive me karakter thjesht subjektiv.

I njëjti veprim mund të bëhet edhe nga komiteti i Partisë i rrethit në drejtim të ministrit të Tregtisë, kur ministria, me gjithë detyrën që ka në bazë të planit për të çuar në rreth çdo muaj një sasi të caktuar të këtij ose të atij malli, nuk i ka dërguar këto rregullisht dhe kërkon të merren masa menjëherë që të furnizohet tregu me ato mallra, nga mungesa e të cilave rrethit i krijohen situata të vështira. Kjo është një detyrë shtetërore që duhet kryer medoemos, prandaj kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, si një komunist me përgjegjësi që drejton pushtetin, i kërkon telegrafisht ministrit të Tregtisë që këto mallra të venë në vend, brenda një ose dy ditëve. Në qoftë se ato nuk dërgohen, ai lajmëron Qeverinë dhe Komitetin Qendror të Partisë që ministri i Tregtisë, ose kushdo tjetër që mban përgjegjësi për këtë çështje, të shkojë në atë rreth për të dhënë llogari dhe për të marrë menjëherë masa për realizimin e detyrës.

Për t'u kryer si duhet çdo punë dhe përf t'u ndërtuar drejt këto marrëdhënie, duhen kuptuar mirë dhe duhen dalluar ç'probleme ka Partia dhe ç'probleme ka pushteti në rreth dhe në bazë. Puna e dikasterit nuk është në zyra, por në bazë, atje janë të mirat e të këqijat. Sipas mendimit tim, për të vlerësuar mirë nëse një dikaster ose kuadër me përgjegjësi në organet qendrore punon mirë ose jo, kjo më qartë se kudo du-

ket poshtë, në sektorin përkatës, në rreth dhë në bazë, ku reflektohet niveli i punës që bëjnë organet e instancat më të larta. Në rast se një dikaster nuk i kryen mirë dhe në kohë detyrat, kur atje konstatohen çrrëgullime, dobësi dhe të metë punë që dëmtojnë interesin e përgjithshëm, komitetet e Partisë, organizatat-bazë dhe komunistët e sektorëve që vuajnë nga pasojat e këtyre dobësive, po edhe ata të sektorëve të tjerë, e kanë për detyrë të jenë vigjilentë, t'i bëjnë këto probleme partie dhe të mos nisen nga mendimi jo i drejtë se në krye të këtij apo të atij dikasteri, të kësaj ndërmarrjeje apo të këtij institucioni, kemi kuadro të mirë, anëtarë partie etj., dhe ta flenë mendjen. Sigurisht në vendet me përgjegjësi Partia na mëson të vendosen kuadro besnikë, të devotshëm dhe të aftë, por dihet se në punë e sipër njerëzit bëjnë gabime, shpesh bien në vëtëkënaqësi etj., prandaj në këto raste duhen ndihmuar, duhen kontrolluar e shkundur, duhen kritikuar dhe, kur vazhdojnë të mos punojnë mirë, edhe duhen hequr. Vlerësimi i komunistëve dhe i kuadrove duhet të bëhet jo në bazë të deklaratave që bëjnë, po në bazë të punës që kryejnë, të organizimit të mirë dhe të rezultateve konkrete që arrijnë në punë. Fjalët duhet të përputhen me veprat.

Ministri ose zëvendësministri është e domosdoshme të jetë në korent të problemeve dhe të nevojave që ka baza për ndihmën e sektorit të tij. Por ministrave që janë anëtarë të Qeverisë, dhe shpesh ata dhe mjaft nga ndihmësit e tyre janë edhe anëtarë të Komitetit Qendror, nuk u lejohet të kufizohen vetëm në proble-

met e sektorit të tyre. Kur venë në rrethe ata duhet të shikojnë edhe punë të tjera kur këto nuk shkojnë mirë, që s'kanë të bëjnë me sektorin që drejtojnë. Duke pasur mendimet dhe pikëpamjet e tyre për ato probleme, pa pritur që t'i thërresë ndonjëri nga sekretarët e Komitetit Qendror, për t'i dërguar në bazë që të ndihmojnë për zgjidhjen e tyre, ata gjejnë momentin dhe, pavarësisht se në vend mund të jetë dërguar një shok tjetër i rekomanduar nga lart, shkojnë edhe vetë. Atje shtrojnë mendimet që kanë të kristalizuara në kokë, të cilat duhet të jenë në përputhje me vendimet e Komitetit Qendror dhe me vijën e përgjithshme të Partisë, marrin një opinion nga organizata përkatëse për problemin që e shohin të domosdoshëm të zgjidhet dhe, më në fund, shfaqin mendimet e veta.

Natyrisht, ministrat, zëvendësministrat dhe shokë të tjerë me përgjegjësi në organet qendrore shtetërore, venë në rrethe për problemet e tyre sipas sektorëve që drejtojnë. Disa herë bisedojnë atje me kryetarin e komitetit ekzekutiv dhe me sekretarët e komiteteve të Partisë, por më shumë shkëmbenë me ta disa mendime në këmbë dhe me kaq kujtojnë se mbaroi detyra e tyre. Mua më duket se kjo nuk është as e plotë as e mjaftueshme. Ata edhe këtë duhet ta bëjnë, por të mos mendojnë vetëm si njerëz të sektorit, po në radhi të parë si anëtarë partie. Ata duhet të kenë parasysh që si të tillë kanë edhe një detyrë plus. Ashtu si edhe punonjësit e aparateve të Partisë, ata duhet të kuptojnë se, për të bërë mirë detyrën si komunistë, është e domosdoshme të dinë në vija të

përgjithshme si shkon puna e Partisë atje ku venë dhe ku çalon ajo. Kur shohin se në bazë në këtë apo në atë sektor ka të meta të theksuara, të interesohen, të informohen mirë, t'i shohin ku janë dobësitë dhe mungesat, thyerjet e disiplinës etj., dhe, pa u futur në detaje, të përpiken që të kontribuojnë për t'i zhdukur dhe të marrin masa për të normalizuar gjendjen. Kështu duhet të veprojë çdo anëtar partie, në cilindo dikaster apo institucion qendror shtetëror që punon. Ai porsa të konstatojë ku janë të metat dhe dobësitë e punës, të reflektojë, të analizojë shkaqet, të nxjerrë e të vërë përpara përgjegjësisë fajtorin, të dalë me konkluzione për punën që duhet bërë dhe për masat që duhen marrë për ta ndrequr situatën.

Mirëpo, në më të shumtata rasteve, këta shokë, kur vërejnë të meta e dobësi, si thyerje disipline, mosrealizim të normave etj., etj., as ua vënë veshin fare këtyre problemeve. Ata nuk bëjnë sa duhet punë sqaruese me njerëzit, duke u justifikuar se punën politike dhe ideologjike me punonjësit e bën Partia, e bëjnë bashkimet profesionale, rinia apo organizata e gruas. Por një komunist që punon në një organ qendror shtetëror apo ekonomik, pavarësisht nga përgjegjësia që kanë organizatat shoqërore, nuk mund të lajë duart nga puna politike dhe ideologjike që duhet të bëjë me masat. Komunistët e organeve shtetërore dhe ekonomike që janë edhe ata njerëz politikë, punëtorë partit, duhet të interesohen që të dinë, në vija të përgjithshme, për propagandën, agjitationin, organizimin etj. Dhe jo vetëm në sektorët që u janë ngarkuar, po kudo, pse Partia interesohet që të gjithë sektorët

të ecin mirë, pasi ata janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe kur njëri çalon, ai pengon tjetrin. Prandaj, në rast se puna diku s'vete mirë, duhen gjetur sa më parë shkaqet dhe të merren masat për përmirësimin e gjendjes. Komunistët, kudo që punojnë, si elementë pararojë dhe më të ndërgjegjshëm, duhet t'i kenë të qarta detyrat, të jenë në krye të punës dhe të mobili-zohen me të gjitha forcat e tyre të trupit dhe të mendjes. Por kjo nuk është e mjaftueshme, pse këtë duhet ta bëjë kushdo, edhe ata që s'janë komunistë. Anëtari i Partisë, pa u ngrënë bukën të tjerëve, duhet të kontribuojë më tepër, prandaj ai, kur vë re se diçka nuk ecën si duhet, në çdo sektor ku punët nuk shkojnë mirë, duhet të reagojë, t'i bëjë probleme partie dhe të mos tërhiqet, derisa punët të fillojnë të ecin mbarë.

Të kihet gjithashtu parasysh, siç e thashë në filim, që shokët që punojnë në aparatet e Partisë të mos ekzagjerojnë, duke u futur më shumë nga sa duhet në anët ekonomike e shtetërore të problemeve. Kjo duhet luftuar. Gjithashtu as të tjerëve që punojnë në sektorë shtetërorë apo ekonomikë nuk u lejohet të mos u futen çështjeve të Partisë, duke arsyetuar gabim se me këto merren punonjësit e aparatave të Partisë. Edhe kjo gjithashtu duhet luftuar. Unë nuk mund ta kuptoj që një drejtor, ose shef seksioni në dikaster, kur konstaton se punët nuk shkojnë mirë në një uzinë që varet nga dikasteri ku bën pjesë, të mos mendojë për të shkuar dhe për të marrë pjesë në diskutimin e problemit që bëjnë punëtorët e kësaj ndërmarrjeje. Atij duhet t'i shkojë medoemos në men-

dje kjo gjë. Qëndrimet indiferente në këto raste ne duhet t'i luftojmë energjikisht. Shpesh të tilla qëndrime indiferente ndodhin edhe për arsyen se në mbledhje mund të dalin dhe dalin edhe probleme për të cilat mbajnë përgjegjësi vetë funksionarët e organeve qendrore, për faj të cilëve ka shpesh mungesa të mëdha në zbatimin e detyrave, në furnizimin me materiale etj., prandaj këta i ruhen në këto raste kërkimit të llogarisë nga ana e bazës. Kjo do të thotë se organizatat-bazë përkatëse të Partisë nuk i kanë ngritur si duhet në atë nivel ndërgjegjeje këta funksionarë, të cilët të kenë kurajën komuniste që «mitralozat» t'i drejtojnë, në radhë të parë, kundër vetes, pastaj kundër të tjerëve. Anëtarë i Partisë, kur shkon nga qendra në bazë, është e domosdoshme të japë llogari për punën e vet, të bëjë autokritikë, të zotohet për masat që do të marrë dhë për mospërsëritjen e gabimeve, pastaj të flasë e të kërkojë llogari nga të tjerët. Bile ai, kur të shohë se kemi faj ne të udhëheqjes, të na kritikojë edhe ne, pavarësisht se mund të mos jetë anëtar i Komitetit Qendror, as i deleguar nga komiteti i Partisë i rrethit etj. Fundi i fundit, një kuadër me përgjegjësi dhe eksperiencë të madhe edhe sikur komunist të mos jetë, kur është i edukuar me frymë partie, ai mund të marrë fare mirë iniciativën dhe të kërkojë për të shkuar në mbledhje për të thënë të vërtetën para kolektivit për të gjithë ata që mbajnë përgjegjësi për një situatë jo të shëndoshë. Në qoftë se nuk veprohet kështu, do të thotë se në këto çështje ka disa arsyen që pengojnë, të cilat duhen zbuluar dhe duhet punuar për t'i zhdukur. Kjo më duket është parimore.

Organizatat-bazë të Partisë, përveç problemeve të përgjithshme kanë edhe probleme të veçanta, specifice, prandaj edhe ndihma që duhet dhënë kërkohet të jetë konkrete, efikase. Të marrim si shembull organizatën-bazë të Partisë në një SMT, si ndërmarrje ekonomike ku ka edhe një numër punonjësish pa Parti. Në rast se në këtë organizatë zbatohen si duhet ligjet e Partisë dhe të pushtetit, ajo bëhet luftarake. Po në rast se në organizatë mendohet për të bërë disa referate të përgjithshme, ku të trajtohen më shumë çështje me karakter të theksuar shtetëror, anëtari i Partisë i kësaj ndërmarrjeje, dashur pa dashur, duke qenë teknik, do t'i shikojë çështjet më shumë thjeshta nga ana teknike. Mos do Partia ta largojë këtë komunist nga detyra e teknikut, që ai të mos jetë një teknik i mirë? Jo, përkundrazi, ajo këshillon që komunistët ta përvetësojnë teknikën e të ngrihen vazhdimi misht gjithnjë e më lart, të ecin përpara, të bëhen teknikë të mbaruar të profesionit të tyre, por, në radhë të parë kërkon, nga ata të jenë njerëz partie, që problemet e sektorit ku punojnë t'i shohin me syrin politik. Kur punët nuk shkojnë mirë në SMT, komunistët të mos i shohin problemet në prizëm teknokratik, por, si anëtarë partie që zotërojnë teknikën, të kërkojnë mbledhjen e organizatës-bazë. Këtu ata të luftojnë për mbrojtjen e parimeve të Partisë, të nxjerrin kush ka përgjegjësi për çështjet që nuk shkojnë mbarë në ndërmarrje dhe të ngrenë zërin kur komunistët nuk janë në rregull me këto punë të ndërmarrjes. Kur në disa punonjës konstatohet se ka munguar ndërgjegjja e janë zhytur në burokratizëm, i ka mbuluar megalof-

mania, ose përpiken t'i futin çështjet në ingranazhet e disa diskutimeve teorike midis tyre dhe nuk kanë shkuar ndonjëherë ta bisedojnë problemin me punëtorët, mendimet e të cilëve t'i shoshitin pastaj me kujdes e me përgjegjësi në organizatën-bazë, këto çështje t'i vënë në dukje dhe të vlerësojnë cilat janë të arsyeshme dhe me leverdi, cilat jo, të nxjerrin vështirësitë që i pengojnë në punë dhe të marrin masat për t'i kapërcyer ato etj., etj. Duke u rrahur problemet kështu, komunisti, që është i specializuar nga ana teknike, nxjerr më parë konkluzionin kryesor: që puna e Partisë atje është e dobët, dobësitë ekzistuese rrjedhin në radhë të parë për fajin e organizatës-bazë, pastaj konkretisht për faj të këtij apo të atij komunisti. Kështu vihen këta përpara përgjegjësisë dhe njëkohësisht përcaktohen detyra për ta kapërcyer sa më parë këtë situatë.

Në qoftë se ne bëjmë një luftë të tillë në çdo organizatë-bazë, atëherë do të shohim sa gjallëri të madhe do të ketë dhe sa shumë probleme do të vërshojnë nga baza në qendër, jo vetëm me karakter teknik, po edhe politiko-ideologjik e kulturor, po shokë, edhe të natyrës kulturore, pse në organizatën-bazë të organeve shtetërore dhe ekonomike nuk do të mendohet vetëm për disa tregues tekniko-ekonomikë, si për koston, rendimentin; normën, asortimentin, cilësinë, por për probleme të edukimit ideologjik e politik, në radhë të parë, pastaj edhe për pushimin e kulturuar, për organizim shfaqjesh dhe për çdo problem tjeter pse atje drejton Partia.

Anëtari i Partisë që punon në dikaster dhe shkon

shpesh me shërbim në bazë, mund të shtrojë për diskutim të tilla probleme në organizatën e veçantë të sektorit ku punon, për të cilat komunistët pastaj mund të pyesin, të sqarohen, të japin mendime etj. Po mos vallë të tilla probleme, duke u shtruar në një organizatë të veçantë sektori në dikaster, mund të mos rriven si duhet, gjë që pengon një diskutim më të gjerë të problemit nga të gjithë komunistët e një ministrie? Kush i ndalon komunistët e dikasterit të mbledhen të tërë për të diskutuar një problem të rëndësishëm, kur e shohin të nevojshme një gjë të tillë? Këtë edhe Statuti e lejon. Ne nuk jemi sekt, po anëtarë të një organizate revolucionare, që kemi çdo ditë lidhje aktive me njëri-tjetrin, komunistë me komunistë, sekretarë me sekretarë organizate në dikastere dhe në bazë. Prandaj, sa herë që lind një problem, kur shohim që nga ana shtetërore diçka nuk shkon mirë në një rreth, atëherë e meriton të organizohet një mbledhje e të gjithë komunistëve, ku të diskutohet për këto probleme, të dalin qartë detyrat që duhen kryer nga organet e qendrës dhe të ngarkohen komunistët më të përshtatshëm për zbatimin e tyre.

Kur vërejmë se në një ministri krijohet një situatë jo e pëlqyer, lidhur me zbatimin e një vendimi të Qeverisë, atëherë thërresim një instruktor, i themi çfarë ngjet në ministri, i japim detyrat, e udhëzojmë dhe kërkojmë të merren masa për ndreqjen e situatës. Në rast se shohim që një dikaster s'ua ka dhënë akoma kompetencat rrëtheve, s'ka marrë masa për organizimin e punës në bazë të vendimit që është marrë, apo s'ka dhënë fondet që nevojiten për krye-

rjen e një pune, mund të lejohet të mos dalë kush është fajtor për këtë? Fajtor duhet të jetë ministri, në radhë të parë, që nuk është në krye të punës, ose që nuk është i rreptë në kërkimin e llogarisë, që nuk ndjek zbatimin e detyrave, ose ky apo ai drejtor, ose zëvendësministër. Në këtë rast përgjegjësi i Partisë në dikaster provokon mbledhjen e gjithë punonjësve të ministrisë, me të cilët shtron për diskutim ato shfaqje negative që janë konstatuar, për të cilat bën kritika në adresë të ministrit, që këtë apo atë vendim nuk e ka zbatuar, ose që zëvendësministri, megjithëse ka vajtur në vend, nuk ka marrë masa për zgjidhjen e çështjes etj., etj. Pas kësaj paraqitjeje fillon një diskutim i rreptë, lihen njerëzit të flasin lirisht në këtë mbledhje të improvizuar që, po të jetë nevoja, mund të vejë edhe një ditë të tërë, megjithëse s'ka të bëjë hiç me mbledhjet e zakonshme që bëhen me rend dite, të parashikuara me kohë.

Në qoftë se do të veprojmë në këtë mënyrë, atëherë jeta në organizatat e Partisë në dikastere, në bazë, në aparatet e komiteteve të Partisë e të pushtetit dhe kudo, do të bëhet me të vërtetë e gjallë e revolucionare dhe nuk do të na shtrohet më problemi nëse organizata-bazë në dikaster është e madhe apo e vogël. Unë mendoj se organizatën e duan të madhe disa shokë të caktuar me qëllim që komunistët të janë një bllok, të tërë bashkë. Po janë apo s'janë komunistët të tërë në bllok në një organizatë, Partia përsëri drejton. Në qoftë se kuptohen mirë parimet, Partia drejton kudo, pavarësisht nga numri i anëtarëve të Partisë që përbëjnë organizatën-bazë.

Rëndësi të madhe për ne ka sidomos realizimi i detyrave të këtij pesëvjeçari dhe në këtë drejtim organizatat-bazë të Partisë të dikastereve kanë një rol të rëndësishëm. Partia jonë tani ka grumbulluar një eksperiencë jashtëzakonisht të madhe, ajo ka bërë në çdo drejtim përparime. Anëtarët e Partisë dhe në përgjithësi njerëzit, kudo që janë ngarkuar të punojnë, kanë fituar, gjithashtu, eksperiencë shumë të madhe. Unë jam dakord edhe me mendimin që u shpreh këtu se në jetë ka njerëz që ecin përpara, por ka edhe nga ata që, megjithëse janë me shkollë, ngelin në vend, prandaj duhen nxitur herë pas here që të ecin përpara si gjithë të tjerët. Këtë punë do ta bëjë, në radhë të parë, Partia, organizata-bazë. Kudo në vendin tonë tërë ambienti është i tillë që i shtyn përpara njerëzit, çdo gjë te ne është dhe duhet të jetë në lëvizje, pse qetësia, rutina, si një ujë i fjetur, i bën njerëzit të ngecin, qofshin ata edhe nga më të mirët. Prandaj, në qoftë se do të përpinqemi e do të sigurojmë masat e nevojshme, metodat dhe atë stil revolucionar pune që tërë ambientin dhe njerëzit t'i vëmë në lëvizje, në diskutime, në propozime, në luftë, jam i bindur se jo vetëm do të zgjidhim shumë nga problemet që kemi përpara, por edhe dobësitë e të metat e vërtetuara që kanë hedhur rrënje në jetën tonë dhe nuk po zhduken lehtë, do të luftohen më mirë. Por këto nuk arrihen me fjalë, me një studim, ose me një të lexuar të Historisë së Partisë. Njerëzit tanë e lexojnë Historinë e Partisë, bile dhe e studiojnë dhe duhet ta vazhdojnë këtë punë, por ta lexosh e ta studiosh Historinë e Partisë dhe nga ana tjetër të mos

zbatosh direktivat e Partisë, ligjet e shtetit, vendimet, urdhëresat dhe udhëzimet e Qeverisë e të mos i zbërthesh ato në detaje, një gjë e tillë nuk mund të lejohet. Ato duhen zërthyer deri në fund. Kjo kërkon që të punojë ca më shumë mendja e secilit dhe jo të hidhen vetëm disa fraza të përgjithshme, ndryshe Historia e Partisë mbetet një shpjegim i vagët, historik, tregim i thjeshtë ngjarjesh. Këtë ne e kemi në dorë ta bëjmë si duhet për arsyen se tani kemi plot njerëz, Partia ka përgatitur një armatë të tërë kuadrosh, mundësitet, pra, janë shumë të mëdha në këtë drejtim.

Unë mendoj se suksese dhe rezultate të shumta kemi arritur në çdo drejtim, prandaj të mos jemi pessimistë. Kritikat i bëjmë me qëllim që të përmirësohet më tej puna jonë në organizatat-bazë të dikastereve.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Raporte e fjalime 1970-
-1971», Tiranë, 1972, f. 325*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime
1970-1971», Tiranë, 1972,
f. 325*

DISIPLINA NË PUNË KËRKON ZBATIMIN ME PËRGJEGJËSI TË DETYRËS PERSONALE DHE KOLEKTIVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 maj 1971

Edhe unë desha të shpreh disa mendime për këtë problem. Tani jemi duke përpunuuar planin e ri pësëvejeçar, projektdirektivat e të cilat do t'i dërgohen bazës për t'i diskutuar masat e gjera të popullit, dhe pastaj do t'i paraqiten për aprovim Kongresit të 6-të të Partisë. Në këtë periudhë kohe, Partisë, pushtetit, organizatës së bashkimeve profesionale, organizatës së rinisë, të gruas etj., u dalin përpëra probleme të mëdha, mbi të cilat ato do të reflektojnë më thellë për organizimin më të mirë të punës e të prodhimit, në radhë të parë, dhe të propagandës, agitacionit e të edukimit, faktorë këta me rëndësi për realizimin e planit. Partia dhe klasa punëtore duhet të jenë të

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe puna që bëjnë organizatat e bashkimeve profesionale me punëtorët e rinj të ardhur nga fshati.

ndërgjegjshme për detyrat e mëdha që u vihen përpara, t'i shikojnë ato realisht dhe me një frymë më të zhdërvjellët nga ç'i kanë parë dhe realizuar deri tani. Unë mendoj se eksperienca e deritanishme duhet të na shtyjë të mendojmë për të përmirësuar në mënyrë rrënjosore metodat ose pikëpamjet nga të cilat jemi udhëhequr në punën tonë. Në parim këto metoda dhe pikëpamje kanë qenë të drejta, por është fakt se në praktikë ka pasur edhe të meta.

Klasën punëtore, qoftë atë me origjinë nga qyteti dhe me stazh të vjetër në punë, qoftë atë me origjinë nga fshati që ka ardhur prej shumë kohe ose rishtas në gjirin e klasës punëtore, duhet ta bëjmë të ndërgjegjshme për rolin e madh që duhet të luajë në realizimin e planit të ri pesëvjeçar, i cili do të jetë mjaft i ngjeshur e do të kërkojë edhe një disiplinë të fortë në punë.

Disiplina në punë kërkon zbatimin me përgjegjësi të detyrës personale dhe kolektive. Realizimi i planit të ardhshëm pesëvjeçar nuk lyp të sakrifikohet jeta, se nuk kanë ardhur momente të tilla. Çështja është që çdo punëtor të bëhet i ndërgjegjshëm dhe të luftojë qëndrimin e gabuar antipopullor për t'i ngrënë vetes dhe klasës së tij kohën e punës, qëndrim që dëmton rëndë prodhimin. Kështu, në vend që ai të punojë 8 orë, punon, fjala vjen, 6 orë e gjysmë. Plotësimi i 8-orëshit të punës është një detyrë absolute për të gjithë. Asnjë lëshim në këtë drejtim nuk duket lejuar. Është e nevojshme të punohet që punëtori të kuptojë dhe pastaj të bëjë vetë përpjekje që të zhdukë pikëpamjen mikroborgjeze, sipas së cilës të punohet më

pak dhe të merret më shumë nga shoqëria. Një qëndrim i tillë i padrejtë nuk duhet t'i lejohet asnje shtetasë të Republikës Popullore të Shqipërisë e jo më punëtorëve. Punëtorët dhe gjithë punonjësit e tjerë në asnje mënyrë nuk duhet të abuzojnë dhe të nënçmojnë sakrificat e mëdha që bën pushteti për përmirësimin e jetës së tyre, prandaj edhe ata t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që u krijohen për të dhënë maksimin e domosdoshëm gjatë 8 orëve, kohë kjo që është vendosur me ligj, sipas të cilit ata shpërblhen për punën që kryejnë.

Shteti u krijon, fjala vjen, punëtorëve të sharrave ose të tjerëve mensa me një çmim shumë të lirë, me qëllim që të shmangen lodhjet e tepërtë përvajtje-ardhje në familjet e tyre dhe të hanë shumë më mirë se në shtëpi. Dëshira e shtetit është që të tërë punonjësve t'u ruajë forcat fizike e mendore dhe, në-përmjet formave të ndryshme të punës edukative, t'u hapë horizonte të gjera politike, ideologjike, kulturore dhe teknike që ata, brenda kohës normale të punës për të cilën paguhen, t'i japid shoqërisë maksimin me sa më pak lodhje.

Për ata punëtorë që banojnë larg familjeve të tyre, ndërmarrjet dhe punëtorët, brenda mundësive që kanë, të përpilen bashkërisht që të krijojnë kushte të përshtatshme për të pushuar dhe për të fjetur sa më mirë. Natyrisht është një sakrificë kur punëtori, për nevojat e punës, shkon vetëm një herë në dy javë në familje, por ai e kuption që këtë e bën sepse ashtu e lypin interesat e socializmit. Por atyre t'u bëhet e qartë dhe të mos harrojnë se para Çlirimtë

atdheut, të parët tanë largoheshin dhjetëra vjet me radhë nga familja për të siguruar kafshatën e gojës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjetkë, kurse tani njerëzit tanë punojnë të lirë në vendin e tyre, të mos harrojmë se shtëpinë punëtori ynë, në shumicën dërrmuese të rasteve, nuk e ka më shumë se dy orë larg nga puna. Veç kësaj, tani kushdo e di se njerëzit në familje, në qytet apo në fshat, i ka shëndoshë e mirë, të siguruar me punë, me shtëpi dhe me çdo gjë të nevojshme. Dua të them se për familjen ai e ka mendjen krejt të mbledhur nga ana ekonomike, shoqërore dhe nga të gjitha të tjerat. Përveç këtyre, në çdo rast askush nuk pengohet të shkojë në shtëpi për një nevojë familjare të ngutshme.

Përpjekjet për t'u hapur punëtorëve më tepër mensa kudo dhe në kushte shumë të favorshme nuk kanë munguar, bile përpjekje të tilla bëhen shumë. Megjithatë vihet re se disa punëtorë dhe punëtore kanë pretendime të tepruara, se gjoja në këto mensa 10 ose 15 lloje gjellësh që gatuhen nuk qenkan të mjaftueshme, por u dashkan më shumë, deri në 25 gjellë për çdo të ngrënë, përveç ëmbëlsirave, pastave etj. Ka pastaj kërkesa të tjera që të hahet akoma më lirë se sot, të krijuhen me mijëra çerdhe e kopshte të tjera të pajisura më mirë etj. Dhe atyre që i bëjnë këto kërkesa jashtë mundësive tonë, kur u kronometrohet shfrytëzimi i orarit të punës, del që nuk punojnë 8 orë, po 6 orë e gjysmë. Kjo, shokë, nuk shpreh atë ndërgjegje të lartë klase që duhet të karakterizojë punëtorët tanë. Këto kërkesa, pa pasur të qartë politikisht dhe ideologjisht se nga dalin të ardhurat

që sjellin shtimin e të mirave materiale, dëmtojnë klasën dhe interesat e saj.

Në qoftë se Partia nuk i bën të ndërgjegjshme masat, e në radhë të parë klasën punëtore, që t'i kup-tojnë drejt detyrat, do të thotë se propaganda, agjicioni dhe edukimi ynë nuk ecin në rrogull. Prandaj mendoj t'i rishikojmë pak metodat dhe format e punës së edukimit që praktikojmë. Partia në asnjë rast, të pajustifikuar, nuk këshillon që punëtori të mos e shfrytëzojë plotësisht e në mënyrë intensive orarin e punës ose të rrrijë dy-tri ditë pa vajtur në punë. Ç'rëndësi ka atëherë leximi i «Historisë së Partisë», kur punëtorët nuk arrijnë t'i kuptojnë mësimet që nxirren prej saj? Si mund të flitet për zgjidhjen e drejtë të kontradiktave, fjala vjen, kur njeriu ka kontradikta të shumta në vetvete dhe këto nuk i vihen në dukje, nuk i numërohen një për një? Vetë ky qëndrim ndaj punëtorit është në kontradiktë me vijën e Partisë. Partia kurdoherë na ka mësuar që me njerëzit të punohet shtruar, që ata të sqarohen konkretisht, të binden për atë që u flitet dhe kjo bindje t'i nxitë që të luftojnë çdo të metë në punën e tyre, gjë që do të ndihmojë për zgjidhjen e drejtë të shumë kontradiktave që lindin në jetën tonë të përditshme. Lufta për zgjidhjen e kontradiktave që lindin, do të thotë eliminimi i asaj që bëhet pengesë në ecjen përpara dhe zëvendësimi i saj me një tjetër që ndihmon zhvillimin progresiv. Por në procesin e këtij zëvendësimi do të lindë përsëri një kontradiktë e re në gjirin e së parës. Këto gjëra duhen shpjeguar praktikisht e jo vetëm në mënyrë teorike.

Kështu, për shembull, kur flasim për kualifikimin e punëtorit, sqarojmë se shteti ka hapur kurse që punëtori të mësojë përdorimin me zotësi të mjetit që i është besuar, të bëhet specialist për të nxjerrë prodhim të një cilësie të lartë, në përputhje me nivelin teknik të mjetit që ka në përdorim. Që t'ia arrijë këtij kualifikimi, është e nevojshme që ai të japë disa provime, prandaj duhet të mësojë sa më shumë e jo ta kalojë kohën kot, sepse, midis përpjekjeve të shtetit dhe qëndrimit të atij që përpinqet ta marrë provimin pa mundime, pa mësuar, do të lindë pastaj një kontradiktë e re. Edhe në qoftë se dikush arrin ta marrë provimin pa mësuar, këtë kontradiktë ai vërtet e kapërcen, mirëpo kur të shkojë në prodhim, nga puna e tij do të dalin prodhime skarco, gjë që bie në kontradiktë me kualifikimin që i është njojur zyrtarisht dhe me interesat e ndërmarrjes prodhuese, pse ato rritin koston e prodhimit. Në qoftë se edhe prodhimet skarco, fjala vjen, pjesët e këmbimit për automjete, ndërmarrja arrin t'i kalojë si «të mira», kur ato të futen në përdorim nga konsumatori, ky i fundit, në vend që të bëjë me to, ta zëmë, 50 000 kilometra, pa riparim, do të bëjë 20 000 kilometra e kështu me radhë. Si rrjedhim i gjithë këtyre do të dëmtohet ekonomia, interesi i përgjithshëm dhe i vetë punëtorit. Po të bëjmë një punë të zgjuar sqaruese, njerëzit do të binden me siguri që të mos veprojnë më siç kanë vepruar në disa raste, duke menduar: «Oburra të ngremë kurse dhe të kalojmë në to sa më shumë njerëz», pa pyetur fare se sa përfitojnë dhe sa ndihmojnë këta njerëz në shtimin e prodhimit dhe në nxjerrjen e tij.

me cilësinë e kërkuar, ashtu sikurse theksoi në diskutimin e vet shoku Haki¹. Ne duhet t'i kalojmë punonjësit tanë në kurse serioze, prandaj t'i rishikojmë me kujdes të gjitha kurset ekzistuese, programet dhe shkallëzimet e vendosura në to për kualifikimet. Të mos sillemi me mendjelehtësi me provimet, me kurset dhe me kategoritë që kemi vendosur.

Që të ngrihet secili punëtor nga një kategori më e ulët në një më të lartë, nga e para tek e dyta e kështu me radhë, ai duhet të dërsijë duke punuar mirë e duke mësuar me këmbëngulje. Kur punëtori të marrë kategorinë e re, dhe për këtë t'i ngrihet paga nga 18 në 20 lekë, të jetë jashtëzakonisht i kënaqur nga ky sukses dhe t'i vihet punës seriozisht që, pas pesë vjetësh, të marrë një kategori më të lartë. Nuk është aspak e drejtë që një punëtor i thjeshtë, 3-4 muaj pasi ka filluar punën, të marrë menjëherë 450-500 lekë në muaj. Një mënyrë e tillë shpërblimi nuk nxit kualifikimin, prandaj nuk duhet lejuar. Në qoftë se për çështje të tilla, siç janë kualifikimi, shpërblimi për një kategori më të lartë etj., nga ana shtetërore dhe e Partisë nuk përmirësohet metoda e punës së edukimit, nuk vendosen kritere të drejta dhe nuk mbahet qëndrim i rreptë për zbatimin e tyre në jetë, ndërgjegjja e njerëzve dhe përpjekjet e tyre për plotësimin e detyrave nuk do të ngrihen në atë shkallë që

1. Haki Toska, në atë kohë, anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH.

kërkon situata, të cilën medoemos duhet ta ndryshojmë.

Shumë serioz është konstatimi që në disa sektore të ekonomisë plani nuk realizohet. Natyrisht ky fenomen është shumë negativ dhe prej tij ka dëm tërë republika. Vihet re, gjithashtu, se normat vazhdimisht ulen dhe ngrihen, një herë realizohen 110 për qind, pas dy muajsh ngrihen në 130 për qind etj. Vallë përse ngjet kështu? Si ka mundësi që klasa punëtore t'i realizojë normat 130 për qind në 6 orë e gjysmë? Këtu sigurisht diçka nuk është në rregull dhe tregon se normat nuk janë caktuar mirë, se në këtë drejtim ka akoma rezerva të mëdha të pashfrytëzuara. Kjo dikton nevojën e shikimit më të thellë të normave nga ana e Partisë dhe e shtetit. Lidhur me këtë problem del një detyrë tjetër, akoma më serioze: sigurimi i cilësisë së prodhimeve, për përmirësimin e së cilës jemi kufizuar vetëm në kritikë, kritikë e kritikë, pa menduar se kush duhet ta mbulojë dëmin e shkaktuar nga prodhimet skarco që nxjerr, duke rënduar në çdo rast me këtë buxhetin e shtetit të klasës punëtore. Më duket se duhen rishikuar dispozitat e Kodit të Punës dhe normat e tjera ligjore për këtë çështje. Për rastet e prodhimeve skarco, kur këto dalin për faj të punëtorit ose të nëpunësit, mendoj që dëmi të shpërblyhet nga ai që ka nxjerrë nga duart e veta të tilla prodhime. Kështu, për shembull, në qoftë se këmishët e këpucët, lapsat a fletoret ose sendet e tjera të prodhuara nuk janë të cilësisë së mirë dhe kontrolli i vlerëson ato jashtë standardit, shkaktari të paguajë medoemos dëmin që ka bërë. Këtë përgjegjë-

si, sipas mendimit tim, duhet ta kërkojmë patjetër në të ardhmen, sepse kështu mbrojmë pasurinë e republikës, interesat e klasës punëtore dhe, në të njëjtën kohë, ndihmojmë edhe vetë punëtorin e pandërgjegjshëm që të mësojë si të punojë dhe të mbrojë shtetin e vet. Kur punëtori blen një mall të dobët në dyqan dhe me të nuk kalon as dy muaj, ka të drejtë të shprehë pakënaqësi për atë që e ka nxjerrë me cilësi të dobët. Por në radhë të parë ai duhet të bëhet i ndërgjegjshëm që, për të mos ndodhur kjo, secili, pra edhe ai vetë si prodhues, në punën e vet të nxjerrë kurdoherë prodhim të cilësisë së lartë. Prandaj të punojmë pareshtur me njerëzit që detyrat që u ngarkohen t'i kryejnë me ndërgjegje, në kohë, në sasi dhe me cilësinë që kërkohet.

Ne kemi vënë disa rregulla për cilësinë e prodhit, po, me sa duket, ato duhen rishikuar, se ndërgjegjja e njerëzve tanë qëndron akoma mjaft prapa. Prandaj të punojmë më shumë që ta ngremë atë me aksione revolucionare, me një edukatë të mirë politike dhe ideologjike dhe krahas tyre, siç thashë, të merren edhe masa për rritjen e përgjegjësisë materiale për punonjësit e pakujdeshëm, duke i detyruar që ta paguajnë dëmin e shkaktuar.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha.
-Raporte e fjalime 1970-
-1971», Tiranë, 1972, f. 348*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972,
f. 348*

ORGANIZIMI I RI I KOOPERATIVAVE BUJQÈSORE BËHET PËR TË SHTUAR PRODHIMIN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 maj 1971

Dëshiroj të them edhe unë diçka rreth problemit që ngrihet në studimin e Ministrisë së Bujqësisë, Institutit të Studimeve Ekonomike dhe Drejtorisë së Bankës Bujqësore, lidhur me masat për intensifikimin dhe specializimin e prodhimit bujqësor e blegtoral në një numër kooperativash bujqësore të fuqishme të fushës, nëpërmjet pjesëmarrjes së shtetit në to.

Në radhë të parë, duke bërë fjalë për këtë organizim, sikurse theksuan edhe shokët në diskutimet e tyre, ne kemi parasysh realitetin që aktualisht, në përgjithësi, ndërmarrjet bujqësore, nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik dhe organizativ, qëndrojnë më lart se kooperativat bujqësore. Kjo vjen jo vetëm si rezultat i

1. Në këtë mbledhje u diskutua mbi masat për intensifikimin dhe specializimin e prodhimit bujqësor e blegtoral në një numër kooperativash të fuqishme me anën e pjesëmarrjes së shtetit në to.

gjithë punës organizative të Partisë, i organizimit shtetëror të ndërmarrjeve, po dhe i metodave të punës etj. Megjithatë është fakt se edhe ndërmarrjet bujqësore nga ana e tyre s'janë akoma në atë stad zhvillimi ku duhet të jenë. Këtë nuk duhet ta harrojnë punonjësit e këtyre ndërmarrjeve, në të cilat ka nevojë të përsosen më tej drejtimi dhe organizimi i punëve.

Meqenëse aktualisht ndërmarrjet bujqësore qëndrojnë më lart, në kooperativat që do të ngrihen me pjesëmarrjen e shtetit, duhet të ndërtojmë një organizim shumë të përafërt ose të njëllotë me atë të ndërmarrjeve bujqësore, me qëllim që, brenda një kohe shumë të shkurtër, këto kooperativa të arrijnë rezultatet që presim. Unë mendoj se për t'ia arritur kësaj ekzistojnë mundësi të mëdha, prandaj jam i bindur se, duke i shfrytëzuar ato plotësisht, në një të ardhme ne do t'i sjellim këto kooperativa në një shkallë të barabartë me ndërmarrjet bujqësore. Kështu, të dyja këto forma organizimi të ekonomisë sonë bujqësore socialiste do të ecin përpara së bashku, frontalisht.

Pavarësisht nga përparimet e bëra dhe rezultatet e arritura, a na lejohet neve tash, pas disa dhjetëra vjetësh ndërtimi socialist, që në kooperativat bujqësore të fushave, e nga më pjelloret, të vazhdohet me një mënyrë të tillë organizimi e me këto ritme prodhimi? A na lejohet neve që për fushat, që janë vendimtare për prodhimin, të mos e vrashim mendjen që të gjejmë forma të reja organizimi që do të ndikojnë për të shtuar prodhimin bujqësor, në mënyrë që ky të ketë stabilitet dhe të shkojë kurdoherë në ngritje? Jo, nuk na lejohet. Pikërisht, duke u nisur nga këto që thashë,

ne arritëm në konkluzionin që një numër kooperativash bujqësore të fuqishme të fushës t'i ngremë në kooperativa të një tipi më të lartë me anën e pjesëmarrjes së shtetit në to. Me këtë sistem të ri të kooperativave bujqësore, ne bëjmë bashkimin e investimeve të shtetit me ato të kooperativës, e cila ka fordin e pandashëm dhe pasuri të tjera si lopët, stallat, magazinat etj. Pas riorganizimit, këto pasuri do të jenë në pronësi të përbashkët të kooperativës dhe të shtetit, në raport me atë që ka vënë secila palë. Prandaj edhe unë, si gjithë shokët që folën sot këtu, jam dakord me projektin që është paraqitur.

Desha të theksoj se hapin që bëjmë për zhvillimin ekonomik të disa kooperativave bujqësore me pjesëmarrjen e shtetit, duhet ta kuptojmë, në radhë të parë, politikisht. Kjo ka rëndësi të madhe për të sotmen dhe për të ardhmen, që ato, në mënyrë graduale, të vijnë në një shkallë me ndërmarrjet bujqësore shtetërore. Pjesëmarrjen e shtetit në zhvillimin e tyre të mos e kuptojmë formalisht. Shteti do të marrë pjesë dhe do të bëhet pjesëtar i ligjshëm me kooperativat në fjalë vetëm për aq sa kontribuon në zhvillimin e tyre. Siç e vura në dukje, qëllimi i këtij organizimi është që të shtohet prodhimi, gjë që varet shumë nga shkalla e investimeve, të cilat janë akoma të kufizuara në kooperativat ekzistuese. Natyrisht, edhe këto kooperativa, investimet kryesore do t'i bëjnë vetë, po në to do të bëjë investime edhe shteti. Tash e tutje investimet që do të bëjë shteti nuk do të jepen më si kredi, po në formën e pjesëmarrjes së tij. Në bazë të këtij parimi, që patjetër duhet sankzionuar me një akt li-

gjor, do të bëhet si shpërndarja e të ardhurave, ashtu edhe zhvillimi e kalimi gradual i këtyre kooperativave nga faza e pronës së grupit në fazën e pronës së të gjithë popullit.

Riorganizimi në këtë rrugë i një numri kooperativash nuk është i njëllojtë me shkrirjen që u bëmë ca kohë më parë në rrethin e Tiranës disa kooperativave bujqësore, të cilat u kthyen në ndërmarrje bujqësore me vendim të organeve kompetente. Në këtë rast prona e grupit u kthye menjëherë në pronë shtetërore, pa kaluar nga faza e ndërmjetme. Por, kjo formë e kthimit të pronës së grupit në pronë të gjithë popullit, tani për tani nuk mund të përgjithësohet, sepse duhet marrë parasysh fakti që fshatarët kanë akoma psikologjinë dhe mentalitetin e tyre për tokën dhe për pronën, të cilat i fituan me luftën që bënë për çlirim. Më vonë, pas Çlirimt, ngritën kooperativat, bënë mjaft sakrifica, duke ndërtuar nü to gjithfarë objektesh ekonomike e socialkulturore dhe, me punën e tyre, e rritën pasurinë e përbashkët dhe fondin e pandarë, nga i cili një pjesë përdoret çdo vit për investime. Prandaj them që shkrirja e kooperativave në ndërmarrje bujqësore, që përmenda e që ishte e nevojshme për një rast të veçantë dhe u bë me pëlgimin e mbledhjeve të përgjithshme të ish-kooperativave bujqësore, nuk duhet përgjithësuar. Pasurinë e kooperativës ne nuk mund ta kthejmë automatikisht në pronë shtetërore, sepse një veprim i tillë nuk do të ishte në përputhje as me interesat e fshatarësise kooperativiste, as me vijën e Partisë.

Ne duhet të kemi parasysh edhe ndryshimet që

ekzistojnë midis kooperativës dhe ndërmarrjes bujqësore. Ndërmarrjet bujqësore nuk kanë qenë kurrë pronë private e fshatarëve; ato janë krijuar në tokat e shtetit, kurse në kooperativë fshatari ka pronën e tij të grupit, që ka rrjedhur nga prona private. Prandaj nuk mund të mos përfillet nga ne fakti që fshatari ka akoma në ndërgjegjen e vet mbeturina të ndjenjës mikroborgjeze, të cilat Partia me punën që bën po i zhduk gradualisht. Por, që të kryhet me sukses ky proces dhe të arrijmë më vonë në pronën e gjithë popullit, është e domosdoshme të futim elemente të organizimit dhe të prodhimit të ri, të forcojmë punën politike dhe ideologjike. Transformimet në format e pronësisë dhe në ndërgjegjen e kooperativistëve duhet t'i arrijmë jo vetëm nëpërmjet masave ligjore, por sidomos nëpërmjet punës bindëse, që kooperativisti ta kuptojë se kjo gjë që bëhet është e drejtë. Ne do të shkojmë duke i rritur të ardhurat e kooperativave, po nuk mund të marrim dot prej tyre që në fillim të ardhura njëlloj si nga ndërmarrjet bujqësore, pse një gjë e tillë nuk mund të arrihet përnjëherë. Prandaj, amortizimin e mjeteve të prodhimit kooperativa nuk e nxjerr kaq lehtë, me të ardhurat që ka. Fshatari llogarit edhe të ardhurat e tjera që nuk i jepen. Mos të harrojmë se ai mendon edhe një gjë tjetër: «me ditë-punoja, me ditë-punoj», thotë ai. «Këta traktorë i kisha në përdorim, shteti më dha edhe disa të tjerë më tepër». Ai pra e di sa investime ka vënë shteti dhe se vetë ka investuar më shumë përritjen e prodhimit. Gjithashtu ai tanë e mendon se shteti është bërë pjesëmarrës në kooperativë, kurse përpala nuk

ishte etj. Kuptohet, pra, se për t'i sgruar drejt gjithë këto pikëpamje e mendime që ai bluan në mendje, duhet bërë një punë shumë e madhe politiko-ideologjike, sepse kjo çështje, sipas mendimit tim, nuk është kaq e thjeshtë. Nuk mjafton të japim ose të mos japim disa traktorë, por para së gjithash të kemi parasysh se në këto marrëdhënie të reja lind një problem me rëndësi politike dhe ideologjike, i cili duhet të zgjidhet drejt në një rrugë të menduar mirë, me masa organizative dhe agroteknike të përparuara, të cilat shkojnë të tëra në mënyrë kreshendo.

Nëpërmjet gjetjes së rrugëve më të drejta e më të përshtatshme, ne duhet të arrijmë në kthimin gradualisht të pronës së grupit në pronë të të gjithë popullit. Sa kohë do të zgjatë procesi i këtij kthimi, nuk mund ta themi qysh tanë, këtë do të na e tregojë vetë jeta, praktika. Vetëm një gjë mund të themi qysh tanë se baza kryesore e këtij procesi është shtimi i prodhimit në kooperativat bujqësore, zhvillimi i gjithë ekonomisë populllore. Në kooperativat e riorganizuara duhet të arrijmë të marrim maksimalen e rendimenteve.

Të mos mendohet në asnjë mënyrë se, meqë në këto kooperativa të tipit të lartë merr pjesë edhe shteti, ato u janë afruar kaq shpejt ndërmarrjeve bujqësore. Të mos mendojmë gjithashtu se, meqë në to do të vendosen norma e rregulla të reja, automatikisht edhe ndërgjegjja e kooperativistëve do të ndryshojë menjëherë. Jo! Ne duhet të kemi parasysh se ndërgjegjja e kooperativistëve, edhe pas këtij organizimi nuk do të pësojë transformim të menjëhershëm, sepse, sikurse në gjirin e klasës punëtore, ca më tepër në ra-

dhët e fshatarësisë, ka dhe do të ketë akoma njerëz me mbeturina në ndërgjegje. Ndërgjegjja ecën përpara më ngadalë sesa zhvillimi material. Prandaj, për të krijuar bindje të thellë e të plotë për riorganizimin që do të vendoset, është e domosdoshme që nga Partia të kryhet një punë e madhe dhe e vazhdueshme politike e ideologjike dhe të punohet për një shpjegim të thellë të problemeve.

Në përgjithësi, thuhet se kooperativistët janë gati të futen në ndërmarrjet bujqësore, por kjo nuk është kudo dhe kurdoherë plotësisht e vërtetë. Më kanë informuar se në rrëthin e Tiranës disa kooperativistë nuk donin të futeshin menjëherë në ndërmarrjen bujqësore për shkak se i tërhoqi interes personal, i cili luan shumë rol, sepse në kooperativat e tyre ata merrnin më shumë të ardhura. Prandaj Partia duhet të punojë shumë politikisht dhe ideologjikisht me njerëzit, që ata, me punën e tyre, të rritin prodhimin dhe të shtojnë të ardhurat në rrugën e drejtë socialiste. Në këtë mënyrë kooperativistët do të shikojnë realisht se kjo rrugë është në dobi të tyre dhe të mbarë shoqërisë.

Çështje tjetër që duhet pasur parasysh në këtë organizim janë rastet kur prodhimi, me gjithë pjesëmarrjen e shtetit, mund të qëndrojë në vend, ose e kundërtë, kur, pa investime të mëdha nga shteti, ai mund të rritet përnjëherë, për shkak të organizimit më të mirë të punës, kontrollit dhe disiplinës më të fortë, për të cilat, aktualisht, kooperativat vuajnë. Në këto raste në mentalitetin e fshatarit do të lindë pyetja: «Përse merr pjesë shteti në të ardhurat e kooperativës, kur ai ka bërë më pak investime se ne?». «Këtë rregull e

organizim ne mund ta bënim edhe vetë», mund të thonë disa të tjerë. Për t'u dalë përpara këtyre mendimeve të gabuara që mund të lindin nga paqartësitet, është e domosdoshme që, siç e theksova edhe më lart, krahas masave që do të merren për zhvillimin e prodhimit, me fshatarët duhet të bëhet edhe një punë e madhe sqaruese politike dhe ideologjike.

Zhvillimi i kooperativave për të cilat diskutuam, do të varet nga dy faktorë: nga organizimi më i mirë i punës dhe nga ndihma që do të japë shteti. Kuota e shtetit hëpërhc mund të jetë e vogël, aq sa janë mundësitë. Mendoj se preokupacioni ynë kryesor nuk duhet të jetë çështja se si do të amortizohen mjetet që do të investojë shteti, por shtimi sa më shumë i prodhimit dhe i kuotave të pjesëmarrjes së shtetit. Këto kuota mund të shtohen me qëllim që t'i përgjigjen një organizimi të ndryshëm nga ai i tanishmi. Lopa sot, për shembull, është në pronësi personale. Edhe me organizimin e ri, ajo mund të qëndrojë në ekonominë e oborrit si e tillë. Mirëpo, me organizimin e ri, veç të tjerave, ne synojmë e do të luftojmë që të realizojmë një prodhim të mjaftueshëm për të furnizuar rregullisht edhe me qumësht dyqanet e kooperativës. Kështu krijohen kushte që kooperativisti, duke u furnizuar rregullisht me çdo gjë, të mos ketë më nevojë për lopën, për të cilën ai do të bindet se nuk i duhet, prandaj mund t'ia shesë kooperativës ose shtetit. Në këtë mënyrë do të rritet fondi kooperativist ose shtetëror i bagëtisë. Pra, me shtimin e prodhimit, ne do të arrijmë në një fazë që ta balancojmë e më vonë, kur të jenë krijuar të gjitha kushtet, ta eliminojmë pronën

e oborrit dhe lopa, për shembull, nga pronë individuale, do të bëhet pronë e grupit. Do të punojmë gjithashtu që, duke shtuar prodhimin, të shtojmë fondet shtetërore, të krijojmë edhe akumulime të tjera e në këtë mënyrë do të arrihet balancimi dhe eliminimi i pronës individuale në gjirin e grupit. Kjo do të realizohet dalngadalë, sepse shteti ka edhe detyrime të tjera për të ndihmuar kooperativat e zonave malore, kështu që një pjesë të akumulimit shoqëror do t'ua japë atyre. Me investimet që do të bëhen ka mundësi të shtohet foni i pagave. Në ato raste kur foni i pagës do të shtohet shumë dhe do të krijohet një tepricë, kjo mund të përdoret për të rritur investimet e për të ngritur mirëqenien, duke shtuar fondin e konsumit kolektiv deri në atë shkallë sa bëhet në ndërmarrjet bujqësore.

Tash, me një organizim më të zhđervjellët edhe kontributi për ndërtimet socialkulturore mund të jetë më i madh nga vetë kooperativat. Kur të futet organizimi dhe ndihma e shtetit, prodhimi do të shtohet, pra edhe paga. Duke caktuar kufirin e pagës, me të hollat që do të teprojnë krijohen mundësi për të bërë investime për çerdhen, shkollën, ambulancën, ujësjellësin etj., që edhe këto t'u afrohen sa më shumë atyre të qytetit. Kështu do të krijojmë një gjendje të mirë ekonomike dhe të ardhurat e tjera të oborrit kooperativist do të përbëjnë një shumë që nuk do të ketë ndonjë vlerë të madhe për fshatarin. Gjatë kësaj periudhe kohë, kur të kemi arritur që ta kemi ngritur më lart edhe shkallën e ndërgjegjes, kur shteti do të japë më shumë investime dhe të vëré në dispozicion më

shumë traktorë e mjete transporti etj., forca ekonomike e kooperativës në fondin e pandashëm do të jetë më e vogël nga ajo e shtetit dhe, si të jenë pjekur kushtet, krijohen mundësitë që të merret vendim me bindje të plotë për kthimin e pronës së grupit në pronë të të gjithë popullit. Se si do të arrihet kjo (kështu si e mendoj unë, ose ndryshe) do të na e mësojë jeta, po hëpërhcë oborrin ne mund të mos e heqim nga përdorimi personal i kooperativistit, siç u përmend këtu. Ne mund të krijojmë një formë tjetër administrimi të tij, po duke ruajtur destinacionin kryesor, që ai t'i vlejë fshatarit për ushqimin e kafshëve, për qumësht, mish etj., dhe për ca zarzavate. Në organizimin e ri duhet t'i kushtohet kujdes edhe mirëmbajtjes së lopëve personale dhe të bëjmë përpjekje që blegtorianë ta shtojmë si numër.

Me riorganizimin lind edhe problemi i statutit të këtij tipi të ri kooperativash, sepse statuti tip në fuqi i kooperativave bujqësore nuk mund të jetë më i përshtatshëm për këto që do të kenë një formë organizimi dhe metoda pune në përputhje me marrëdhëniet e reja që do të krijohen.

Jam dakord që dita e punës dhe shpërbllimi në këto kooperativa të llogariten me normë, ashtu si edhe në ndërmarrjet bujqësore. Pikërisht ne duam ta bëjmë këtë që të vendosim në disa kooperativa normat e ndërmarrjeve bujqësore, me qëllim që të rritet prodhimi në një kohë sa më të shpejtë, ndryshe nuk e bëjmë fare. Shteti ka interes që organizimin ta bëjë jo me metodat e vjetra që përdorin kooperativat sot, por me të rejat, në mënyrë që t'i angazhojë kooperativistët në

punë dhe të rriten rendimentet. Në qoftë se kooperativisti bën të gjitha përpjekjet për realizimin e normës, edhe prodhimi do të shtohet. Prandaj atyre duhet t'u japim jo një rrogë fikse të caktuar, por një pagë të garantuar.

Edhe unë jam dakord me variantin e dytë që na është paraqitur lidhur me riorganizimin e 40 apo 50 kooperativave. Punën për këtë qëllim duhet ta fillojmë menjëherë dhe ta mbarojmë mundësisht për 3-4 vjet. Për sa u përket studimeve që nuk janë plotësuar, të merren töpë gjitha masat e nevojshme.

Një çështje me shumë rëndësi që duhet të kemi parasysh me këtë organizim është propaganda, e cila duhet të ndërtohet në mënyrë të atillë që t'i shërbujejë me të vërtetë zhvillimit të kooperativave. Për këtë qëllim duhet bërë një punë e menduar mirë, politike dhe ideologjike, qysh në hartimin e planit të kooperativave që do të riorganizohen, sepse në këtë gjë ka rëndësi të jenë të ndërgjegjshëm, në radhë të parë, vetë kooperativistët.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

SPONTANEITETI I SHKRIMEVE NË SHTYP E UL INTERESIN E LEXUESIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

21 qershor 1971

Jam dakord me vërejtjet që u bënë këtu për punën e kolektivit të redaksisë së gazetës «Zëri i popullit», sepse ato janë të drejta dhe mendoj se shokët që merren me shtypin duhet t'i kenë parasysh. Besoj se nuk është hera e parë që punonjësve të gazetës u bëhen vërejtje të kësaj natyre nga ana e shokut Hysni, ose e shokut Ramiz, që është i lidhur direkt me këtë sektor. Mendimet që shprehën shokët në këtë mbledhje natyrisht nuk duhen kuptuar sikur në punën e gazetës «Zëri i popullit» nuk ka përmirësimi, përkundrazi, atje ka përparime, por përsosja gjithnjë e më shumë e metodës dhe e stilit në punë është një proces në vazhdim dhe nuk ka fund, prandaj duhen bërë përpjekje të përhershme, duke caktuar objektivat që duhen arritur

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit për punën në gazeten «Zëri i popullit» dhe për ngritjen e mëtejshme të cilësisë së punës dhe të organizimit në ATSH.

dhe, në luftë për realizimin e tyre, do të shikohet se sa të mëdha janë mundësítë për të ecur akoma më përpëra.

Gazeta «Zëri i popullit» është organ i Komitetit Qendror të Partisë, organi kryesor i shtypit, por me gjithkëtë ajo nuk mund t'i mbulojë çdo ditë të gjitha problemet e vendit tonë. «Zëri i popullit» duhet të dijë të kapë problemet kryesore të Partisë dhe të pushtetit dhe këto t'i trajtojë si duhet jo vetëm nga ana stilistike, por sidomos nga ana e përmbajtjes së lartë ideologjike, politike, teknike, organizative dhe, që t'i trajtojë kështu, duhet t'i ketë kuadrot të kualifikuar, që të dinë të shkruajnë mirë dhe të kenë njohuri të gjera e dituri të mjaftueshme.

Gazeta «Zëri i popullit» nuk është organi i vetëm i shtypit në Shqipëri, sepse ne kemi edhe organe të tjera të shtypit të përditshëm dhe periodik, të cilat, gjithashtu, kryejnë funksionin e informatorit dhe të edukuesit të masave të gjera punonjëse. Këtej del nevoja absolute e bashkërendimit të punëve ndërmjet të gjitha organeve të shtypit tonë. Ky orientim ka filluar të vihet në rrugë, por në këtë drejtim vërehen akoma shumë dobësi si në organet qendrore siç janë gazeta «Puna» e Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, «Zëri i rinisë» e Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë, revista «Shqiptarja e re» e Bashkimit të Grave të Shqipërisë, gazeta «Luftëtar» e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore etj., ashtu dhe në organet e shtypit lokal të disa rretheve ku bashkërendimi i punëve të shtypit nuk ekziston sa duhet. Në qoftë se nuk gaboheim, nga kjo anë në rrethe ka një mosinteresim të

palejueshëm. Redaksitë e gazetave lokale i marrin (dhe duhet t'i marrin) orientimet nga komitetet e Partisë, organe të të cilave janë, por nuk duhet harruar se, përveç komiteteve të Partisë, këto gazeta duhet të orientohen edhe nga organet qendrore të shtypit, në radhë të parë nga «Zëri i popullit» dhe nga gazetat e tjera të organizatave të masave që përmenda. Më shumë gazetat lokale shkruajnë për rrethet përkatëse dhe drejt e kanë këtë orientim të përgjithshëm, vetëm se duhet të dinë si dhe çfarë mund të shkruajnë për rrethin, që t'i lehtësojnë punën. Për këtë qëllim është e domosdoshme që organet e shtypit lokal si gazetat: «Përpara» e Korçës, «Jeta e re» e Shkodrës, «Pararaja» e Gjirokastërës, «Shkumbini» e Elbasanit etj., ta ngrenë më tepër nivelin e tyre, pasi në këtë anë, mendoj unë, ato çalojnë shumë. Duke marrë shembull të mirë edhe nga organet qendrore të shtypit, nga njëra anë, gazetat lokale do të ngrihen më lart në përbajtje dhe në formë dhe, nga ana tjetër, ato do të lehtësojnë më shumë barrën e rëndë të organeve të shtypit qendror.

Në qoftë se do t'i lëmë gazetat lokale të bëjnë si të bëjnë vetë, të jemi të ndërgjegjshëm se nuk e kemi bërë si duhet detyrën në fushën e shtypit. Po të kujdesemi vetëm për «Zërin e popullit» dhe për redaksinë e saj e të mos interesohemi edhe për të gjitha gazetat e tjera dhe për redaksitë e tyre, atëherë nuk do ta ngremë dot shtypin në atë nivel që kërkohet. Unë jam i mendimit që të mos e rritim numrin e gazetave qendrore, por të shtojmë tirazhin e gazetave lokale. Në të njëjtën kohë të ngrihet niveli i artikujve dhe i të

gjitha gjinive të shkrimeve, me qëllim që nga këto gazeta njerëzit në rrethe të orientohen më mirë politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht për situatën e rrethit, ndërsa vijën dhe situatën e përgjithshme të Shqipërisë ta marrin nga organet e shtypit qendror. Kjo, më duket mua, është një detyrë e rëndësishme dhe duhet zbatuar drejt gjithmonë.

Sipas mendimit tim, për informacion, baza kryesore duhet të jetë ATSH-ja, së cilës ne i japim të gjitha orientimet e nevojshme e për këtë punë kualifikojmë edhe korrespondentët e saj. Pra, ATSH-ja do t'i japë «Zërit të popullit» dhe të gjitha gazetave të tjera informacione, nga të cilat mund të zgjidhen ato që do të botohen, plus informacioneve të gazetave lokale, që janë shumë më të mira nga ato që jepin korrespondentët e «Zërit të popullit». Në këtë mënyrë, organi i Komitetit Qendror të Partisë dhe organet e tjera qendrore kanë dy burime informacionesh: ATSH-në, që është organ zyrtar i informacionit, dhe gazetat lokale, që kanë gazetarë shumë më të kualifikuar sesa ndonjë korrespondent, që, siç u tha këtu, ka katër rrethe dhe është ngarkuar të ndjekë të gjithë sektorët e punës e të jetës, të gjitha problemet kalojnë nga dora e tij. Ne, pra, duhet të kualifikojmë korrespondentët e ATSH-së për informacione, ndërsa ata të «Zërit të popullit» t'i kemi me profile të caktuara e për këto të shkojnë edhe nëpër rrethe për të shkruar.

Për sa i përket gazetës «Zëri i popullit», unë mendoj se me gjithë përmirësimet, vazhdon të ketë përsëri njëfarë kaosi. Akoma nuk po bëhen përpjekjet e duhura që të sistemohen shkrimet, në bazë të rubrikave

ose të faqeve të veçanta, të zgjidhen me kujdes problemet, të trajtohen thellë ato etj., që kjo gazetë të jetë me të vërtetë e një niveli të lartë, të plotësojë të gjitha kërkesat në rritje dhe njëkohësisht të mbajë gjallë fryshtën e entuziazmit dhe të mobilizimit të masave, e cila është një forcë e madhe, që çon përpara punët e Partisë sonë. Për mendimin tim «Zëri i popullit» e ka ulur ca këtë fryshtë, pse mjaft artikuj që boton nuk kanë kurdoherë shumë vlerë. Në qoftë se lëmë të ndryshken hovi revolucionar dhe shpirti praktik i masave, do të venitet edhe puna e Partisë sonë, prandaj shkrimet e shtypit tonë të ngrihen në atë nivel sa të prekin «telat» e zemrës së komunistëve dhe të masave të gjera punonjëse. Me gjëra bajate, të thëna e të stërthëna kaq herë, me përqindje e shifra të thata, me fluturime në stratosferë dhe me frazat boshe të ndonjë gazetari, nuk preken ndjenjat e njerëzve. «Zëri i popullit», duke u nisur nga logjika e gjérave, të propagandojë forcën e madhe të ideologjisë së Partisë, nevojën e përparimit të teknikës e të shkencës dhe të tëra këto, t'i pleksë me fryshtën e entuziazmit popullor. Kusht për t'ia arritur kësaj është që njerëzit e shtypit të janë të ngritur politikisht, ideologjikisht dhe nga ana profesionale.

Disa të meta në gazeten «Zëri i popullit» duket sikur janë korrigjuar, por, sipas mendimit tim, ka përsëri dobësi dhe mbetet shumë për t'u bërë. Më duket se interes i lexuesve nuk mund të zgjidhet duke botuar shkrime pa kriter e dësido, por duke vepruar sipas disa rregullave. Konfuzioni dhe spontaneiteti i shkrimeve në shtyp e ul interesin e lexuesit. Kam përshtyp-

jen që në shumë numra të gazetës kanë dalë shkrime të tilla që tregojnë se redaksia s'ka pasur çfarë të botojë. Janë hapur dosjet e materialeve dhe është menduar çfarë të vëmë në gazetë, këtë apo atë shkrim? Edhe kur është gjykuar se për njërin apo për tjetrin problem nuk është koha të shkruhet, përsëri janë vënë në gazetë duke gjykuar: «Po s'ka gjë, sepse të gjitha këto janë probleme partie!» Rreth çështjeve sociale, për shembull, mund të flasësh e të shkruash gjithmonë, por problemet, siç thashë, duhen zgjedhur mirë e në kohën e duhur. Kur vjen ndonjë shkrim, ta zëmë nga Tropoja, që flet për shkurorëzimet, menjëherë jepet për botim, pa menduar se me këtë përbajtje, kanë dalë tre, katër, pesë ose më shumë artikuj, se ka dy vjet të tëra që po shkruhet rreth këtij problemi shoqëror. Në qoftë se pas tri ditësh vjen përsëri një artikull po për shkurorëzimet nga rrathi i Librazhdit, edhe ky btohet pse «është një problem shoqëror!» Këto teprime nuk janë të mira. Nuk duhet menduar se shkrimet që na vijnë në redaksi, meqenëse kanë një tematikë të ndryshme, t'i mbajmë në dosje dhe, kur të mbenë në gazetë vende bosh, të mbushen me to, pa parë aktualitetin e tyre, rregullat dhe objektivat e caktuar që synojmë të arrijmë.

Në numrin e shkrimeve që vijnë në redaksi, ka edhe nga ato që s'janë të nivelit. Ç'ndodh në këto raste? Siç e tha edhe shoku Ramiz, disa gazetarë, meqenëse janë specialistë për gazetari, shpeshherë, marrin artikujt e ardhur dhe i korrigojnë, i redaktojnë. Unë e marr me mend se të korrigjosh një shkrim që vjen prej një korrespondenti vullnetar nga Tropoja, nga

Vlora ose nga Gjirokastra, duhet ta nxish midis radhëve me një shkrim të dendur e të hollë sa ndonjëherë të shndërrohesh edhe në kopist, por mendoj se nuk është e drejtë që këtyre njerëzve të talentuar t'u kalojë koha duke u marrë me rregullimin e shkrimeve të të tjera. Kjo metodë pune është jashtëzakonisht e gabuar.

Duke vepruar kështu organet qendrore të shtypit bëjnë punën e gazetave të rretheve, sepse për emancipimin e plotë të gruas, për disiplinën në punë, për shkurorëzimet etj., këto organe duhet të shkruajnë të shumtën disa artikuj në vit, por vërtet artikuj që të lexohen me interesim, të bëjnë përshtypje dhe t'i tun din njerëzit. Se çfarë ngjet në Tropojë apo në Gjirokastër, të shkruajnë gazetat përkatëse lokale dhe jo «Zëri i popullit», të cilat, sipas praktikës së gjertanishme, i duhet të merret me një mijë e një gjëra dhe të mbushë gazeten me ato që nuk i takojnë, me arsyetimin e gabuar, se «Të gjitha këto janë probleme të Partisë»!

Unë jam dakord me mendimin që u shfaq këtu se në gazetë është filluar të dilet nga një situatë e tillë, por kjo punë duhet vazhduar me këmbëngulje akoma më të madhe në të ardhmen dhe të shkohet drejt ndërtimit tematik të lëndës në gazetë. Është e padrejtë që të shkruhen tre artikuj njëri pas tjetrit për arkitekturën, sikurse bëri vërejtjen me vend edhe shoku Ramiz. Për arkitekturën mund të shkruhet një faqe gazete një herë ose e shumta dy herë në vit, po në atë faqe të pasqyrohet në mënyrë shkencore mendimi i Partisë për arkitekturën dhe cilitdo arkitekti që do t'i interesojë

ky artikull i gazetës, le ta mbajë si libër në xhep. Probleme të veçanta të arkitekturës mund të trajtohen fare mirë në gazeten «Drita» ose në revistën «Nëntori». Ndërsa artikulli për arkitekturën, që u intereson tërë arkitektëve të Shqipërisë, btohet sipas një plani dhe në të shprehet jo mendimi i një njeriu të vetëm apo i dy-tre vetave, por mendimi dhe direktiva e zërthyer e Komitetit Qendror të Partisë për këtë çështje, rrugët e zbatimit etj., dhe, për këtë qëllim, ftohet që të shkruajë një nga specialistët mbi dy-tri aspekte themelore të arkitekturës. Edhe për disa lloje vjershash, që dalin herë pas here në gazeten «Zëri i popullit», mendoj se s'është nevoja, pse për botime të tillë janë organet letrare, kurse në gazeten «Zëri i popullit» të shkruhet më tepër për çështje me rëndësi të vijës së Partisë në letërsi, të btohen shkrime me rëndësi teorike dhe praktike. Nuk është nevoja që në gazeten «Zëri i popullit» të btohet, për shembull, një shkrim i gjatë mbi një roman të caktuar ose krijimet e ndonjë poeti, jo se ato që kanë dalë në faqet e gazetës «Zëri i popullit» s'kanë qenë të mira, ose ai roman ose krijimtari poetike nuk ka vlerë, por sepse, siç thashë, «Zëri i popullit» duhet të merret me çështjet e vijës së Partisë në këto fusha dhe jo aq me ato lloj shkrimesh që u përkasin organeve të tjera të shtypit.

Po kështu mund të them edhe për shkrime të karakterit tekniko-shkencor. Në gazeten «Zëri i popullit» duhet të trajtohen probleme të vijës së përgjithshme të Partisë lidhur me zhvillimin e teknikës dhe të shkencës në aspekte të ndryshme. Prandaj, të hartohet një plan i studiuar në bazë të nevojave tonë, sipas të

cilit, kohë pas kohe të trajtohen thellë e në përmasa të drejta shkrime për disa probleme në fushat e ndryshme të shkencës, me qëllim që shkencëtarit, inxhinieri apo mjeku ynë të ketë mundësi që tc «Zëri i popullit» të lexojë materiale të nivelit të lartë e që kanë lidhje me specialitetin e tij. Në këtë gazetë mund të shkruhet, për shembull, për një organizim më të mirë të shërbimit mjekësor në spitale, nga profesorët më të mirë mund të shkruhet për rastet e përdorimit të antibiotikëve etj., etj. Në «Zerin e popullit» mund të shkruhet për çështje të historisë botërore dhe të historisë së Shqipërisë. Në raste të tilla trajtohen probleme të dorës së parë, që vlejnë t'u kushtohet një vend me rëndësi në gazeten kryesore të vendit, po s'mund të botohen shkrime sipas dëshirës ose qejfit të njërit apo të tjegrit, sepse për probleme të veçanta studimi, për shembull, studentët, pedagogët dhe profesorët e universitetit kanë buletinet e tyre, ku shkruajnë kuadro të përgatitur e të kualifikuar. Për temat që bëhen objekt studimi në gazeten «Zëri i popullit», personi që mendohet të shkruajë duhet të njoftohet shumë kohë përpara, atij i duhet thënë se përbajtja e shkrimit do të jetë orientim i përgjithshëm që do të jepet në bazë të vijës së Partisë. Po të veprohet kështu, ai që ngarkohet do të shkruajë me gjithë qejf dhe do të përpiqet që artikulli i tij të jetë térheqës dhe mobilizues.

E kam thënë edhe herë tjeter se në shtypin tonë, sidomos në «Zerin e popullit», duhet të shkruajnë edhe kuadrot kryesorë të Partisë, por këta s'mund të shkruajnë kurdoherë e për gjithçka. Është e vërtetë se këta shokë janë në gjendje të shkruajnë artikuj shumë të

mirë e të nivelist shkencor, por të mos harrojmë se janë edhe të zënë me mjaft punë të tjera. Prandaj, kuadrot kryesorë të Parisë dhe të shtetit mund të shkruajnë se ç'mund të bëhet e ç'masa duhen marrë për një problem të caktuar, por s'kanë kohë të futen në gjëra të tilla, për të cilat mund të shkruajnë shumë mirë specialistët.

Që të mënjanohet kaosi në shtyp, duhet bërë një plan serioz për materialet që do të botohen. Për këtë gjë del nevoja e kualifikimit dhe e specializimit të redaktorëve të gazetës «Zëri i popullit», të cilët janë përgjegjës për materialet që botohen. Kjo nuk do të thotë se redaktorët do të shkruajnë përgjithçka vetë. Jo. Që kur hartojnë planin, ata konsultohen edhe me specialistët e tjerë në fusha të ndryshme si: me mjekët, me inxhinierët, por edhe me punëtorët, me kooperativistët, me teknikët etj. Në këtë mënyrë redaktori do të jetë në korent me të rejat e shkencës dhe të jetës.

Duhet të kemi parasysh që gazeta te ne është një-kohësish edhe edukative, edhe informative, prandaj ne do ta informojmë publikun jo për gjithçka që ngjet në tërë Shqipërinë, se kjo s'ka mundësi të bëhet, por për gazeten «Zëri i popullit» unë mendoj se duhet të gjejmë një rrugë të veçantë. Për shembull, në momentin kyç të fillimit të fushatës së prodhimit, duhet botuar një artikull, në të cilin të jepen disa informata për realizimet në një, dy, tri ose në katër vende më karakteristike, me qëllim që të formohet opinioni, kurse informatat e tjera për fshatin, do t'i marrim, po nuk do të angazhohen njerëzit e gazetës që t'i korrigojnë e t'i botojnë çdo ditë. Redaktorët do t'i lexojnë ato ko-

rrespondenca e lajme, që të dinë mendimet dhe eksperiencën e bazës, ta zëmë, për fushatën e korrjeve në të gjitha anët e vendit si: në Korçë, në Gjirokastër, në Vlorë, në Kolonjë etj., etj. Të gjitha këto të dhëna me anët e tyre pozitive e negative duhet t'i grumbullojë gazeta, jo për t'i botuar, po për të nxjerrë prej tyre konkluzionet e duhura, esencën që do të botohet në gazetë. Këtu qëndron, si të thuash, mjeshtëria e gazetarisë. Botimi i gjërave të vogla e të cekëta e ul nivelin e gazetës, e cila, detyrimisht pastaj, bie në informacione shumë të thata. Ka vërtet probleme të përditshme, por në qoftë se ndërhyjnë të gjithë për të botuar çdo lajm, atëherë gazeta e humbet qëllimin e vërtetë të saj.

Çfarë bëjnë gazetat e tjera si «Bashkimi», «Puna», «Zëri i rinisë» etj., përse shkruajnë ato? Unë mendoj që «Zëri i rinisë» ndoshta paraqitet më mirë, por edhe atje duhet pak më shumë kontroll pse mundet që të rrihet kurdoherë një anë e problemeve dhe mund të ketë shumë fantazira. Unë nuk them që të mos ketë fantazi, sepse gazeta e rinisë, duke iu përshtatur lexuesve të vet, duhet të ketë probleme të dëfimët, shkrime të gjueshme edhe fantazi, por duhet të trajtojë edhe probleme serioze, të shtrojë edhe detyra. Artikujt duhet të mos jenë shumë të gjatë se nuk lexohen, prandaj ju, shokët e rinisë në këtë drejtim duhet të bëni disa sondazhe tek të rinxjtë dhe ta përmirësoni akoma më tepër gazeten «Zëri i rinisë».

Mendimi ynë dhe juaji për «Zërin e popullit» si-gurisht ka rëndësi, po ne, krahas kësaj, duhet të dimë edhe çfarë mendon Partia për të, për shkrimet e tij,

ç'mendon klasa punëtore, ç'mendon inteligjencia, kë-naqen dhe ç'vërejtje kanë?

Si duket, ju shokë të redaksisë, e keni gjetur të panevojshme të flitni për aksionet që ndërmerr rinia në shkallë të gjerë. Këtë e bazoj në faktin se nuk shikoj të shkruhet asgjë në gazeten «Zëri i popullit» për gjithë këtë masë të madhe të rinjsh e të rejas që vënë në këto aksione, punojnë, dërsijnë, lodhen, bile qëndrojnë atje edhe më tepër nga sa është caktuar prej Komitetit Qendror të BRPSH. Unë e ndjek çdo ditë shtypin dhe kam vënë re që me muaj të tërë nuk po shkruhet asgjë për këto aksione. Lidhur me këtë qëndrim ka vend për kritika edhe në adresë të organeve të pushtetit, edhe të organizatës së rinisë. Me sa duket, ju nuk e gjeni të nevojshme të shkruani për këtë problem. Natyrisht për këtë nuk është faji vetëm i shokëve të gazetës, por, siç thashë, edhe i shokëve të rinisë. Ti, Agim [Mero] dhe shokët e tjerë të rinisë më duket nuk veni sa duhet në hekurudhë të takoheni me rrininë që punon atje. Konstatohet se të rintjtë në aksione punojnë nga 10-11 orë në ditë, duke përfshirë edhe rrugën që bëjnë; e hedhin dheun me lopatë deri në dy metra lart; punojnë me dy turne, deri në orën 11³⁰ të natës, bile, kam marrë vesh se atje kërkoni ta bëni punën me tre turne. Po çfarë janë këta që i ladhni kaq shumë? Si është e mundur të veprohet kështu? Unë nuk jam dakord me këto veprime dhe një gjë e tillë mendoj se nuk duhet të lejohet më, pse atje kemi të rinj e të reja 16-17-vjeçarë. Nuk kemi vendosur ta çapëlojmë, por ta edukojmë rrininë me punën. Pse i dërguat studentët 20-vjeçarë në një punë më të lehtë,

siç është ngritja e tarracave dhe nuk i dërguat në hekurudhë? Në tarracime mund të ishin dërguar fare mirë të rinjtë dhe të rejat 17-vjeçare.

Le të marrim një çështje tjetër. Pse ta ngrejë vetëm «Zëri i popullit» nevojën e mbledhjes së kallinjve të grurit që po humbasin? Këtë çështje fare mirë mund ta zgjidhte me anë të telefonit Ministria e Bujqësisë, e cila t'u tërhiqte vëmendjen rretheve për t'u mobilizuar njerëzit në punë konkrete. Për këtë mund të shkruhej, qoftë edhe një faqe e plotë, në gazetat lokale, ku asgjë nuk shikon të shkruar për kallinjtë e grurit, megjithëse vetë shokët e rretheve i shikojnë kallinjtë e mbetur në ara. E njëjta gjë po përsëritet çdo vit. Unë nuk them që të mos shkruajë «Zëri i popullit» edhe për çështje të tilla, le të shkruajë, por mendimin e kam që si organ qendror, kjo gazetë të zbatojë planet dhe orientimet e përgjithshme që i janë dhënë dhe të mos merret me probleme që u takojnë gazetave të tjera.

Kam përshtypjen sikur puna e rinisë në to prej disave konsiderohet si diçka angari, që duhet të bëhet. Vitet e tjera nuk ka ndodhur kështu, përkundrazi, vazhdimisht ka pasur reportazhe, fotografji, shkrime të bukurë dhe entuziaste. Qofsha i gabuar, por tani sikur s'ndihet shumë çështja e aksioneve të rinisë, entuziazmi i saj.

Këto që preka unë këtu kanë lidhje me tematikën e gazetës. Po të mendohet se problemi zgjidhet me një temë të trajtuar nga një specialist, më duket se kjo, siç e ndieni edhe ju vetë, shokë të gazetës, nuk është e mjaftueshme, prandaj dhe i ktheheni asaj disa

herë. Por duhet pasur parasysh edhe ana tjetër se, po t'i kthehesh disa herë së njëjtës gjë nuk ka dhe aq dobi, sepse ai që do të shkruajë, për shembull, për të tretën herë, do të thotë përsëri po ato që ka shkruar më parë, ndoshta do të shtojë edhe ndonjë ide tjetër, veçse me një varg fjalësh gjoja të bukura. Kjo shpie që në gazetë të ketë edhe fraza boshe. Ne duhet të mësojmë si të shkruajmë dhe jo të botojmë shkrime në formën e raporteve burokratike, me frymë dikasteriale. Shkrimet e mira në gazetë kërkojnë jo vetëm kohë të mjaftueshme, por edhe studim të problemit, kujdes të veçantë në trajtinin e tij, që shkrimi të çelë perspektiva të gjera dhe të arrihet që përmes tij, orientimet dhe direktivat e Partisë të thellohen e të zërthehen nga ata që janë të specializuar. Kështu artikulli me siguri do të dalë serioz, interesant, i gjallë dhe prej tij lexuesit do të kenë çfarë të mësojnë. Në qoftë se artikujt dalin të thatë, vetëm me disa shifra dhe me frymë burokratike, atëherë faqet e gazetës do të mbushen, por njerëzit nuk do t'i lexojnë ata.

«Zëri i popullit» duhet të ketë shumë kujdes që të mos bjerë në pozitat e njërit apo të tjetrit, të ndonjë recensioni ose kritike që është bërë nga një organ tjetër, por, duke pasur parasysh vijën e përgjithshme të Partisë, të ndjekë deri në fund e me gjakftohtësi debatet, që janë shkëmbimi i mendimeve dhe luftë e ideve. Gazetarët që venë për të shikuar diçka ose për të ndjekur zhvillimin e një debati, natyrisht kanë mendimet e veta për ngjarjet dhe fenomenet që lindin e zhvillohen, por mendimet e tyre të mos bëhen pengesë për t'i shikuar problemet me objektivitetin

më të madh ose për të mos dëgjuar me shumë kujdes rrahjen e mendimeve të të tjerëve, sepse aty do të rrihen edhe mendimet e tij. Nga këto debate gazetari mund të bindet që gjykimi i tij për çështjen që këmbehen mendimet është me vend apo i gabuar dhe, pastaj, kur vjen në kolegjum paraqit mendimet e shprehura, jep dhe konkluzionet e tij. Kështu gazetari do të arrijë të japë tonin parimor për problemin që bisedohet; ai jep mendime të thella dhe jo të sipërfaqshme për çështjen.

Një nga problemet kryesore të gazetës «Zëri i popullit» është botimi i shkrimeve që kanë të bëjnë me jetën e Partisë, të cilat trajtohen në faqen e dytë. Atje ka shkrime të mira, po ka edhe gjëra shumë të përsëritura e të përcipta. Mua më duket se në këtë drejtim gazeta duhet të perfektionohet. Unë nuk e kam fjalën që të mos shkruhet, fjala vjen, për eksperiencën e punës së Partisë në rrethin e Pukës ose të Mirditës kur shkruajnë sekretarët e komiteteve të Partisë së këtyre rretheve etj.; këto do t'i botojmë se flasin për eksperiencën e bazës, po përvojën e rretheve duhet ta pasqyrojmë në gazetë në mënyrë të organizuar dhe jo kur të mundim e si të mundim, pa pasur disa kritere. Unë jam kurdoherë për njëfarë rregulli. Të botohet shkrimi, tema e të cilit jo se na doli rastësisht në rrugë, po sepse është zhvilluar një plenum i komitetit të Partisë të rrethit ku është ngritur një problem me rëndësi ideologjike e organizative, si për shembull fushata e zgjedhjeve në Parti, që shtron detyra të mëdha para Partisë. Në raste të tillë ftohen për të shkruar artikullin njëri nga sekretarët

e Komitetit të Partisë të Mirditës, të Pukës ose të Gramshit, të cilit i thuhet që më parë të shkruajë me kujdes se do t'i botohet pa u korrigjuar nga redak-sia e gazetës. Në qoftë se ndonjërit i teket të shkruajë se u mblohd organizata-bazë e Partisë e fshatit Çepunë të Gjirokastrës, është një gjë krejt e zakonshme dhe me rëndësi lokale, prandaj ky shkrim s'ka përse të botohet në «Zërin e popullit», por mund të botohet në gazeten «Pararoja» që është organ i Komitetit të Partisë të atij rrethi.

Janë gjithë këta shokë instruktorë të Komitetit Qendror që shpesh marrin pjesë në mbledhjet e Byrosë Politike e të Sekretariatit dhe aq më shpesh venë në bazë, por unë i kam parë shumë rrallë firmat e tyre nëpër shkrimet që botohen për jetën e Partisë. Në qoftë se nuk shkruani ju shokë, që jeni në dijeni të shumë problemeve, të cilat shkonit e i shtronit edhe me masën e Partisë në bazë, që ndihmoni bazën dhe merrni eksperiencën e saj të pasur, si do të shkruajë më mirë një sekretar partie në rreth? Përgjithësimi i eksperiencës së punës së Partisë nga ana juaj që jeni të informuar mirë, ka rëndësi për gjithë Partinë. Mua më duket se para se të kritikojmë inxhinierin ose çdo specialist tjetër që nuk aktivizohet për të shkruar në gazetë, duhet t'ju kritikojmë ju, shokë instruktorë të Komitetit Qendror, sekretarë dhe punëtorë të aparateve të Partisë në rrethe. Është kështu apo jo?

Për sa i përket mënyrës së organizimit të shkolave për përgatitjen e gazetarëve, unë jam dakord, le të vendoset se cila formë të jetë më e mirë dhe më e

drejtë, por, siç thashë edhe më parë, duhet të mendojmë që gazetarët e talentuar t'i heqim nga punët administrative, që ata të mos merren me shkresurina.

*Botuar për herë të parë,
me ndonjë shkurtim, në li-
brin: Enver Hoxha, «Ra-
porte e fjalime 1970-1971»,
Tiranë, 1972, f. 357*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali
i mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

DISIPLINA PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT KËRKOHET NË TË GJITHË SEKTORET

*Diskutim në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike
të KQ të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH¹*

24 e 25 qershor 1971

Dëshiroj të them edhe unë disa mendime, po natyrisht pa u zgjatur, për dy arsyet:

Së pari, se këto probleme tepër të rëndësishme i kemi marrë disa herë në diskutim në Byronë Politike, ku janë dhënë jo vetëm orientimet e përgjithshme për mënyrën e diskutimit të planit në bazë, por edhe orientime të veçanta për probleme të caktuara.

Së dyti, se nga shokët këtu u bënë diskutime të mira, të drejta dhe shumë të dobishme, të cilat do të na shërbejnë jashtëzakonisht shumë për ta përmirësuar më tej planin tonë të ri.

Si gjithë shokët, edhe unë jam dakord me projektdirektivat që na janë paraqitur për shqyrtim dhe

1. Në këtë mbledhje u diskutua për projektdirektivat e planit të pestë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të RPSH, për vitet 1971-1975.

me diskutimet që u bënë. Natyrisht pati edhe ndonjë mendim të ndryshëm, por, për planin, për këtë çështje kaq të madhe dhe jetike, në bazë të të cilit do të punojnë Partia dhe pushteti gjatë pesë vjetëve të ardhshëm, përfundimisht do të vendoset në Plenumin e Komitetit Qendror.

Në përgjithësi, mendimi im është që ky projekt-plan është i studiuar mirë dhe me baza. Them kështu se mund të hartohen edhe plane ku të parashikohen detyra të lehta e të realizueshme pa shumë përpjekje, po me to nuk mund të dilet aty ku duam. Mund të përgatiten, gjithashtu, plane fantastike, që nuk mund të realizohen kurrsesi dhe, njëloj si më parë, të dilet në të njëjtën qafë: t'i shkaktohen vendit dhe popullit dëme të mëdha politike dhe ekonomike. Projekti i tashëm nuk është as i pamundur, as i lehtë për t'u realizuar, por ai është një plan real, që mbështetet në eksperiencën dhe në rezultatet e arritura, në mundësitë që janë krijuar te ne dhe në perspektivat që hap zhvillimi i ekonomisë dhe i shoqërisë sonë socialiste.

Në hartimin e projektplanit të ri pesëvjeçar kanë marrë pjesë masat e gjera punonjëse, të cilat kanë dhënë shumë mendime dhe nga më të ndryshmet. Studimi i kësaj pune, pra, është bërë me kujdes dhe në mënyrë masive. Është me shumë rëndësi të dimë se çfarë ka thënë populli, ç'ka thënë fshatarësia lidhur me këto plane, sepse planin nuk do ta realizojnë sekretarët e komiteteve të Partisë, por kooperativistët dhe punëtorët. Natyrisht, edhe ne, në vija të përgjithshme po japim sot mendimet tona për ta përsosur më tej këtë plan. Por, e gjithë kjo punë e mirë që është

bërë dhe po bëhet, nuk përjashton mundësinë që për disa çështje, gjatë zbatimit në jetë të detyrave të pesë-vjeçarit, të marrim masa për ta përmirësuar dhe përforçuar akoma më shumë planin, siç kemi bërë edhe me planet e tjera në të kaluarën, që të mos na ngjasin gabime, sidomos gabime parimore. Natyrisht, ne nuk mund t'i parashikojmë dot në plan të gjitha gjërat në hollësi, deri te peri e gjilpëra. Për gjëra të vogla, të paparashikuara, duhet t'i lëmë edhe Qeverisë rezerva që të mund të manovrojë kur të lindë nevoja.

Tash dëshiroj të flas pak për çështjet e bujqësisë dhe konkretisht për hapjen e tokave të reja. Sipas mendimit tim, që e bazoj në direktivat e Partisë, ne duhet të vazhdojmë t'i vëmë rëndësi hapjes së tokave të reja, pse ekonomia jonë ka shumë nevojë për to. Në Kongresin e 5-të të Partisë me të drejtë u hodh parulla: «T'u qepemi kodrave dhe maleve, t'i zbulu-rojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat». Kjo nuk është një shprehje e thjeshtë letrare, po një parullë me kuptim të madh ideologjik, politik, ekonomik dhe ushtarak. Thirrjen e Kongresit për hapjen e tokave të reja, si një hallkë kryesore përkrah intensifikimit të bujqësisë, e gjetën me vend Partia dhe populli, prandaj u mobilizuan me një entuziazëm të madh për realizimin e detyrave të rëndësishme që u vunë për këtë çështje. Ne pamë konkretisht se si koo-perativistët dhe ushtria, me një zell të papërshkruar, iu futën punës dhe hapën sipërfaqe të mëdha tokash, shumicën dërrmuese të të cilave e punuan dhe e mbollën. Si rezultat i kësaj direktive të drejtë të Partisë dhe të punës së madhe që u bë në këtë

drejtim, me qindra fshatra që më parë bënин vetëm për dy, tre ose e shumta për katër muaj bukë, e siguruan atë për gjithë vitin, bile disa edhe më tepër. Të gjithë u habitën se si, për herë të parë gjatë jetës së tyre, u arrit ky sukses kaq i madh. Fshatarësisë sonë, me hapjen e tokave të reja, iu hoq, si të thuash, ai «saç i rëndë» nga koka, ai preokupacion i përhershëm, frika e madhe për bukën, që e kishte mbajtur në ankth gjithë jetën. Duke e kuptuar rëndësinë e thirrjes së Kongresit të 5-të të Partisë fshatarësia jonë kooperativiste punoi me këmbëngulje që të mos priste më me thes në dorë për t'u furnizuar me drithë nga depot e shtetit. Përkundrazi, ajo iu vu punës me zell të madh për të plotësuar jo vetëm nevojat e veta për bukë, por për t'i dhënë edhe shtetit teprica.

Në atë kohë të gjithë kemi qenë entuziastë për hapjen e tokave të reja, por, kam përshtypjen, se ai entuziazëm fillestar tash sikur ka rënë ca e nuk është në shkallën e duhur. Për mendimin tim, ky është një gabim i rëndë me rrjedhime politike, ekonomike dhe ushtarake për vendin tonë. Dhe gabimi që po përmend nuk është dukur në popull, po te drejtuesit. Siç e dimë kjo detyrë iu ngarkua rretheve. Mirëpo tash na thuhet «s'kemi krahë punë» ose parashtrohen plot justifikime të tjera. Kur vendosëm për hapjen e tokave të reja, ne i kishim parasysh të gjitha kushtet, e dinim mirë se popullsia e malësive tona do të rritet sipas grafikëve të rregullt që krijojnë nga zhvillimi i natyrshëm demografik dhe i mirëqenies së popullit, kështu që nuk pritnim që ajo të arrinte në

gjashtë milionë brenda pesë vjetëve! Gjithashtu, në bazë të llogarive të studiuara, patëm parasysh edhe nevojat që kishte gjithë ekonomia jonë për krahë pune, prandaj bëmë shumë mirë që morëm një sërë masash organizative për të kufizuar në maksimum shpërnguljen e fshatarëve nga kooperativat. Këtë e bëmë me ndërgjegje të plotë, në kundërshtim absolut me vijën antimarksiste të braktisjes së malësisë dhe të varfërimit të ekonomive të vogla fshatare që ndiqet në vendet kapitaliste e revisioniste. Në zhvillimin e bujqësisë ne nuk mund dhe nuk duhej të qëndronim në vend e të lejonim që njerëzve tanë të mos u plotësoheshin nevojat jetike. Kjo nuk mund të bëhej, sepse ne luftuam pikërisht që populli t'u jepte fund vuajtjeve e të krijonim kushte të atilla që jeta e njerëzve tanë të bëhej kudo e mirë. Por, në fshatrat kodrinore dhe malore kjo nuk mund të arrihet me atë tokë arë të paktë që ekzistonte; duheshin hapur sipërfaqe të tjera të reja dhe ato që do të hapeshin, të punoheshin patjetër. Prandaj, duke e parë problemin kështu, ne duhej të merrnim më shumë masa dhe të kishim menduar më tepër e më mirë nga sa menduan për këtë problem të rëndësishëm.

Gjithashtu mendoj se, për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë në zonat kodrinore e malore, duhet të marrim akoma më shumë masa për mekanizimin e punimeve dhe jo të tërhiqemi përpëra vështirësive. U tha këtu, për shembull, se ka mendime që të mos shtohen vreshtat. Po pse të mos shtohen vreshtat? Atëherë ta shtrojmë problemin ndryshe, mund t'ia referojmë këtë edhe Plenumit të Komitetit Qendror,

pse pa vreshta s'mund të bëhet, populli dhe fëmijët duan rrush. Por ç'ndodh? Sa herë që shtrohet kjo çështje, të del përpara puna intensive dhe mungesa e krahut të punës. Atëherë, për ta zgjidhur problemin, t'i vëmë rëndësi të madhe mekanizimit të proceseve të punës në bujqësi, mekanizimit në stil më të gjërë të shërbimeve për të cilat kanë nevojë bimët bujqësore, pse duhet thënë që këtë e kemi lënë deri diku pas dore. Prandaj, është e domosdoshme t'i kthehem me përgjegjësi të plotë këtij problemi. Çështja e krahëve të punës në bujqësi nuk mund të zgjidhet pa mekanizime. Si mund të prashiten të paktën dy herë me krahë, me qindra mijë hektarë lulledielli, misri etj.? Po të veprohet kudo me krahë, ne nuk do t'uа dalim dot kurrë nevojave të tjera të ekonomisë sonë, nën pretekstin se «s'kemi krahë pune». Këtë duhet medoemos ta zgjidhim.

Ka ardhur koha që në bujqësi nuk mund të bëjmë dot pa mekanizime, ashtu si tani nuk bëjmë dot pa traktorë. Apo bëjmë? Në asnjë mënyrë nuk mund të bëjmë dot! Më përpara, kur kishim pak tokë, problemi i mekanizimit s'ishte kaq i mprehtë sa tani. Puna me dorë në bujqësi është e pamundur të bëhet kudo, si nga ana ekonomike, ashtu dhe kur flasim përrendimentet. Çfarë rendimentesh të larta kërkojmë të marrë fshatari, kur ai nuk ka si i përgjigjet me krahë gjithë atyre shërbimeve, për të cilat kanë nevojë bimët bujqësore? Ja sepse problemi na vihet kështu: pa zhvillimin e mëtejshëm të mekanizimeve në bujqësi, nuk mund të zgjidhet absolutisht as çështja e vreshtave. Pse të angazhojmë gjithë ata punëto-

rë me pompa në krahë për të spërkatur vreshtat, kur këtë punë mund ta bëjmë me makinë? Si spërkatja ka edhe procese të tjera, ku punën e njeriut mund ta zëvendësojë makina. Atëherë, ç'na ka penguar ne që s'e kemi bërë këtë në shkallën e duhur? Në radhë të parë kanë penguar konceptet. Ka nga shokët tanë që kanë rënë në pozitat e disa fshatarëve, pikëpamjet e të cilëve janë arkaike. Ne e dimë sa rezistencë ka pasur për prashitjen me kultivator, rezistencë kjo që vazhdon akoma edhe sot. Është e qartë se zgjerimi i mekanizimit në bujqësi nuk mund të realizohet pa luftuar më mirë kundër koncepteve arkaike të fshatarit.

Ne kemi shumë nevojë për mekanizime. Ato makinë bujqësore që nuk i prodhojmë dot vetë akoma, t'i blejmë jashtë, kurse për disa të tjera të blejmë jashtë vetëm lëndën e parë dhe të fillojmë t'i prodhojmë në vend. Po të jetë nevoja, në të ardhmen ne mund të ngremë edhe një uzinë të veçantë për prodhimin e makinave që do të mekanizojnë më tej punën në bujqësi. Në këtë mënyrë do ta ekonomizojmë shumë krahun e punës, do të krijohet një situatë tjetër edhe për sa u përket rendimenteve dhe do të ndryshojë koncepti mbi vlerën e ditës së punës. Në qoftë se do të zgjerojmë mekanizimin, atëherë normat e punës do të ndryshojnë. Për kooperativistët do të ketë përsëri ditë-punë, por një pjesë e madhe e shërbimeve të bimëve do të kryhen me makinë, jo me krahë. Kështu puna do të matet ndryshe, gjë që do të ndikojë mjaft në konceptin e fshatarit, i cili në ato procese që s'arrin dot t'i bëjë me krahë, do t'i

vijë në ndihmë makina. Puna në këtë mënyrë jo vetëm nuk do të mbetet pa kryer, po edhe rendimenti do të rritet; prodhime do të ketë më shumë e si rrjedhim, do të ngrihet edhe mirëqenia e njerëzve tanë.

Rëndësi të veçantë t'u kushtojmë kooperativave të zonave malore, sepse në malësi kemi një popullsi të madhe, trime dhe patriote që, në rast rreziku, do të bëhet bazë për të mbrojtur atdheun me çdo kusht. Organizatat e Partisë në rrethe, veçanërisht udhëheqjet e tyre, më duket se nuk po e kuptojnë mirë dhe drejt në kushtet e vendit tonë, nevojën e intensifikimit të bujqësisë dhe këmbënguljen për zbatimin e agroteknikës edhe në zonat malore. Duke vepruar kështu, në mënyrë të njëanshme, ka rrezik që mund të bien në dy gabime:

Së pari, brenda në kooperativat e bashkuara, zmadhimi i të cilave ishte i drejtë, keqkuptimet mund të çojnë në komprometimin e idesë së krijimit të këtyre kooperativave të zmadhuara, ku përfshihen edhe zonat e malësisë, prandaj të gjitha tokat e çdo kooperative të punohen deri në fund, për të marrë nga të gjitha parcelat sa të jetë e mundur çdo vit e më shumë prodhime dhe kooperativat bujqësore kudo, deri edhe në malësi, t'i kthejmë kështu gradualisht, me një punë të menduar mirë, në ekonomi të mëdha, të fuqishme e moderne. Në rast se në kooperativat e zmadhuara do t'u vëmë rëndësi vetëm tokave që janë më pjellore dhe do të intensifikojmë vetëm ato, duke mos u kujdesur sa duhet, apo ca më keq, duke i braktisur të tjerat që janë më pak pjellore, kjo do të thotë që bashkimin e kooperativave nuk e kemi parë në rrugë

të drejtë dhe, për pasojë, nuk do të kemi ato përparrime dhe rezultate që presim dhe për të cilat i krijuam këto kooperativa. Këto prirje do të ngjallin te njerëzit tanë tendenca parazitizmi, për t'u mjaftuar vetëm me një sipërfaqe të kufizuar toke, gjë që nuk është e leverdishme as për ekonominë kooperativiste të zmadhuar, as për tërë vendin. Vetëm duke ndjekur rrugën e intensifikimit të të gjitha sipërfaqeve të tokës arë, ekonomia e zmadhuar kooperativiste mund të dalë me rendimente të realizuara. Prandaj, të shfrytëzohen mirë të gjitha tokat dhe të bashkërendohen mundësitë ekzistuese për zhvillimin e shpejtë të ekonomisë bujqësore.

Së dyti, brenda rrethit ku ka kooperativa të mëdha në fushë dhe të vogla në male, të kihet kujdes që të mos u vihet e gjithë forca vetëm kooperativave të fushës, ndërsa ato të zonave malore të lihen në dorë të fundit. Këtë e them, pse, me sa di unë, një gjë e tillë ka ngjarë në Durrës dhe gjetkë.

Mendimet e ardhura nga rrethet për të rritur rendimentet dhe për të ulur sasinë e sipërfaqes së tokës së mbjellë tregojnë pikërisht pikëpamjet e gabuara të atyre që vura në dukje. Jam i bindur se kërkesa për pakësimin e sipërfaqes së tokave të reja, të parashikuara për t'u hapur, nuk është e fshatarësisë, sepse fshatari ynë e do tokën; ai kurrë nuk mund të prononcohet kundër saj; ai është kundër kërkesës që bëjnë drejtuesit e rretheve, të cilët, siç thanë shokët Haki Toska e Rrapi Gjermenit, e paraqesin këtë si një kërkesë të masave. Pra, janë disa drejtues, që bëjnë gjëra të tilla, shokë, dhe jo masat.

Kështu është edhe rasti që u tha këtu, se një nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë, nëpërmjet telefonit, merr nga zyra e kadastrës së Lushnjës të dhëna të njëanshme për hapjen e tokave të reja dhe planin e paraqet si të parealizuar, kur në të vërtetë gjenjëja është ndryshe. Me qëndrimin që mban ky nëpunës i vë një minë ekonomisë bujqësore. Një frymë e tillë, siç është tendenca e të kënaqurit me pak, pretekstet për mungesën e krahut të punës dhe të kafshëve të punës (që natyrisht nuk i kemi me bollëk), si dhe dobësitë në organizim çojnë në kërkesën e pamenduar për uljen e sipërfaqeve të hapjes së tokave të reja. Do të bënim gabim të madh në qoftë se tërhiqemi nga direktiva e Partisë për hapjen e tokave të reja. Nuk them se kjo është një punë e lehtë, bile është mjaft e vështirë, por ne duhet të marrim masa, të japim ndihmë, të gjemë mjetet etj. dhe të luftojmë që këto 60 mijë hektarë që do të hapim, të kthehen në fakt në tokë ara¹. Ne kemi qenë ata që kemi hapur edhe më tepër se kaq në pesëvjeçarin e kaluar. Gjersa jemi të bindur se ka akoma toka për të hapur, në vend që të tërhiqemi para vështirësive, duke thënë se tash ato janë larg, të punojmë me këmbëngulje për të zhdukur çdo pengesë e po qe e nevojshme, të ndërtojmë edhe rrugë për të vajtur në to.

Unë nuk jam shumë i bindur në atë që u tha këtu se një pjesë të tokave e mori lumi. Lumi mund t'i gërryejë vërtet po të mos marrim masa për t'i ruaj-

1. Në fakt, në pesëvjeçarin e pestë u hapën 66 300 hektarë toka të reja për ara.

tur. Por, fryma e ngjallur në këtë drejtim më bën të dyshoj se shkaqet e përmendura këtu kanë shërbyer për të justifikuar neglizhencën e vërtetuar në hapjen e tokave të reja, prandaj të merren masat efikase që të mbrohen ato, në fushë e kudo. Nuk mjaf-ton të përcaktohen detyrat e të premtohet se do të organizohet mirë puna. Çështja është që kjo të bëhet realitet, të zbatohen zotimet e detyrat dhe sa më parë të duken frytet e punës. Në qoftë se nuk zhdukim frymën që ekziston për tokat, as vitin tjetër nuk do ta realizojmë planin e hapjes së tokave të reja dhe as tokat e hapura nuk do të sistemohen, siç duhet. Nuk është e udhës që, për arsyet e shumë të metave dhe mungesave që kemi në bujqësi, të themi se s'ka mundësi të shkohet më tej. Ne do të pranojmë të mos happen toka të reja, vetëm kur të mos ketë më të tilla. Por derisa toka ka, jam i mendimit të mos i lëmë pa hapur.

Çështja tjetër për të cilën dëshiroj të flas, është ajo e qarkullimit të bimëve bujqësore. Në kushtet tona, po ta shikojmë këtë problem vetëm nga ana agroteknike, do të jetë gabim. Natyrisht, s'ka asnje dyshim që agroteknika duhet të zbatohet si duhet edhe për qarkullimin bujqësor. Por mua më duket se ky problem për disa bimë duhet parë lidhur me një sërë rrëthanash, nevojash e kushtesh të vendit tonë.

Çfarë i shtyn kooperativistët që t'i ndërrojnë tokat e brigadave sot? Mendoj se i shtyjnë pikëpamjet e tyre mikroborgjeze. Një brigadë që punon mirë, ia bën tokës të gjitha shërbimet, e sistemon, e kullon etj. Një tjetër që nuk e punon mirë, nuk interesohet si

duhet as për sistemimin e tokave, as për kanalizimet etj. Atëherë, kjo e dyta është gati të kërkojë për ta këmbyer tokën, domethënë, kjo të marrë të mirë dhe ajo që ka punuar me ndërgjegje, të shkojë tek e keqja që ta bëjë edhe atë si të parën. Në përgjithësi çdo brigadë e arave, qarkullimin bujqësor do ta bëjë rreth disa bimëve. Kjo do të thotë që specializimi i tyre do të bëhet në bllok dhe s'ka si të lëvizin forcat sa andej këtej. Në qoftë se mendohet që këtë brigadë të arave ta marrim dhe ta çojmë të punojë në vreshstat, kjo është tjetër punë, është tjetër specializim, kurse në brigadat e arave janë boll tri-katër bimë. Kështu brigadat e arave do të specializohen për punët që u takojnë bimëve që janë ngarkuar të mbjellin vetë.

Le të marrim, për shembull, pambukun. Ne kemi ngritur dy kombinate të mëdha, për të cilat kemi vendosur që të punojnë me pambukun shqiptar, duke menduar të sjellim nga jashtë, si lëndë të parë, vetëm një sasi të caktuar pambuku fijegjatë, që ta përzierjmë për nxjerrjen e disa prodhimeve të cilësisë së lartë. Tashti na thuhet se nuk është realizuar plani i pambukut, për arsyе se nuk është bërë qarkullimi e për këtë thuhet të térhiqemi nga orientimi i dhënë. Mendoj se vec qarkullimit ka edhe shumë arsyе të tjera që e kanë penguar realizimin e planit të pambukut. A nuk e vërteton këtë edhe fakti që te ne ka bujqësorët apo brigada të dalluara që, megjithëse nuk e kanë zbatuar kurdoherë qarkullimin në tokat ku mbjellin pambuk, kanë marrë një produksion prej 15-20 kuintalë për hektar? Plani ynë aktual është bazuar në rendimentet që janë arritur gjatë tanisë së fundit.

pambuk. Të mos harrojmë se pambukut ne i kemi dhënë tokën më të mirë, e kemi rajonizuar dhe punimet për këtë bimë i kemi mekanizuar në maksimum. Edhe për sa i përket problemit të farërave, me aq sa kemi pasur mundësi, për pambukun jemi përpjekur të gjenim nga më të mirat. Atëherë pse tërhiqemi nga shifra e planifikuar? Ky nuk është qëndrim i drejtë.

Unë mendoj se neve mund të na lejohej ta ulnim planin e pambukut vetëm kur të kishim krijuar dhe të kishim vënë në dispozicion të Qeverisë një sasi të mirë devize ose kleringu, që do të na jepte mundësi për të bërë ndryshimin e një sasie boshtesh të ndonjërit prej kombinateve tona që të punonte me fije sintetike të sjellë nga jashtë. Të tërhiqesh tash nga projekti i parashikuar për prodhimin e pambukut, duke pretenduar se mund të blihet jashtë lënda e parë për nevojat e industrisë sonë, pa qenë të sigurt për devizën, dhe se valutën do ta kompensojmë me shtimin e sipërfaqes së mbjellë me misër, më duket një hap i nxituar. Kush na siguron nëse do ta marrim ose jo sasinë e misrit që dëshirojmë? Prandaj jam i mendimit që të bëjmë të gjitha përpjekjet për të prodhuar në vend sa më shumë pambuk dhe stofra pambuku.

Të tërë shokët na thonë vazhdimesht që stofrat e pambukta kërkohen shumë jashtë. Duhet të mendojmë që në kombinatet tona të vendosim një teknologji sa më të lartë për të nxjerrë stofra pambuku që të pëlqehen jo vetëm nga populli ynë, por edhe nga blerësit e huaj. Po ç'bëhet në të vërtetë në këtë drejtim? Më kanë thënë se ka pasur raste që bezet e

produara në kombinatet tona nuk na i kanë blerë jashtë. Ku po shkojmë shokë?! Përse nuk bëjmë përpjekje për të vlerësuar drejt mundësitë tona, po kemi gjetur rrugën më të lehtë duke thënë se pambukun s'e prodhojmë dot, as atë tjetrën s'e prodhojmë dot; të ulim sipërfaqen e kësaj, të ulim prodhimin e asaj etj.? Kështu si po ecim, më duket se ka rrezik, që mund të vijë avash-avash koha e të na thuhet që të heqim dorë fare nga pambuku. Ne jo vetëm që nuk duhet ta lejojmë këtë, por përkundrazi t'i japim rëndësinë e duhur kësaj bime dhe të bëjmë ç'është e mundur për të marrë rendimente sa më të larta nga sipërfaqet që mbjellim me të.

Po diskutohet, gjithashtu, shumë për të mbjellë 2 apo 4 mijë hektarë më pak luledielli, sikur nga kjo sipërfaqe të varej fati i gjithë ekonomisë sonë. Vajin e lulediellit ne nuk e prodhojmë për luks, po për nevojë. Mirëpo, në qoftë se do të pakësojmë mbjelljen e lulediellit atëherë, për plotësimin e nevojave të popullit me vaj, duhet t'i drejtohem i tregut të jashtëm. Por, që të blesh jashtë vaj për të përballuar nevojat e vendit, duhet të kesh devizë, valutë të huaj. Edhe në qoftë se arrijmë të sigurojmë një sasi devize, jam i mendimit që kjo t'i lihet Qeverisë në dispozicion për të siguruar me të rezerva fondesh materiale për ato nevoja të ekonomisë që tash nuk i kemi. Bile, nga kjo anë plani ynë i ardhshëm pesëvjeçar po ndërtohet, si të thuash, cip më cip. Kjo kërkon që njerëzit tanë të mobilizohen totalisht për realizimin dhe tejkalimin e tij, me qëllim që të krijohen edhe rezerva për t'i

pasur në kohë rreziku. Në qoftë se devizën ose rezervat e tjera në materiale i shpërndajmë si të qëllojë përtë mbushur këtë ose atë boshillëk të rastit që na krijohet dhe jo mbi baza të studiuara të parashikuara mirë, nuk mund të kemi as disiplinë, as kursim materiali.

Mund të flasim e të bëjmë agjuracion sa të duam, por, kur të tëra rezervat preken, mund të vijë pastaj një kohë që mbetemi pa gjë fare. Sivjet, shokë, disa artikuj ushqimorë u detyruam t'i importojmë me devizë, duke shpenzuar përtë ta miliona. Prandaj nuk i kuptoj aspak propozimet e disa shokëve të rretheve, që kërkojnë me këmbëngulje të ulet sipërfaqja e mbjellë me luledielli. Të jemi realistë: populli ynë është vërtet patriot, po buka, vaji, mishi etj., janë të domosdoshme përtë ushqimin e tij të përditshëm, prandaj mungesa e tyre në treg me të drejtë do të shkaktonte shqetësime. Kjo i kushton shumë Partisë. Prandaj, shokë, është gabim t'i marrësh e t'i trajtosh këto punë në mënyrë akademike, pa i parë me kujdes edhe nga ana praktike.

Mua s'më duket e drejtë as pikëpamja e Mehmetit [Shehut], i cili thotë të pakësojmë sipërfaqen përtë mbjelljen e pafates dhe se pataten duhet ta llogaritim vetëm përtë gjellë. Jo vetëm të mos e ulim sipërsaqen, por të përpinqemi të rritim shumë rendimentin e pafates. Të mjaftohemi me 40 ose 50 kuintalë patate përtë hektar, do të thotë të shkaktosh pasoja të rënda. Unë mendoj se është e domosdoshme të bëjmë të gjitha përpjekjet përtë marrë jo 40, por, po të jetë e mundur, 340 kuintalë patate përtë hektar.

Mbaj mend se edhe për panxharin, në fillim, fshatarët e Korçës rezistonin ta kultivonin, dhe arsyjeja ishte se nuk u leverdiste. Ngaqë nuk punohej si duhej ata nuk merrnin më shumë se 60-70 kuintalë për hektar. Për këtë arsye shkova edhe vetë në fshatin Sovjan. «Nuk na del hesapi, shoku Enver» më thanë atëherë. Këmbëngulja e fshatarëve u thye vetëm në sajë të punës bindëse e me durim që bëri atje organizata e Partisë. Pastaj vetë fshatarët, iu vunë punës, fituan eksperientë dhe me sa di (ekzakt s'më kujtohet), sot marrin 250 deri 300 kuintalë panxhar për hektar. Me këtë rendiment kjo bimë është bërë mjaft e leverdishme.

Të prodhosh, pra, patate me 40, 50 ose edhe 60 kuintalë për hektar, natyrisht nuk të leverdis. Një prodhim kaq i dobët i patates vjen sepse puna për këtë bimë është marrë shumë ftohtë; nuk i bëhen shërbimet e duhura. Pataten disa rrethe, që në fillim, e kanë marrë si diçka që nuk shërben për bukë, bile as për gjellë, megjithëse gjatë entuziazmit të parë produam edhe makinat që do të gatuanin bukën me patate. Pra patatja nuk shikohet si duhet te ne as si zarzavate, merret si një bimë me pak rëndësi. Vëtëm kur ngrihen çmimet për eksport, atëherë shtohet prodhimi i saj. Si të mos e mendojë një çikë koooperativisti ynë arsyen që të huajt e blejnë pataten si frëngu pulën? Mos vallë ata e blejnë për ta hedhur në det?! Jo, të huajt e blejnë për nevoja, se patatja është ushqim i vlefshëm dhe në vend që të hanë bukë, hanë patate. Kjo është shumë e mirë dhe veç përdorimit për bukë, të punojmë që populli ta përdorë

më gjerësishët edhe si gjellë. Përdorimi i saj ka rëndësi të madhe. Ne duhet të zhvillojmë një politikë të tillë që të mos e braktisim këtë bimë kaq me vlerë. Po e lamë pas dore, asaj vetveti nuk do t'i vihet rëndësi. Është e vërtetë se patatja kërkon shërbime, do dy qilizma, po edhe bimët e tjera, edhe panxhari, i duan këto shërbime. Ne i kemi marrë të gjitha masat për ta kultivuar gjerësishët pataten, derisa edhe farë sollëm nga jashtë, prandaj s'duhet të térhiqemi.

MEHMET SHEHU: Po të doni, ne mund ta rritim sipërfaqen edhe më shumë, por ankime për këtë bimë kemi nga të tëra rrrethet. Unë jam pesimist për pataten, prandaj propozoj që sipërfaqja e mbjellë me të, të kufizohet. Kjo që po them mund të jetë gabim, dakord, por nuk duhet të cilësohet si një térheqje nga vija e Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shiko, Mehmet, unë nuk e ngre çështjen ashtu si e shtron ti. Edhe mbrëmë gjatë diskutimit të shokut Hysni, kur ndërhyre e i the «hajde t'i therim të tërë qetë», nuk fole drejt. Asnjëri nuk thotë dhe askush nuk na lejon t'i therim qetë, bile jam i mendimit, se për një kohë të gjatë qetë do të na jenë akoma shumë të nevojshëm, pse në malësi sidomos, nuk bëjmë dot pa ta. Kur avash-avash ta kemi zëvendësuar punën e qeve me automjete të mjaftueshme (dhe dihet se deri tash kooperativave ne u kemi dhënë shumë pak automjete), atëherë mund të flasim për shkurtimin e numrit të qeve. Kooperativave të fillojmë t'u japim diçka nga automjetet që të mund t'i përdorin në terrenet kodrinore. Prandaj me atë që u shprehe ti «hajde t'i therim të

tërë qetë», as unë, as ndonjë tjetër nuk jemi dakord.

SHOKU HYSNI KAPO: Më lejoni të flas edhe unë, se Mehmeti kot shprehet me aq «kompetencë» dhe këmbëngulje.

Kur fola për qetë, sikurse e kam ngritur edhe radhën e parë në mbledhjen e Byrosë Politike, së pari, theksova se kafshët tërheqëse që kemi sot është fakt që nuk i përdorim siç duhet. Së dyti, thashë që reportin midis lopëve dhe kafshëve joprodhuese nuk e kemi në rregull dhe dhashë mendimin si ta përmirësojmë këtë raport.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti Mehmet nuk ke pse nxehesh, ashtu siç u nxehe dhe me Hysniun. Nuk është gabim që shoku Hysni u shpreh që t'i mbajmë qetë në nivelin ku jemi. Ç'të keqe ka këtu kur u thuhet shokëve mendimi personal?! Ti vetë the se numrin e qeve e ka vendosur Kongresi, pra është një vendim i Partisë, kurse kur unë shpreha mendimin se nuk duhet ta ulim sipërfaqen e mbjellë me patate, thua se nuk je dakord. Unë nuk nxehem me ty, Mehmet, prandaj më vjen shumë keq që në këtë rast ti po tregohesh shumë *susceptible*¹ dhe që na u preke deri atje saqë the: «Partia le të më caktojë kryetar kooperative apo brigadier!».

Ti mund të kesh bindjen tënde se nuk realizohet patatja, po edhe unë kam bindjen time, megjithatë nuk duhet thënë «të më caktojë Partia të bëhem brigadier dhe do të përpinqem të marr patate sa të jetë e mundur më shumë», siç na the ti këtu. Çështja

1. Frëngjisht — I ndjeshëm, që preket shpejt.

shتروhet: duhet apo nuk duhet ta vlerësojmë pataten në masën që meriton. Unë mendoj që duhet, sepse ajo është një bimë leguminoze me rëndësi të madhe, një ushqim i vlefshëm për popullin. Por, siç e thashë dhe po e përsëris, me 40 kuintalë për hektar nuk mund të ecet me pataten, se nuk ka leverdi.

Gjatë diskutimit tim thashë se mund të merren 340 kuintalë për hektar, gjë që edhe është arritur në ndonjë parcelë të veçantë, por kjo nuk do të thotë që t'i themi fshatarit të prodhojë që tash 340 kuintalë patate për hektar, se ne nuk fluturojmë. Në kushtet tona një rendiment kaq i lartë nuk është i mundur të arrihet në të tërë sipërsaqen, kurse 90-100 kuintalë për hektar, me disa përpjekje më shumë, mund t'i marrim, gjë që është edhe e leverdishme¹.

Për sa i përket ushqimit të lopëve dhe të bagëtisë, në përgjithësi, nuk kam çfarë të them, se kështuna e keni paraqitur në shumë mbledhje. Por, në qoftë se do të merren me të vërtetë të gjitha masat që parashikohen, jo vetëm mund të rriten aq krerë lopë sa janë planifikuar, po edhe mund të avancohen shifrat ashtu siç u propozua këtu, sepse nevojat janë shumë të mëdha. Përse lihen pa u punuar gjithë ato sipërsaqe toke që na përmenden, në një kohë që kërkohen toka të tjera për foragjere? Pse nuk merren rendimente të larta nga foragjeret? Për ushqimin e bagëtisë nuk mund të ecet më siç kemi bërë deri

1. Vetë përvoja e mëvonshme tregoi se këto rendimente u realizuan e u tejkalan u nga disa rrethe si ai i Korçës, i Kukësit, në kooperativën e Bellovës në Peshkopi etj.

tani. Natyrisht, në të ardhmen do të ketë përparime, por të kemi parasysh se që tash është e domosdoshme të bëjmë përpjekje për ta rritur sasinë e foragjereve dhe për të përmirësuar cilësinë e tyre, në një shkallë më të lartë se deri sot, ndryshe edhe lopët e blera jashtë, për të cilat kemi investuar shuma të mëdha, jo vetëm do të na degjenerojnë, po nuk do t'i kemi as si numër. Prandaj të punojmë që ta shtojmë ushqimin e tyre, sepse ato do të na japin qumështin, djathin, gjalpin, lëkurën. Llogaritë t'i bëjmë mirë dhe në këtë llogari të përfshijmë edhe qetë e lopët e anëtarëve të kooperativave bujqësore, që përbëjnë një kontingjent jashtëzakonisht të madh. Në qoftë se ato do t'i lëmë pa llogaritur, si deri tash, do të bënim një gabim të rëndë.

Për sigurimin e zarzavateve nuk do të flas shumë, mbasi këtë problem do ta trajtoj edhe në Plenum. Dua vetëm të theksoj se kështu si veprojmë me zarzavatet, nuk mund të ecet. Edhe sikur të kemi bukë me bollëk e të shtojmë konsumin e saj, prapë përdorimi më i madh i zarzavateve nga ana e njerëzve tani është jo vetëm i nevojshëm, por i domosdoshëm. Pa përdo-rur gjerësisht zarzavatet, ne edhe bukë do të konsumojmë më shumë. Prandaj, sikur edhe për të parandaluar konsumin e tepërt të drithit, ne nuk duhet të shkurtojmë sipërfaqen e mbjellë me zarzavate, përkundrazi, të mbjellim një sasi më të madhe toke me to dhe të luftojmë për ngritjen e rendimenteve që deri tash i kemi të ulëta. E vërteta është se me vështirësi po i marrim masat për prodhimin e zarzavateve. Kur

flasim për masa duhet të kuptojmë në radhë të parë atë që kooperativistët tanë të ngrihen nga ana agroteknike dhe në të gjitha drejtimet e tjera.

Sidomos për zbatimin e mirë të agroteknikës të jemi ekzigjentë që të bëhen përpjekje të mëdha, me qëllim që të realizohen plotësisht detyrat e shtuara në Letrën e Komitetit Qendror të Partisë dhe të mos na mbeten vetëm të shkruara në kartë. E theksoj këtë se shpesh, siç konstatojmë, për sa themi e vendosim, në fillim merren një sërë masash, caktohen edhe disa kuadro, por më vonë del një vendim tjetër, lihet i pari, i vihet forca të dytit dhe kështu mbeten detyra pa zbatuar. Për këtë arsyе them se duhet të reflektojmë thellë në këto çështje, të mos zvarritet zbatimi i vendimeve, të mos gjykojmë cekët dhe të mos e lëmë punën të bjerë, të venitet. Të gjitha masat që marrim, duke dërguar një kuadër në kooperativë, duke organizuar shtabet etj., etj., kanë për qëllim që të zbatohen si duhet detyrat, por jo të na krijohet një burokratizëm i ri. Në qoftë se ne e kuptojmë drejt çështjen, që masat e marra ta forcojnë e ta modernizojnë kooperativën, njerëzit që dërgohen në fshat të veprojnë me frymë revolucionare.

Për sa u përket investimeve e ndërtimeve, si në industri dhe gjetkë, u thanë shumë gjëra të drejta. Doja të thosha që, duke marrë parasysh vëllimin e madh të investimeve, megjithëse janë bërë përpjekje për shkurtim, në përgjithësi, ka akoma vend për shkurtim të tjera. Unë nuk them të shkurtohen veprat e mëdha, se ato në asnje mënyrë nuk mund të

hiqen, po e kam fjalën për disa vepra të tjera, të cilat mund të jenë të nevojshme në të ardhmen, po që tani për tani mund të bëjmë edhe pa to, pra të mos jemi aq kategorikë.

Dyshoj sidomos për veprat që bëhen nën limit, sepse në këtë zë fshihen shumë dallavere. Të mos ofendohen shokët se nuk e kam fjalën për dallavere në rrugë personale. Për shembull, caktohen fonde për të ndërtuar shkolla, ndërsa një pjesë e të hollave shpenzohen për të rrethuar, si në mesjetë, me kan gjella, ndërtesën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit në bulevardin «Stalin» duke shpenzuar për këtë qëllim 28 mijë lekë. Vihet pyetja: kush i ka dhënë këto para për të bërë një shpenzim të tillë? Asnjeli s'i ka dhënë, ato janë të tëra shpenzime për vepra nën limit. Në një kohë që flasim për kursime, nuk bën të ecet kështu, shokë të Ministrisë së Arsimit. Po nuk veproni vetëm ju kështu, se ka të tjerë që bëjnë shpërdorime edhe më të mëdha. Sa gjëra të tilla që nuk bien në sy, mund të gjesh, po t'i hysh kësaj pune, prandaj duhet parë me kujdes çdo shpenzim që të mos na ndodhin më në të ardhmen.

Dua të kthehem edhe një herë te mekanizimi, për të cilin folën edhe shokët. Mendoj se kryesore që duhet të marrim është ajo që do të na çojë në shkurtimin e fuqisë punëtore. Kjo masë duhet të zërë vend më parë se krijimi i komisioneve. Le të krijojnë komisione sa të duan por, në qoftë se shokët ministra dhe vartësit e tyre harrojnë se nuk do të kenë asnje herë krahë pune të tepërt, atëherë komisionet që do të ngrihen, nuk do të bëjnë asgjë. Puna mund të

kryhet me më pak punëtorë, në qoftë se mendohet me kohë për mekanizime, qofshin ato edhe shumë të thjeshta, që të zëvendësojnë punën e disa punëtorëve. Pa menduar e vepruar për mekanizimin e punimeve edhe në ndërtim, nga do të dalin këta mijëra punëtorë që kërkohen?

Ju shokët e ndërtimit duhet t'u kushton shumë më tepër rëndësi mekanizimeve të thjeshta. Në një mbledhje të Byrosë Politike na keni thënë se e keni mekanizuar përpunimin dhe transportimin e llaçit, po kjo nuk është aq e vërtetë. Në Hekurudhën Elbasan-Përrenjas për shembull, përgatitja e llaçit nuk është e mekanizuar; ai përpunohet nga vajzat me shatë dhe me lopatë. Po kështu edhe shinat që peshojnë tonelata të tëra, transportohen me krahët e rinisë. Po lokomotivat që kemi përsë janë? Këto veprime janë të palejueshme dhe të dëmshme. Çfarë janë këta kalamanë? Të rind e të reja të Shqipërisë, brezat e ardhshëm.

Të metat në organizimin e punës për ndërtimin e hekurudhës dhe në mungesat e mjeteve mekanike, për të cilat bëra kritikën, nuk janë të vogla. Në këtë vepër kanë shkuar me dhjetëra, në mos me qindra mijë të rind e të reja, të cilët i mban shteti me ushqime. Mirëpo gjatë gjithë kësaj kohe Ministria e Ndërtimit nuk ka bërë sa duhet që të mekanizojë disa procese pune të vogla. Po sikur t'u thoshim shokëve të kësaj ministrie se për ndërtimin e hekurudhës nuk u japim me mijëra të rind, po me qindra? Të shikoje pastaj si do ta vrissnin mendjen ata për të gjetur zgjidhjen e problemit dhe si do të preokupo-heshin për rritjen e shkallës së mekanizimit të puni-

meve. Zgjidhjen e problemit të mekanizimit të disa proceseve të punës në hekurudhë unë e shoh të domosdoshme. Për këto ju duhet të tregoni më tepër kujdes. Ka ardhur koha që edhe ne të kërkojmë më shumë llogari që t'i zbatoni më mirë detyrat që ju përkasin. Nuk mjafton vetëm të na thoni këtu se «kemi mundësi» dhe të mos veproni për t'i kthyer në realitet këto mundësi.

Sigurisht, të gjitha gjërat nuk zbatohen dot menjëherë, por disa të meta duhen zhdukur, pastaj të shikohen ato që s'mund të shhangen e kështu me radhë të shikohen të gjitha detyrat. Ja, për shembull, a nuk mund të bëhen kova dhe çikrikë? Këto, edhe plaka e fshatit ka vrarë mendjen dhe i ka bërë e me to ka nxjerrë ujë nga pusi. Atëherë pse të mos bëhen gjëra të tillë në ndërtim, që të ngrihet balta lart dhe jo të hidhet 2 metra me lopatë nga vajzat 18 vjeçare? Apo hajde, le ta hedhin, punë e madhe! Jo, shokë, Partia nuk do ta lejojë një gjë të tillë. Çfarë bazë materiale kërkohet? Ne nuk pretendojmë për procese pune të automatizuara, por gjëra që mund të bëhen pa ndonjë vështirësi të madhe, si çikrikë, vendosjen e disa drurëve për ngritjen e shinave etj. Këto mund dhe duhet të bëhen me iniciativë e me punë.

Mua më kanë raportuar se në një uzinë u bënë thirrje të rinxve: «Kush do të vejë në hekurudhë?». Siç më thanë, nuk di sa është e vërtetë, që një pjesë e të rinxve nuk vajtën në mbledhje, se mos i çonin në hekurudhë. Në qoftë se kjo është e vërtetë, fajin nuk e ka rinia e kësaj uzine. Me sa duket në këtë

uzinë nuk e ka bërë efektin e duhur puna politike, e cila duhet të forcohet, por nga ana tjetër, edhe në hekurudhë të krijohen ca kushte më të mira pune.

Lidhur me atë që ngriti Adili për krahët e punës dhe për të dhënrat rreth tyre që japid zyrat e statistikës, kam biseduar një ditë gati një orë e gjysmë me Sihat Tozajn, kryetarin e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Vlorës. Regjistrimi i forcave të punës duhet bërë në dinamikën e vet, nga sektorët përkatës. Në komitetin ekzekutiv (nuk e kam fjalën për gjendjen civile që e kemi në rregull, po në zyrën e punës) kemi njerëz apostafat, po ata më duket se nuk punojnë mirë. Ata rrinë e regjistrojnë personat që venë për të kërkuar punë, u marrin emrin dhe asgjë më tepër nuk bëjnë, nuk bëjnë një punë shkencore. Atje vijnë të rinj, të moshuar, intelektualë, mësues, studentë, vajza e gra, dhe të tërë kërkojnë punë. Përgjegjësi i zyrës së punës i pret, u thotë «do ta shikojmë punën tënde», «do të të njoftojmë» etj. Mirëpo zyra e punës nuk mjafton të ketë një evidencë se ç'punë kërkojnë njerëzit, por të dijë edhe të gjitha nevojat për fuqi punëtore që kanë ndërmarrjet, kooperativat dhe institucionet e rrethit; të dijë sa i duhen çdo sektori dhe t'i ketë të klasifikuara çfarë njerëzish e të ç'kategorie i duhen. Në bazë të këtyre objektivave ajo bën ndarjen e njerëzve që kërkojnë punë: cilët janë për në bujqësi, cilët për ndërtim, cilët për në kurse, sipas moshës, nivelit arsimor, ngritjes profesionale etj., etj. Kjo është një punë studimore, që vepron me perspektivë, që zgjidh më mirë problemin e zëries me punë të forcave të lira.

Po përgjegjësi i zyrës së punës nuk punon kësh-tu. Në qoftë se ne nuk do ta bëjmë një gjë të tillë, në fakt duhet të pranojmë se nuk kemi zyrë pune, po vetëm një qendër regjistrimi të kotë, që na jep lloj-lloj shifrash të pastudiuar. Prandaj ndodh pastaj që, pa farë kriteri e pa bërë klasifikimin që thashë, të tëra grave që kërkojnë punë, pa dallim, u thuhet: «shkoni të punoni në bujqësi».

Në qoftë se nuk gabohem, ka ca kohë që zyrate të punës iu shtua edhe një kuadër tjetër plus, se na thoshin që kishin problem çështjen e fuqisë punëtore të fshatit. Atëherë çfarë bën ky njeri për fshatin? Vetëm një regjistrim? Prandaj mua më duket se kjo çështje duhet studiuar mirë.

Studimet e veta, duke i pasur të klasikuara, e jo më në mënyrë të cekët e të përgjithshme që të ngatërrojë njerëzit, zyra e punës ia raporton, sa herë lind nevoja, komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe Komisionit të Planit. Kjo punë, mendoj unë, do rregulluar sa më parë se sjell shqetësimë edhe te njerëzit që kërkojnë punë, edhe në organet tona që luftojnë për plotësimin e nevojave me fuqi punëtore.

Dëshiroj të them edhe një gjë tjetër. Unë nuk jam specialist dhe nuk futem në detaje, por mendoj se më shumë besim dhe entuziazëm duhet të keni në veten tuaj ju të ndërtimit. Ishim nja tre-katër shokë që shkuam e pamë disa punime të ushtrisë. Nga sa pamë na u dukën mirë po mundet që ta kemi gabim që jemi kaq entuziastë. Sidoqoftë, megjithëse nuk jemi specialistë, me ato që pamë, na u hap një perspektivë e madhe në fushën e ndërtimeve. Specialistët

e sektorit të ndërtimit duhet të kenë ide shumë më të bazuara dhe më shkencore. Puna që po bëhet në objektet që pamë duhet t'i frymëzojë edhe ata, pse një gjë e tillë ka rëndësi të madhe. Pa besim dhe entuziazëm nuk bëhen këto vepra kaq të mëdha. Natyrisht, ka edhe mjaft vështirësi që duhen kapërcyer, prandaj, si specialistë që jeni, merrini më mirë në dorë këto çështje, futuni edhe në studime.

Për sa i takon vendburimeve të reja minerale duhet parë, nëse janë të leverdishme gjithë këto miniera kështu si i hapim ne, një këtu e një atje? Përse të mos përqendrohemë ne në disa miniera kryesore, sidomos atje ku është siguruar edhe transporti me hekurudhën? Sikur të përqendrohemë më mirë në kryesoret, pastaj t'u futemi të tjerave. Në këtë drejtim mendoj se duhet t'i orientojmë më mirë kërkimet gjeologjike. Për shembull, ne i orientojmë gjeologët që të kërkojnë bakër nga të katër anët e Shqipërisë, dhe mirë bëjmë për këtë, po kudo nuk na del bakër, ose na del në disa zona të shpërndara. Para se të fillojmë një minierë, mirë do të jetë që në atë zonë ku kemi të dhëna, të mund të përqendrohemë nü kërkime, ta zotërojmë mirë dhe të konkludojmë për shfrytëzim. Po të veprojmë kështu, nga ana ekonomike do të na leverdiste më shumë. Por që bëjmë kërkime, kjo është një gjë shumë e mirë, sepse do të dimë se ku i kemi burimet. Pra, kërkimet gjeologjike t'i bëjmë kështu si janë menduar dhe të arrijmë t'i kthejmë në rezerva industriale. Por që të fillojmë t'i shfrytëzojmë të tëra pikat ku i kemi këto rezerva, kjo duhet parë mirë nga ana e interesit ekonomik.

Këto çështje t'i studioni më mirë shkencërisht, që të jenë sa më të leverdishme për ekonominë tonë, domethënë, të shikohet me kujdes përhapja në gjithë këtë numër minierash. E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për shpimet e mëdha, si, për shembull, ato të naftës, në të cilat është mirë të shikohen proporcione. Këto proporcione të studiohen lidhur edhe me territorin e me perspektivat, duke marrë parasysh rezervat që kemi aktualisht; të përqendrohem i dëgjohemi atje ku kemi të dhëna.

Po nuk morëm masa me kohë për çdo gjë që vendosim, do të mbetemi në konstatime. Në qoftë se koeficientin e përdorimit të çelikut nëpër uzinat tona nuk e arrijmë dot menjëherë 80 për qind, por, ta vëmë 70 ose 75 për qind atëherë çelik duhet të japim deri në atë masë dhe asnje gram më shumë. Kjo është e lidhur edhe me kualifikimin e punëtorëve. Punëtorët e katgorive të ulëta harxhojnë materiale më shumë se ata të kualifikuarit.

Këtu u fol edhe për cilësinë e dobët të prodhimeve. Po ne këtu kemi vendosur disa masa për të siguruar cilësinë e lartë në prodhim. Çfarë është bërë me këto masa? Ndodh që disa gjëra ne i kemi thënë dhe i përsëritim vazhdimesh, po në qendër e në bazë nuk merren masat e duhura për t'i zbatuar. Prandaj t'i shikojmë mirë këto çështje. Se ç'ndodh? Në qoftë se kontrollori i cilësisë bën detyrën si duhet dhe në 100 palë këpucë për shembull 30 i nxjerr me kualitet jo të mirë, edhe pse ka vepruar drejt, të nesërmen në mëngjes atë mund ta pushojnë fare mirë nga puna. Drejtori i ndërmarrjes dhe sekretari i or-

ganizatës-bazë të Partisë ka raste që pleksen, bien në kompromis. Edhe kur tregtia nuk i merr mallrat me cilësi të dobët ndërhyhet deri te ministri i Tregtisë, bile i tërhiqet vëmendja këtij pse nuk i merren ato mallra industrisë. Këto veprime janë të padrejta, kështu nuk mund të ecet dhe gjëra të tillë duhet të mos përsëriten më.

Po kështu është edhe çështja e kënetës së Durrësit. S'ka se si të jemi dakord, për shembull, me ju, shokë të Durrësit, ashtu si keni vepruar lidhur me këtë kënetë. Ju nuk duhet të lejoni në asnje mënyrë që të largohet ndërmarrja e bonifikimit nga rrethi, pa mbaruar punën, të mbarojë njëherë detyrat që ka, pa të ikë. Derisa atje keni vendosur së bashku me shokët e ndërtimit e të bujqësisë që të kryhen disa detyra të caktuara, ju nuk duhet të lejoni që t'ju ikë asnje ditë ndërmarrja e bonifikimit pa mbaruar punë. Asaj t'i thoni: «mbaro detyrën që të takon, pastaj largohu». Për gjëra të tillë ne do të marrim edhe masa ndaj atyre që mbajnë përgjegjësi, mbasi këneta e Durrësit është e madhe dhe do të shfrytëzojmë tokën që zinte ajo.

Për sa i përket shfrytëzimit të makinerive me kapacitet të plotë, do parë mirë ngarkesa e tyre. Në qoftë se nuk kemi si t'u japim ngarkesë të plotë, atëherë këto makineri të mos i lëmë atje, por të krijojmë me të tepërtat një uzinë të re, që na duhet për të prodhuar mjete të tjera, ose t'ua japim uzinave që kanë më tepër nevojë për to. Mirëpo, kur vëmë çështjen që këto makina në këtë ose atë uzinë janë bosh dhe duhet t'i marrim që t'i vëmë në punë gje-

tiu, atëherë njerëzit vënë ulurimat, thonë se «janë të tëra të zëna, na duhen» etj.

Për realizimin e detyrave të planit, rëndësi shumë të madhe ka kuptimi e zbatimi kudo, në çdo sektor, i një disipline të rreptë proletare në punë. Disiplina proletare në punë nuk është një parullë e thjeshtë; ajo duhet kuptuar e zbatuar në radhë të parë ideologjikisht, në frymën e Partisë dhe pastaj në frymën shtetërore. Për këtë çështje bëhet njëfarë propagande, por vetëm kjo nuk mjafton. Duhet punuar vazhdimisht për të shpjeguar dhe për të futur thellë te cilido ndjenjën e disiplinës dhe kjo çështje të kombinohet edhe me ligje që të parashikojnë masa për ata që e thyejnë atë.

Kemi theksuar vazhdimisht në propagandën tonë se diktatura e proletariatit, ndërtimi i socializmit, ka ligjet dhe rregullat e veta. Por vihet re se, duke fillouar nga lart e deri poshtë, bëhen lëshime të mëdha, të cilat justifikohen gjoja me zbatimin e vijës së masave, me bërjen e një pune propagandistike, bindëse, me edukim, këshillim etj. Ato vërtet duhet të praktikohen në radhë të parë, por te ne nuk duhen përjashtuar as masat shtetërore që duhen gërshtuar drejt me punën bindëse për ata tek të cilët puna propagandistike nuk bën efekt. Pra, për rastet e thyerjes së disiplinës, krahas punës edukative ata që gabojnë, sipas shkallës, duhen vënë para përgjegjësisë disiplinore, përgjegjësisë materiale, përgjegjësisë penale etj. Ai që është për socializmin, për ligjet e tij, për politikën dhe ideologjinë e tij, duhet t'i vërë këto në jetë. Nuk mjafton të mësohen përmendsh 10 cilësitë

që duhet të ketë komunisti dhe, kur vjen puna për të parë një ndeshje futbolli, të thyhen xhamat apo dyert e trenit. Jo, fjalët duhen shoqëruar me qëndrime të drejta në jetë dhe me vepra. Asnjeriu nuk i lejohet shkelja e ligjeve të pushtetit popullor, prandaj të punohet që këto gjëra të futen thellë në kokën e njerëzve tanë, në radhë të parë të komunistëve.

Edhe agroteknikën, në qoftë se ua mësojmë njerëzve në teori, vetëm thjesht si literaturë, sa për të shkuar radhën dhe jo për ta zbatuar plotësisht e me doemos edhe në praktikë, kjo punë s'do të kishte asnjë dobi. Njerëzit ne duhet t'i respektojmë e t'i nderojmë sipas rezultateve të punës. Kur kemi për të kualifikuar dikë më tepër, të preferojmë dhe të çojmë në kurs atë që punon më shumë, që është i ndershëm dhe jo të padisiplinuarin. Të mos i konsiderojmë të tërë njëloj, nën parullën se të tërë njerëzit janë të socializmit. Nuk mund të trajtohen njëloj si ata që s'kanë merita, ashtu edhe ata që kanë.

Çdo njeri që punon, kudo në vendin tonë, duhet ta ketë të qartë se punon për popullin e për socializmin, prandaj e ka për detyrë të kursejë çdo gjë, të përpinqet të zbatojë me rreptësi disiplinën financiare dhe në këtë drejtim të vrasë shumë mendjen në fillim për vete, pastaj të këqyrë edhe të tjerët e, kur sheh se nuk kursejnë, të ngrejë zërin. Por që të zërë vend fjalë e tij, ai duhet të jetë i shtrënguar ndaj vetes në radhë të parë, pastaj ndaj të tjerëve.

Në qoftë se nuk ka sa duhet disiplinë plani dhe njëri i bie gozhdës e tjetri potkoit, secili të preokupohet e të vihet në lëvizje dhe të bëjë ç'është e

mundur që të merren sa më parë masa për të vënë rregull. Ne themi që ecim me plan, por në fakt jo kudo ecet kurdoherë kështu. Të tëra këto kërkesa, shokë, duhet të kombinohen mirë në punën e çdo dikasteri, të çdo sektori dhe të çdo njeriu që punon. Disiplina proletare është e detyrueshme dhe për atë që merret me veterinarinë, me teknikën, me literaturën, me planin, me financat e kështu me radhë për punonjësit tanë të të gjitha fushave. Këto çështje të kuptohen drejt si duhet, se pa to nuk mund të na realizohen planet.

Këtu u dhanë shumë mendime, me më të shumtë e të cilave jemi dakord. Por për ato çështje për të cilat u parashtruan mendime të ndryshme, prapë mund të biem dakord, sepse nuk pashë të kishte diferenca të mëdha pikëpamjesh. Edhe ndonjë shifër që u diskutua, mund të sheshohet, qoftë tani, qoftë më vonë etj.

Në përgjithësi këto kisha për të thënë.

*Botohet për herë të parë, si-
pas tekstit të nxjerrë nga
procesverbali i mbledhjes së
përbashkët të Byrosë Politike
të KQ të PPSH dhe të Kë-
shillit të Ministrave të RPSH,
që gjendet në AQP*

MBI PROJEKTDIREKTIVAT E PLANIT TË PESTË PESËVJEÇAR

Fjala në Plenumin e 12-të të KQ të PPSH¹

29 qershor 1971

Për të mos u zgjatur, unë do të prek vetëm disa nga çështjet kryesore që kanë të bëjnë me projektplanin e pesëvjeçarit të ri.

Investimet në këtë pesëvjeçar arrijnë në 16 miliardë e 460 milionë lekë, kundrejt 9 miliardë e 406 milionë në pesëvjeçarin e katërt. Siç e shikojmë investimet në pesëvjeçarin e ri janë shumë më të mëdha dhe në to është industria ajo që ka pjesën më të madhe me 10 miliardë e 816 milionë lekë, 1 miliard e 930 milionë lekë bujqësia. Por edhe sektorët e tjera s'mbeten pas.

Ndërtimet arrijnë edhe këto shumën prej 6 miliardë e 800 milionë lekë dhe vendin e parë e zë edhe këtu industria me 3 miliardë e 340 milionë lekë.

1. Në këtë Plenum u shqyrtua raporti i Byrosë Politike të KQ të PPSH: «Mbi projektdirektivat për planin e 5-të pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të RPSH për vitet 1971-1975».

Mendoj se orientimet e dhëna nga Byroja Politike dhe Qeveria, në përgjithësi, janë zbatuar drejt. Kudo është bërë një punë e studiuar, e bazuar, në përgjithësi e balancuar, e shikuar me syrin kritik. Natyrisht çdo gjë nuk ka kaluar lehtë, por është dashur e do të duhet akoma, dhe sidomos gjatë zbatimit, të luftohen më shumë pikëpamjet joracionale, kërkesat e pastudiuar e të fryra, është dashur dhe do të duhet të luftohet shumë kundër burokratizmit dhe rutinës në metodat e planifikimit, të projektimit, të zbatimit, të financimit, kundër metodave të lëshimeve në çështjen e madhe të kursimit të fuqisë punëtore, të lëndëve të para të ndërtimit dhe sidomos atyre deficitare dhe kursimit të vlerave monetare.

Pikërisht me aprovin e projektplanit, me përcaktimin e fondeve monetare, të fondeve materiale, të makinerive, të asaj apo të kësaj çështjeje nuk mund të flihet mendja dhe të mendohet se çdo gjë tani do të ecë si sahat. Por për zhvillimin e çdo sektori jo vetëm nuk duhet të tejkalohen caqet e caktuara për sa u përket fondeve materiale, monetare, njerëzore etj., por është e domosdoshme të bëhen përpjekje të mëdha përtu bërë shkurtim, ekonomizime, mekanizime dhe organizime të forta. Pa të tilla përpjekje nuk mund të ecet përrpara.

Kur u hedhim një sy veprave që do të ndërtohen në këtë pesëvjeçar, të mëdha e të vogla, me të drejtë kënaqemi dhe jemi të bindur se asnëjëra prej tyre nuk është e kotë. Por nuk mund të mos shqetësohem dhe t'i vëmë pyetjen vetes se në gjithë këta miliarda që caktohen për ndërtime dhe investime, nuk ka vallë

edhe çështje të pastudiuarë mirë, nuk ka miliona, bila dhjetëra e qindra milionë që duhen shkurtuar, pa shkurtuar aspak veprën? Shokë, unë mendoj se të tilla duhet të ketë plot, për këtë të jemi të gjithë të bindur. Një pohim të tillë eksperiencia na e ka vërtetuar. Na janë bërë vallë mësime pësimet? Jo kurdoherë! Në rast se cilido dhe në çdo punë nuk udhëhiqet nga parimi bazë që t'i kursejë ekonomisë popullore edhe santimin e fundit, atëherë zor t'i kuptojmë dhe të mësojmë nga gabimet. Në rast se cilido dhe në çdo punë është i ndërgjegjshëm se shteti është i tij dhe duhet të punojë me ndërgjegje për të, atëherë ai i kupton dhe i ndreq gabimet.

Në ndërtime ku investohen miliona e miliarda lekë në objekte të panumërtë që kushtojnë nga 2-3-5 apo më shumë milionë lekë, këto caktohen si pa gjë të keqe dhe kam përshtypjen sikur kjo konsiderohet nga të «këqijat» më të vogla. Thuhet se këto objekte që kërkohet të ndërtohen janë të nevojshme dhe ashtu është, po kostoja e tyre më të shumtë e herës bëhet në bazë të kritereve të vjetra, shkohet «për analogji», por kjo analogji brenda ka një mijë gjynahe dhe, në rast se u bëhet ndonjë shkurtim, ky bëhet aforfe, duke u nisur kurdoherë nga pikëpamja «të jemi brenda», domethënë bëhet me rezerva të mëdha. Edhe shokët që diskutuan, prekën çështje të kësaj natyre. Kështu shoku Hajredin Çeliku foli këtu drejt për shpenzimet e mëdha që bëhen për ndërtime kantieri pse janë diçka provizore, prandaj duhen bërë përpjekje që ato të ngrihen me shpenzime minimale.

Jo vetëm kaq, po unë mendoj se objektet që ndër-

tohen nga ndërmarrjet e Ministrisë së Ndërtimit, jo vetëm objektet e vogla, por edhe të mëdhatë, duhen rishikuar imtësish në drejtimin e kursimeve, dhe jo me një e me dy milionë, po me dhjetëra milionë. Unë pastaj dyshoj shumë edhe në saktësinë e kostos së caktuar në ato objekte që ne i quajmë nën limit. Atje jam i mendimit se duhet vënë dorë, duhet vënë fre, atje duhet të kalojë gërvshëra e madhe. Unë nuk them se fondeq që u caktohen dikastereve janë të kota e të panevojshme; është e qartë për të gjithë se janë edhe ato për zhvillimin e prodhimit, por të përdoren miliona pa ekonomi, pa kritere të shëndosha, të mos ndërtohen në kohën e caktuar dhe të mos hyjnë gjithashtu në kohën e caktuar në prodhim, këtë në asnjë mënyrë nuk duhet ta lejojmë. Është skandaloze të shpenzohen pa asnjë nevojë fonde për të rrethuar mu në mes të bulevardit oborrin e njërsë prej ndërtesave të Fakultetit të Shkencave të Natyrës me kangjella të hekurta mesjetare, ndërsa Ministria e Arsimit dhe e Kulturës mezi po vë në lëvizje makinat moderne për të shtypur dispensat e studentëve. Të tilla gjëra ka mjaft, kudo. Atëherë ç'duhet të bëjmë? T'ua heqim dikastereve këto fonde? Unë mendoj që jo, por duhet t'ua shkurtojmë dhe me pak fonde ato të bëjnë shumë punë, të bëjnë më të nevojshmet dhe sa më shpejt.

Që të bëhet kjo duhet të vendosim kudo një disiplinë të rreptë në punë. Punëtorët, inxhinierët, mjeshtrit, nëpunësit e kanë për detyrë të respektojnë rrapëtësish orarin e punës, të realizojnë dhe të tejkalojnë normat, të kursejnë materialet, të kualifikohen dhe ta

meritojnë kualifikimin e jo t'u bëhen lëshime, të realizojnë veprën në kohën e caktuar dhe mundësisht shumë më parë.

Duhet të vendoset një disiplinë e rreptë financiare në të gjitha çështjet, po jo një disiplinë financiare statike, duke u kufizuar vetëm në shpërndarjen e lekëve në dispozicion, por në mënyrë dinamike, duke realizuar bashkëpunimin e ngushtë të financierëve me inxhinierët për mekanizimin e punimeve, gjë që ndikon në uljen e krahëve të punës dhe të fondit të pagave, bashkëpunimin me arkitektët për thjeshtësim që sjell kursimin e materialeve, bashkëpunimin me montatorët që siguron fitim kohe etj., etj.

Së fundi dua të vë edhe një herë theksin në kujdesin që duhet t'i vëmë kurdoherë shpejtësisë së ndërtimit të objekteve që do të hyjnë në prodhim. Ky është një problem që duhet ta kemi vazhdimisht në rendin e ditës. Të mos fillojmë duke ndërtuar drejtoritë dhe lulkat, por më parë se çdo gjë të ndërtojmë qendrat ku do të punohet dhe do të prodhohet, pa pritur mbarimin e tërë veprës.

Veprat e vogla që janë të nevojshme për prodhimin të mos i sorollatim në kohë, por të dimë të përqendrojmë forcat në më të rëndësishmet, më të nevojshmet e më urgjentet e tyre dhe jo të hapemi si vaji në lakra, t'i fillojmë të gjitha dhe të mos mbarojmë asnjë, ose të mbarojmë ato që presin për më vonë dhe të lëmë ato më urgjentet.

Ideja me shumë rëndësi për të filluar ndërtimin e një sërë ndërmarrjesh industriale etj., nën tokë, për ekonominë dhe ndërtimet tona hap një perspektivë të

madhe. Një gjë e tillë është e mundshme, e nevojshtme, bile e domosdoshme.

Te ne predominon prirja për ndërtime vetëm mbi tokë. Shfrytëzimi i minierave tona bëhet nën tokë dhe me gjithë eksperiencën që kemi në këtë sektor, megjithëse minatorët punojnë nën tokë, ne nuk e kishim përpunuar dhe zgjeruar më tej këtë ide. Tani kjo ide me rëndësi u hodh në tryezë dhe duhet me u marrë seriozisht me zbatimin e saj.

Në radhë të parë, të gjithë ne, duhet të thyejmë disa koncepte që na frenojnë, siç janë ato «se nuk punohet nën dhe», «se atje bën ftohtë», «se atje s'ka dritë dhe ajër», «se atje ka lagështirë», «se atje s'ka vend ku mund të futen gjithë këto makineri» etj. Të gjitha këto koncepte duhen rrëzuar një nga një me fakte, me bindje, me vegla dhe me instrumente matëse mjekësore, me zgjedhjen gjeologjike të vendeve dhe me masat e përshtatshme që mund të merren për të krijuar edhe nën tokë të gjitha kushtet e përshtatshme për punë, ashtu si edhe mbi tokë. Përveç kësaj, ndërtimi nën tokë, sipas llogarive të para, ka tri të mira të mëdha që nuk i gjen mbi tokë:

- 1) Kursen tokën e bukës që do të zinte objekti.
- 2) Kushton shumë më lirë se mbi tokë dhe ndërtohet më shpejt.
- 3) Në kohë lufte punëtorët dhe makineritë janë plotësisht të mbrojtura dhe mund të vazhdojnë punën pa ndërprerje dhe pa asnje shqetësim.

Këto të mira të mëdha nuk i ka ndërtimi mbi tokë.

C'duhet, pra, të bëjmë? T'i futemi serioz studimit të shumanshëm dhe, pa u sorollatur, të bëjmë llogaritë,

të studiojmë vendet, të mendojmë, të përpunojmë opinionin e ndërtuesve, që ata të bëjnë kthesën e nevojshme, të mendojmë për mekanizimet që duhen përnjë profil të ri, të mos ecim duke thënë «të ndërtojmë një dhe të shohim», kur ato që do të shohim i kemi ngritur mbi tokë.

Këtu kemi një gamë të madhe objektesh të natyrave të ndryshme që akoma nuk janë ndrequr, por edhe nga ato që do të ndreqen më vonë, nga ato që duhet të spostohen e që në shikimin e parë mund të mendojmë se s'mund të futen nën tokë. Shumë galeri minierash që tani s'punojnë duhet t'i kthejmë në vende moderne për depo, për objekte industriale etj.; shumë tulla, tjegulla e lëndë druri do të ekonomizojmë për të furnizuar popullin me to; shumë fonde monetare do të kursejmë për t'i investuar në pikat aktualisht të ngushta. Prandaj Ministria e Ndërtimit, punëtorët e ndërtimit, Komisioni i Planit të Shtetit, punëdhënësit dhe Partia në bazë ta marrin me seriozitetin më të madh këtë problem revolucionar.

Si gjithë shokët, edhe unë jam dakord me shifrat e planit të ri pesëvjeçar për bujqësinë, si për hapjen e tokave të reja, për sasinë e hektarëve që caktohen për kulturat kryesore, ashtu edhe për rendimentet dhe mendoj që këto përcaktime janë të arsyeshme, pra të mundshme për t'u realizuar. Por kjo nuk do të thotë aspak se do të arrihen lehtë, pa përpjekje, bile shumë të mëdha e të gjithanshme.

Mbi këto probleme kyç të bujqësisë ka pasur dhe vazhdon të ketë akoma diskutime, por veç një gjë s'duhet të harrojmë, dëshira për t'ia arritur këtyre shifrave

nuk është diçka idealiste. Masat e gjera që kanë diskutuar orientimet dhe shifrat e bujqësisë, janë mbështetur në orientimet e drejta të Partisë, sipas të cilave ato duhet të bazohen në realizimet më të mira që janë arritur deri tani në njësitë e ndryshme bujqësore, në kooperativa, në rrethe, në çdo sektor të bujqësisë dhe të kahasueshme me kooperativat e tjera, me rrethet e tjera. Kjo do të thotë, dhe kjo ka shumë rëndësi, se shifrat janë të bazuara, janë reale.

Detyra që ne i vëmë vetes, dhe kjo ka rëndësi vendimtare për arritjen e synimeve tona të planit të ri pesëvjeçar në bujqësi, është që të bëjmë përpjekje për të ngritur gjithë bujqësinë në nivelin e atyre brigadave e kooperativave ku kemi bazuar synimet tona.

Për realizimin e detyrave në sektorin e bujqësisë është e domosdoshme që të ecim përpara me të gjitha mjetet dhe format, politikë, organizative dhe teknike.

Kështu kur vendosim për këto direktiva, ne ecim me bindje të plotë për realitetin objektiv të këtij plani.

Një çështje tjetër me rëndësi, gjithashtu, shumë të madhe është nevoja që kemi ne për rritjen e prodhimeve bujqësore, të cilat nuk kemi rrugë tjetër nga i nxjerrim për të plotësuar kërkesat e popullit, bile akoma në mënyrë shumë modeste, përvçse me përpjekjet tona të vazhdueshme e të gjithanshme në vendin tonë.

Për zhvillimin e sektorit të bujqësisë nga ana e Partisë dhe e shtetit janë bërë e po bëhen të gjitha sforçot e mundshme për investime. Një rritje e mëtejshme e këtyre investimeve tej shifrave që kemi caktuar do të na shkaktonte disbalancime në ekonomi. Megjithatë, edhe në këtë plan pesëvjeçar, janë parashi-

kuar fonde mjaft të konsiderueshme, në devizë e nëklering, për të importuar drithëra, pambuk, yndyrna, oriz dhe prodhime të tjera bujqësore e blegtorale. Letë mendojmë tani për një çast eventualitetin e mosrealizimit të këtij plani që po shtrojmë, pale sikur t'i shtojmë këtij eventualiteti edhe ato mendime të disa udhëheqjeve të bazës, sipas të cilave kërkohet ulja e sipërsaqeve të mbjella me bimë industriale, me oriz e patate. Për ne vihet atëherë pyetja: si do ta furnizojmë popullin? Në rast se ne do të vepronim ashtu sikur mendohet nga disa, kompromctojmë gjithë planin tonë, dobësojmë ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut.

Unë nuk them se të gjitha vërejtjet e disa udhëheqjeve të bazës janë pa arsy, ose krejt të pabazuar, por mendoj se shumë prej tyre janë të shikuara në prizmin e ngushtë të interesave të rrethit dhe jo të ballafaquara me ato të gjithë republikës. Sigurisht ato janë të llogaritura dhe këto llogari mund të janë të drejta dhe me leverdi për rrethin, por ato mbeten zbuluar për republikën. Më në fund, në parim dhe në praktikë, është shumë më mirë të marrësh rendimente të larta nga një sasi e vogël toke, sesa të zgjerosh sipërsaqet dhe të marrësh rendimente të ulëta. Mirëpo për të siguruar prodhimet, për të cilat kemi nevojë, duhet pasur siguri gati të plotë dhe republika të disponojë rezerva të mira për të përballuar të papriturat që mund të ndodhin në bujqësi ku ne, me gjithë sukseset, kemi pasur vazhdimisht shumë të tilla. Prandaj në bujqësi ne duhet të luftojmë si në thellësi, ashtu edhe në gjerësi. Të mos kënaqemi me rendimente të ulëta, por

të përpinqemi që edhe në tokat e reja që çelim të marrim rendimente sa më të larta. Problemi i hapjes së tokave të reja është vija e Kongresit të 5-të të Partisë. Ai ka një rëndësi të madhe politike dhe ekonomike, prandaj nuk duhet ta nënveftësojmë. Në duhet të mendojmë qysh tani për të ardhmen e vendit, prandaj Byroja Politike e Komitetit Qendror ka hapur perspektivën që ne të arrijmë të disponojmë aq tokë nën kulturnë sa të jetë e mjaftueshme për popullsinë tonë, e cila do të rritet e në fund të këtij pesëvjeçari mund të arrijë afér 2,5 milionë banorë. Por, më vonë ne mund të vemi dhe 3-4 apo dhe më shumë milionë njerëz. Pra, Partia duhet të mendojë për t'i kriuar popullit tonë të gjitha kushtet që ai të rrojë si në socializëm dhe në komunizëm, jo tash që është pak mbi dy milionë, por edhe kur të arrijë 5 apo 7 milionë. Dhe këto kushte do t'i krijojë vetë populli me Partinë në krye. Po ku do të jetojnë gjithë këta njerëz? Në të katër anët e Shqipërisë, dhe kjo do të ndodhë kur ne t'i kemi bërë pjellore, me ara dhe kopshte të bukura, tërë këto toka të Shqipërisë. Atëherë nuk do të na ngjasë fenomeni që vërehet në vendet kapitaliste e revizioniste që fshatarët të braktisin fshatrat, se nuk do të kenë ç'të bëjnë dhe do të na vijnë në qytete. Bile, mund të ndodhë e kundërta, që qytetarët të shkojnë në fshatra se atje është bukuria e natyrës sonë, prodhimi i drithërave, frutave, rrushit, mollëve, dardhave e gjithë pemëve të tjera; atje janë bagëtia dhe çdo gjë tjeter e nevojshme. Por në fshat, siç thashë, ka diçka më tepër nga qyteti: është natyra me të mirat e bukuritë e saj që përtërin shëndetin e njerëzve. Të tilla probleme të

mëdha për jetën e njerëzve ne duhet t'i mendojmë që tashti e vazhdimisht.

Natyrisht që ka vështirësi për hapjen e tokave të reja, krahët e punës në fshat mungojnë, ka akoma toka të pasistemuara që na i gjerryen uji, por neve nuk na lejohet të zgjedhim rrugën më të lehtë, duke ulur planin, por të vazhdojmë të hapim toka të reja dhe njëkohësisht t'i ndreqim, t'i sistemojmë, e t'i tarra-cojmë ato si duhet e të organizojmë punën sa më mirë që t'i mbjellim në kushte optimale. Me një fjalë, ne duhet t'u kushtojmë rëndësi maleve e kodrave tonë dhe ta vëmë në jetë plotësisht parullën me rëndësi të madhe të Kongresit të 5-të të Partisë: «T'u qepemi kodrave e maleve e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat».

Këto janë disa nga arsyet, të cilat ne s'mund të mos i kemi parasysh dhe as t'i marrim lehtazi. Prandaj na vihet detyrë të punojmë shumë shtrënguar, të hapim toka të reja dhe t'i mbjellim ato sa më parë, në sipërfaqet e caktuara të mbjellim bimët që kemi parashikuar, pa bërë asnje zbritje, dhe në to të marrim rendimentet e larta që i kemi vënë detyrë vetes të realizojmë. Atje ku s'mund të zbatojmë dot qarkullimin bujqësor, siç e lyp agroteknika, këtë minus ta kompesojmë me zbatimin sa më mirë të shërbimeve kulturore në të gjitha drejtimet dhe të respektojmë me rreptësi të gjitha kërkesat dhe rregullat e tjera agroteknike që kanë nevojë bimët e mbjella.

Në bujqësi kemi bërë përparime të mëdha. Kolektivizimi në baza leniniste vërtetoi dhe po vërteton çdo ditë e më qartë edhe në realitetin e vendit tonë, se është e vetmja rrugë e drejtë për ndërtimin e socia-

lizmit në fshat. Në punë e sipër, me durim e me sukces, ne kemi korrigjuar shumë forma organizative dhe pune, kemi kapërcyer mjaft të meta dhe gabime të rritjes, subjektive dhe objektive. Por zhvillimi dialektik i të kundërtave ka bërë që përsëri të vërtetohen të meta e gabime të reja, nga të cilat ne vazhdojmë të kemi akoma mjaft, prandaj ato duhet të mos i fshehim, përkundrazi, t'i zbulojmë sa më shpejt, t'i korrigojmë pa vonesë dhe të punojmë që t'i zhdukim, pse vetëm kështu sigurohet ecja përpara e ekonomisë.

Ne jemi optimistë për të ardhmen e bujqësisë sonë, optimizëm ky që nuk qëndron në hava, por në realitetin tonë të prekshëm nga të gjithë. Nuk dua të përdor fjalë të mëdha, por si në këtë pesëvjeçar, vazhdimisht edhe në pesëvjeçarët e tjerë të ardhshëm, bujqësisë sonë socialiste i hapen perspektiva të reja. Është e vërtetë se neve na mbeten akoma mjaft detyra të rëndësishme bazë për bujqësinë, ku punimet për tharjen e kënetave të fundit, kanë filluar me kohë, prandaj duhet të mbarojnë, që të mund të përfitojmë tokat që do të lirohen në to. Është e vërtetë se ne kemi për të bërë, gjithashtu, punime të rëndësishme për ujitten, dhe në këtë pesëvjeçar do t'u futemi masiveve malore dhe kodrinore, por fakt është se në këtë drejtim pushteti popullor e ka kryer me sukses punën më të madhe dhe gjithë kjo punë kolosale është bërë në një bujqësi krejtësisht socialiste. Krahas kësaj pune të madhe bazë për ujitten u zgjidh e po zgjidhet edhe problemi i plehrave kimike.

Tani ne jemi duke iu futur seriozisht punës për seleksionimin e farërave elite, jemi duke punuar serio-

zisht për t'i ndryshuar boshtin thenielor blegtorisë dhe për trajtimin e saj modern, duke futur dhe duke shuar raca të zgjedhura lopësh, në radhë të parë, për qu-mësht e mish, si dhe raca dosash; po përpinqemi që edhe delen ta sjellim në proporcionet e balancuara që kërkon një bujqësi moderne socialiste, që të na japë, në radhë të parë, lesh në sasi të madhe, po edhe mish.

Frutikultura në këtë pesëvjeçar, megjithëse ca si me zor, por po çan edhe kjo përpara. Edhe këtij sektori duhet t'i vëmë, gjithashtu, rëndësi shumë të madhe.

Pra, në bujqësinë tonë socialiste, ku është derdhur shumë mund e djersë, ku janë investuar dhe po investohen fonde të mëdha, Partia, pushteti, kooperativistët, klasa punëtore dhe inteligjencia populllore, duhet të përqendrojnë tani forcat, t'i koordinojnë dhe t'i harmonizojnë ato që mbi fitoret e arritura të korrim fitore të reja. Neve na vihet pra si detyrë që fushat, arat e livadhet tona t'i kthejmë në kopshte të lulëzuara, nga të cilat të marrim prodhime të bollshme. Neve na vihet, gjithashtu, detyrë që çdo gjë, duke filluar nga toka e deri te prodhimet, nga kafshiët e deri te bari, nga bleta deri te lulet, ta përpunojmë në mënyrë shkencore; asgjë të mos i shpëtojë syrit, mendjes së mprehtë e të mësuar dhe dorës së palodhur të kooperativistit-tonë. Çdo gjë ka domethënien e saj që kooperativisti duhet ta dijë, çdo gjë që të zhvillohet mirë, kërkon punën dhe trajtimin që i përket.

Proceset bujqësore kanë nevojë për punime të përgjithshme, por proceset speciale për disa bimë mund ta dëmtojnë procesin e përgjithshëm, në rast se punonjësi i bujqësisë nuk i hyn thellë zanatit. Anembanë ne

jemi përpëra periudhës së një perfeksionimi të madh e të mëtejshëm masiv të kooperativistëve në çështjet e diturive bujqësore, dituri absolutisht të domosdoshme, që do të përvetësohen duke punuar e mësuar njëkohësisht, duke punuar dhe eksperimentuar, duke bërë gabime e duke u përpjekur për t'i ndrequr ato.

Letra që Komiteti Qendror i dërgoi gjithë Partisë dhe kooperativave shënon një etapë të re të mëtejshme të zhvillimit, të konsolidimit dhe të modernizimit të kooperativave tona bujqësore. Udhëzimet dhe orientimet e Komitetit Qendror që përmban ky dokument, shkuan në bazë në kohën e duhur. Ato ishin absolutisht të nevojshme për planin e ri pesëvjeçar që po diskutojmë dhe që do të vendosë Kongresi i Partisë. Dërgimi i saj ishte një nevojë dialektike.

Propozimet që dolën nga studimi dhe diskutimi i thellë i problemeve të ndryshme që ngre Letra e Komitetit Qendror nga ana e bazës, e kooperativave bujqësore, nga komitetet e rretheve dhe nga organet qendrore, ne i morëm në shqyrtim në Byronë Politike, i studiuam dhe i aprovuam në vija të përgjithshme. Çështja, shokë, qëndron tani në atë që këto vendime të zbatohen dhe jo të zvarriten, çdo gjë duhet të planëzohet dhe të ndiqet zbatimi i saj. Kush nuk i zbaton, kush i zvarrit nga rruga, e cila duhet të spastrohet nga ata që pengojnë direktivat që kërkojnë zbatim të plotë në jetë; dhe nga ata që për një arsyesh ose për një tjetër vënë gurë në rrota, ndaj tyre s'duhet të bëhen lëshime dhe të mos mbahen qëndrime oportuniste.

Detyrat e mëdha që na vihen përpëra për t'i përbushur nuk mund të plotësohen pa pasur kooperativa

bujqësore të ngritura në një stad të ri zhvillimi politik, moral, ideologjik, organizativ dhe teknik. Ashtu si lufoton Partia kundër mbeturinave të ndryshme në ndërgjegjen e njerëzve për çështjet moralo-politike dhe ideologjike, me të njëjtin kujdes ajo duhet të luftojë pa pushim e pa hezitim mentalitetin e vjetër fshatar në punë, shthurjen e disiplinës në punë, agroteknikën primitive, rezistencën që u bëhet formave të reja socialiste të organizimit. Këto mentalitete nuk luftohen duke u hequr kooperativistëve ditët e punës, ose duke u prerë atyre bukën, siç është vepruar në ndonjë rast nga disa injorantë që qëndrojnë bile edhe në organe drejtuese në rrethe, por duke i edukuar dhe duke i bindur ata me durim, pa u bërë as lëshime, por pa u prerë as bukën.

Për kryerjen e detyrave që shtron Letra e Komitetit Qendror dhe që i plotësoi e i konkretizoi më tej baza, kanë shumë për të bërë si qendra, ashtu edhe baza vetë. Kjo kërkon të merren seriozisht përgjegjësitë, pse e kemi zakon të themi: «S'e bëmë se na türhoqën çështjet e ditës, na türhoqën problemet e prodhimit» etj. Në qoftë se vazhdojmë të mendojmë e të veprojmë kështu, atëherë do të thotë se këto i kuptojmë si «probleme në vetvete që s'kanë lidhje me prodhimin as me çështjet e ditës». Duke i kuptuar çështjet kështu, të shkëputura në kohë me problemin, me jetën e përditshme, është shumë gabim dhe një gjë të tillë s'duhet ta bëjmë. Po ta kuptojmë drejt këtë problem edhe datat, edhe afatet që caktohen për kryerjen e detyrave, nuk lihen të gjata si tërkuzë, por ngshtohen dhe bëhen përpjekje që të realizohen shpejt dhe mirë.

Organizimi modern i kooperativave bujqësore duhet të kuptohet thellë. Partia nuk ka aspak ndër mend të krijojë tani një burokraci të re në fshat, që disa njerëz të marrin atje rroga o ditë-punë, të mbushin defterë me shënimë që nuk i shërbejnë njeriu, të mbushin formularë për të justifikuar rrogën dhe të gjitha këto t'i bëjnë për të qenë në rregull kur t'u raportojnë komiteteve të Partisë dhe komiteteve ekzekutive në rrethe. Edhe financat në kooperativë nuk i organizojmë për të regjistruar shifra pasive etj., por që të luajnë atë rol të rëndësishëm që u ka caktuar Letra e Komitetit Qendror për zhvillimin e mëtejshëm dhe forcimin e pandërprerë të ekonomisë kooperativiste.

Çështja të kuptohet drejt: gjithë këta njerëz, të zgjedhur o të emëruar, me funksione drejtimi, politike apo teknike, janë në shërbim absolut të prodhimit, të kooperativës, janë në shërbim të dinamizmit të planit, të realizimit të tij, të edukimit të shumanshëm të të gjithë kooperativistëve. Gjithë këta njerëz nuk janë aspak të privilegjuar. Natyrisht, si të gjithë edhe ata kanë të drejtën e fjalës dhe duhet ta thonë mendimin e tyre, po duhet të luftohet fort arroganca e ndonjë drejtuesi, të goditen ata që shtrembërojnë demokracinë kooperativiste, që orvaten të shuanjë kritikën, që u bien shkurt llogarive, sikur kanë të bëjnë me mallin që u ka lënë babai.

Mbase vutë re se për të gjitha çështjet fola pak, kurse për mekanikën bujqësore deri tani nuk fola, jo se e lashë këtë si një problem të fundit, ose për të folur gjatë, por më tepër për të ritheksuar një problem që na preokupon shumë dhe që duhet ta zgjidhim.

Siq e dimë, mekanizimi i bujqësisë është një nga sektorët kryesorë, pa të cilin s'mund të realizohen kurër gjithë këto rezultate që janë arritur deri sot. Edhe në të ardhmen ne s'mund të kemi bujqësi moderne pa një mekanizim kompleks dhe në shkallë të gjërë. Çdo vit e kemi shtuar forcën mekanike në bujqësi, me gjithatë mund të themi se kemi prapë shumë nevoja. Me mekanikën që disponojmë aktualisht në proceset e punimeve bujqësore, jemi akoma larg që t'i plotësojmë si sasi dhe si lloje shërbimet e ndryshme kulturore. Por edhe në pesëvjeçarin e ri ne kemi planifikuar të sigurojmë aq mekanizma në bujqësi, sa kanë qenë mundësitë tona, pse më tepër nga shifrat e parashikuara nuk ka qenë e mundur. Kjo do të thotë se nevojat e bujqësisë sonë për traktorë, për aggregate dhe makineri të ndryshme bujqësore janë më të mëdha. Nuk jam dakord me propozimin e Ramadan Xhangollit që të zhdukim qetë dhe të zhvillojmë kuajt. Shtimi i kuajve e i mekanizmave dhe pakësimi i qeve duhet të ecë në mënyrë proporcionale, procesi për çdo gjë duhet të zhvillohet në rregull, pa shkaktuar shqetësime, se nuk kemi as mjete, as fonde për të bërë më shumë. Këto nevoja, natyrisht, janë planifikuar të plotësohen sa të jetë e mundur me fuqi punëtore dhe me kafshë pune. Fuqia punëtore dhe kafshët e punës janë kurdoherë të domosdoshme në bujqësi, por neve na del vazhdimisht përpara çështja e rendimentit të punës së tyre të ulët, gjë që, natyrisht, sjell uljen e rendimentit të prodhit, ngritjen e kostos etj.

Atëherë q'duhet të bëjmë? Gjatë këtij pesëvjeçari neve na vihet detyrë ta studiojmë më seriozisht pro-

blemin e mekanizimit në bujqësi, sidomos atë që ka lidhje me shërbimet që u duhen bërë bimëve të ndryshme, në të cilat jemi shumë prapa, gjë që, sipas mendimit tim, rrjedh për arsyen se edhe mundësitetona kanë qenë të kufizuara se s'kemi pasur mundësi finanziare, edhe se jemi influencuar nga mentaliteti i vjetër i fshatarit tonë që ua bën shërbimet bimëve në mënyrë primitive. Ai me zor, bile as që do t'i përdorë disa mjete, siç janë kultivatori etj., por preferon më mirë shatën, bile edhe me bisht të gjatë, apo capin ose kalistirin. Mirëpo mund të përballohet prashitja, të paktën dy herë, me të tilla mjete, e këtyre qindra mijëra hektarëve të mbjellë me bimë të ndryshme? Kjo është e pamundur të bëhet në kohën e duhur as si sasi as si cilësi, për arsyen se rendimenti i punës i këtyre veglave është fare i ulët, ndërsa kooperativisti ditën e punës e harxhon. Po sa procese pune ka, ku punën e dorës, me këto mjete, ne mund ta zë-vendësojmë me makina? Shumë. Sapo kemi filluar të prodhojmë mekanizma të ndryshëm në vend, por këta janë akoma të paktë. Ne duhet ta vazhdojmë këtë punë edhe në të ardhmen me shumë kujdes.

Edhe pyjet e pyllëzimet e reja aktualisht vuajnë shumë, pikërisht se nuk u bëhen shërbimet, për shkak të mungesës së fuqisë punëtore. Në rast se ne do ta mekanizojmë ca më shumë bujqësinë, do të kemi më tepër forca edhe për pyjet, sektor ky mjaft i rëndësi-shëm i bujqësisë sonë socialiste.

Një çështje tjetër të fundit që doja të prekja dhe që ka lidhje me bujqësinë është problemi i bukës dhe i zarzavateve. Në pesë vjetët e ardhshëm ne do të

vazhdojmë t'i vëmë rëndësi të madhe prodhimit të bukës, gjë që është e drejtë; por vazhdojmë që bukën ta konsiderojmë si ushqim kryesor dhe gati të vetmin, gjë që nuk është aspak e drejtë.

Kjo ka arsyе të thella fiziologjike, prandaj duhet të punojmë që ta ndryshojmë kryekëput këtë kuptim që të mund të ndryshojmë edhe praktikën në këtë çështje. Praktika nuk qëndron në pakësimin e prodhimit të drithërave, përkundrazi, në shtimin e tyre, por ne duhet të ndryshojmë praktikën e prodhimit pak ose aty-këtu aspak të zarzavateve, duke filluar që nga fasulet e deri te majdanozi, duke prodhuar nga këto më shumë se deri tani. Që të prodhojmë më shumë zarzavate nuk na pengon çështja e hektarëve të tokës, apo e mungesës së fuqisë punëtore, por janë konceptet e gabuara që na pengojnë seriozisht dhe na bëjnë të kemi humbje të rënda në ekonomi dhe sidomos në çështjen e shëndetit të popullit. Kjo e fundit nënvlef-tësohet quditërisht.

Ne ndihemi të kënaqur po të kemi bukë, pak mish, pak vaj e pak djathë dhe këto i konsiderojmë bazën e ushqimeve tonë. Duhet të njohim seriozisht, shokë, se kjo është primitive dhe nuk u përgjigjet normave të zakonshme ushqimore që rekomandon shkenca mjekësore për njeriun, ruan zhvillimin dhe orientimin e vjetër të ekonomisë, frenon zhvillimin modern të bujqësisë dhe nuk e lë këtë t'u përgjigjet as nevojave as shijeve të shoqërisë sonë në zhvillim të vrullshëm.

Kur shtrohet problemi për mbjelljen e zarzavateve, nxirren një mijë arsyë të kota për të mos i mbjellë, kultivohen disa lloje perimesh vetëm kur ka nxitje për

eksport, siç janë domatet, preshtë, fasulet pllaqi apo patatet e hershme etj.

Çështja nuk zgjidhet duke thënë të mos eksportojmë zarzavate që t'i hamë vetë. Jo, çështja vihet të prodrojmë shumë për vete dhe për eksport. Sa kohë që ne nuk do ta kuptojmë si duhet këtë problem, sa kohë që do të mbetemi skllevër të koncepteve të vjetra në çështjen e zarzavateve, ne këto nuk do t'i mbjellim sa duhet në praktikë dhe tokës nuk kemi për t'i marrë rendimente të larta prej tyre. Pastaj edhe drithë sikur të prodrojmë shumë, buka neve nuk do të na mjaftojë, as organizmin e njeriut nuk do të na e ushqejë si duhet, për arsy se ajo përbëhet nga disa lëndë të pakta, të kufizuara, që nuk mund të zëvendësojnë dot lëndët e shumta, të ndryshme e të domosdoshme, për të cilat ka aq shumë nevojë organizmi dhejeta e njeriut.

Më lejoni t'i shkoj një çikë më thellë shkencërisht kësaj çështjeje. Kur kam qenë i ri, student, jam marrë ca, me gjithëse pak, edhe me shkencat natyrore, me botanikë, prandaj kur marr vesh se është botuar ndonjë libër i tillë, e porosis, e lexoj dhe nënvizoj ato çështje që më më interesojnë. I tillë është një libër i profesor Binet, anëtar i Institutit të Francës dhe ish-president i Akademisë Nacionale Franceze të Mjekësisë, titulli i të cilit është «BIMËT DHE SHËNDETI I NJERËZVE». Ja ç'thotë ai për disa nga këto çështje. Mos u mërzitni, ju lutem, se jua kam përkthyer.

«... Njihet nga të gjithë përdorimi i përditshëm i dömates në gjellë dhe si lëng i pijshëm. Përveç ujit, ajo përmban 3,6 për qind glysid, pak substanca azotike dhe shumë pak lipide. Por, nga ana tjetër, ajo

përmban vitamina A dhe C, vitamina B, si dhe pektinën. Te domatja kanë zbuluar një lëndë që nuk është larg nga kortizoni, çka do të thotë se kjo zarzavate mund të konsumohet nga ata që vuajnë nga reumatizma dhe sëmundje të tjera të këtij lloji».

«... Çikorja përmban nitrat të potassiumit. Ajo përmban, gjithashtu, hekur 20-25 miligram për çdo 100 gram substancë. Në 100 gram hi të çikores janë gjetur 31,47 dhe 7,48 miligram manganez. Shumë mjekë vënë në dukje vlerën mjekësore kurative të kësaj bime përmëlçinë».

«... Qepa dhe preshi janë ushqim i çmuar dhe një medikament dieuretik i fuqishëm që eliminon urenen dhe sodiumin. Të dy këta lloj perimesh shërbejnë në sëmundjet e edemës, të asitës, pleurezisë, perikarditit etj. Qepa ka fuqi antiskorbutike dhe, në sajë të sylfyr d'alilë që përmban, ka edhe veti antiinfektuese të mahnitshme. Ajo përmban një lëndë aktive që quhet glu-kokininë, e cila lejon uljen e sasisë së sheqerit në gjak. Qepa ka, gjithashtu, cilësi antibiotike dhe neutralizon stafilokokët. Profesorë gjermanë e rekomandojnë qepën për shërimin e gushës egzoftalmike. Ata këshillojnë, gjithashtu, që preshi dhe qepa të hahen në supa, pse janë ushqime që japid fuqi».

«... Hudhra konsiderohet si një antiseptik pulmonar që nuk mund të neglizhohet. Ajo ka mundësi hipotensive, cilësi diuretike, laksative, aperitive, më së fundi përdorimi i saj ngrë tonin e organizmit».

«... Majdanozi është me gjithë mend një ushqim i jashëzakonshëm: tonik, antirakitik, antianemik, antiskorbutik, antiskleroftalmik dhe, pa e tepruar, mund

të konsiderohet ushqimi i sigurt më i çmuar që natyra ka vënë në mënyrë aq bujare në dispozicion të njerëzve. Kompozimi kimik i majdanozit është i mahnitshëm. Ai përmban një shumicë kalciumi. Jashtëzakonisht e lartë është edhe përbajtja e tij në hekur: mesatarisht 19 miligram për çdo 100 gram në fletë të freskëta. Një grusht majdanoz prej 20 gramësh përmban 3,8 miligram hekur. Ai është i pasur në shumë oligoushqime dhe veçanërisht në manganez (0,9 miligram për çdo 100 gram gjethë të freskëta). Majdanozi i freskët përmban vitamina C në sasinë 240 miligram në çdo 100 gram. Duhet bërë e njohur se ky ushqim hahet më shumë i freskët dhe kushton fare pak. Ai jep në përpjesëtim të konsiderueshëm sasinë e vitaminave antiskorbutike të nevojshme çdo ditë për njeriun. Një grusht majdanoz prej 20 gramësh në gjendje të freskët, përmban 48 miligram acid asorbik që korrespondon me dy të tretat e vitaminave C të nevojshme për të rriturit. Te majdanozi ekzistojnë edhe karotenoidet ose provitaminat A në një përqindje shumë të lartë, 60 miligram për çdo 100 gram. Kështu, një tufë prej 20 gramësh majdanoz mund të japë 12 miligram provitaminat A, që do të thotë një sasi 3 ose 4 herë më të madhe sesa ajo që caktohet në normat e ushqimit për të rriturit (që është 2 deri 4 miligram në ditë) etj.

«... Siç dihet, trupi i njeriut ka nevojë për kalcium dhe fosfor, të cilët i gjejmë në një përqindje të lartë në fletët e kokës së lakrave dhe të rrepave, si edhe në thierzat, që te ne janë zhdukur thuajse fare, fasulet, mollët etj. Spinaqi përmban 30-130 miligram hekur për çdo 100 gram. Ai përmban, gjithashtu, një

dozë të lartë potassiumi, 489 miligram për 100 gram spinaq, si dhe një sasi të konsiderueshme magneziumi, 828 miligram».

Libri i profesor Binet flet edhe për shumë lloj zarzavatesh të tjera me radhë dhe për çdo frutë, por këtu nuk është vendi të zgjatemi, mjafton të kuptojmë esencën dhe rëndësinë e problemit që ka të bëjë me kënaqësinë, mirëqenien dhc shëndetin e njeriut.

Përbajtja e lëndëve të perimeve që përmenda dhe e të gjitha të tjerave, për të cilat flet ky autor, është shumë e nevojshme, bile e domosdoshme për organizmin dhe jetën e njeriut. Prandaj për çështjen e ushqimeve, duke përfshirë edhe zarzavatet, për rëndësinë që kanë dhe gatimin e tyre, ne kemi bërë një Plenum të Komitetit Qendror¹. Mund të duket si e çuditshme që Komiteti Qendror është marrë deri edhe me gatimin e zarzavateve. Por sa e nevojshme ka qenë një gjë e tillë e megjithatë ne përsëri vazhdojmë që zarzavatet t'i mbjellim pak, t'i prodrojmë pak, t'i gatuajmë dhe t'i hamë pak. E theksoj këtë problem edhe një herë për arsy se nuk është «gusto personash», por një problem kombëtar me rëndësi të veçantë ekonomike dhe sidomos fiziologjike për njeriun.

Plani mbi të cilin po punojmë për t'ia paraqitur për aprovim Kongresit të 6-të të Partisë, natyrisht, është një plan i madh, është një plan i ngjeshur, por i

1. Është fjala për Plenumin e 10-të të KQ të PPSH (6-8 qershor 1963), ku shoku Enver Hoxha mbajti raportin: «Mbi gjendjen ekonomike, sociale e kulturore të fshatit dhe masat për ngritjen e mëtejshme të saj». (Shjh: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 25, f. 8).

studiuar dhe real. Përpunimin e tij të mëtejshëm ne po e bëjmë akoma edhe sot këtu, në këtë mbledhje të përbashkët të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, do të vazhdojmë ta bëjmë edhe me popullin gjatë punimit të direktivave që do të nxjerrim. Të gjithë na preokupon shumë çështja që plani të jetë jo vetëm i realizueshëm, por edhe të plotësojë nevojat kurdoherë në ngritje të popullit, mirëqenien e tij dhe të sigurohen zhvillimet e drejta të forcave prodhuase. Natyrisht mund të bëhen plane lehtësish të realizueshme, por të pamjaftueshme, mund të bëhen edhe plane në stratosferë, pa baza, pra të parealizueshme. Ne nuk mund të gënjejmë veten me asnjerin nga këto plane. Jemi pra duke ndërtuar një plan që, siç e thashë, është i ngjeshur, por i studiuar dhe i bazuar, që do të kërkojë nga ne një punë shumë të madhe dhe të organizuar mirë për t'u realizuar.

Edhe planin ekonomik të pesëvjeçarit të katërt drejt e parashikuam, edhe ai ishte një plan i ngjeshur, por real. Dhe si dolëm me të? Me shumë sukses. Partia po shkon kështu në Kongresin e 6-të të saj kryetartë, me një bilanc shumë pozitiv, në të gjithë zërat, me përjashtim të sektorit të bujqësisë. Edhe në këtë sektor jo se nuk u punua, jo se nuk u bënë heroizma e sakrifica, apo nuk patëm suksese të mëdha, sidomos në disa kultura, por shumë gjëra ndikuan, u vërtetuan të meta objektive dhe subjektive.

Por, kur shikon tejkalimet e shumë zërave të planit nga shifrat e vendosura në Kongres, atëherë thua: Ç'forcë kolosale ka Partia, fshatarësia, rinia, gruaja, ç'forcë revolucionare jetëdhënëse është pushteti ynë popullor!

Të mos harrojmë se si u çuan peshë populli dhe Partia me një entuziazëm të papërshkruar, si u ngritën valët e revolucionit dhe zienin fabrikat, fushat e kordat, detet e minierat, se si u ngrit i madh e i vogël në këmbë. Kështu duhet të ngjasë dhe do të ngjasë edhe për pesëvjeçarin e ri.

Për asnjë çast nuk duhet të harrojë Partia se entuziazmi ronor i masave, i frymëzuar dhe i udhëhequr nga Partia, është vendimtar. Prandaj të luftohet çdo pesimizëm në zbatimin e planit, bagazhi i thatë i shifrave gjoja të bazuara e shkencore, por pa entuziazëm dhe hov revolucionar, pse një gjë e tillë është frenuese.

Partia punon dhe lufton që njerëzit t'i kuptojnë dhe shkencërisht problemet, por t'i zgjidhin ato kurdoherë në mënyrë revolucionare dhe me një entuziazëm e besim të madh.

Partia i kritikon të metat dhe gabimet, me qëllim që t'i vëré gjërat në vend dhe njerëzit t'i ndreqë që të ecin përpëra kurdoherë të spastruar e të korrigjuar me entuziazëm e hov revolucionar. Partia kërkon disiplinë proletare, disiplinë teknike, disiplinë agroteknike, por me entuziazëm dhe me besim të madh e dashuri të thellë për atdheun socialist. Për asnjë kohë nuk duhet të lihet të bjerë entuziazmi, i cili, siç e kuptojmë ne, marksistët, e ka bazën e vet në punë, në realizimin e detyrave, në shfrytëzimin me drejtësi dhe në rregull të fryteve të këtij përparimi. Entuziazmi për ne nuk qëndron në fjalët boshe, por në ato që prekin ndjenjat e thella të popullit, «telat» e zemrës. Po ia preke ato atij, ai sulmon qiejt.

Në çdo punë ne nuk duhet të lejojmë të vegjetojnë

njerëz të dhelasur, me moral të rënë e tendenca pesimiste, që hiqen zvarrë, njerëz që e kanë humbur besimin në forcën e gjallë të masave dhe hiqen të ditur për të frenuar guximtarët, heroikët.

Guximi, heroizmi, plus pjekuria dhe dituria e njerëzve tanë, të pleksura ngushtë të gjitha këto veti në entuziazmin realist të tyre, do të bëjnë çudira akoma më të mëdha në këtë pesëvjeçar. Unë jam shumië optimist në këtë çështje, prandaj nuk ka përse të kemi frikë nga shifrat pavarësisht se ato janë të ngjeshura, po reale dhe plotësisht të mundshme t'i kthejmë në të mira materiale për popullin, për atdheun tonë, për sozializmin. Pikërisht për këtë qëllim të lartë Partia do të mobilizojë masat e gjera të punonjësve në një hov revolucionar të paparë, prandaj çdo gjë do të realizohet e do të tejkalohet me siguri, ashtu si edhe në pesëvjeçarin e katërt.

*Botuar për herë të parë
me ndonjë shkurtim në li-
brin: Enver Hoxha, «Ra-
porte e fjalime, 1970-1971»,
Tiranë, 1972, f. 371*

*Botohet i plotë sipas origji-
nalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

ATDHEU ËSHTË I GJITHË POPULLIT, PRANDAJ DUHET TË MBROHET NGA I GJITHË POPULLI

Nga fjala në Plenumin e 12-të të KQ të PPSH¹

1 korrik 1971

Shokë dhe shoqe,

Asnjë shtet në botë nuk çarmatoset, përkundrazi të gjitha, pa përjashtim, qofshin këto shtete imperialiste, socialimperialiste, «demokratiko-borgjeze», revisioniste, të gjitha armatosen, të gjitha përgatitin forcat sulmuese pushtuese për të rindarë botën në mes kapitalistëve, për të shtypur revolucionet, për të shkatterruar socializmin dhe për të robëruar popujt. Përpara kësaj gjendjeje, shteti ynë socialist detyrohet, gjithash tu, të armatoset për mbrojtjen e lirisë dhe të paravësisë së tij që kërcenohet nga armiqtë e socializmit.

Çarmatim në botë nuk po bëhet dhe nuk do të bëhet, derisa të mos zhduken shtetet imperialiste dhe so-

1. Në këtë Plenum u diskutua edhe mbi masat për përsosjen e mëtejshme të përgatitjes e të gatishmërisë luistarake të Ushtrisë e të Forcave Vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore.

cialimperialiste. Çdo iluzion për çarmatim për atë shtet që bie në kurthin e ngritur nga imperialistët amerikanë dhe nga socialimperialistët revisionistë sovjetikë, është vetëvrasje. Qëllimi i të dyja këtyre fuqive imperialiste është të sigurojnë armatime të bollshme e moderne për vete, të arrijnë të balancojnë deri diku forcat e tyre dhe këtë balancim ta paraqitin si «përpjekje për çarmatim» për të gënjer kështu ata që mund të gënjen për t'u çarmatosur, që t'u impojojnë më lehtë diktaturën e tyre dhe, nga ana tjeter, t'u japid thërrime të ushqehen «teoricienët pacifistë» që bëjnë çmos për të lyer me sheqer pilulen, që u jepet për të gëlltitur naivëve, që shpresojnë dhe rrojnë jastë realitetit objektiv.

Shpërthimi i një lufte botërore nuk duhet ekskluduar në asnje mënyrë. Shtetet agresive imperialiste, me imperializmin amerikan në krye dhe me social-imperializmin sovjetik me aleatët e tij, armatosen dhe përgatiten për këtë qëllim. Këta mund të shpërthejnë veç e veç një luftë kundër nesh dhe kjo luftë, duke prekur edhe interesat e atij shteti imperialist që ka pritur për një moment «t'i nxirren gështenjat nga zjarrri», të kthehet më pas në një luftë botërore.

Imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët revisionistë sovjetikë mund të shpërthejnë luftë në mes tyre dhe kjo luftë të marrë përpjesëtime botërore, kur kontradiktat të jenë acaruar në atë shkallë që, siç e kanë në parimin e sistemit të tyre shfrytëzues, t'i zgjedhin ato me anën e luftërave imperialiste, grabitëse, të padrejta.

Ca më keq nuk duhen ekskluduar luftërat lokale

që imperialistët ose socialimperialistët shpërthejnë kundër shteteve të vogla socialiste ose josocialiste, që u rezistojnë presioneve, shantazheve dhe diktateve të tyre. Këto agresione në rendin e ditës për ta janë në funksion dhe përgatitin terrenin e cilitdo agresor për luftëra imperialiste në një shkallë më të gjerë të mëvonshme, janë avancimet taktike të agresivitetit imperialist në strategjinë e tyre të një lufte imperialiste globale. Këtë synim ndjekin edhe komplotet e puçet e fshehta të kurdisura nga agjenturat e imperialistëve dhe të socialimperialistëve brenda shleteve të ndryshme, pa ndërhyrje ushtarake të jashtme, por duke sjellë në fuqi klika tradhtare vendëse në shërbim të tyre.

Pra çarmatim në këtë botë aktuale nuk ka. Imperialistët dhe socialimperialistët po armatosen me të madhe për luftëra imperialiste, për të shtypur popujt e tjerë dhe, tok me ta, edhe popujt e tyre. Duhet të kemi parasysh faktin se, pavarësisht nga shkalla dhe intensiteti i veprimit, masat e gjera të popujve të shteteve imperialiste dhe socialimperialiste nuk janë plotësisht të bindura për të shkuar në kasaphana agresive. Duhet të njohim dhe të llogaritim, natyrisht, pa pasur besime të verbra, se atje ka dhe do të ketë rezistencë kundër veprimeve agresive të imperialistëve. Sa më shumë që këta të pësojnë disfata, aq më e madhe do të bëhet rezistenca e popullit në ato vende. Masat e demonstruesve, grevat, demonstratat dhe vetë puna e të ashtuquajturve pacifistë nuk mbeten pa efekt. Edhe kjo rezistencë, pra, është një pengesë serioze për agresorët, prandaj sa më e organizuar të jetë kjo, aq më e rrezikshme bëhet për agresorët e popujve.

Kurse armatimi i shteteve socialiste ka një qëllim të madh parimor: mbrojtjen nga çdo agresor dhe asnje synim agresiv o imperialist. Ai drejtohet, pra, kundër imperialistëve dhe socialimperialistëve agresorë, kundër shtypjes së të drejtave, pavarësisë dhe lirisë të popujve nga armiqjtë e tyre, ai synon t'u vijë në ndihmë popujve për t'i fituar dhe për t'i ruajtur këto të drejta. Shteti socialist është i popullit, pse në të populli është në fuqi dhe udhëhiqet nga parti marksiste-leniniste. Ky shtet ka mbështetjen e plotë të masave në çdo gjë, veçanërisht në çështjen e forcimit të mbrojtjes, në çështjen e luftës kundër luftës imperialiste dhe pro luftërave të drejta çlirimtare të popujve dhe të triumfit të revolucionit socialist botëror.

Të tillë vijë ndjek Republika jonë Popullore. Si i vetmi shtet socialist i vërtetë në Evropë, Republika Popullore e Shqipërisë është një ishull i vogël, gjeografikisht i rrethuar plotësisht nga shtete kapitaliste dhe revisioniste. Duke qenë në mes të zjarreve, neve na vihet si detyrë e dorës së parë, detyrë mbi detyrat, të mbrohem i nga zjarret, t'i përballojmë me sukses ato dhe të dalim fitues, duke ruajtur të paprekur atdheun, jetën dhe fitoret e popullit, duke mbrojtur dhe duke forcuar vazhdimisht rendin tonë socialist.

Të gjitha këto gjëra nga më të shenjtat do të mbrohen me sukses, kur populli ynë, i madh e i vogël, në unitet të çeliktë rrëth Partisë, të ngrihet në një nivel të lartë politik dhe ideologjik, që të kuptojë qartë në çdo situatë, të qetë o të turbullt, të lehtë o të vështirë, vijën e Partisë, të kuptojë taktikat dhe strategjinë e saj dhe të dijë të mësohet që t'i zbatojë ato

në jetë me ndërgjegje dhe me një disiplinë të hekurt, me një patriotizëm të zjarrtë në çdo moment, në çdo rrethanë, pa marrë parasysh sakrificat.

Të gjitha këto gjëra nga më të shenjtat mbrohen me armë në dorë, duke pajisur ushtrinë dhe popullin me mjete moderne, duke i stërvitur vazhdimisht e kurdoherë që të dinë t'i përdorin ato në perfeksionin më të madh. Ne stërvitim vazhdimisht ushtrinë dhe popullin me artin tonë luftarak që qëndron mbi atë të armikut, pse mbështetet në marksizëm-leninizmin, në eksperiencën e Luftës sonë Nacionalçlirimtare, në eksperiencën më të mirë të luftërave progresive dhe të drejta të popujve, të zhvilluara kundër gjithfarë agresorësh në epoka të ndryshme historike, pse arti ynë luftarak zbatohet nga një ushtri dhe nga një popull që udhëhiqen nga Partia dhe që dinë përse luftojnë, që luftojnë në tokën e tyre, të cilën e njojin me pëllëmbë, e kanë fortifikuar anekënd për ta kthyer në varr për pushtuesit eventualë që do të guxojnë t'i futen ndonjë aventure kundër atdheut tonë.

Partia dhe populli ynë duhet të kenë të qartë se Republika Popullore e Shqipërisë është një vend me rëndësi të madhe strategjike, që lakmohet nga të gjithë armiqtë veç e veç dhe në aleanca në mes tyre, në kufij imediatë dhe në rrethime koncentrike rreth saj. Që të gjithë ata, pa përjashtim, janë armiq të betuar të Partisë së Punës të Shqipërisë, Parti që mban lart dhe mbron me heroizëm marksizëm-leninizmin, ata janë armiq të betuar të regjimit socialist, që është një pasqyrë e ndritur për të gjithë popujt e vendet e tjera. Qëllimi i përbashkët i armiqve tanë ka qenë,

është dhe do të jetë t'i likuidojnë Partinë dhe rendin tonë socialist. Ata kanë vepruar në këtë drejtim veç e veç dhe së toku, duke përdorur të gjitha format dhe metodat, por kanë dështuar me turp, pse përgatitja e shumanshme dhe rezistenca jonë kanë qenë të mëdha e të çelikta.

Ky është realiteti dhe këtë realitet ne duhet ta kuptojmë në tre komponentë: Së pari, në pozitën strategjike të rëndësishme të Shqipërisë, së dyti, në domosdoshmërinë absolute të përgatitjes sonë ushtarake, politike dhe ekonomike në një shkallë shumë të lartë, që asnjëherë nuk duhet dobësuar, dhe së treti, në atë që armiqtë tanë nuk do të ndërrojnë kurrë qëllimet e këqija kundër popullit tonë. Për këtë nuk duhet pasur në asnje rast as edhe iluzionin më të vogël.

Të mos harrojmë asnjëherë thelbin e çështjes dhe të gënjenjehemi nga koniunkturat e përkohshme politike ndërkombëtare. Këto duhet t'i ndjekim me kujdesin më të madh dhe të përpinqemi të përfitojmë nga momentet, por asnjëherë të mos dobësojmë punën dhe luftën tonë për zgjidhjen e problemeve dhe të detyrave kyç, asnjëherë të mos lejojmë të na dëmtohen paramet, pse pikërisht për arsyet të shumë rrëthanave, në koniunkturat aktuale, armiku në këto drejtime synon kundër nesh, kurse ne synojmë të fitojmë prej tyre dhe ai të ketë humbje.

Grupimi agresiv i NATO-s dhe grupimi agresiv i Traktatit të Varshavës përbëjnë rreziqet kryesore kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Ne duhet të jemi plotësisht të përgatitur për t'u rezistuar dhe

për t'i thyer sulmet agresive të të dyja palëve, qofshin këto që bëhen të veçuara, qofshin njëkohësisht, qofshin të dy së toku. Rreziku nga këto grupime ekziston në çdo kohë për vendin tonë. Ca më shumë shtohet ai kur shtohen dhe acarohen kontradiktat në mes të këtyre dy grupimeve imperialiste. Pavarësisht se ç'formula do të përdorin agresorët, në sy të opinonit botëror të gjithë përpinqen ta fshehin qëllimin që kanë për pushtimin e Republikës Popullore të Shqipërisë. Prandaj vendi ynë, Partia dhe populli duhet të jenë plotësisht të përgatitur, asnjëherë dhe asgjë nuk duhet të na gjejë në gjumë, asgjë s'duhet të na trembë, të na tronditë dhe as të na mashtrojë.

Për ne ekziston kurdoherë edhe rreziku jugosllav. Regjimi aktual jugosllav nuk ka asgjë socialiste, ai është një regjim kapitalist, kundërshtar deri në fund i Partisë dhe i pushtetit tonë popullor. Synimet e Jugosllavisë titiste ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, pavarësisht se nuk u arritën dot, ne i dimë cilat kanë qenë. Aktualisht Jugosllavia titiste, që hiqet si një «vend i botës së tretë», «kundër blloqeve ushtarake», po kalon një krizë të rëndë regjimi, ekonomike, politike, konstitutionale. Vetë «indipendenca» si një shtet borgjez rrezikohet nga rivalitetet e të dy grupimeve agresive, atij të NATO-s dhe të sovjetikëve, që përpinqen të nxjerrin në skenë dhe të nxitin shovinizmin serbo-madh dhe atë kroat. Prandaj në situatën aktuale nuk duhet nënveftësuar asnjëherë rreziku jugosllav, ideologjia antimarksiste titiste dhe struktura politike organizative shtetërore kapitalisto-shoviniste e tij.

Por pushtimi i Çekoslovakisë nga trupat sovjetike dhe grupimi i vendeve që bëjnë pjesë në Traktatin e Varshavës, doktrina famëkeqe antimarksiste e «sovranitetit të kufizuar» të Brezhnjevit, lënia dorë të lirë nga Uashingtoni aleatit të tyre sovjetik në Çekoslovakia, bënë që socialimperialistët sovjetikë të kërçenonin me pushtim Jugosllavinë, sigurisht me synimin për të dalë në Adriatik. Ky plan sovjetik u dha zemër shovinistëve serbë, alarmoi Titon dhe të gjithë passesit e tij në Jugosllavi, të cilët filluan të merrnin masa për t'u mbrojtur. Një pushtim i Jugosllavisë nga ana e sovjetikëve pa dyshim rrezikonte edhe kufijtë tanë nga të gjitha anët. Ne nuk u alarmuam aspak, po morëm të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e vendit, përfitua nga koniunktura e krijuar, demaskuam botërisht dhe zyrtarisht grupimet e forcave pushtuese sovjetike në Bullgari dhe, siç e dini, deklaruam botërisht se, po të sulmohej Republika Federative Popullore e Jugosllavisë nga revizionistët sovjetikë dhe grupimi i Traktatit të Varshavës, populli shqiptar do të qëndronte përkrah popujve të Jugosllavisë.

Kjo deklaratë me shumë rëndësi bëri efekt të ndjeshëm në botë, veçanërisht në popujt e Jugosllavisë, të cilët panë se në kohët më të rrezikshme për ta i përkrahu vetëm populli shqiptar, kundër të cilit kanë punuar me zell aq të madh gjithë kralët serbë deri te klika revizioniste e Beogradit. Akti ynë ka dhe do të ketë edhe më vonë efektet e tij.

Ne nga ana jonë kemi bërë vazhdimisht një luftë të drejtë parimore në mbrojtje të të drejtave të vëllezërve tanë shqiptarë që rrojnë në trojet e veta në

Jugosllavi, si edhe të të gjithë popujve të Jugosllavisë.

Jeta vërtetoi drejtësinë e vijës së Partisë sonë. Titoja tash po u bën disa lëshime shqiptarëve në të drejtat e tyre. Regjimi titist mendoi ndoshta me këtë rast që ne ta shuanim polemikën ideologjike kundër tij dhe të bënim hapa të atillë që të përfitonin revisionistët jugosllavë. Por, ata u gabuan, synimet e tyre nuk shkojnë te ne. Duke ruajtur fort vijën tonë të drejtë, duke ruajtur fort parimet, në brendi dhe në formë, gradualisht ne zgjeruam marrëdhëniet shtetërore, tregtare dhe veçanërisht në shkallë shumë të gjerë marrëdhëniet arsimore, kulturore dhe turistike me vëllezërit shqiptarë që jetojnë në Jugosllavi.

Unë nuk do të zgjatem në këtë çështje, pse është jashtë temës, por dëshiroj të theksoj atë që ne nuk e kemi fshehur dhe nuk e fshehim nga kurrikush, se shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi i duam me gjithë shpirt, pse janë vëllezërit dhe motrat tona të një gjakut, të një gjuhe edhe të një mëme, që valët e egra të historisë i kanë shkëputur nga trungu. Ne, si marksistë-leninistë dhe si shqiptarë, ashtu si deri tash, edhe në të ardhmen, do të luftojmë kundër të gjithë atyre që do të orvaten t'i çkombëtarizojnë dhe t'i shtypin shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi, do t'i përkrahim në kërkesat e tyre që të fitojnë të gjitha të drejtat që u përkasin brenda kushtetutës së Jugosllavisë. Ne e kemi për detyrë t'i ndihmojmë ata, veçanërisht në zhvilimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare me një frysëzim të madh patriotik. Ky qëndrim yni është i drejtë dhe s'bie në kundërshtim me miqësinë me po-

pujt e Jugosllavisë, me të cilët, pavarësisht nga papajtueshmëria jonë ideologjike me titizmin dhe me regjin min në fuqi, ne dëshirojmë të rrojmë në harmoni dhe shqiptarët e Jugosllavisë janë në këtë drejtim një faktor i madh revolucionar, progresist, patriotik.

Por në çdo veprim, në çdo problem, nuk duhet harruar kurrë problemi i madh i mbrojtjes, çështja e vigjilencës, e cila duhet të qëndrojë kurdoherë e mprehtë dhe asnjëherë të mos humbasë busulla, siç e humbasin disa që shkojnë sa djathtas majtas, harronjë kryesoren, parimin dhe kapen nga elementët e lëkundshëm të koniunkturës ose nga sentimentalizma të sëmurë dhe interesa të vegjël personalë, duke harruar dinjitetin dhe rolin e madh edukativ e moral që luajnë Partia dhe atdheu ynë socialist.

Aktualisht, në drejtim të Shqipërisë ne asistojmë në një fenomen që mund ta quajmë me karakter ndër-kombëtar: gati të gjitha vendet kapitaliste po lidhin dhe duan të lidhin marrëdhënie diplomatike me Republikën tonë Popullore. Deri edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet përfaqësuesve të ndryshëm në Organizatën e Kombeve të Bashkuara po bëjnë sondazhe në këtë drejtim. Edhe revisionistët sovjetikë s'po lënë rast pa përdorur për të ndrequr marrëzinë që bënë, duke prerë marrëdhëni shtetërore me një vend socialist siç është Republika Popullore e Shqipërisë, por ne as Shteteve të Bashkuara të Amerikës, as sovjetikëve nuk duhet t'u japim përgjigje, sepse as marrëdhënie shtetërore nuk dëshirojmë të kemi me ta.

Këtë situatë, natyrisht, e krijuan qëndrimet burrërore të Partisë dhe të Qeverisë sonë që përfaqësojn-

në vullnetin dhe forcën e popullit shqiptar. Kjo është një gjë e mirë, por nuk duhet të na mbulojë një eufori e tillë që të mendojmë se të gjitha këto shtete na duan të mirën, se ato janë miqtë tanë. Sot janë koniunktura të atilla që shumë shtete kapitaliste, dhe vëçanërisht fqinjët, i detyrojnë të thonë nga halli: «Jemi dakord me regjimin aktual të Shqipërisë dhe nuk dëshirojmë që ky të ndryshohet». Në realitet ata nuk janë aspak dakord me regjimin tonë, por këtë e thonë kundër një «ndërhyrjeje eventuale të sovjetikëve dhe doktrinës së Brezhnevit».

Greqia u detyrua të lidhë marrëdhënie diplomatike pa asnjë kusht me ne, se e dinte që kushtet do t'i hidheshin poshtë. S'duhet të harrojmë pastaj se në mes fqinjëve tanë imediatë, në lakmitë që ushqejnë ata ndaj vendit tonë, ka kontradikta. Me Italinë dhe me Jugosllavinë ne kemi marrëdhënie normale shtetërore, bëjmë tregti, shkëmbejmë ndonjë delegacion kulturnor-shkencor. Greqia deri tash ka pasë qëndruar jashtë marrëdhënieve të tilla me ne, por së fundi dëshiron të ketë lidhje, të bëjë edhe ajo tregti etj.

Lidhjet e vendit tonë me shtetet e tjera të botës e forcojnë pozitën ndërkombëtare të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ato do ta bëjnë më të lehtë njohjen nga ana e popujve të tjerë të përparimeve të shumanshme të vendit tonë, do të ndihmojnë për zhvillimin e tregtisë në interesin reciprok, por të gjithëve, pa përjashtim, dhe jo vetëm organeve të dikaturës, atyre të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Tregtisë e të Turizmit, na vihet si detyrë e madhe të kemi kurdoherë parasysh çështjen e mbrojtjes, në ra-

dhë të parë, të ngremë në një shkallë të lartë politike vigjilencën ndaj çdo lloj përpjekjeje që do të drejtobet kundër regjimit tonë socialist, kundër mënyrës së jetesës dhe të mendimit tonë socialist.

Vetëm një punë politike dhe ideologjike e gjallë dhe e shkathët e Partisë dhe e të gjitha organizatave të tjera politike të masave mund të krijojë një situatë të tillë të shëndoshë.

Në çdo kohë dhe vazhdimisht Partia i ka vënë një rëndësi të dorës së parë dhe i ka kushtuar një vëmendje të posaçme mbrojtjes së atdheut. Ky problem kaq i madh dhe jo i thjeshtë për t'u zgjidhur me sukses, ka angazhuar fonde njerëzore dhe materiale me një peshë të ndjeshme në ekonominë tonë populllore. Por kjo ka qenë dhe është e domosdoshme për mbrojtjen e jetës së popullit, të të drejtave dhe të lirive të tij të fituara me gjak e me sakrifica, për mbrojtjen e pavarësisë, të lirisë, të sovranitetit dhe të integritetit tokësor të Republikës Popullore të Shqipërisë. Në kuptimin e plotë të detyrave dhe të barrës që i ngarkohet ekonomisë popullore në çështjen e mbrojtjes nuk duhen llogaritur vetëm shpenzimet materiale, natyrisht, të nevojshme për këtë problem, por duhen llogaritur edhe fitoret moralo-politike që kanë rrjedhur dhe rrjedhin në gjirin e popullit, besimi në forcat e veta, sigurimi i ndërtimit të socializmit, ruajtja e pavarësisë etj. Të gjitha këto fitore i bëjnë njerëzit tanë kurajozë, të shkathët, të ndërgjegjshëm për kryerjen e detyrave dhe këto ndjenja të forta patrio-

tizmi bëjnë kështu që të nxirren e të shumëfishohen të mirat materiale, ndërsa shpenzimet materiale për destinacionin e mbrojtjes, të mos e pengojnë zhvillimin e vrullshëm ekonomik të vendit tonë.

Arritja e një kuptimi të tillë të plotë në këtë çështje jetike është rezultat i vijës politike të drejtë të Partisë dhe i zbatimit të saj në jetë në mënyrë korakte. Për mbrojtjen kanë punuar dhe punojnë së toku popull e ushtarë. Popull dhe ushtarë kanë bërë njëlloj sakrifica. Populli e ka konsideruar shërbimin ushtarak si një nga detyrat e tij më kryesore, e ka konsideruar ushtrinë si shkollë, jo për të ndërtuar fabrika dhe për të punuar arat, por për të mësuar me përsosmëri artin luftarak, përdorimin e armëve e të mjeteve të tjera ushtarake, pikërisht për të mbrojtur fabrikat, tokën, atdheun dhe jetën e popullit nga armiqtë eventualë.

Djemtë e bijat e popullit, kur largohen nga ushtria, nuk ndahen kurrë nga ajo, ata rrojnë me të, kanë kontakt me të, vazhdojnë të aftësohen më tej në detyrat e vëna nga ajo, vazhdojnë tok me të të përsosin sistemet e mbrojtjes etj...

Partia na ka mësuar dhe na mëson se atdheu socialist duhet mbrojtur nga çdo rrezik, i jashtëm apo i brendshëm, me forcat tona. Atdheu është i gjithë popullit, prandaj ai duhet të mbrohet nga i gjithë populli, mbrojtja duhet të ketë për ne karakterin e mbrojtjes populllore. E shikuar në këtë prizëm të drejtë marksist-leninist, Ushtria jonë Popullore është vetëm një pjesë e popullit të armatosur. Kështu, një luftë eventuale kundër pushtuesve të atdheut tonë

nuk do të jetë luftë vetëm e ushtrisë, por luftë e gjithë popullit të armatosur dhe të stërvitur për ndeshje kundër armiqve agresorë.

Ne nuk jemi as shtet borgjez e revizionist, as ushtri e kapitalistëve dhe e revizionistëve, por jemi një shtet socialist, prandaj ushtria jonë është një ushtri popullore, ushtri e revolucionit. Në rast të një sulmi nga ana e armiqve të jashtëm ne nuk do ta nisim luf्�tën nga pozitat kur filluam Luftën Nacionalçlirimtare; luftën mbrojtëse ne do ta fillojmë kryekëput nga pozita të reja, shumë më të favorshme për të arritur fitoren. Shumë gjëra kanë ndryshuar në karakterin e luftërave aktuale moderne agresive, si në strategji, në taktikë e në armatime, ashtu edhe në aleanca. Edhe përgatitja jonë politiko-ushtarake, edhe strategjia e taktika që ruajnë karakterin vendimtar popullor e revolucionar, ashtu edhe armatimet moderne, me të cilat është armatosur sot ushtria jonë, s'kanë qëndruar në vend. Kjo nuk do të thotë aspak se janë braktisur nga ne taktika e luftës partizane dhe parimet e saj politiko-ushtarake, përkundrazi, ato ne i kemi përsosur më tej dhe qëndrojnë kurdoherë si mësimë bazë shumë të vlefshme për Ushtrinë tonë Popullore. Çështja qëndron në atë që sot vendi ynë është i pavarur, i lirë, sovran, socialist, prandaj ai duhet të jetë i përgatitur më së miri që të përballojë një agresion eventual të jashtëm, që popull e ushtri, nën udhëheqjen e Partisë, të jenë si një trup i vetëm në këmbë për të mos e lejuar armikun të shkelë kufijtë tanë.

Partia, me një punë të thellë e të shumanshme, duhet të krijojë bindjen e plotë në popull se, për t'a

arritur fitores mbi armikun, në asnë moment nuk duhet të nënvleftësojë stërvitjen ushtarake, se është e domosdoshme të stërviten të gjithë për luftë dhe për mbrojtje, se duhet të bëjmë sakrifica të mëdha që të kapërcehen vështirësitë kolosale që sjell lufta me vete. Kështu duhet të kuptohet kjo, se lufta është diçka shumë serioze, se fronti i luftës nuk mund të jetë në një sektor të vetëm, por mund të jetë në shumë sektorë e kudo, se lufta nuk do të bëhet vetëm nga ana e ushtrisë, por ajo do të jetë një luftë popullore dhe se gjithë strategjia jonë është e bazuar në strategjinë popullore, duke pasur, natyrish, parasysh edhe strategjinë që na vë përballë armiku, që ne duhet ta bëjmë të dështojë.

Në çdo kohë Partia u ka vënë rëndësi të madhe forcimit, modernizimit dhe përgatitjes politiko-ushtarake të ushtrisë dhe të të gjithë popullit. Ushtrinë ajo e ka konsideruar kurdoherë si një shkollë të madhe, për të qenë e gatshme në çdo moment që t'i bëjë ballë me repartet e veta të papriturës së fillimit. Si një ushtri kuadri, në rast emergjence, ajo hapet në një kohë të shkurtër në ushtri të plotë, me reparte të plota. Kjo është njëra anë e problemit. Por ushtria jonë aktive e kohës së paqes nuk stërvit vetëm rekru-tët, por freskon dhe plotëson njëkohësisht stërvitjen e rezervistëve dhe të të gjithë atyre që, për arsyetë ndryshme, janë të bronjuar nga shërbimi i rregullt ushtarak.

Partia, me rrugën e saj të drejtë marksiste-leniniste dhe në mënyrë dialektike, ka përpunuar vazhdimisht vijën politike, atë organizative dhe ushtarake

të ushtrisë sonë dhe ua ka përshtatur këtë zhvillimit dhe forcimit të socializmit në vendin tonë, ua ka përshtatur kushteve politike, të brendshme dhe të jashtme, ua ka përshtatur nevojave objektive të krijuara në vend dhe atyre që krijonin armiqjtë e vendit tonë në vendet e tyre. Vija e Partisë ka qenë dhe mbetet shpirti i ushtrisë, truri që e drejton atë në rrugë të drejtë, forca jetëdhënëse që e bën të jetë e fortë dhe e pathyeshme.

Ushtria jonë u spastrua kështu nga shumë forma organizative dhe rregullore me gjëra të gabuara apo të huaja e të papërshtatshme pér një ushtri si jona, ushtri e diktaturës së proletariatit, ushtri e vogël në numër e një vendi të vogël në popullsi, që me forcat e veta, e detyruar nga rrethanat objektive, i duhet të kryejë detyra kolosale, të përballojë forca armike të mëdha në numër dhe në armatime, t'i mundë dhe të fitojë mbi to. I gjithë ky transformim i madh pozitiv që ka perfekcionuar dhe ka modernizuar më tej strukturën dhe organizimin e ushtrisë dhe të popullit, që duhet stërvitur pér luftë dhe pér mbrojtje njëkohësisht, nuk u kuptua përnjëherësh dhe plotësisht nga të gjithë, pse disa i ka penguar rutina e vjetër, i kanë penguar konceptet e vjetra mbi ushtrinë, pikëpamjet skolastike dhe akademike, si edhe ana e lëvizjeve, e transformimeve të nevojshme dhe disa herë të domosdoshme të reparateve dhe të kuadrove. Këta nuk mund të realizonin shpejt se ushtria, si çdo gjë që lëviz, që transformohet, që përmirësohet, duhet të bënte ndryshime në mënyrë dialektike, por mendonin se me ligjet e saj,

me rregulloret e saj të vendosura një herë e mirë, ajo duhet të qëndrojë si një «bllok i pandryshueshmë».

Unë nuk dua të zgjatem për të shpjeguar strukturën organizative aktuale të ushtrisë, pse ju morët dijeni nga raporti i Byrosë Politike. Unë dua të theksoj me forcë që çështja e forcimit, e përmirësimit të strukturës organizative të ushtrisë dhe jo vetëm të ushtrisë si me thënë aktive, të asaj që stërvitet në kazerma, por e të gjitha reparteve të Ushtrisë sonë Popullore, e të gjithë popullit të inkudruar në formacione luftarakë, është një nga detyrat kryesore të Partisë në ushtri dhe jashtë ushtrisë, është një nga detyrat kryesore të pushtetit dhe veçanërisht detyra e madhe vendimtare e kuadrove të ushtrisë të të gjitha rangjeve, të të gjitha reparteve.

Partia të kuptojë mirë problemin, gjerësinë dhe rëndësinë e tij jetike, se kështu do të mobilizohet t'i kryejë më mirë detyrat. Aktualisht ne nuk jemi duke përgatitur disa reparte elite për të qenë gati për luftë dhe për mbrojtje në kohë rreziku, por jemi duke përgatitur njëkohësisht të gjithë popullin për të qenë plotësisht i gatshëm për luftë dhe për mbrojtje. Me fjalë të tjera, Partia këtë duhet ta kuptojë qartë, se kështu bëhet e ndërgjegjshme për detyrën e rëndë e të shenjtë që i ngarkohet të kryejë. Ne që tash, në kohën e kësaj paqeje relative, e përgatitim dhe e stërvitim intensivisht ushtrinë e madhe të kohës së luf-tës për të qenë e gatshme për mbrojtjen e atdheut dhe nuk shkojmë nga parimi i gabuar se është mjaft të kemi një ushtri kuadri, pa në rast rreziku bëjmë mobilizimin dhe i plotësojmë repartet e kohës së luf-

tës. Për Partinë nuk qëndron vetëm çështja që të bëjë mobilizimin e përgjithshëm në kohë emergjence. Këtë ajo do ta bëjë, por për ne vihet detyra që mobilizimi të bëhet në një kohë shumë, shumë të shkurtër, dhe ata që do të mbushin repartet, të jenë të përgatitur dhe të stërvitür me kohë si ushtarë dhe si kuadro ushtarake të vërtetë.

Pikërisht Partia duhet të kuptojë mirë se organizimi aktual i ushtrisë, i cili duhet vazhdimisht të përsoset, pa dëmtuar aspak përgatitjen dhe gatishmërinë, lejon një përgatitje të tillë masive popullore sa më afër bazave të prodhimit dhe të punës së njerëzve, për të qenë përnjëherësh në këmbë në vendin e caktuar të luftës dhe gati për zjarr. Ky organizim luttarak u përgjigjet strategjisë dhe taktikës sonë luftarake dhe përballon me sukses dhe pa humbje të shumta në njerëz strategjinë dhe taktikat e armikut, i cili, me epërsinë e tij në armë dhe veçanërisht në ajër, do të përpiqet të na dëmtojë, të na çorganizoje, të na pengojë, do të përpiqet të hapë fronte të shumta anekënd vendit tonë. Prandaj me këtë organizim dhe përgatitje të rrufeshme ne i përgjigjemi armikut zjarr për zjarr.

Lidhur me këtë problem, dëshiroj të bëj tani disa vërejtje kritike për organizatat e Partisë në terren, për komitetet e Partisë dhe për komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Veçanërisht Partia ka përgjegjësi të madhe për mbarëvajtjen e kësaj çështjeje, prandaj më parë duhen bërë përpjekje që të kuptohet thellë ana politiko-ideologjike e problemit. me qëllim që organizimi të kryhet me sukses dhe edu-

kimi e stërvitja luftarake të japid kështu rezultatet e duhura. A e ka kuptuar mirë këtë problem jetik dhe a e zbaton atë si duhet Partia? Unë mendoj dhe faktet tregojnë se në këtë drejtim ka të meta serioze.

Nuk mund të themi se baza i nënveftëson çështjet e mbrojtjes, se udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rreth nuk i merr ngandonjëherë në studim, ose nuk interesohet deri diku për pjesëmarrjen dhe për përgatitjen e njerëzve, nuk bashkëpunon me forcat dhe me kuadrot e ushtrisë për këto probleme. Shumë rrethe as e ndjekin dhe as interesohen si duhet për stërvitjen ushtarake, Partia nuk di sa mësojnë, si mësojnë dhe sa përfitojnë punonjësit në këto stërvitje. Po përse ngjet një gjë e tillë? Pse ky interesim i pamjaftueshëm? Sepse Partia dhe udhëheqja e saj në bazë nuk e ka kuptuar sa duhet rëndësinë e problemit, ajo nuk e ka kuptuar rëndësinë e tij politike, ideologjike dhe teknike dhe nuk po ndërton si duhet një punë të dendur e sqaruese për këtë çështje të madhe. Çfarë ngjet kur lihet kjo çështje kështu? Stërvitja ushtarake, mbrojtja, me rëndësi kaq jetike për popullin dhe për atdheun, konsiderohen disa herë si një punë angari që na humbet kohën kot, prandaj ka indiferentizëm dhe nënveftësim. Të tillë njerëz, e sidomos intelektualë, s'mungojnë të flasin me termë bombastikë për rëndësinë e mbrojtjes, por me qëndrimin që mbajnë, duke mos shkuar në stërvitjet ushtarake, lënë të kuptohet që atdheun le ta mbrojë dikush tjetër, ose disa të tjerë thonë: «Ne i dimë këto, se kemi qenë në luftë», kurse në fakt ata s'dinë gjë-kafshë dhe Lufta Nacionallirimtare sa i pati prekur.

Ata thonë se «politikisht këto gjëra ne i kuptojmë mirë», por asgjë nuk kuptojnë mirë, kur nuk kuptojnë se atdheu duhet mbrojtur si duhet, ata e konsiderojnë luftën si diçka të lehtë, që mund të kapërcehet me disa fjalë bombastike.

Si mund të kënaqemi ne, kur konstatojmë se në stërvitjet e rezervistëve mungojnë kuadro, nëpunës, administratorë e të tjerë? C'janë këta të përkëdhelur apo njerëz të tillë që mendojnë të marrin rrogat më të mira, ndërsa në stërvitje ushtarake dhe në luftë të venë punëtorët dhe fshatarët? Kjo është një çështje serioze, shoqe dhe shokë, që na bën të dalim me konkluzionin se Partia nuk punon sa duhet dhe si duhet politikisht me këta njerëz.

Organizimi i mirë krijon çdo mundësi për të mos lënë mangut asnjë punë, pastaj të mos harrojmë se në rendin e ditës për ne ekziston edhe çështja e sakrificave. Ne duhet të bëjmë pak sakrifica sot, për të shmangur sakrificat e shumta në kohën e rrezikut, burimi i të cilave është te mungesa e përgatitjes politike, ushtarake etj., që sjell me vete hutimin, panikun, frikën dhe vrasjen më me lehtësi të njerëzve tanë nga ana e armikut. Prandaj të gjitha këto të meta serioze që paraqiten duhet t'i zhdukim sa më parë.

Pa zvogëluar aspak përgjegjësinë e madhe të Partisë në terren për çështjet ushtarake, jo vetëm për sa fola më lart, por edhe për ato detyra po aq të mëdha politike e ideologjike për kuadro dhe ushtarë që rrojnë dhe militojnë në gjirin e popullit dhe që, duke qenë të ngarkuar me detyra speciale të ushtrisë, janë të lidhur ngushtë me ndërtimin e socializmit, me të gjii-

tha problemet që ngre dhe zgjidh ky, edhe organizatat e Partisë në ushtri, komandat e ndryshme të reparteve dhe Ministria e Mbrojtjes Popullore e kanë detyrën e tyre kryesore numër një çështjen e forcimit, të modernizimit, të ngritjes politiko-ushtarake të ushtrisë dhe përgatitjen e plotë të vendit për mbrojtje. Përpunimi i vijës ushtarake, i vijës së mbrojtjes, është veç për e Partisë dhe e Komitetit Qendror. Mbrojtja e atdheut socialist është çështje bazë, prandaj duhet të shfrytëzohet çdo gjë për fuqizimin pa ndërprerje dhe për përsosjen e saj. Kjo mbrojtje duhet të mbështetet kryesisht në forcat e veta dhe mbi këtë bazë është ndërtuar koncepti strategjiko-operativ dhe taktik i forcave tona të armatosura.

Mbrojtja e vendit nuk mund të kuptohet e shkëputur nga ndërtimi i socializmit, ashtu sikundër nuk mund të kuptohet popull dhe ushtri pa një unitet të plotë. Puna politike e Partisë duhet të vihet në plan të parë si kudo edhe në ushtri, pse ajo ndriçon, e bën të kuptueshme, të asimilueshme dhe shumë mirë të zbatueshme në fushat e operacioneve tona punën ushtarake. Në ushtrinë tonë revolucionare të popullit ka centralizëm dhe demokraci proletare, Partia është në komandë. Këto janë disa parime kyç, kryesore, të pashlyeshme, që e kanë bërë dhe e bëjnë ushtrinë tonë një ushtri të popullit, një ushtri të çeliktë.

Organizatave të Partisë në ushtri, të gjitha komandave, Ministrisë së Mbrojtjes dhe të gjithë kuadrove politikë e ushtarakë, jo vetëm u është besuar nga Partia dhe Komiteti Qendror një barrë e shenjtë që duhet ta kryejnë me nder, po duhet njojur, gjithash-

tu, se kjo është një barrë jo e lehtë. Prandaj ata vetë çdo ditë e më shumë duhet të jenë dhe të bëhen plotësisht të ndërgjegjshëm për këtë, duke u përpjekur nga të gjitha anët për t'u ngritur politikisht e profesionalisht, për të zhdukur të metat e mbeturinat e huaja në ndërgjegjen e tyre dhe dobësitë e të metat që vërtetohen në punën e përditshme të reparteve.

Por ushtria duhet ndihmuar njëkohësisht nga sektorët e tjera në të gjitha çështjet që këtyre u përket të japid ndihmën. Është e qartë se Partia dhe push-teti, në zbatimin e përpiktë të detyrave që i caktohen çdo sektori, brenda normave, ligjeve, fondeve e planeve të caktuara, duhet të jenë kurdoherë të rreptë. Në këto çështje asnjë lëshim nuk lejohet, sidomos në drejtim të ushtrisë.

Natyrisht, këtu lypsen një mirëkuptim dhe organizim i fortë, një bashkëpunim dhe kontroll reciprok. Terreni duhet të jetë me të vërtetë në rregull me të gjitha repartet që presin forcat për t'i stërvitur, por edhe vetë repartet duhet të jenë shumë në rregull për të pritur njerëzit në ditën dhe në orën e caktuar për stërvitje. Kjo presupozon që çdo përgatitje të bëhet në kohë, pse kështu mësimet do të fillojnë në rregull dhe njerëzit do të përfitojnë si duhet e do të lirohen në afatin e caktuar. Në këtë drejtim duhet të themi se jo vetëm ka të meta e gabime nga ana e terrenit, por edhe nga komandat e ushtrisë.

Duhet të shkojmë nga parimi se kuadri i ushtrisë e kupton më mirë se kushdo tjetër rëndësinë e stërvitjes, rëndësinë e armës, rëndësinë e taktilës dhe të strategjisë së luftës, ai i njeh më mirë se ushtari

rregulloret, Tezat e Këshillit të Mbrojtjes etj. Prandaj, në qoftë se ai nuk kupton pikërisht se detyra e tij është t'i zotërojë vetë mirë këto, që t'ua futë në kokë edhe të tjerëve, në format dhe në kohën që është caktuar, ai kuadër nuk e bën mirë punën dhe ka të tillë që detyrën e bëjnë shkel e shko. Po nuk i ngritëm në këmbë kuadrot e ushtrisë aktive, po nuk i ngritëm kuadrot e rezervës në një nivel me ata të aktivit, po nuk kaluam në ta vazhdimisht «korrentin elektrik» që quhet puna e gjallë politike, ne nuk do të mund ta stërvitim ushtrinë tonë në gjerësinë dhe në thellësinë e saj. I kemi ne këto mundësi t'i bëjmë? Unë mendoj se asgjë s'na mungon dhe do t'i bëjmë.

Çështja e kuadrit, na mëson Partia, ka rëndësi të madhe. Ne kemi shkolla ushtarake, por edhe vetë ushtria është një shkollë. Atje ne organizojmë edhe kurse, stërvitje ushtarake, prandaj në rast se të gjitha këto i bëjmë si duhet, nuk do të vuajmë asnjëherë nga mungesa e kuadrore për këtë ushtri të madhe. Njerrëzit tanë është e vërtetë që fitojnë eksperiencë të madhe në ushtri, por neve na vihet detyrë të zhdukim pikëpamjen e vjetër borgjeze, sipas së cilës: «Unë e mbarova ushtrinë dhe s'kam më ç'të mësoj». Përkundrazi, shumë mirë që e kreve shërbimin ushtarak, por mos harro se, duke qenë qytetar i mirë, ti duhet të vazhdosh të jesh edhe ushtar i mirë dhe, që të jesh ushtar i mirë, duhet të vazhdosh të mësosh në stërvitjet ushtarake dhe si rezervist, të bëhen kuadër dhe si i tillë të mësosh pastaj të tjerët dhe kështu të veprohet zinxhir, ndryshtë socializmi nuk fiton mbi imperializmin e revizionizmin.

Puna politike e Partisë në ushtri dhe në terren, me ushtarët dhe me kuadrot, ka një rëndësi të dorës së parë, pse vetëm ajo u ngrëndësh që gjithë punën tjetër që bëhet në ushtri, punën ushtarake dhe organizative. Vetëm puna politike e bën ushtrinë instrumentin e armatosur të Partisë së Punës dhe të shtetit revolucionar për të mbrojtur regjimin socialist dhe fitoret e revolucionit tonë. Një punë e tillë synon forcimin dhe kalitjen e ndërgjegjes politike dhe rrënjos thellë në zemër dhe në mendje të ushtarëve dhe të kuadrove pozitat klasore të ushtrisë. Kur këto pozita kuptohen drejt, atëherë ushtria bëhet shumë e dashur për këdo, bëhet diçka shumë e shenjtë, e lidhur ngushtë me jetën e popullit dhe me gjithë zhvillimin e vendit. Një kalitje e tillë e ndërgjegjes bën që ligji e rregulloret e ushtrisë të asimilohen lehtësisht dhe të zbatohen përpikërisht nga ushtarët dhe nga kuadrot.

Tri drejtime kryesore, si me thënë, ndjek Partia: perfeksionimin e plotë të ushtrisë dhe të kuadrove të saj, perfeksionimin dhe përdorimin si duhet të armëve dhe perfeksionimin në maksimum të terrenit për mbrojtje dhe për luftime.

Në perfeksionimin e ushtrisë një rol me rëndësi luajnë kuadrot e saj politiko-ushtarakë. Partia duhet t'u bëjë atyre të qartë jo vetëm me fjalime dhe me leksione këtë rol, por me punë të palodhur. Edhe ata vetë të tregojnë se e meritojnë plotësisht të shërbëjnë në ushtri për kryerjen e kësaj detyre të madhe. Meritat nuk bien nga qiejt, po fitohen me punë, me mësim, me eksperimentim. Në radhë të parë, kuadrot

e ushtrisë duhet të jenë njerëz shumë të dashur, të sinqertë, të hapët dhe të drejtë me ushtarët, ata duhet të jenë të thjeshtë dhe punëtorë të palodhur, të jenë këmbëngulës dhe të rreptë në kërkesë të llogarissë, ndaj vetes së pari, pastaj dhe ndaj ushtarëve, pa rënë në arrogancë ose në anën tjetër, në plogështi, në oportunizëm, në liberalizëm. Këto janë detyra shumë të rëndësishme për Partinë në ushtri. Të mos mendohet për asnje çast se kuadrot e ushtrisë janë të spastruar nga këto mbeturina në karakterin, në metodën dhe në stilin e punës së tyre. Jo. Në qoftë se Partia nuk bën një punë të thellë, te disa kuadro të ushtrisë këto mbeturina mund të trashen. Për ne është krejt e huaj pikëpamja reaksionare borgjeze mbi ushtrinë se shfaqje të tillë, siç janë: arroganca, prepotenca, fodullëku, mbajtja e distancës ndaj ushtarëve etj., duhen pak a shumë që të mos bjerë autoriteti i kuadrit dhe të mund të zbatohen kështu ligjet dhe vendimet.

Pra, para së gjithash, Partia duhet t'i edukojë kuadrot ushtarake të jenë më parë kuadro partie. Po të jenë të tillë, ata do ta kuptojnë si duhet çështjen se lypset të perfeksionohen në të gjitha problemet ushtarake, t'i bluajnë mirë dhe t'i asimilojnë ato. Kurrë ata të mos mendojnë dhe të kënaqen se i kanë gjetur çdo gjëje fundin, po vazhdimisht të mësojnë, të arsyetojnë, të perfeksionojnë, të jenë dialektikë dhe të luftojnë dogmatizmin dhe shabllonizmin. Çdo gjë ata duhet ta vërtetojnë në praktikë me njerëzit, në kompleksitetin e tyre psikologjik, politik dhe kulturore, me diversitetin e terrenit, me ndryshueshmërinë e kohës, me llojet, sasinë, cilësinë dhe fuqinë e ar-

mëve në terrene të ndryshme, në pozicione luftimi të ndryshme etj., etj.

Partia duhet t'ua bëjë të qartë kuadrove të ushtrisë se të gjitha çështjet që përmenda më lart nuk janë probleme në vetvete për ta, por këto duhet të jenë një realitet i gjallë dhe i shkëlqyer tek ata, që të mund t'ua futë në shpirt, në zemër e në kokë për gjithë jetën ushtarëve, popullit që stërvitet për luftë dhe për mbrojtje, që ashtu siç u bëhet zakon njerëzve tanë profesioni i tornos, i shkrirjes së hekurit, i bujqësisë ose profesioni i mësuesit, t'u bëhet njëkohësisht një zakon, një jetë e dytë, një gjë e natyrshme edhe profesioni për të qenë ushtar i përsosur i republikës. Kuadri i ushtrisë, gjatë çdo minute të punës së tij, s'duhet të heqë kurrë nga mendja se pikërisht nga puna e tij shumë e kujdeshme, e mprehtë dhe e vazhdueshme varet nesër fitorja mbi armiqtë eventualë. Kuadri ka një përgjegjësi të madhe sot dhe nesër në luftë, prandaj me punën e tij të zgjuar e plot pasion, me sjelljet e tij, ai duhet të fitojë që tanë, në kohë paqeje, dashurinë dhe respektin e ushtarëve, që këtë ta ketë të siguruar edhe nesër në luftë, kusht ky i rëndësishëm i unitetit e i kompaktësisë së ushtrisë sonë dhe i fitoreve të saj.

Prandaj kuadrot dhe shtabet të jenë sa më larg zyrave dhe sa më afër ushtarëve, të jenë sa më afër dhe pranë kuadrove e shtabeve të njësive të bazës, që janë kolona e ushtrisë sonë. Paradat, prepotenca, burokratizmi të luftohen pa mëshirë nga Partia, pse ato krimbin kuadrot dhe ushtrinë. Të luftohen megalomania dhe fodullëku në çështjet ushtarake, pse këto

të këqija të rrezikshme degjenerojnë e deformojnë jo vetëm kuadrin që është i prekur nga këto vese, por edhe direktivat, fshehin gjendjen dhe realitetin që mund të jetë i hidhur dhe, në kohën e emergjencës u shkakton dëme të rënda atdheut dhe mbrojtjes së tij.

Këshilli i Mbrojtjes i ka dhënë ushtrisë sonë një tog Tezash¹ që janë fryti i eksperiencës së madhe të ushtrisë sonë, duke filluar që nga Lufta Nacionalçlirimtare, nga dita e krijimit të saj, e deri sot. Këto Teza janë baza mbi të cilat stërvitet tash ushtria jonë. Këshilli i Mbrojtjes, i mbështetur në vijën e në mësimet e Partisë, ka urdhëruar që këto Teza ushtria t'i zbatojë në jetë, t'i përpunojë më tej në bazë të eksperiencës së saj të përditishme, të gjallë e në punë e sipër t'i pasurojë dhe t'i plotësojë.

Kuadrot tanë duhet të kuptojnë mirë thelbin e çështjeve ushtarake, si në teori ashtu edhe në praktikë; ata nuk duhet të nënvleftësojnë një çështje dhe të mbivlerësojnë një tjetër. Çdo gjë ka vlerën e saj, rëndësinë dhe vendin e saj. Rëndësia e shkallëzimeve të luftës nuk vihet që këto shkallëzime të nënvleftësojnë njëra-tjetrën, siç bëhet në disa raste në praktikë nga ana e disa komandave të ushtrisë, gjë për të cilën ne i kemi kritikuar.

Edhe neve që kemi bërë Luftën Nacionalçlirimtare nuk na lejohet të mos vazhdojmë të thellohemë në konkluzionet e mëdha të asaj lufte, pale të arrijmë në mendimin joreal «që Luftën Nacionalçlirimtare e kemi bërë, atë e dimë, prandaj s'kemi ç'mësojmë»

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 43, f. 1.

dhe të harrojmë se me dhjetëra mijë të rinj, që, në-sër o pasnesër, në një moment rreziku, do të përbëjnë pjesën dërrmuese të ushtrisë sonë, nuk e kanë bë-rë Luftën Nacionalçirimitare dhe nuk e dinë, në rast se ne nuk ua mësojmë me rrënjen. Nuk mund të shkojnë nga rruga që shkuam ne, të futemi në luftë dhe në luftë të mësohemi, por në luftë të futemi të mësuar.

Kjo është njëra anë e të kuptuarit gabim të kësaj çështjeje. Ana tjetër që të çon në gabim është ajo që, mbasi jemi një shtet dhe kemi një ushtri sulmuese, të pajisur me armë moderne etj., u vëmë rëndësi vetëm operacioneve të mëdha të kësaj. Kjo ka rëndësinë e vet, por neve nuk na lejohet të nënveftësojmë rolin e forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore e të atyre të kufirit dhe të veprimeve të tyre në luftime. Në këto probleme kuadrot tanë ushtarakë duhet të ruhen nga akademizmi dhe skolasticizmi dhe të tregojnë interesin e nevojshëm për stërvitjen e këtyre forcave, që, në luftën e ardhshme, kur armiku do të përpinqet të krijojë fronte të shumta në territorin tonë, ato do të luajnë një rol shumë aktiv dhe aspak pasiv dhe në pritje.

E gjithë ushtria, pa përjashtim, duhet të njohë parimet bazë dhe format e luftës partizane, të cilat nuk duhet vetëm të mësohen nga forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore, por dhe nga forcat e rregullta sulmuese, sepse këto parime të taktikave të luftimeve partizane përbëjnë bazën e strategjisë dhe të taktikës së luftës popullore revolucionare të ushtrisë sonë këtë herë të rregullt, të armatosur si duhet,

me një fjalë moderne dhe që do të zhvillojë një luftë frontale, të gjerë e sulmuese. Ushtria janë aktuale është dhe do të mbetet edhe gjatë luftimeve një ushtri kompakte dhe e aftë në veprime luftarake, taktike dhe strategjike, në kushte të vështira, në të gjitha llojet e luftimit dhe në veprim të ngushtë me të gjitha llojet e armëve, por kurdoherë në kushtet dhe në përpjeksimet e fushave të betejave të territorit tonë.

Po cilat janë disa nga parimet kryesore të luftës sonë partizane? Iniciativa, shpejtësia, befasia, shkathësia, goditja e rrufeshme etj., etj. Këto elemente janë të domosdoshme në çdo kusht luftimi që do të zhvillojmë ne kundër armiqve që do të na sulmojnë. Në luftën partizane ne edhe na mbronin malet. Në luftën moderne, përveç maleve, ne ngremë edhe «male» të tjera atje ku s'ka, për t'u mbrojtur e për të sulmuar. Këto janë fortifikimet që kemi ndërtuar, po ndërtojmë dhe do të vazhdojmë të ndërtojmë, duke u aktivizuar intensivisht në to ushtri dhe popull, deri në fortifikimet e fshatrave. Kjo do të thotë që ne nuk i lejojmë hapësirë tokësore armikut, gjë për të cilën ai ka nevojë. Asgjë nuk duhet lënë pas dore. Pra fortifikimet janë si malet, janë si gërxhet e grykat tona para se armiku të arrijë në male dhe në gërxhe të vërteta natyrale që nuk do ta lejojmë të vijë kurrë. Armikun në luftën partizane ne e dërrmonim në malet dhe gërxhet tona. Të njëjtën punë do të bëjmë ne edhe në luftën frontale, duke përdorur kësaj here edhe fortifikatat e llogoret, të cilat nuk i kishim në atë kohë. Ç'bënim atëherë? Në luftën partizane ne e goditnim armikun atje ku nuk na priste, i as-

gjësonim forcat e gjalla të tij dhe ruanim sa të ishte e mundur forcat tona. Në luftën agresive aktuale armiku do të orvatet të shtypë rezistencën tonë dhe të na detyrojë të kapitulojmë. Ai do të përpinqet të na likuidojë forcat e gjalla, kurse ne nga ana jonë do ta grimmë atë, duke ruajtur forcat tona të gjalla nga armët moderne që disponon ai.

Këto çështje janë të qarta për të gjithë, por unë i ngrita që për çdo gjë të bëhet kujdesi i duhur dhe të ruhen kurdoherë lidhjet e ngushta njëra me tjetër. Kjo është dialektika e gjërave. Mbrojtja e atdheut nga një sulm eventual nga jashtë ka të bëjë me luftën e gjithë popullit, prandaj ne shkojmë nga disa parime kryesore, të cilat i zbatojmë në praktikë, siç janë: mobilizimi, organizimi, edukimi dhe përgatitja e gjithë popullit në një ushtri moderne.

Strategjia dhe taktika e armikut do të jenë të ndryshme nga tonat, prandaj ne duhet t'i njohim edhe ato, të mos lejojmë të na imponojë ai të tijat, por të jemi ne që t'i imponojmë atij taktikën dhe strategjinë tonë. Duke qenë në pamundësi për të zbatuar si duhet as të tijën, se nuk e lëmë ne, dhe as tonën, mbasi nuk mund ta zbatojë dot, pse jona është me baza popullore dhe revolucionare, ai do të pësojë disfata. Që të zbatojë taktikën dhe strategjinë e tij, armikut i duhen hapësira. Për këtë ai do të përpinqet të zërë këmbë dhe t'i përqendrojë forcat e tij për sulm. Ne duhet ta ndalojmë edhe veprimin e parë, edhe veprimin e tij të dytë të sulmit dhe, në rast se nuk do të arrijmë të ndalojmë dot të parin, të veprojmë fuqimisht me shkakthësi për t'i shkatërruar të dytin.

Pra, faza e intervencionit armik, që përbën përanëni tonë fazën mbrojtëse, ka rëndësi, pse e pengojmë atë të vërë këmbë në truallin tonë. Faza e lufitimeve të ashpra për ta penguar armikun të përparojet duhet të përbëjë atë moment të dobësimit të tij në forcat e gjalla dhe në armatime, së cilës nuk mund t'i përcaktohet afati, por që çon në fazën e balancimit të forcave dhe përgatit për ne momentin e kundërmësjes së përgjithshme.

Këtë gjë e them pse nuk duhen lejuar mendime sempliste ose disa herë mburrëse, sikur armikun e kemi në xhep dhe me një goditje mund ta shkatërrojmë. Mendime të tillë nuk janë reale dhe ndikojnë të na dobësohet përgatitja. Duhet të parashikojmë se lufta, po të fillojë, do të jetë e gjatë dhe e rëndë. Të mendosh se ajo do të mbarojë shpejt, pas një ose dy betejave të fituara, do të jetë një gabim i rëndë. Armiku është kurdoherë kryeneç dhe, sidomos kur është epror në njerëz dhe në materiale, ai i hedh këta si pa gjë të keq në furrën e luftës.

Prandaj strategjia jonë nuk mund të përpunojë dhe të përgatitë një mbrojtje që mund të fitojë mbi një armik o grupim armiqsh vetëm me fitimin e një beteje, por do të fitojë pas shumë betejash, duke i shkatërruar armikut sistematikisht forcat e gjalla, mjetet luftarake, deri në dobësimin e tij të madh ushtarak dhe politik, për t'i dhënë më në fund goditjen përfundimtare. Asnjë mendim dhe veprim yni nuk lejohet nga Partia të ketë karakter adventuresk. Çdo mendim dhe çdo veprim ushtarak nga ana jonë duhet të jetë i studiuar, i peshuar, i matur dhe që të jenë

kështu lypset parapërgatitje në çdo gjë, lypset me çdo rrugë e mënyrë të njihen forcat, mjetet, taktikat e armikut, të zbulohen dredhitë e tij, të mos biem pa peshuar mirë në kurthet që do të përpinqet të na ngrejë ai, por të jetë ai që të bjerë në kundërkurthet tona.

Duke e mbyllur fjalën time, dëshiroj shkurt të them se një ushtri e fortë duhet të ketë edhe pravija të forta, nga ana politike dhe ekonomike. Ne jemi duke punuar për planin pesëvjeçar, për të cilin diskutuam në pikën e parë të rendit të ditës, por Partia të punojë edhe në atë drejtim që të ngjallë te çdo punonjës ndjenjën dhe të forcojë mendimin se, duke realizuar e duke tejkaluar planet tona ekonomike, ne luftojmë për forcimin e socializmit dhe të atdheut, ngremë mirëqenien e popullit, por punojmë njëkohësisht edhe për mbrojtjen, e cila kërkon fonde monetare dhe materiale të konsiderueshme, që nuk kanë nga dalin, veçse nga puna dhe nga djersa e popullit dhe nga sakrificat që ai duhet të bëjë. E theksoj këtë çështje pse nganjëherë sikur harrohet. Kur nuk realizohet drithi osë vaji dhe për të furnizuar popullin detyrohemë të tërheqim sasitë përkatëse nga rezerva e paprekshme, s'para u bën përshtypje shumë prej njërrëzve tanë të punës dhe të prodhimit. Kjo vjen nga një mungesë e theksuar e një pune politike për këtë problem. Një çështje e tillë, dhe disa të tjera si këto, nuk duhet t'i lejojmë të na kalojnë lehtë, nuk duhet të ngopemi me një propagandë të fryrë dhe të përciptë që në kohë të shtrënguara dhe të vështira vërtetton kotësinë e saj dhe krijon frikën, panikun dhe pasigurinë.

Ne kemi një ushtri heroike dhe të fortë. Kjo u detyrohet udhëheqjes e kujdesit të vazhdueshëm të Partisë e të Komitetit Qendror të saj. Gjithë Partia e veçanërisht organizatat e Partisë e kuadrot në ushtri duhet të punojnë me mish e me shpirt që ushtria jonë të forcohet më tej, të kalitet, të edukohet, të spastrojë të metat dhe gabimet nga puna e saj dhe të bëhet e denjë për misionin e madh që i ka ngarkuar Partia. Ushtria jonë është e përgatitur dhe ne vazhdimisht do ta përgatitim dhe do ta kalitim në rrugën e Partisë. Asnjë epërsi e armikut nuk na tremb, pse armikun o armiqtë e vendit tonë që do të guxojnë të na sulmojnë atdheun, ne do t'i thyejmë, pse na udhëheq Partia dhe marksizëm-leninizmi, pse Parti dhe ushtri janë një. Ne do t'i thyejmë armiqtë me zotësinë e armëve tona, me heroizmin, zgjuarsinë, manovrimin, disiplinën e forcave tona të armatosura, do t'i thyejmë ata, se luftojmë në vendin tonë dhe përvendin tonë që e duam aq shumë dhe e njohim me pëllëmbë, do t'i thyejmë se luftojmë për një çështje të drejtë.

*Botuar në librin:
Enver Hoxha, «Për Ushtri-
në Popullore», vell. I, f. 555*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

DASHURIA PER POPULLIN DHE ATDHEUN TE BEN TE RI

Nga biseda me shkrimtarin Viktor Eftimi

2 korrik 1971

Shoku Enver Hoxha e priti shkrimtarin rumun me origjinë shqiptare në selinë e Komitetit Qendror të Partisë dhe zhvilloi me të një bisedë të ngrohtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se na erdhët. Jemi shumë të gjuar që erdhët në vendin tonë, që është edhe vendi juaj i lindjes. Populli ynë ka dashur që ju të vinit edhe më përpara në Shqipëri, në vendlindjen tuaj, të cilën nuk e keni harruar.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Edhe dëshira ime ka qenë që të viaj më përpara. Megjithatë vazhdimisht kam ndjekur me admirim përparimet e vendit, patriotizmin e popullit shqiptar, rininë e mrekullueshme, të thjeshtë, të vullnetshme e krenare, njerëzit tuaj të zotë me një disiplinë të fortë, që nuk marrin parasysh asnjë vështirësi dhe që vënë mbi të gjitha interesat e popullit. E gjithë kjo situatë e krijuar në Shqipërinë e

re është arritur në sajë të udhëheqjes Suaj të mrekullueshme e të lavdishme.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju jeni i njohur nga të gjithë njerëzit tanë jo vetëm si njeri me vlerë e kulturë të madhe, që keni dhënë një kontribut të madh edhe për popullin rumun, por edhe sepse nuk e harruat kurrë vendin tuaj. Sigurisht ju keni dashur dhe keni pasur mall për Shqipërinë, keni pasur besim se kjo do të fitonte pavarësinë, për të ndërtuar pastaj një jetë më të mirë për popullin. Këtë ju e keni ndier dhe e keni shkruar.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Ju jeni sot një nga njerëzit e mëdhenj të Evropës. Jam shumë i lumtur që erdha t'Ju shoh Ju dhe vendin tim që e kam dashur gjithmonë dhe më vjen keq që nuk kam mundur të vij këtu shumë kohë përpara.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë vetë kam jetuar në Korçë, ku kam mbaruar edhe studimet e mesme, prandaj e njoh mirë Boboshticën, vendlindjen tuaj. Kur ishim të rinj, të shtunave shkonim në Dardhë, në Boboshticë, në Dvoran e fshatra të tjera pranë qytetit. Shkoja nganjëherë me disa shokë te një fshatar në Boboshticë dhe qëndronim shtrirë në bar bashkë me të. Ai kishte dy mana, me të cilët kënaqesha kur ishin mbushur plot me kokrra. «Pse nuk hani mana», na thoshte ai, megjithëse ishte shumë i varfër dhe ndoshta jetonte me prodhimin e rakisë që nxirrte nga këta dy mana. Ai kishte dëshirë të na jepte dhe të na kënaqte, gjë që provonte se zemrën e kishte shumë të mirë.

Kur të shkoni nga Korça në Boboshticë, do të shihni se atje ka shumë mana. Për popullin e Boboshticës do të jetë një ngjarje me rëndësi të presë në gjirin e vet shkrimitarit e madh.

E mjeruar ishte para Çlirimt gjendja te ne. Por kjo gjendje e varfër e klasës punëtore, e fshatarësisë dhe e gjithë popullit tonë kaloi përgjithmonë, se populli luftoi vetë dhe fitoi. Edhe ju keni luftuar për popullin, prandaj armiqtë e tij ju kanë bërë të vuani, por ju, me ndihmën e popullit, keni triumfuar gjithmonë. Këtë populli, me Partinë tonë të Punës në krye, nuk e harrojnë kurrë.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Duhet ta duam dhe të punojmë që ta çojmë popullin gjithnjë përpara, se ai ka dhënë gjithçka për ne.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne u themi shokëve të rrojmë të gjithë gju më gju me popullin, ta dëgjojmë dhe ta kuptojmë atë, t'ia kuptojmë dhe t'i zbatojmë gjithmonë dëshirat e tij. Partia na mëson të mos e harrojmë kurrë këtë. Lidhjet me popullin na e dhanë neve fitoren dhe, i udhëhequr drejt nga Partia, populli ynë patriot fitoi besim në vettete dhe ushqeu besim të pakufishëm te Partia. Gjatë kohës së luftës ne nuk e preknim pasurinë e popullit, prandaj vetë masat e popullit bukën që kishin, qoftë edhe një kafshatë, e ndanin me ne, me komunistët dhe partizanët.

Pas Çlirimt patëm vështirësi të mëdha, por në një kohë shumë të shkurtër i kapërcyem ato, pse populli, ashtu siç u mobilizua në luftën për çlirim, iu përvesh edhe punës ndërtimitare me një entuziazëm të madh, të papërshkrueshëm. Kjo, forca e popullit,

ishte diçka e mrekullueshme. Në fillim ne nuk kishim shumë gjëra, na mungonin edhe sendet më të domosdoshme, nuk kishim as kuadro, inxhinierë, specialistë e të tjerë dhe i bënë pyetjen vetes: «Si t'ia bëjmë që të ndërtojmë vendin, rrugët, shkollat, ndërtesat etj?». Atëherë i bëmë thirrje rinasë dhe në më pak se dy vjet rindërtuan çdo gjë që qe shkatërruar gjatë luftës. Njëkohësisht iu vumë mësimit. Partia dha direktivën që kush dinte të shkruante, të shkonte të organizonte punën e mësimit në popull, t'i mësonte atij gjithçka që dinte përvete. «Merrni pllakën e zezë dhe shkonit në popull ta mësoni», ishte thirrja që u bëri Partia të gjithë atyre që dinin shkrime e këndim. Dhe tash kemi arritur një përparim të përgjithshëm, ngritëm Universitetin tonë dhe një numër shkollash të tjera të larta; krijuam një brez të mirë shkrimitarësh dhe artistësh popullorë.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Të gjitha të shkëlqyeshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumica e këtyre nuk janë profesionistë, ata janë më tepër kuadro me talent, të dhënë pas krijimtarisë, që akoma e kanë jetën përpara, që frymëzohen dhe si shembull të madh kanë popullin.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Ju keni folur shumë mirë dhe keni shumë të drejtë përkëtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne tash jemi në pragun e shtrimit të direktivave të planit të pestë pesëvjeçar, i cili i hap popullit tonë perspektiva edhe më të mëdha. Gjatë këtij pesëvjeçari do ta zhvillojmë më tej industrinë, do të ndërtojmë hidrocentrale të tjera,

fabrika e kombinate të reja, rrugë e hekurudha të tjera do të përshkojnë Shqipërinë, do të shtohen më shumë prodhimet bujqësore. Në fillim punuam për të tharë kënetat në zonat fushore, tanë u jemi qepur më shumë kodrave e maleve për t'i bërë ato pjellore si dhe fushat.

Qysh në fillim ne u nisëm nga synimi fisnik që populli ynë të mos vuante më për kafshatën e gojës. Ju ndoshta nuk keni vuajtur ndonjëherë ekonomikisht, por ne e dimë se babai juaj ka qenë i varfër, prandaj e kuptioni lehtë ç'do të thotë të luftosh për të zhdukur varfërinë.

Populli rumun ka ushqyer gjithnjë ndjenja miqësore për popullin shqiptar. Gjatë periudhës së Rilindjes shqiptare, patriotët tanë që kanë punuar në atë kohë në Rumani, kanë gjetur lehtësi për të zhvilluar veprimtarinë e tyre patriotike me botime etj., që të zhvillohej kultura e popullit dhe, nëpërmjet saj, të mba-heshin lart ndjenjat kombëtare. Ëndrra e rilindësve në këtë drejtim është bërë sot realitet te ne. Partia ka bërë që të zhvillohen në masë kultura dhe arsimi jo vetëm në qytet, por edhe në fshat dhe jo vetëm në zonat e pasura fushore, por edhe në majë të maleve.

Partia punon që jo vetëm këta 2 milionë ose 2,5 milionë njerëz, sa do të bëhemë në mbarim të këtij pesëvjeçari, por edhe kur të arrijmë të jemi 5 milionë dhe më shumë, të gjithë të punojnë dhe të jenë në gjendje të jetojnë mirë. Te ne gjithçka bëhet për lumturinë e popullit, për të sigruar drejtësinë dhe demokracinë në vend, pse drejtësia dhe demokracia

janë çështje të popullit, të cilat nuk lejojmë që t'i shkelë kush.

Partia jonë punon shumë me rininë, i bën asaj të ditur fatet e të parëve dhe baballarëve, se brezi i ri sheh vetëm atë që sot njerëzit në vendin tonë rrojnë të lumtur dhe nuk ka njobur as vuajtjet dhe as luf-tën e shkuar. Nga ana tjetër, ne e mësojmë rininë të mos harrojë se imperializmi synon ta prishë lumturinë e popullit, lirinë tonë, prandaj barutin duhet ta mba-jë, siç bën tërë populli, kurdoherë të thatë. Populli shqiptar nuk ka frikë të luftojë dhe këtë e ka treguar gjatë shekujve.

Unë të konsideroj vëlla, se në fakt vëllezër të një gjaku jemi, shoku Viktor, prandaj të flas hapur. Ne u themi të rinxje e të rejave të punojnë, të studiojnë, të mësojnë dhe të sakrifikojnë për popullin, që ai të jetojë i lumtur. Këto ua theksojmë atyre se ka edhe që mendojnë se, me të mbaruar studimet, u bënë të ditur, «dijetarë». Partia u tërheq vëmendjen, i këshillon të mos mendojnë kështu. Njeriu duhet të mësojë tërë jetën dhe prapë duhet ta ketë të qartë se nuk ka më të ditur se populli, nuk ka më të urtë dhe më të mençur se ai, se gjithçka që është realizuar, ka dalë nga puna e nga eksperienca e madhe shekulllore e popullit.

Ne kemi akoma shumë për të bërë që të plotësojmë nevojat e popullit, të cilat janë të mëdha; kemi akoma shumë për të ndërtuar, prandaj na vihet detyrë që të punojmë gjithnjë pa u lodhur.

Ju keni qenë shumë i vogël kur jeni larguar nga atdheu, i cili që nga ajo kohë ka bërë ndryshime të mëdha. Ndryshime të mëdha, pra, ka e sotmja me të

djeshmen në vendin tonë. Me sytë tuaj keni parë shumë vende në botë, po jemi të sigurt se Shqipërinë e shikoni me zemër. Te ne ka edhe të meta e gjëra që s'janë bërë akoma, por zemra juaj e ndien se ato boshllëqe që na ka lënë e kaluara, do të ndreqen dhe koha për këtë nuk do të jetë e largët.

Marsel Kasheni bëri një vizitë në Shqipëri 3-4 vjet para se të vdiste. E kam takuar dhe kam folur personalisht me të. Ishte njeri i mirë, një nga mbrojtësit më të vendosur të marksizëm-leninizmit në Francë. Kur u kthye në vendin e vet ai u thoshte franezëve: «Në qoftë se do të shkoni sot në Shqipëri, mos u tallni me rrugët e saj. Kini parasysh se edhe Parisi që është kaq i bukur, nuk u ndërtua në disa vjet, po janë dashur shekuj për ndërtimin e tij. Ndërsa Shqipërisë i jepni 10-15 vjet kohë dhe atëherë gratë mund të venë të shëtitin në bulevardet e saj me këpucë me takë».

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Sikurse u theksova të pranishmëve, dje, në mbledhjen që ishte organizuar për mua, sakrificat e secilit, sakrificat e njerëzve të thjeshtë e intelektualë për madhështinë e këtij vendi do të krijojnë kushte që ky popull i vogël të bëhet një komb i madh.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë e lexova fjalimin tuaj të djeshëm. Ai ishte një fjalim i mrekullueshëm, i thurur me fjalë e ndjenja të dala nga mendja e një njeriu të zhvilluar e të kulturuar, e një njeriu që u flet masave me dashurinë e popullit, që u flet artistëve dhe shkrimitarëve me zemër, me ndjenja të thella vëllazërore. Prandaj shkrimitarët dhe artistët tanë kanë

shumë respekt për ju, për talentin tuaj, që do të mbetet i pavdekshëm, sepse në veprat që keni krijuar, ju shprehni ide të qarta popullore, që prekin zemrat e njerëzve të thjeshtë dhe ai që bën të prekin zemrën e njeriut të popullit, nuk vdes kurrë. Ka edhe të tjerë që shkruajnë, por masat i hedhin në shportë veprat e tyre, kurse njerëz si ti ka pak.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Këtë unë e ndiej singjerisht në fjalët Tuaja.

SHOKU ENVER HOXHA: Shqiptarët nuk dinë të bëjnë komplimente sa për sy e faqe, atë që kanë për të thënë e shprehin haptazi, pa drujtje dhe qartë, si ujët që del në burimin pranë shkëmbit. Ne që kemi vuajtur shumë, themi kurdoherë të vërtetën.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Tani që Ju pashë dhe po Ju dëgjoj vetë, e kuptoj edhe ca më mirë përse i gjithë populli shqiptar Ju ndjek pas, përse Ju do kaq shumë. Me këtë Ju keni arritur një fitore të jashtë-zakonshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne na u bë shumë qejfi që erdhët dhe dëshirojmë që të qëndroni në Shqipëri sa më shumë, sepse duam t'ju kemi në gjirin tonë të ngrohtë për një kohë sa më të gjatë. Por këtë e lëmë në dorën tuaj të vendosni.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Kam qenë një herë në Bashkimin Sovjetik në kohën e Stalinit dhe jam takuar me të. Ai ka qenë njeri i madh. I thashë atëherë Stalinit se më duhej një kohë e gjatë për të vizituar atdheun e tyre të madh dhe ai m'u përgjigj me buzëqeshje të këndshme: «Kush ju ndalon? Shikojeni, shikojeni!».

SHOKU ENVER HOXHA: Sidoqoftë, ju do të jettoni gjatë. Ne duam të rroni sa malet tonë, që të vini edhe herë të tjera në Shqipëri, ku do të gjeni gjithmonë mikpritjen më të ngrohtë vëllazërore, si biri i këtij populli. Prandaj dëshirojmë të jeni i fortë, që shëndeti juaj të jetë gjithmonë i mirë.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Që kur kam ardhur në Shqipëri, e ndiej sikur po më vijnë forca të reja, sikur po ripërtërihem.

SHOKU ENVER HOXHA: Populli shqiptar dhe populli rumun kanë nevojë për njerëz kaq të mirë si ju. Dashuria për popullin dhe atdheun të bën të ri, të rinon, sepse populli është gjithmonë i ri. S'ka dyshim që mbi organizmin, me kalimin e kohës, duam s'duam ne, veprojnë ligjet e natyrës, por, duke i njojur këto ligje, ne do të bëjmë që të jetojmë sa më shumë. Një profesor, i quajtur Rostand¹, ka shkruar mjaft për gjëra të tillë. Ai i këshillon njerëzit të kenë kurajë, të mos lëshohen kur kalojnë vitet.

Prandaj kur të shkoni në rrëthin e Korçës, në Drenovë e në Boboshticë, do të shikoni se si do të bëheni, fizikisht, edhe 30 vjet më i ri. Kur isha student, siç ju thashë, shkoja shpesh me shokët nga Drenova e Boboshtica dhe e këndonim përherë «Një ditë shkova nga Drenova, pashë një vajzë të re...». Ishim të rinj dhe na pëlqente mjaft kjo këngë. Atëherë ekzistonte edhe një kor që, midis të tjerave, këndonte këngë të tillë. Ky kor bile është edhe sot, por tash i thonë «kori i pleqve». Shumë nga ata që rrojnë akoma, por

1. Zhan Rostand (1894-1977), biolog francez.

që dikur ishin të rinj, si, për shembull, Ilo Moskoja e të tjerë, aty këndoijnë këngët e vjetra të Drenovës e të Boboshticës.

Mos harroni, shoku Misto¹, tani që do të shkoni në Korçë me shokun Viktor, të organizoni një koncert për ndër të mjeshtrit, me këngë të këtij kori, me këngë nga folklori i fshatit të tij të lindjes dhe atëherë të shohë miku i nderuar se si do të bëhet vërtet më i ri. Mistoja është vetë nga Korça, kurse unë jam nga Gjirokastra dhe na vjen mirë kur dëgjojmë të flitet për qytetet tona.

Kam qenë edhe unë 2-3 herë në Rumania, kur jetonte Dezhi. Për herë të parë atje shkova ilegalisht, por në aerodrom më priti Dezhi, i cili më mori në veturën e vet. Kur u ula në makinë, diçka e fortë më vroua prapa. Kur vë dorën, kujtohem se ishte pistoleta «Mauzer» që mbaja. Atëherë ishin kohë shumë të vështira, prandaj arma duhej mbajtur me vete. Dezhi më tha të shkonim te një miku i tij jashtë Bukureshtit për të biseduar. Ky qe një fshatar komunist, që kishte një shtëpi të bukur fshati dhe nënën shumë mikpritëse. Pikërisht në këtë shtëpi diskutuam me Dezhin. Atë fshat dhe muzeun e tij, që ishte shumë interesant, ne i vizituam mirë. Muzeu, sidomos, ishte atje objekti i vetëm dhe përmbante mjaft gjëra karakteristike të fshatit. Aty kishin të eksposuara shtëpi të ndryshme të fshatit, objekte etnografike etj. Populli

1. Misto Treska, në atë kohë kryetar i Komitetit për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme, i pranishëm në takim.

rumun është i kulturuar. Pastaj prej andej shkuam në Komitetin Qendror. Kur hapëm portën për të hyrë në dhomën ku ndodhej Kishinjevski, pamë se e gjithë dhoma ishte mbushur plot me bankënota, pse, siç na thanë ata, vetëm atje i kishin të sigurta. Pas diskutimeve shkuam në ish-pallatin mbretëror, një ndërtesë e vogël e bukur me harqe. Edhe atje bëmë një mbledhje, pastaj vajtëm për të fjetur. Më kujtohet që në një nga dhomat ndodhej mbi tavolinë një libër i madh, që ishte albumi mbretëror.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Do të dëshiroja të bëja një përkthim nga veprat e letërsisë shqipe. Romani «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», i shkrimtarit Ismail Kadare, më duket, është një vepër letrare burrërore shumë e lartë, nga më të mirat e letërsisë së sotme botërore.

SHOKU ENVER HOXHA: Duke i çmuar në këtë mënyrë shkrimtarët tanë, vlerësimi juaj është një inkurajim i madh për ta.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Ka shkrimtarë të tjerrë të këtij rangu?

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht, ka edhe të tjerë të këtij rangu, po ndaj letërsisë sonë shtypi borgjez ka organizuar komplotin e heshtjes. Me botimin e këtij romani të Ismail Kadaresë, është hapur një dritare në botë. Megjithatë në letërsinë tonë ka edhe vepra të tjera letrare, po aq të mira sa edhe «Gjenerali i ushtrisë së vdekur».

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Po marr atëherë edhe një pjesë teatrale shqiptare ta përkthej, pastaj do të bisedoj për ta vënë në skenë në teatrin rumun.

SHOKU ENVER HOXHA: Ka një interesim të madh jo vetëm brenda, po kudo edhe jashtë për letërsinë tonë. Tani, kudo në botë, njerëzit interesohen më shumë për të dhe konstatojmë më në fund se shkrimtarët tanë po çajnë.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Do të jem i lumtur që do të jetoj këto ditë me popullin e vendlindjes dhe do të shikoj se si ka ndryshuar Boboshtica që nga koha e rinasë sime.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe Korça ka ndryshuar shumë, janë ndërtuar rrugë të tëra të reja me shtëpi banimi e dyqane, vepra të rëndësishme industriale, si Fabrika e Trikotazhit, Uzina e Instrumenteve dhe shumë fabrika të tjera. Bujqësia sidomos është zhvilluar mjaft në krahasim me të kaluarën. Korça është një nga rajonet më të zhvilluara të bujqësisë në Shqipëri. Në kooperativat bujqësore të këtij rrethi tani fillon korrja. Siç do ta shikosh vetë, brigje të tëra që deri dje ishin djerrë, sot janë pyllëzuar me pemë frutore. Në Korçë ka shumë mollë, por ka edhe vreshta. Bile tani atje kanë mësuar ta prodhojnë verën si duhet. Një shkrimtar francez i quajtur Monmuso, një shok shumë i mirë, vizitoi njëherë Shqipërinë dhe, me gjithëse në moshë të kaluar, shkoi edhe në Korçë në kohën e vjetër së rrushit. Ai kujtoi me këtë rast stinën e vjetër së rrushit në Shampanjën e tij. Në Korçë Monmusoi këndoi e kërceu si ndonjë i ri dhe mbeti shumë i kënaqur. Kur u takuam, biseduam për shumë gjëra dhe, për gjithçka pa në vendin tonë, më fliste me shumë entuziazëm, por për verën tonë na bëri vërejtje. Më vonë prodhimi i verës është

përmirësuar shumë, prandaj verën e eksportit tonë e kërkojnë shumë në mjaft vende të botës se, është e pastër. Atë na e kërkojnë deri anglezët e francezët, po edhe të tjerë, se është e mirë. Ata që ia kanë vënë synë ndonjërs prej llojeve të verërave tona dhe e kanë zgjedhur, nuk e braktisin më, sepse ne nuk bëjmë hile, sikurse bëjnë jashtë në industrinë e pijeve.

Prodhuesve dhe punonjësve tanë të tregtisë u kemi vënë detyrë që të jenë kurdoherë të ndershëm, sepse në tregti ne nuk nisemi vetëm nga nevoja që të shesim produktet tona, por të ruajmë edhe zërin e mirë të Shqipërisë në drejtim të ndershshmërisë dhe të pastërtisë. Duke vepruar kështu, ka shumë raste që tregtarë të ndryshëm i lakmojnë prodhimet e vendit tonë, se kanë krijuar besim që prodhimet tona të eksportit janë pa hile. Kësisoj vendi ynë do të bëhet edhe më i njobur. Ne kemi vuajtur shumë nga të huajt në këto drejtime, prandaj s'lejojmë t'u bëjmë dëm të tjerëve me produktet tona. Ne luftojmë për ndershshmëri në të gjitha drejtimet.

SHOKU VIKTOR EFTIMIU: Ju keni bërë shumë sakrifica për të arritur të gjitha këto suksese dhe në të gjitha fushat e jetës.

Jam shumë i lumtur që erdha në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë që Ju takova dhe Ju pashë me sy. Unë pashë në Shqipëri forcën e popullit dhe dashurinë e madhe që ka ai, dhe sidomos rinia, për Ju, sepse Ju bëni gjithë këto sakrifica jo për lavdinë Tuaj personale, por për lumturinë e atdheut dhe për të mirën e popullit. Prandaj e shikoj me besim të ardhmen e lumtur dhe madhështinë e këtij vendi.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falënderoj për fjalët e ngrohta e të përzemërta, të cilat nuk do t'i harrojmë kurrë. Ato janë një inkurajim i madh për ne. Ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj. Jetë të gjatë dhe rrugë të mbarë!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

STRATEGJIA E PARTISE SONË KA QENË DHE MBETET PËR LUFTË SI KUNDER IMPERIALIZMIT ASHTU EDHE KUNDER REVIZIONIZMIT MODERN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

2 gusht 1971

Ju e lexuat informacionin që Çu En Lai i ka dhënë ambasadorit tonë në Pekin, shokut Xhorxhi Robo. Sot ne duhet të vendosim për përgjigjen që do t'i jepim Partisë Komuniste të Kinës, nëse jemi dakord apo jo me këtë kurs që po ndërmerr ajo.

Ne, disa shokë të Byrosë Politike, kemi përgatitur një projektleterpërgjigje për Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, në të cilën shprehen mendimet tona kolektive, por mendoj se kjo letër ka akoma nevojë për një ripunim të mëtejshëm, me që-

1. Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua lidhur me informacionin që i dërgoi PK e Kinës Partisë së Punës të Shqipërisë, nëpërmjet të cilit e vinte në dijeni për vizitën që do të bënte presidenti i SHBA-së, Nixon, në Kinë.

Ililm që të dalë një dokument me të vërtetë historik, sepse ky është me vlerë të madhe për sot dhe për të ardhmen. Në letër duhet vënë mirë në dukje çështja e luftës në të dy frontet, kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit, e cila ka qenë, është dhe mbetet guri i provës për Partinë tonë dhe për çdo parti të vërtetë marksiste-leniniste. Këtë t'ua theksojmë mirë, pa lëkundje. Këtu nuk duhet të shkelim asnjë parim.

Duke e parë problemin në këtë prizëm, mendoj se kjo mbledhje e Byrosë Politike është nga më të rëndësishmet për historinë e Partisë sonë, për arsyen se kemi të bëjmë, për të mos thënë me një konflikt, por me hedhjen hapur në tryezë të kontradiktave ideologjike midis nesh dhe kinezëve. Ju do të shprehni mendimin tuaj, por unë desha të theksoj se çështja nuk është aq e thjeshtë, siç na e paraqesin ata në informacionin që na kanë dërguar, sikur gjoja kemi të bëjmë thjesht me një shkallëzim të bisedimeve kino-amerikane nga rangu i diplomatëve në Varshavë, në nivelin më të lartë. Kurse vajtja e Niksonit në Kinë ka të bëjë me kursin strategjik të kinezëve. Kjo është ajo strategjia «e madhe» e tyre. Unë mendoj që edhe në formë, informacioni që na është dërguar, është përgatitur posaçërisht për ne, shqiptarët.

Strategjia e Partisë sonë ka qenë dhe mbetet përluftë në të dy frontet, si kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, ashtu edhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye. Brenda kësaj strategjie janë përcaktuar edhe lufta, edhe taktikat që duhen ndjekur. Këta janë binarët kryesorë të kësaj strategjie marksiste-leniniste, e cila përkrah çirimin e popujve,

rritjen e valës së revolucionit botëror, ndihmën e luftrave nacionalçlirimtare etj.

S'ka asnje diskutim se këtë strategji Partia jonë e ka ndjekur me konsekuencë. Deri dje, me disa variante të vogla, me disa hezitime, me disa lëkundje e tërheqje të brendshme, që i dimë të gjithë, mund të themi se atë e ka ndjekur deri diku edhe Partia Komuniste e Kinës. Por po shohim se udhëheqja e saj ka filluar të ndryshojë, ka filluar të largohet nga kjo strategji. Ky ndryshim, mendoj unë, nuk duhet kuptuar sikur do të bëhet menjëherë, brenda ditës, brenda vitiit ose përdy vjet. Me afate këtë ndryshim nuk kemi si e parashikojmë, por faktet tregojnë se shokët kinezë do të lidhin marrëveshje, do të puqen, do të bëhen aleatë me amerikanët. Kursi që po marrin ata synon në ndjekjen e politikës së përmirësimit të marrëdhënieve me imperializmin amerikan dhe, pasi t'ia arrijnë kësaj, atëherë Kina do të hyjë në xhiron e tri fuqive të mëdha, megjithëse Çu En Lai, në informacionin që na ka dërguar, përpinqet të na bindë ne, amerikanët dhe gjithë botën se ekonomikisht dhe ushtarakisht Kina është fuqi e dobët. Udhëheqja kineze hyri në këtë rrugë, prandaj kemi të bëjmë me një ndryshim të politikës së saj, që do të ketë në të ardhmen evolucionin e vet. Këtë duhet ta kemi parasysh, që asnje situatë të mos na gjejë të papërgatitur.

Çfarë i shtyn shokët kinezë ta braktisin strategjinë e luftës në të dy frontet, të veprojnë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin? Natyrisht, i shtyn ideologjia e tyre, por ç'ideologji? Ne duhet të rikujtojmë se, në takimet që kemi pasur me shokët kinezë,

vazhdimesht kemi konstatuar tek ata lëkundje, bile të thella. Kjo do të thotë se politika e tyre nuk ka qenë konsekuente marksiste-leniniste. Edhe në qëndrimet që mbajnë kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, nuk kanë pikëpamje të drejta marksiste-leniniste. Ne e kemi bërë vazhdimesht analizën e qëndrimeve «taktike» të udhëheqjes kineze në luftën kundër revizionizmit modern dhe veçanërisht kundër revolucionistëve sovjetikë dhe nga këto analiza na ka dalë se lufta e tyre kundër revizionizmit ka ekzistuar vetëm në formë, se në thelb ata janë udhëhequr nga pikëpamje shoviniste dhe nacionaliste. Të tilla pikëpamje, të tilla shfaqje dhë qëndrime jo të drejta të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës, në mjaft raste, ne i kemi konstatuar edhe më parë, por më të qarta na kanë dalë qysh kur u shpall lufta e hapët kundër revolucionistëve. Ndaj tyre Partia jonë ka pasur kundërshtimet e veta dhe ka bërë vërejtjet përkatëse. Natyrisht, ato ne i kemi bërë të myllura, prandaj kanë mbetur brendaperbrenda të dyja palëve, udhëheqjes së Partisë sonë dhe udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës. Tek udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës kemi vënë re shpesh zigzage në qëndrimet që ka mbajtur, përkëto kemi bërë vërejtje shoqërore në rrugë partie, por udhëheqja e sotme e saj ia ka hedhur fajin për to grupit të Liu Shao Çisë. Më vonë u konstatua se ato nuk ishin vetëm te ky grup, por edhe te Çu En Lai. Pas rënies së Hrushovit, nga udhëheqja kineze u bënë tentativa për të biseduar me udhëheqësit e rinj që erdhën në fuqi në Bashkimin Sovjetik, por ato dështuan. Pra, ne mund të themi se qëndrimet e udhëheqjes ki-

neze ndaj revizionistëve sovjetikë nuk ishin dhe nuk janë të bazuara në parime marksiste-leniniste, ashtu sikundër janë të bazuara qëndrimet e Partisë sonë ndaj revizionistëve sovjetikë.

Që në kohën kur ne dolëm hapur kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, dhe deri më sot, ne ishim miq dhe shokë të ngushtë të kinezëve. Ky është fakt. Kurse tani duhet të mendojmë se nuk mund të jemi më të tillë. Këtë na e dikton realiteti, për arsyen se ndryshoi boshti i politikës së tyre. Atëherë ishim miq, sepse të dyja palët u gjendëm përballë revizionistëve sovjetikë dhe revizionistëve të tjera, kundër të cilëve ne, nga ana jonë, kemi qëndruar dhe do të qëndrojmë në baza parimore gjer në shpartallimin e plotë të tyre.

Ne do të qëndrojmë si kurdoherë në po ato pozita që kemi, si kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, ashtu edhe kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, pavarësisht se udhëheqësit kinezë u lëkundën. Tendenca e re e kësaj strategjie të udhëheqësve kinezë është se aktualisht armiku kryesor, sipas tyre, janë revizionistët sovjetikë dhe jo imperialistët amerikanë. Këtë mund ta nxjerrim nga informacioni i Çu En Lait, që në fakt është i udhëheqjes së PK të Kinës, mbasi nuk është vetëm Çu En Lai në këto pozita.

Udhëheqja kineze na e nxjerr imperializmin amerikan të dobësuar, sikur është në buzë të varrit, ndërsa popullin amerikan në pozita aq të forta revolucionare, sikur të ishte në prag të revolucionit. Për socialimperialistët sovjetikë në informacion as që flitet fare, he-

shtet. Përse bëhet kjo? Bëhet për të mos zbuluar strategjinë dhe taktikën që ata po ndjekin, megjithëse kjo kuptohet. Po përse ngjet kështu? Ngjet për arsyen të pikëpamjeve të paqarta që ekzistojnë te shokët kinezë. Ata nuk janë në gjendje të vlerësojnë drejt as imperializmin dhe as socialimperializmin, nuk janë në gjendje të çmojnë drejt forcat tona nga pikëpamja marksiste-leniniste, të mbështeten në to dhe të kenë besim te populli, te partia, te marksizëm-leninizmi dhe te revolucioni.

Unë mendoj që shokët kinezë kanë arritur në atë konkluzion që kanë arritur edhe amerikanët dhe arsyen do ta them, natyrisht, si e mendoj unë. Sipas tyre, «tani kanë ardhur momente që ne (domethënë kinezët), si fuqi botërore, që kemi kaluar nga etapat e vështira, duhet të bëjmë politikën e balancimit, prandaj na duhet t'i zgjedhim miqtë, aleatët e përkohshëm dhe aleatët besnikë», por këtë ata nuk e kuptojnë në rrugën marksiste-leniniste. Kjo ka arsyen e vet. Duke mos qenë në pozita të shëndosha, ata mendojnë se revisionistët sovjetikë paraqesin rrezikshmërinë kryesore për kinezët dhe; pas gjithë atyre demonstracioneve që revisionistët e Moskës bënë në kufirin sovjeto-kinez, mendojnë se përgatiten ta sulmojnë Kinën. Sigurisht, demonstracionet në kufi nga ana e revisionistëve sovjetikë janë bërë apostafat, me një qëllim të caktuar, por që të themi se revisionistët sovjetikë donin ta sulmonin Kinën, nuk mundemi, se nuk dimë gjë. Sidqoqoftë, forcat ata i grumbulluan në kufi, por kjo ishte si konsekuençë e asaj gjendjeje të turbullt që ekzistonte në Kinë gjatë periudhës së Revolucionit

Kulturor. Atëherë në Kinë kishte çoroditje, gjendja ishte e turbullt, partia dhe pushteti nuk funksiononin. Revisionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë mendonin se fati i Kinës nuk qe vendosur. Sovjetikët kishin shpresë që situata të fitohej nga revisionistët kinezë në favor të tyre, por këtë «në favor të tyre» të mos e kuptojmë ala zhivkovçë, domethënë duke hequr një udhëheqje për të vënë një udhëheqje tjetër me në krye Liu Shao Çinë e Ten Hsiao Pinin, por njerez të tjerë më të moderuar. Pra, revisionistët sovjetikë kishin shpresa te revisionistët kinezë dhe për këtë arsy i afruan forcat në kufi. Afrimi i forcave mund të ishte kështu si njëfarë presioni dhe jo sulmi ndaj Kinës.

Amerikanëve, natyrisht, u interesonte që të lindte një konflikt midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, se në këtë mënyrë do të dobësoheshin të dy këto shtete, gjë që do të sillte si pasojë që të ndryshonte në favor të tyre edhe gjendja e luftës në Vietnam, ku ata ishin ndërlikuar, dhe kjo luftë, që i ka diskredituar, të merrte një drejtim tjetër për ta. Në këtë kohë amerikanëve u është krijuar një situatë e re në Azi; Japonia, një fuqi tjetër e madhe, me tendenca të forta ekspansioniste, doli në skenë. Amerikanëve u leverdis t'i nxjerrin gështenjat nga zjarri me duart e të tjerëve, prandaj po e mëkëmbin këtë vend që e mbajnë akoma të pushtuar.

Kur Bashkimi Sovjetik sulmoi dhe pushtoi Çeko-sllovakinë, amerikanët nuk bënë shumë zhurmë. Pavarësisht se nuk kemi informacione të shumta, me sa kuptojmë dhe nga zhvillimi i të gjitha ngjarjeve, mund të nxjerrim disa konkluzione nga qëndrimi që mbaj-

tën ata në ngjarjet e Çekoslovakisë. Është fakt se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk u ndien jo vetëm se Çekoslovakia, sipas ndarjes që kishin bërë këto dy superfuqi, ishte në zonën sovjetike të influencës, por edhe se shikonin edhe njëfarë prirjeje për keqësim të marrëdhënieve, shikonin zhvillimin e një armiqësie të theksuar midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Kjo u intereson shumë imperialistëve amerikanë, se e dimë që midis këtyre dhe revizionistëve sovjetikë ekzistojnë kontradikta, të cilat vazhdimisht shtohen, për arsyen të rivalitetit për dominim, për ekspansion, por edhe për arsyen se revolucioni në botë po ngrihet dhe po zgjerohet, se popujt kërkojnë të çlrohen nga sundimi imperialist.

Ne gjithashtu dimë se ka kontradikta si brenda sistemit imperialist, ashtu edhe midis vendeve revisioniste dhe secila nga palët përpinqet t'i shfrytëzojë këto në dëm të tjetrës.

Gjatë kësaj kohe kinezët, me luftën e tyre, si dhe në sajë të luftës së të gjithë popujve, të marksistë-le-ninistëve, të luftës sonë, me aq sa ka qenë e mundur për mbrojtjen e Kinës, i kaluan vështirësitë e brendshme dhe Kina erdhi duke u forcuar, kurse pozitat e imperializmit amerikan, si në Indokinë, ashtu dhe në të gjithë sektorët e tjerë, janë dobësuar.

Në këto kushte është duke u luajtur loja e aleancave të mëdha. Kush ka dalë më përpara me kërkesën për aleancë? Unë mendoj se kanë dalë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kinezët i kanë pranuar. Ofertat kryesore të amerikanëve janë që të gjithë aleatët e tyre të njojin Kinën dhe këta aleatë kanë filluar ta

njohin, duke propaganduar se këtë gjoja e bëjnë për arsyet të kontradiktave që kanë me amerikanët. Mirëpo të gjitha këto shtete borgjeze, që po lidhin marrëdhënie diplomatike me Republikën Popullore të Kinës, këtë e kanë armike dhe në të vërtetë nuk e duan, por kursi i ri që po ndjekin ka për qëllim të përgatitë afrimin me Kinën. Oferta kryesore e tyre është njohja e Republikës Popullore të Kinës. Këtë ofertë, pra, ata ia bëjnë Kinës për arsyet të konsolidimit të pozitave të saj. Në këtë situatë, kinezët pranuan që Niksoni të vejë në Kinë. Po përse imperialistët nuk i bënë më parë këta hapa? Përse nuk e njihnin Kinën? Përpara vizitës së Niksonit në Kinë, atje do të venë shumë amerikanë të tjerë, kuptohet, gjersa do të vejë presidenti. Gjatë kësaj kohe do të ketë zigzage nga ana e kinezëve, por puna është të kuptojmë esencën e kësaj çështjeje.

Mendoj se kinezët nuk do ta presin Niksonin fare pa kushte, ashtu sikurse duan ta paraqesin në informacionin që na kanë dërguar, pse, sipas tyre, gjoja është njëlloj, se si të kenë rezultate në bisedimet që do të bëjnë me Niksonin, ashtu edhe po të mos kenë, ato prapë në favorin e tyre do të jenë. Ky arsyetim nuk është i drejtë. Ne do të tregoheshim naivë në qoftë se do ta kuptionim kështu.

Është e mundur të ngrihet Niksoni dhe të vejë të ulë kokën në Pekin? Pavarësisht se i ka pozitat të dobëta, nuk mund të mendohet që ai të kthehet nga Kina duarbosh. Kjo nuk mund të ngjasë. Po kinezët si mund ta pranojnë këtë? Opinion botëror do të pyesë: Kina që e thirri Niksonin në Pekin për të biseduar,

që e priti me popull dhe me ceremoni, çfarë bëri gjatë bisedimeve që nuk patën asnjë rezultat? Ky do të jetë një diskreditim i madh për Kinën, do të jetë e kundërta e asaj që thotë Çu En Lai.

E vërteta është se afrimi nuk do të bëhet menjëherë, por do të ecet në atë rrugë, sa të tërhiqen trupat amerikane nga Vietnami. Kjo do të bëhet me kompromis. Amerikanët do të tërhiqen mbasi të marrin pjesë në bisedime edhe kinezët, por kjo situatë do një kohë që të përgatitet. Republika Popullore e Kinës do të njihet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ajo do të pranohet në OKB, në bisedimet që do të bëjnë të dyja palët do të arrihet njohja e Tajvanit si pjesë përbërëse e Kinës, do të fillojnë bisedime midis përfaqësuesve të Republikës Popullore të Kinës dhe atyre të Çan Kai Shisë dhe ato do të vazhdojnë me vite, duke u argumentuar para opinionit botëror si çështje të brendshme. Pas një kohe të gjatë këto gjëra do të zgjidhen dhe pastaj do të vijnë të na thonë neve, shqiptarëve: «Ajo që bëtë ju nuk është e drejtë, ju nuk na keni kuptuar, prandaj nuk jemi dakord me letrën që na dërguat. Ne jemi marksistë-leninistë, jemi kundër imperializmit amerikan dhe revizionistëve, megjithatë shikoni, me bisedime arritëm këto rezultate që ju nuk i parashikuat, kurse ne i patëm parashikuar dhe janë në interes të kësaj strategji. Amerikanët na njohën dhe na pranuan në OKB, hoqën trupat nga Vietnami dhe nga Tajvani etj., prandaj jeni ju të gabuar, pse veç këtyre, gjatë kësaj kohe, ne kemi lëshuar bombat e dynjasë, me mijëra artikuj kundër amerikanëve. Prandaj, pa bërë lëshime, ne do të fitojmë shumë nga

kjo rrugë». Këtë lë Çu En Lai të kuptohet në informacionin që na dërgoi. Ai gjësim, ajo eufori, ai besim që ka Çuja se amerikanët do të tërheqin trupat nga Indokina, nga Tajvani dhe se amerikanët nuk do t'i lënë japonezët të futen në Tajvan dhe në Kore, është një iluzion. Këtë pretendim të tyre ne duhet ta parashikojmë dhe letrën ta formulojmë në mënyrë të tillë që ata të mos na thonë dot gjë nesër, por t'u themi ne se këta hapa ata i kanë bërë jo me fitime, por me humbje.

Shokët kinezë, në bisedimet që kanë bërë me amerikanët, duhet të kenë trajtuar edhe çështje të tjera, të cilat neve nuk na i kanë thënë. Kisingeri u pati kërkuar atyre t'i tregonin një tunel. Pastaj i pyeti, përse u duhen tunelet dhe kinezët iu përgjigjën se u duhen për t'u mbrojtur nga imperialistët dhe social-imperialistët. Kisingeri ndërhyri menjëherë dhe u tha se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta sulmojnë asnjëherë Kinën, prandaj ajo divizionet e saj mund t'i përdorë gjatkë, atje ku duhet. Atasheu ushtarak kinez, në një nga vendet revisioniste, i mbështetur në këtë «garanci», ka deklaruar se, meqenëse SHBA nuk kanë ndërmend të sulmojnë Kinën, kjo rrethanë e favorshme na jep mundësi të tërheqim divizionet nga pjesa lindore dhe t'i çojmë për mbrojtje në kufirin me Bashkimin Sovjetik. Kinezët shpresojnë se kjo aleancë do ta çlirojë Kinën nga rreziku që mund t'i vijë nga Lindja, se amerikanët do t'u krijojnë mundësi t'u mbetet dorë e lirë për të çuar forcat e tyre ushtarake në Veriperëndim, në kufi me Bashkimin Sovjetik, sepse «atje mbetet rreziku kryesor» për

ta. Amerikanët mendojnë që kur të kenë forcuar mirë pozitat me kinezët, dhe si të jetë shtuar armiqësia e kinezëve ndaj sovjetikëve, atëherë i jepin satisfaksion Bashkimit Sovjetik për të çuar forcat në kufi me Kinën, me qëllim që të lindë një konflikt i armatosur kino-sovjetik, të dobësojnë këto dy fuqi rivale, kurse vetë vazhdojnë të mbajnë kontakte me ta, të forcojnë pozitat e tyre në botë, të nxjerrin, si kurdoherë, gështhenjat nga zjarri me duart e të tjerëve. Këto janë komplate banditësh.

Po si do të arrihet kjo? Natyrisht, jo menjëherë, por me etapa. Edhe Hrushovi në fillim, kur erdhi në fuqi, për të bindur opinionin botëror se është në pozita «të drejta marksiste-leniniste», lëshoi «bomba» sa të duash kundër imperializmit dhe Titos, por këto ishin vetëm maska, fasada, pse në thelb ai qëndronte në pozita revizioniste dhe e shpuri Bashkimin Sovjetik atje ku e dimë. Në qoftë se ky kurs që po merr udhëheqja kineze nuk shpartallohet brenda nga Partia Komuniste e Kinës, ky do të shfryjë sa do të shfryjë kështu dhe më në fund do të dalë me variantin e tij.

Në këto kushte na bie detyra të jemi vigjilentë, se rruga që po marrin shokët kinezë atje të çon, prandaj, siç e thashë më parë, gjer tani ne ishim miq të ngushtë të tyre, por aktualisht del se miq të ngushtë të tyre janë rumunët dhe Titoja. Këtë ata nuk e thonë hapur, por e demonstrojnë. Me kohë ne do të shikojmë se nga do të anojnë me qëndrimin e tyre.

Përse shokët kinezë, ashtu si dhe rumunët, janë pro «sigurimit evropian», që është një objektiv i sovjeticëve? Për arsy se një gjë e tillë do të forcojë lidh-

jet Moskë-Bon, që kinezëve u intereson, sepse dobëson gjer në njëfarë mase influencën edhe të vetë imperialistëve amerikanë. Kinezot janë të interesuar që të mos forcohet imperializmi amerikan.

Nga sa mund të gjykojmë ne dhe nga sa shikojmë në informacionin që na kanë dërguar, kinezët heshtin për çështjet që kanë të bëjnë me udhëheqjen sovjetike. Ata ngrenë problemin e militaristëve japonezë, të cilët i paraqesin ashtu si bënte Hrushovi në kohën e tij për revanshistët e Bonit. Por sovjetikët u puthën me amerikanët dhe arritën deri atje sa për situatën e rëndë që u kriua në Çekosllovaki para okupimit nga trupat sovjetike dhe të Traktatit të Varshavës, të thonë se ishte dora e Bonit. Kurse në këtë situatë kinezët ngrenë rrezikun japonez, që është karta e amerikanëve në Azi, ashtu siç është Boni në Evropë. Rrezikun e një aleance të Japonisë me Bashkimin Sovjetik e parashikojnë kinezët, prandaj mendojnë se një afrim nga ana e tyre me amerikanët e neutralizon Japoninë. Tendencën për neutralizimin e Japonisë ne e shohim edhe në informacionin që na kanë dërguar dhe përkëtë theksojnë edhe mbështetjen e Kim Ir Senit, me gjithëse ai, siç duket, nuk i mbështet plotësisht. Kim Ir Seni e kundërshton aleancën e Japonisë me Bashkimin Sovjetik, duke u nisur nga pozita centriste, revisioniste, po ai në të njëjtën kohë nuk do që Kina të hidhet kundër Bashkimit Sovjetik.

Vietnamezët gjithashtu janë kundër, për arsyen se kjo tendencë, ky kurs i kinezëve, gjykohet prej tyre se është proamerikan dhe kundër Bashkimit Sovjetik. Vietnamesezët kanë interesat e tyre kryesorë: të mba-

rojë lufta; të ikin amerikanët; bisedimet të bëhen, por nuk duan që në to të marrin pjesë kinezët.

Pak a shumë kështu mund t'i gjykojmë ne këto çështje, ndoshta edhe mund të gabojmë, por i gjykojmë në bazë të atyre që thuhen e nuk thuhen në letrën e udhëheqjes kineze, si dhe me sa shikojmë vetë në zhvillimin e situatës ndërkontrolluese. Qofshim të gabuar dhe kursi i kinezëve të jetë i drejtë marksist-leninist, por, që të vejë Niksoni në Pekin dhe të bisedojë në këtë situatë me shokët kinezë, nuk mund të mendojmë në asnjë mënyrë që të jetë i drejtë. Prandaj, sipas mendimit tim, ne nuk mund të bashkohemi kurrsesi me këtë kurs.

Për ne është e qartë se vajtja e Niksonit në Pekin është rruga e fillimit të miqësisë së kinezëve me imperializmin amerikan. Për këtë ne duhet të mbajmë qëndrim, mendimi ynë të jetë i qartë, t'u japim përgjigje, e cila natyrisht të jetë e matur, pa i prerë urët. Këta hapa që bëjnë kinezët do të kenë procesin e tyre, ashtu siç e thotë vetë Çu En Lai. Ne do të bëjmë shkallëzim marksist-leninist në këtë proces, sepse edhe ata do të bëjnë shkallëzim nga ana e tyre. Ne nuk duhet të lëmë asnjë moment që të komprometohemi dhe të kuptohet sikur edhe ne shqiptarët jemi me kinezët në këtë çështje. Ne duhet të mbajmë qëndrim, me qëllim që opinioni botëror të shikojë se Shqipëria dhe Partia e saj e Punës dallohen për qëndrimin e tyre parimore revolucionar ndaj këtyre problemeve dhe se ato, si kurdoherë, nuk bëjnë lëshime në parimet.

Do të vijë koha që do të jemi edhe në konflikt me kinezët, në qoftë se ata nuk kthehen nga kursi që

kanë filluar. Nuk jemi ne që kemi ndryshuar kursin, por janë ata. Deri tani ne u kemi vënë në dukje se ata disa herë kanë pasur lëkundje në qëndrimet e tyre. Po të gjykojnë se na kanë konsideruar miq vetëm për faktin se jemi kundër revizionizmit sovjetik, e kanë gabim. Ne jemi kundër revizionistëve sovjetikë për çështje të thella parimore. Kur ne u thamë kinezëve përsë bisedojnë me Kosiginin, se ai është një nga krerët e revizionizmit, ata nuk kundërshtuan, ose kur u thamë pse vajtën në Moskë, as atëherë nuk kundërshtuan, por për ne është e qartë arsyeh që nuk shkuan më tej. Ata edhe për rastin e tanishëm nuk mund të na thonë që pse flitni kundër vizitës së Niksonit. Për kundërshtimet që do të kenë me ne mbi kursin që po marrin, ata do të mbajnë qëndrim, dhe këtë ne duhet ta kuptojmë.

Për këtë çështje që kinezët e konsiderojnë, siç e thonë edhe në informacion, një strategji të madhe, pse nuk morën ata mundimin për të dërguar një delegacion të posaçëm që të bisedonin me miqtë dhe me aleatët e tyre, shokët shqiptarë, që u kanë qëndruar afër në situatat më të vështira, gjë që e ka vënë në dukje vetë Mao Ce Duni, sipas të cilët shqiptarët dhe Partia e Punës e Shqipërisë i kanë mbrojtur në situatat më të vështira? Ata nuk vepruan si marksistë-leninistë, prandaj themi se qëndrimi i tyre nuk është i drejtë. Vallë si marksistë-leninistë nuk kemi ne të drejtë të themi pikëpamjen tonë, megjithëse jemi një shtet dhe një parti e vogël? Ne mund të jemi të vegjël dhe Kinës mund t'i dukemi si miza përpara elefantit, por përpara marksizëm-leninizmit jemi njëloj.

Atëherë përse nuk vijnë të bisedojnë me ne për këto probleme kaq të mëdha, por ujdisen me rumunët, me Jahja Kanin, me amerikanët? Atëherë nuk kemi të drejtë ne si udhëheqje e Partisë së Punës të Shqipërisë, si marksistë-leninistë, të reflektojmë dhe të arrijmë në disa konkluzione, të marrim vendime dhe t'u jepim përgjigje shoqërore dhe parimore shokëve kinezë?

Si konkluzion, duke u nisur edhe nga diskutimet e të gjithë shokëve, mund të themi se edhe për këtë çështje me rëndësi kaq të madhe që po shqyrtojmë sot, ne, ashtu si edhe për të gjitha çështjet e tjera që ka marrë në shqyrtim Partia jonë, del se kemi unitet të plotë dhe të çeliktë. Kjo është një fitore e madhe e Partisë sonë marksiste-leniniste, që e ka burimin te pjekuria e udhëheqjes së saj dhe që thellohet për të gjitha problemet në mësimet e marksizëm-leninizmit. Ajo i zbaton me konsekuencë parimet dhe të gjitha vendimet, qofshin ato strategjike apo taktike, që përbëjnë vijën e Partisë sonë dhe aktivitetin e gjithanëshëm të saj për ndërtimin e socializmit. Kjo bëhet pa marrë parasysh asnjë sakrificë. Këtu qëndron pjekuria e Partisë sonë, trimëria e saj, që e gjen forcën e vet dhe e ka burimin te marksizëm-leninizmi dhe te karakteri i popullit tonë. Pavarësisht sa të mëdha janë vështirësitë, sa kanë qenë dhe sa mund të jenë ato që mund të na dalin në të ardhmen, ne kurdoherë i kemi kapërcyer të gjitha dhe kështu duhet t'i kapërcejmë edhe këtej e tutje. Prandaj nga kjo anë ne nuk kemi pasur kurrë frikë dhe as nuk kemi. Ne do ta themi fjalën tonë, siç e kemi thënë kurdoherë për të

gjitha çështjet. I vjen dikujt hidhur apo thartë, ptkë-pamjen e vet Partia jonë e thotë hapur. Kush të dojë ta pranojë, kush të mos dojë, të mos e pranojë. Ne dëshirojmë që shokët kinezë të reflektojnë dhe thellë bile. Në qoftë se thonë se nuk na kuptuat, mos mendojnë vallë se ne vërtet nuk i kemi kuptuar? Atëherë përse nuk kanë marrë mundimin të vijnë këtu? Mos presin vallë të vemi ne? Gjersa janë ata që po e bëjnë kthesën për të keq përse të vemi ne tek ata? Kjo nuk është çështje formale, por parimore. Në qoftë se nuk vijnë, atëherë marrin përgjigjen dhe në qoftë se këtë ia lënë kohës, kësaj nuk ia lëmë ne.

Në do të përpinqemi edhe në të ardhmen dhe do të luftojmë që ata ta kuptojnë gabimin që bënë, të cilin ne e quajmë të rëndë, fatal, prandaj mbajmë qëndrimin më konsekuent, më të hapët dhe është detyra jonë që ta bëjmë këtë. Pavarësisht se jemi të vegjël në numër, ne jemi marksistë-leninistë, prandaj në parimet nuk lëshojmë, sepse në bazë të këtyre parimeve marksiste-leniniste luftuam, me këto çliruam Shqipërinë dhe sot luftojmë për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Pa këto parime nuk mund të kishte Shqipëri, nuk mund të kishte liri dhe socializëm e çdo gjë tjeter të mirë për popullin tonë. Këto janë armët e fuqishme politike dhe ideologjike me të cilat kemi luttuar kundër një, dy, tre dhe kundër të gjithë armiqve e, po të jetë nevoja, edhe vetëm do të luftojmë, pa shokë, sepse nuk kemi ç'të bëjmë kur ata që na hiqen shokë nuk na duan. Ata që janë miq, le të urdhërojnë të diskutojmë, ata që nuk duan të diskutojnë me ne, le të kenë vijën e tyre, kokën e tyre, por

dhe ne kemi kokën tonë. Ata mund të thonë se veprojnë në bazë të marksizëm-leninizmit, por ja që ne e interpretojmë ndryshe nga kinezët. Ata mund të bëjnë diplomaci, që e quajnë popullore, dhe e zhvillojnë atë fshehurazi, kurse ne bëjmë një diplomaci të hapët parimore me të gjithë dhe jemi të bindur se kjo që bëjmë është e drejtë.

Me këtë mbledhje të Byrosë Politike ne vëmë edhe një shtyllë tjetër të çeliktë, të drejtë në rrugën e Partisë sonë, që lufton për ndërtimin e socializmit, që lufton kundër imperializmit, kundër revizionizmit të të gjitha formave dhe nuancave qofshin këto në mëmë, në bijë ose në degë të tjera.

Pasi diskutuan shokët e Byrosë Politike, të cilët miratuan njëzëri përbajtjen e letrës, në mbyllje të mbledhjes, shoku Enver Hoxha tha:

Drejt, siç u vendos këtu, letrën ta qëndsim të bazuar në argumente, duke përfshirë të gjitha mendimet që shprehën shokët. Kinezët, kur ta lexojnë, të dinë se ne e kuptojmë që ata kanë ndërruar kursin dhe strategjinë, prandaj ua themi të gjitha hapur dhe të bazuara, ua themi se ne me atë kurs nuk bashkohemi. Me një fjalë të kuptojnë se ne nuk e pranojmë vajtjen e Niksonit në Kinë.

Tani vihet pyetja: Do të zemërohen apo nuk do të zemërohen shokët kinezë? Edhe sikur t'ua themi butë ata prapë do të zemërohen, prandaj t'ua themi drejt, kjo është detyra jonë. Në rrethana të tjera, që mund të krijohen, ka shpresë që të ketë një rishikim të vijës nga ana e tyre, disa udhëheqës atje mund të thonë, dale të reflektojmë.

Për sa u përket Partisë sonë dhe shokëve të Komitetit Qendror, kuadrove, në përgjithësi, t'ua shpje gjomë çështjen, me qëllim që Partia të marrë dijeni për qëndrimin e udhëheqjes së saj ndaj këtij problemi me rëndësi të madhe historike. Të mos e kuptojnë njerëzit vajtjen e Niksonit si një takтикë, si atë që mund të thotë atasheu ushtarak ose ai i kulturës pranë ambasadës kineze në Tiranë se ç'humbasim nga kjo gjë! Në qoftë se ai nuk e kupton ose paraqitet sikur nuk e kupton këtë, ne i themi të mos na i shesë neve, se nuk i shkojnë.

Ne do t'ia themi Partisë këto çështje që kanë të bëjnë me Kinën dhe ajo e kupton përse nuk flasim hapur. Një gjë e tillë bëhet për interes të çështjes. Në Kinë ka njerëz që kanë një dashuri të madhe për Shqipërinë, për arsy se në situatat e vështira vetëm Shqipëria e ka mbrojtur Kinën. Këtë të mos e harrojmë. Në ato kushte udhëheqja kineze ka qenë në pozita të tillë që ishte e detyruar ta propagandonte Partinë e Punës të Shqipërisë në masë, si mbrojtëse e vetme e popullit kinez. Megjithatë edhe ngurosjet, edhe ekstremet e tyre duhet t'i mendojmë. Prandaj, sipas etapave, të punojmë për forcimin e unitetit, duke e shpjeguar vijën tonë hap pas hapi.

Krahas me këtë çështje kaq të rëndësishme neve do të na duhet të përballojmë situatat me realizimet e planeve, me sakrifica. Shumë gjëra presim të na vijnë nga Kina, mirëpo me njerëz si Çu En Lai në krye të qeverisë kineze, të kemi parasysh se mund të na sillen edhe pengesa dhe të mos na vijnë. Ne kemi eksperiencë në këtë drejtim, prandaj këto ngjarje nuk du-

het të na gjejnë të çarmatosur, por t'i përpunojmë me kujdes planet tona ideologjike dhe ekonomike. Në planin e ri pesëvjeçar që do të aprovojë Kongresi¹ të kemi parasysh variantin më të vështirë. T'i ruajmë parimet dhe taktikën, me qëllim që udhëheqësit kinezë ta shikojnë çështjen një çikë më thellë, në mos që të kthehen, të paktën me shpresë që të mos kenë mundësi të marrin masa kundër nesh. Prandaj them që të paktën të fitojmë sa më shumë në këto drejtime me punën dhe me taktikën tonë.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha, «Kun-
dërt revizionizmit modern
(Përbledhje veprash)
1971-1975», f. 62*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Kundërt revi-
zionizmit modern (Përbled-
hje veprash) 1971-1975», f. 62*

1. Është fjala për Kongresin e 6-të të PPSH që i zhvilloi punimet më 1-7 nëntor 1971 në Tiranë.

ME MIQTË NUK MBAJMË REZERVA, ÇËSHTJET I SHTROJMË HAPUR

*Nga biseda me një delegacion ushtarak
të RP të Kinës*

20 gusht 1971

*Pas shkëmbimit të përshëndetjeve, e mori fjalën
shoku Enver Hoxha:*

Ardhja e delegacionit tuaj është një ngjarje e rëndësishme jo vetëm për Ushtrinë tonë Popullore, por për gjithë Partinë dhe popullin shqiptar, sepse do të shërbejë për forcimin e miqësisë që ekziston midis dy partive, dy popujve dhe dy vendeve tona. Kontaktet e ngushta dhe të vazhdueshme midis shokëve të të dyja palëve, qofshin këta përfaqësues të partisë, të ushtrisë, qofshin për çështje ekonomike, apo për çdo problem tjetër, kanë rëndësi të madhe si për politikën tonë të brendshme, ashtu edhe për marrëdhëniet tona me botën e jashtme.

Ne shqiptarët i duam Kinën dhe popullin vëlla kinez, prandaj përpinqemi me të gjitha forcat që, me aq sa kemi mundësi, ta ndihmojmë Republikën Popullore të Kinës...

Ashtu siç thatë edhe ju, sukseset e arritura, si dhe sukseset e tjera akoma më të mëdha që do të arrihen në të ardhmen, në qoftë se nuk kuptohen drejt nga partia, nga ushtria dhe nga masat, krijojnë mundësinë e lindjes në to të mendjemadhësisë dhe të shovinizmit të shtetit të madh. Këto shfaqje jo vetëm çojnë në vepër prime të gabuara, por edhe pengojnë ecjen përpëra, kurse Republika Popullore e Kinës duhet akoma më shumë të forcohet, të konsolidohet dhe të ekzistojë përgjithmonë që të ndihmojë për triumfin e revolucionit të madh botëror, i cili do të sjellë shkatërrimin e imperializmit dhe të revizionizmit modern. Prandaj doktrina marksiste-leniniste na mëson që ne, marksistë-leninistët, të jemi njerëz të thjeshtë, jo mendjemë-dhenj, të luftojmë çdo shfaqje shoviniste që mund të lindë idenë e shtetit të madh. E them këtë se rreziqë të tilla nuk ka vetëm te ju që jeni një shtet i madh por edhe te shtete të vogla. Eksperienca ka treguar se atje ku ekzistojnë paqartësi ideologjike, lindin si mendjemadhësia, ashtu edhe shfaqje të tjera që çojnë patjetër në vepër prime të gabuara, në kundërshtim me marksizëm-leninizmin.

Marksizëm-leninizmi na mëson se shtetet socialiste duhet të forcohen vazhdimisht, të bëhen të fuqishme, të jenë të pamposhtura nga armiqtë dhe kurdoherë revolucionare të vendosura e parimore për interesin e revolucionit botëror dhe çështjen e madhe të socializmit e të komunizmit, që të luftojnë gjer në fund për të dërrmuar imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik dhe gjithë reaksionarët në botë. Këtë detyrë të madhe historike vendet tona nuk mund ta kryejnë

dot si duhet pa shtuar fuqinë e tyre, në radhë të parë, pa qenë të qarta nga ana ideologjike, pa forcuar politikën e drejtë marksiste-leniniste, pa forcuar pa ndërprerje zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së vendit përkatës, pa rritur aftësinë luftarake për mbrojtjen e atdheut. Të gjitha këto së bashku, në unitet të pandarë, përbëjnë forcën tonë të madhe e të pathyeshme, e cila na shton besimin e madh në fitore dhe na bën të jemi të pamposhtur ndaj armiqve të tërbuar.

Ne duhet të punojmë, të luftojmë dhe të fitojmë mbi imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik. Nuk është mungesë modestie të themi se në këtë drejtim neve na bie barra të bëjmë një luftë të vendosur deri në fitore, prandaj, pa ecur në rrugën e drejtë, sipas mësimave të marksizëm-leninizmit, dhe pa u pastruar nga shfaqjet e huaja, deri tek ato që mund të duken më të thjeshtat, nuk mund të arrijmë qëllimin e përbashkët, për të cilin duhet të luftojmë krah për krah.

Të gjithë e dimë se vendet tona kanë armiq, dhe bille armiq të mëdhenj, siç janë, në radhë të parë, dy superfuqitë, SHBA dhe BS, si dhe lakenjtë e tyre, të cilët as nuk duhet t'i mbivlerësojmë, por as edhe t'i nënveftësojmë. Këta armiq të betuar të socializmit e të komunizmit, të Kinës dhe të Shqipërisë, ne duhet t'i përballojmë dhe t'i mundim jo vetëm politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht, por, po ta kërkojë nevoja, edhe ushtarakisht. Por që t'i mundim armiqtë duhet të kemi edhe një ushtri të fortë, të pathyeshme, të edukuar drejt politikisht, me një organizim të përsosur dhe të armatosur sa më mirë. Me fjalën ushtri ne

nuk kuptojmë vetëm ushtrinë e irregullt aktive, ashtu si e kuptojnë imperialistët dhe revizionistët. Ushtria jonë përbëhet nga i gjithë populli i armatosur, që është i gatshëm në çdo çast për mbrojtjen e atdheut. Dhe kur një popull është i armatosur, i vendosur dhe gati për luftë, nuk ka asnjë fuqi që ta mposhtë, sado e madhe që të jetë ajo.

Nga ana tjetër, ne dimë, gjithashtu, se ushtria, në rast agresioni, nuk mund të veprojë në kushte nga më të vështirat, që mund të krijohen, me aq shkakhtësi e rreptësi dhe në çdo moment ndaj armikut, në qoftë se vendi nuk do të ketë një ekonomi të shëndoshë, industri dhe bujqësi të përparuar.

Tani imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, për të realizuar qëllimet e tyre, përpiken, duke thurur gjithfarë kombinimesh diplomatike, të krijojnë përshtypjen sikur ekziston njëfarë paqeje në botë. Mirëpo partitë marksiste-leniniste nuk gënjen nga një situatë e tillë.

Partia jonë mendon se situata e krijuar fsheh në vetvete një gjendje të sëmurë e të kalbur të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik, të cilët mundohen të krijojnë iluzione për paqe, për të shpëtuar nga tronditja e thellë që po pësojnë sistemi i kalbur shoqëror kapitalist dhe revolucionizmi modern. Situata në botë është duke u zhvilluar kundër dëshirës së tyre. Kjo situatë është shkaktuar nga forcat kolosale, që janë frymëzuar e po ngrihen gjithnjë e më shumë nga dita në ditë në revolucion dhe luftojnë për çlirimini kombëtar e shoqëror të popujve të botës. Ata që luftojnë në krye të këtyre forcave, për t'ia arritur

këtij qëllimi të lartë, janë jo marksistë-leninistë me fjalë dhe demagogji, por marksistë-leninistë të vërtetë me vepra, me punë, me luftë.

Popujt kanë sy, janë në gjendje të gjykojnë e të dallojnë cilët janë miqtë që i ndihmojnë me vepra për çlirimin kombëtar dhe shoqëror, për fitoren e revolucionit në botë, dhe cilët janë armiqjtë e tyre. Ata frymëzohen nga partitë marksiste-leniniste, të cilat janë në gjendje t'i vlerësojnë drejt situatat që janë krijuar sot në botë. Prandaj imperialistët amerikanë dhe rezisionistët sovjetikë nuk do t'i gënjejnë dot kurrë ata me manovrat e tyre, të çfarëdo forme qofshin këto.

Kurdoherë Shqipëria e vogël socialiste ka zhvilluar një politikë të drejtë ndërkontaktare marksiste-leniniste. Edhe në situatat e reja të krijuara ajo vazhdon të ndjekë një politikë të tillë, duke u përpjekur të shfrytëzojë edhe kontradiktat në radhët e armiqve, sepse dihet që ekzistojnë kontradikta të thella midis të gjithë armiqve tanë të përbashkët si kudo, edhe këtu në Evropë.

Ne shqiptarët, si popull i një vendi të vogël që jemi, të udhëhequr nga një parti që ka vuajtur shumë, çdo hap që bëjmë, e peshojmë mirë, e matim me kujdes. Me këtë dua të tregoj prudencën e madhe në rrugën ku ecim. Ne kemi parasysh që armiqjtë e vendit tonë përpinqen të krijojnë situata të tilla, me qëllim që Shqipëria të kalojë nga ana e tyre, por kjo nuk do të ndodhë kurrë.

Shqipëria, me Partinë e Punës në krye, nuk shkel në dërrasë të kalbur. Ne përpinqemi të bëjmë një analizë sa të jetë e mundur më reale të gjendjes dhe të kontradiktave që ekzistojnë midis shteteve kapitaliste

dhe vendeve revizioniste. Gjendja në Evropë është e turbullt, këtu zhvillohet një konkurrencë e madhe si nga ana e imperializmit amerikan, ashtu dhe nga ana e revizionizmit sovjetik. Të dyja superfuqitë janë në krizë, por që të dyja bëjnë çmos për të mos vepruar kundër njëra-tjetrës, për t'iu shmangur goditjeve reciproke, sepse kërkojnë të ruajnë aleancën dhe zonat e tyre të influencës dhe të arrijnë në një statukuo në Evropë, me qëllim që t'i vërsulen pastaj Republikës Popullore të Kinës. Për këtë arsyе të dyja palët përpinqen të mbajnë të shtypur popujt e Evropës, duke krijuar përshtypjen e rreme sikur këtu gjoja s'ekzistojnë kontradikta të rrepta.

Për ne, shqiptarët, të gjitha ngjarjet që zhvillohen në botë, dhe ca më tepër ato që ndodhin në afërsi të vendit tonë, kanë rëndësi të madhe, prandaj situatat që krijohen, përpinqemi t'i analizojmë, sigurisht, brenda mundësive tona, për të nxjerrë realitetin. Të marrim, për shembull, Jugosllavinë, që është një vend kapitalist i degjeneruar. Vetë Titoja, udhëheqësi i saj, është një renegat. Që Titoja ka qenë dhe është ashtu siç e ka përcaktuar Stalini, për ne nuk ka asnje dyshim. Lind pyetja: Ekzistojnë indipendenca dhe sovraniteti në Jugosllavi? Përgjigjja është e qartë: Titoja e ka shitur vendin e vet tek amerikanët dhe sot ky vend nuk është tjetër veçse një shtet borgjez.

Në pamjen e jashtme krijohet përshtypja sikur Titoja ka kontradikta me revisionistët sovjetikë, dhe në të vërtetë ka, po çfarë kontradiktash janë këto? Natyrisht, këto nuk janë kontradikta të sferës ideologjike, sepse ai është një antimarksist; mosmarrëveshjet

midis këtij renegati dhe krerëve të Kremlinit janë refleks i kontradiktave që ekzistojnë në mes një agjentre të imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik. Socialimperializmi sovjetik dëshiron ta tërheqë Jugosllavinë pas vetes dhe nuk i pëlqen që ajo është e lidhur me imperializmin amerikan.

Titoja e heq veten marksist-leninist, mirëpo kush e mbështet atë si të tillë, gabon rëndë, sepse Titoja nuk ka qenë kurrë dhe nuk është marksist, pavarësisht se me demagogji përpinqet të dalë përpara popujve të botës si një udhëheqës i tillë. Me lloj-lloj sloganesh për paqen, bashkëkzistencën, mosangazhimin etj., Titoja përpinqet të mashtrojë në radhë të parë popujt jugosllavë, pastaj gjithë popujt e tjerë të botës, që luftojnë për liri dhe pavarësi. Por e vërteta nuk mund të mbulohet me fjalë. Socializmi, shokë, nuk mund të ndërtohet me dollarët amerikanë.

Revisionistët sovjetikë kanë frikë nga Titoja, sepse ky, me politikën që ndjek, u jep një shembull të padëshirueshëm për ta «miqve» hungarezë, polakë, bullgarë, çekë, kurse rumunëve duket qartë që ua ka dhënë, gjersa këta ndjekin hap pas hapi rrugën e tij, sikur të kishin dalë nga hunda e Titos. Jugosllavët dhe rumunët e heqin veten marksistë-leninistë dhe në emër të luftës gjoja për të qenë të pavarur, përpinqen të qëndrojnë të shkëputur nga Bashkimi Sovjetik. Po me kë lidhen? Ne e shohim se ata nuk janë sovranë, të pavarur. Jugosllavia e Titos vetë është e lidhur kokë e këmbë me imperialistët amerikanë, por edhe Rumania është e lidhur ngushtë me amerikanët, me Gjermaninë Perëndimore dhe me shumë shtete të tjera im-

perialiste. Pas ngjarjeve që ndodhën në Çekosllovaki, në vitin 1968, Titoja bëri zhurmë të madhe për rrezikun e një agresioni të sovjetikëve ndaj Jugosllavisë, sepse ata bënë presione të mëdha ndaj rumunëve dhe jugosllavëve. Po përse i bënë këto presione sovjetikët? Qëllimi ishte i qartë: t'i trembnin dhe t'i lidhnin pas politikës së tyre, që këto dy vende të paktën ta balancinin qëndrimin si me amerikanët, ashtu dhe me Bashkimin Sovjetik.

Edhe kohët e fundit revizionistët sovjetikë po bëjnë manovra në Hungari, në Çekosllovaki dhe në Bullgari. Për këtë gjeneralët e Titos janë shumë të shqetësuar, sepse fashistët sovjetikë në çdo moment të përshtatshëm për ta, janë gati dhe mund të bëjnë çdo gjë. Ne mund të gabohemi në gjykimet tonë, por mendojmë se jo vetëm në situatat aktuale, por edhe sikur këto të bëhen akoma më të rënda, carët e rinj të Kremlinit do ta kenë zor ta sulmojnë Jugosllavinë. Po t'i referohemi historisë, as carët e vjetër të Rusejë nuk e kanë sulmuar kurrë Serbinë, Malin e Zi, Bosnjën etj.; krerët e këtyre vendeve në të kaluarën nuk janë vrapë me rusomëdhenjtë. Prandaj, edhe për hatër të lidhjeve tradicionale që kanë ekzistuar në mes rusëve dhe sllavëve të jugut, Brezhnev me Kosiginin nuk do ta bënin një gjë të tillë. Ata e mendojnë sa e rëndë do të ishte për Bashkimin Sovjetik po të sulmoheshin nga ana e trupave të tyre «vëllezërit sllavë» dhe këtë e di edhe Titoja. Një sulm kundër Jugosllavisë është, gjithashtu, vështirë të ndodhë edhe për arsyen e strategjisë dhe të lidhjeve të Jugosllavisë me amerikanët. Nga ana tjetër, midis Turqisë, Greqisë dhe Ju-

gosllavisë ka kohë që është nënshkruar një traktat që sot as përmendet, por, me ndryshimin e koniunkturave, mund të aktivizohet, sepse njihen lidhjet e ngushta që ekzistojnë midis dy vendeve të tjera të Traktatit Ballkanik me Traktatin e NATO-s. Prandaj në qoftë se revisionistët e Moskës do ta sulmonin aktualisht Jugosllavinë, kjo do të ishte një katastrofë e madhe për Bashkimin Sovjetik. Të goditet Jugosllavia, bëhet luftë botërore, pse NATO-ja nuk mund të lejojë që Bashkimi Sovjetik të futet në hundë të Italisë, të Austrisë, të Greqisë dhe të Turqisë.

Titoja i di të gjitha këto situata dhe, pavarësisht se është një renegat i marksizëm-leninizmit, ai është njeri i zgjuar. Atëherë pse e bën gjithë këtë zhurmë? Për të marrë sa më shumë para, mbasi situata brenda në Jugosllavi është katastrofike, me tërë kuptimin e fjalës. Sistemi kapitalist jugosllav ka falimentuar plotësisht. Brenda këtij vendi janë ngjallur ndjenja të forta shoviniste dhe janë duke u zhvilluar përleshje nationale. Titoja vetë ka shumë kundërshtarë në Jugosllavi. Sovjetikët, me presionet që i bëjnë, kanë për qëllim të forcojnë në Jugosllavi pozitat e tyre dhe të kundërshtarëve të Titos, por jo ta sulmojnë këtë vend; Titoja po e përgatit ushtrinë jo për t'u mbrojtur nga Bashkimi Sovjetik, sepse e di që ai nuk e sulmon, por për t'u treguar grushtin popullit dhe kundërshtarëve të vet të brendshëm dhe për t'i detyruar sovjetikët që të kërkojnë të bisedojnë vetëm me të dhe jo me kundërshtarët e tij dhe, me sa duket, kësaj po ia arrin, se, siç dihet, Brezhnjevi së shpejti do të bëjë një vizitë në Beograd.

Partia jonë e ka parashikuar me kohë se do të bëhej një takim i tillë dhe mendon se gjatë këtij takimi në Beograd Titoja dhe Brezhnjevi do të merren vesh dhe të dyja palët do të realizojnë kështu qëllimet e tyre. Brezhnjevi, nga njëra anë, do të mundohet ta zbutë situatën me jugosllavët, kurse Titoja, nga ana tjetër, nga këto bisedime do të dalë fitimtar mbi kundërshtarët e tij.

Partia e Punës e Shqipërisë nuk është aq naive së të identifikojë politikën e saj të drejtë marksiste-leniniste me politikën adventureske plot zigzage që ndjek renegati Tito. Sot ai është i lidhur ngushtë me amerikanët, nesër është gati të afrohet edhe me sovjetikët, po kështu tani është mirë me italianët, pastaj mund të zemërohet me ta dhe të fillojë të puthet me grekët, ashtu siç po përqafohet me revanshistët e Gjermanisë Perëndimore. Pse i bën ai gjithë këto zigzagë politikën e tij? Kuptohet qartë, kjo është politika tipike e një shteti borgjez në falimentim, që nuk di nga të shkojë, lëkundet sa andej-këtej në koniunkturat që krijojen. Republika Popullore e Shqipërisë, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e saj nuk mund të identifikojnë kurrë politikën e tyre të drejtë marksiste-leniniste me politikën adventureske të një tradhtari.

Mos ka ndryshuar aktualisht politika e Partisë së Punës të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë? Jo. Partia jonë ndjek e do të ndjekë edhe në të ardhmen atë politikë që ka ndjekur vazhdimit ndaj saj dhe kjo nuk duhet ngatërruar me marrëdhëniet tregtare që kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit midis të dy vende-

ve, ose me zhvillimin pak më shumë edhe të marrëdhënieve në fushën e kulturës, për arsyen se atje ka shumë shqiptarë, është gati një Shqipëri e dytë.

Ne kemi dekluar botërisht që, në rast se Jugosllavia sulmohet nga ndonjë shtet tjetër, populli shqiptar do të jetë përkrah popujve jugosllavë. Kjo deklaratë, përveç që është shprehje e një qëndrimi të drejtë internacionalist, ka rëndësi edhe për ne. Dhe ne do të qëndrojmë në pozita të tillë po ta sulmojë Jugosllavinë Bashkimi Sovjetik ose ndonjë fuqi tjetër.

Sot po bëhet zhurmë e madhe nga propaganda revizioniste sovjetike sikur është duke u formuar një bosht Beograd-Tiranë-Bukuresht. Kjo nuk është tjetër veçse një shpifje, një parullë antishqiptare e revizionistëve sovjetikë, por që u pëlqen shumë si jugosllavëve, ashtu edhe rumunëve. Por ne, marksistë-leninistët, e kuptojmë fare mirë se kjo është një parullë antimarksiste, prandaj Partia e Punës e Shqipërisë nuk gënjet prej saj dhe nuk futet në rrugën që kërkojnë ta futin armiqtë e socializmit.

Aktualisht, bota kapitaliste dhe revizioniste është përfshirë në një krizë të rëndë. Kriza e dollarit e detyroi xhelatin e popujve, Niksonin, të merrte masa për të ulur vlerën e kësaj monedhe, të ngrinte 10 për qind taksat e mallrave të importit dhe të bllokonte pagat e punëtorëve për 90 ditë. Të gjitha këto masa Niksoni i mori për ta nxjerrë vendin nga situata e rëndë ekonomiko-financiare që është krijuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pasojat e kësaj krize, që tanë kanë filuar të duken qartë, do të rëndoijnë jo vetëm mbi popullin amerikan, por edhe mbi të gjithë popujt e tjerë

të botës, që nuk do të durojnë shumë gjatë, sepse do të vijë koha që të shpërthejnë një ditë.

Nga politika amerikane janë egërsuar jo vetëm popujt, por edhe vetë qeveritë e vendeve kapitaliste. Ne nuk mund të parashikojmë me saktësi të gjitha rrjetdhimet e kësaj politike imperialiste, por fakt është që ajo do të ketë patjetër pasoja, popujt do të ngrihen kundër saj, do të shpërthejnë në greva e në demonstrata, të cilat përkohësisht do të frenohen nga diktatura kapitaliste në vendet e ndryshme të botës, kurse të gjithë tradhtarët revizionistë, si: italianët, francezët, japonezët e të tjerë do të bëjnë çmos t'i shërbijnë kapitalit të brendshëm të vendeve të tyre dhe amerikanëve për të shtypur revoltat e punëtorëve. Të marrim, për shembull, Japoninë, 75 për qind e eksportit të së cilës drejtohet për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Se çfarë do të ndodhë tani në Japoni dhe në të gjitha këto vende që eksportojnë mallrat e tyre në SHBA, ku u ngritën taksat në 10 për qind, merret me mend. Po mos vallë do të shpëtojnë socialimperialistët sovjetikë nga kjo krizë e madhe ekonomike botërore? Jo, kriza e rëndë monetare në botën kapitaliste nuk do të lërë pa prekur edhe vendet revizioniste.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se kriza ekonomiko-financiare, që ka përfshirë botën kapitaliste, do të sjellë patjetër një situatë të favorshme revolucionare. Atëherë çfarë duhet të bëjmë ne këtu, në Evropë? Në kushtet e krijuara edhe brenda mundësive tonë po përpinqemi e do të përpinqemi të përfitojmë nga kjo situatë, në radhë të parë, të mbështetim pakënaqësitë e masave popullore, të mbështetim partitë marksis-

te-leniniste revolucionare të vërteta në luftën e tyre të drejtë, kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik. Tani më mirë se kurrë është momenti që të shfrytëzohen e të thellohen kontradiktat që kanë ata midis tyre. Socialimperializmi sovjetik, me aq sa e kuptojmë ne, do të përpinqet të akaparojë tregjet, por, nga ana tjeter, edhe Franca, Japonia, Italia etj. nuk kanë ku t'i çojnë mallrat e tyre të eksportit, prandaj do të fillojë një luftë për tregje. Kjo situatë i detyron këto shtete t'ju buzëqeshin juve.

Kohët e fundit revisionistët sovjetikë u lidhën menjë marrëveshje me reaksionarët e Indisë kundër Kinës, nesër ata do të lidhen edhe me Saton e Japonisë, përsëri kundër Kinës. Në traktatin që u nënshkrua midis Bashkimit Sovjetik dhe Indisë, kanë gisht edhe amerikanët, dhe shumë bile, sepse Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson që Kina të rrethohet, prandaj ata janë të gatshëm ta sakrifikojnë Indira Gandin, ta lënë atë të puthet me Bashkimin Sovjetik, por vetëm kaq, sepse dihet se kyçet kryesore të ekonomisë në Indi i mbajnë amerikanët. Edhe në situatën e krijuar imperialistëve amerikanë nuk u leverdis që India, Indonezia, Japonia të futen në sferën e influencës së Bashkimit Sovjetik, por u intereson shumë që këto shtete të afrohen me socialimperializmin sovjetik, sepse të dyja palët kanë një qëllim tjeter të madh politiko-strategjik: të rrethojnë Republikën Popullore të Kinës. Sidoqoftë, Mao Ce Duni dhe partia juaj let'i gjykojnë më mirë vetë këto çështje.

Sic e shikoni, këtu në Evropë Partia dhe populli ynë përpinqen dhe luftojnë me vendosmëri kundër im-

perializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe gjithë aleatëve të tyre. Të jeni të sigurt se Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë do të jenë kurdoherë armiqtë e betuar të tyre.

Tani më falni të flas pak në mënyrë të veçantë për vendin tonë, Republikën Popullore të Shqipërisë, e cila është sot i vetmi vend socialist në Evropë. Ky është një fakt i njojur, sepse në kontinentin tonë jo vetëm Jugosllavia, por as Rumania nuk është vend socialist. Ne do të dëshironim që Rumania të hidhej në rrugën socialiste, por një gjë e tillë nuk po duket. Kështu, pra, Shqipëria, duke qenë i vetmi vend socialist në Evropë, ka «akaparuar» armiqësinë dhe urrejtjen e të gjitha fuqive kapitaliste të Evropës dhe për këtë ne ndihemi krenarë.

Të gjitha këto shtete jo vetëm nuk e duan këtë vend të vetëm socialist në Evropë, por, po t'u jepet mundësi, janë gati edhe ta likuidojnë. Mirëpo e kanë të zorshme t'ia arrijnë këtij qëllimi për dy faktorë:

Në radhë të parë nga faktori i brendshëm: Republika Popullore e Shqipërisë është një vend socialist, në krye të saj qëndron një parti marksiste-leniniste, e mbështetur fort në parimet dhe në normat leniniste, me një unitet të fortë, të çeliktë brenda radhëve të saj dhe në unitet të plotë me popullin. Populli ynë është i armatosur mirë politikisht dhe ushtarakisht, i ngritur edhe ideologjikisht dhe plotësisht i vendosur për t'u ngritur i téri si një trup i vetëm për mbrojtjen e atdheut socialist dhe për t'i asgjësuar të gjithë armiqtë që do të guxojnë të prekin kufijtë e vendit tonë, edhe sikur ta sulmonin njëkohësisht nga të katër anët

(sepse ka mundësi që lufta t'i vijë në një drejtim, por edhe nga të gjitha drejtimet dhe për këtë Partia jonë i ka marrë të gjitha masat). Prandaj të gjithë ata që kanë për qëllim të likuidojnë Republikën Popullore të Shqipërisë, duhet ta kenë mirë parasysh se me kë do të luftojnë. Ne kemi besim se armiqtë që do të na sulmojnë, do t'i mundim, pavarësisht se ata mund të jenë një shumicë e madhe, sepse në kufijtë tanë nuk do të gjejnë asnjë shteg, sado të vogël, për të hyrë, pale portë. Kjo mund t'i detyrojë ata të përpilen për t'u futur «nga dritarja», por edhe nga kjo anë populli do t'i grijë. Armiqtë i llogaritin të gjitha këto.

Në radhë të dytë është faktori tjetër, ai i jashtmi. Me Shqipërinë janë popujt, revolucionarët marksistë-lininistë, elementët përparimtarë e miqtë e shumtë të saj kudo në botë, që përbëjnë një forcë të madhe. Armiqtë edhe këtë e bëjnë llogari.

Megjithatë, nuk e fshehim, ne kemi parasysh se jemi të rrethuar nga të gjitha anët me armiq të shumtë, të cilët duhet t'i përballojmë vetë, prandaj edhe kemi punuar dhe vazhdojmë të punojmë për forcimin e gjithanshëm të fuqisë mbrojtëse të vendit. Mbrojtja dhe forcimi i Republikës Popullore të Shqipërisë u shërben drejtpërsëdrejti interesave të proletariatit dhe revolucionit botëror...

Kryetari i delegacionit kinez, pasi falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe vlerësoi lart përgatitjen e gjithanshme ideologjike, politike dhe ushtarake të popullit dhe të ushtrisë sonë, parashtroi edhe variantin e luftrës që do të zbatohej në Kinë, të përpunuuar nga Mao Ce Duni, në rast të një agresioni të mundshëm të fuqive

imperialiste e revizioniste ndaj saj. Duke folur për këtë variant, ai, ndër të tjera, tha:

Në fillim ne do t'u vëmë agresorëve një forcë të vogël përballë, pastaj do të mobilizojmë të gjitha forcat njerëzore e materiale, pra të gjitha mundësitë tonë dhe, në momente të caktuara, do t'i hedhim në sulm për ta asgjësuar armikun përfundimisht... Sigurisht, armiqjtë mund të pushtojnë kështu një sipërfaqe të madhe të tokës sonë, do të marrin qytete dhe krahina të tëra, por kjo gjendje do të jetë e përkohshme, sepse, fundi i fundit, do të vijë dita që këto toka, përkohësisht të pushtuara, të çlironen, t'i rimarrim prapë... Kështu ata mund të futen shpejt në fillim në territorin tonë, por për të dalë do të jetë e zorshme, për ta nuk do të ketë rrugëdalje përvëç asgjësimit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju thatë se në rast agresioni do të tërhiqeni, duke i lëshuar armikut hapësira të mëdha toke, kurse ne ushtrinë dhe popullin i përgatitim në mënyrë që armiku të mos vërë këmbë në tokën tonë. Por edhe në qoftë se do të arrijë të zë-rë pak vend, të mos ia lëmë, por do ta asgjësojmë ose do ta detyrojmë të kthehet mbrapsht. Në Shqipërinë tonë të vogël ne nuk do t'i lëmë vend armikut të manovrojë. Prandaj ju lutemi t'u thoni shokëve të udhëheqjes suaj se ne shqiptarët manovra të mëdha tërheqjeje nuk do të bëjmë. Ne do të luftojmë vendosmërisht që ta shkatërrojmë armikun që në fillim. Ai do të përpinqet të zë-rë hapësirë toke në vendin tonë, sepse është i madh e i fuqishëm dhe këtë fuqi të vet ai në këtë mënyrë mund ta tregojë, por ne nuk do t'ia lëmë tokën. Ai do të orvatet të futet prapë, por përsëri nuk

do ta lëmë dhe kemi marrë masa të tilla që ai zor të futet. Por edhe po u fut, siç thashë, do ta asgjësojmë ose do ta detyrojmë të kthehet nga ka ardhur. Kësh-
tu që në Shqipëri armiku do të ketë epërsi vetëm në ajër, nga i cili s'ka ç'bën, se për të zënë tokë duhet të dërgojë shumë ushtarë, por këta do të bien nën zjarrin e plumbave tanë, do të ndeshen në bajonetat tona.

Shokët e ushtrisë në këtë drejtim bëjnë përpjekje të mëdha për t'i stërvitur sa më mirë jo vetëm ushtarët, por edhe vullnetarët, të cilët në të vërtetë janë ushtarë. Siç ju thashë më parë, ne jetojmë të rrethuar nga të katër anët me armiq, prandaj edhe një predhë për ne është shumë e çmuar dhe për të pasur rendiment të madh në qitje, njerëzit i mësojmë që me një të shtënë ta goditin armikun. Ne vazhdimisht marrim masa për forcimin e mbrojtjes kundërajrore të qyteteve tona dhe përpinqemi ta shkurtojmë sa më shumë kohën e grumbullimit e të gatishmërisë së njësive rezerviste.

Ne jemi marksistë-leninistë, kjo është e qartë, prandaj me miqtë tanë çështjet i shtrojmë kurdoherë qartë, nuk mbajmë rezerva, të gjitha i kemi të hapëta. Miqësia e singertë midis dy popujve tanë përbën një faktor me rëndësi të madhe dhe në këtë rrugë ne jemi përpjekur e do të përpinqemi ta kalitim atë vazhdimisht.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha, «Ku-
ndër revizionizmit modern
(Përbledhje veprash)
1971-1975», f. 78*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Kundër revizio-
nizmit modern (Përbledhje
veprash) 1971-1975», f. 78*

REALIZIMI I PLANIT TË MOS NDAHET NGA PLOTËSIMI I NEVOJAVE TË POPULLIT

*Nga biseda me sekretarë të KQ të PPSH
dhe shokë të Qeverisë¹*

2 shtator 1971

Çështja e prodhimit të drithërave të bukës ka rëndësi të madhe. Por, duke luftuar që të realizojnë totalin e drithit, rrethet nuk bëjnë të gjitha përpjekjet për të realizuar planin e prodhimit për çdo bimë, sepse gënjen nga shifrat. Ata mund ta realizojnë 30 për qind të planit të drithit me misër, por ama në radhë të parë të mos heqin dorë nga realizimi i grurit. Në qoftë se nuk e realizojnë dot këtë prodhim, është tjetër gjë: atëherë duhet të bëjnë përpjekje ta realizojnë me misër. Çështja e kompensimit të planit të grurit me misër, në realitet, na leverdis. Por problemi shtronhet që të synohet për të marrë edhe grurin, edhe misrin e planifikuar, bile të vazhdojnë përpjekjet edhe për tejkalimin e planit.

1. Në këtë takim shoku Enver Hoxha u informua për realizimin e planit për 7 muajt e parë të vitit 1971.

Për sa u takon shifrave për realizimet e pritshme që na u përmendën këtu ato duhen marrë me rezerva; në fund, atëherë do të nxjerrim konkluzione të sakta. Tani, vërtet rrethet na thonë se do të realizojnë planin, por në dhjetor mund të na raportojnë që nuk e plotësuan dot detyrën. Ne duhet të nxjerrim konkluzione me rëndësi të përgjithshme dhe të marrim masat e nevojshme me qëllim që manovrimi në llojin e drithërave që mbillen të bëhet në shërbim të interesit të popullit. Puna është që të prodrojmë plotësisht atë që parashikojmë dhe të mbjellim më shumë toka, duke përfshirë edhe ato që hapim të reja.

Duke e parë globalisht çështjen e farërave problemi paraqitet më mirë. Kur vajta në Durrës pashë se në tokat e mbjella me farën «Senator Kapeli» gruri dukej shumë i mirë. Megjithatë, edhe ata që kanë mbjellë këtë lloj fare, nuk kanë dhënë rendimentin e duhur, megjithëse kanë një eksperiencë 30-vjeçare në kultivimin e saj.

Këtu u fol edhe për riorganizimin në sektorin e transportit. Lidhur me këtë unë dua të pyes: A e justifikon veten në praktikë ky riorganizim që është bërë? Më kanë thënë që nuk e justifikon, për arsyen se tani transporti nuk i furnizon mirë tregjet dhe dyqanet me ato mallra që kemi, pasi nuk funksionon në rregull, gjë që ka shkaktuar çrrregullime. Po të shikohet problemi thjesht nga ana financiare, natyrisht xhiroja mund të realizohet, por ama, ka dyqane që nuk furnizohen si duhet me malira, sidomos me mallra të vogla. Por, duhet ditur se këto mallra të vogla mund të jenë shumë të nevojshme për popullin. Mirë se për-

çimento e lëndë druri problemi është i zgjidhur, sepse tregu furnizohet me to, por si i bëhet halli për artikujt e vegjël, për brisqet, për shembull, për çorapet, për fanellat e të tjera sende që kanë rëndësi të madhe për popullin, por që nuk çohen nëpër dyqane. Domethënë, siç del këtu, pas riorganizimit transporti i mbulon nevojat e ekonomisë, në bazë të planit. Atëherë pse ndodhin pengesa në transportimin e hekurit, të kromit dhe materialeve të tjera si këto?

Lidhur me konfekcionet dhe stoqet e krijuara, ka rëndësi puna që bëhet për prodhimin e tyre me cilësi. Ne nuk duhet të nisemi vetëm nga koncepti që t'u gjejmë njerëzve punë, por edhe t'i paguajmë ata në mënyrë të atillë që të nxiten të prodrojnë jo vetëm në sasi, por edhe me cilësi, sepse, në qoftë se nuk prodhojnë me cilësi, do të kemi humbje të madhe. Nuk është e drejtë të futen në ato punë që kërkojnë kualifikim njerëz të paspecializuar. Nuk është e drejtë nga ana politike t'u themi njerëzve të blejnë konfekcionet e përgatitura me cilësi të dobët nga punëtorë të pakualifikuar. Po të vepronim kështu, do të vinim në kundërshtim me nevojat dhe me guston e njerëzve, e cila nuk është më ajo e para, por ka ndryshuar, është ngritur. Prandaj për kërkesat tona në këtë drejtim duhet të jemi rigorozë.

Kur një vajzë ose grua e pakualifikuar kërkon punë si rrobaqepëse etj., më parë, të futet me shpenzimet e saj në kursin që duhet ngritur për këtë qëllim për një kohë prej një vit e gjysmë apo për sa të shihet e arsyeshme dhe vetëm pasi ajo të përfundojë kursin me sukses, të vendoset në punë. Kjo çështje të

shikohet edhe në rrethet e vogla, se ashtu siç është bërë deri më sot, nuk është e leverdishme. Kjo është një çështje me rëndësi që ka lidhje me krahun e punës.

Shoku Ramiz më tha se na vijnë vazhdimisht kontingjente të reja me të rinj që mbarojnë shkollat e mesme, të cilët për arsyet tē ndryshme nuk mund të venë në universitet. Ata duhet të vihen në punë, por kjo çështje nuk mund të zgjidhet, si të thuash, në mënyrë letrare. Ne themi se në vendin tonë ka punë sa të duash, por këto punë duhet të klasifikohen. Të klasifikohen edhe njerëzit e rinj, me të cilët tē punohet shumë që të njihen me punën dhe ta duan atë, të arrijnë kualifikimin teknik dhe tē jenë në gatishmëri tē plotë. Propaganda e Partisë tē jetë vendimtare për këtë problem dhe komitetet e Partisë tē jenë tē lidhura me këto detyra. Nuk është lehtë tē binden tē rinjtë që tē shkojnë, për shembull, nga Tirana në Tropojë. Ne themi që fshati thith krahët e punës, por si do t'i thithë ai këta për sa kohë që edhe në fshat njerëzit shtohen dhe tendenca jonë është që tē rritet mekanizimi?

Po ku do tē futen në punë gjithë këta njerëz? Këtë vit duhet t'u japim porosi ndërmarrjeve që 50-60 për qind e atyre tē rinjve që venë për tē punuar atje për një vit, pas mbarimit të shkollës së mesme¹ tē punohet me ta e t'u nxitet dëshira për tē punuar në ato ndërmarrje dhe jo tē ikin. Ky vit në prodhim tē

1. Në atë kohë pas mbarimit të shkollës së mesme, nxënësit bënin një vit punë në prodhim para se tē fillonin studimet në shkollën e lartë.

mos konsiderohet si ndihmës, por si fillim i punës së të rinxve për të qëndruar atje, ndryshe do të kemi vështirësi. Ky është një problem i madh.

Të mos shkohet me mendimin se te ne nuk ka rrezik të kemi njerëz të pazënë me punë, gjersa synojmë të rritim rendimentin dhe të automatizojmë fabrikat. Këto të fundit nuk janë të tilla që të futim në to sa punëtorë të duam, prandaj të mendojmë që tani se ku do t'i inkuadrojmë këta njerëz. Duhet t'i hyjmë një çikë më thellë kësaj çështjeje që për këtë qëllim të kemi statistika të studiuara mirë në çdo qendër pune. Është e nevojshme të studiohet me kujdes edhe mënyra e veprimit në këto raste, se ndryshe do të na krijohen shumë probleme politiko-shoqërore, që po të mos merren masat me kohë, do të na acarohen.

Në prodhim ka shumë procese pune që mund të automatizohen. Atje ku ekzistojnë këto mundësi duhet të realizohen.

Por, këtu del e mprehtë ana politike e problemit. Punëtorët që shkurtohen mund të jenë gra dhe këtyre nuk mund t'u thuhet të shkojnë për të punuar larg familjeve. Kjo gjë e mundon drejtorinë e ndërmarrjes, prandaj dhe nuk i heq nga puna.

Mua më duket se për këto probleme shoqërore shumë të rëndësishme nuk interesohet sa duhet organizata e bashkimeve profesionale. Por kur dalin përpëra situata të tilla, kjo organizatë shoqërore duhet t'i shikojë me kujdes dhe të bëjë sugjerime të vlefshme.

Për sa i përket arsimit pa shkëputje nga puna, mendoj se një nga detyrat është të kontrollohen e të

ndiqen ata që venë në këto shkolla se nuk janë pak, por rreth 120 mijë veta. Për këta ka rëndësi të shikohen orët që u paguhen pa punuar, për arsyse se vazhdojnë shkollën. Si shfrytëzohen këto orë, nga këta punëtorë, a e frekuentojnë rregullisht shkollën? Mos duhet ndryshuar ndonjë gjë në qoftë se rezultatet nuk e justifikojnë këtë kohë të humbur? Ata e kanë orarin e punës të reduktuar dhe, megjithatë, ka raste që nuk frekuentojnë shkollat, nuk përgatiten dhe nuk i marrin dot provimet. Të shikohet një çikë mirë kjo punë, sepse të 120 mijë vetave u japim 2,4 apo 6 orë në javë, secilit, që kapin afro 1 milionë orë pune. Kjo gjë del më e saktë kur mbaron viti shkollor, bile kur jadin provimet e sezoni të vjeshtës, sepse atëherë duhet sa kaluan e sa jo.

Mendoj që në ndjekjen e shkollës pa shkëputje nga puna të jemi të kujdeshshëm edhe në një drejtim tjetër: ai që do të lejohet të vazhdojë shkollën, të mësojë për degën ose sektorin ku punon, të priret nga interesit i përgjithshëm. Nuk duhet lejuar, për shembull, që mjeshtri i fabrikës të ndjekë shkollën e mesme të arsimit të përgjithshëm, sepse ai ka nevojë për arsim të mesëm teknik.

Shkolla e mesme industriale është shumë e përshtatshme për punëtorët dhe mjeshtrat, por të kemi kujdes se mos ndiqen këto shkolla me të vetmin qëllim për të vazhduar pastaj universitetin. Ne duhet ta shikojmë kuadrin me arsim të mesëm në profil, do të ketë prej tyre që të vazhdojnë studimet e larta, por s'ka mundësi që të ndjekin të gjithë universitetin. Ne kemi nevojë shumë për kuadro të mesëm që punojnë

në prodhim. Këtu ka një gjë që mendoj se duhet korriguar.

Sa për atë që u tha këtu ka mendime që të kalohet përsëri në sistemin e pesë notave. Për vlerësimin e nxënësve, mendoj që sistemi i notave të mbetet ai që është, domethënë, vlerësimi me sistemin e dhjetë notave. Duke përdorur notat deri në 10 ne shkojmë drejt heqjes së mëvonshme të notave në shkolla, sepse nëpërmjet sistemit që kemi tani bëhet një vlerësim më i gjerë, një shkallëzim më i gjerë dhe më i kualifikuar për vlerësimin e dijeve. Kurse, po të kishim sistemin e pesë notave, si ai që sot merr 10, dhe ai që merr 9, do të kualifikoheshin njësoj, domethënë «shumë mirë». Pra, do të ishte zor të shquheshin nga njëritjetri nxënësi i dhjetës nga ai i nëntës.

Këtu nuk është çështja vetëm në përcaktimin e dijeve individuale të njeriut, por kjo ka të bëjë edhe me ekzigjencën e mësuesve dhe pedagogëve. Kur ishim ne në Liceun e Korçës kishim sistemin e 20 notave, por vetëm notës 18 i afroheshim.

Pra, mendoj që ta shikoni këtë çështje, se ne jemi, në radhë të parë, për cilësinë e përgatitjes së nxënësve dhe të studentëve. Tani ne kemi krijuar kuadro. Ka ardhur koha të luftohet për kualitet dhe kjo arrihet më mirë, mendoj unë, me këtë sistem të notave që kemi.

Me këtë sy duhet parë edhe rregullorja e brendshme e shkollës, që ka të bëjë me marrëdhëniet mësues-nxënës. Nuk e di nëse janë futur tepër në hollësira. E kam fjalën se mos rregullorja është e tillë që «u zë frymën» mësuesve dhe nxënësve.

Është, gjithashtu, një gjë shumë e mirë që në çdo fshat të ketë nga një mami. Kjo pa dyshim është një fitore e madhe. Çështja është që tani t'i ndihmojmë me konsultime dhe me anë të kurseve që mund të organizohen herë pas here në shtëpitë e lindjes. Tani për tani në to ka vetëm shtretër dhe personelin, por puna është që të kenë edhe pajisjet që u duhen për punë. Sikur secila mami të ketë nga një çantë me komplet veglash, kjo do të ishte gjë e mirë. Duhet të bëjmë përpjekje për t'i sigruuar këto gjëra që janë të nevojshme.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

DISA PROBLEME TË KONTROLLIT PUNËTOR NË FUSHËN E ARSIMIT DHE TË KULTURËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 shtator 1971

Duke folur për kontrollin punëtor në fushën e arsimit e të kulturës s'ka pse të flitet për përparimin në shkolla ose për zbatimin e direktivës së Partisë, për revolucionarizimin e shkollës etj., se kështu largohemi nga tema. Pra, e kam fjalën që edhe sot të përqendrohem i në problemet që shihet nevoja të ngrëmë për kontrollin punëtor.

Lidhur me raportin e Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë unë kisha një pyetje, nëse kontrolllet e punëtorëve bëjnë efekt në kuadrot drejtues të arsimit dhe në personelin mësimor të shko-

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi disa probleme të kontrollit punëtor në fushën e arsimit e të kulturës» si dhe mbi përfundimin e mbledhjeve për dhënie llogari e zgjedhje në organizatat-bazë të Partisë dhe disa detyra për të ardhmen.

llave? Si venë në shkolla këto ekipe të punëtorëve dhe a lënë gjurmë atje? Po vetë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, këshillat pedagogjikë të shkollave si i presin këto ekipe? Përgjigjen që do të jasin shokët nuk e kërkoj në teori, sepse e dimë që teorikisht këto kontrollle kanë rëndësi shumë të madhe, pse është kontrolli i klasës, po pyes konkretisht: ua vënë veshin në shkollat dhe në institucionet arsimore vërejtjeve dhe propozimeve që bëjnë shokët e kontrollit punëtor apo mos mendojnë: «Ç'janë këta që na vijnë», «këta nuk kuptojnë fare nga puna jonë pedagogjike» etj. Pas kontrolleve a vihen re ndryshime në punën e këshillave pedagogjikë?

Pasi shokët iu përgjigjën pyetjeve të mësipërme dhe diskutuan për probleme të ndryshme të kontrollit punëtor në fushën e arsimit e të kulturës, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Është e domosdoshme të vazhdojmë edhe në të ardhmen me kontrollin punëtor, pse është një çështje me rëndësi të madhe për Partinë. Në këtë punë ne duhet të nisemi kurdoherë nga parimi që as të mos dëshpërohem për të metat e dobësitë që zbulohen, as të mendojmë se kjo punë që ka filluar po na shkon mirë, pse një gjë e tillë mund të bëjë që ta flemë mendjen dhe të mos arrijmë në mënyrë progresive rezultatet që dëshirojmë.

Sigurisht në praktikë është vështirë të arrihet që klasa punëtore ta njohë gjithçka mirë dhe t'i kontrollojë të gjitha çështjet deri në fund. Nga ana tjetër, nuk duhet të dalim as në konkluzionin se ajo nuk e bën mirë punën lidhur me kontrollin punëtor. Çështja

nuk duhet të vihet kështu, mendoj unë. Problemi është që Partia të punojë vazhdimisht, që klasën punëtore ta bëjë të ndërgjegjshme për rolin e saj udhëheqës, drejtues, edukues dhe kontrollues. Po t'ia arrijmë kësaj, atëherë kemi bërë një punë të madhe. Por kjo nuk realizohet as në një ditë as në një vit as në pesë apo shtatë vjet, prandaj kërkohet vazhdimësi. Të krijohen tradita me të vërtetë ideologjike dhe revolucionare në këtë çështje, duke pasur parasysh që klasa punëtore përtërihet përherë me elementë të rinj, shumë nga të cilët vijnë nga shtresat e tjera të popullsisë, që, me gjithëse bëjnë stazhin e klasës, për një kohë nuk e kanë akoma eksperiencën e kësaj klase. Nga kjo pikëpamje ne duhet të bëjmë që këta elementë të fitojnë eksperiencën e klasës, duke u udhëhequr nga mësimet e Partisë, të klasës punëtore, të punëtorëve më të vjetër.

Klasën punëtore ne duhet ta bëjmë të ndërgjegjshme për rolin e saj të madh. Po për t'ia arritur kësaj është e nevojshme ta mësojmë që të përsosë gjithnjë e më shumë, përveç detyrave të tjera, edhe detyrën e veçantë që i shtrojmë, atë të kontrollit. Dhe në qoftë se duam që klasa punëtore ta bëjë si duhet kontrollin e të tjerëve, është e domosdoshme ta mësojmë atë që të bëjë më parë kontrollin e vetvetes. Kur vjen puna që klasa punëtore të kontrollojë, ta zëmë, sektorin e arsimor të saj njëherë, pse vetëm kështu do të mund të kontrollojë si duhet të tjerët. Prandaj, përpëra se të vejë të kontrollojë shkollat, ajo duhet të kontrollojë punëtorët që janë regjistruar në shkolla, të shohë

i ndjekin apo nuk i ndjekin ato si duhet, e përvetësojnë ata ideologjinë e Partisë apo nuk e përvetësojnë, i realizojnë në punë normat dhe rendimentet, ekziston tek ata disiplina e fortë në punë apo nuk ekziston. Me një fjalë të shohë më parë nëse punëtorët janë apo jo vetë në rregull në krye të luftës për të mbështetur e për të zbatuar plotësisht vijën e Partisë në të gjitha aspektet.

Në përgjithësi ne mund të themi se punëtorët janë dhe luftojnë për zbatimin e vijës së Partisë, por nuk mohojmë se në këtë drejtim ka edhe të meta. Të meta ka e do të ketë edhe në të ardhmen. Kjo është dialektike dhe nuk duhet të na dëshpërojë e të themi që, derisa ekzistojnë të meta në klasën punëtore, atëherë ç'i duhet kësaj të vejë për kontroll nëpër shkolla? Ç'i duhet të vejë për kontroll në tregti, në shëndetësi e në sektorë të tjerë? Veç duhet të kemi parasysh se ata punëtorë që s'mësojnë mirë, ose ata që në sektorin e tregtisë, të shëndetësisë etj., bëjnë hatëre e hile në jetë, janë vetëm disa individë të veçantë, nuk është tërë klasa punëtore si ata. Dihet se kur klasa punëtore vete në një dyqan të tregtisë për kontroll dhe atje zbulon të meta e dobësi nga ana e punonjësve të këtij sektori, nuk përjashtohet që në të njëjtën kohë të ketë disa punëtorë që bien në ortakllék me matrapazë, apo me ndonjë shitës të pandërgjegjshëm, me qëllim që si e si të furnizohen më parë. Kjo do të thotë se faji nuk është vetëm i klasës punëtore, që përparimi në këtë çështje kaq të rëndësishme nuk është akoma në nivelin e duhur, faj ka në këtë drejtim edhe udhëheqja e klasës punëtore, dua të them Partia, faj kanë për këtë

edhe organizatat e bashkimeve profesionale që drejtohen nga Partia. Atje ku organizata e Partisë është e fortë dhe zbaton si duhet direktivat, elementët e klassës punëtore edukohen mirë dhe zbatojnë e vënë në jetë si duhet të gjitha ligjet e rregulloret. Edhe disiplina në punë, në jetë, në parimet e moralit etj., atje shikohet me një sy marksist-leninist, edukimi i njerëzve kryhet më mirë, diskutimet ziejnë në mënyrë revolucionare, ndërsa kur organizata e Partisë në një qendër pune bie në gjumë, natyrisht edhe klasa punëtore në atë qendër do të flejë.

Prandaj çështja e kontrollit punëtor të kuptohet në dy drejtime kryesore: së pari, nëpërmjet tij ta bëjmë të ndërgjegjshme klasën punëtore për rolin e saj, që ajo të kuptojë mirë ç'do të thotë kontroll dhe që puna për të kontrolluar çdo gjë në rrugën e Partisë është një nga detyrat e saj me rëndësi dhe, së dyti, është çështja që klasa punëtore të ngrihet në një nivel të atillë që të mund ta bëjë si duhet këtë kontroll. Një rol të rëndësishëm luan për këtë edhe shkolla.

Për punonjësit tanë shkolla filllore tashmë është krejt e pamjaftueshme, prandaj atyre që kanë vetëm filloren dhe që janë në moshë 25 deri 35 vjeç, duhet t'u vëmë detyrën ta mbarojnë shkollën 8-vjeçare; kurse ata që kanë një zanat dhe janë në moshën mbi 40 vjeç, t'u vihet detyrë që njohuritë e tyre t'i zgjerojnë e t'i perfeksionojnë në zanatin që ushtrojnë, pse kulturën e përgjithshme ata mund ta marrin (dhe në fakt e marrin) edhe duke lexuar libra, gazeta, revista, kuriqozitete etj. Po të kenë dëshirë këta mund ta vazhdojnë edhe shkollën 8-vjeçare kur nuk e kanë mbaruar atë.

Për ndjekjen e shkollave ne duhet të mbajmë orientimet që kemi dhënë, por mendoj që ato t'i zbatojmë më realisht në praktikë, se deri tani është kërkuar prej të gjithëve të mbaronin shkollat e mesme. Mirëpo atyre që kanë mbaruar 8-vjeçaren dhe janë mbi 40 vjeç, nuk është e arsyeshme t'u kërkohet që të mbarojnë medoemos dhe shkollën e mesme. Në këtë drejtim duhet parë me kujdes mosha dhe horizonti i njerëzve, si dhe mundësitet e tyre për të vazhduar shkollën etj. Njerëzve të tillë, në vend që t'u kërkojmë të ndjekin shkollat, t'i orientojmë më mirë të bëjnë nga një kurs që të kualifikohen në zanatin e tyre. Ne tash kemi edhe shkolla teknike ku shokët mund të venë e të kualifikohen, kurse më përpara, kur kishim pak të tilla, puna ishte më ndryshe.

Tani për tani, nuk duhet ngulur këmbë që të mbarojnë të tërë shkollën e mesme. Kulturën e mesme të përgjithshme sigurisht që është mirë ta kenë sa më shumë njerëz. Në të ardhmen njerëzit tanë do ta kenë në masë kulturën e mesme të përgjithshme që do të marrin në shkolla të këtij profili, por do të ketë të tjerë që, edhe pa mbaruar të tilla shkolla të mesme, prapë nuk do të jenë pa kulturë të përgjithshme si, për shembull, specialistët e mesëm, për të cilët do të kemi nevojë. Ata kulturën e përgjithshme do ta marrin si gjatë mësimeve në 8-vjeçare, ashtu edhe në-përmjet formave të shumta dhe nga më të ndryshmet që kemi për këtë qëllim në vendin tonë e që do të shtohen në të ardhmen. Njerëzit ne nuk i dërgojmë në shkolla sa për të marrë një dëftesë, po për t'u kualifikuar, për të rritur më tej aftësitë e tyre për punë.

Po ta bëjmë të qartë këtë qëllim të shkollës, do të kemi përfitim shumë të madh. Në këtë vështrim edhe kualifikimi që arrihet me ndjekjen e një kursi është kulturë.

Sipas mendimit tim, kultura e një njeriu nuk mund të përcaktohet vetëm me disa dijeni të cekëta, si bie fjala të mbash mend kur vdiq Luigji i 15-të, kur jetoi Rosini ose Molieri dhe çfarë kanë bërë këta, që fundja, edhe po të mos i dimë, nuk prishet ndonjë punë. Sigurisht që prodhimit i shërben më shumë kultura teknike, prandaj, pa nënveftësuar aspak kulturën e përgjithshme që duhet të ketë njeriu ynë, mendoj që këtë problem ta shikojmë mirë dhe t'i kombinojmë sa më drejt të dyja këto forma për t'i shërbyer sa më mirë çështjes sonë.

Përveç kujdesit për të punuar në mënyrë më specifike, për edukimin e klasës punëtore nga ana e Partisë, mendoj që kontrolllet punëtore të mos ia lëmë spontaneitetit. Me këtë nuk dua të them se deri tanë ka vepruar spontaneiteti. Çështja është që këtë detyrë ta përmirësojmë gjithnjë e më shumë dhe interesimin e aktivizimin e klasës punëtore, për të kontrolluar zbatimin e direktivave të Partisë, ta vëmë në një rrugë akoma më të mirë.

Ka shumë probleme shoqërore për të cilat klasa punëtore, me luftën e saj të përditshme, është në gjenje të japë mendime dhe të nxjerrë konkluzione. Por këto konkluzione, mendoj unë, do të jenë edhe më të mira, më të bazuara, do të bëjnë më shumë efekt politikisht dhe ideologjikisht jo vetëm në administratë, po sidomos mbi njerëzit në të cilët ushtrohet

kontrolli, kur ekipet me punëtorë të jenë të përgatitur si duhet. Këtu nuk është çështja që ata të cilët do të kontrollojnë një shkollë, duhet t'i dinë lëndët mësimore, kiminë, fizikën, zhvillimin e përgjithshëm të rrymave të letërsisë e të artit etj., etj., njëloj si mësuesit e lëndëve përkatëse. Çështja është që anëtarët e ekipit të kontrollit punëtor, para se të nisen për të kontrolluar disa çështje shoqërore, të vihen mirë në dijeni mbi gjendjen reale të objektit që do të kontrollojnë. Kështu, për shembull, në rast se do të lindë nevoja të shkohet në një shkollë për të kontrolluar përse nuk frekuentohet ajo si duhet, të mos arrihet shpejt e shpejt në përfundimin se fajin e kanë vetëm studentët ose nxënësit. Një konkluzion i tillë nuk do të ishte i plotë edhe sikur të shkohet posaçërisht përkëtë çështje. Prandaj mendoj që punëtorët të orientohen më parë se ç'probleme do të shikojnë dhe si paraqitet situata në shkollë, që të jenë pastaj në gjendje ta vënë atë në vend si duhet.

Kontrolli punëtor në shkollë mund të jetë për një problem të përgjithshëm e nga të gjitha anët, por mund të jetë edhe special, ta zëmë vetëm për mësuesit dhe profesorët. Në këtë rast ai, natyrisht nuk mund të mos prekë edhe nxënësit, por ekipit t'i bëhet e qartë se shkon kryesisht për personelin mësimor. Një gjë e tillë t'u shpjegohet mirë anëtarëve të ekipit, pse ndër ta mund të ketë njerëz që, duke pasur njohuri të plota mbi problemin që kontrollojnë, janë në gjendje të nxjerrin në pah të metat e vështirësitet, cilat janë shkaqet e tyre dhe ç'masa duhen marrë, por ka të tjera që, për mungesë kulture apo stili e metode, nuk

janë në gjendje të kontrollojnë, prandaj më parë duhen orientuar e instruktuar mirë. Veç, kur ta bëjmë këtë punë, të mos e çorientojmë klasën punëtore, sidomos anëtarët e ekipit, duke i ngarkuar me shumë çështje për të parë, aq më tepër kur problemet e shkollës nuk njihen sa duhet prej tyre. Rëndësi ka çështja që me punën e tyre ata të arrijnë të çojnë në shkollë fryshtë e klasës për disa probleme kapitale, të cilave ata ua dinë edhe qoshet, sepse, para se të nisen për kontroll, janë instruktuar, kanë bërë një debat të thellë midis tyre, janë sinjalizuar në ç'drejtëm të kontrollojnë etj.

Po të jetë se ka të dhëna që në shkollë shkelet, fjala vjen, disiplina proletare, anëtarët e ekipit e shtrojnë problemin në fryshtë e klasës dhe kujdesen të mos lejojnë që t'i hidhet ujë verës nga ana e personelit, duke u përpjekur për justifikim të zgjerojen në çështje të tjera, të largohen nga thelbi i çështjes, të thonë, për shembull, se edhe nxënësit janë të parë disiplinuar, sillen kështu, vallëzojnë ashtu etj., etj. Anëtarët e ekipit të kontrollit në këtë rast u vënë kufi prirjeve e orvatjeve për justifikim, flasin prerë se nuk kanë shkuar për nxënësit, po për të parë thyerjet e disiplinës nga ana e mësuesve e profesorëve, ose për t'u vënë këtyre në dukje se nuk po zbatojnë këtë ose atë metodë, apo stil të përshtatshëm pune, se nuk i bëjnë interesante mësimet etj. Me një fjalë, punëtorët ngarkohen të ndjekin probleme të caktuara, të veçanta, të cilat i analizojnë dhe dalin në përfundim të punës së tyre me konkluzione serioze, që i referohen Partisë ose Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, që në këtë

rast mund ta ketë kërkuar edhe vetë ndihmën e Partisë dhe të klasës punëtore në Tiranë, ose në qytete dhe në rrethe të tjera. Ministria i publikon këto probleme, duke dërguar një qarkore në të gjitha shkollat e republikës, me anën e së cilës bën të ditur se klasa punëtore, gjatë kontrollit të vet, ka konstatuar se ekziston ky ose ai problem në shkolla, se direktivat e Partisë shkelen nga personeli shkollor etj., prandaj të punohet me kujdes për zhdukjen e dobësive që ajo ka konstatuar.

Le të vijmë tani te nxënësit dhe studentët. Edhe kur ka të dhëna se një pjesë e këtyre nuk frekuentojnë rregullisht shkollat ose janë të padisiplinuar etj., etj., anëtarët e grupit të kontrollit punëtor, para se të nisen për një çështje të tillë, vihen mirë në dijeni për gjendjen dhe përgatiten për kontroll, jo vetëm me synimin për të parë anët e zeza, por edhe të mirat, nga të cilat ka shumë kudo. Kurdoherë të mos harrojmë, shokë, që të mos biem në pozitat e atyre që përpiken të vënë në dukje vetëm anët negative të nxënësve apo studentëve, duke u hedhur atyre tërë fajin. Edhe në rast se del nevoja t'i kritikojmë të rinjtë e të rejat për ato që u përkasin atyre dhe për aq sa kanë, të bëhet edhe kjo, por njëkohësisht të lavdërohen ata për anët pozitive. Kështu duhet vepruar edhe përmësuesit, të cilët të kritikohen për dobësitë, po edhe të lavdërohen për punët e mira. Klasa punëtore të shfrytëzojë të dyja mundësitë: edhe lavdërimet edhe qortimet. Veç të kihet parasysh që, kur kontrolli bëhet për të parë punën e nxënësve e të studentëve, këta të mos kritikohen në masë të gjithë për dobësitë

që konstatohen te disa prej tyre, po të kritikohen vetëm ajo pjesë që i ka këto dobësi. Të rinxje e të rejave t'u flitet hapur, po duke pasur parasysh që janë pa eksperiencë, të këshillohen me durimin dhe zemërgjerësinë e madhe të klasës e në mënyrë shumë shoqërore. Tjetër qëndrim duhet mbajtur me drejtoret, mësuesit, profesorët, apo me anëtarët e Partisë. Kur është nevoja me këta të flitet më ashpër. Të gjitha këto forma e metoda pune, me gjithë brendinë e tyre, duhet t'ia themi klasës.

Partia të mos shkojë nga parimi se klasa punëtore (dhe këtu e kam fjalën për grupet e punëtorëve që dërgohen për kontroll) i di të gjitha këto çështje. Duke pasur parasysh se punëtorët nuk është e mundur të dinë çdo gjë, kur ndërmarrim të kryejmë në rrugën që thashë një detyrë kaq të rëndësishme partie, ne zbatojmë me të vërtetë një direktivë bazë të Partisë, e kalitim dhe e përgatitshmë klasën punëtore për udhëheqje. Kësaj i thonë që klasa punëtore të marrë dijeni për të tëra problemet e jetës së vendit, për zgjidhjen e tyre, për zbatimin e direktivave, të dijë ku janë përparimet, ku janë vështirësitë dhe të metat. Kështu e mësojmë si duhet klasën, i themi kësaj të shikojë se cili është arsimi dhe të njihet me të, të krijojë bindje se ky sektor nuk është i pakapshëm nga klasa punëtore, se nuk është një fushë e pashkelur dhe vetëm pronë e intelektualëve. Në asnjë mënyrë jo! Kështu të veprohet edhe për tregtinë, e cila nuk është një fushë vetëm e shitësve. Sado me ndërgjegje të lartë që të janë këta, grapi i kontrollit punëtor të ketë parasysh se, midis punonjësve të këtij sektori,

ka edhe elementë të pandërgjegjshëm. Veç kësaj, qëllimi nuk është vetëm që të zhdukim në këtë sektor vjedhjet e shpërdorimet, por, me anë të kontrollit punëtor, t'i japim një zhvillim dhe përparim akoma më të madh tregtisë, ta bëjmë atë të kulturuar, të zhvillojmë tek të gjithë një shije akoma më të bukur socialistë. Dhe, që të arrihen këta objektiva nga ana e klasës punëtore, kjo duhet ta njoftë këtë sektor.

Çfarë bëjmë ne duke vepruar në këtë mënyrë? Edukojmë një mori njerëzish, natyrisht jo tërë klasën, por grupe aktivistësh të ndryshëm të klasës, për sektorë të veçantë, të cilët jo vetëm që do të vënë në vend çdo gjë që nuk ecën, por, duke pasur kontakte me klasën, me shokët e tyre, do të edukojnë edhe të tjerët. Prandaj në këtë drejtim të rekomandojmë që anëtarët e ekipeve të kontrollit punëtor të mos e konsiderojnë të mbaruar detyrën vetëm me vajtjen për kontroll në shkollë, në tregti, në administratë e kudo, duke u kufizuar vetëm me dhënie udhëzimesh, apo duke vajtur qoftë edhe në Ministrinë e Tregtisë për të kërkuar nga ministri¹ që t'i zbatojë mirë detyrat që i ka ngarkuar Partia. Në rast se anëtarët e ekipit janë punëtorë, ta zëmë të uzinës «Partizani», kur të kthe-

1. Një grup i kontrollit punëtor kishte shkuar tek ish-ministri i Tregtisë Kiço Ngjela, i cili në fillim me mendjemadhësi e prepotencë u kishte thënë punëtorëve: «Pse nuk bëni dyqane, por vini e kontrolloni tregtinë» (?!). Por punëtorët iu përgjigjën atij prerë: «S'kemi ardhur për të bërë dyqane, kjo është detyra juaj, por kemi ardhur t'ju kontrollojmë se si i zbatoni detyrat». Ish-ministri u detyrua të bëjë autokritikë. Koha tregoi se ai ishte armik i kamufluar.

hen në uzinë ata mund të mbledhin kolektivin, ta informojnë këtë se për dobësitë e konstatuara në tregti, ata i kanë tërhequr vëmendjen ministrit të tregtisë dhe t'i shpjegojnë fije e për pe si i kanë kontrolluar disa nga njësitë tregtare, në ç'gjendje i kanë gjetur dobësitë e të metat që konstatuan dhe si i vunë në vend etj. Atëherë zhvillohet në uzinë një debat parimor, politik dhe ideologjik, jo në baza thashethemesh. Gjatë debateve mund të dalin akoma vërejtje të reja për tregtinë, pse të tilla dobësi kanë konstatuar edhe punëtorë të tjerë në këtë ose në atë dyqan. Kështu nxitet një luftë mendimesh në uzinën «Partizani» dhe, më së fundi, nga organizata-bazë e Partisë që ka të qartë direktivën e Partisë dhe udhëzimet e komitetit të Partisë, merret me iniciativë një vendim për të organizuar ekipe me njerëzit më të mirë dhe me eksperiencë të kolektivit, duke përfshirë edhe nga ata që diskutuan me baza në këtë mbledhje, dhe lajmërohet pastaj kjo ose ajo ndërmarrje e tregtisë se në një datë të caktuar ata do të venë për kontroll, pasi në kolektivin e tyre u diskutua se në këtë ose në atë ndërmarrje të tregtisë ekzistojnë hatëre, sjellje jo të mira me popullin, shpërdorime etj. Dhe këtu dalim te ajo që u tha këtu nga shoku Hysni, tek iniciativa dhe vëtëveprimi. Kështu, pas këtij debati, nga kjo uzinë mund të organizohen pesë, gjashtë, shtatë grupe kontrolli. Këtë e kap menjëherë organizata e Partisë, i ndihmon e i frymëzon këta, aktivizon në këtë punë edhe bashkimet profesionale dhe kështu, pasi bëhet një punë përgatitore e menduar mirë, grupet nisen për kontroll.

Në këtë formë dhe mënyrë, mendoj unë, duhen edukuar njerëzit e klasës. Sigurisht, duke pasur para-sysht këto orientime dhe caqe që kërkojmë të realizohen, ato nuk mund t'i arrijmë as për një vit as për dy vjet me njerëzit e klasës, sepse ne kemi shokë që kanë një eksperiencë të gjatë drejtimi nga 20-25 vjet me radhë, qoftë në punën e Partisë, qoftë në atë të pushtetit, dhe, megjithëse kanë fituar eksperiencë të madhe, prapëseprapë, nganjëherë nuk i kapin dot si duhet të tëra çështjet. Prandaj të jemi të ndërgjegj-shëm dhe të mos kërkojmë nga një punëtor që të jetë eflatun. Rëndësi ka çështja që në këtë rrugë të më-sojmë gjithë njerëzit që t'i kuptojnë mirë mësimet e Partisë mbi kontrollin punëtor, t'i kuptojnë drejt qëllimet përse venë këto grupe punëtorësh dhe ku janë synimet e Partisë.

Të gjithë duhet ta kenë të qartë se qëllimi i madh i Partisë, që nxit dhe organizon kontrollin e klasës punëtore, në radhë të parë, është që të edukojë klasën punëtore për rolin e vet udhiheqës. Prandaj njerëzit që i nënshtrohen kontrollit të klasës, duhet të karakterizohen nga vullneti i mirë, t'i presin punëtorët me sinqeritet dhe t'i ndihmojnë në kryerjen e detyrës së ngarkuar, sepse në atë punë ndonjëri mund të mos jetë kompetent. Në këtë rast ata s'duhet të zemërohen kur kontrollohen, në qoftë se do ta kenë të qartë qëllimin e madh të kësaj pune.

Këta njerëz të klasës do t'i edukojë Partia, dhe kur themi Partia, kuptojmë komunistët. Në këtë punë duhet të përfshihen edhe ata që s'janë në Parti, por që janë patriotë, prandaj të gjithë e kemi për detyrë

t'i edukojmë. Të marrim një drejtor shkolle me një eksperiencë të gjatë 40-vjeçare në punë. Si njeri politik, ky e di që klasa punëtore është në fuqi në vendin tonë, pse pa këtë edhe vetë ai, personalisht, nuk do të ishte gjë, pasi e mban mend fort mirë se si në kohën e Zogut, edhe ata që ishin në marrëdhënie pune, rrjinin muaj me radhë pa marrë rrogën, përveç gjithë poshtërsive të tjera që regjimi bënte nibi kurri zë popullit dhe të atij vetë. Ky njeri me eksperiencë dhe pjekuri të madhe duhet të ketë parasysh se një e re ose i ri punëtor që punon në torno dhe është caktuar për kontroll, nuk mund ta ketë eksperiencën e tij, prandaj të ketë durim të madh me ta. Këtë edukatë Partia duhet t'ua futë në gjak të gjithëve, kudo që punojnë. Kur atyre t'u vejë kontrolli punëtor, të shohin e të kuptojnë drejt qëllimin e madh të kësaj pune, të zhdukin sa të jetë e mundur më shumë në veten e tyre ndjenjat mikroborgjeze të fshehjes së gabimeve, mendjemadhësisë, besimin e tepruar e mbivlerësimin e vetes dhe ndjenjën e nënvleftësimit të kontrolluesve, se në punët «e tyre» po u futen ca njerëz «inkompetentë», kurse këta janë njerëzit e klasës. Të gjithë e kanë për detyrë t'i edukojnë ata që s'e kanë eksperiencën e tyre, t'i edukojnë me zotësi nëpërmjet sukseseve dhe gabimeve të tyre. Në këtë rrugë duhet të ecim ne, shokë, dhe Partia punon e duhet të punojë vazhdimisht në këtë drejtim.

Mua më duket se të gjitha këto çështje që u ngritën këtu janë probleme të rëndësishme dhe qëndrojnë. Vihet re se ka përparime, ka luftë dhe përpjekje, po ka edhe të meta dhe kjo është e kuptueshme, prandaj

në këtë drejtim më duket se nuk kemi çfarë të shtojmë. Në materialin që na është paraqitur janë thënë të gjitha. Bile në këtë material janë dhënë edhe udhëzime, këshilla e orientime të Partisë për këto çështje. Tani të përpinqemi që edhe për këto probleme, Partinë ta bëjmë sa më luftarake për t'i zbatuar mirë dhe me sukses detyrat e mëdha që na presin.

Edhe unë jam dakord me mendimin e shokut Ramiz, që ky material t'u dërgohet komiteteve të Partisë të rretheve. Mirë është që ju shokët e shtypit, për disa nga këto probleme që janë më të rëndësishme, të shkruani disa artikuj, duke gjetur format e mënyrat e përshtatshme dhe jo në format e zakonshme që botohen vazhdimisht nga disa sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve dhe kuadro. Duhet përpjekur që artikujt të bëhen sa më tërheqës, që të këndohen me kujdes dhe me dëshirë nga lexuesit. Ka shumë probleme të tillë që Partia duhet t'i trajtojë në shtyp më me seriozitet.

Mua më duket se si kuadrot që shkruajnë në shtyp, edhe gazetarët, kanë mundësi t'i trajtojnë problemet e rëndësishme që preokupojnë Partinë në forma të ndryshme e tërheqëse. Mirëpo konstatojmë se problemet në shtyp, në më të shumtën e herës, nuk trajtohen kështu; ato shpesh mbyten me fraza dhe fjalë të panevojshme e të përsëritura që njerëzit kanë lexuar vazhdimisht, prandaj gjatë leximit cilido e merr me mend çfarë do të thuhet më poshtë. Kështu lexuesit mërziten dhe nuk u shkojnë artikujve deri në fund. Ju shokët e shtypit duhet të luftoni shumë që çdo artikull të jetë interesant e tërheqës. Mbase ky kon-

statim bie më shumë në sytë tanë që jemi në dijeni të problemeve që shtrojmë dhe diskutojmë vazhdimisht, ndërsa te lexuesit e tjerë më pak. Megjithatë shokët që lidhen direkt me bazën, me klasën punëtore e me masat punonjëse në përgjithësi, duhet të interesohen konkretisht dhe t'i pyesin ata nëse u interesojnë problemet që rrihen në shtypin tonë apo jo dhe përçfarë kanë nevojë më shumë që të ndihmohen.

Mendoj që në organizatat-bazë të Partisë, ku dalin shumë probleme, të shohim nëse ka apo jo komunistë që kur ngrihen të diskutojnë, i referohen shtypit apo jo? A thonë për shembull se «gazeta «Zëri i popullit», në filan artikull i fshikullon këto dobësi që vërtetohen edhe te ne, prandaj të marrim masa t'i zhdukim». Me fjalë të tjera, desha të di se kur vjen rasti në punë, ose gjatë mbledhjes së organizatës-bazë kur diskutohet për të tilla probleme, nxjerrin njerëzit disa citate nga artikuj të rëndësishëm që kanë dalë një apo dy muaj përpara në «Zërin e popullit», me qëllim që t'i përdorin si material për diskutimin dhe argumentimin e problemeve? Çështja është që orientimet dhe artikujt e «Zërit të popullit» të lënë mbresa të thella politike, ideologjike dhe teknike në kokën e njerëzve tanë, të cilët të ngrihen në mbledhjen e organizatës së Partisë dhe të thonë që: ««Zëri i popullit» në filan kohë ka thënë kështu ose ashtu në një artikull të tij». Këtë synim duhet ta kemi dhe, në këtë drejtim, shokët e shtypit të bëjnë më shumë përpjekje. Pra rëndësi ka fakti se a lexohen gazetat nga njerëzit tanë dhe a përdoren artikujt e shtypit si material për t'u orientuar dhe për të mobilizuar komunistët, kuad-

rot dhe punonjësit në punë, si dhe për t'i ndihmuar ata në zërthimin e detyrave dhe në ndreqjen e të metave? Nuk e kam fjalën për ato organizata në adresë të cilave bëhet kritika, se natyrisht ato diskutojnë, por flas edhe për ato organizata që artikulli nuk i drejtohet direkt.

Gjithashtu, edhe nëpërmjet letrave kemi parë të shkruhet se kjo ose ajo e metë nuk po ndreqet akoma. Por keni vajtur ju në mbledhje të asaj organizate-bazë kur trajtohen këto probleme, për të dëgjuar se si i referohen këtij apo atij artikulli që është botuar dhe t'u thoni pastaj atyre që ankohen me letër, se përsë nuk ngrihen të diskutojnë në mbledhjet e organizatës e të shtrojnë ato çështje që i kanë shkruar gazetës? Ose t'u thuhet këtyre shokëve se «Lidhur me problemin që të preokupon, lexo këtë ose atë artikull të «Zërit të popullit», që është organ i Komitetit Qendror të Partisë!».

Çështja e kontrollit punëtor është një nga parimet më të mira e revolucionare që ka vënë në jetë dhe është duke zhvilluar Partia. Në këtë punë ka suksesë e në të ardhmen me siguri do të ketë suksesë akoma më të mëdha. Ne do të vazhdojmë të ecim rë këtë rrugë dhe klasa punëtore, bashkimet profesionale, me Partinë në krye, do të fitojnë gjithnjë e më shumë eksperiencë edhe në këtë fushë.

Të mos dëshpërohem, shokë, duke thënë se kjo çështje nuk është në rregull, nuk është ashtu si dëshirojmë, se në këtë drejtim ka të meta, pse pavarësisht nga këto, si çdo gjë, dhe kjo do të ecë përpara. Prandaj mendoj se bëmë shumë mirë që e morëm në

shqyrtim këtë çështje në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe s'ka dyshim se ne do ta zhvillojmë më tej këtë punë.

*Botuar për herë të parë me
disa shkurtime në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjalime 1970-1971», Tiranë,
1972, f. 392*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali
i mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

MBI MOSHEN E EFEKTIVIT TË PARTISE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 shtator 1971

Unë jam dakord me studimin e paraqitur nga Institut i Studimeve Marksiste-Leniniste dhe Sektori i Statutit të Partisë pranë Komitetit Qendror. Ky studim do t'i shërbejë përmirësimit të mëtejshëm të të gjithë punës së Partisë në drejtim të përbërjes së saj. Rezultatet e arritura në pranimet në Parti janë inkurajuese. Ato janë rrjedhim i një pune më të kujdeshme që çshëtë bërë dhe i masave më të mira që janë marrë, për të cilat na ka detyruar situata, pse në shtrirjen e forcave të Partisë kishim të pambuluara shumë fshatra. Akoma edhe tani kemi shumë brigada pa komunistë. Me këtë studim me siguri do të bëhen hapa të rinj përpara.

Prandaj studimi e konkluzionet që dalin nga kjo

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rrëth studimit «Mbi moshën e efektivit të Partisë», paraqitur nga Institut i Studimeve Marksiste-Leniniste dhe sektori i Statutit i KQ të PPSH.

analizë e Sekretariatit të Komitetit Qendror t'u dërgohen komiteteve të Partisë në rrethe dhe mbi këtë bazë ato të përcaktojnë zhvillimin normal të Partisë, të orientohen e të ndihmohen prej tyre, si për një punë më të thellë shkencore dhe teorike në të ardhmen. Kjo punë duhet të ndihmojë edhe për një zgjidhje më të mirë në praktikë të problemeve e detyrave që na dalin në fushën e forcimit gjithnjë e më shumë të përbërjes së Partisë. Kjo ka shumë rëndësi.

T'u theksojmë, gjithashtu, komiteteve të Partisë në rrethe dhe organizatave-bazë se këtu nuk është çështja t'u qëndrojmë besnikë pikë për pikë disa orientimeve, të cilat janë të drejta dhe të rëndësishme pse hapin perspektiva për Partinë, duke ruajtur edhe proporcionet e përbërjes së saj, por rëndësi ka gjithashtu çështja që, kur vjen puna e pranimeve në Parti, punë kjo që ka të bëjë me një luftë të përditshme të Partisë, shokët e rretheve të kenë kurdoherë parasysh parimet bazë që duhet të na udhëheqin në këtë punë e që Partia jonë i ka theksuar vazhdimisht. Mbi të gjitha të mbahet kurdoherë parasysh cilësia e atyre që pranohen sipas kërkesave të Statutit të Partisë. Në këtë mënyrë çështja e madhe e shtimit të radhëve të Partisë dhe e forcimit të vazhdueshëm të përbërjes së saj do të drejtohet shkencërisht dhe nuk do t'i lihet spontaneitetit, ashtu sikurse nuk i është lënë as deri sot.

Unë mendoj që komitetet e Partisë të ndjekin më konkretisht e më nga afër çështjen e shtrirjes së Partisë dhe të shpërndarjes së forcave të saj. Për këtë ata duhet të kenë një për një në çdo organizatë-bazë një orientim mbi gjendjen dhe zhvillimin e saj perspektiv,

kryesisht në sektorët e prodhimit, duke u mbështetur në vetë përbërjen e organizatës-bazë, në numrin e punëtorëve, të kooperativistëve, në bazë të seksit dhe të grup-moshave. Këtë e them jo se shokët e bazës deri tani kanë ecur në tym dhe pa gjykim, por ka raste që nuk u kanë vënë sa duhet kujdesin e duhur këtyre problemeve. Fakt është se në shumë organizata-bazë ka teprime ose boshllëqe për këtë ose atë çështje që ka të bëjë me shtimin e radhëve të Partisë. Kështu, ka organizata-bazë të mëdha që pranojnë pak të rinj, ka të tjera që pranojnë pa kurrfarë kontrolli shumë nëpunës, gjë që nuk duhet ta bëjnë, ka gjithashtu disa organizata-bazë që mbajnë qëndrime sektare në pranimin e punëtorëve të rinj, ose që pranojnë elementë të rinj në një ndërmarrje, e cila nuk ka fare nevojë për rritjen e Partisë as si sasi punonjësish as nga pikëpamja e rëndësisë ekonomike të qendrës së prodhimit, as nga pikëpamja cilësore, duke quajtur punëtorë ata që në fakt nuk janë akoma të tillë.

Mënyra se si pranohen anëtarët e Partisë, për shembull në tregti, unë mendoj se lë shumë për të dëshiruar. Kjo mënyrë mund të lërë shumë për të dëshiruar gjithashtu edhe në një ndërmarrje të mirë mekanike, në qoftë se atje organizata-bazë pranon shumë më tepër komunistë nga sa ka nevojë ndërmarrja. Mundet që një ndërmarrje të ketë më pak nevojë nga sa ka pranuar, mirëpo organizata-bazë që ka pranuar më shumë komunistë nga sa nevojiten për ndërmarrjen ku ajo vepron, ka menduar vallë ndonjëherë t'i destinojë ata për të plotësuar nevojat e organizatave të tjera në qendra pune të reja që do të krijohen? Mua

më duket se nuk shkohet shumë nga ky parim, nuk punohet me perspektivë në këtë drejtim, prandaj edhe kur vjen çështja që disave nga këta anëtarë partie që janë plus në një ndërmarrje, u bëhet thirrje të shkojnë për të punuar në një vend tjeter ku ndihet më shumë nevoja, ka prej tyre që hezitojnë. Në këtë çështje, komitetet e Partisë të rretheve u bie detyra të bëjnë një punë më me perspektivë dhe t'i orientojnë më mirë organizatat-bazë.

Kur them që komitetet e Partisë të rretheve duhet t'i kenë mirë parasysh çështjet që përmenda, që llimi është që këto parime t'u bëhen të qarta nga ana e tyre organizatave-bazë. Duke njojur mirë normat e Partisë, cilësitet që duhet të ketë anëtarë i Partisë, kur një organizatë-bazë partie, për shembull, në një kooperativë të bashkuar, ka mbetur deri tanë me elementë të një fisi, atëherë komiteti i Partisë i rrethit duhet t'ia ngrejë kësaj organizate problemin dhe të vendosë që në radhët e saj të pranohen komunistë edhe nga fise të tjera të fshatit. Ose në qoftë se shihet që një organizatë tjetër e kooperativës së bashkuar ka bërë shumë pranime, ndërsa tjetra nuk ka bërë fare, kjo tregon se as organizata-bazë dhe as komiteti i Partisë nuk e kanë drejtuar mirë këtë problem. Për këto arsyen, komiteti i Partisë vendos që për një kohë të mos pranohet më asnjeri në atë organizatë, por pranime të ketë nga organizatat e atyre fshatrave ose brigadave ku s'ka komunistë ose ka nga këta në numër jo të mjaftueshëm. Në këtë mënyrë do të luftohet më mirë që organizatat e Partisë të ngrihen në bazë brigadash sipas orientimeve që janë dhënë dhe do të luftohet

që përbërja e saj të mos jetë me elementë vetëm të një fisi. Në një organizatë tjetër ku mund të ketë pak të reja, atje duhet të bëhen përpjekje për t'i vënë rëndësi grup-moshave dhe shtimit të radhëve të organizatës-bazë me të reja. Në një ndërmarrje ku ka shumë komunistë, apo në administratë, duhen bërë pak pranime. Natyrisht edhe në këto raste duhet orientuar drejt kush do të jenë këta të paktë dhe cilët elementë do të sakrifikohen, ata që kanë pjekuri, apo njerëz të moshës së re. Në qoftë se në një organizatë-bazë partie, fjala vjen, ka shumë komunistë me stazh të vjetër në Parti, këtu duhen bërë më shumë përpjekje për të futur elementë të rinj në Parti. Mirëpo si kandidat i mundshëm për në Parti aty mund të jetë edhe një tjetër element më i madh nga mosha, i pjekur dhe si formim ndoshta më i mirë se një e re. Në këto dy raste, sigurisht për të futur në Parti duhet zgjedhur i riu, sepse organizata duhet të synojë të ardhmen. Është e kuptueshme se duke mbajtur parasysh të gjitha cilësitë e tjera që Komiteti Qendror i ka përsëritur shpesh në orientimet e veta të herëpashershme, pikërisht këto probleme, sipas rastif, duhen studiuar me kujdes pastaj të vendoset drejt.

Unë mendoj që procesi i pranimit të shoqeve në Parti duhet të vazhdojë me ritmin e viteve të fundit. Ne duhet të përpinqemi që edhe gjatë këtij pesëvjeçari të rritet akoma ndoshta edhe 10 për qind numri i grave të moshave të reja në Parti, me qëllim që në përgjithësi deri në vitin 1975 gratë të zënë deri në 30 për qind të të gjithë efektivit të Partisë. Është tjetër punë orientimi që duhet të japim për sa i përket pro-

porcionit që duhet pasur parasysh për pranimin e grave punëtore, fshatare etj.

Studimi që na paraqitet për grup-moshat, megjithëse ka rëndësi të madhe, nuk e trajton problemin e shtrirjes së Partisë jo vetëm për periudhën e tanishme, por as në perspektivë. Si do të zhvillohet vallë shtrirja e Partisë kur popullsia e vendit tonë në vitin 1980 do të arrijë rrëth tre milionë banorë? Ku do të shkojnë për të punuar gjithë këta njerëz të rinj që shtohen? Ku do ta zhvillojnë ata aktivitetin? Këto janë probleme me rëndësi të madhe edhe për Partinë, për përpunimin e orientimeve që duhen dhënë për shtrirjen e saj. Me një fjalë, në këtë studim duhej parë afërsisht se ku do të na shtohen më shumë organizatat-bazë, në qytete, në uzina e fabrika, apo në fshatra? Do të na ndryshojnë proporcionet apo jo? Prandaj t'i shikojmë edhe këto probleme, sepse themi që ta ruajmë rritjen e përqindjes së klasës punëtore, por gjithë ata njerëz që do të na shtohen, në cilat qendra prodhimi do të drejtohen të punojnë? Pikërisht mbi këtë bazë duhet të parashikojmë ne edhe shtrirjen e Partisë, të cilën do ta ndërtojmë sipas paramit të njohur të prodhimit, por edhe të numrit të popullsisë. Lidhur me këtë të kemi parasysh proporcionet sipas situatave që do të krijohen edhe për sa i përket përbërjes burra-gra, sido që vetë natyra ka njëfarë rregullariteti në lindjet meshkuj-femra, po në zhvillimin e shoqërisë nuk mund të bëhen ndryshime brenda 10 vjetëve, megjithatë në këtë drejtim, ne mund ta kemi një parashikim. Orientimi për sa u përket grup-moshave ka rëndësi, po kurdoherë ky është

vetëm orientim, se që t'u caktojmë komitetete të Partisë shifrat, duke u thënë të pranohen medoemos kaq ose aq veta çdo vit, këtë mendoj në asnje mënyrë të mos e bëjmë.

Për sa u takon shokëve të zgjedhur në forumet drejtuese të Partisë, në parim e në praktikë, ne nuk u themi organizatave-bazë që të zgjedhin në udhëheqje komunistë të kësaj ose asaj moshe, por i orientojmë që në to të vijnë njerëz të sprovuar, të pjekur dhe për këtë u japim disa udhëzime. Por, në udhëheqje duhet të vijnë edhe të rinj, të cilët e kemi përdetyrë t'i përgatitim. Ky është orientim i drejtë që kuptohet fare mirë nga Partia. Ndonjëherë edhe është shkelur ky orientim, por megjithatë nuk është shkaktuarasnijë shqetësim. Në fakt është me vend që komunistët 35-vjeçarë janë zgjedhur në udhëheqje, se 26-vjeçarët, në përgjithësi, vetëm pak kohë më parë janë futur në Parti dhe akoma nuk kanë përvojën e duhur. Në plenum mund të zgjidhen dy ose tre veta kur janë edhe në moshën 26 vjeç, por jo aq shumë, siç u përmend një rast këtu. Pra, ne nuk themi kurssesi që të mos zgjidhen elementë të rinj në udhëheqje, kur ata e meritojnë. Në qoftë se do të vijnë 2-3 ose 4 për qind më shumë ose më pak, kjo jo vetëm nuk përbën ndonjë problem, por është normale. Është e qartë se janë rrethanat që e vendosin këtë, por zakonisht udhëheqja duhet të jetë më e moshuar, më e pjekur, më me përvojë.

Studimi që morëm në shqyrtim është i mirë dhe jam dakord me përbajtjen e tij, prandaj mendoj që t'u dërgohet komitetete të Partisë të rretheve, me që-

llim që bazës t'ia freskojmë edhe një herë këto probleme dhe t'i ketë parasysh si orientime përmirësimin e mëtejshëm të përbërjes së Partisë në të ardhmen.

*Botuar për herë të parë,
me ndonjë shkurtim, në li-
brin: Enver Hoxha, «Ra-
porte e fjalime, 1970-1971»,
Tiranë, 1972, f. 404*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali
i mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

SHEMBULL I LARTE FRYMËZIMI PËR CILINDO

*Letër drejtuar Heroit të Punës Socialiste
Shyqyri Kanapari*

21 shtator 1971

I dashur Shyqyri,

Letra që më dërgove zgjoi në kujtesën time jehonën e atyre ditëve kur zotimi yt i guximshëm u bë i njohur në të gjitha anët e vendit tonë. Partia kishte besim dhe priste që një ditë të njoftohej për zbatimin e këtij zotimi. Dhe ja, kjo ditë erdhi. Ti na dhe një lajm gazmor, që na e bën zemrën mal: me të njëjtin traktor realizove jo 8 000 hektarë unitet hamullor, sa u zotove në fillim, as aq sa u zotove më vonë, por 30 450 hektarë dhe do të vazhdosh të punosh akoma duke i zgjatur sa më shumë jetën traktorit. Të përqafoj e të përgëzoj nga zemra për këtë sukses të rëndësishëm.

Duke menduar për t'iu përgjigjur letrës tënde, më del përpara figura e dashur e traktoristit, përfaqësuesit të klasës punëtore në fshat, shok pune i kooperativistëve, që lufton pa u lodhur ditën dhe natën, duke

çarë e lëvruar fushat tona, duke shpyllëzuar e çelur toka të reja, që mendja dhe duart e arta të punonjësve tanë i bëjnë të gjelbërojnë e të lulëzojnë nga prodhimet bujqësore çdo vit e më të mëdha. I tillë je edhe ti, shoku i dashur Shyqyri, traktoristi ynë i respektuar, Heroi i Punës Socialiste, që fjalët nuk i ndan nga veprat, që ndodhesh gjithmonë mbi timonin e traktorit, të cilin e do aq shumë dhe e ruan si dritën e syve.

Puna jote e lavdërueshme, guximi për të marrë zotime revolucionare, besa për të mbajtur fjalën e dhënë, thjeshtësia dhe urtësia, vendosmëria dhe optimizmi për të ecur përpara e për të korrur kurdoherë suksese të reja, — të gjitha këto janë një shembull i lartë frymëzimi për cilindo, por sidomos për traktoristët tanë, të cilët kanë q'të mësojnë nga ti, nga cilësitë e karakterit tënd e të shokëve si ti, si Budo Isufi, Ibrahim Hidri e të tjerë, nga vrulli juaj revolucionar, nga eksperiencia juaj e pasur.

Të uroj shëndet e suksese të reja në punë ty dhe gjithë traktoristëve të tjerë për të mirën e popullit tonë të mrekullueshëm, për begatinë dhe çelikosjen e atdheut tonë socialist, për t'i pritur duarplot e ballëlart 30-vjetorin e Themelimit të Partisë dhe Kongresin e 6-të të saj.

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popu-
llit», nr. 226 (7203), 22
shtator 1971*

*Botohet sipas gazetës «Zëri i
popullit», nr. 226 (7203), 22
shtator 1971*

PËR FORCIMIN E DISIPLINËS PROLETARE NË PUNË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

22 shtator 1971

Mua më duket se u ngritën drejt çështjet lidhur me problemin që po shqyrtojmë, të cilin ne nuk e diskutojmë sot për herë të parë. Partia atë e ka ngritur vazhdimesht edhe herë të tjera si në Byronë Politike, ashtu edhe në Qeveri e kudo. Në plotësimin e planit të asortimenteve dhe të cilësisë së mallrave të konsumit të gjerë në industrinë e lehtë dhe ushqimore, në sajë të punës së mirë të punonjësve të ndërmarrjeve të këtij sektori të industrisë, të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, të Ministrisë së Industrisë e të Minierave etj., janë arritur suksese, janë bërë mjaft përparime. Por sukseset nuk duhet të na

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave «Mbi plotësimin e planit të asortimenteve dhe të cilësisë së artikujve të konsumit të gjerë në industrinë e lehtë e ushqimore dhe masat që duhen marrë».

bëjnë që të mbyllim sytë dhe të mos shikojmë të metat e shumta që ekzistojnë akoma, sidomos në organizim, në disiplinë dhe në realizimin si duhet të planeve në të gjithë treguesit.

Ti Koço [Theodhos] na fole për të gjitha gjërat, por tani duam që ato t'i zbatoni e të mos mbeten fjalë, që njerëzit, byrotë teknike e çdo hallkë tjetër, të aktivizohen dhe kështu situata të përmirësohet sa më parë. E them këtë sepse kemi një eksperiencë të hidhur në disa raste, duke sjellë makineri që kushtojnë shtrenjtë dhe na është dashur të ndërhyjmë kush e di sa herë e megjithatë akoma nuk janë vënë në funksionim. Unë nuk kënaqem me lugë të zbrazët, duke u mjaftuar vetëm me atë që thoni se «kemi filluar». Për shembull, për rafinimin e vajit, na the se keni nisur ta bëni që në fillim të vitit, por veç kanë kaluar 8 muaj dhe akoma nuk keni arritur ta rafinoni të gjithë.

Në qoftë se e lëmë sipas dëshirës së disave dhe të vazhdojmë t'i japim popullit vaj të parafinuar, kjo nuk është e drejtë. Pse i bëni punët të shpërndara e i zvarritni, duke ngritur një repart rafinimi sot në Rogozhinë, nesër një tjetër në Fier e më vonë në vende të tjera. Kur themi që gjithë vajin duhet ta rafinojmë, të marrim masa dhe ta bëjmë gjer në fund këtë punë.

Kështu si e keni filluar ju ka rrezik të mos arrijë të rafinohet i téri as gjer në fund të vitit që vjen. Kur është çështja për nevoja të popullit duhet të lëmë diçka tjetër për më vonë dhe të bëhet kjo. Kur marrim vendime, e kemi detyrë t'i shpiem këto gjer në fund. Secili të kryejë detyrën që i takon.

Këto të meta nuk i vëmë re vetëm në sektorin e industrisë së lehtë dhe të asaj ushqimore, por në përgjithësi në tërë industrinë, në të gjitha degët e tjera të ekonomisë sonë dhe kudo gjetkë.

Prandaj në lidhje me problemin e forcimit të mëtejshëm të organizimit dhe sidomos të disiplinës proletare në punë, mendoj se është e nevojshme që Partia dhe organet shtetërore, në bashkëpunim me specialistët, të studiojnë, të hartojnë dhe të na paraqitin për aprovim vendosjen e disa normave më të rrepta që do të gjykohen të drejta dhe në favor të mbrojtjes së disiplinës në punë. Një nevojë e tillë duhet të zgjidhet, pse me gjithë punën e gjithanshme edukative që zhvillohet, propaganda e Partisë nuk po e bën efektin e duhur në disa njerëz, të cilët vazhdojnë të shkelin normat e Partisë, disiplinën shtetërore në punë, disiplinën teknike etj. Një gjendje e tillë vazhdon, mendoj unë, pse krahas punës edukative, sipas shkallës së shkeljeve, nuk merren edhe disa sanksione ekonomike për mbrojtjen e pasurisë socialiste, për zbatimin e normave, të rregullave, të teknologjisë, të standardeve në prodhim etj. Pa e mbështetur punën propagandistike edhe me masa të atilla që do ta rritin përgjegjësinë në punë, organizimin dhe kontrollin, nc nuk do ta vëmë dot në rrugën që duhet këtë çështje kaq të rëndësishme.

Aktualisht ne kemi në fuqi Kodin e Punës dhe një sërë aktesh të tjera ligjore që rregullojnë disiplinën në punë, që në përgjithësi janë të drejta, por që nuk zbatohen plotësisht. Ndoshta këto norma ligjore janë të pamjaftueshme dhe unë propozoj që t'i rishikojmë dhe, po të jetë nevoja, të bëjmë përmirësimet përkak-

tëse në mënyrë më të detajuar për t'i caktuar drejt disa masa ndaj atyre punonjësve që bëjnë shkelje, thyejnë disiplinën në punë etj. Kushdo në vendin tonë e ka të qartë parimin që shpërblehet sipas punës që kryen, por edhe e kundërtat duhet të ndodhë. Në rast se puna s'është e cilësisë së mirë dhe në sasinë e parashikuar, atëherë edhe shpërblimi duhet të cungohet në atë masë sa është dëmtuar prodhimi. Dëmin që bëri vetë, shkaktari duhet të detyrohet ta kompensojë dhe kjo është gjithashtu e drejtë dhe me baza socialiste. Duke u kufizuar vetëm me propagandën dhe agitacionin në punën edukative me njerëzit, nga e cila kurrë nuk do të heqim dorë, nuk duhet të lëmë mënjanë masat disiplinore, natyrisht kur këto janë të nevojshtme.

Është fakt se gati kudo, në vend të 8 orëve të parashikuara me ligj te ne, punohet 6 deri në 6 orë e gjysmë në ditë. Do të lejojmë ne të vazhdohet më tej me këtë qëndrim ndaj punës dhe të pranojmë dëmtimin e interesave të shtetit tonë socialist? Është e qartë për të gjithë se ky qëndrim nuk është në interes të socializmit. Prandaj është e domosdoshme të vendosim disa rregulla të përshtatshme për forcimin e disiplinës, me të cilat të jemi të bindur se edhe socializmin e mbrojmë, edhe njerëzit i ruajmë nga gabimet dhe i edukojmë me ndërgjegje të lartë për punën. Në të kundërtën as socializmin mbrojmë, as njerëzit i ruajmë nga korrupzioni dhe prishja e ndërgjegjes. Unë mendoj t'i kemi këto rregulla kudo ku punohet dhe të kërkojmë zbatimin e tyre të plotë që kur fillon puna dhe gjatë punës për shfrytëzimin si duhet të kohës për

realizimin e prodhimit jo vetëm në sasi, por edhe në cilësi, asortiment, kosto etj.

Kapitalisti për mbrojtjen e interesave të vet, vendos rregulla të forta në ndërmarrjen e tij, qysh nga paraqitja në kohë dhe fillimi i punës në orarin e caktuar. Këto kërkesa pronari kapitalist nuk ia lë spontaneitetit, po organizon kontrollin e rreptë mbi punëtorët jo vetëm gjatë proceseve të punës, po që me paraqitjen e tij në orar. Kështu, në orën e caktuar, kapitalisti, në rast se konstaton që një punëtor nuk ka ardhur në afatin e duhur i pret rrogën, ose e largon nga puna.

Pra, punëtori në kapitalizëm, në rast se nuk punon sipas kushteve që i vihen, nxirret në rrugë pa mëshirë. Ndërsa te ne, në Shqipërinë socialiste, Partia e ka bërë atë të ndërgjegjshëm se punon për vete dhe për shoqërinë, prandaj në vendin tonë ekziston ai entuziazëm e vrull i madh në punë. Megjithatë, siç thamë, aty-këtu ka edhe te ne njerëz të pandërgjegjshëm, që i bëjnë bisht punës.

Le të marrim momentin e paraqitjes dhe të fillimit të punës në orarin e caktuar si dhe çështjen kur pas disa orë pune bëhet nga punëtorët një pushim për t'u çlodhur gjysmë ore apo një orë, sa parashikohet me rregullore, sipas nevojës e natyrës së punës së secilës ndërmarrje. Çfarë ndodh? Në të dy rastet ka njerëz që nuk fillojnë menjëherë të punojnë, qoftë në fillim të 8-orëshit, qoftë pas pushimit, duke marrë kështu kohë të vlefshme nga puna. Këto shfaqje pasqyrojnë shkallën e ndërgjegjes, të vlerësimit dhe të respektimit që ka punonjësi ynë për kohën e punës. Pra, ndër-

gjegjja socialiste nuk është tek të gjithë punonjësit në atë nivel të lartë që kërkohet.

Ne nuk duhet të lejojmë të ecet kështu. Nuk është aspak e drejtë të sillemi liberalë ndaj shpërdoruesve të kohës së punës. Sado pak që të jenë ata elementë me ndërgjegje jo të formuar socialiste të mos i lejojmë të livadhisin e të mos i jasin shoqërisë atë që e kanë për detyrë dhe ca më tepër të bëhen shembull i keq për të tjerët. Njeriu ynë i edukuar me ideologjinë e Partisë, duhet ta kuptoje se me punën që bën, i shërben shoqërisë dhe vetes së tij, prandaj duhet ta kryejë mirë atë. Për ata që kjo punë s'bën efekt, të organizojmë edhe një kontroll të rreptë gjatë punës dhe sipas sasisë së kohës së shpërdoruar të merren sanksione ndaj atyre që shkelin disiplinën. Kjo është një masë plotësisht e drejtë, sepse vetëm ai që është i disiplinuar në punë dhe jep atë që kërkohet nga shoqëria duhet të meritorë shpërblimin e plotë që parashikon vendi i punës.

Rregullat që do të vendosim është e domosdoshme t'i bëhen të njobura çdo punonjësi, që kur hyn në punë dhe të kërkohet pastaj prej tij me këmbëngulje që t'i zbatojë. Thyerja e rregullave, shkelja e disiplinës janë të huaja për socializmin. 8-orëshi i punës duhet plotësuar rreptësisht.

Le të marrim gjithashtu një tjetër problem të rëndësishëm, atë të detyrës për të nxjerrë prodhim sipas cilësisë së kërkuar. Për cilësinë e punës këtu u fol mjaft, por mendoj se duhet të gjejmë ku janë kyçet që ndikojnë negativisht për të, ku prishet cilësia dhe nga cilët, që të mund të merren masat e nevojshme për të garantuar prodhim me cilësi dhe sipas standardit të

parashikuar. Kur zbulohen shkaktarët, atyre që punojnë me cilësi të dobët, t'u pritet medoemos paga dhe të zbatohet kështu parimi sipas të cilit punonjësi të shpërblehet jo vetëm për sasinë, por edhe për cilësinë e punës së kryer.

Kërkesat për cilësinë duhet t'i kemi parasysh në të gjitha çështjet, duke filluar që nga lënda e parë, nga zbatimi i teknologjisë e deri në nxjerrjen e prodhimit, sepse lënda e parë dhe zbatimi me rreptësi i teknologjisë etj., ndikojnë shumë në cilësinë e prodhimit të mallrave. Në qoftë se një kombinati tekstilesh i kërkojmë pëlhirë të cilësisë së parë dhe e furnizojmë me pambuk të kategorisë së tretë, nuk duhet të pretendojmë që ai të na nxjerrë tekstile të kategorisë së parë, bile as të dytë. Po kështu, në qoftë se lëkura më të cilën do të prodhohen këpucë është e dobët, prej saj nuk ka si nxirret mall i cilësisë së mirë. Në një rast të tillë të mos ngarkojmë me faj punëtorët e prodhimit të tekstileve, të këpucëve etj., por prodhuesit e lëndës së parë, ata të pambukut, regjësit e lëkurëve etj. Punëtorët e tekstileve ose të këpucëve duhet t'i kritikojmë dhe për pasojë t'i ngarkojmë edhe me përgjegjësi materiale, vetëm në rast se prodhimi i dobët rrjedh për faj të tyre, kur ata nuk zbatojnë si duhet teknologjinë e prodhimit etj., që varen prej tyre.

Këtej lind nevoja për të përcaktuar sipas rastit masën e ndalesës nga paga edhe kur punonjës të ndryshëm, për faj të tyre, nxjerrin prodhim të dobët, ose kur përgjegjësit e tyre i lejojnë ata që të prodhojnë me cilësi të dobët. Të shikohet që paga t'i ulet secilit sipas shkallës së përgjegjësisë dhe sipas dëmit që sjellin.

Kur cilësia e prodhimit dëmtohet nga paaftësia e punonjësit, atëherë duhet të merret një masë tjeter, të vihen para përgjegjësisë ata që ia kanë dhënë kategorinë, ndërsa shkaktari vetë të zbritet medoemos nga kategoria që mban, sepse vetë malli i prodhuar tregon qartë se nuk është vlerësuar drejt për atë kategori. Ai mund të rritet në kategori vetëm pasi të japë prova se e meriton. Këto masa mendoj të zbatohen jo vetëm kundër personave që dëmtojnë direkt prodhimin, që shkelin disiplinën në punë etj., por edhe kundër të gjithë atyre që Partia dhe pushteti i kanë ngarkuar me funksionin e kontrollit të zbatimit të përpiktë të detyrave dhe nuk e kryejnë atë si duhet, duke filluar që nga përgjegjësi imediat, ai i repartit e deri te drejtori i ndërmarrjes etj. Në qoftë se të gjithë këta në ndërmarrje bëjnë lëshime, lejojnë shthurje në shfrytëzimin e kohës së punës, ngrenë në kategori njerëz pa e merituar, ose bëjnë sikur nuk shikojnë prodhimin me cilësi të dobët dhe ua nisin ndërmarrjeve të tjera ose konsumatorëve, gjë që prek interesat e shtetit dhe të ble-rësve, ndaj tyre të mos mjaftohet vetëm me nga një këshillim, ose vërejtje në brigadë apo në kolektiv, por të zbatohen sanksione në rrugë shtetërore.

Nuk është e drejtë gjithashtu të nisemi nga konsiderata të përgjithshme për punëtorët, duke arsyetuar se filani është njeri i mirë, është ashtu e kështu etj., kur prodhimi që nxjerr është i dobët. I mirë duhet të konsiderohet ai punëtor që nxjerr prodhime me cilësi dhe, natyrisht, për këtë ai të përgëzohet, të respektohet, bile edhe të lavdërohet, ndërsa kur s'e kryen detyrën, krahas zhëmëtimit, të këshillohet, të

kritikohet, të paralajmërohet ose dhe të pushohet.

Edhe një drejtor ndërmarrjeje ose çfarëdo përgjegjësi qoftë, kur ai nuk i drejton mirë punët që i janë besuar, kur nuk është i rreptë në kërkimin e llogarisë, kur bën shkelje vetë ose tregohet i butë ndaj shkeljeve që bëjnë të tjerët, lidhur me zbatimin e detyrave shtetërore, apo të direktivave të Partisë, sipas fajit edhe këtij duhet t'i preket rroga në masën që do të përcaktohet me dispozitat përkatëse dhe nëse vazhdon të ecë në këtë rrugë të gabuar, kjo do të thotë se ai s'e kryen dot detyrën që i është besuar, prandaj s'e meriton dhe duhet të shkarkohet nga detyra, duke shkuar deri punëtor i thjeshtë. Në këtë rast del e qartë se jo vetëm ai, po bile as organizata-bazë ku bën pjesë nuk është në rregull, prandaj në rrugë partie të përgjigjet edhe ajo për dëmin e shkaktuar. Për të ardhurat e familjes qoftë punëtori apo drejtuesi le të mendojnë vetë, të mos punojnë keq që të mos u pakësohen ato, por t'i rritin me punë të ndërgjegjshme, me djersë, me përpjekje për të mësuar e për t'u kualifikuar që të nxjerrin punë me cilësi të mirë, apo të drejtojnë mirë, pse shpërblimin që u takon duhet ta marrin në bazë të punës.

Studimi që do të bëhet për këtë problem duhet të parashikojë masa jo vetëm ndaj punëtorëve, drejtuesve të ndërmarrjeve ekonomike dhe institucioneve të bazës, po të përcaktojë edhe përgjegjësinë e komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, të dikastereve e të institucioneve qendrore, si të industri-së, ndërtimit, tregtisë etj. Kjo çështje duhet kuptuar drejt dhe jo në mënyrë të njëanshme. Shpesh, kur ma-

rrim në diskutim çështje të tilla dhe thërresim në raport shokët ministra, këta bëjnë autokritikë edhe për të metat e dobësitë që vërtetohen poshtë, pra për ato për të cilat faj kanë punonjësit e bazës. Sigurisht aparatet qendrore përgjigjen edhe për to. Megjithatë pavarësisht nga dobësitë e të metat direkte që kanë kuadrot e organeve qendrore, kundër të cilave ata duhet të bëjnë përpjekje t'i luftojnë, përgjegjësia për të metat e dobësitë e bazës nuk bie vetëm mbi ministritë, ndërsa baza ta ndiejë veten të lehtësuar. Megjithëse duhet bërë akoma më shumë, ne nuk mund të themi që ministritë nuk punojnë me bazën për t'i dhënë kësaj ndihmë nëpërmjet këshillave, urdhërave, udhëzimeve, studimeve etj. As nuk mund të themi gjithashtu se në bazë fajin për të metat e dobësitë e kanë të tërë, pse dhe atje jo kudo, po vetëm në disa hallka dhe nga disa njerëz nuk kryhen detyrat, ose shtrembërohen direktivat e dhëna. Lufta dhe përpjekjet që bëjnë punonjësit e bazës për plotësimin si duhet të detyrave nuk mund të mohohen. Atje me siguri dhe në shumicë ka njerëz që punojnë shumë mirë, ka të tjerë që punojnë mirë, ka edhe nga ata që punojnë më pak, por aty-këtu ka edhe njerëz (dhe këta përfat të mirë nuk janë shumë dhe nuk përbëjnë karakteristikën e njerëzve tanë) që punojnë keq. Dhe pikërisht për ata që punojnë keq ne duhet të vëmë fre dhe të bëjmë që nga gabimet e tyre të mësojnë ata vetë, në radhë të parë, por të mësojnë edhe të tjerët, bile edhe ata që punojnë mirë, ashtu sikurse nga puna e ndërgjegjshme e këtyre të fundit duhet të mësojnë të gjithë. Atyre që punojnë pa ndërgjegje, pa asnjë hezitim,

t'u hiqet veshi dhe askujt të mos i lejohet t'u dalë, në një formë ose në një tjetër, në mbrojtje, siç mund të ndodhë në ndonjë rast. Në qoftë se ndodh një gjë e tillë, kur është i qartë për të gjithë gabimi ose faji i atij që kritikohet apo ndëshkohet, të mbahet qëndrim. Qëndrim duhet mbajtur edhe ndaj atyre që nuk i mbrojnë drejtpërsëdrejti fajtorët, por që me indiferentizmin e tyre bëhen një mbështetje e heshtur për shkelësit.

Indiferentizmi ndaj gabimeve, si një formë e përkrahjes së heshtur, shpeshherë vjen edhe për arsy sentimantale ose të arsyetimeve të gabuara, duke menduar se këta që nuk punuan mirë ose gabuan «janë punëtorë», «me shumë fëmijë», «janë të klasës» etj. Të tilla arsyetime s'janë të shëndosha, sepse njerëzit e klasës duhet të ecin kurdoherë në pararojë me klasën, të mos shkëputen për asnjë çast nga vrulli dhe interesat e saj, prandaj ai që punon keq, ose që nuk punon fare, ta ketë të qartë se nuk mund të konsiderohet i klasës dhe asnjëri s'ka të drejtë ta mbrojë, përkundrazi, ta kritikojë dhe bile fort që të mos i përsëritë gabimet në punë, ndryshtë të merren masa deri në prekjen e interesave të tij ekonomikë. Këto masa natyrisht klasa dhe Partia e saj nuk i dëshirojnë, por detyrohen t'i marrin në emër të interesave të popullit dhe të ndërtimit të socializmit. Prandaj, kushdo që punon keq, ta dijë se për vështirësitetë ekonomike që mund t'i krijohen përkohësisht me marrjen e sanksioneve kundër tij, nuk ia ka fajin as klasa as shteti i diktaturës së proletariatit, por e ka vetë që punon keq ose shkel disiplinën në punë.

Kur ndaj një vjedhësi, për shembull, në bazë të ligjit, shteti merr masa, ai futet në burg. Mos vallë kanë faj për të klasa punëtore dhe shteti socialist? Jo! Në vendin tonë, ku udhëheq Partia dhe ku jetesa është e garantuar për çdo individ me punë të ndershme, njerëzit edukohen të mos vjedhin. Megjithëkëtë në realitet ka ndonjë që vjedh, pse për faj të vet, duke mos ua vënë veshin mësimeve të Partisë dhe normave të moralit proletar, ai arrin të degjenerohet. Në këtë rast, ligji parashikon masa të rrepta, fajtori mund të futet edhe në burg, me qëllim që, duke vuajtur dënimin, të edukohet, të pendohet për aktin e kryer, që të mos e përsëritë më. Por te ne, siç dihet, ka edhe raste që, kur kryhet ndonjë faj jo i rëndë, fajtori nuk futet përnjëherë në burg, bile as nga puna nuk nxirret. Herën e parë ai këshillohet, nëse e përsërit fajin kritikohet rreptë dhe mësohet si të ecë në të ardhmen, kur nuk korrigohet, paralajmërohet për pasojat që mund të heqë mbi vete, i hiqet edhe vërejtje etj., etj., dhe, në qoftë se vazhdon në rrugën e gabuar, atëherë merren masat më të rënda. Bëhet në këtë rrugë një punë e tërë edukative për ta shpëtuar njeriun. Vetëm kur pas gjithë kësaj pune ai s'bën kujdes, po vazhdon të shpërdorojë zemërgjerësinë e klasës, atëherë kjo detyrohet të marrë masat që parashikon ligji, duke e pushuar, ose duke e futur në burg, me qëllim që keqbërësi të ndreqet me rrugën e masave shtrënguese.

Ky orientim me karakter politik dhe ideologjik duhet të shpjegohet drejt dhe të mbështetet nga Partia dhe nga propaganda e saj. Në qoftë se në ndonjë qendër pune shihet se ky orientim nuk zbatohet, atëherë

organizata-bazë e Partisë duhet të ngrihet në këmbë dhe ta bëjë problem. Ne nuk mund t'i lejojmë disa njerëz që të rrojnë në kurriz të shoqërisë dhe të punës së ndërgjegjshme të shokëve të tyre. Jo, në asnjë mënyrë! Ndaj shkelësve organizatat-bazë të jenë të vëmendshme dhe të ngrenë në këmbë tërë opinionin e kolektivit për të zbatuar masat përkatëse dhe jo vetëm disiplinore, të cilat te ne kanë, gjithashtu, karakter edukativ, por edhe sanksione me karakter ekonomik.

Organizata-bazë është e nevojshme të shikojë herë pas here masat disiplinore që merren në qendrën e punës ku ajo ushtron veprimtarinë e saj. Në qoftë se konstatohet që shkeljet vazhdojnë, dhe për rrjedhim masat ndëshkimore vijnë duke u rritur, konkluzioni i parë që duhet të nxjerrë organizata-bazë përkatëse e Partisë është se ajo vetë nuk qëndron në lartësinë e detyrate, se në gjirin e saj ka disa «drunj të shtrembër» që duhen gdhendur mirë, ose duhen nxjerrë jashtë Partisë. Këta, natyrisht, nuk mund të nxirren përnjëherë jashtë radhëve të Partisë, por vetëm pasi të jenë bërë të gjitha përpjekjet për edukimin e tyre, domethënë, si të jenë këshilluar, kritikuar, paralajmëruar etj., etj., sipas normave të Statutit të Partisë. Kur ata nuk ndreqen dhe vazhdojnë të bëjnë autokritikë të përgjithshme, kjo do të thotë se të tillëve të quajtur komunistë, që nuk punojnë mirë, u ka ardhur koha të flaken jashtë radhëve të Partisë, se nuk e meritojnë titullin e lartë të anëtarit të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Mendoj që para se të vendosim rregullat për forcimin e disiplinës në punë, ne duhet t'i rishikojmë pak më mirë edhe ligjet e dispozitat në fuqi, si Kodin e

Punës etj., lidhur me disiplinën, me përgjegjësinë materiale, me largimin nga puna, se kam përshtypjen që aty-këtu ekziston njëfarë liberalizmi. Një punonjës, i cili ka vjedhur pasurinë socialiste dhe pikërisht për këtë arsyе është larguar nga puna dhe është ndëshkuar, përse të merret përsëri në punë me përgjegjësi materiale, bile nganjëherë në një punë edhe më me rëndësi në një ndërmarrje tjetër? Kjo ndodh se nuk zbatohen si duhet me rreptësi as ato norma e rregulla që ekzistojnë, se në librezën e punës të punonjësit nuk shkruhet gjithmonë drejt dhe saktë motivacioni i largimit nga puna, nuk thuhet e vërteta se ky është pushuar nga puna që ka pasur para se të vijë këtu, për arsyë se ka vjedhur si magazinier, si shitës, arkëtar, llogaritar etj. Po të bëhet kjo rregullisht, atëherë ndërmarrja apo institucioni ku ai mund të drejtohet për punë, e cila e ka për detyrë që të mos marrë asnjeri pa i parë me kujdes dokumentin përkatës, nuk ka arsyë pse ta rimarrë në punë me përgjegjësi materiale, kur sheh se diku ai është njollosur, pa dhënë për shumë kohë prova bindëse se është rehabilituar. Prandaj nëpërmjet rishikimit të dispozitave ligjore që rregullojnë përgjegjësinë materiale të punëtorëve dhe nëpunësve, të bëhet me vëmendje studimi për t'i parë këto çështje drejt, në mënyrë marksiste, me qëllim që të gjitha ato që thashë të shërbejnë për mbrojtjen e interesave të socializmit, por edhe për t'i edukuar njerëzit tanë me normat e moralitetë shëndoshë proletar.

Masat që propozoj të studiojmë dhe të vendosim mund të duken sikur janë si shumë të rrepta, po mendoj se ato janë të domosdoshme që bashkë me punën

edukative, e cila do të prijë e të jetë kurdoherë në plan të parë dhe që Partia do ta forcojë edhe më shumë në të ardhmen, do të ndihmojnë që edhe kjo pakicë punonjësish, që sa kalon zvogëlohet, të detyrohet të punojë ndershëmërisht. Në rast se tjetri nuk dëshiron t'i pritet rroga, në rast se nuk dëshiron t'i shkruhen në librezën apo në karakteristikën e punës gjëra negative, kjo është në dorën e tij që të mos ndodhë. Partia do të bëjë të gjitha përpjekjet, do të punojë që asnjë, po të jetë e mundur, të mos kemi në këtë kategori, po kur dikush e mbush kupën, kur thyen disiplinën, kur vjen me vonesë në punë, kur nuk e shfrytëzon mirë kohën e punës, kur bën hile, kur nxjerr prodhime me cilësi të dobët, ose jo në sasinë apo assortimentin e parashikuar etj., etj., atëherë nuk duhet hesituar për të marrë kundër tij edhe masa shtrënguese. Unë mendoj sikur t'i studiojmë disa gjëra të tillë për të cilat fola, se i lyp nevoja e zhvillimit tonë të vrullshëm.

*Botuar për herë të parë,
me ndonjë shkurtim në li-
brin: Enver Hoxha, «Ra-
porte e fjalime 1970-1971»,
Tiranë, 1972, f. 411*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Byrosë Politike
të KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

**IDEALI MË I LARTE I FRROK KAÇORRIT ISHTE
T'I SHËRBENTE ME BESNIKËRI DERI NË FUND
PARTISË SË DASHUR**

Letër drejtuar familjes së shokut Kolë Kaçorri

23 shtator 1971

Të dashur Kolë e Mara Kaçorri dhe ju shtatë bijat e tyre,

E dashur Davë,

U preka thellë kur shokët e Partisë më njoftuan për vdekjen e Frrokut, njeriut të shtrenjtë të zemrave tuaja, shokut tonë të dashur komunist, anëtar besnik i Partisë sonë të lavdishme. Më pas këtë lajm që më hidhëroi shumë e mora edhe nëpërmjet letrës suaj, ku ju më shkruani thjeshtë, çiltër, plot me ndjenja të fuqishme dhe njëkohësisht me dhimbjen aty shprehni edhe forcën, kurajën, durimin e krenarinë për Frrokun¹ tuaj

1. Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH i dha atij titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste».

dhe të Partisë, që ra me nder si trim në krye të detyrës.

E shkurtër ishtejeta e Frrokut, por vepra dhe akti i tij i fundit për zhbllokimin e pusit, deri në sakrificën më të lartë do të mbeten një shembull i ndritur jo vetëm për shokët e tij të afërt, por edhe për gjithë njerëzit tanë. Që pesëmbëdhjetëvjeçar ai filloi punën në gjeologji dhe më pas vazhdoi profesionin e nderuar të minatorit, duke u gjendur kurdoherë në krye të detyrës edhe kur i takonte të pushonte. Mbi tokë e nën tokë ai punoi pa u lodhur me një ndërgjegje të lartë socialiste, duke luftuar kurdoherë për realizimin dhe tejkalimin e detyrave që i ngarkoheshin. Zemra e re e këtij biri të Mirditës dhe të Shqipërisë gufonte nga gjëzimi kur shikonte vagonët plot me bakër, gjë që ia shumëfishonte forcat për të punuar e për të prodhuar gjithnjë më shumë për popullin. Të tillë e kishte edukuar atë Partia. Por një meritë për rritjen dhe edukimin e Frrokut me cilësi të tilla keni edhe ju, prindërit e tij, që e mbrujtët atë me frymën e Partisë, me mësimet e saj, të cilat ai i bëri flamur dhe i zbatoi më së miri në jetë, deri në frymën e fundit. Ai nuk ishte vetëm një minator i dalluar, por dhe aktivist i shquar shoqëror, një komunist i vërtetë. Prandaj hallall e pastë qumështin me të cilin e mëkove ti, motra ime Marë, nënë trimëreshë e Frrokut, që nuk derdhe lot për humbjen e papritur të djalit të vetëm e të shtrenjtë!

Edhe me ty mburret Partia, i dashuri Kolë, që në këto ditë të rënda për familjen tuaj qëndrove i fortë, përparrë dhimbjes së madhe nuk u ligështove, por rrë-

ke automatikun e Frrokut dhe shkove për ta zëvendësuar atë në stërvitje dhe, si kurdoherë, qëndron i gatshëm për të përmbushur çdo detyrë të Partisë, ashtu siç bënte yt bir, që ti e rrite dhe e mësove të ecte në rrugën e saj.

E fortë dhe zemërçelike qëndrove, o Davë, bashkëshortja e Frrokut, po kështu edhe ju shtatë motrat e tij, krenare për emrin dhe veprën e burrit dhe vëllait tuaj, që lumturinë personale dhe të familjes e gjente vetëm në luftën dhe punën për të sigruuar lumturinë e mbarë popullit dhe që kishte vënë të gjitha forcat për t'i pritur duarplot e ballëlart 30-vjetorin e Partisë dhe Kongresin e 6-të të saj.

Ideali më i lartë i Frrokut ishte t'i shërbente me besnikëri deri në fund Partisë së dashur, si anëtar i denjë i së cilës ai luftonte gjithnjë në vijën e parë derisa zemra i pushoi së rrahuri në Minierën e Kurbneshit, që e donte aq shumë. Në mendjen dhe zemrën e birit, bashkëshortit dhe vëllait tuaj ishte skalitur thellë parimi revolucionar i Partisë: Interesi i përgjithshëm mbi gjithçka.

Partia nuk do ta harrojë kurrë anëtarin e saj të vendosur, Frrok Kolë Kaçorrin¹. Komunistët, brezat e sotëm dhe të nesërm do të frymëzohen nga figura e karakteristikat e tij dhe do të mësojnë shumë nga puna e tij heroike.

1. Për të përjetësuar kujtimin e tij, me vendim të Këshillit të Ministrave të RPSSH, në korrik 1985, Ndërmarrjes Minerare të Kurbneshit iu dha emri i Heroit të Punës Socialiste Frrok Kolë Kaçorri.

Me këtë letër vij aty pranë jush t'ju sjell ngushë-llimet më të përzemërta të Partisë dhe të miat.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 228 (7205), 24 shtator 1971*

*Botohet sipas gazetës «Zëri
i popullit», nr. 228 (7205),
24 shtator 1971*

T R E G U E S I T

TREGUESI I LËNDËS

A

Aleanca dhe kontradiktat sovjeto-amerikane — 18-28, 110-111, 157-159, 165-166, 374-376, 427-428, 446, 453.

Armatimi dhe çarmatimi. Politika demagogjike e superfuqive për çarmatimin — 26-27, 374-377.

Arsimi në RPSH

- shkollat; shkollat profesionale me dhe pa shkëputje nga puna — 56-59, 462-464;
- mësuesit; kualifikimi i tyre — 58-59;
- sistemi i notave në shkollë — 464.

Ariacioni ushtarak, aviatorët

- 69-71, 75-79, 85-86.

B

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik

- revizionistët sovjetikë tradhtarë të marksizëm-leninizmit. Degjenerimi i

- jetës politike, ideologjike e ekonomike dhe rivenosja e kapitalizmit në BS — 2-10, 155-156;
- politika ekspansioniste e socialimperializmit sovjetik. Hegjemonizmi ndaj vendeve e partive revisioniste dhe kontradiktat me ta — 10-16, 21-28, 156-157;
- sabotues dhe shtypës të revolucionit dhe të lëvizjeve çlirimtare të popujve — 16-21, 158-159;
- lufta e revisionistëve sovjetikë kundër PPSh dhe partive marksiste-leniniste — 28-30, 110-111;
- Kongresi i 24-t i partisë revizioniste sovjetike — 1-32.

Bibliotekat — 99-100, 185-186
205.

Blegtoria

- zhvillimi, përmirësimi racionor dhe rritja e rendimenteve në blegtori — 233-235, 242-243, 360;

- baza ushqimore e blegtorisë — 236-238, 240, 334-335.

Bujqësia

- politika e Partisë për zhvillimin e bujqësisë dhe për kthimin e saj në ekonomi të prodhimit të madh modern — 67-68, 197, 249-250, 323-324, 354-360;
- organizimi dhe drejtimi shkencor i punës në bujqësi; puna kërkimore-shkencore, shërbimet agroteknike, rajonizimi, qarkullimi në bujqësi — 53, 65-66, 326-334, 336, 360-361;
- mekanizimi i bujqësisë; rritja e rendimenteve dhe hapja e tokave të reja — 60-68, 224, 231, 238-240, 318-323, 324-326, 356-358, 363-365;
- drithërat e bukës; detyrat për sigurimin e bukës në vend — 64, 365-366, 458-459;
- perimet, patatja; bimët industriale — 327-336, 366-370;
- ujitja, veprat ujitetëse — 230, 231, 359.

C

Çekosllovakia. Pushtimi ushtarak i saj nga socialimperializmi sovjetik — 11-12.

D

Disiplina e punës, e planit dhe ajo financiare — 103-104, 223, 280-287, 345-347, 351-352, 372, 496-509.

E

Edukimi komunist, lufta kundër shfaqjeve të huaja — 83-85, 134, 135-136, 142-143, 148-149, 150, 151, 283-284;
 — qëndrimi socialist ndaj punës dhe pronës — 83-84, 137-138, 280-287, 345-346, 495-509;
 — harmonizimi i edukimit me masa administrative — 345-346, 497-499, 500, 501-503, 505, 506-509.

Efektiviteti ekonomik — 221-231.

Ekonomia popullore dhe perspektivat e zhvillimit të saj — 48-49, 225, 250.

Enver Hoxha — të dhëna biografike — 85-86, 367, 408-409, 415-416.

Evropa, «sigurimi evropian» — ndërhyrjet e imperializmit amerikan dhe të socialimpe-

rializmit sovjetik në këtë kontinent — 25-26, 432-433, 446.

F

Familja dhe roli i saj në edukimin e brezit të ri — 84-85, 148-149.

Fondet monetare dhe shfrytëzimi me efektivitet i tyre — 225, 229, 240-241, 349-351.

Fuqia punëtore — lëvizja dhe sistemimi i saj — 65-66, 222-223, 340-341, 461-462.

GJ

Gjermania Lindore (RD Gjermane) në pazarllëqet sovjeto-gjermane — 11, 41, 128, 1'9-183.

Gjykatat; Gjykata e Lartë — 143-147.

H

Hetuesia — 143-147.

I

Industria

— arritje dhe zhvillimi perspektiv i saj. Zbatimi i shkencës bashkëkohore në industri — 53-55, 195-197;

— industria e naftës dhe e gazit — 250-251, 252;

— industria minerale, industria mekanike; prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit — 228, 322, 342-343;

— industria tekstile dhe ajo ushqimore — 328-329, 418-419, 460, 495-497.

Internacionalizmi proletar — 115-118, 128-129.

Investimet; politika e Partisë në fushën e investimeve — 220-231, 290-291, 296, 336-337, 348-351, 355-356.

J

Jugosllavia, revisionizmi jugosllav

— rivendosja e kapitalizmit dhe pasojat e tij — 81-82, 118-119, 173-179, 380-381, 449;

— lidhjet dhe bashkëpunimi me imperializmin amerikan. Marrëdhëniet dhe kontradiktat me revisionistët sovjetikë — 81, 171, 178-179, 381, 446-450;

— qëndrimi armiqësor ndaj RPSH dhe ndaj populisisë shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 82, 172-173, 380, 382.

K

Këshilli i Ministrave i RPSh (Qeveria) — 228, 231, 235-236, 318, 329, 349.

Kina — strategjia dhe takтик. Tendencat proimperialiste të Kinës — 109-110, 111, 127, 421-440.

Klasa punëtore — roli udhëheqës i saj në socializëm. Edukimi ideopolitik, kulturor dhe profesional i klasës punëtore — 197-198, 280-287, 468-473.

Komunisti, roli udhëheqës dhe edukimi ideopolitik i tij — 103, 251-252, 257-261, 262-263, 264-267, 268-277.

Kontradiktat në shoqërinë tonë socialiste dhe rrugët e zgjedhjes së tyre — 49, 147-148, 283-284.

Kontrolli punëtor; përbajtja dhe efektiviteti i tij. Rol i udhëheqës i Partisë në të — 466-481, 483.

Kosova — gjendja e brendshme dhe politika shoviniste e revisionistëve jugosllavë ndaj saj — 82-83, 172-173, 178-179.

Kostoja e prodhimit — detyrat për uljen e saj — 220-231, 337, 350-351.

Kooperativat bujqësore — 323-324;
— organizimi dhe drejtimi shikencor i punës në 10.

Statuti i kooperativave bujqësore — 289-298, 361-363;

— kooperativat bujqësore të tipit të lartë — 288-293.

Kriminaliteti — shfaqjet e kriminalitetit; shkaqet, parandalimi dhe dënim i tyre — 130-154.

Kritika dhe autokritika; roli edukues i tyre — 193-199.

Kriza dhe kontradiktat në botën kapitaliste e revisioniste — 108-109, 122, 155, 159, 162-164, 428-429, 445-446, 451-453.

L

Ligjshmëria, ligjet — 130, 143-146, 497-498, 507-508.

Lindja e Mesme — presionet dhe ndërhyrjet sovjeto-amerikane në këtë rajon; qëndresa e popujve kundër tyre — 19-20, 122-124, 164-166.

Lufta e klasave — karakteri objektiv i saj — 125-127, 130, 136-142, 145-146, 152-154.

Lufta popullore — 386-388, 401-405, 456-457.

Lustërat imperialiste — 25-26, 166, 375-376, 449.

M

Mbrojtja e atdheut — përgatitja e ushtrisë dhe e popullit për mbrojtje — 36, 71-75, 377-

-378, 385-388, 391-405, 456-457.

Mekanizimi — roli i tij në zhvillimin e prodhimit — 53-54, 223-224, 228, 337-340.

Metoda dhe stili në punë — 48-49, 52-53, 54-55, 92-98, 102-103, 104-106, 151-152, 264-278, 473-478.

Ministritë — kompetencat, metoda e punës së tyre — 266-273, 275-276, 503-504; — Komisioni i Planit të Shtetit — 59, 60, 64, 220, 229, 354;

— Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 351, 467, 474-475;

— Ministria e Bujqësisë — 61, 64, 233, 236, 238-239, 240, 241-242, 288, 325;

— Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 49, 495;

— Ministria e Ndërtimit — 227, 338, 354;

— Ministria e Tregtisë — 384, 477.

Mirëqenia materiale dhe ngri-tja e nivelit kulturor të masave — 229-230, 281-282.

N

NATO — 26, 109, 127, 159, 183, 379-380, 449.

Ndërmarrjet bujqësore — organizimi dhe drejtimi shken-

cor i punës në to — 241, 288-289.

Ndërtimet — organizimi, drejtimi shkencor dhe mekanizimi i punës në ndërtim — 221-224, 226-231, 264-266, 337-340, 341-342, 350-354.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — 124-127, 410-413, 454-455.

Normat e punës — përmirësimi i tyre — 286.

O

Organet e punëve të brendshme; detyrat e tyre — 143-146.

Organet shitetërore dhe ekonomike qendrore e lokale; kompetencat, kontrolli dhe ndihma e tyre për bazën — 257-258, 261, 263-273, 503-504.

Organizata-bazë e Partisë

— roli udhiheqës, gjallërimi dhe revolucionarizimi i saj — 264, 273-275, 323, 391-393, 482-483, 487-489, 507;

— në dikastere dhe institucione — 255-256, 263, 272, 275-277.

P

Palestina — lufta nacionalçlirimtare e popullit palestinez

kundër pushtuesve izraelitë — 19, 122-124, 164.

Paqja — demagogjia revizioniste për paqen — 24-26, 444.

Partia e Punës e Shqipërisë

- roli udhëheqës i Partisë. Vendimet e direktivat e saj; njohja dhe zbatimi i tyre — 142-143, 238-240, 256-278, 361;
- përbërja, shtrirja dhe mosha e efektivit të Partisë. Pranimet në Parti — 485-492;
- Kongresi i 5-të i PPSH — 318-319, 357, 358;
- Kongresi i 6-të i PPSH — 45, 279, 370;
- Plenumi i 10-të i KQ të PPSH (6-8 qershori 1963) — 370;
- Plenumi i 12-të i KQ të PPSH (29 qershori — 1 korrik 1971) — 348-373, 374-406;
- Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ — 62, 150, 235-236, 349, 357, 361, 421-422, 486, 489;
- Letra e KQ të PPSH për bujqësinë — 249, 336, 361, 362-363;
- komitetet e Partisë në rrethe; sekretarët — 261-262, 263-266, 267, 271, 391, 486-488;

— Komiteti dhe Byroja e Partisë e rrëthit të Elbasanit — 130, 198.

Planifikimi

- metodologjia e planifikimit; hartimi i planeve — 225-228, 349, 370-371;
- plani i pestë pesëvjeçar (1971-1975) — 45-46, 196-197, 220-231, 279-280, 316-342, 348-373, 410;
- pjesëmarrja e masave në diskutimin, hartimin dhe plotësimin e planeve — 317, 371-373.

Politika e jashtme e RPSH

- parimet themelore të politikës së jashtme. Qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj problemeve ndërkombëtare. Lufta kundër imperializmit e rezolucionizmit — 29-30, 39, 108-113, 118-120, 154-155, 170-171, 422-423, 425, 444-446, 451-454;
- marrëdhëniet me vendet e tjera. Rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe RPSH në botë — 199-200, 383-384;
- marrëdhëniet me RD të Vietnamit; solidariteti dhe përkrahja e luftës së popullit vietnamez kundër agresorëve amerikane — 33-36, 42;

- marrëdhëniet dhe kontradiktat me Kinën — 107-108, 421-426, 434-440, 441-444, 456-457;
- marrëdhëniet me Greqinë — 38-39, 80, 166-170, 200-201, 384;
- marrëdhëniet me Jugosllavinë — 37, 80-81, 171-172, 381, 384, 450-451;
- qëndrimi parimor dhe përkrahja për shqiptarët që jetojnë në trojet e vota në Jugosllavi — 82-83, 172-173, 381-383.

Polonia, gjendja e brendshme politike dhe ekonomike — 6, 12-13, 41.

Populli shqiptar — roli vendinitar i tij në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit — 115-118, 125, 409-410.

Prodhimi material — rritja e cilësisë së prodhimit — 286-287, 343-344, 460-461, 500-501.

Prokuroria; Prokuroria e Përgjithshme — 143-146.

Prona

- prona e grupit, shndërrimi i saj në pronë të gjithë popullit — 291-294, 296-297;
- oborri kooperativist, shndërrimi i tij në pronë të grupit — 295-297.

Propaganda borgjezo-reviziونiste — 5-9, 98-99, 111, 134-135, 141, 166.

Q

Qenia shoqërore dhe ndërgjegjja shoqërore; roli i faktorit subjektiv në krijimin e ndërgjegjes socialiste — 50, 132-136, 292-294.

R

Regjimi i kursimit; forcimi i tij — 224-225, 349-354.

Rendimenti i punës; rritja e tij — 63-64.

Revizionizmi modern — kontradiktat dhe kriza në gjirin e tij — 11, 15-16, 40-41, 120, 128, 156-157.

Revolucioni ideologjik, kulturore dhe ai tekniko-shkencor në RPSH — 50-51.

Rezervat shtetërore — 232-233, 235-236, 329-330.

Rinia dhe BRPSh. Edukimi i rinisë. Lufta kundër konservatorizmit dhe formalizmit në punën me rininë — 84-85, 88-106, 139-140, 310-311.

RR

Rrethimi imperialisto-reviziونist i Shqipërisë; lufta për përballimin dhe çarjen e tij

— 36-37, 98-99, 124, 152, 378-381.

S

Stalin, Josif Visarionoviç — 4, 180, 446.

Strehimi i popullsisë, ndërtimi i banesave — 186, 192-193.

SH**Shëndetësia**

- kujdesi i Partisë për nënën dhe fëmijën — 190-191, 465;
- kopshtet, çerdhet — 186-191, 193-194.

Shkencë

- studimi dhe përvetësimi i shkencës; lidhja e shkencës me prodhimin; studimet ekonomiko-shqërorë — 45, 46-51, 53-55, 101;
- roli i masave në zhvillimin e shkencës, masivizimi i saj — 44, 46, 50;
- organizimi i punës shkençore. Organizmat shkençorë dhc punonjësit e tyre — 43-44, 46, 47-48, 51, 52-53.

Shkencë dhe kultura në vendet borgjeze — studimi dhe qëndrimi ndaj tyre — 45, 99-101, 131-132.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, imperializmi amerikan — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme; kriza dhe disfatat e tij — 34-35, 40, 110, 121-122, 159-164, 426-432, 451-452.

Shtypi; përbajtja dhe tematika e tij — 299-315, 481-483.

T

Traktati i Varshavës — 13, 14-15, 40, 127, 156, 157, 159, 379-380, 381, 433.

Transporti, organizimi i tij — 459-460.

U

Uniteti Parti-popull — 199-200.

Ushtria Popullore

- roli udhëheqës i Partisë. Organizatat e Partisë, komunistët dhe kuadrot në ushtri — 388-389, 390-400, 406;
- karakteri, forcimi, modernizimi i ushtrisë; përgalitja politiko-ushtarake — 73-75, 388-394, 397-405, 443-444;
- armatimi. Roli i njeriut dhe i armëve në luftë — 69-79;
- lidhjet ushtri-terren — 391-395.

V

-42, 112, 120-122, 158-161,
162, 164, 427, 430.

Vietnam — lufta e popullit *Vigjilence revolucionare* —
vietnamez kundër agresorëve 37, 83.
amerikanë — 18, 34-35, 40, 41-

TREGUESI I EMRAVE

A

Alia, Ramiz — 299, 304, 305,
461, 481.

B

Bajoti, Atlije — 187.

Binet, Leon — 367-370.

Brezhnev, Leonid — 1, 2, 3,
7-8, 10, 11, 12, 13, 15, 16, 20,
21, 24, 25-26, 28, 29, 31, 41,
181-182, 381, 448, 450.

C

Çarçani, Adil — 340.

Çeliku, Hajredin — 350.

Çan Kai Shi — 430.

Çaushesku, Nicolae — 111.

Çu En Lai — 421, 423, 424,
425, 430, 431, 434, 439.

D

Dezh, George Georgiu — 416.

Dodbiba, Pirro — 61, 62, 232,
233, 234-235, 238, 240.

Dostojevski, Fjodor — 99.

Dyrmishi, Mereme — 190, 191.

E

Eftimiu, Viktor — 407-408,
409, 410, 412, 413-415, 417,
418, 419.

Ekmekçi, Hatixhe — 211, 212,
213, 214, 215.

Ekmekçi, Petrit — 212, 213.

G

Gandi, Indirá — 453.

Gierek, Eduard — 12.

Gromiko, Andrei — 14, 21.

GJ

Gjermení, Rrapi — 324.

H

Hoxha, Nexhmije — 203, 211,
213.

Hidri, Ibrahim — 494.

Honeker, Enrik — 180, 183.

Ho Shi Min — 120.

Hoxha, Alemsha — 216, 217.

Hoxha, Dr. Fejzi — 205.

Hoxha, Nuredin — 216, 217-
-218.

Hrushov, Nikita — 1, 4, 24,
118, 180, 181, 182, 424, 432,
433.

Husak, Gustav — 11.

I

Isufi, Budo — 494.

J

Janku, Niqi — 187.

K

Kapo, Hysni — 299, 332, 333,
478.

Kaçorri, Frrok, Marë, Kolë,
Davë — 510-512.

Kadare, Ismail — 417.

Kamami, Vasil — 218-219.

Kanapari, Shyqyri — 493-494.

Kan, Jahja — 436.

Kardel, Eduard — 173.

Kashen, Marsel — 413.

Kellezi, Abdyl — 225-226.

Kim Ir Sen — 433.

Kisinger, Henri — 431.

Kishinjevski — 417.

Kosigin, Aleksei — 2, 4, 6, 8,
21, 181, 182, 435, 448.

Kotoko, Pandelejmon — 167,
168.

L

Laçka, Kristina — 208, 209,
210.

Liu Shao Ci — 109, 424, 427.
Lon Nol — 18.

M

Mao Ce Dun — 127, 435, 453.

Markuze, Herbert — 100.

Menzelxhiu, Jashar — 185,
190-191, 192, 203, 204, 207,
217, 218, 219.

Menzelxhiu, Margarita, Iliriana,
Agron — 203, 204.

Mero, Agim — 87, 310.

Mikojan, Anastas — 181.

Monmuso, Gaston — 418.

Mosko, Illo — 416.

Mustafai, Sulo — 244, 245,
246, 247, 248, 249, 250, 251,
252, 253, 254.

Myslimi, Rudina — 188.

N

Naska, Kozma — 209.

Naska, Simon — 208, 209.

Naska, Todi — 207, 208.

Ndroqi, Dr. Shefqet — 205.

Nguyen Van Hong — 33-34.

Njela, Kiço — 477.

Nikson, Riçard — 40, 123, 160,
162, 422, 429, 434, 438, 439,
451.

P

Pik, Vilhelm — 180.

R

- Rankoviç, Aleksandër — 176,
177.
Robo, Xhorxhi — 421.
Rostand, Zhan — 415.
Roxhers, Uiliam — 165.

Ten Hsiao Pin — 427.

Tito, Josip Broz — 111, 119,
172, 173, 174, 175, 176, 177,
178, 179, 446, 447, 449, 450.
Topi, Ilmije — 217.
Treska, Misto — 416.

S

- Sabri, Ali — 166.
Sato, Eisaku — 453.

TH

Theodhosi, Koço — 225-226,
496.

SH

- Sharra, Tomor — 188.
Shehu, Mehmet — 62, 225-226,
232-233, 330, 332, 333-334.

U

Ul briht, Valter — 179-183.

T

- Toska, Haki — 236, 285, 324.
Tozaj, Sihat — 340.

Xhangolli, Ramadan — 364.
Xhufka, Jorgji, Marta — 203,
205, 206.

XH

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Afrikë — 19, 20, 23, 98, 158.
Agjencia Telegrafike Shqiptare — 302.
Algjeri — 158.
Amerika Latine — 20, 98.
Angli — 122.
Austri — 163, 449.
Azi — 19, 20, 26, 98, 427.

B

- Banka Bujqësore — 288.
«Bashkimi» (gazeta ~) — 309.
Beograd — 449, 450.
«Bimët dhe shëndeti i njerëzve» (libri ~, L. Binet) — 367-370.
Boboshticë (Korçë) — 408, 409, 415, 416.
Bosnjë — 448.
Brioni (Jugosllavi) — 178.
Bullgari — 11, 128, 157, 381, 448.

D

- Dardhë (Korçë) — 408.
Dibër — 205.

- Drenovë (Korçë) — 415, 416.
«Drita» (gazeta ~) — 306.
Dumre (Elbasan) — 206.
Durrës — 324, 344, 459.
Dvoran (Korçë) — 408.

E

- Elbasan — 130, 185-191, 192-196, 197-198, 205, 206, 214.

F

- Fabrika e Vajit — Ndraq (Tiranë) — 227.
Fakulteti i Shkencave të Naturaresh i Universitetit të Tiranës — 337, 351.
Francë — 122, 123, 453.
Fronti i Bashkuar i Vietnamit, i Laosit dhe i Kambozhias — 40.

GJ

- «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» (romani ~, I. Kadare) — 417.
Gjermania Perëndimore (RF Gjermane) — 162-163, 447, 450.

Gjirokastër — 85, 205, 230,
305, 309.

K

Kamboxhia — 18, 23, 40.
Kënceta e Durrësit — 344.
Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke (KNER) — 14.
Kodi i Punës i RPSh — 286,
497, 507-508.
Kodi Penal i RPSh — 144.
Kolonjë — 230-231, 309.
Kombinati Metalurgjik — Elbasan — 220, 250.
Korçë — 309, 408, 409, 415,
416, 418.
Kukës — 230-231.

H

Has (Kukës) — 231.
Hekurudha Elbasan-Përrenjas — 338.
Hidrocentrali i Fierzës — 220,
250.
«Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (teksti ~) —
277-278, 283.
Holandë — 163.
Hoxharë (Fier) — 226.
Hungari — 11, 128, 448.

I

Indi — 453.
Indokinë — 18, 24, 34, 36, 112,
159, 160, 161, 428, 431.
Indonezi — 453.
Instituti i Studimeve Ekonomike — 288.
Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste — 485.
Itali — 118, 127, 167, 170, 200,
449, 453.
Izrael — 111, 122-123, 164.

J

Japoni — 427, 433, 452, 453.
«Jeta e re» (gazeta ~) — 301.

L

Laos — 18, 23, 40, 121, 160.
Libi — 158.
Librazhd — 214, 304.
«Luftëtarë» (gazeta ~) —
300.
Luksemburg — 122.

M

Mali i Zi — 179, 448.
Mallakastër — 244-249, 253.
Maqedoni — 179.
Mirditë — 313, 314, 511.
Mongoli — 11.
Moskë — 1, 16, 435.

N

«Nëntori» (revista ~) — 306.

O

Organizata e Kombeve të Bashkuara — 23, 170, 383, 430.

P

«Pararoja» (gazeta ~) — 301, 314.

«Përpara» (gazeta ~) — 301.

«Puna» (gazeta ~) — 300, 309.

Pekin — 421, 429, 434.

Pogradec — 230-231, 253.

R

Radiotelevizioni Shqiptar — 98.

Rafineria e Naftës — Ballsh-Fier — 220, 250.

Republika Arabe e Bashkuar — 158.

Rilindja Kombëtare Shqiptare, patriotët e Rilindjes — 411.

Rumani — 41, 157, 411, 416, 447, 454.

Rusi — 448.

S

Sarandë — 168, 169.

SEATO — 109.

Selckë (Gjirokastër) — 206.

Serbi — 176, 179, 448.

Sovjan (Korçë) — 331.

Stegopul (Gjirokastër) — 206.

SH

Shampanjë (Francë) — 418.

«Shkumbini» (gazeta ~) — 301.

«Shqiptarja e re» (revista ~) — 300.

T

Tajvan — 430, 431.

Tezat e Këshillit të Mbrojtjes — 396, 400.

Tiranë — 291, 294.

Traktati Ballkanik — 449.

Tregu i Përbashkët Evropian — 163.

Tropojë — 85, 253, 304-305.

Turqi — 118, 127, 449.

U

Uashington — 121.

Universiteti i Prishtinës — 173.

Universiteti i Tiranës — 173, 410.

V

Vlorë — 168, 185, 230, 305, 309.

Vrith (Shkodër) — 63.

Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~)

- 1, 299, 300, 301, 302, 303, “Zëri i rinisë» (gazeta ~) —
305, 306, 307, 308, 309, 314, 300, 309.
482, 483. Zvicër — 163.

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 46-TË V—IX

1971

KONGRESI I RESTAURIMIT TË KAPITALIZMIT DHE I SOCIALIMPERIALIZMIT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (17 prill 1971)	1—32
FITORJA PËRFUNDIMTARE NUK VARET NGA VULLNETI I REVIZIONISTËVE, POR NGA LUFTA E MARKSISTË-LENINISTËVE, NGA LUFTA E PO- PUJVE TË BOTËS — Nga biseda me ambasadorin e RD të Vietnamit, Nguyen Van Hong (17 prill 1971)	33—42
TË NGREMË NË NJË NIVEL MË TË LARTË PËR- MBAJTJEN DHE ORGANIZIMIN E PUNËS SHKEN- CORE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Po- litike të KQ të PPSH (20 prill 1971)	43—55
SHKOLLËN TA NDËRTOJMË NË PËRPUTHJE ME ZHILLIMIN E EKONOMISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 prill 1971)	56—59
TOKAT E REJA QË HAPEN, TË FUTEN MENJË- HERË NË PRODHIM — Nga një bisedë me sekretarë të KQ të PPSH dhe me disa shokë të Qeverisë (23 prill 1971)	60—68

AVIATORI ME AVIONIN JANË NJË E TË PANDARË — Fjala me rastin e 20-vjetorit të krijimit të armës së avacionit (24 prill 1971)	69—86
TË LUFTOJMË KONSERVATORIZMIN DHE FORMALIZMIN NË PUNËN ME RININË — Nga biseda me sekretarin e parë të KQ të BRPSH (28 prill 1971)	87—106
TAKTIKAT T'I SHËRBEJNË STRATEGJISË REVOLUCIONARE — Nga biseda me delegacionin e punëtorëve kinezë (30 prill 1971)	107—114
VULLNETIN E NJË POPULLI TË BASHKUAR DHE TË VENDOSUR NUK E MPOSHT DOT AS ARMA MË MODERNE — Nga biseda me delegacionet e huaja që morën pjesë në festimet e 1 Majit (6 maj 1971)	115—129
TË ORGANIZOHET MË MIRE PUNA EDUKATIVE DHE LUFTA PARANDALUESE KUNDËR KRIMINALITETIT — Fjala në mbledhjen e zgjeruar të byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit (7 maj 1971)	130—184
NË ÇERDHE E NË KOPSHTE FËMIJËT RRITEN TË SHËNDETSHËM E TË LUMTUR — Nga bisedat e zhvilluara gjatë vizitave në Lagjen e Re të qytetit të Elbasanit (8 maj 1971)	185—191
ASHTU SI NJERIU QË NUK MUND TË RROJË PA BUKË, EDHE EKONOMIA NUK MUND TË RROJË PA HEKUR — Fjala në mitingun spontan me banorët e Lagjes së Re në Elbasan (8 maj 1971)	192—202
KUR KALON MOSHA, KEMI EDHE MË SHUMË MALL PËR VENDLINDJEN — Nga bisedat në familjen e shokut Jashar Menzelxhiu si dhe në atë të shokut Jorgji Xhuska (8 maj 1971)	203—206

NJEREZIT QË ECIN NË RRUGËN E PARTISË JANË TË PAHARRUAR NGA POPULLI — Nga biseda në familjen e komunistit veteran Todi Naska (8 maj 1971)	207—210
EDHE KËSHTU SIÇ JE, PA SY, E NDIHMON PARTINË — Nga biseda në familjen e nënë Hatixhe Ekmekçiut (8 maj 1971)	211—215
VULLNETI I ÇELIKTË E BËN NJERIUN TË DO-BISHËM — Nga biseda në familjen e Heroit të Punes Socialiste Nuredin Hoxha (8 maj 1971)	216—219
TË RRITIM MEKANIZMIN E PROCESEVE TË PU-NËS NË NDËRTIM, NË BUJQËSI DHE KUDO — Nga biseda me disa shokë të Qeverisë (17 maj 1971)	220—231
PROBLEMET E ZHVILLIMIT TË BLEGTORISË ZGJIDHEN ME FRYMË DHE PUNË REVOLUCIONARE — Nga biseda me disa shokë të Qeverisë (18 maj 1971)	232—243
PËR POPULLIN DO TË VIJNË DITË EDHE MË TË LUMTURA — Nga biseda me komunistin nga Mallakastra, Sulo Mustafai (21 maj 1971)	244—254
PËR TË RRITUR MË TEJ ROLIN E ORGANIZATAVE-BAZË TË PARTISË NË DIKASTERE DHE NË INSTITUCIONET QENDRORE ADMINISTRATIVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 maj 1971)	255—278
DISIPLINA NË PUNË KËRKON ZBATIMIN ME PËRGJEGJËSI TË DETYRËS PERSONALE DHE KOLEKTIVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 maj 1971)	279—297
ORGANIZIMI I RI I KOOPERATIVAVE BUJQËSORE BËHET PËR TË SHTUAR PRODHIMIN — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 maj 1971)	288—298

SPONTANEITETI I SHKRIMEVE NË SHTYP E UL INTERESIN E LEXUESIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 qershor 1971)	299—315
DISIPLINA PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT KËRKOHET NË TË GJITHË SEKTORET — Diskutim në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe të Këshillit të Minis- trave të RPSH (24 e 25 qershor 1971)	316—347
MBI PROJEKTDIREKTIVAT E PLANIT TË PESTË PESËVJEÇAR — Fjala në Plenumin e 12-të të KQ të PPSH (29 qershor 1971)	348—373
ATDHEU ËSHTË I GJITHË POPULLIT, PRANDAJ DUHET TË MBROHET NGA I GJITHË POPULLI — Nga fjala në Plenumin e 12-të të KQ të PPSH (1 korrik 1971)	374—406
DASHURIA PËR POPULLIN DHE ATDHEUN TË BËN TË RI — Nga biseda me shkrimitarın Viktor Eftimiui (2 korrik 1971)	407—420
STRATEGJIA E PARTISË SONE KA QENË DHE MBETET PËR LUFTË SI KUNDËR IMPERIALIZ- MIT ASHTU EDHE KUNDËR REVIZIONIZMIT MO- DERN — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (2 gusht 1971)	421—440
ME MIQTË NUK MBAJMË REZERVA, ÇËSHTJET I SHTROJMË HAPUR — Nga biseda me një dele- gacion ushtarak të RP të Kinës (20 gusht 1971)	441—457
REALIZIMI I PLANIT TË MOS NDAHET NGA PLOTËSIMI I NEVOJAVE TË POPULLIT — Nga biseda me sekretarë të KQ të PPSH dhe shokë të Qeverisë (2 shtator 1971)	458—465

DISA PROBLEME TË KONTROLLIT PUNËTOR NË FUSHËN E ARSIMIT DHE TË KULTURES — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 shtator 1971)	466—484
MBI MOSHËN E EFEKTIVIT TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 shtator 1971)	485—492
SHEMBULL I LARTË FRYMËZIMI PËR CILINDO — Letër drejtuar Heroit të Punës Socialiste Shyqyri Kanapari (21 shtator 1971)	493—494
PËR FORCIMIN E DISIPLINES PROLETARE NË PUNË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 shtator 1971)	495—509
IDEALI MË I LARTË I FRROK KAÇORRIT ISHTE T'I SHËRBENTE ME BESNIKËRI DERI NË FUND PARTISË SË DASHUR — Letër drejtuar familjes së shokut Kolë Kaçorri (23 shtator 1971)	510—513
Treguesi i lëndës	517
Treguesi i emrave	527
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera	531